

Dr. Nuhi Veselaj

**INJORIMI DHE DËSHMIMI
ME PAHIR I GJUHËS SHQIPE
SI KRITER I SË VËRTETËS**

Shkas vepra e Z. M. S. Milojević (1866-1873) dhe e pranët e pasuesit e tij

(Vështrim historiko-gjuhësor)

ERA
Prishtinë, 2023

Dr. Nuhi Veselaj

**INJORIMI DHE DËSHMIMI ME PAHIR I GJUHËS
SHQIPE SI KRITER I SË VËRTETËS**

*Shkas vepra e Z. M. S. Milojević (1866-1873)
dhe epranët e pasuesit e tij*

Recensues:

Prof. dr. Begzad Baliu

Prof. dr. Mustafa Ibrahim

Prof. Dr. Nuhi Veselaj

INJORIMI DHE DËSHMIMI ME
PAHIR I GJUHËS SHQIPE
SI KRITER I SË VËRTETËS

*Shkas vepra e Z. M. S. Milojević (1866-1873)
dhe epranët e pasuesit e tij*

(Vështrim historiko-gjuhësor)

ERA
Prishtinë, 2023

Tryeza e lëndës

Parashtresë nga recensionin, i Prof. dr. Begzad Baliut:	1
MONOGRAFIA E PARË KRITIKE PËR SHKENCËN ROMANTIKE SERBE TË SHEKULLIT XIX	1
PARATHËNIE	19
Kreu I	43
INJORIMI I GJUHËS SHQIPE SI KRITER I SË VËRTETËS RRETH ZBËRTHIMIT TË PËRQINDJES ETNIKE SERBE-JOSERBE NË NJË PJESË TË SERBISË SË VJETËR - KOSOVË (1866/1873)	43
Hyrje	43
NËNKREU I	43
Nënkreu II	51
DISA KONSTATIME RRETH TERMAVE NGA LEGJENDA DHE NDONJË SQARIM I DOMOSDOSHËM	51
1. Legjenda: shenjëzimi e rubrikat	51
2. Disa sqarime që imponohen sot rreth domethënies së shenjëzimit për grupet përkatëse etnike	52
3. Sqarime të tjera	59
NËNKREU III	61
KONSTATIME NGA TË DHËNAT NGA VITI 1866/68 PËR DISA VENBANIME NË SERBINË E VJETËR (KOSOVË) DHE PËRBERJA E TYRE ETNIKE	61
Hyrje	61
Tabela e shkurtesave	62
Shënim:	63
A) KONSTATIME NGA ZONA E KADILLËKUT TË KURSHUMLISË	63
B) KONSTATIME NGA ZONA (nahitë) E KOSOVËS QENDRORE	67
2) Raporti i të dhënave nga hapësirat e grupimeve të tjera të kësaj nënjesie zonale	68

Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës

2. Fshatrat e Drenicës (Sela Drenice)	70
3. Nahia e Vushtrrisë (Vuçiternska nahija)	71
5. Disa fshatra nga Nahia e Gjilanit	73
Tabela përmbyllëse rreth gjendjen etnike të Zonës së Kosovës Qendrore	73
C) KONTATIME NGA ZONA E RRAFSHIT TË DUKAGJINIT (Metohija)	74
Tabela përmbyllëse, njësisë zonale Pejë	77
2. Nahia e Gjakovës (Djakovička nahija)	78
Tabela përmbyllëse: Njësia zonale Gjakovë	81
3. Nahia e Prizrenit	82
5) Bajraku i Suharekës ose Disa fshatra nga Rrafshaku dhe Rrethbjeska e Therandës	83
Tabela e nënnjesisë 5	84
Tabela përmbyllëse: Njesisë zonale Prizren	88
Tabela e rezultatit të tri njësive zonale të Zonës së Rr. të Dukagjinit: Pejë, Gjakovë, Prizren	89
NËNKREU IV	90
VENERIME DHE SQARIME TË NATYRËS GJUHËSORE E KUPTIMORE RRETH LËNDËS SË TRAJTUAR	90
1) Disa konstatime të përgjithshme formale byroteknike-administrative	90
NËNKREU V	98
Përplotësim e përforcime rreth disa të dhënave përmbyllëse statistikore	98
a) Statistika për numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse	98
b) Statistika për numrin e shtëpive sipas etnive për qytetet mbi 500 shtëpi:	100
c) Vërejtje rreth disa të dhënave pa mbulesë po mbi këtë temë në veprën e fundit të z. Mirčeta Vemić	100
1) Gjendja statistikore e popullsisë (shtëpive) në tri zonat:	103

Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës

2) Statistika për numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse	104
SHTOJCË(fotokopje)	108
Të dhënat tabelare statistikore sajuar nga z. Vemic 2005 sipas Udhëpërshkrimit të z. Milojevic 1866-1873	108
I. Zona e Kushumlisë Куршумлијски кадилук – нахија	108
II. Zona e Kosovës Qendrore Приштинска нахија / Priština nahiya i dr.	114
Zona e Dukagjinit – Metohisë	119
1. Okrug peñki	119
2. Nahia e Gjakovës /Djakovichka нахија	122
3. Nahia e Prizrenit / Призренска нахија	125
Kreu II	133
INJORIMI POR EDHE DËSHMIMI ME PAHIR (1872) I GJUHËS SHQIPE DHE TË VËRTETËS JETËSORE SHQIPTARO-SERBE NË KOSOVË E MË GJERË	133
Hyrje	133
NËNKREU I	135
INJORIMI POR EDHE DËSHMIMI ME PAHIR PËR POTURËT E GJUHËN E TYRE (1866-1867),	135
NËNKREU II	141
Kreu III	153
RRETH REFLEKTIMIT KONTAMINUES TË KONCEPTEVE TË TERMAVE: S(K)LLAVË E SERBË (SI ETNI) DHE S(H)KIZMË (SI DUKURI) NË GJUHËN SHQIPE	153
NËNKREU I	153
RRETH KUPTIMËSISË DHE ETIMOLOGJISË SË FJALË-TERMAVE NDËRKOMBËTARË: SLLAV (SKLLAV) e serb (ShERB-) DHE SKIZMA (SHKIZMË)	153
a) Rreth përhapjes në fillet e mesjetës të fjalë-termit etnonimik skllav /sllav e serb (sherb-) në disa gjuhë të huaja dhe serbisht e shqip	154

Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës

Pasqyrza e fjalëtermave: sclavus e slave, servus +folja dhe scisma	155
NËNKREU II	161
FJALËT SHKJA/SHKIZMË NË KONTANIMI SEMANTIKE NË DISA BURIME SHQIPE KRYESISHT TË HERSHME LEKSIKOGRAFIKE DHE AKTUALE	161
NËNKREU III	168
DISKUTIM PËR ÇËSHTJE TË IMPONUARA GJUHËSORE NGA FJALORI I MEHMET ELEZIT LIDHUR ME TERMAT SHKA E SHKIZMË	168
1) Rreth përkufizimit të parë	169
2) Rreth përkufizimit të dytë	171
1. Rreth fjalës së urtë “Ruejna Zot prej shkaut të dejun e turkut të untë”	172
2. Rreth dy mallkimeve dhe gjeneza e tyre	173
a. Rreth gjenezës së mallkimit të parë	174
b. Rreth gjenezës së mallkimit të dytë	175
Kënga «Prej Prokupje deri në Nish»	176
(2) Diskutim për dy derivatet e imponuara risimisht nga Fjalori i M. Elezit	181
Kreu IV	189
ARBËRIA GJATË PERIUDHËS SË SUNDIMIT OSMAN, RAPORTI TURKO-SHQIPTAR/ SLLAVO-SHKA DHE PASOJAT FATALE MBI SHQIPFOLËSIT NGA SHKIZMA E RE	189
Nënkreu I	190
RAPORTI ARBËR/SHQIPTAR DHE SHKIZMA FATALE IDEO-FETARE, NDODHUR GJATË PERIUDHËS OSMANE	190
Nënkreu II	196
OPINIONE RRETH PREJARDHJES SË FJALËTERMIT “SHQIPTAR”	196
1. Opinione rreth tri hipotezave jo tërësisht të lehtërrëzueshme	198
3) Rreth opinionit: folja me shqipë apo shqip ose shqipoj apo me shqipue dhe ndërtimi i emrit shqiptar, shqipo-i	204

c) Rreth konceptit të foljes shqipoj si veprim dhe të emrit shqiptar si veprues në koincidencë ose puçje rrënjëzimi fjalësor me disa gjuhë të huaja	216
ç) Përforcim-përcaktimi i koncepteve: “shqipja shqip”, “disiplinimi i shkopit” dhe mitizimi i të “shqiptuarit me shkop” që nga lashtohistoria shqiptare	220
a. Rreth prejardhjes së etnonimit shqiptar nga fjalë-tema scip/scop shqip- (shkip e shkop – si mjet drunor)	220
b. Shqiptari dhe përdorimi me kuptim të zgjeruar figurativ të shkopit (shkipit)	222
c. Lashtohistoria e shqiptarit dhe mitizimi i të shqiptuarit rreth “disiplinimit të shkopit” si kult-mit i trashëguar	224
a) Rreth mitizimit të sintagmës “disiplinimit të shkopit”	224
b) Rreth rastit “disiplinimi i shkopit” si kult i trashëguar te ne, apo jo?	227
c) Raste të tjera të trashguara nga realiteti ynë rreth “disiplinimit të shkopit”	229
d) Rikthim rreth tri hipotezave jo të lehtërrëzueshme rreth etimologjisë “shqipo- shqiptar”	232
2. Edhe disa konstatim-venerime të hijesuara me përgjërim	235
Kreu V	245
FEJA ORTODOKSE SI SHKAK-PASOJË NË PËRCAKTIMIN E KOMBËSISË TË SHKIVË TË VENDIT NË PËRGJITHËSI DHE ATYRE TË FSHATIT REÇAN TË THERANDËS NË VEÇANTI	245
Nënkreu I	246
RRETH HISTORIKUT TË FSHATIT REÇAN TË THERANDËS (SUHAREKËS)	246
Nënkeu II	253
I. PAQARTËSI RRETH PREJARDHJES PARAIKLAME RITOKRISTIANE TË FAMILJES VESELAJ E PËRGJITHËSISHT	253
Nënkreu III	258
PAK FJALË RRETH ROLIT DREJTUES-KONSOLIDUES TË PLEQNARIT MEHMET REÇANI SI BRENDA-PËRBRENDA FAMILJES E FSHATIT SI DHE JASHTË	258

Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës

a) Të bëma e veprime me jehonë të brendshme, familje e fshat	261
b) Veprimtari, me vlerë me jehonë të jashtme shoqërore	263
NËNKREU IV	267
PAQARTËSI E SERBO-DHUNË RRETH PËRVETËSIMIT TË VARR-MURANËS SIPERMENDORE TË FSHATIT NË KISHË SERBE	267
Nënkreu V	284
SI KANË QENË MARRËDHËNIET TONA FQINJËSORE ME SHKITË E FSHATIT GJATË MBAMENDJES SIME 90-VJEÇARE, QË NGA DHJETËVJETËSHI I FUNDIT PARA LDB-SË (1933-1941) DERI NË LUFTËN E FUNDIT 1996-1999?	284
2) Nga bashkjetesa shqiptaro-muslimane /shqiptaro-ortodokse (1941-1944)	291
3) Nga bashkëjetesa në Jugosllavinë e pas LDB-së	295
NËNKREU VI	299
POLITIKA SHTETËRORE ALBANOFOBE ME PASOJA FATALE NË RAPORTE NDËRFQINJËSORE SHQIPTARO-SERBE EDHE NË FSHATIN TONË	299
Kreu VI	311
SHQIPJA SI PROMOTOR I ZGJIMIT DHE RRRITËS SË SHQIPTARISË NDAJ NACIONAL-SHOVINIZMI SERBOMADH, DHE VATRAVE TË TJERA PENGUESE	311
NËNKREU I	314
RRETH DIFERENCIMIT E PËRKIMIT TË ETNOGJENEZËS SHQIPTARE E SERBE KRYESISHT NGA BURIMET BASHKËKOHORE SERBE	314
NËNKREU II	319
ARGUMENTA PARA E MESJETARË, GJITHSESI PARA SHEKULLIT XIX QË DËSHMOJNË VIJIMSINË E SHQIPTARËVE DHE BASHKËPRANINË E TYRE ME SERBËT (KRISTIANË) NË KOSOVË	319
NËNKREU III	346
BASHKËPRANIA DHE KONTRIBUTI I SHQIPTARËVE NË BASHKËJETESË ME TURQ, SERBË, GREKË E TË TJERË DHE MOSPËRFILLJA GJITHANDEJ E TYRE NDAJ ASPIRATAVE TË RILINDJES SHQIPTARE	346

Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës

NËNKREU IV	356
PËRKUNDËR PENGESAVE TURKO-SERBO–GREKE E GJITHANDEJ NË PRAG E GJATË I RILINDJES SHQIPTARE GJUHA SHQIPE SI PROMOTOR KARAKTERISTIK I SHQIPTARISË ÇAU PËRPARA	356
Kreu VII	371
KONTRIBUTI ME PAHIR I Z. MILOJEVIC PËR “SHKIPËT“, HISTORINË E GJUHËN SHQIPE	371
NËNKREU I	374
NËNKREU II	379
DISA TË DHËNA HAMENDESE HISTORIKE ETIMOLOGJIKE TË MILOJEVIÇIT PËR SHKIPËT E GJUHËN E TYRE	379
NËNKREU III	385
RRETH PËRKTHIMIT TË DY VJERSHËZAVE NGUCAKEQE PREJ SHQIPES Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës, shkas vepra e z. Milojević (1866 -1873) dhe epranët e pasuesit e tijSERBISHT DHE SHËNIMIT T Ë NJË KËNGE POPULLORE SHQIPE	385
a) Vjershëza e parë: Pop, Pop...	387
b) Vjershëza e dytë: Shkja, Shkja ...	387
3) Rreth kontinuitetit të vjershëzave të tilla ngucakeqe në raporte përçarëse ndërfaqetare brendashqiptare	389
(2) Rreth shënimit të një kënge popullore shqipe -Kënga e kumonës	391
NËNKREU IV	396
RRETH SIFJALORHTIT DYGJUHËSH SHQIP-SERBISHT 1873)	396
Nyja e asnj.	414
a) Konstatime për kontributin e Sifjalorhtit dygjuhësh që si veçori argumentuese nuk mund të mohohet dot në të dyja gjuhët	440
b) Konstatime e venerime si kontribut që nuk mund të mohohen dot si veçori të gjuhës shqipe	440
5) Komenti ynë i shkurtër rreth disa shembujve që dëshmon modelin e formëzimit shqip të shprehjeve të tilla që nga lashtësia	445

Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës

1. Disa dromca realiteti, përkundër qëndrimit subjektivist të Milojeviçit në atë kohëhapësirë	450
2. Disa të dhëna hamendëse historiko-etimologjike të autorit lidhur me shqipët e gjuhën e tyre	450
3. Rreth përkthimit të dy vjershëzave ngucakeqe prej shqipes në serbisht dhe shënimit të një kënge në shqipe	452
4. Rreth Sifjalorthit shqip-serbisht (1873)	453
PËRFUNDIMI I VËSHTRIMIT KRITIK HISTORIKO-GJUHËSOR I VEPRËS INJORIMI DHE DËSHMIMI I GJUHËS SHQIPE SI KRITER I SË VËRTETËS NGA M. MILOJEVIC (1873)	456
a) Statistika për numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse	461
b) Statistika për numrin e shtëpive sipas etnive për qytetet mbi 500 shtëpi:	461
II) NJOHJA ME TË VËRTETËN PA MITE TË GËNJESHTËRTA E URREJTJE NDËRETNIKE, SOTPËRSOT ËSHTË ZGJIDHJA E VETME REALE DREJT MIRËKUPTIMIT E PAQETIMIT SHQIPTARO-SERB	475
R E Z Y M E	490
a) Statistka mbi numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse	493
b) Statistika për numrin e shtëpive sipas etnive për qytetet mbi 500 shtëpi:	494
Pasqyrza e fjalëtermave: sclavus e slave, servus +folja dhe scisma	497
R E S U M E	512
a) Statistics on the number of villages and houses by ethnicity in the three relevant areas	517
b) Statistics on the number of houses by ethnicity for towns over 500 houses:	517
TË DHËNA BIO-BIBLIOGRAFIKE PËR AUTORIN	539

Parashtrësë nga recensionin, i Prof. dr. Begzad Baliut:

**MONOGRAFIA E PARË KRITIKE PËR SHKENCËN
ROMANTIKE SERBE TË SHEKULLIT XIX**

Nuhi Veselaj, *Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe, si kriter i së vërtetës. Shkas vepra e z. Milojević (1866 -1873) dhe epranët e pasuesit e tij*, Era, Prishtinë, 2023.

Prej vitesh dija albanologjike ka theksuar disa veçori të romantizmit serb dhe burimet e miteve të tyre, të cilat jo njëherë janë bërë sinonim i luftërave, grindjeve ballkanike dhe madje gjenocidit serb ndaj popujve fqinj. Prej vitesh ndërkaq, ka theksuar dhe ka fajësuar një paradigmë shkencore të ndikimit të saj edhe në botimet shkencore europiane dhe më tej, shkollën antropogjeografike të Jovan Cvijiçit, e cila megjithëse nuk përkon me shkencën serbe të shekullit XIX, sepse si shkollë dhe metodë ka nisur në fillim të shekullit XX, ajo në të vërtetë mitet serbe i ka përdorur dhe ju ka dhënë karakter shkencor edhe gjatë gjithë shekullit XX e fillimit të shekullit XXI.

Shkenca shqiptare dhe dija albanologjike në përgjithësi, disa herë nga autorë shqiptarë e të huaj, i ka dhënë përgjigje shtrirjes së koncepteve mitike serbe në hapësirën shqiptare në përgjithësi dhe në hapësirën e Kosovës në veçanti. Mjafton të kujtojmë këtu studimet polemizuese të Norbert Joklit, Milan Shuflait, Eqrem Çabejt, Selman Rizës, Idriz Ajetit, Rexhep Qosjes, Selami Pulahes, Ali Hadrit, Mark Krasniqit etj., të shquara në rrafshin antro-po-gjeografik, antropologjik, linguistik, historik, publicistik etj., për të kuptuar përmasën shumështrësore të kësaj mbrojtjeje kombëtare ndaj një politike largvajtëse në shkencën serbe.

Nuk kemi pasur ndërkaq tekste, qofshin ato thjesht deskriptive, artikuj, studime, vepra, analiza apo sinteza të studiuesve shqiptarë për mendimin shkencor të studiuesve serbë të shekullit XIX, të cilët, me gjasë nën ndikimin e mendimit shkencor austro-hungarez dhe ende larg ndikimit të shkollës politike ruse, bënë kërkime edhe në Sanxhakun e Nishit e të Novi Pazarit, në Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, por në veprat e tyre, megjithatë, sikur shprehet profesori ynë Nuhi Veselaj, “me pahirë”,

lanë të shkruara edhe disa aspekte të jetës materiale e shpirtërore të shqiptarëve, me interes për trashëgiminë e tyre edhe në kohën tonë.

Studiuesi dhe shkrimtari Nuhi Veselaj (1933) është njëri prej lingvistëve, shkrimtarëve, edukatorëve dhe pjesëtarëve të Lëvizjes kombëtare, i cili me jetën e tij, me punën e tij e me krijimtarinë e tij, është përpjekur që t'i kontribuojë shkencës shqiptare, kulturës shqiptare, shkollës shqipe dhe vlerave kombëtare përgjithësisht. Në vendlindje bëri mësimet fillore, ndërsa Shkollën Normale e përfundoi në Gjakovë. Më 1963 autori ynë i takon gjeneratës së parë të studentëve, të cilët mbarojnë studimet në Degën e Gjuhës e të Letërsisë Shqipe në Universitetin e Prishtinës. Me gjithë vështirësitë sociale dhe ekonomike, politike e të sigurisë, ai vazhdoi studimet pasuniversitare dhe në vitin 1980 në Universitetin e Prishtinës merr gradën shkencore magjistër i shkencave filologjike, me një temë mbi gjuhën e shkrimtarit kombëtar Aleksandër Stavre Drenova - Asdreni. Po këtu, kur ndryshimet ligjore dhe politike i hapin rrugë, më 1992, mbron tezën e doktoratës. Më shumë se dy dekada, i përndjekur dhe i penguar që të merret me kërkime shkencore, ai u detyrua të punojë në institucione prodhimi, duke kryer detyrën e përkthyesit. Megjithatë, gjatë kësaj kohe, ai nuk u ndal së shkruari edhe tekst letrare duke dëshmuar njëkohësisht edhe cilësi të tjera njohëse në fushë të kulturës së popujve të tjerë që jetonin apo jetojnë në Kosovë.

I theksova disa prej elementeve biografike të tij, për të përgatitur lexuesin e kësaj vepre me përmbajtje shumështrësore dhe shumëdimensionale në rrafshin nacional dhe krahasues me popujt tjerë në Kosovë.

Monografia e studiuesit dr. Nuhi Veselaj me titull *Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës, shkas vepra e z. Milojević (1866 -1873) dhe epranët e pasuesit e tij*, është shkrua duke e pasur si shkas veprën e M. Vemić, *Etnička karta dela Stare Srbije*, botim i Institutit Gjeografik “J. Cvijić”, SANU, Beograd (2005), hartuar sipas veprës së M. S. Milojević *Putopis dela Prave Stare Srbije (1866-1873)*, me vlerësim të akademik Vladimir Stojančević, ku ndër të tjera, mbështetur në konstatimet e tyre, e në veprat origjinale të Milojeviqit, si dhe në burime të tjera, para studiuesve imponohen këto dy konstatime e qëndrime, të cilat autori i ka verifikuar me kujdes dhe me kompetencë:

- në radhë të parë, nga hartat, përkatësisht nga regjistrat sipas tri zonave regjistruese në tërë hapësirën e një pjese të ‘Serbisë së vërtetë’, d.m.th. kryesisht të Kosovës së sotme, në fshatra e qytete, me dhjetëra vite

para Luftës serbo-turke (1876-1878), shihet që serbët ishin 90% shumicë kundrejt shqiptarëve pakicë dhe

- në radhë të dytë, ky *Udhëpërshkrim (Putopis) në historio-gjeografinë serbe*, si me thënë, pothuaj 143 vite ishte shpërfillur e mohuar pa të drejtë, nga shkenca e politika zyrtare serbe.

Veprën trivëllimshe në fjalë, përkatësisht lëndën nga vepra e Vemiqit rreth marrëdhënieve ndëretnike shqiptaro-serbe me theks në aspektin historiko-gjuhësor studiuesi ynë e ka vështruar në shtatë krerë. Por, ne po e hapim këtë *Parashitresë* me një fragment nga *Parathënia* e veprës III të Milojeviqit, për shkak se ky pasues si asnjë tjetër, përfaqëson rrethanat historike të botimit të saj dhe disa veçori specifike që përfaqëson ajo, si me përmbajtjen nacionaliste ashtu edhe me lëshimet e rastit, apo kintributin me pahir në të mirë *shqipëve* e gjuhës së tyre, të cilat e dëshmojnë të kundërtën e dëshiruar për gjendjen në teren.

Për këtë libër nuk ka dashur me më ndihmë Shoqata e Dijetarëve Serbë për mungesë mjetesh, andaj do ta botoj me harxhime vetjake, duke shpresuar që publiku ynë serb sinqerisht do të më shpërblejë. Kjo vepër është dorëzuar në shtyp para katër vitesh, por për shkak të shumë punëve nga dy vitet e kaluara dhe për shkak të angazhimit në kufi, vetëm tash është gati. Gjatë angazhimit tim në kufi më kanë humbur dy tabakë të dorëshkrimit, ndërsa shënime nuk kam për t'i kompensuar, andaj (vepra) do të dalë jo e plotë, sidomos mbi Prizrenin. Përveç kësaj nuk kam kohë t'i përmirësoj gabimet e shtypit, andaj lus lexuesit e lexueset e nderuara, që ku t'i vërejnë gabimet, korrigjimet le t'i bëjnë vetë, ngase kur të botohet tërë Udhëpërshkrimi nga pjesa e Serbisë së Vërtetë, që përbëhet prej 12 vëllimesh, në librin e fundit do të vendoset si shtojcë: Regjistri i korrigjimeve1.

1 Teksti i origjinalit. **Predgovor:** Ову свеску није ми хтело Срп. уч. друштво помоћи због својих материјалних незгода, те сам је о сопственом трошку напечатао, држећи да ће ме наша, српска публика својски подпомоћи. — Дело је ово дато у штампу још пре 4 год. па због многих послова, за прошле две године, и ове због мог бављења на граници, сад је тек готово. У мом бављењу на граници изгубили су се неки табаци рукописа, а прибележака немам да их надокнадим, те тако излази неподпуно нарочито о Призрену. Осим овог немам кад назначити печатње погрешке, те молим г. г. читаоце и читачице да их сами, изволе поправити где примете, а кад сав Путопис дела праве Србије, којег има

Beograd, më Pashkë 1877. M. S. Milojević'

Vepra e udhëpërshkruesit M. S. Milojeviq dhe e botuar në shek. XIX, dikur është projektuar për interesa të nacionalizimit serb, ndërsa së fundi u ribotua nga M. Vemić, me qëllim të ruajtjes së kujtimit të miteve serbe për pushtime të reja, sjell njëkohësisht edhe një pasqyrë të raporteve politiko-shoqërore serbo-shqiptare, sidomos nga fillimi i shekullit XIX. Këtyre qëllimeve i shërbeu edhe intelektual i entuziast i kohës Milosh S. Milojević. I shkolluar në institucionet shkencore ruse dhe në Kishën Pravosllave Serbe, Milojeviq u dërgua në të ashtuquajturën Serbi të Vjetër, me udhëzime për të përshkruar gjendjen fetare, gjeografike, kulturore dhe etno-historike të kësaj hapësire e të popujve që jetonin atje. Prej variantit të parë, në të vërtetë prej dokumentit bazë, nuk është vështirë të shihet se përshkruesi ishte i përgatitur për të kryer këtë mision, por prej botimit të tri vëllimeve të para (nga 12 të supozuara sa thotë se i kishte në dorëshkrim). Nëse botimi i parë në dy vëllime (*sveske*) e kishte bërë me titull "*Putopis, dela Prave Stare Srbije*" (*Udhëpërshkrim nga një pjesë e Serbisë së Vërtetë, të Vjetër, në vitin 1871, 1872 dhe që vlerësuar si vepër e përshtatshme propagandistike para fillimit të Krizës Lindore (1877-1878), vëllimin e tretë të përgatitur më 1873, do ta botojë më 1877, gjatë luftës, gjithsesi me qëllim propagandistik 'të ruajtjes së kujtimit të të parëve për tokat e vjetra', ku ishin gjoja shumicë!*

Do theksuar që në fillim se autori i veprës gjatë luftërave ruso-turke ishte komandant i vullnetarëve rusë dhe nxënësve të tij serbë. Pavarësisht vlerësimit të parë dhe pavarësisht nderimit të autorit, si luftëtarë kombëtar, vepra e tij do të mbahet nën rrogoz, me gjasë për dy arsye të ndryshme: e para, për shkak se ndonjërit prej studiuesve serbë, me gjasë do t'i shkoj përdore t'i shoh gabimet e Milojeviqit, me rastin e regjistrimit së më të plotë të popullatës, duke përdorur konstruksione të rrezikshme nacionale dhe kritika kundër drejtimit të shtetit gjatë luftës; si dhe e dyta, për shkak se në gjysmën e dytë të shekullit XX, një vepër si kjo, i prishte punë regjimit serb jo vetëm në raport me shqiptarët po edhe me pakicat fare inekzistente, të cilat sado që të ishin, me të qenit e tyre, përmbysnin numrin edhe ashtu modest të serbëve në Kosovë e rrethinë.

Vetëm së fundi, në rrjedhë të propagandës kundër Kosovës, në vitin 2005, pra në fillim të shekulli XXI, me porosi të Akademisë së Shkencave

12 књига, изиђе, ми ћемо ставити. у последњој књизи и регистар и поправке погрешака.

На Ускрс 1877 год. у Београду. М. С. Милојевић

dhe Arteve të Serbisë, si dhe të Kishës Serbe, hartografi Mirçeta Vemiq, njëri prej studiuesve më të pasionuar të mesjetës serbe në Kosovë dhe njërit prej pasionantëve të shkencës propagandistike kishtarë serbe, e nxori nga pluhuri i raftave të kishës serbe këtë vepër, me shpresë se mund të mashtronte edhe më tej opinionin serbë dhe madje duke e botuar edhe në gjuhën angleze, edhe lexuesin ndërkombëtar, se si Kosova para Krizës Lindore paska qenë e banuar jo më pak se me 90% me serbë, kur realiteti ishte i kundërt! Do theksuar fakti se jo rastësisht Memiq, veprën e tij e titulloi “*Etnička karta dela Stare Srbije prema Putopisa, M. S. Milojevića 1871-1873 godine (Harta etnike e një pjese të Serbisë së Vjetër, sipas veprës “Udhëpërshkrime” të M. S. Milojevic 1871-1873, sepse kështu, duke i dhënë titullin e ri dhe duke e përpunuar atë brenda kornizave bashkëkohore të shkencës së hartografisë, Vemiq shpresonte se do ta bindë me gënjeshtër opinionin shkencor vendor dhe atë ndërkombëtar.*

Rileximi, përkatësisht leximi kritik, e qasja metodologjike shkencore, autorit tonë Nuhi Veselaj i ka dhënë mundësinë që të nxjerr në pah jo vetëm të pavërtetat shkencore po edhe sjelljen e një pasqyre të re reale të hartës etnike të shoqëruar me të dhëna bindëse gjuhësore, kulturore, fetare e faktografike. Këto parime të ngritura në metodë kritike-shkencore autori ynë i ka ngritur që në *Hyrje* të veprës dhe i ka ruajtur edhe në diskutimet e mëtejme në të gjithë kapitujt tjerë. Të gjithë kapitujt kanë karakter monografik më vete, madje mund të botoheshin jo vetëm si studime më vete, po mund të hapeshin diskutimet e dokumentet krahasuese, e të botoheshin edhe si vepra më vete.

Studimi i Profesor Nuhi Veselajt hapet me përshkrimin e veprës: *Harta etnike e Serbisë së vjetër sipas “Udhëpërshkrimit” të M. Milojeviçit 1871-1873*, për të vazhduar më tej me diskutimin e nocioneve dhe termave të përdorur në këtë dorëshkrim, duke cekur mungesën e kriterëve shkencore të dijës së sotme moderne me rastin e ribotimit, karakterin e tejkualuar të strukturës gjuhësore, rrafshin semantik dhe natyrën terminologjike të përdorimit të sotëm të tyre në një botim bashkëkohorë çfarë sinon Vemiqi etj. Më tej Profesor Veselaj bën një krahasim të këtyre të dhënave nga udhëpërshkrimi me të vërtetën e numrit të etnive reale dhe kështu arrin në pasqyrimin e numrit real të popullsisë sipas etnive.

Autori ynë Nuhi Veselaj për arsye metodologjike jep të dhënat deskriptive, duke i ndarë në tri zona regjistruese: në Zonën e Kadillëkut të Kurshumlisë, Zonën apo Nahitë e Kosovës Qendrore dhe Zonën e

Dukagjinit. Megjithëse në një format modest, Prof. Veselaj ndalet e diskuton ndonjëherë edhe për çështje të tjera, sikur janë ojkonimet, toponimet e etnonimet e shfaqura në një hapësirë më të gjerë brenda Serbisë Qendrore, sikur është vendbanimi *Arbanashke*, i cili përcakton jo thjesht një vendbanim të ri, po një trashëgimi etnike mesjetare të kësaj zone. Emërtime etnike të kësaj natyre, si ojkonime, toponime e sidomos oronime, janë të pranishme në gjithë Serbinë, Kosovën, Malin e Zi e Maqedoninë.

Mbështetur në leximin shkencor, përshkrimin kritik dhe diskutimin intelektual e gjithëpërfshirës, Profesor Nuhi Veselaj e përmbyll këtë hulumtim me tri konstatime:

a) e para, inicialja identifikuese e etnitetit serbë, në të vërtetë përfshin tërë etnicitetin ortodoksks në serbë, edhe pse në të vërtetë një shumicë e tyre ishin shqipfolës;

b) e dyta, para vitit 1878, qyteti i Kurshumlisë dhe 24 fshatrave përreth nuk kishte pothuajse asnjë banor serb, ndërsa pas vitit 1878, fati i këtyre banorëve vetëm mund të merret me mend; dhe

c) e treta, ai sjell një të dhënë mjaft interesante të studiuesit Jovo Bajiq, se “kjo zonë rreth Kopaonikut paska qenë *Zonë ushtarake e Turqisë*, prandaj në atë zonë nuk kishte fshatra serbe (ortodokse), por vetëm fshatra të banuara me *shqipë e çerkezë*” (2018).

E shohim me interes këtu të theksojmë se të gjitha të dhënat, përveç me burimet historike, etno-gjeografike dhe etno-kulturore, përcillen edhe me shembuj e përbërës gjuhësorë të terrenit dhe atyre të literaturës dokumentare.

Nëse në kapitullin e parë paraqitja e temës më shumë ka karakter deskriptiv dhe shumëdimensional e përgjithësues, në kapitullin e dytë që mban titullin *Injorimi, por edhe dëshmimi me pahir i shqiptarëve dhe i gjuhës shqipe në jetën e përbashkët shqiptaro-serbe në Kosovë dhe më gjerë*, çështjet paraqiten më të thelluara dhe diskutimet më sintetike. Problemi i diskutimit përqendrohet në çështjet kulturore, përkatësisht etnike. Fjala është për një periudhë historike, kur problemet etnike në Ballkan, që në krahasim me popujt tjerë të Europës janë mjaft të vonuara, shfaqen mjaft të ndërlikuara, qoftë në kontekstin gjuhësor, qoftë në kontekstin fetar, qoftë në kontekstin etnik. Në këtë rast janë mjaft me interes nëntitujt dhe çështjet e trajtuara brenda nëntemave, sikur është ai për injorimin, por edhe dëshmimin me pahir për *poturët* e gjuhën e tyre 1866/67, të cilët në viset potenciale serbe, nuk ishin as serbë as turq, po

ishin rrënjësisht shqiptarë. Po kështu mund të thuhet edhe për nëntemën dëshmi rreth ekzistimit të ortodoksëve, por edhe të poturëve shqiptarë gjithandëj në viset potenciale serbe para vitit 1866, mbështetur në dëshmitë e bardit të lëvizjes kombëtare serbe Vuk Karaxhiqi dhe dëshmitë e udhëpërshkruesit serb M. S. Milojeviq. Referencë me interes e këtij kapitulli del shoqëruesi i tij *Mixha Zymer*, që të kujton edhe shoqëruesit e udhëpërshkruesve të tjerë të kësaj natyre gjatë shekullit XIX e XX, mbase edhe një paradigmë kjo e ‘lëshimeve me pahir’ të Milojeviqit, për praninë e shqiptarëve në këto tërthore nën maskën kulturore, fetare, gjysmetnike dhe gjeografike. Dëshmi e etnicitetit të tyre historik, e gjuhës së tyre, e kulturës së tyre mjaft të formuar dhe të përqendruar, e sedentaritetit të tyre brenda territoreve historike dhe etnike në këtë hapësirë është edhe mënyra se si ata u mbajtën gjallë, mënyra se si ata e ruajtën gjuhën e tyre, mënyra se si ata nderuan familjen, etninë, gjuhën dhe kombin, përtej besimit fetar edhe atëherë kur brenda familjes, lagjes apo krahinës bashkëjetonin vëllezër të dy besimeve fetare: mysliman e të krishterë ortodoksë.

Kapitulli i tretë i veprës së Profesor Nuhi Veselajt me titull përshkrues e largvajtës *Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës. Shkas vepra e z. Milojević (1866 -1873) dhe epranët e pasuesit e tij*, është pothuajse plotësisht i çliruar prej natyrës e përbërësve historikë, gjeografikë, kulturorë e etnikë. Autori i këtij kapitulli është përcaktuar që etnonimet historike serbe e shqiptare t’i trajtojë vetëm brenda formatit gjuhësor, madje edhe atëherë kur ato përplotësohen me ndonjë përbërës të karakterit etno-gjeografik, historik e kulturor. Kapitulli i tretë me titull *Rreth reflektimit kontaminues të koncepteve të termave: *shklavë (sclav/us) e *sherb/ë (serv/us) si etni dhe shkizmë (scissm) si dukuri në gjuhën shqipe*”, është artikuluar në tri pjesë: në pjesën e parë është trajtuar problemi i kuptimisë dhe etimologjisë së trajtë-fjalëve të termave ndërkombëtarë skizmë (shkizmë) dhe sllavë (skllavë e serb (shërb-); në të dytin problem i njësisë leksikore *shkja / shkizmë*, në kontaminimet semantike, në disa burime të shqipes, kryesisht të hershme leksikografike dhe aktuale; ndërsa në të tretin, janë sjellë diskutime për çështje të imponuara gjuhësore nga *Fjalori* i Mehmet Elezit lidhur me termat *shka* e *shkizmë*.

Në rastin e parë, shtrirja semantike dhe etimologjike e trajtë-fjalëve skizmë (shkizmë) dhe sllavë (skllavë e serb (shërb-), janë parë në kontekstin ndërkombëtarë, madje që nga mesjeta dhe është krahasuar me

gjuhën shqipe po edhe me gjuhë të tjera të rajonit. Në latinishte e greqishte, -thekson autori, - “të ardhurit e tillë quheshin *skllavë* –/(l.*schlavus/gr. *sklavos) me kuptim *bujkrobë* ose serb. *robovi*), në gjuhën shqipe trajta fillimisht ishte *shklavë*, ndërkohë si gjuhë e gjallë atëherë pësoi ndryshime, pa kuptim pezhorativ, *shkjav*, *shkja*, *shka* – *shkje* /*shkije* – *shqe*,.

Në rastin e dytë, çështja e shtrirjes vertikale dhe horizontale e etnonimit përkatësisht fjalës a termit *shkja* / *shkizmë* është parë brenda burimeve dokumentare dhe letrare e sidomos leksikografike në literaturën shqiptare, që nga *Fjalori* i Frang Bardhit (1635), *Kuvendi i Arbrit* (1703), *Fjalori* i K. Kristoforodhit, *Fjalori i Bashkimit* e deri te *Fjalori* i M. Elezit (2006), si dhe derivatet e kësaj fjale në frazeologjinë shqiptare. Serbët, thekson autori “quheshin: lat. *servus* gr. *servos*, që në shqipe forma fillimisht e kishte rrënjëfjalën: **sherb/ë* (me kuptim jopejorativ shërbyes). Krahaso, *servire servus* te Bardhi e Pjetër Budi, *sherbej* me *shërbye* / *shërbyes sherbëtyrë*, *Servi* / *servijan*, ndërsa të Bogdani: *shërbi* / *sherbyes*, gjithsesi jo në me kuptim pejorativ. Gjithsesi në shqipe fjala *serb* kishte kuptim jonjëetnik dhe joperorativ, ngase ashtu quheshin ortodoksët ose shkizmatikët shqiptarë, që banonin në *Servi*, përkatësisht *Shërbi*”.

Së fundi, autori, kësaj fjale, këtij termi a këtij etnonimi i është qasur kryesisht brenda frazeologjisë, teksteve popullore dhe madje urimeve, mallkimeve e teksteve folklorike, për t’ju kthyer edhe njëherë strukturës gramatikore a fjalëformuese të tij. Në studimin tonë, thekson Profesor Veselaj, “të tria këto trajta: *shkllav* (sclav), *sherb serb* (serv) dhe *shkizmë* (scissm) në ndonjë mënyrë kanë pasur ndërndikim në latinishten (vulgare ose jo), por po, sidomos në serbishte, në formësimin e trajtave përkatëse, të cilat “në mos nën ndikimin e shqipes gjithsesi janë formësuar nën praninë e drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe, andaj rreth kësaj dukurie në dy nënkrerët e fundit të këtij kreu kemi dhënë mjaft prova që mund të diskutohen, por jo, assesi, nuk mund të mohohen”.

Në kapitullin e katërt është diskutuar tema, e cila përshkruhet në mënyrë deksriptive, që në titull: *Injorimi i gjuhës shqipe në Arbëri gjatë periudhës së sundimit osman, raporti turko-shqiptar/sllavo-shka dhe pasojat fatale ndaj shqipfolësve nga shkizma e re. Ose, me sa pasoja mbijetoi shqipja nga presionet e autoqefalive shqiptarofobe ortodokse dhe nga turko-islamizimi fanatik osman*”. Çështjet janë trajtuar në dy nënkapituj, sado edhe vetëm prej titullit mund të shihet se fjala është për më shumë nëntema, për më shumë çështje dhe për më shumë përbërës të

karakterit historikë, socialë, politikë, qytetërues, gjuhësor, e madje edhe material e shpirtëror.

Në plan të parë është diskutuar mbi gjendjen shpirtërore, materiale e qytetëruese të popullit shqiptar në prag e pas pushtimit nga Perandoria e Osmanëve, duke e vënë theksin në ndarjen e tyre në dy ritet e krishtera dhe tani me ofrimin e ritit të tretë, apo fesë islame.

Në nënkreun e parë janë diskutuar tri çështje: raporti *arbër/shqiptar* dhe shkizma fatale ideo-fetare ndodhur gjatë sundimit osman, identifikimi dhe shtrirja gjeografike e Arbërisë, pasivizimi i termit *arbër* dhe nxjerrja kokë e termave me konotacion konfrontues nga *turk* e *shka* në *shqiptar/shka* dhe përftimi e përkufizimi i fjalës-termit *shqiptar* në raport me *shka*; ndërsa në nënkapitullin e dytë janë sjellë elemente të karakterit historikë, gjeografikë, gjuhësorë e kulturorë të prejardhjes së fjalë-termit *shqiptar*, ceken disa hipoteza të kohës, të cilat i konsideron të lehtërrëzueshme, po dallon tri jo lehtë të rrëzueshme. Të mbështetur thekson semantikën e foljes *shqip* me *shqipe*, të cilën e shtron në sistemin eptimor foljor e emëror.

Gjithsesi ky kapitull hapet me çështjet që kanë të bëjnë me karakterin historik të kohës, përkatësisht me rrethanat historike të periudhës së dytë të Mesjetës, në të cilën shqiptarët hyjnë pa atë forcë koherente të tyre dhe me gjuhën shqipe, pa atë forcë fetare e integruese me të cilën hynë fqinjët, si: serbët, bullgarët, grekët etj. Populli shqiptar, i ndarë në fise, forcë pothuajse të vetme kohezive kishte gjuhën, po edhe ajo, sikurse dihet, u ndalua më 31 maj 1779, me dekretin e Sulltanit të Perandorisë Osmane. Me këtë vendim gjuha shqipe u dëmtua, por megjithatë u ruajt vetëm brenda hapësirave familjare myslimane e katolike, por në proveniencën e Shqiptarisë së besimit ortodoks u ruajt jo vetëm deri në kufi me grekët po edhe me sllavët, ndërsa ata në brendi të autoqefalive shqiptarofobe, pothuajse plotësisht u asimiluan.

A është e rastit që shqiptarët e mërguar në Itali bashkë me organizimin kishtar ortodoks të proveniencës perëndimore ruajtën gjuhën në një vend të tretë, ndërsa shqiptarët ortodoksë në Jug dhe në Verilindje të trojeve shqiptare pothuajse u asimiluan, përveç atyre që kaluan në besimin islam?!

Lidhur me atë që z. Nuhi e quan shkizmë të re fatkeqe, po shtojmë ne se sot, historia, gjuha, kultura shqiptare, letërsia shqiptare ruan dhe njeh disa botime të proveniencës katolike që nga shekulli XV, por nuk njeh shkaku i shkizmës së re pothuajse asnjë tekst të librit shqip në

proveniencën ortodokse, sado dihet lulëzimi i kësaj kulture sidomos gjatë shekullit XVIII, kur vetëm gjatë periudhës së viteve 1750-1770 kishte një lulëzim të madh të literaturës ortodokse në gjuhën shqipe, duke përfshirë edhe dy përkthime të plota të Biblës. Ndërkaq, pas dekretit të 31 majit 1779, që mund të quhet dita më e zezë në kulturën shqiptare të shkrimit shqip dhe të identitetit shqiptar, nuk mund të mos besohet se me censurë e pa të, janë zhdukur me qindra vepra e dorëshkrime në gjuhën shqipe. U desh të vinte viti 1827, kur edhe u botua *Dhjata së Re* e Korfuzit, për t'i orientuar të huajt në mësimin dhe krahasimin e gjuhës shqipe. Një hulumtim i kësaj gjendjeje në jug të trojeve shqiptare, përkatësisht në kufi me grekët, besoj mund të dëshmojë edhe për raportin e gjuhës dhe kulturës shqiptare me sllavët këtej në Veri dhe Veri-Lindje, në të cilën shqiptarët, me gjasë, vetëm nën ndikimin e latinitetit perëndimor ruajtën gjuhën, por pranuan besimin e ri islam, i cili jo vetëm ju jepte privilegje ekonomike dhe sociale, por ju mundësonte edhe ruajtjen e gjuhës brenda familjes dhe si shqiptar joshën dhe shqipfolësit kristianë.

Në këtë ose para kësaj periudhë prej pesë shekujsh, shkruan autori, vetëm Skënderbeut i shkoi për dore të bashkonte shqipfolësit e të gjitha besimeve, fiseve dhe krahinave etnografike. Prandaj, pas vdekjes së tij, pësuan të gjithë, duke u shpërngulur drejt Lindjes dhe Perëndimit: ortodoksët e jugut unitë drejt Italisë së Jugut, Egjiptit dhe madje drejt Odesës: katolikët drejt Italisë, Kroacisë dhe përgjithësisht Europës, ndërsa muslimanët drejt Qendrës së Perandorisë. Në këto rrethana u aspërsua edhe shkizma, si term, si besim, si virtyt dhe si koncept i raportit brenda shqiptarëve. Mbi këto paradigma të karakterit historik, gjeografik, fetar, social, kulturor e gjuhësor, autori i kësaj vepre përmyll një hipotezë të rreth etnonimit shqiptar “e përfutur nga trajtë-foljet: *shqip* me *shqipe*, bazë për emërtimin e *gjuhës shqipe* dhe të emrit etnik *shqiptar*, por përmedet edhe trashëgimia e pazhdukur krejtësisht nga miti i Zotit –Zeus, nga shkipi, shkopi apo “*skeptri mitologjik i tij*”.

Kapitulli i pestë mund të quhet i veçantë brenda kësaj vepre dhe madje mund të quhet vepër brenda veprës, jo vetëm për shkak të përmasës shumështrësore të metodës së hulumtimit, po për shkak të hapësirës së hulumtimit. Në kapitullin e pestë, me titull: *Feja ortodokse si shkak-pasojë në përcaktimin e kombësisë së shkive në përgjithësi dhe atyre të fshatit Reçan të Therandës në veçanti*, objekt studimi bëhet një vendbanim i fëmijërisë dhe rinisë së autorit, ndërsa lëndë për diskutim edhe përvoja e tij. Lënda e këtij kapitulli është ndarë në gjashtë nënkapituj.

Në këtë kapitull është sjellë një paraqitje pothuajse deskriptive. Janë me mjaft interes të dhënat që sjell autori mbi raportet serbo-shqiptare, të cilat ai i quan si raporte normale të bashkëjetesës shqiptaromuslimane / shqiptaro- ortodokse, gjatë shekullit XX, me theks të veçantë gjatë kthesave apo ngjarjeve të mëdha historike, sikur janë periudhat e pushtimeve të huaja apo periudhave të konflikteve të brendshme, si dhe gjatë viteve të ndërhyrjes së politikave shoviniste serbe të Beogradit. Sidoqoftë ata megjithatë nuk kanë bërë një jetë të vështirë dhe pothuajse të padenjë shpirtërore brenda bashkësisë së tyre, me vëllezërit e një gjuhe e gjaku deri te lufta e fundit. Në këtë rast autori sjell faktin se serbët e fshatit Reçan, deri në luftën e fundit, asnjëherë nuk patën mosmarrëveshje me shqiptarët e besimit mysliman. Vetëm në luftën e fundit 1999-2000, propagandës serbe i shkoi përdore që të ndizte urrejtjen ndërmjet tyre dhe pas përndjekjes së shqiptarëve dy herë nga fshati, pas humbjes së luftës ushtria serbë-jugosllave, i mori me vete familjet serbo-ortodokse dhe i degdisi nëpër Serbi.

Është me shumë interes tregimi për raportet këtij fshati me shtetin serb në kontekst me një varr-muranë kenotaf, pa eshtra, para luftërave ballkanike ishte nën mbrojtjen e Familjes së Ukë Mehmetit. Kenotafi, një varr shekullor, ka legjendën e tij, kujdestarët historik të tij, historinë e ndërhyrjes nga pushteti dhe madje fundin dhe përvetësimin e dhunshëm nga shteti serb. Serbët e fshatit as që kanë pasur ndonjë ndërlidhjeje trashëguese me te. Pas kësaj paraqitjeje të brendshme të një familjeje shqiptare të besimit islam, në vazhdim sillen të dhëna dhe diskutime shumë konstruktive mbi disa paqartësi rreth përvetësimin të Varr-muranës, kult i fshatit, dhe riemërtimin e tij si kishë serbe, më 1926 i ishte dhënë formë kishëze, ndërsa është ndërtuar e afreske e ikonizuar në vitin 1956-58, dhe së fundi është regjistruara nën mbrojtjen shtetërore, në vitin 1990. I nxitur nga politizimi dhe përvetësimi serb i saj, autori sjell të dhëna të gjëra mbi këtë pasuri prej një shekulli, duke dhënë shembuj të ndryshëm, sidomos të traditës familjare, duke filluar nga privatësia shekullore e tokës ku ishte vendosur objekti, deri te fati i saj pas Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë kapitull të strukturuar në gjashtë nënkapituj, fillimisht sillen një përshkrim detajues për fshatin Reçan të Therandës (Suharekës) dhe vihet theksi në të ashtuquajturën Kartë të Dushanit, botuar në Beograd më 1862, pastaj sillen përbërës dokumentarë dhe të kujtesës mbi disa

paqartësi rreth prejardhjes paraislame ritokristiane të familjes Veselaj, për ta përmbyllur me një portret të pleqnarit Mehmet Reçani.

Në kapitullin e gjashtë autori sjellë dëshmi dhe referenca rreth popullimit të viseve të sotme shqiptare, ndihmuar nga personalitetet e mëdha që e kanë ndryshuar rrjedhën e historisë europiane e aziatike si: Diokliciani, Konstatini i Madh dhe Justiniani. Autori sjellë dy përbërësit më të rëndësishëm të etnisë shqiptare, emrin e popullit dhe gjuhës shqipe, duke e formuluar kapitullin: *Gjuha shqipe si promotor i zgjimit dhe rritës së Shqiptarisë, përkundër nacional-shovinizmit serbomadh dhe vatrave të tjera penguese*, që është shtjelluar në katër nënkrerë. Diskutimi në këtë rrjedhë hapet me një varg argumentesh rreth diferencimit e përkimt të etnogjenezës shqiptare e serbe, mbështetur kryesisht në burimet bashkëkohore serbe, për të vazhduar me argumente të periudhës mesjetarë, të botuara deri në shekullin XIX, të cilat dëshmojnë vijimësinë e shqiptarëve dhe bashkëpraninë e tyre si të krishterë shumicë me të krishterë të tjerë në Kosovë.

Megjithëse të një nënkapitulli më vete, po i kësaj natyre, tani më i hapur është edhe teksti mbi bashkëpraninë dhe kontributin e shqiptarëve në bashkëjetesë me turq, serbë, grekë e të tjerë, si dhe mospërfillja gjithandej e tyre ndaj aspiratave etnike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Diskutimet e mbështetura në një literaturë të gjerë dhe relevante për historinë, gjuhën, besimin dhe kulturën shqiptare, nxjerrin në krye gjuhën shqipe si një prej forcave të brendshme më kohezive në jetën shqiptare. Në një rrethanë të vështirë historike ndërkombëtare gjatë fillimit të shekullit XX, kur një lëkundje kombesh po hapëronin në histori, është gjuha shqipe ajo që doli në plan të parë. Më parë se sa të shquhej populli dhe besimi fetar i tij, më parë se sa të shquhen institucionet e karakterit kombëtar, u shqua pasuria historike e gjuhës shqipe dhe mundësitë që përmes saj të përkthehen veprat e përmasave botërore, sikur ishte *Bibla*.

Parë në tërësinë e saj, ky kapitull është përgjigje studiuesve serbë, të cilët mbështetur në përvojën e studimeve historike, në shkollat nacionale të shekullit XIX dhe XX dhe madje në shkollat europiane, përpiqen të gjejnë strehën më të vogël për të sulmuar etnogjenezën e popullit shqiptar. Në këtë linjë personalitetesh hyn edhe Milojeviqi, ndërsa në këtë kolanë hyjnë edhe veprat *Odlomci e Udhëpërshkrimi* i tij. Këtë traditë të përvetësimit të historisë e vazhdojnë edhe sot individët, grupet dhe madje institucionet e caktuara akademike. Ata vërtetë nuk mund të arsyetojnë gjuhën e tyre si paraardhëse të shqipes, por megjithatë gjurmët

lashto-shqiptare përpiqen t'i nxjerrin si trashëgimi sllave! Një legjendë më vete dhe një kullë mitike ata kanë ngritur për periudhën mesjetare, duke ngatërruar hapësirat, besimet, trashëgiminë fetare e kulturore, gjuhën, identitetet etj. Të vetëdijshëm për ndërhyrje të kësaj natyre nga provenienca serbe, greke dhe madje italiane rilindësit tanë, jo rastësisht zgjodhën gjuhën, si shtyllën e parë të identitetit kombëtar dhe kombin si pararojë fetare e shtetërore, sipas motos: *Feja e shqiptarit është shqiptaria!* (Vaso Pasha), të cilën autori e modifikon: *Fe që Zotynë e bekon, Shqiptaria feja jonë*, kur janë të tolerueshme në këtë nënhije skeptike të gjitha fetë e besimtarëve shqiptarë.

Kapitulli i fundit i kësaj monografie në të cilën suksesshëm bashkohen analiza, sinteza, polemika, diskutimi shumplanësh, sjellë në plan të parë trajtesën *Injorimi i gjuhës shqipe dhe kontributi me pahir i z. Milojevic në e për gjuhën shqipe*, e cila është ndarë në katër nënkrerë.

Nuk e vlerësuam rastësisht këtë vepër gjerësisht dhe nuk e nderuam për shkaqe subjektive. Prej vitesh kemi lexuar artikuj përgjithësues të historiografisë serbe, prej vitesh kemi lexuar vëllime me dokumente politikanësh e diplomatësh serbë dhe madje prej vitesh kemi lexuar vëllime dokumentare, kryesisht udhëpërshkruesish serbë në tokat shqiptare, por deri më tash nuk kemi pasur mundësi dhe nuk kemi gjetur një studim kaq të thelluar e kaq komplementar në raport me një vepër të një studiuesi serb. Për më tej, monografia e Profesor Nuhi Veselajt nuk merret thjesht me kundërshtimin e përshkrimeve të Milojeviqit dhe analizave të tij, përkundrazi, ai i diskuton gjithanshëm përshkrimet e Milojeviqit në gjysmën e dytë të shekullit XIX duke gjetur në atë përshkrim te veprat e tij pikërisht gjurmët e trashëgimisë shqiptare dhe i diskuton analizat e Milojeviqit, duke u mbështetur në pasaktësinë dhe njëanshmërinë e përfundimeve të tij. Në këtë proces, janë pikërisht të “vërtetat e shënuara me pahir” ato që e dominojnë kontributin e Milojeviqit për shqiptarët dhe gjuhën shqipe, e të cilat përplotësohen nga aspekti logjik, gjuhësor, historik, etno-geografik e kulturor nga penda e profesor Veselajt.

Le t'i theksojmë vetëm disa prej atyre, të cilat janë me interes jo vetëm për këtë kapitull po edhe për librin e kulturën përgjithësisht:

a) përplotësimin e dromcave historike të Milojeviqit me të dhëna të reja, qofshin ato referenca të proveniencës Lindore qofshin ato të proveniencës Perëndimore;

b) diskutimin e etimologjive të autorit dhe botuesit me metoda bashkëkohore të dijes së sotme albanologjike, ballkanike dhe përgjithësisht linguistike;

c) identifikimin e teksteve shqipe të Milojeviqit dhe sjelljen e teksteve folklorike, etno-kulturore të vendlindjes, një shembull prioritar i trashëgimisë kulturore fetare në Kosovë, në raport me trashëgiminë serbe. Në të vërtetë autori bënë paraqitjen origjinale me përkthim origjinal nga autori Millojeviq i dy ‘vjershave ngucakeqe’ dhe të një kënge (*Kanga e kumonës*), e cila jepet në origjinal në gjuhën shqipe;

d) në mënyrë të veçantë si një dokument më vete të natyrës gjuhësore paraqitet *Fjalorthit shqip-serbisht* të vitit 1873, me përmasë të vogël, por me interes jo të vogël sociolinguistik, kulturor e etnik.

Sifjalorthin shqip –serbisht, sikur e quan autori këtë korpus leksikografik, është një prej kapitujve më të rëndësishëm, më sistematik dhe madje më thelbësor i kësaj vepre. Paraqitja deskriptive e tij, sinteza tabelare, komentet e gjithanshme dhe madje, vërejtjet, për mangësitë e tij, për të cilat ishte i vetëdijshëm me kohë edhe Milojeviq, përplotësimet në gjuhën shqipe dhe serbokroate, komentet në rubrikën e shënimeve, shënimet grafike etj., e bëjnë këtë kapitull të rëndësishëm edhe për studimet e ardhshme në fushë të leksikografisë, dialektologjisë historike, etimologjisë, sociolinguistikës e historisë së gjuhës shqipe e serbishte përgjithësisht. Këtij korpusi leksikor, përkatësisht studimit krahasues të tij brenda marrëdhënieve gjuhësore shqiptaro-serbe, shpresoj t’i kthehem edhe unë në një studim tjetër. Sado modest të quhet ky korpus leksikore prej 339 fjalësh, disa dhjetëra shprehje e frazeologji popullore, toponime etj., me këto të dhëna autori, me apo pa dëshirën e tij, ju ka lënë një trashëgimi të pasur studimeve albanologjike, të cilat në të ardhmen do të vlerësohen dhe respektohen si një shërbim i mirë dijes shqiptare, në ato përmasa të cilat disa studiues të tjerë të proveniencës sllave dhe madje europiane nuk ja kanë arritur, përkundër dëshirës së mirë që kishin. Ky kontribut me gjasë është rrjedhojë e mospërkrahjes së Shoqatës së Dijetarëve Serbë, për botimin e këtyre materialeve. Ne sot mund të themi kështu, sepse ndoshta, pikërisht pse Milojeviqi me pahir bëri këtë punë në të mirë të shqipes e serbishtes, andaj nuk e pati përkrahjen nga forcat e errëta për botimin e veprës, forca këto që në asnjë rast me rastin e ribotimit të veprës nuk po e shënojnë me qëllim këtë sifjalorth. Ishte me fat Nuhi Veselaj që e pati fotokopjuar lëndën e sifjalorthit atë version që rastësisht pati dalë edhe më këtë lëndë., dhe më nuk po përsëritet.

Këtu po e sjellim vetëm një listë fjalësh, shprehjesh e trajtash leksikore me interes, kuptohet jo në origjinal e çirilicë, por nga punimi i Veselajt, me qëllim dhe në këtë mënyrë të mësohet sadokudo për përmbajtjen e fjalorthit:

*Cjap, Dru, Flakë, Thëngjillt (i), Kërcell, Kërc, Natë, Dreq, Dimër, Me shtrakatë! (thurë, kërrabzue), Shenjtë (i), Rus? (i tmerrshëm), Rrip (brez), Purtekë, Frikësoj (përulem) (N'besë tande!) Njeri, Burrë (djalë), Grua, Vajzë, Me pa (shih), Ari-u, Afër, Ballë, Baltë (dhe, vendi), Me pjekë, But (kofshë) ose butë (emër njeriu), Varfër (të), Vapë, Vjehërr, (vgis-heri?), Shok (mik), Begatë (të), Vesh (veshë, me veshë), Viç (*vit, njëvitshe), Ju, Gjashtë, gjashtë, Gardh, Gati, Gjarpër, Dhëmb, Emër, Asht (eshtër), Zonjë (grua), Thëngjill (thingill, djegie pa flakë), Me hangër, me ngrënë), Ka, Kalë (hipur në kalë), Kush, Kurm (trup), Krimb, Krye, Dru (Lis) Madh (më i), Mal (bjeshkë) /mall Zi (i), Marrë (i), Martesë, Mes, Gomar (magjar), Mish (muskul), Mot (vit), Nuse, Vjehërr (njeri), Merr vesh (di), Rrush, Zotni (sifer), sefer/ arab. i nderuar(!), Posi/ si, Me mbytë, turp(?), / Ujë Fashna (shami), Armë, Armik (djall), Verdhë (e), Fitore, Ngushtë, Gjel, Grigjë, Egër (të), (egërsisht), Argjend, Qen, Korb, Kudhët (i) (farkim), Haraç (xhymryk?) Gjerë(i), Larg, Këndoj, Mend, Lepur, Mik, Mollë, Mort, Paqe, Pemë, Me grabitë, me u ropë, me robërue, Sipër (mbi), Shëndet, Shenjtë (i) Shenjti-, Shin, Shërbëtor, Shigjeta, Turp, Tra, Faqe (fytyrë), Hark, Të kam pa(rë), Me mendue (ka menduor?!), Rino! (lind), Shkruaj (e qëndis), Me rrëmihë, (vezirimo?!), Parmend, Bir, Bijë, Fëmijë (voc e djalë), Meshkull, Femën, Borë, Shi, Gur, Ujë, Drithë /dritë, Dërrasë (pllakë), Lugë, Thikë, Shtrat (tshtruemt), Tshtyemt, Shtëpi, Diell, Akull, Pokjo (qeknej!), Me vrapue (vrik), Me kalërue (hipur në kalë), Dhen (dele), Dhija, Dhëndërr, Ëndërr, Dasmë, Me dhënë, Kam porositë (me porositë), Kësulë, Një (nja), Dy, Perëndi, Zot, Erë, Së shpejti, pak më herët?, Më shpejt, Me fejuë /cucën(??), Dorë, Këmbë, Gisht, Pëllamb (shpresë??), Hardhi (vresht), Flok, Mjekërr, Zverk (qafë), Shpatë (Çiad??), Këmishë, Mërtek (thupër), Derr, Lum, Kodër, Bjeshkë, Det, Dardhë, Udhë, Urë, Bardh, Kuq, Gjak, Bojëgjake (bojna), Verdhë (e), Hasëm (armik), Orum (grek), Brekë, Rosë, Patë, Pulë, Djall, Vdekur (i), (njeri i dektë!), Venë, Groshë, Kaza (nahi), Mera (kullotë), Peshk, Urreje (i lantë!), Me u la (u lava), Drejë, Darkë, Me v(n)u / ka nder?, Me lavrue (laroj!),*

Kam mbjellë /me pjellë, Shumë (boll), Farë, Zjarr, Bini (qitni), (dru), Ndiz zjarr, Me pi, (krua me u krue), Qengj (dhen), Berr (dash), Arushë, (ari), Ujk, Dhelpra, Dren, Kaprolle (drenushë), Grykë (fyt), Me u pajtue, (e mpetuor ! -financ.) Robtë (gjinja shpis), Gardh, Dosa, Lopë, Shkëmb, Këmbës/or, Muaj, Kjo javë ose e djelë, E ve (grua pa burrë), Plakë, plak, Kokë, Tërmet, (Trem(b)et dheu!), Dhe /vendi, Ditë Mirë (i), (i qetë) Mirëdita! Gjysma, Fytyrë (faqe), Penë, Dru (kaçubë, pajë), Derë, Shkallë, Gabim, Më fal të më falish, Të më falësh, Shtëpi e mbuluar, E m/buluar/a?, Majëmali (Qafë), Jona? çat??. Me këndue, këndo, Mos qani, T'shtina! (shtëna!! (me pushkë??), U gëzuar, Gëzoni, Rrofshi e qofshi, Trim njeri, i përunjët, i poshtëm (poshtër), Mendtar, Ma fal zot (zotni) (unë kam gabuar), Faj, E drejta (drejt), Tredhë (me), me shky herdhe?, Ai Tçava (kokën!), prish me luftue, luftuar, Ne, Yni, Ju, Ata, Im (imja), Jotja, I atij, Juaji, Lyej shtëpinë (kam lyer), Fushë, Arë (ari!), Vreshta, Diell, agim, e djelë, U ngrys?, u ndrit? Prift, Kishë, Vijë Krua/çeshme, Rrahje, breshër, shushlak (mbetje), Letër (libër), Kos (qumësht), Mirë, Keq, Me djegë (digje), Baltë, Qen, këlysh, Pus, Bukë, Hidhërim (pret/zi), Brez (shokë), Pamartuar (i) (beqar), i lagët, Këpucë, Të ngrysurit (pa frymëzim), Tubim (kuvend), U bë falja, Me u pajtue (U fatua!), Koha, Kec (një kec), Gjuhë Shqa (shka), Shqijana (shkina), Tëmbëlit, Djathë, Gjizë, Gozhdë (peronë), Me mbathë me patkua, Për të mirë! (shëndet!), Të bëftë mirë! (shëndet), Kam çarë dru ose thërrmuar gurë, Pëllumb, Ndritu (u ndije!), Vezë /voja /veja, Tegërt, Fëllanza, Kam fituar, Kam fluturuar, Kllaçkë, Sëmunë (i), Shëndosh, Ethe, Dhallë???) (/mushtrelisë ortodokse /musht Punambarë! Mbarëpaç Qerre (kerr), Natën e mirë, U trashëgofsh, me të mira (përfitim), Gëzuar (i), Na ka zbardhë (me punë), Hënë, Hyll, Gomar, Babai i gomarit, gomar, Kalë (i kuq), - dori Kali vranç, Kali i bardhë- gjok, Plumb, Copë, Rëndë, Kohë e rëndë /zaman/ose shekull, Na ruajtë zoti, i vjetër, Stapanj ose feja e vjetër, Pe, Lule, e lale (lalelalje), Bilbil (zog), Bilbili (zogu) na këndon, Tym, Shpend, Arrë, Fe, Lakra e laknor, Mulli, Miell, Mbret, perandor, Princ, mbret Shtëpi /etj./

Megjithëse i dorëzuar në shtyp në vitin 1873, studiuesi serb arriti ta botonte vetëm në vitin 1877. Ndërkohë Profesor Veselaj dhe studiuesit e tjerë të albanologjisë presin të ribotohet në origjinal dhe i plotë, madje nëse gjenden dorëshkrimet, për të cilat flet Milojeviqi, të botohen edhe ato çka

është obligim i vetë Akademisë dhe shtetit serb, pa marrë parasysh nëse edhe në vëllimet e pabotuara do të dilte edhe ndonjë kontribut sado i vogël me pahir në të mirë të raportit të historisë së gjuhës shqipe dhe të asaj serbe të para 150 vitesh.

Vepra e Profesor Nuhi Veselajt *Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës, shkas vepra e z. Milojević (1866 -1873) dhe epranët e pasuesit e tij*, përmbillet me një sintezë të gjerë, brenda të cilës mesazhet e tij janë mjaft bindëse, ndërsa ne mendojmë se janë jo vetëm bindëse po edhe inicuese e nxitëse për diskutimin e veprave të shumë studiuesve, publicistëve e udhëpërshkruesve serbë për hapësirën shqiptare. Shpresojmë se autori i kësaj vepre edhe pas letërlibërtimit të këtij punim do të vazhdojë me monografi të tjera të kësaj natyre.

Prishtinë, më 23 korrik 2023

PARATHËNIE

Në vështrimin tonë kritik historiko-gjuhësor me titullin bosht: **Injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës**, botuar në portalin *zemrashqiptare.net*, në nëntë vazhdime, **10.09.2017 – 20.11.2018**, kushtuar (si fillim) veprës së z. Mirçeta Vemić: *”Etnička karta dela Stare Srbije prema putopisa M. Milojevića”*, botim i jashtëzakonshëm, SANU, Beograd 2005, konsultuam mbi 1400 emërtime vendbanimesh të Kosovës të shoqëruara me numrat përkatës të shtëpive (banorëve) sipas etnive të nxjerra nga tri veprat e z. **Miloš Milojević** me titull të përbashkët: **Putopis dela Prave –stare Srbije** (Kosovë) shënuar , me gjasë) në vitet 1866-1868, ndërsa botuar në vitet 1871-1877 (vëll. I 1871, vëll. II 1872 dhe vëll. III, ofruar 1873, por botuar 1977), ndërsa tashti me rastin e rishikimit, punimit tonë, ia modifikuam titullin me shtojcën:... **“dhe dëshmimi me pahir”**. .. **“dhe epranët e pasuesit e tij”**

Në të vërtetë, gjatë shtjellimit të kësaj teme, pos tjerash patëm konstatuar dukuri manipulimi që përsëritej në të dyja veprat e autorëve të përmendur, njëra shkruar në fillim të gjysmës së dytë të shekullin XIX dhe e dyta, në fillim të shekullit XXI, që kishte të bënte me shënimin e numrave të shtëpive në favor të etnisë serbe, në dëm të asaj shqiptare, e cila me një interpretim të drejtë jofals përmbyste rezultatin në të mirë të së vërtetës. Me këtë falsicitet apo gënjeshtër-mashtrim të autorëve duke e nxjerrë etnitetin serb shumicë ndaj atij shqiptar pakicë, hanxhari programatik serbomadhadh prekte rëndë mbi kurriz të fatit të shqiptarëve, të cilët, që në atë kohë siç do të shohim injoroheshin jo vetëm si shumicë ekzistuese në Kosovë, por edhe si kombësi shqipfolëse që më parë e identifikuar qartë.

Po si ndodhi që nga ky injorim apo nga kjo gënjeshtër mashtruese me dalë e vërteta si dëshmim me pahir, e cila si sot edhe atëherë mbi bazë të kriterit të së vërtetës nuk mund të mohohet as të dyshohet dot?

Së këndejmi, kjo dhuratë me vlerë jetike e fshehur me sherr, pothuaj 150 vite, erdhi ose u zbulua si një ogur i bardhë në saje të dëshmisë së të pashuarës *gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës*, argument ky që do të jetë objekt trajtimi në këtë vepër, andaj po fillojmë tash fill me sqarue këtë të vërtetë të pamohueshme të shënuar nga doravetë e z. Milojević dhe e përsëritur nga z. Vemić, të cilët duke u përpjekur t’i bëjnë gropën tjetrit (të fshehin të vërtetën shqiptare) e hedhën me turp veten apo shkencën serbe në gropën e gënjeshtres.

Çështë e vërteta, z. Milojević si etni kryesore, përveç atyre pakicë që i shënonte me inicialet: O (osmane), Č (çerkeze) dhe C (cigane), por si më të dalluar që për ne zgjoi interes ishte etnia **serbe (S)** dhe ajo **shqiptare** që në realitet ishte shumicë, të cilën, këtë të fundit, nuk e shënon me këtë emër por në trajtën **shkip shkipët**, të cilët shqiptarët në bazë gjuhe të njëjtë (shkipe) i ndan në tri etnitete: **L (latine)**, **A (arnaute)** dhe **P (poture)**, por këtë të fundit, e cila në tekst mbizotëron numerikisht, ndonëse e pranon si *shkipfolëse*, e llogarit si etni serbe (*serbë të islamizuar*). Kështu vepron edhe Vemić, i cili nga ato tri vepra të z. Milojević, duke përmbledhur e seleksionuar emërtimet e vendbanimeve me numrin e shtëpive, të shoqëruar edhe me një hartë demografike mirë që i paraqet shumicë enorme, por jo mirë që pa të drejtë i paraqet si etni serbe (!).

Ne, posa vumë re këto të dhëna nga vepra e hartografit Mirčeta Vemić, e cila rastësisht na u shfaq në ekran televizori, nga faqe interneti, nga fundi i vitit 2017, ndërsa e përgatitnim për botim veprën VI “Çështje të shqipes standarde rreth vendbanimeve” e fotografuam dhe veç tjerash:

së pari, konsultuam *fillimisht* drejtshkrim-ndryshimin e emërtimeve të vendbanimeve të atëhershme, të para 150 vitesh, në krahasim me këto të sotmet zyrtare shqip e serbisht të Kosovës, që z. Vemić i kishte shënuar paralelisht, kuptohet vetëm në gjuhën serbe dhe *së dyti*, krahasuam gjithashtu edhe numrin e përbërjes etnike sipas emërtimeve të vendbanimeve, ku më tepër ngrinte peshë dhe binte në sy statistika e sistemuar mjaft pedanterisht nga z. Vemić sipas zonave, qyteteve, nahive, përkatësisht bajraqeve.

Gjithsesi nga ai sistemim binte në sy etniteti i **paturëve shkipfolës** që llogariteshin *serbë të islamizuar* dhe kështu rritej enorm numri e paqenë i etnisë serbe, në krahasim me atë shqiptare, e cila minimizohej me qëllim vetëm me *arnautë e latinë (pjesërisht)*, pasi *paturët shkipfolës* në total, siç u tha, rritnin numrin në rubrikën **S (serbe)**.

Këtë falsicitet të rritjes së numrit enorm të etnisë serbe nuk e patëm vështirë me e konstatue. Konkretisht morëm shembull fshatin tim të lindjes dhe fshatrat për-rreth qi njihnim, sepse para 150 vitesh si tash dihej se nuk kishte pasur shpërngulje dhese *poturët*, d.m.th muslimanët e tillë nuk kishin qenë serbë po *shqiptarë që ishin islamizuar* dhe kjo vërtetohej lehtë e sigurt, duke u bazuar në shqipen e folur si realitet, fakt ky që vlente pothuaj për të gjitha vendbanimet *pature* të të gjitha trevave të Serbisë së Vjetër (Kosovës) e më gjerë, banorë këta anas që nga lashtësia, të cilët si tash si atëherë kishin qenë të njëjtë me histori, gjuhë e zakone – kishin

qenë shqiptarë. Ndërkaq sa i përket besimit para përqaimit të fesë islame mund të kenë qenë *ortodoksë* apo mbase paganë apo katolikë, por ata edhe pas rastit të konvertimit ruajtën vetqenien etnike, ruajtën zakonet e gjuhën shqipe - *ruajtën kombësinë shqiptare*. Kjo binte ndesh me konstatimin e z. Milojević që gjoja këta qindpërqind kishin qenë ortodoksë të rritit serb, gjë që nuk përjashtohet riti ortodoks, por që turqit kinse i kishin detyruar (!) jo vetëm ta ndërronin fenë, po ta ndërronin edhe gjuhën nga serbishte (sllavishte e vjetër sakrale) në *shkipe!*, arsyetim ky pa kurrfarë logjike, ngase shqipja nuk ishte gjuhë fetare muslimane, që nuk kishte qenë as fetare ortodokse as popullore sllave-serbe, po kishte qenë siç është edhe sot gjuhë masive e trashëguar popullore iliro-dardane-shqipe.

Si po shihet z. Milojevic e ngatërronte fenë me kombësinë, madje ngatërronte edhe gjuhën sakrale të vjetër sllave me gjuhën e re letrare kombëtare serbe. Pra, serbë sllavë me kuptim njënacional quheshin sipas tij edhe poturët shqipfolës, vetëm pse supozohej se para konvertimit i takonin rritit të besimit kristian ortodoks, dukuri kjo që tregon se nacionalizmi serb në atë valë të rilindjes së tyre (*preporod*) e kishin përvetësuar fenë ortodokse me emërtimin *pravosllavlje (srpska vera ose večna slavna pravoslavna)*. Lidhur me këtë, siç e dimë nga realiteti te ne në Kosovë një shumicë e ortodoksëve vendas, të ashtuquajtur *shkie vendës (skizmaikë)* të fshatrave e qyteteve tona, si para e sidomos deri në moshën time 7-8 vjeçare, pra, edhe gjatë kohës së Kravevinën Jugosllave të viteve të '30-a, por edhe në Jugosllavinë komuniste pas vitit 1944-1999 për shkak feje ortodokse quheshin serbë, po shqipen e kishin gjuhë amtare.

Sido që të ketë qenë, këta ortodoksë quheshin shkie apo serbë të vendit gjatë dhe pas misionit të z. Milojević, shek XIX, kur këndeje gjuha shtetërore ishte turqishja. Emri *shkije të vendit* nuk ka qenë përbuzës nga shqiptarët, edhe pse feja islame e drejtuar nga hoxhallarë fanatikë është munduar me përhapje urrejtje ndërfitare në raportin turq-shkie të së njëjtës kombësi folëse. Së këndejmë, shqiptarët e të dy-tri feve te ne (turq e shkie, arnaut e latinë) trashëgimisht flisnin shqip, sepse shqipen që nga lashtësia e kishin gjuhë amtare veç atyre sakrale të veçanta (greke, sllavo-serbe, turko-arabe e më pak shqipo-latine). Këtë duhet ta dijnë jo vetëm serbët e studiuesit e tyre, po edhe disa studiues e politikanë nga Shqipëria e Kosova e më gjerë, por edhe disa fanatikofetarë katolikë e islamofundamentalistë tanë.

Së këtëjmi konstatoam se z. Milojevic në vitet 1866-1868 në Kosovë të gjithë ortodoksët edhe ata shqipfolës i shënon serbë që nuk e

kundërshtojmë, por meqë atij ai numër statistikisht i dilte i vogël, ky duke vepruar makiavelisht e rriti numrin me *poturët* (me shqiptarë të islamizuar) dhe kështu bëri zgjidhje me rrena, dhe kjo si të thuash ishte normale në pazarin filoserb të asaj kohe, sidomos gjatë qindvjetshave XIX e XX, gjë që po dëshmohet aksiomativisht deri edhe në shek. XXI me veprën z. Vemic: **“Etnička karta dela stare Serbije prema putopisa M. Milojevića**, botim i jashtëzakonshëm nga SANU, Beograd 2005, që ishte shoqëruar me koment të akademik Vladimir Stojančević, ku gjithsesi u përdor gënjeshtër si argument *shkencor(!)*, apo jo?!

Si duket, z. Vemić këtë vepër e botoi me vetëdije të plotë si të tillë me rrena, duke menduar se ashtu vihej në shërbim të propagandës së politikës ditore të qeverisë e kishës serbe rreth çështje së Kosovës. Për mendimin tim, kjo ishte fatkeqësi për autorin si edhe për autoritetin SANU-s, të shtetit dhe të kishës serbe, sepse tue i bë gropën tjetrit rane vetë në të, ngase mbështetja në gënjeshtër edhe në shekullin e ri XXI, në arenën ndërkombëtare aspak nuk u ndihmoi, po ua qiti faqen e zezë, pra, jo vetëm autorit, por edhe atij treshi zyrtar serb (SANU. shtet e kishë), ngase jep me kuptue se shkenca serbe ende u përpiqka me mbajtë primatin me falsicitete e gënjeshtër, apo jo?!

Pamëdyshje, z. Vemic e dinte se fund e krye numri i shumësisë serbe nga z. Milojević ishte i pasaktë, por megjithatë, përdori ato të dhëna, ashtu siç bënë edhe shumë burime të tjera, të cilat mbase nuk e dinin paqëndrueshmërinë e raportit të tillë, ashtu siç e ndeshim këtë fals-konstatim të shënuar edhe në burime të tjera, si te portali *Krstarica*, *Wikipedia serbe* etj., konkretish e kemi fjalën për këto dy konstatime:

E para, **“Pre Srpsko-turskih ratova 1877-1878 god. na Kosovo i Metohiji Srbi bili etnička većina a Arbanasi manjina”**.

!“Para luftës serbo-turke 1877-1878 në Kosovë e Metohi shumica etnike ishte serbe(!) ndërsa ajo shqiptare pakicë”(!)/, madje edhe më absurde del pika tjetër:

E dyta, **“U gradskim naseljima Prizren, Priština, Peć, Đakovica i Kuršumljija Srbi su činili devedeset procenata stanovništva”**.

!“Gjendja në qytete në Kosovë Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Kurshumli tregon se në atë kohë

90% e banorëve ishin serbë”(!!!)/.

Ndërkaq, në fakt e vërteta, sipas verifikimit që bëmë ne, duke shfrytëzuar pikërisht të dhënat nga z. Milojević, përkatësisht z. Vemić, në total, si

pasqyrë-përgjigje ndaj dy pikave të mësipërme, sipas përqindjes rezultati del kështu:

1. Në Kosovë numri i shtëpive sipas veprave të Milojeviçit në vitet 1866-1868, d.m.th para

luftës serbo-turke, në përqindje ishte: S 22% (ortodoksë), ndërsa **JOS 78%**” (shqiptarë

kryesisht),

ndërsa pika tjetër:

2. Numri total i etnive në qytetet Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Kurshumli, Vushtri,

rezultonte: S 14% (ortodoksë), ndërsa **JOS shqiptarë 86%**.

Pra, ja si u zbulua me interpretim të saktë e **vërteta**, që dëshmohet me analizë-sajimin e 12 tabelave me rezultate të konfirmuara dhe kështu ky **gënjeshër-mashtrim i madh (velika lažnabluda)** i lansuar aksiomativisht tash 150 vjet tash doli sheshit, gënjeshër kjo, e cila ka mashtruar kuptohet edhe popullin serb e shqiptar naivë e të painformuar, por edhe mbarë botën antiosmane dhe atë neutrale, ka mashtruar tërë botën.

Ne, me këtë fakt-provë të sforcuar me 12 tabela demaskuam dhe rrëzuam katërcipërisht për të parën herë këtë gënjeshër-mashtrim të lansuar si provë e pranuar aksiomativisht si e saktë që afro 150 cvjet, por ne nuk u kënaqëm me kaq, ngase e dinim që kjo ishte vetëm një hallkë e zinxhirit verigë të gënjeshër-mashtrimeve dhe të shpërfilljeve të tjera që serbët e lëvizjes nacional-shoviniste i fabrikonin në seri kundër popullit shqiptar, së pari ndaj atij të fesë ortodokse, të cilin e shfrytëzuan me lehtësi si karrem kundër sivëllezërve të një gjuhe e gjaku të feve të tjera, duke e asimiluar formalisht me yshtjen e fesë, sepse ai komunitet përherë ishte i gatshëm me bashkëpunue me serbë pansllavistë, madje në raste edhe u ka prirë zhvillimeve njënacionale serbe, si këlmendasi Karagjorgje, Hodo Bimbashi e shumë ortodoksë të tjerë të mohuar si shqiptarë. Prandaj punimin tonë e zgjeruam me krerë të tjerë, duke përdorur edhe fakte të reja plotësuese, sepse gënjeshtra si dukuri në filozofinë shoqërore të Lëvizjes *të preporodit serb* të shek. XIX është e njohur, por që fatkeqësisht rutinisht del e pranishme në programet e çdo qeverie serbjane deri më sot, ku si shumë të tjerë po i viktimizon, së pari njerëzit e vet, ashtu siç u përbaltën edhe zotërinjtë Milojević e Vemić, por edhe disa epranë e pasues të tjerë, gjithsesi edhe anëtarë të SANU-s, siç është rasti me leje-botimin e

jashtëzakonshëm të veprës së Vemiqit mbi bazë gënjeshtresh, prandaj vërtet ka ardhur koha që të gjitha sklluqet që u dolën serbëve për fushë si pjesë e propagandës e të veprimeve të tilla antishqiptare, të vlerësohen si të tilla në veçanti edhe nga vetë intelektualët serbë, siç bënë disa apelistë për disa teprime të tjera të Milojeviqit e jo për ato ndaj shqiptarëve e gjuhës shqipe që duhen përfshirë, ashtu siç do të cekën më poshtë.

Për mendimin tonë tash pas këputjes së kësaj hallke të zinxhirit të verigës së gënjeshtër-mashtrimit se gjoja serbët njënacional paskan qenë shumicë në Kosovë e gjithkëndej, kur doli sheshit e vërteta se shqiptarët si anas përherë kanë qenë shumicë, prandaj nuk e shoh naivitet me përsëritë kërkesën drejtuar serbëve të mençur, që të esëllohen edhe më tej, të ndërpresin **injorimin ndaj gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës**, t'i kthehen së mbares, ta pranojnë realitetin, të kërkojnë falje për të këqijat bërë deri tash 200 vjet shqiptarëve në emër të elitës serbe, që i shpalli shqiptarët armiq pa qenë, vetëm pse kastat donin shtim territori në tokat e tyre, por që në të vërtetë kjo shpallje ishte kundër së vërtetës, ishte armike edhe ndaj popullit paqedashës serb që tashmë po kuptohet fare qartë, apo jo?!

Për z. Milojevic, biografinë, implikimin dhe kontributin e tij me pahir në shqipe e për shqipen disa hollësi i kemi shprehur në kreun VII, ndërkaq këtu e shohim të arsyeshme të themi pak fjalë vetëm rreth formimit të tij si intelektual e krijues në kuadër të kauzës së Lëvizjes nacional-romantike serbe dhe degradimit që pësoi autoriteti i tij nga ngulshimi i sinqertë i tepërt që kishte për të qëndruar me fanatizëm brenda atij shërbimi nacionalist, për të dhënë sa më shumë për serbizëm dhe vetëm për serbizëm.

Milosh S. Milojeviç (1840-1897), si i ri, nxënës e student i etshëm për dije pas kryerjes së liceut të Beogradit, si student në Rusi (Kijevë e Moskë), tregon zell të madh për mësim e dituri multidisiplinare. U dallua në drejtësi, histori, filozofi, gjuhë etj., por mbi të gjitha ishte brumosur me substrate pansllaviste e në veçanti si serbofil fanatik. Kështu që ai me përqaftimin e kauzës së pansllavizmit serbofil me fantazinë e tij të bujshme, pothuaj, tejkaloi kornizën e platformës së ashtuaquajtur *Načertanie* të I. Garashaninit 1844, sepse u zhyt e përshyt në kuadër të asaj **lëvizjeje nacional-romantike serbomadhe** (preporod) të shekullit XIX deri sa e pëmbysi talentin e tij krijues me fantazi të bujshme të jashtëzakonshme. Themë kështu sepse aq shumë iu dha asaj kauze, sa që kur u kthye nga Rusia më 1865, në moshën 25 vjeçare nuk u kënaq me

pak, nuk u kënaq si nëpunës shteti, shkrues e deri sekretar gjykate në Valevë e Beograd, ku qëndroi nga tre muaj, ngase ai kishte ambicie më të mëdha. Dhe si duket më 1866 e gjeti veten më mirë në Bogosllavi, shkollën fetare të Beogradit, ku atij iu hapën rrugë të kryente punë dukshëm më të dobishme për vendin, qofte edhe me rreziqe, vetëm e vetëm me kontribue sa më shumë për atdhe dhe fe (*srbstvo i pravosllavlje*). Kështu në këtë kohë, si duket me sugjerim të epranëve fetarë e në pajtim me organet e shtetit, vullnetarisht merr zotim të kryente një mision fisnik atdhetarie si udhëpërshkrues të kalonte ilegalisht në viset e ashtuquajtura “Stara Serbi” (Kosovë) që ishin nën okupim të *Turqisë*, prej nga duhet të konstatonte, përkatësisht gjithsesi të kontribuonte në ngritjen e vetëdijes pravosllave serbe tek ortodoksët (kryesisht shqiptarë) disa edhe të ritit bullgaro-grek, madje edhe tek muslimanët poturë të luhatshtëm dhe nga ky udhëpëshkrim të sillte sa më shumë elemente të ekzistimit e gjallimit iluzionist të etnisë serbe që mendohej se kishte shtrirje të gjerë dhe numër të madh.

Nga shumë biografë të tij, asnjëri nuk dokumenton se kur e filloi këtë mision: vizitë *tokave serbe* në Turqi, por sipas gjasave këtë e provoi në vitin 1866, kur edhe e shkroi artikullin *Propagande u Turskoj* (Propagandat në Turqi). Sidoqoftë, në bazë të materiaoit që lexuam nga Putopis-i (Udhëpëshkrimi) por ai *së paku tri herë ilegalisht ka kaluar kufirin e Turqisë dhe pastaj qoftë si zograf, moler, apo deri edhe si i shtir si çoban ka kryer misionin e tij në Prava Serbi (Kosovë), Maqedoni e Albani*. Në një shkrim lexova se në këtë mision është nisur në qershor 1870, në një tjetër edhe në vitin 1871, që na duket e pabesueshme, pasi ai atëherë veprat i kishte në botim e sipër, Gjithsesi logjika na thotë se misionin e parë e filloi në në vitin 1866, kur edhe e shënon një rast kur një tokë ishte blerë për varreza. dhe e përfundon më 1868, sepse më 1869 fillon botimin, dhe vazhdon 1871, e në vijim, kur edhe dekretohet profesor në Bogosllavi. Edhe studiuesi, Qazim Namani mendon se se <milosh S. Milojeviqi ashtu si edhe pasuesi i tij Todor Stankoviç “kishin bërë shumë udhëtime nëpër vendbanime shqiptare” (Shih “zsh” 13.01.2022).

Sidoqoftë, dihet se kur nisët nga Beogradi për në Kosovë merr me vete një nga mërgimtarët e mbetur shqiptar atje, mixhën Zymber dhe i maskuar *si mjeshtër moler, murator restaurues kishash*, kalojnë kufirin serbo-turk këndej Krushevcit, nga Zona e Kopaonikut, ku sipas studiuesit J. Bajoviç, nuk kishte fshatra serbe (ortodoksë), po vetëm shqiptarë të islamizuar e çerkezë, sepse, ajo zonë ishte e shpallur **zonë ushtarake**

turke. Së andejmi, gjatë rrugëtimit deri në Kurshumli dhe Kurshumli-Prishtinë Milojeviqi mban shënime. Shënon vendbanimet me radhë nga kalon, por, çuditërisht pa datime. Në Prishtinë e Graçanicë do të ndërli dhej me aktivistë fetarë e të tjerë ortodoksë që vepronin legalisht pranë kishave e manastireve disa sapo të riemëtuara pravosllave, ku ishin hapur deri edhe shkolla serbe dhjeta vite më parë. Së këndejmë kalon në Pejë: Patrikanë e Kishë –Deçan, pastaj nga Prizreni e vise të tjera kalon përtej Sharrit, Lumë e Tetovë, arrin deri andej nga Berati (*Beogradi*) dhe së andejmi qëndron edhe në Elbasan. Gjithkund pritet mirë si mik dhe mban shënime, po për çudi, pa datime. Kthehet së andejmi nga Mirëdita dhe përsëri përshëndet bazat e mëparshme e të reja dhe me një mal mbresash e të dhënash udhëpërshkrimi, pa një ferrë në këmbë, kthehet në Beograd, ku përveç mbarështrimit të shënimeve me të dhënat përkatëse e pret si dhuratë e obligim emërimi *profesor* në atë shkollë bogosllavie. Sa ka zgjatur dhe si ka ndodhur mbarështrimi apo libërtimi e të dhënave nga udhëpërshkrimi nën titullin *Putopis dela Prave stare Srbije* (Udhëpëshkrimi nga një pjesë e Serbisë së Vërtetë të Vjetër (Kosova) nuk dihet, por në vitin 1869 fillon publikimet, prin me një artikull dhe pastaj po atë vit fillon me botue, si të thuash paralelisht, këto tri vepra voluminoze:

1) *Narodne pesme i obečaji naroda srpskog ...*, në tre vëllime, 1869, 1870, 1875:

2) *Putopis dela Prave stare Srbije*, në tri libra, 1871, 1872, ndërsa libri i tretë ofruar për shtyp më 1873, por e botuar më 1877 dhe

3) *Odlomci istorije srba i srpskih jugoslovenskih zemalja*, në dy vëllime 1872, 1873.

Botoi dhe vepra të tjera, por këto ishin më të rëndësishmet, por edhe më problematiket, më të diskutueshmet.

Pjesë të këtyre tri veprave i kemi lexuar e konsultuar nga faqe interneti, nga të cilat kam nxjerrë ndonjë fakt-vërejë me interes për shqiptarët e shqipen, që i kam trajtuar në nënkrerët përkatës të kreut VII te këtij punimi.

/Thuhet se me 1871, me një kumarën e tij, z. Kosta Šumenković. edhe një herë (unë mendoj se ishte sprova e tretë) kryen mision të tillë ilegal për 5 muaj në Stara Serbi e Maqedoni, me ç’rast rekruton për luftë kundër Turqisë, afro 150 të rinj kryesisht nga viset e Ohrit e të Dibrës./

Për përgatitjen e botimin e këtyre librave fillimisht pati ndihmën e *Shoqatës së dijetarëve serbë*, por jo për vëllimin III të *Putopis-it...*

Ndërkohë u angazhua drejtpërdrejtë në luftën e ashtuquajtur serbo-turke 1876-1878 si epror, komandant i vullnetarëve serbë e rusë, ku në formacion kishte edhe nxënës-kadetët vartës nga Gjumnazi i Bogosllavisë.

Pa marrë parasysh të vërtetën se ajo luftë *frontale* e Milojeviqit nuk kishte kundështarë aq ushtrinë turke e cila tërhiqej, por ishte aksion spastrimi kundër popullatës së pambrojtur shqiptare muslimane e katolike, andaj nuk po themi me ironi, por po pyesim çfarë trimnie ishte ajo, siç i thurin lavdi kronikanët se u dallua si “junak” *trimosh kreshnik* – që me *ustashët* e tij vetëm për dy hera, spastroi **mbi 400 fshatra**, sigurisht me popullësi të *pastra* shqiptare ose të përziera, ku nuk kishte fare mundësi rezistence. Madje si mund të quhet *çlirim*, b.f., pushtimi i qytetit të Kurshumlisë, ku sipas shënimeve të tij të para 10 vitesh, në atë qytet nuk kishte pasur asnjë banor ortodoks serb (!), ashtu si edhe në disa qytete të tjera ku së paku gjysma e banorëve kishin qenë *poshkipovani poturi(!)*. të cilët u dëbuan me dhunë. Sidoqoftë, pikërisht për këto “*heroizma*”, nga të gjitha bashkësitë e *qyteteve të çliruara* të Serbisë (së re) Jugore, Krushevcit, Nishi, Kurshumlija etj.) dhuruar Serbisë nga Kongresi i Berlinit, ku kishte qenë pjesëmarrës edhe z. Milojeviç, ky u shpall **qytetar nderi**. Mori medalje e lavdata edhe nga shteti, mirëpo si duket vetëm kjo *eufori lavdie* si *trim-luftëtar*, sa qe gjallë, i mbeti *sadisfakson* në biografinë e tij, sepse ndërkohë pësoi degradim, poshtrim, sa i përket krijimtarisë kulturo-letrare e historike, ngase veprat e tij u gjenden në tapeta kritike nga shokët militantë të së njëjtës ideologji, Kështu humbi përkrahjen edhe nga *Shoqata e dijetarëve serbë* e institucione të tjera shtetërore, por edhe nga qeveritarët e lartë.

Pse ndodhi kështu, po japim mendimin tonë. Milojeviçi pësoi debakël, sigurisht jo aq për qëndrimin injorues *ndaj gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës*, të cilën donte ta shkrinte në serbishte, por për disa qëndrim-teprime të guximshme edhe në fushë të politikës së ditës. Sepse temperamentit i tij: **Što na umu - to na drumu (Ç’kish në gushë bam për fushë)**, nuk mund të duronte, disa përluje nga joluftëtarët e karrieristët potikantë servilë. Së këndejmi kundërshtarët e tij gjetën shkak ta sulmonin pos tjerash edhe për qëndrime të guximshme vetjake, të paqëndrueshme kulturo-shkencore, siç ishte oponenca ndaj shkollës historike kryesisht gjermane (perëndimore), ku veç tjerash, serbët si sllavë (*skllavë*), përkatësisht serbët si *servë* (sherbëtorë) konsideroheshin ardhës në Ballkan nga shek. VI, ndërsa shqiptarët e gjuha e tyre (Hahn, Bob etj.) preknin, jo vetëm tek ilirët, por edhe tek pellazgët parahistorikë. Kjo me

gjasë e ngacmonte deri në mosdurim fantazinë e tij të bujshme si serbofil, të ngjizur me euforizëm ndaj serbishtes e serbizmit, andaj këtë mosdurim e kishte shprehur guximtarisht në librat e tij të parë. Kështu ai ngarkoi veten si mbrojtës i autotoktonisë serbe para asaj *shkipe*, të cilën nuk e mohonte, madje edhe *maqedonishten e vjetër e quante shkipe*, por gjithsesi para etniteteve të tjera të lashta parahitorike e antike e konsideronte serbishten e serbët si popull. Nga konsultimi i literaturës së mundshme gjeti ndonjë element toponimastik ku mund të kapej rreth kësaj autoktonie mbështetur iluzionisht në disa rrokje fjalësh e tingujsh, mirëpo në këtë kapje ishte i vetëm pa shokë e përkrahje institucionale shtetërore, ngase si shteti, si shokët i mbanin krahun shkollës së miqve, shteteve mike perëndimore, të cilat i ndihmuan Serbisë që të korrte një fitore të tillë të paimagjinueshme, madje shpresohet edhe në vazhdimin e asaj ndihme, siç do të ndodhi me të vërtetë në dëm të shqiptarëve e kundër gjuhës së tyre shqipe, pas vitit 1912, kur Milojeviqi nuk ishte më në jetë.

Po cilat ishin, në të vërtetë, ato mendime të tepruara apo pjella fantastike të z. Milojeviç të prezentuara në veprat e sapocekura të tij, do t'i përmendim më poshtë, pasi të njihemi me një apel sipeticion të paraqitur nga 142 studiues e intelektualë serbë të publikuar nga fundi i vitit 2019, pra një vit pas përfundimit të publikimit të punimit tonë të *zemrashqiptare*, ku në të vërtetë edhe ne demaskonim po ato teprime e ne veçanti theksonim gënjeshtër-mashtimin rreth shumësisë serbe në Kosovë.

Apeli i 142 studiuesve dhe intelektualëve nga Serbia ku Milojeviqi demaskohej për teprime të tjera, në masmedia e portale elektronike të Serbisë e më gjerë u publikua më **25.11.2019**, me këtë titull: **Apel protiv novog talasa pseudoistorije i mitomanije stvaralaštva Milojevića** /*Apel kundër valës së re mitomanike e pseudohistorike të krijimtarisë së M.S. Milojeviçit.*/

Në atë tekst apeli, ndër të tjera theksohen disa nga teprimet nga veprat e Milojeviçit. të cilave momentalisht po u jepte jehonë shumë të madhe *Shoqata e historianëve* me të njëjtin emër “*Milos S. Milojeviç*” nga vendlindja e tij Crna Bara (Mačva), e cila e përkrahur nga shteti, ministria përkatëse, gjithsesi edhe nga SANU, bëri të ringjallen ide nga veprimtaria krijuese të moshës relativisht të re të tij, të publikuara para luftës serbo-turke (1877-1878), të cilat me pompozitet nga ajo Shoqatë u popullarizuan vetëm pas *shpëtimit* të Serbisë nga Federata jugosllave, pra, tash, kur Serbia e humbi Kosovën, në fillim të shekullit XXI.

Edhe pse SANU nuk implikohet si argate e apelistëve, ajo qëndron e heshtur, po nuk ishte edhe aq neutrale, sepse më parë dha shenja rehabilitimi të personalitetit: **Milosh Milojeviq**, duke konfirmuar anëtarësinë e tij si akademik, lejoi ribotimin e veprave, por aq më tepër mori pjesë aktive në botimin e veprës së Vemiqit. Por njëherazi nuk ishte as kundër kërkesës së apelistëve, në mënyrë që veprat e Milojeviqit mos të idealizohen e shfrytëzohen si shkencë e vërtetë, dhe në këtë frymë apelistët me të drejtë i tërheqin vërejtjen kësaj Shoqate dhe opinionit e kompetentëve përgjegjës në mënyrë energjike:

“Odlučno ukažemo na izrečito negativne i duguročne veoma štetne posledice novoromantičkog talasa stvaralštva Miloša Milojevića XIX veka”.

/Vendosmërisht tërhiqim vërejtje kundër rrjedhøjave tejet të dëmshme afatgjata që po shkakton vala e re e krimeve romantike të M. S. Milojevic nga shekulli XIX./

Kështu, në të vërtetë patëm vërejtur edhe ne si këta apelistë në eprime te tilla te vepra **Odlomci...** ku z. Milojeviq kundërshtonte shkollën gjermane rreth kohës së dyndjes së ser(V)ëve apo (s(K))llavëve në Ballkan në shek. VI pas Kr., të cilët serbët këndeј si autoktonë ishin të pranishëm shumë më përpara, madje, sipas tij:

*Serbët janë popull hyjnor... Të gjithë sllavët e tjerë (edhe rusët) janë pasardhës të serbëve antikë. Epiqendra panslaviste nuk është Rusia e gjuha ruse, po Serbia e gjuha serbe, Gjuha serbe është amë e të gjitha gjuhëve sllave dhe të botës, ishte gjuhë e njohur paralatine e paragreke, para shkipes e maqedonishtes në Ballkan. Serbishtja kishte pasur ndikim në Italinë para romake, deri në gjuhën haramide biblike. Serbët (Sarbët) e lashtë prej këndeј (Mesdheut) qarkulluan në Afrikë(në luftë me Faraonin), në Azi, Indi gjithandeј deri sa patën kontakte me kinezët. Madje në të kthyer nga Irani (Persia) sipas autorit, implikimi i Serbëve dëshmohet edhe nga vetë emri **SRB** (serb/sarb) sepse në persisht **SAR** do të thotë kokë, krye, kurse **sarb** ose **serb**, përkatësisht **srB** do të thotë luftëtar **kokëprerës** (!).*

Lexuesi mund të vërejë ngjashmëri metodologjie me pellazgologët, që sapo thamë që në atë kohë para tij (Han, Bob etj.) kishin tërhequr interesimin e studiuesve seriozë të kohës ndërldhur me shqiptarët që sot pellazgologjia tashmë ka emër bindës pikërisht rreth ndërldhjes së prejardhjes shqiptare, apo jo, kurse reagimi imagjnativ i Milojeviqit i

asokohshëm për mendimin tim, s'ka asnjë të keqe të vlerësohet jo veç si *vesela kniga* (libër argtues) pa vlera, por edhe pse jo si dëshirë që cyt oponencë ndaj shkollës gjermane (perëndimore), madje edhe pse vërtet kanë ndodhur implikime përzierja popujsh...

Prandaj, për mendimin tim vetë fjalët e shqipes **shklavë** (shklavë shkjavë shkavë shkau) në krahasim me **sclav/us** të latinishtes **sklavos** të greqishtes, përkatësisht **sherb/yes /sherbë/tor** në krahasim me me lat. **serv/vus** e gr/ **serb/os** (*shih ndërndikimin s/sh*), flasin mjaft për përzierjen konkretisht të protoshqiptarëve që pas Tetrakisë së lashtë të Dioklicianit me sllavë si skllavë e shërbyes dhe sidomos pas Shkizmës së Madhe u implikuan zonat e interesit. Kështu një pjesë e atij vendi quhej **Shkiavoni** (F. Bardhi), përkatësisht **Servi** (P. Budi), Shërbi (P. Bogdani), prandaj shqiptari skizmatik që jetonte në **Shkiavoni** ishte krejt normale të quhej **shkja**, me kuptim jopejorativ, gjithashtu ishte krejt normale që skizmatiku shqipfolës që jetonte në **Serbi** të quhej **serb**, po në shqipe edhe **shërb/ye/s**, apo jo?!

Natyrisht kjo dukuri e shprehur në veprat e Milojeviqit meriton qasje serioze, ndërsa teprimet e tij gjithsesi kërkojnë sqarime, si:

Së pari, ajo që u shpreh në veprën Odlomci... e në veçanti fenomeni i asimilimi gjuhësor e kombëtar i *shkipëve, i cili* ka ndodhur edhe më përpara, por edhe më vonë, u gjallërua rrufeshëm, sidomos në mënyrë të organizuar shtetërore pasi Serbia fitoi autonmi shtetërore në shekullin XIX dhe ky aktivitet po vazhdon edhe pas luftës së fundit 1999, apo jo?!

Së dyti, te vepra **Putopis**... siç patëm hetuar edhe ne autori kishte shtuar në shënime jo vetëm tempuj, kisha e manastire të paqena, p.sh. në fshatin tim dy kisha të paqena, por ngulmonte se gjoja kishte, ndeshur edhe mbishkrime në gjuhën e lashtë sllave. që nga antika e sidomos nga mesjeta, nga periudha mesjetare nemanjide etj. Me thënë të dfrejtën, po për këto gjëra po po në atë kohë u kritikua nga studiuesi rus Jastrebov, që ishte konsul, në Shkodër e Prizren, i cili pasi bëri verifikime u shpreh se z. Milojeviç ishte *sharlatan e gënjeshtar*.

Së treti, te **Këngë popullore** ... kishte shtuar vargje qe gjoja kishte hasur nga goja e serbëve si këngë folklorike, me të cilat kinse dokumentohej qarkullimi i protoserbëve anë e mbanë botës deri në Indi e Kinë. Edhe për këto teprime ishte kritikua edhe nga shokët e tij si edhe të tjerë, madje njeri nga shokët e tij Ilarion Ruvarac, i cili duke i cilësuar ato këngë si trillime të dobëta të vetë z. Miilojevic shprehet: (*Milojević*) *Šarlatan, koji nije*

čak umeo ni krivotvorinu da napravi vešto./ M. sharlatani, i cili nuk qe i zoti as trillet e veta të rreme me i thurë mjeshtrisht!//

Po shtojmë edhe këtë se përveç këtyre teprimeve ne kemi vërejtur edhe ato ndaj gjuhës shqipe, ku ndër të tjera kemi cekur raste të tilla konkrete në punimin tonë, sidomos në kreun VII, prandaj këtu nuk po zgjatem, por po ndërlidhem me konstatimin e z. Ilarian Ruvarac, nga i cili kuptojmë se edhe studiues të tjerët serbë si makiavelistë përdorimin e gënjeshtër- mashtrimeve e kishin bërë rutinë (siç e pohon edhe shkrimtari akademik Dobrica Ćosić), por ato i bënë më me shkathtësi e mjeshtri se Milojeviçi, ngase ai për shkak temperamenti: **Što na umu - to na drumu** /Ç'kish në kry'bam nër sy, ishte më i drejtpërdrejtë nuk kishte nerva aq të stërholluara dhe vërtet nuk e kishte atë aftësi fsheheje për shkak të temperamentit të tij. Këtë e kemi vërejtur që jo pak gjera të politikës së fshehtë serbe i demantonte haptazi, siç ishte çështja e rrezikimit të manastireve e kishave serbe nga shqiptarët, shpërngulja inekzistuese e ashtuquajtur e madhe serbe, nuk e mohonte ekzistimin e *shkipëve* (shqiptarëve) të lashtë e të tashëm, të cilët kërkonte jo t'i zhdukte po t'i asimilonte gjuhësisht, pranonte variantizimi i emrit serv, sarb, serb srp etj. por për mendimin tim si e veçantë pozitive nga z. Milojevic mbi të gjitha është vet emërtimi i fjalës **shkip**, me të cilën ashtu quhej edhe gjuha edhe folësi i kësaj gjuhe. Lidhur me këtë po shtojmë:

e para, këtë gjuhë e flisnin disa komunitete etnish të së njëjtës gjuhë pa dalim feje e territori: arnautët, albanolatinet, poturët, serbë të shqiptarizuar, turqit shqipfolës, përkatësisht edhe ata të papërcaktuarit etnikisht që z. Milojevic i radhiti si: **ili -ili**, /ose-ose/, të cilët nuk pranonin se ishin latinokatolik apo arnautë malësorë ardhacakë, as serbë të poturëruar, por pranonin se ishin fetarisht turq, po turqisht nuk dinin, por e flisnin dhe trashëgonin me fanatizëm vetëm *shkipen*, dhe për këtë qëllim forcërisht vepronin në shqiptarizimin e grave serbe(!);

e dyta, me apelativin *shkip shkipi shkipjani*, kuptohej secili nga këta që fliste shqip pa marrë parasysh zonën gjeografike ju jetonte. Kështu **shkipë** quheshin *albanesët* në Albani, arbanët a arbanasit në Arbeni (Dardani//Serbi, Maqedoni), epirotët në Epir (Greqi), shkitë shqipfolës si edhe serbopoturët në Serbi, Pikërisht shkipët kishin shtrirje, pikërisht ashtu siç ndërkohë u instalua konkretisht vetë emri *shqiptar*, apo jo? Vërtet interesant, por për këto më në hollësi në kreun III të këtij punimi.

Po sido që të ketë qenë, ndoshta jo për *shkipët e gjuhën shqipe*, po edhe për arsye se z. Milojević “Ç'kishte në kry' ua përplaste në sy” pati

kritika e poshtrime dhe aq më keq për të, pasi edhe shteti nuk i doli mbrojtje dhe pikërisht si duket këto gjera, mbase edhe spastrimet barbare monstruoze jo vetëm kundër 400 fshatrave të *shqipëve paqësor* por edhe më terrorëzime të tjera sfarosëse *Serbia e Re e Çliruar*, ndikuan si rëndesë në thyerjen e tij shpirtërore, e si rezultat u shfaq topitje në punën e tij krijuese të mëtejshme, prandaj edhe e pensionuan në moshën 53 vjeçare, supozohet apo dyshohet që në vitet më vitale të pjekurisë jetësore të tij në moshën 57 vjeçare vdiq, thuhet se e *helmuan me moh*.

Sa ishte i bindur në qëndrimet e tij tregon kumbara i z. Milojevic, Kosta Shumenković se fjalë të fundit pa i dalë shpirti si amanet la: **“Cuvajte mi SrBstvo” (Ruamnani srB-ënë)**, ku vetëm B-ja e sforcuar brenda fjalës ka domethënien e tezës së tij.

Sigurisht kundërshtarëve nuk iu dhimbs shuarja e jetës së këtij punëtori të madh serbomadh, ngase kishte qëndrimet ndryshe që e konfrontonin haptas me interesat e përkohshëm të shtetit të atëhershëm. Me fjalë të tjera, humbi pse nuk dinte me gënjye mjeshtërisht si të tjerët. Sigurisht kundërshtarët kundër autoritetit të tij futen në përdorim edhe ndjenjat instiktive primitive si xhelozia, intriga dhe kjo armiqtësi ndaj tij u pa, jo pse nuk u përkrahën për së gjalli idetë e tij, por pse me rastin e varrimit në Beograd asnjë anëtar i *Shoqatës së serbëve të ditur*, madje anjë zyrtar instutucional apo pushtetar, jo vetëm nuk organizoi ceremoni përmortore, por nuk u duk t’i thotë dy fjalë për të, për kontributin e tij dhënë serbizmit (siç e thekson z. Jovo Bajic). Por aq më keq, askush nuk u përkujdes nga kolegët apo ndonjë institucion me ia ruejtë pjesën e pabotuar të *Putopisit* për Prava Stara Serbinë që siç pati pohuar vetë kishte edhe 9 vëllime në dorëshkrim. Madje thuhet se kishte lënë dorëshkrime e dokumenta plot 17 arka, të cilat s’dihet nga u tretën.

Sidoqë të ketë qenë, mbase këto mbetje 9 vëllimëshe apo në ato 17 arka dokumentash mund të ketë pasur teprime, por përveç bykut trille panserbosllave mund të ketë pasur edhe ndonjë kokërr drithi me vlerë historike e gjuhësore për **serbishten**, mbase edhe **në e për shqipen e shqiptarët**, siç pati bërë *me pahir*, kryesisht në librin e tretë të *Putopisit*, të cilin Shoqata e dijetarëve serbë, ndoshta për atë arsye, nuk ia botoi ose ia vonoi, andaj u përpoq vetë, vëllim ky, i cili as tash nuk po ribotohet i plotë(!!!). E kam në spikamë, ndër të tjera, edhe *sifjalorthin e tij shqip-serbisht* mbi 350 fjalësh. I cili assesi nuk po ribotohet, për çudi?!!!.

Veprat e Milojeviçit që në kohën e tij, mbeten të izoluar, ato u lanë po nën atë hije izolimi edhe pas vitit 1918, d.m.th., nuk u çizoluan

as në kohë të Kravevinës Jugosllave 1918-1941, madje as gjatë Jugosllavisë komuniste 1945-1999, por ato përveç në arkiva, u ruajtën dhe u shfrytëzuan më fort pjesërisht si nënrogos nga Bogosllavia, shkolla fetare pravosllave, vepra këto, të cilat “u zbuluan” për ndonjë segment vetëm pas “shpëtimit” të Serbisë e të Bogosllavisë nga Federata Jugosllave dhe në veçanti *u rilindën*, pasi Serbia e humbi Kosovën në luftë më 1999, siç dëshmon edhe botimi i veprave të Vemiqit dhe ribotimi ndërkohë i veprave me idealizimin i ideve të tij nga adhuruesit, jo vetëm nga Shoqata e sipërcekur, portali Krstarica, Akademia serbe etj.

Sido që të jetë, ne përshëndesim kërkesën e apelistëve, por sugjerojmë se një kërkesë e tillë, është e udhës, të zgjerohet, përveç kundër teprimeve romantike të Milojeviçit duhen shtuar edhe kundër qëndrimeve jo të drejtë ndaj shqiptarëve jo vetëm të Milojeviçit, por kundër disa emrave të tjerë, mekatarë e rrenca më të mëdhenj se Milojeviçi, të cilët ishin po pjesëtarë vazhdues të Lëvizjes nacional-romantike shoviniste serbomadhe të shek XIX e në vazhdimësi, po përgjithësisht ishin aktivë nga fundi i shek. XIX dhe në pjesën e parë të shekullit XX.

Prandaj kur është fjala te mitomania e pseudohistoria, për mendimin tonë apeli duhet të përfshijë mendimet absurde kundërshtimore të ashtuquajturive shtetarë e mendimtarë serbë si: Stojan Protić, Vladan Đorđević, Jovan Cvijić, Ivo Andrić, Vasa Čubrilović e të tjerë të vjetër por edhe disa të rinj të sotëm, të cilët me gënjeshtërmashtërime mohuan vlerat etnike e historike të kombit shqiptar, të vetë gjuhës shqipe si kriter i të së vërtetës, dhe kështu mashtruan e po mashtrojnë jo vetëm popullin serb me ide hegjemoniste e ekspansioniste, të cilin e gjakosën me mikun më të shtrenjtë që kishin në rrugëtimin historik, siç ishin shqiptarët, të cilët duke i mashtruar e tradhëtuar mashtruan e tradhëtuan edhe vetveten, kauzën njerëzore të popullit të vet, Europën e tërë botën, se gjoja shqiptarët qenkan erdhacakë të vonshëm në këtë vend, se gjoja Kosova ka qenë e banuar përherë me shumicë serbe, se gjoja vetëm serbët ndërtnuan kisha e manastire, duke mohuar ortodoksinë shqiptare vendase autoktone të hershme e në vazhdimësi. Me fjalë të tjera, sido që ta marrësh, u përpoqën me mohue të vërtetën e pamohueshme që shqiptarët përherë kanë qenë shumicë në Kosovë e më gjerë dhe se kishat e manastiret i ndërtnuan vet, prandaj edhe i kanë ruajtur dhe i ruajnë e respektojnë edhe sot e mot bashkë me sivëllezërit, shkiët e vendit, ortodoksët e vet, edhe pse për shkaqe politike, taktike, por edhe me dashje e padashje e kanë pëlqyer ndërrimin e fesë, apo sistemin e doktrinës

ideologjike, por assesi nuk e kanë harruar dhe as e harrojnë të kaluarën e vet kulturo-historike e fetare.

Sidoqoftë, një gjë dihet dhe kuptohet qartë se propaganda e qeverisë dhe e kishës serbe tani gjithnjë më inerte dhe e degraduar po vazhdon të shërbehet me gënjeshtër e mashtrime të tilla, nuk e ka hallin e fesë, po ka qëllimin ta rikthejë dhe ta mbajë edhe më Kosovën të pushtuar si koloni.

Së këtejmi apelohej që brezi i ri ideologjik i studiuesve dhe politikanëve serbë duhet të jetë i vetëdijshëm që për hir të së vërtetës e paqes, duhet të punojë në demaskimin e mitomanisë dhe pseudohistorisë jo vetëm lidhur me teprimet e sapocekura të Milojeviqit sipas Apelit të intelektualëve rreth prejardhjes hyjnore të serbëve e serbishtes etj., por edhe lidhur me pseudohistorinë rreth miteve të tjera, si miti i Luftës së Kosovës pa shqiptarë e të tjerë, miti rreth shenjtërimit të Lazarit e Kopiliqit, miti mbi shtetin jo ekzistues serb mesjetar të tribalëve Nemanja, miti mbi kishat dhe manastiret e krishtera (shqiptare ortodokse e katolike) të aneksuara pa të padrejtë nga pala serbe, me ç'rast përjashtohet qëllimshëm prania historike e shqiptarëve, përherë shumicë absolute në këto troje e më gjerë, apo jo?!

Gjithsesi nga ajo mitomani e pseudohistori duhet hequr urrejtja ndaj popullit shqiptar që pa të drejtë për arsye zaptuese hegjemoniste është shpallur armik nga kastat politike kishtare e shtetërore serbe, sidomos që nga shek. XIX e këndej që faktikisht shqiptarët kurrë nuk kanë qenë të tillë, po bashkëpunues të sinqertë.

Sidoqoftë, ne, në të vërtetë ende pa u njohur me veprat e Milojeviqit e biografinë e tij nga zberthimi i të dhënave nga vepra e Vemiqit bëmë gjetjen e lëshimit të qëllimshëm dhe konstatuam realisht përqindjen etnike **serbe –joserbe** në Serbinë e Vjetër (Kosovë) dhe rezultatit ashtu si ditëm e mundëm e publikuam më 10.09.2017 në **portalin zemrashqiptare.net** nën titullin bosht: **Injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës**, ku lidhur me këtë dukuri: ***gënjejshtër-mashtrim të madh (veliku laž-zabludu)***, në ballinë të punimit si paranjoftim përshëndetës bëmë me dije opinionin e gjerë lexues se në këtë vështrim kritik me titull **Injorimi i gjuhs shqipe si kriter i së vërtetës nga Miloš S. Milojević (1866-1873 dhe epranët e pasuesit e tij**, zberthyer nga vepra e hartografit **Mirčeta Vemić**, "*Harta etnike e një pjese të Serbisë së Vjetër sipas udhëpëshkrimit të M. Milojeviçit veç tjerash, mund të ndeshni:*

Së pari, kur te ne poturët (shqipfolës) me dhjeta mijë llogariteshin serbë, në tënjëjtën periudhë nga Principata serbe me qindra mijë të tillë, edhe pse shqipfolës, dëboheshin barbarisht nga trojet e veta si turq?!

Së dyti, si është e mundur që një gënjeshtër e tillë, me bisht më të madh se trupi, rreth shumësisë gjoja serbe në Kosovë, t'i ketë këmbët false të gjata mbi 150 vjet dhe faktikisht të mos vërehej e gënjeshtrohej nga askush dhe si e tillë si një verigë zinxhirore ende vazhdon me i ngërdhucë e helmue paskrupullisht marrëdhëniet serbo-shqiptare?! Së treti, është e mundur, apo jo, që sot dhe në të ardhmen mendjet e esëlluara serbe, në saje të së vërtetës, t'i gjykojnë gafet e tilla urrejtjembjellëse nga veprat si këto për gjoja ekzistuesen Serbia e Vërtetë e Vjetër, me shumicë serbe në Kosovë dhe t'i kthejnë ato në kërkimfalje, shans i mirë ky për t'u arritur paqetimi i singertë ndëretnik shqiptaro-serb për sot e nesër?!

Me këtë kam dashtë me paratregue se veprat e Milojeviçit dhe ajo e Vemiqit në temë-analizën tonë janë vetëm si shkas konsultimi e trajtimi, sepse tema jonë bosht është **Injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës**, temë kjo e cila e tëra rrah dukurinë pothuaj dyshekullore të shpërfilljes së gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës nga Lëvizja nacional romantike serbomadhe aktive (preporod) që nga shekulli XIX, e cila fatkeqësisht ende po vazhdon, çka dëshmon ribotimi e komentimi tendencioz jo vetëm i veprave të Milojeviqit, po edhe kjo e Vemiqit e të tjera.

Sido që të ketë qenë, ne e felenderojmë makiavelistin Miloš Milojević si dhe hartografin Mirčeta Vemić, që ndoshta me pahir në veprat e tyre na i ofruan të dhënat me të cilat argumentohet bindshëm në të mirë të shumicës etnike autoktone joserbe shqiptare në Kosovë para Kongresit të Berlinit. e vërtetë kjo që njëherazi u kthehet sot grushtakreje atyre dhe studiuesve keqinterpretues si dhe ndaj të gjitha mbeturinave të nacional-shovinizmit serbomadh, por njëherazi i bie në mend të gjithë fanatikët fetarë (shqiptarë, serbë, turq e të tjerë), të cilët injoruan gjuhën shqipe si kriter të së vërtetës.

Ne, pasi konstatuam që kjo gënjeshtër-mashtruese nga vepra e z. Milojević ndërkohë e prezantuar nga z. Vemić, pothuaj tash mbi 150 vite kishte qenë në shërbim hasmërie ndaj popullit shqiptar, gjithsesi ishte dhe

është rezultat i oreksit të kastës së Lëvizjes nacioal-romantike hegjemoniste serbomadhe ndaj gllabërimit të qenies shqiptare, e shishmuar dhe e ndihmuar edhe nga Turqia që me njohjen autonomisë serbe me kryeqyte Srmederevën e ndërkohë Beogradin, kur nga ai territor me pëlqimin e dypalëve u dëbuan të gjithë joserbët (joortodoksët), përkatësisht ata që nuk e pranonin asimilimin, prandaj ajo kërkesë e zgjerimit dhe e spastrimit të terrenit mbeti pjesë e programit të çdo qeverie serbe, sigurisht e bekuar nga kisha serbe (pravosllave), andaj ne jo sa për kundërvënje, por për të zbadhur të të **vërtetën** iu përveshëm punës dhe nga interpretimi i rregullt real i shifrave saktësuam se shumica e popullsisë në Kosovë atëkohë nuk ishte serbe po shqiptare, shqipfolëse. Por njëherazi shprehëm dëshirën që kjo gafë e rëndë të shërbejë si pretekst për esëllimin e kastës përgjegjëse të sotme serbe për të kërkuar falje për të gjitha të pamirat bërë në të kaluarën në kurriz të popullit shqiptar, shans e shkas shumë i mirë ky për me u arritë me mirëkuptim paqja e dëshiruar. Pra, kasta e palës serbe, qeveria e kisha serbe, duhet të kërkojnë falje për gjenocidin e për dëmet e luftës dhe gjithsesi jo edhe më ta pengojnë, por ta ndihmojnë pavarësinë e Kosovës. Dhe këtë ta bëjnë për hir të paqes së popullit të vet, për hir të fëmijë dhe brezave të adhsëm, për hir të mësimëve të Perëndisë dhe jo vetëm deklarativisht po me zemër e shpirt. Madje-madje kisha serbe të ndihmojë në bashkëpunim me autoqefalinë kishtarë të Shqipërisë që në shenjë respekti ndaj këtij populli lridashës, të shenjtit Gjon Vladimir e t shenjtëreshës Angjelinë, në kishat e Kosovës të fillojë të praktikojë edhe meshën në gjuhën shqipe, përkatësisht të përgatisë lutjet në të dyja gjuhët dhe këtë ta bëjë pa hezitim, ngase siç dihet të gjithë ortodoksët apo shkitë e vendit e dinë shqipen nga trashëgimia dhe kanë bashkëjetuar e bashkëpunuar si shqiptarë dhe kështu plotësohet më së miri kushti shpirtëror për kthimin e tyre në gjirin e sivëllezërve shqipfolës.

Sido që të ketë qenë, siç mendojmë ne, kërkimfalja është rruga më e mirë për arritjen e një paqeje e bashkëpunimi të vërtetë e të qëndrueshëm mes dy popujve: shqiptarë e serbë. Ky ishte dhe është në të vërtetë edhe mesazhi i këtij punimi.

Ç’është e vërteta, që nga publikimi ynë në “zsh” (2017-2018), ku doli sheshit sklluqi i këtij rrenë-mashtrimi plasuar nga Milojeviqi, përsëritur nga Vemiqi e të tjerë, gëzon fakti se nga pala serbe nuk pati reagime, po më tepër shihet nga ajo palë një sipranim i realitetit në heshtje, ndërkaq, nga institucionet shqiptare në Kosovë e Shqipëri, edhe pse nga punimi ynë dalin risime me vlera të pamohueshme që nuk njiheshin më

parë, pothuaj nuk u vërejt ndonjë reagim i fortë pozitiv, prandaj nuk pati sa duhet as jehonë mirëkuptimi për libërtimin e këtij punimi. Kjo amulli apo mosnjohje punë është pasojë e pandemisë së virusit famkeq, i cili fatkeqësisht paska prekur mendjesisht edhe disa nga studiuesit përgjegjës në institucionet tona, apo jo, le të vlersohet.

Sidoqoftë, kjo neglijencë mua nuk më ka befasuar fare, ngase jam mësuar me komplete të tilla për shkak të përdorimit të paskajores së mirëfilltë. Sidoqoftë, e quajmë me vend një *këshillë mësuesi* që punimi para se të libërtohet gjithsesi duhet rishikuar, sepse është e vërtetë se nuk ka vepër njerëzore individuale pa ndonjë lëshim, por edhe pesha e vërejës së të metave varet nga qasja e vlerësuesit, megjithatë nuk thuhet kot *se kush punon gabon, por më shumë gabon ai ose ata që nuk punojnë dhe punën që nuk e njohin ose nuk përpiqen me njohtë e vlerësojnë* kuturu.

Gjithsesi, pajtohemi, pra, që ky punim, para libërtimit duhet t'i shtrohet një rishikimi serioz, qoftë nga pikëpamja përmbajtësore historike, qoftë nga ajo gjuhësore normëzuese, sepse nga koha e botimit të dorëshkrimit në portalin “zsh” 2017-2018 kanë ndodhur gjëra të reja rreth dukurisë që rrah kjo temë, të cilat patjetër nëse vlejnë duhen përfshirë brenda kornizave të nëntemave sipas krerëve të tekstit integral, apo jo?!

Sido që të ketë qenë, kjo temë komplekse kërkon qasje e studime më të hollësishme e më të sofistifikuara, ku lypset angazhim i ekspertëve të institucioneve profesionale, të cilët mendojmë se duhet vlerësuar përpjekjen tonë modeste dhe duhet përplotësuar më tej temën bosht: ***Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës***, tani edhe pas rishkimit, i sistemuar po në këta shtatë krerë:

I. *Zbërthimi i përqindjes etnike serbe-joserbe në këtë pjesë të Serbisë së Vjetër (Kosovë) në vitet 1866-1867, nga vepra e z. Mirčeta Vemić, hartuar sipas Udhëpërshkrimit të z. Miloš S. Milojević;*

II. *“Injorimi, por edhe dëshmimi me pahir i shqiptarëve dhe gjuhës shqipe dhe e vërteta jetësore shqiptaro-serbe në Kosovë e më gjerë;*

III. *Reflektimi kontaminues i koncepteve të fjalë-termave ndërkombëtarë: s(k)llavë e serbë (si etni) dhe s(h)kizma (si dukuri) në gjuhën shqipe;*

IV. *Arbëria gjatë periudhës së sundimit osman, raporti turkoshqiptar/sllavoshka dhe pasojat fatale mbi shqipfolësit nga shkiezimi apo shkizmat e reja;*

V. *Rreth injorimit të gjuhës shqipe për shkak të fesë ortodokse në përcaktimin e kombësisë të shqive të vendit në përgjithësi dhe të atyre të fshatit Reçan të Therandës në veçanti;*

VI. *Shqipja si promotor i zgjimit dhe e rritës së shqiptarisë dhe injorimi nga vatra e nacional shivinizmit serbomadh dhe vatrën e tjera penguese dhe*

VII. *Kontributi me pahir i z. Miloš Milojevič në e për gjuhën shqipe.*

Natyrisht pasojnë përfundimi e rezymeja e vlerësimit kritik historiko-gjuhësor i veprës.

Së këndejmi, jemi përpjekur, pra, që syzheja me kokluzionet përkatëse e këtij punimi të jetë vërtet sa më në nivel, vlera e së cilës duke u mbështetur në të drejtën dhe të vërtetën objektive si e tillë të ndikojë pozitivisht si pikë në përmirësimin e marrëdhënieve serbo-shqiptare. Raporti të jetë në përputhje dhe me disa deklarata të pushtetarëve (që do të dëshironim të mos jenë vetëm formale politike), që plasohen, qoftë nga drejtuesit aktual të shtetit të Serbisë, qoftë të Kosovës apo të Shqipërisë dhe nën atmosferën që po sugjerohet me ndërmjetësimin e SHBA-së dhe BE-së.

Kështu gjatë shtjellimit të lëndës në krerët përkatës të këtij punimi, që secili në vete mëtohet të jetë një simonografi në vete do të sjellim në kujtesë argumenta që përplotësojnë temën me ndonjë të vërtetë historike rreth qeniesisë shqiptare që karakterizohej me gjuhë e virtyte si komb i vjetër i këtyre trojeve, gjuhë kjo që pothuaj del në njëfarë mënyre si e konsoliduar para ardhjes së sllavëve këndeje, fakte këto disa të **padiskutueshme** të cilat **duhen njohur e jo injoruar, sidomos nga studiuesit e politikanët përgjegjës serbë e anasjelltas, pjesëmarrës në negociata, në mënyrë që këto marrëdhënie serbo-shqiptare tash e në vijim të ecin drejt normalizimit të plotë e të vërtetë**, që njëherazi, po përsërisim, edhe është mesazhi kryesor i këtij shkrimi, të cilin para se ta përfundojmë po e përforcojmë me një profil të konstatimit të shprehur në pjesën IV të kreut VI të dorëshkrimit, me ç'rast ritheksojmë faktin se nuk mund të mohohet bashkëjetesa shekullore e shqiptarëve me serbë, grekë e të tjerë por edhe me turq dhe kontributi që dhanë shqiptarët ndërkohë, sidomos nga fundshekullit XVIII dhe gjatë tërë shek. XIX, në shtetëzimin dhe nacionalizmin ose zgjimin nacional-romantik kombëtar të tyre. Kështu, pa u zgjatur në sqarime dihet se shqiptarët të identifikuar në katër vilejete që ishin nën sundimin e asaj perandorie karakterizoheshin me tri

fe kryesore muslimane, ortodokse dhe katolike dhe me shumë sekte. Ortodoksët e jugut të Shqipërisë u përshinë masivisht në kuadër të nacionalizmit grek në luftën për liri e pavarësi, gjithashtu ndodhi edhe me nacionalizmin serb ku komuniteti ortodoks shqipfolës u angazhua për autonominë politike e shtetërore të Serbisë, ndërkohë edhe pse ishin më të vonuar edhe turqit sajuan nacionalizmin e vet osmanlli, ku u përfshi një masë e gjer muslimanësh shqipfolës. Kështu këta nacionalizma kombëtarë në vend që të ndihmonin rinlindësit shqiptarë të të katër vilajeteve që që edhe shqiptarët të arrinin pavarësinë në trojet e veta dhe të bëhej një paqe e liri e vërtetë, këta nacionalizma luftuan rilindësit shqiptarë që propagandonin shtet kombëtar pa dallim feje, propagandonin zgjimin kombëtar kryesisht mbi bazë gjuhe dhe me tolerancë fetare, dhe pse nuk preknin asnjë interes jetik të fqinjve. Së këndejmi përfshirjen masive të shqipfolësve naivë si ndihma nacionalizmave të huaj (fqinjëve ortodoks e turq) u “shpërblyen” jo vetëm me mospërfillje drastike ndaj gjuhës shqipe dhe aspiratave të rilindjes kombëtare shqiptare, por duke shfrytëzuar tolerancën fetare të shqiptarët, kjo ndihmë të sinqertë e tyre u keqpërdor deri në asimilimin dhe zhdukjen e gjuhës e popullit shqiptar. Kështu grekët në mënyrë të organizuar fetarisht përvetësuan çam e arvanitas shqipfolës, të cilët iu nënshtuan pothuaj vullnetarisht nacionalizmit grek. Në të njëjtën mënyrë edhe serbët këndej nga veriu me nacionalizmin pansllavisht idealizuan mitomanisht pravosllavën, më saktë liturgjinë ortodokse dhe kështu, pothuaj nga gjithë territori këndej nga veriu përthithën në gjirin e vet masë të ortodoksësh shqipfolës (shkitë tanë), të cilët me naivitetin e tyre pranuan jo vetëm bashkëpunimin, por edhe asimilimin, edhe pse në disa zona gjuhësisht nuk ia arritën plotësisht atë asimilim. Edhe më keq turqit duke e shfrytëzuar fenë muslimane dhe shtetin përthithen masë të gjerë shqipfolësish, sidomos ata që jetonin e vepronin në tokat aziatike e afrikane.

Kështu këto efekte që nuk i them me nostalgji, por po i theksoj si fakte reale ndikuan në vonimin dhe moskonsolidimin si duhet të nacionalizmit shqiptar, nacionalizëm ky i vetmi në Ballkan pa kërkesa hegjemoniste sikurse ai grek, e serb e të tjerë, ngase nacionalizmi shqiptar u sajua vetëm në mbrojtje të trojeve të veta aty ku mbizotëronte gjuha shqipe. Megjithatë edhe si i tillë u pengua nga shtetit turk për mosdhënie autonomie me kohë, u sabotua pandërprerë nga shtetet fqinje, të cilat në vend që të ndihmonin pabesisht pushtuan tokat shqiptare, duke i shndërruar shqiptarët në robë me synim dëbimi apo zhdukjeje.

Fati tragjik i popullit shqiptar dihet, megjithatë përpjekja e rilindësve tanë të tri feve e në veçanti të intelektualëve dhe klerikëve patriotë katolikë, orodoksë, begtashi, sunitë e të tjerë më 1912 u shpall **Shqipëri e pavarur**, pavarësi që e atribuoi vetëm një pjesë e atij Arnautistani.

Sidoqë të ketë qenë. efektet e tilla asimiluese të shekulli XIX vazhduar edhe në shekullin XX ndihen edhe sot si në Shqipëri edhe në Kosovë, e cila u themelua si shtet në vitin 1999 dhe kështu shpëtoi nga kolonizimi nën Serbi.

Është e vërtetë se prejardhjen shqiptare e pranojnë lirshëm me miljona frymë në Turqi e anembanë shtete islame, tashmë të asimiluar, por edhe familje të tëra katolike e unite në Perëndim, në Greqi përejardhje shqiptare intimisht në masë shtresa të gjera ortodoksësh arvanitësh e çamësh e të tjerë nuk e kanë të shuar, por nga shteti e kleri hezitojnë ta shprehin, sepse mund të kenë pasoja. Ky konstatim vlen edhe për Malin e Zi e sodomos Serbinë e Maqedonuinë, por kemi bindje se me arritjen e paqes së vërtetë, një deklaram i tillë sa i përket prejardhjes historike nuk do të jetë as për shumë mbiemra familjesh ortodoksësh nga e veriut të Arnautistanit apo të Dardanisë së lashtë siç e ka të ravigjzuar në ndër dije, por sidoqoftë paqja i sjell të mbaren e të mirën një pjesë dërmuese të njerëzve normalë dhe gjithsesi gjithandej e këndej patjetër do të shuajë plotësisht urrejtjen ndaj shqiptarëve dhe anasjellta, sepse as shteti, as feja, madej as nacionalizmat ekstrem nuk do të kenë arsye për armiqësi e mëni të tilla në shoqërinë, ku do të jetë për qafuar model i shoqërisë së Europës Perëndimore, apo jo?!

Sa i përket shtetësisë së Kosovës nuk është mirë që vetëm për Serbinë mbeti çështje e brishtë. Është shumë e logjikshme, siç vepruan shtete europiane për kolonitë e tyre, edhe Serbia ta njohë Kosovë, pavarësia e saj, madje edhe duhet ndihmuar edhe nga shteti aq më shumë nga kisha serbe. Themi kështu ngase siç doli në masmedia më 27.07.2021 gëzon fakti “*se në Serbi sipas një hulumtimi rezultoi se rreth 70% e serbëve duan paqe të përhershme me shqiptarët në Kosovën e Pavarur*”.

Së këtejmi, si duket ka ardhur koha që serbët të jenë të shëruar nga mitomania dhe pseudohistoria, fakt ky që sot studiuesit e esëlluar serbë atë lëvizje nacional-romantike serbomadhe vetë ta kthejnë mbarë, ta shndërrojnë në Lëvizje paqesore dhe kështu ta kthejnë atë në lëvizje mirëkuptimi në kërkim falje ndaj padrejtësive deri monstruoze bërë

shqiptarëve, pasi gjithkush duhet të ketë bindje se vetëm bashkëmirëkuptimi mes popullit shqiptar e atij serb është domosdoshmeri, rrugëzgjidhje tjetër nuk ka. Nuk do të shiten më gënjeshtat si më parë. Ato nuk i qas as popullit serb, vendet perëndimore jo se jo, po as Rusia, e cila e di se me shqiptarët duhet të këtë politikë tjetër, gjithsesi jo politikë të vjetër pansllaviste poshtëruese pushtuese asimiluese.

Punimi ynë mund të cilësohet edhe me elemente të një sipamfleti kundër mbeturinave të atij nacional-shovinizmi romantik serbomad, përkatësisht kundër të gjithë nacionalshovinizmave naivë fetarofundamentalistë që po pengojnë paqetimin ndërfaqinjësor shqiptaro-serb, ku fatkeqësisht po shfaqen aktivë në veprime grupe të caktuara të shtetit e sidomos të kishës serbe që po manifestohet duke mospranuar realitetin që Kosova tashmë është shtet i mëvetësishëm dhe si të tillë duhet njohur, por edhe ndihmuar, gjithsesi jo injoruar e sabotuar. Këtë detyrë paqetimi duhet ta dijë e kuptojë si ilaçin më të mirë vetë populli serb, qeveria, shkrimtarët e studiuesit e SANU-së dhe kisha nacionale serbe, faktorë këta që për ta lehtësuar mëkatën të pandërprerë tashmë dy shekullorë ndaj shqiptarëve, i cili, veç tjerash, u shfaq edhe në përmasa gjenocidale që nuk mund të mohohen as të harrohen dot:

Së pari më 1877/78, kur veç qyteteve nga katër krahinëza të okupuara (Nish, Piro, Vraje, Toplicë) u spastruan *shkipët* me terror nga afro 1000 fshatra (998, sipas nënkosullit anglez z. *Gould*);

Së dyti, më 1912/13 kur u pushtua Kosovë e Maqedoni, fillimisht siç raportohet nga reporterët përkatës afër Shkupit, për kursim plumbash, u therën 2000 arnautë paqesorë, ndërsa në Ferizaj 3.500 e afër Prizrenit 5000 etj. Pati aq shumë vrasje e terror, konfiskime, shpërngulje e zhdukje deri ndërkohë edhe ligje shtetërore që arsyetonin monstruime të tilla;

Së treti, më 1944/45 me rastin e ripushtimit të Kosovës pati represalje e terrorizma në masë deri vrasje ushtarësh shqiptarë të mobilizuar, siç ishte Ploja e Tivarit etj. dhe

Së katërti, më 1998/99 pati gjithashtu vrasje masive barbare të popullsisë, saqë për fshehje krimi kufomat e viktimave u bartën *si trofe* e kamufluar në Beograd, saqë disa nga ato kufoma, ku përgjithësisht ndër viktima ishin edhe mbi 1000 (1.133) fëmijë i zbuluan valët e Savës që edhe ato i patën rëndë me i tretë, apo jo?!

Së këndejmi për gjitha këto faktorët: shteti, kisha, SANU dhe grupe e individësh duhet me dhënë përgjigje, në veçanti edhe kisha serbe

e cila i bekoi këto dhuna si dhe luftën e fundit, andaj ajo duhet vepruar, sipas asaj siç mëson Bibla, përkatësisht siç ka porositur vetë Jezu Krishti:

Prano, rrëfahu, mos e fsheh mëkatin, trego të vërtetën se e vërteta do të të lehtësojë!

(Gjoni 8.32)

Gjithsesi nga të gjitha palët duhet të pranohet parimisht e faktikisht realiteti, duhet spastruar shpirti me demaskimin e së keqes. Të mos mbetet as një shibël urrejtjeje e shkaktuar nga politika e deritashme e trashëguar serbe antishqiptare, madje edhe ajo sporadike si reaksion dhe tërë ajo e pamirë të shndërrohet në mirësi dhe mirëkuptim. Të pranohet e vërteta, rreth shumësisë shqiptare, së paku siç e ka shënuar në fakt mbase me pahir edhe Milojeviqi se ortodoksët në Kosovë me dhjeta vite para Kongresit të Berlinit pra edhe në vitet e 1866-1868 ishin pakicë, ndaj joserbëve shqiptarëve shumicë.

Për t'u realizuar kjo, Serbia e sotme, qeveria e kisha e saj, patjetër duhet të distancohen nga e kaluara e përgjakshme e asimiluese ndaj popullit shqiptar e Kosovës si koloni.

Kreu I
INJORIMI I GJUHËS SHQIPE SI KRITER I SË VËRTETËS
RRETH ZBËRTHIMIT TË PËRQINDJES ETNIKE
SERBE-JOSERBE NË NJË PJESE TË SERBISË SË VJETËR
- KOSOVË (1866/1873)

Hyrje

Me të çfaqurit në ekran televizori vepra: M.Vemic “*Etnicka karta dela Stare Srbije prema putopisa M. Milojevića*” (Hartë etnike e një pjese të Serbisë së Vjetër sipas Udhëpërshkrimit të z. M. Milojevic), siç e kemi cekur në hyrje të këtij punim, m’u zgjua kureshtja për të trajtuar këtë vepër në mënyrë analitike dhe pas konsultimit në origjinal të veprave të Milojeviqit për lehtësi studimi e manipulimi, duke respektuar ecurinë metodologjike origjinale të përdorur nga z. Vemiq lëndën në këtë krye e kemi trajtuar në këta pesë nënkrerë:

Së pari, disa të dhëna paraprake interesante nga vitet 1866 -1867 për Kosovën sipas veprës së Vemiçit: “*Etnicka karta dela Stare Srbije prema putopisa M. Milojevića*”.

Së dyti, disa konstatime rreth termave nga legjenda me ndonjë sqarim të domodoshëm.

Së treti, disa konstatime rreth emërtimeve të vendbanimev të Kosovës nga viti 1866/67 dhe përbërja e tyre etnike.

Së katërti, venerime dhe sqarime plotësuese nga aspekti gjuhësor rreth emërtimeve të vendbanimeve.

Së pesti, përplotësime përmblylëse rreth vërtetësisë së llogaritjes së të dhënave statistikore në total.

Sidoqoftë, ne, edhe pse më tepër jemi përqëndruar në konstatime konkrete rreth injorimit të gjuhës dhe historisë shqiptare, materialin e përmbledhur dhe konstatimet e këtij autori (Vemiq) i kemi shfrytëzuar në të mirë të përforcimit të mendimeve tona gjatë analizës bërë sipas nënkrerëve përkatës të këtij kreu.

NËNKREU I

TË DHËNA PARAPRAKE INTERESANTE NGA VITET
1866-1867 PËR KOSOVËN SIPAS VEPRËS “Etnicka karta dela
stare Stare Srbije prema putopisa M. Milojevića”

Si të dhëna paraprake me interes sipas tekstit që konsultuam nën titullin” *Etnička Karta dela Stare Srbije prema Putopisa M. S. Milojevića (2005)* (Harta etnike e një pjese të Serbisë së Vjetër sipas Udhëpërshkrimit të z. M. Milojeviq”. botim i SANU-s, libri 61 /internet/, Beograd, 2005), përpunuar e hartuar nga z. Mirčeta sipas udhëpërshkrimi i z. Milosh S Milojeviq, dhe me parathënien dhe epilogun shkruar nga akademik Vladimir Stojančević, veç tjerash na ra në sy se Kosova edhe nga z.Vemiq quhet pjesë e Serbisë së vjetër (deo Stare Srbije), ndërsa Milojeviqi në Udhëpërshkrimin si titull të përbashkët për tri vëllime (libra) e përdor titullin: **Putopis dela Prave –stare Srbije** (*Udhëpërshkrim i një pjese të Serbisë së Vërtetë të vjetër*), Milojeviçi i shtron atributin *Prave Srbije* (Serbi e Vërtetë). Kështu quhej Kosova me sherr, kur Serbia nga Smedereva në Beograd (Pashakllëku i Beogradit nga Porta e Lartë fitoi **autonomi fetare (1859)**, përkatësisht Autonomi politiko-shtetërore serbe, gjoja tëurvejuar! Kjo zgjon intres sepse, mesa kam lexuar termi serb e Serbi për të parën herë vetëm në këtë periudhë merr konotacion nacionalist njënacional, njëetnuik. Kështu themi se emri Serbi si emërtim toponimik ishte i mëhershëm që sadokudo zëvendësonte Dardanië e Dioklicianit, që përfshinte edhe pjesë të Maqedonisë, ngase fillimisht turmat sllave grekët i quanin servos, e latinët servus (shërbëtorë) Këtë fakt e pranon edhe z. Milojeviq, mirëpo me këtë koncept praktikisht nuk quheshin vetëm sllavët serb me gjuhën e sotme serbishte, por edhe popuj të tjerë që jetonin në ato vise, madje mëtohet se shumica ishin pikërisht *shkipë, qoftë si shëbyes, qoftë si fisnik-drejtues me emërtim tjetër latin apo elin* mirëpo lidhur me këtë do të bëhet fjalë edhe më poshtë.

Sidoqoftë, veç tjerash nga vepra z. Vemiq, përkatësisht veprat e z. Milojeviq, morëm njohuri me shumë interes që na zgjuan kërkshërinë të mësojmë jo vetëm rreth drejtshkrim-përdorimit të disa emërtimeve të vendbanimeve në Kosovën e asokoshshme, por edhe për gjendjen e etnive dhe për numrin e tyre, sepse siç na bëhet me dije në fundvitet e 1860-a, me gjasë brenda viteve 1866-1868 me urdhër shtetëror të Principatës dhe të Kishës Serbe dhe me pëlqimin e këtij intelektual, studiuesi Miloš S. Milojević dërgohet në emision special në të ashtuaquajturën Stara Serbi për të vjelë material, sidomos në të mirë të propagandës për të ngritur e nxitur elementin serb në përputhje me frymën e planprogramit të nacionalromantizmit pansllavist serb *Naçertanije* (1844) të Ilija Garashaninit (1812-1874), program sekret ky i politikës së jashtme

nacionale serbe, i përpunuar ndërkohë nga Shoqata e dijetarëve serbë pranë Principatës serbe (Smederevë –Beograd), sipas të cilit Serbisë si principatë i duhetj shtrirje, prandaj duhet të punonte për *çlirimin e bashkimit* e të gjithë serbëve (ortodoksëve) në Ballkan, përkatësisht të tokave serbe “*kudo ku janë*” (V. S. Karadžić). Në të vërtetë, programi në fjalë, i cili kishte filluar së realizuari që më parë me largimin e elementit joserb muslimanë kryesisht shqiptaro-boshnjak nga ajo Principatë dhe njëherazi me dërgimin më parë të mësuesve dhe personelit kishtar pravosllav, të cilët do t’i ndihmonin Milojeviçit në misionin e tij (Shih: Jovo Bajic, 8.11.2018, internet). Gjithsesi ndërkohë ky program u përplotësua edhe në Mbretërinë Serbe nga pasardhës të Garashaninit e bashkëkohorë të M. Milojeviçit, ndër ta më të zëshëm ishin: N. Pashiq, S. Gjorgjeviq, J. Cvijiq etj., të cilët pas pushtimit dhe përvetësimit të Serbisë Jugore, përkatësisht Arnautllëkut Verio-Lindor (1877-1878), shtuan oreksin për shtrirje të mëtejme, duke u mbështetur edhe në mitin folklorik të krijuar më parë si Stara Serbi e Maqedoni, ku veçohej Shqipëria e Veriut e sidomos Kosova e Dukagjini të cilën Milojeviçi e të tjerë e quanin Prava Srbija (Serbia e Vërtetë), por në plan ishte madje jo vetëm *çlirimi e bashkimi* edhe i Maqedonisë e vise të tjera tl Shqipnisë që ishin në administratën e Perandorisë Osmane. Dhe kjo të bëhet në bashkëpunim me Greqinë e Malin e Zi.

Me fjalë të tjera planifikohej “*të çliruarit*” e tërë Turqisë europiane (Rumelisë, përkatësisht Arnautllëkut të Turqisë), sepse për këto toka gjoja Serbia më tepër se çdo shtet tjetër e kishte të drejtën e shenjtë fetare e historike që nga Mesjeta (!), ngase në shek.14, këto hapësira paskan qenë në përbërje të Perandorisë Nemanjide (serbe), selia e së cilës fillimisht nga Rasha (Rashka) qenka shtrirë e sforcuar në Kosovën e sotme, prandaj edhe emërtohej kjo trevë propagandisht Stara Srbija, ndërsa Milojeviçi i shton atributin *Prava stara Srbija /Serbi e Vërtetë/*. Së këtejmi këtë fryrje sugjestive fantastike lypsej sadokudo arsyetuar me “fakte” se gjoja ende në këto hapësira ekzistonte elementi serb, dhe se ende flitej serbishtja dhe se populli që jetonte si shumicë në këto troje edhe pse tani nuk quheshin serbë po “*shkipi shkipi*”, ata në të vërtetë paskan qenë serbë dhe kinse edhe aktualisht nuk fshihet nga vetë ata prejardhja sllave serbe e tyre(!), identifikim me ortodoksizëm, por disa prej tyre gjuhësisht qenkan *shqiptarizuar* me dhunë nga Turqia (!) etj. Makineria propagandistike serbe, pra përpalli mendime se këtë popull, që tani paraqitej shumicë që në tekst edhe pse më parë nga sllavët e parë, quheshin

arbanas arbanasi ose sipas turqishtes zyrtarisht quheshin *arnauti*, tani nga Milojeviçi quhen jozyrtarist: *shkipi, shkipi* ose *shkipjani*.

Sidoqoftë, po me kësi koncepti të paraformuar jodrejt Milojeviçi niset në misionin e tij, siç u cek më parë, andaj pasi kjo ide në realitet i del zhgënjyese, sepse në këto treva përveç shqipës vende -vende përdorej gjuha bullgare, përkatësisht gjuha e vjetër kishtare sllavo-bullgare (metodocirilie), kundër atij ndikimi ishte shumë aktiv Milojeviçi, me intelektualë e klerikë serbë të organizuar mirë, madje për torbeshët e goranët nga ana e Prizrenit Milojeviçi, gjuhën e tyre të shpejtë e quante të pakuptueshme, por në xhaminë e Lubinjës ndëgjon dhe e kupton mirë vaizin e një hoxhe sojli(!!!).

Ç'është e drejta, për hir të së vërtetës kërkohet nga lexuesi dhe studiuesit të mbajnë qëndrim kritik distancues ndaj gjykimeve makiaveliste të autorit të udhëpërshkrimit si dhe hartuesit të hartës si vlerësues të veprës së Milojeviçit dhe pasuesve të politikës shtetomadhe serbe të asokohshme, të ndërkohshme dhe të sotme, politikë shumë të dëmshme kjo për marrëdhëniet shqiptare-serbe, veprime këto, që mjerisht nuk reshtin edhe sot nga qarqe të caktuara shtetërore serbe, edhe pse, atëherë dhe sot kishin e kanë mbështetje në gënjeshtra.

Ndërkohë, pas krijimit Serbisë e të të Jugosllavisë Mbretnore si edhe më parë, deri sa ishte gjallë autori, lidhur me saktësinë e të dhënave nga udhëpërshkrimi e harta e tij, si dhe për veprat e tjera të M. Milojeviçit, historianët e hulumtuesit zyrtarë serbo-jugoslavë e të tjerë kishin shprehur rezerva të ligjshme, dhe për këtë kishin të drejtë, sepse vepra e tij nuk mund të cilësohej si burim i mbështetur shkencërisht në kuadër të shkencës serioze europiane dhe si e tillë pothuaj qe mënjanuar edhe nga qarqet shkencore serbo-jugosllavee asj kohe dhe periudhës së Jugosllavisë titoiste. Mirëpo, si duket pas zhbërjes së Jugosllavisë (federale), pastaj pas Çlirimit ose ndarjes së Kosovës me luftë nga Serbia 1999 dhe para shpalljes së saj Shtet i Pavarur e Sovran (2008), propaganda serbe në valët e turbullta të lundrimit politik, kërkoi dhe e gjeti edhe këtë barkë sulmi për të penguar Pavarësinë e Kosovës, kështu zbuloi materialin e tillë të pasivizuar nga arkivimi rregallë zyrtar, por i gjallë në kuadër të klerikëve të shkollës së bogoslllovisë, material ky, të cilin vazhdon ta ringjallë edhe me ribotimin e dorëshkrimeve të Milojeviçit, siç u bë edhe me ribotimin e përpunuar të veprës me titull: *Etnicka karta dela Stare Srbije* (Hartë etnike e një pjese të Serbisë së Vjetër) për ta përdorur edhe këtë gënjeshtrë-

material, bashkë me mjete e insinuata të tjera propagandistike kundër Mëvetësisë së Kosovës.

Sidoqoftë, ne kemi bindjen se shkencëtarët e vërtetë serbë e dinë fort mirë që materiali i tillë, edhe pse i lyer e ngjyer me bojna e i përkthyer në gjuhën angleze, është një trill a në barkë trinë dërrasash e pagozhduar mire në dallgët e zhvillimit shtetëror e ndërkombëtar nëse i shtrohet sadopak valëve të kritikës serioze, siç po bëjmë ne, duke e pasur gjuhën shqipe si kriter të së vërtetës, që në puqjen e parë me dallgëzimin e komenteve shkencore do t'i çarten ngjyrat dhe do t'i shpartallohen dërrasat dhe si bumerang jo vetëm do t'ua vrasin këmbët e leqet, por do t'iu përplasen marrëzisht surratave përfaqësuese serbomëdha, ngase jo me shumë mund del në shesh e vërteta, gjithsesi jo në dobi të përqindjes serbe, por të asaj joserbe (shqiptare) në trevat e atëhershme të Kosovës së sotme e më gjerë.

Ç'është e drejta, pasi të metat nga një rehabilitim ose botim i tillë i veprës në fjalë mund të shihen, jo vetëm nga specialistët e degëve përkatëse, por edhe nga amatorët, apo jo, ne lidhur me këtë shprehim *dhimbisuri*, jo vetëm për konsultuesin akademik si dhe për botuesin SANU të veprës në fjalë, por edhe shprehim çudi për vetë autorin z. Dr. M. Vemić! Është fjala konkretisht për vështrime e analiza përkatëse objektive si po i bëjmë ne, të cilat do të ndihmonin në të zbardhurit e raporteve reale ndëretnike serbo-shqiptare për sot e nesër. Së këtejmi, ne, më tepër si një dashamirës i së vërtetës, si intelektual i pavarur, adhurues i sinqertë i paqetimit ndëretnik shqiptaro-serb, pa asnjë shibël urrejtjeje dhe anshmërie, për aq sa dimë, morëm për sipër që me këtë vështrim kryesisht historiko-gjuhësor të japim ndihmësën tonë lidhur me të sqaruarit e drejtë të këtij rasti dhe të disa çështjeve të tjera të trajtuara ose të prekura joobjektivisht aktualisht nga pala serbe, mbase jo aq me ndonjë tendencë makiaveliste, por për mungesë koncepti e mosnjohje punë, apo jo?!

Gjithsesi, duam të besojmë, se tashmë janë pjekur kushtet që shumë gjëra të plasura më parë dhe aktualisht në marrëdhëniet serbe kundërshqiptare duhet të rishikohen me gjakftohtësi dhe të revidohen të këqijat në mënyrë më të mundshme realisht. Në të vërtetë, autori M. Vemić mbase duke qenë i ndikuar nga autoriteti i veprimtarisë atdhetare voluminoze vërtet grandioze të shumanshme të M. Milojeviçit për kohën, me fantazinë e bujshme krijuese në të mirë të jetësimit romantik, përkatësisht sforcimit të serbëve e serbizmit dhe zmadhimit sipërfaqësor apo shtrirjes së suksesshme të Knezhevinës serbe: nga Pashallëku i

Beogradit, qoftë 10 vjet pas atij udhëpërshkrimi, por edhe më vonë deri sa qe në jetë, nuk ka mundur të dallojë mirë ose ta qërojë pjesën shkencore e atdhetare pozitive, nga ato pjesët lajthitëse makiaveliste antishkencore si romantikometodë të cilën e shfrytëzonte atbotë Milojević si modë-metodë me jo pak bashkëpunëtorë e pasues të tij.

Për mendimin tonë, M. Vemić, bie viktimë e atij autoriteti, dhe të situatës aktuale të përmjegullt, pa menduar se me një punë e tillë siç bëri e po e bën sot ai, nuk i sjell asnjë të mirë as shkencës në përgjithësi, as Serbisë, askujt, përkundrazi i jep hije jo të mirë atij si studiues dhe SANU-së, e cila njihet si institucion i njohur ndërkombëtarisht, që e përfaqëson Serbinë e kulturën shkencore serbe në botë jo me rrena, po me të vërteta shkencore, me dije të vërtetë objektive.

Së këtejmi, në bazë të asaj që zbuluam ne nga trajtimi i materialit nga kjo vepër (2005) dhe nga sqarimi shtesë në veprën tjetër që ka bërë ndërkohë z. Mirçeta Vemić, del sheshit se e vërteta e tij tregon të kundërtën e asaj që e shpreh ose duhet ta shprehë, sepse për hir të së vërtetës hartuesi i kësaj harte lidhur me përqindjet etnike përkatëse serbe e joserbe në Kosovën e atëhershme (1871) duhet t'i ndërrojë ngjyrat në dobi të shqipfolësve.

Mendimin tonë do ta argumentojmë gjatë shtjellimit të mëtejshëm të kësaj teme, prandaj lus lexuesin e nderuar dhe studiuesit solidë, përfshirë edhe ata serbë dhe vetë autorin e hartës, z. Vemić, që nëse do me kuptue e me marrë vesh më mirë **“të vërtetën”** i duhet me marrë pjesë në gjykimin që del nga analiza dhe sidomos duhet pasur kujdes lidhur me interpretimin e fakteve dhe të japë edhe ai kontributin objektivisht. Sigurisht, në këtë drejtim kërkojmë prej tij e shokëve të tij, që t'i konsultojnë edhe veprat e specialistëve shqiptarë e të huaj, të cilët i kanë rrahur temat si kjo me kompetencën e duhur, por që sipas meje nuk kanë qenë shterrues dhe bindës, pasi kjo vepër e Milojeviçit (Vemiçit) më përpara nuk ishte aq e njohur.

Së këndejmi ne, bazuar në fakte që zbulohen nga analiza e zbërthimi i kësaj lënde, qartësojmë pa vështirësi këto të vërteta:

së pari, praninë e popullit shqiptar në viset e ashtuquajtura serbe me fe e besim të njëjtë ortodoks (pravosllav) dhe

së dyti, mësojmë për përqindjen e gjendjes etnike të atëhershme rreth raportit serbë/joserbë (shqiptarë) në këto hapësira, ku nga statistika e shënuar në veprën në shqyrtim, sipas interpretimit real siç tregojnë faktet,

duke e pasur si kriter gjuhën e etnisë, kontatojmë se rezultati del në të mirë të anës shqiptare.

Siç dihet, mbi bazë të atyre koncepteve të gabuara rreth injorimit të gjuhës së masës shqipfolëse janë bërë padrejtësi tejet të mëdha ndaj etnisë shqiptare, dhe si rrjedhojë janë përdorur masa represive shnjerezore monstroze direkt e indirekt, jo vetëm kundër asaj etnije me fe muslimane e katolike, por edhe ndaj masës ortodokse shqiptare dhe të familjeve laramane shqiptaro-serbe (ortodokse) që nuk ishin të rralla atëbotë te ne e më gjerë, veprime të padrejta këto, të cilat, në trevat tona, deri edhe sot e gjithë ditën, në marrëdhëniet ndëretnike, kanë lënë gjurmë të pashlyera përkeqësuese.

Pra qëllimi ynë është vetëm e vetëm pasqyrimi i së vërtetës, ngase drita e së vërtetës do të bëjë të mundur të zbutet ose edhe të shuhet krejtësisht urrejtja e mjellë nga shovinizmi shtetomadh serb i atëhershëm i përkrahur e nxitur edhe nga Kisha Ortodokse Serbe, madje edhe nga ndonjë studiues me aso tendence, shkencërisht joserioz dhe kjo e keqe me ndihmën e së vërtetës së Zotit, kërkojmë të spastrohet nga mendjet, zemrat e shpirti i serbëve normalë e sidomos tek të rinjtë me orientim human europian. Në këtë mënyrë tek të gjithë serbët dhe të (ortodokse) tjerët që ndjekin rrugën e Perëndisë dhe të njerëzishmërisë në kokat zemrat e tyre lusim të mos mbetet asnjë shibël urrejtjeje ndaj shqiptarëve që ishin bashkudhëtarë më të singertë e besnikë në rrugën e përbashkët historike, të cilët, siç del katërcipërisht edhe atbotë e sot shqiptarët u tradhtuan dhe u akuzuan krejtësisht pa faj. U akuzuan të pafajshëm që nga fillimi e në vijimsi dhe aktualisht vetëm nga lakmia e kokave të dikujt për t'i grabitur e gllabëruar trojet e tyre dhe kështu me një esëllim të duhur plotësisht të njerëzishëm të pranohet, pra, e vërteta e Perëndisë, nga e cila vjen paqetimi i singertë ndëretnik duke u shuar urrejtja e mbjellë nga ajo lakmi nga kastat katilë pa kurrfarë të drejte dhe mbi këtë bazë nga kërkimfalja e shprehur me sinqeritet do të rigërshetohet tamam miqësia e vërtetë ndërfaqinjësore me bekim hyjnor, e cila si e tillë duhet të shërbejë si shembull jo vetëm për popujt e ballkanit e të Europës por edhe të botës.

Këtë paqetim e shohim të mundur jo fort larg, nëse studiuesit e paanshëm në radhë të parë serbë, ia ofrojnë vetvetes dhe opinionit serb të vërtetën objektivisht me të rrëfyer e pranim serioz për padrejtësitë bërë popullit shqiptar dhe njëherazi kërkohet që shteti dhe kisha serbe të esëllohen dhe shprehen ose predikojnë si duhet po ato të vërteta të bekuara në udhën e Zotit, siç udhëzojnë mësimet e shenjta biblike, por gjithsesi, në

anën tjetër, kërkohet që edhe studiuesit e intelektualët shqiptarë, ashtu si edhe shteti e organizmat përkatës të gjykojnë drejt, të përgatisin opinionin dhe qarqet përkatëse që të jenë realistë në kërkesa, të mos synohet vetëgjyqësi, njëfarë kërkimborexhi pa kontrollë... shtrirje përtej Mellës ose Mollës së kuqe..., madje deri shporrje për shkak të vandalizmave të së kaluarës së paharruar drejt stepave(!) etj. Është tjetër gjë, mos-harrimi i së keqës apo njohja me realitetin e hidhur, kërkesa për zhdëmtim nga e kaluara avare dhe tjetër gjë brutaliteti apo mbjellja e panikut për hakmarrje, i cili duhet të shndërrohet në drejtësi, paqetim në veçanti me njerëzit e thjeshtë.

Gjithsesi, të dyja palët ta kuptojnë realisht të kaluarën e largët dhe mos të kujtojnë vetëm të këqijat, por edhe afërsitë simbiozore të imponuara nga bashkëjetesa historike ndëretnike e ndërftare shqiptaro-serbe, deri edhe në situata të paimponuara me lidhje gjaku e farefisnie në kohëhapësirat përkatëse, që dëshmon edhe ADN-ja e sotme, ngase populli si popull, përveç mosmarrëveshjeve, egoizmave brenda vetvetes e me fqinj, gjatë bashkëjetesës ka pasur më shumë mirëkuptime ndëretnike sesa armiqësi e orvatje për shfarosje, siç po propagandohet ende diku-diku, deri edhe në disa komentime të njëanshme nga ndonjë individ. Gjithsesi, po përsërisim, kërkohet nga shteti dhe kisha e sotme serbe që duke gjykuar padrejtësitë gjenocidale nga okupimet e së kaluarës, tashembastashti të veprohet pa intrigancë në të mirë të së tashmes, në të mirë të së ardhmes dhe në të mirë të paqetimit të vërtetë ndëretnik fqinjësor serbo-shqiptar, për jetë e mot. Njëherazi kërkohet që të dyja palët e sidomos shqiptarët t'i shërojnë, po mos t'i harrojnë plagët e marra jo vetëm në shtatin historiko-gjeografik, por edhe në mendje e shpirt.

Po ripërsërisim, arritja e këtij paqetimi me esëllim ndërgjegjeje ndaj të së vërtetës, si kusht për pajtim të plotë serbo-shqiptar, është pra edhe mesazhi kryesor i këtij vështrimi.

Gjithsesi, nga lexuesit dhe studiuesit kërkohet, që t'i kenë parasysh edhe veprat e specialistëve objektivë që rrahin këtë temë, siç është edhe punimi i akad. Srdjan Atanasosvskit, *“Prodhimi i Serbisë së Vjetër”* (Koha ditore – kulturë, prill-maj 2017), i cili, veç tjerash, cek edhe manipulimin me të dhëna pseudoshkencore nga hartat etnike “anakronike” të M. Vemiqit, si edhe veprën vëllimore pozitive të Petrit Imamit, por njëherazi edhe veprat e studiuesve shqiptarë objektivë, siç janë edhe Jusuf Buxhovi, Hakif Bajrami, Jusuf Osmai etj. etj.

Nënkreu II

DISA KONSTATIME RRETH TERMAVE NGA LEGJENDA DHE NDONJË SQARIM I DOMOSDOSHËM

Duke u nisur nga shkalla e dijes së përdorimit të sotëm të termave të etniteteve, por që edhe të atëhershëm, për dijetarë jomakiavelistë serbë e ndërkombëtarë objektivë, disa fjalë- terma nga vepra e M. Milojeviçit, logjikisht ka qenë e mundur të jenë më të qartë, më të përgjithësuar, pasi në serbishte shumë para tij për shqiptarët përdorej termi *arbanas e arbanashki jezik*, ndërsa ky si më bashkëkohor e njëjtte edhe termin gjuhë shqipe (*shkip/ski*) dhe emrin **shkip** (*arbanas*), opo edhe *shkipëtar*, por me qëllim në atë vepër manipulonte me terma të ndryshëm, siç vepronin edhe qarqe të caktuara me përdorimin e trajtës turke *arnaut* për konceptin *zyrtar*, megjithatë mbesin gjera të paqarta.

Lidhur me këtë në dy pikat vijuese në shenjë sqarimi:

së pari, po fillojmë me paraqitjen e legjendës nga vepra (2005) dhe

së dyti, do të japim disa përplotësime që domosdo imponohen lidhur me disa emërtime të përdorura atbotë, karakteristikë e veprës ose veprave në shqyrtim dhe si është dashur kuptuar atëherë e mirëkuptuar sot.

Sidoqoftë, disa terma të mbetur si historizma ose jo, por edhe disa koncepte që mbulojnë sot termat përkatës gjatë shtjellimit të temës në vijim do t'i kemi më të qarta, si ne, si masa e gjerë, por mbase kjo do të jetë mdihmesë edhe për disa intelektualë e studiues të papërvojë e joprofesionistë në fusha e domene të caktuara, të cilët mund t'i konsultojnë këto harta.

1. Legjenda: shenjëzimi e rubrikat

a) Shenjëzimi:

- 1) * (yllthi)- vendi i pidentifikuar i termit në hartat bashkëkohore.
- 2) / - /- (shenja vizël/vizël) tregon popullatë etnikisht të papërcaktuar ose entitet të përzier
ose-ose (ili-ili).
- 3) S - serbë.
- 4) P - serbë të islamizuar (poturë).
- 5) A – arnautë (arbanas të islamizuar).
- 6) O – osmanli (turq të deklaruar).

- 7) L – latin (katolikë vendës ose në raste serbë të katolikëzuar!).
- 8) Ç – çerkezë (etnitet i islamizuar, joserbë).
- 9) C – ciganë (romë vendës joserbë ose në raste ciganë të serbizuar).
- 10) nv – vërejtje–s qarime rasti, zakonisht mbi numrin rendor të përsëritur në nënnyjësi
përkatëse të Regjistrimit të përgjithshëm sipas zonës regjistruese.

b) Rubrikat:

- 1) Numri i përgjithshëm rendor i vendbanimit.
- 2) Numri rendor i ndonjë grupimi ose njësie apo nënnyjësi dalluese.
- 3) Emërtimi i vendbanimit cirilicë nga autori.
- 4) Emërtimi i sotëm i vendbanimit (latinicë) nga botuesi i sotëm i veprës.
- 5) Numri i shtëpive sipas emërtimit (inicialeve) të etnive.
- 6) Përbërja etnike e banorëve, numri i shënuar (po ose jo) sipas inicialit të etnisë përkatëse.
- 7) Vërejtje - ndonjë sqarim a korrigjim rasti, më fort të ndonjë vendbanimi (i shënuar në cilirilicë nga përpunuesi)

.Shënim:

Si duket tërë renditjen e sidomos dy rubrikat 4) dhe 7) dhe shenja e yllthit si dhe disa sqarime janë shtuar nga hartografi, përkatësisht nga ripërpiluesi (përpunuesi) i kësaj vepre (harte).

2. Disa sqarime që imponohen sot rreth domethënies së shenjzimit për grupet përkatëse etnike

1) Me shenjë-inicialin S zëvendësohet termi i etnonimit *serbë*. Me këtë term serbë në këtë burim konsiderohen të gjithë ortodoksët (zakonisht pravosllavë, sepse etnia serbe me fenë ortodokse pravosllave konsiderohet identike), edhe pse mbase etnikisht mund të mos kenë qenë të gjithë të atij entiteti (kombi) ose të atij riti (fetar). Në fakt, realiteti tregon se nën këtë emërtim llogariteshin edhe shqiptarët e vllahët ortodoksë e të tjerë në kuptim të ngushtë, po gjithsesi, siç do të vërtetohet edhe gjatë analizës, në serbë përfshiheshin në raste edhe ciganët, madje edhe katolikët, ngase nga të prekurit nga rryma e nacionalizmi pansllavist të kohës, ku bënte pjesë atbotë edhe M. Milojević si prijatar, edhe **kroatët** konsideroheshin *serbë të latinizuar*, ashtu siç konsideroheshin edhe **maqedonët e sotëm serbë të bullgarizuar**, **boshnjakët serbë të**

islamizuar), **malazezët serb të kulluar**, deri edhe **arnautët** e sidomos **arnautashët serbë të arbanizuar** (të islamizuar ose jo)! Së këtejmi, në të dhëna statistikore në këtë lëmë, shikuar nga aspekti i tillë sipas makiavelizmit edhe mund të kenë ndodhur për atë kohë edhe manipulime të lejueshme zyrtare, apo jo?!

2) *Me shenjë-inicialin P* simbolizohet termi *poturë* d.m.th. *serbë të turqizuar*, ngase serbi duke u islamizuar, sipas këtij burimi e përgjithësisht konsiderohej se ishte tjetërsuar, ishte bërë *potur*: polaturçin / (po(l) + turç(in)) ose poturçenik, poturica ose për makiavelistët merrte edhe atributin: *izdajica* (tradhtar) që në shqip trajta *potur* mund të kalkëzohet fjalëpërfjalshëm (bukvalisht) me barasvlerësin: gjysmëturk (gjysë+turk), ose siturk (si+turk, sikur+turk!) jobash+turk apo përbuzësisht *turkoshak*(!).

Në të vërtetë, kjo fjalë sllave në shqipe ka hyrë në trajtën **patur** (ndryshimi o/a), kështu e ndeshim në ligjërimet popullore si dhe në Fjalorin e Bashkimit (1908), me kuptimin: “*ai që e lëshon fenë e të parëve*”. Edhe te ne në Kosovë, e gjetiu, e ndeshim po trajtën *patur*, po zakonisht me kuptimin: “shqiptari jo me veti vërtet malësori (me burrnin e besë)” apo “shqiptari jo aq mikëpritës” ose “ai që e flet shqipen paturisht, jo aq pastër me theks të një odatari fisnik”, por ka të bëjë, përgjithësisht me ndonjë familje laramane (ortodokse – muslimane), por që anon nga shqiptarizimi, duke u liruar ose jo nga ortodoksizmi pravosllav, zakonisht ishte fjala për disa të shpërngulur më herët nga Serbia ose edhe vendës, të cilët tashmë si rajë përziheshin me *jerli* (vendës rrafshakë), por që ende nuk i njihnin mirë rendet e odës e të burrnisë sipas vendit e kuvendit të kodit fisnor tek ne), term ky që s’kishte të bënte fare as me turqeli as me muhaxherët e mëvonshëm (pas 1876-78-s).

Po sidoqoftë, në këtë vepër fjala *potur*, merr kuptim shumë më të gjerë, nga sa u tha. Në këtë vepër *poturët* trajtohen si grup i veçantë etnik, jo si shqiptarë, siç ishin, por si: serbë të islamizuar (!). Njerëzit e tillë për nga feja dhe kombi konsiderohen se kishin qenë vetëm serbë (vetëm pse mbase kishin qenë me fe ortodoksë), të cilët ndërkohë ishin konvertuar në konfesionin e turkut, andaj serbisht quheshin, siç u tha, *poturi*, *poturçinici* ose *poturice*, dhe së andejmi edhe në shqipe te ne hyri termi *paturë*, por me kuptim shumë më të ngushtë e pejorativ, nga koncepti që i jepet në këtë vepër.

Lind pyetja njerëzit e komunitetit të tillë, kishin qenë vërtet serbë serbishtfolës apo ndoshta vetëm ortodoksë me fe, ndërsa flitnin shqip ose

vllahisht, apo jo, siç ofron logjika dhe e vërteta, ngase ata poturë, serbë të quajtur sipas autorit në trevat që shënon ai, sidomos në Kosovën e sotme, siç tregon realiteti, vërtet kishin qenë dhe ishin joserbë, dhe pa kurrfarë mëdyshjeje kishin qenë ortodoksë shqipfolës, pra kishin qenë shqiptarë dhe me rastin e konvertimit kishin mbetur po shqiptarë, d.m.th., shqiptarë me vulë, që si tapi kishin gjuhën shqipe. Këtu qëndron paqartësia e konceptit të kësaj dukurie tek ndokushi, mjerisht edhe te shënues-regjistruesi si dhe ripërpiluesi i hartës, apo jo?! Andaj, kush do me njoftë të vërtetën e shqiptarëve (paturë të Kosovës e më gjerë) nuk e ka të vështirë, duhet t'i shkojë mendja se ata kishin qenë ortodoksë shqiptarë. Dhe kjo del edhe më e kuptueshme kur shtrohet pyetja, në fakt kur të tillët u gjysmëturqizuan (apo u paturëzuan), d.m.th., u konvertuan në fenë islame (arabe-turke), flitnin turqisht, apo vazhdonin të flisnin familjarisht shqip apo serbisht!? Nga realiteti mësojmë, që të gjithë të konverturit e tillë, të cilët nga autori shënohen si poturë (serbë) në trevat tona, nuk kishin qenë serbë, por ortodoksë shqipfolës, d.m.th. shqiptarë të mirëfilltë, të cilët, edhe pse e ndërruanë fenë skizmatike (shkizmën), qoftë të ritit romeas (grek), qoftë atij pravosllav (serb apo bullgar dhe kaluan në fenë islame, ndoshta vetëm formalisht, ata gjithsesi mbeten po shqipfolës, siç edhe kishin qenë familjarisht edhe më parë. Mjerisht, një e vërtetë e tillë e qindpërqindtë nuk njihet e respektohet nga Milojeviçi, madje nuk respektohet as nga përpiluesi i sotëm i hartës, z. Vemiq. Lidhur me këtë faktohet edhe një e vërtetë tjetër, përveç shqipfolës ortodoksë, kishte edhe shqiptarë katolikë, të ortodoksuar ose jo, deri edhe në Serbinë fillimishte, në Smederevë e gjithandej në ato vise, para ndodhjes së serbizimit të Pashallëkut të Beogradit. Një dukuri e tillë nuk mund të mohohet dot nga askush, po kësaj teme do t'i rikthehemi paksa më poshtë, edhe në kreun vijues, sepse kjo dukuri imponon trajtim më të thellë, më bindës dhe gjithsesi edhe më serioz.

3) *Me shenjë-inicialin A* ose me fjalë-termin **arnaut** (term zyrtar i marrë nga turqit), siç del aty, me të kuptohen vetëm disa arbanas, me gjasë, sipas autorit, katolikë gjithsesi të islamizuar, apo jo?! Në të vërtetë, edhe ky koncept, pothuaj historizëm i imponuar, del i tkurrur dhe në këtë kontekst etnie del i keqpërdorur me shumë pasoja. Në të vërtetë, në këtë vepër është përdorur me tendencë se gjoja vetëm katolikët e islamizuar mund të quheshin arnautë, të cilët nga Malësia e Arnautllëkut Dukagjinas (Shkodër e Gjakovë), kinse me ndihmën e turqve, kishin invaduar kënde, në tokat ortodokse serbe(!). E vërteta, rreth këtij historizmi qëndron

ndryshe. Pa përjashtuar mbetje paganizmi, që nga predikimet e Shën Pjetrit e në vazhdimësi shqiptarët kishin qenë kryesisht të krishterë, madje me ndarjen e Perandorisë në atë Lindore e atë Perëndimore (më 395, përkatësisht 1054) ata, varësisht nga terreni ku jetonin, me imponim u detyruan që fetarisht t'u takonin njëres prej dy sferave ose rrymave rivale rituale: katolike ose ortodokse. Rasti imponoi që shqiptarët katolikë të jenë më të ndërlidhur me Perëndimin. Kishin shtrirje më të vogël hapësinore (Raguzë-Tivar-Shkodër-Malësi, Bregdet) në krahasim me ortodoksët qështriheshin pothuaj në tërë Siujdhesën Ilirike, të cilët gjeografikisht (administrativisht) i takonin Bizantit ose ritit ortodoks. Kështu, ndërsa ortodoksët arbnorë (shqiptarë) që qëndronin në vise më lindore e jugore që ishin probizantinë, quheshin me emra të ndryshëm, si sllavë (serbë ose bullgarë) apo grekë, varësisht nga organizimi shoqëror e fetar, ndërkaq arbnorët e ritit perëndimor, edhe pse intimisht e ruajtën sadopak termin arbnor zyrtarisht nga osmanët quheshin *latinë*. Sot kjo e vërtetë historike njihet mjaft mirë, por para 100 vitesh nuk njiheshin aq mirë, prandaj edhe manipuloheshin më lehtë. Në të vërtetë, meqë në periudhën e mesjetës Dardania, Epiri (nga Siujdhesa Ilirike) gjeografikisht i takonin Bizantit, atëherë shqipfolësve më shumë iu imponua feja ortodokse e ritit bizantino-grek ose ndërkohë këndeje nga veriu feja e ritit bizantino-sllav (bullgaro-serb), ndërkaq hapësira e arbnorëve të ritit katolik latin, siç u tha, edhe pse nuk përjashtohet ndërndikimi, gjeografikisht ishte më e vogël. Natyrisht raporti mes këtyre dy rrymave nga lufta e interesave në trojet e vetë shqiptarëve, varësisht nga situata dhe dëshira që kishin drejt Romës në këtë aspekt gjendja nuk mund të ishte e qetë, andaj edhe e pësuan edhe vetë banorët e së njëjtës gjuhë folëse në krahasim me etnitë e tjera që u orientuan kryesisht drejt një riti, siç ishte shembulli me vetë sllavojugorët, nga të cilët b.f. kroatët fetarisht u latinizuan si katolikë, ndërsa serbët, si me thënë, u bizantizuan si ortodoksë.

Sidoqoftë, shqiptarët (ortodoksë e katolikë), për shkak të tjetërsimit të emërtimeve që kishin nga trashëgimia: iliro-thrako-dardane-arbnore dhe të shtrirjes shumë të gjerë që e kishin të trashëguar, madje tash të kapur edhe nga formacione përkatëse fisnore-princore, si të thuash shtetërore, vazhdonin të quanin veten intimisht jo sipas gjuhës, por, si me thënë, sipas zyrtares, qoftë administrative, qoftë fetare. Pra, ata si autoktonë e quanin veten arbër arbnor e sëmëtejmi u quajtën fillimisht edhe nga të tjerët nga sllavët arbanas, nga grekët *arvanitis*, nga perëndimi *alban albanes* dhe nga turqit *arnaut*, por ndërkohë ashtu të shpërndarë vise-vise edhe nga të tjerë

identifikoheshin edhe me emra të ndryshëm sipas formacionit shtetëror ose trevës gjeografike që i takonin, epirotë, maqedonë, serbë, grekë (elenë) etj., por gjithnjë e më pak arbër, arbnorë, arbneshë, duke zëvendësuar me një emërtim të ri *shqiptar* (*shkip/tar), term ky që u formëzua (ose supozohet se u riformëzua) më përzemër, si më i pranueshëm për të gjithë si emërtimi etnik, sigurisht para e sidomos gjatë e pas kohës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare dhe në vijim, emërtim ky i fundit njihej edhe nga Milojeviqi, në disa trajta, si: *shkipi shkipisi*, madje edhe me shtrirje mjaft të gjerë. Krahaso nga origjinali i Milojeviçit: *epir i shkipisa* (epiri e shkipësit), *shkipi e eleni* (shkipët dhe helenët), *masa shkipisa* (masa e shkipëve) etj. Madje ky njih edhe termin “*Albania i Epir – gde neprastano utamanjuju srbi u Pravoj Staroj Srbiji, Maqedoniji, Albaninama i td*” (Albania dhe Epiri prej nga po shfarosen serbët në Serbinë e Vertetë të Vjetër, në Maqedoni dhe në Albanina! etj.), ku sipas tij dominuaka jo shqipja që këtë rast e injoron po “*gjuha e shpirti bullgar e jo ai serbë*”... Madje vëren që në rrethinën e Pejës, pjesëtarit e fisit gash, të cilët flasin *goranski* (gjuhën malësore) ose *shkipske reci* (fjalë shqipe)...edhe pse gjoja ky fis kishte prejardhje serbe, por, për çudi të tij “*na shkipskom jeziku slave sv. Petka*” (në gjuhën shqipe e kremtojnë Shën Premten). Milojevici konstaton që gashët e kanë ruajtur Deçanin (Kishën e Deçanit) afro 550 vjet dhe në këtë periudhë nuk ka pasur dëmtime, sepse arnautët (gashët) e kanë ndjerë e respektuar si objekt adhurimi si të vetin, por edhe *aq më tepër se të vetin* “*pa jos i vise*” (sipas P. Imamit), Ka edhe të dhëna të tjera për *shkipësit* (shqiptarët), por për ta, për shqiptarët, siç u tha, si term zyrtar në veprën në shqyrtim e përdor fjalë-termin turk *arnaut*.

Po shtojmë paksa edhe këtë se disa studiues jo të paemër mendojnë se fjala *shqip shqiptar* del e përforcuar nga elementi musliman arbnor, në saje të të cilëve u bë përvetësimi i këtij emërtimi shqiptar, në shkallë etnie. Ndërsa katolikët edhe pse nuk e kundërshtuan, megjithatë më përzemër e kishin emërtimin e traditës arbnorë, mirëpo ndërkohë, sidomos te ne, kur muslimanët shqiptarë, nga shteti i Turqisë dhe ai i Serbisë quheshin *turq*, atëherë katolikët (latinët!!) e ndjenin veten se vetëm ata (latinët) ishin *shqiptarë të vërtetë* dhe kjo ishte pozitive. Sidoqoftë, ne nuk po ndalemi më gjatë në sugjerime të tilla, ngase, në të vërtetë, siç u cek më sipër ata (njerëzit e thjeshtë) e quanin veten edhe ndryshe, sipas shtetit e pushtetit ku gjallonin, apo edhe sipas gjuhës fetare që respektonin dhe së këtejmi edhe pse nuk ishin etnikisht të tillë, quheshin: *serbë, grekë, bullgarë, egjiptianë, turq, arabë*, sikurse sot që po quhen të shpërngulurit tanë të

hershëm si dhe disa emigrantë tanë të rinj (sipas meje mjerisht edhe nga masa) që duke u hequr gjymtyrën e parë të kompozitës *shqiptaro-* po thirren në bazë të nënshtetësisë, ose shtetit ku punojnë, ku po e nxjerrin bukën ose po fitojnë mjete jetese: *amerikanë, zviceranë, gjermanë, suedezë, italianë, grekë* etj.

Në të vërtetë, për trevat për të cilat po flasim, sipas veprës së Milojeviçit, kuptohet se shqipfolësit ose “shkipsët” e tillë, nuk kishin emigruar gjëkund, ata jetonin në trojet e veta anase, andaj, qoftë si ortodoksë apo katolikë, qoftë të islamizuar, gjithsesi ishin shqiptarë, siç tregojnë faktet, ngase komunikonin në gjuhën e vet shqipe (shkipski), sidomos aty ku përbënin një shumicë, siç ishin jopak raste jo vetëm në Malësi, e viset e Kosovës, por edhe në viset ku sapo themelohej edhe shteti i Serbisë. Madje ndoshta vetë trajta *arnautë* (jo shkipsë ose arbanas) si term me origjinë turko-arabe e përdorur nga autori, duke u shfrytëzuar dinakërisht ashtu që përputhej me përdorimin e kësaj fjale në raste edhe në turqisht, ku veç tjerash, jashtë gjeografisë shqiptare, quheshin *arnautë, shqiptarët, qoftë ortodoksë, katolikë apo muslimanë të pandarë, të cilët i lidhte edhe interesi, sepse përveç vetive zakonore ata edhe flisnin një gjuhë: shqipen, por të cilët shërbenin zakonisht në formacione mercenare në vise të ndryshme deri edhe në Rusi, por sidomos në Perandorisë Osmane dhe si të tillë, ashtu si edhe në shtresa të tjera shoqërore, duke qenë lojal ndaj pushtetit, varësisht nga gjeturia, lojaliteti ose zotësia që tregonin, mund të zinin edhe poste e pozita në hierarkierkinë ushtarake, administrative jopezhorative, në raste deri edhe në pozita të larta ushtarake e shtetërore, si: zabitë, pashallarë, vezirë etj., që tani quheshin zyrtarisht *turq*, e drejtë kjo që mund të gëzonin edhe etnitë e tjera në atë perandori osmane, ku siç thuhet respektoheshin në njëfarë mënyre elemente multifetare e multietnike, apo jo?*

Për rastin konkret mund të bëjmë një pyetje, meqë ky etnitet njihej shumë më herët me emrin *arbanas* nga serbët, përkatësisht nga pushtetarët mesjetarë serbë ose sllavë pse në këtë vepër nuk përdoret fjala *arbanas* me kuptim neutral, por ngulmon në këtë vepër në përdorimin e termit *poturi*, madje është pozitive gjithashtu, sepse shqipfolësit në Malësi i njeh edhe me emërtimi shqiptarë (*shkipjani*) siç i quan ai, por nuk i konsideron etni, andaj themi se përdorimi *arnaut*, edhe pse ishte legjitim për kohën, megjithatë si dhe i shumë gjerave të tjera ishte përdorim nën ndikim makiavelist, apo jo? Sidoqoftë, ne kemi të drejtë të supozojmë që përdorimi i tillë *arnaut* u bë për qëllime të fshehjes se identitetit të vërtetë

të shqiptarëve (arbanas ose shqipë) autoktonë) dhe u përqufua kjo fjalë turke (sherr me rrugë) me qëllim që të manipulohej më lehtë me të vërtetën rreth tyre, siç kishin planifikuar të bënin garashanianët antishqiptarë, në përputhje me mësimet e pasuesve të naçertanies së tyre dhe misionarëve rusë, francezë e të tjerë, të cilët urrenin Turqinë bashkë me fetaro-ideologjinë e tyre islame, apo jo??!

Sido që të ketë qenë, ne, që punimin tonë e kemi bazuar në tekstin në shqyrtim, mendojmë se etniteti i shënuar *arnaut* logjikisht nënkupton shqiptarët katolikë të islamizuar, të cilët, tashmë bashkëjetonin familjarisht, fetarisht e gjuhësisht me të ashtuquajturit *poturë*, po ashtu shqiptarë, ndoshta ortodoksë e katolikë të islamizuar. Në të vërtetë, oponenca fetare ose jo nga e kaluara nuk ishte fort dalluese edhe atëherë, në vitet e '60-a të shekullit XIX mes shqiptarëve të së njëjtës gjuhë: ortodoksë të islamizuar ndaj arnautëve (katolikë) po të islamizuar. Në të vërtetë, ky dallim ndërftetar edhe më parë nuk kishte qenë dallim aq fort i shënuar ndër shqiptarët, por tashti me emrin **shqiptar** u bë edhe më i lehtëzbatueshëm, ngase përveç gjuhës e traditave etnike të njëjta të përbashkët e kishin edhe më shumë idealin e lirisë dhe të mvetësinë vetjake, sepse nuk thuhej kot se “shpirti kryengritës i shqiptarit nuk njëjthe edhe më parë, siç nuk njeh fort edhe sot, kufizime fetare, krahinore, madje edhe as sociale”.

4) *Me inicialin L* ose termin *latin* shënohej konkretisht grupi etnik i komunitetit shqiptar katolik që nuk quhej ashtu nga vetë etniteti, qoftë në fshatra, qoftë në qytete shqiptare, ngase ata në këtë anë, më fort njiheshin si arbnorë ose shqiptarë (katolikë). Në të vërtetë, atëherë nga osmanët zyrtarisht shënoheshin *latinë*, ngase turqit praktikisht përdornin këta terma: 1) *latinë* për katolikët, 2) *turq* për muslimanët dhe 3) *rumei (urum)* për ortodoksët (grekë, shqiptarë, vllahë, malazezë, serbë, bullgarë). Po këtu, në këtë vepër, dihet mire se cilët ishin këta latinë që figurojnë si etnitet më vete?! Në Janjevë, sqarohen si *serbë të latinëzuar* (ose serbë të katolikëzuar!), po ata të njëjësive e nënjëjësive të tjera regjistruese në këtë libërth që nuk ishin numerikisht aq pak, cilës etni reale i takonin?! Ne e dimë, siç e dinin edhe autori dhe faktorët e tjerë serbë, se edhe ata ishin shqipfolës (si arnautët e poturët), po pse nuk theksohej qartë e vërteta se latinët e tillë, vërtet, i takonin etnisë shqiptare katolike, që ishte zemra dhe thelbi historik që mbanin gjallë ndikimin properëndimor tek raca shqiptare. Themi kështu se atëherë, vetëm këta ndërkohë si të krishtenë katolikë, nën përkujdesjen e Austrohungarisë dhe ndërkohë të Italisë

(Vatikanit) kishin të drejtë të kishin, jo vetëm kisha, por edhe shkolla e kolegje fetare dhe aty të kultivonin sadopak shqipen edhe në mesha e në shkolla?! Është e vërtetë që këta katolikë françeskanë por sidomos ata me prejardhje shqiptare) shtrinin influencën kombëtare shqiptare edhe te vëllezërit e vet shqipfolës muslimanë e ortodoksë, me të cilët bashkëjetonin dhe bashkëvepronin kombëtarisht e gjuhësisht edhe sipas normave të bashkëjetesës fisnore. Madje kështu pa kursyer asgjë prelatët e latinëve të tillë (kleri i shqiptarëve katolikë) ndihmuan zgjimin kombëtar, ashtu si edhe disa intelektualë muslimanë e klerikë ortodoksë, tek të cilët në atë periudhë kishin depërtuar ide iluministe, edhe pse këta kishin më shumë vështirësi të vepronin legalisht ose gjysmëlegalisht se katolikët, ngase pengoheshin me të gjitha mjetet, qoftë nga patrikana greke, qoftë nga grekomanët, serbët e serbofilët, po nga ana tjetër aq më keq edhe nga vetë shqiptarët turkoshakë të tërbuar fanatikë të frustruar nga propagandat e huaja, jo vetëm nga ajo osmane.

5) *Me inicialin C* kuptohet etnia cigane (rome). Që kishte ciganë serbë ortodoksë (madje mbase serbishtfolës) kjo del e shënuar në 2 fshatra të Drenicës së Poshtme e gjetiu, po shtrohet çështja, në raste të tjera, si p.sh. në Gjakovë, kishte ciganë apo egjiptianë shqipfolës, të cilët gjithsesi mund të radhiten si joserbë, apo jo?

6) *Me inicialen Ç (Ç)* kuptohet etniteti çerkezë, popullatë kjo muslimane. Gjithsesi edhe kjo llogaritet si popullatë joserbe. Edhe këta sikurse disa të ashtuquajtur egjiptianë (ashkali) e të tjerë, siç dëshmon e sotmja që atëherë ishin shqipfolës ashtu si edhe disa të ashtuquajtur vllahë që atë ditë e sot mbahen shqiptarë me gjuhë e vepra, të cilët regjimi i mëvonshëm serbë assesi nuk mundi t'i ndajë nga shqiptarët (muslimanë), apo jo?

7) *Me inicialin O*, kuptohet etnia e deklaruar turke, ose që flitnin turqisht, qoftë në qytete, qoftë në fshatin Mamushë të Prizrenit, të cilët mesa dime janë ardhacakë nga disa vise të Bullgarisë, po sidoqoftë, edhe kjo etni nuk ishte serbe dhe mbahej, siç mbahet edhe sot familjarisht, fetarisht ndërlidhur fort me shqiptarë muslimanë, gjë që tregojnë edhe vetë mbiemrat e familjeve ose të lagjeve përkatëse që bartin në atë fshat.

3. Sqarime të tjera

Sidoqoftë, mund të dalin edhe shumë pyetje e nënpyetje të tjera si çështje të diskutueshme që kërkojnë sqarime, prandaj insistojmë nga lexuesi i nderuar dhe studiuesit e pasionuar që ta mbajnë kureshtjen hapur

rreth konstatimeve të tjera shtesë lidhur me të vërtetën shqiptare të atëherëshme që deri këtu paksa u përpoqëm me e shprehë dhe me e sqarue, në mënyrë që analiza me të cilën do të ballafaqohemi në vijim të kuptohet se nxjerr në shesh *të vërtetën dhe vetëm të vërtetën*, e cila duke qenë fort e qartë dhe e lehtë për t'u kuptuar, të kuptuar ky që njëherazi do të ndihmojë që edhe gjykimet të jenë më të përkapshme në masë. Gjithsesi nuk do të ketë mëgyshje rreth konceptit të së vërtetës për poturët – cilët ishin ata?

Lidhur me këtë kemi bindje të plotë se kjo e vërtetë, që do të qartësohet edhe nga raporti numerik do të shihet dritë me diell se shqiptarët (pa llogaritur numrin e tyre si ortodoksë shqipfolës, por vetëm te ata të shënuar si poturë, latinë, arnautë ishin shumicë në këto troje, pohim ky po të lexohet drejt, del i dëshmuar faktikisht, edhe nga vetë statistika e shënuar ndoshta me pahir nga M. Milojeviçi, mbase edhe nga Vemiqi, andaj kjo e vërtetë sapo të mësohet do të qetësojë përnjëherësh. Gjithsesi e vërtea, për të gjithë shpirtrat e hutuardso të shërbejë si një medikament i fortë çlirues pragmatik mjekësor dhe do të ndikojë për sot e mot për këndelljen e mendjeve ende të përmjegullta, jo vetëm të lexuesve të rëndomtë shqiptarë e ndërkombëtarë, por edhe të vetë serbëve të rëndomtë dhe çka është edhe më e rëndësishme do t'i esëllojë edhe mendjet studiuesve serbë e të huaj, qoftë në kuadër të forcave të organizuara shtetërore serbe, qoftë edhe në kuadër të disa qarqeve ndërkombëtarë të frustruara që i nxitnin dhe ndihmonin ndërmarrjet e tilla gjenocidale serbe atëherë e sot kundër shqiptarëve (joortodoksë pravosllavë), kuptohjet krejtësisht të pafajshëm muslimanë e katolikë, apo jo?!

Pra, së paku tashembastashti kombëtarë e ndërkombëtarë, sidomos studiuesit duhet ta kuptojnë dhe ta kenë të qartë të vërtetën se si janë bërë mashtrime atëherë e po bëhen edhe sot në dëm të popullit të pambrojtur shqiptar, i cili u bë pre, e ndikimit të imperializmave të huaj, por atëherë edhe të vetë Turqisë, sepse disa pushtetarë të lartë turq, mbase edhe vetë sulltani e urrenin etnitetin e parehatuar arnaut, siç dëshmonte edhe ndalimi vetëm i gjuhës shqipe zyrtarisht me ferman si asnjë gjuhë tjetër nga Sulltan Mehmeti në shek. XIV dhe e përtëriu këtë ndalesë Sulltan Hamidi II, në fillim të shekullit XIX (sipas Lutfi Alisë, I. Kadarese etj.), ashtu siç bënë më vonë edhe qarqet e shteteve të reja fqinje, siç ishte edhe vetë Serbia e Mali i Zi, Greqia e Bullgaria, ngase ishin të stërngarkuara, përveç me urrejtje gjuhe edhe me epshet vetjake nacional-shoviniste për t'i mbajtur shqiptarët robë, pa shkolla, për t'i asimiluar më

lehtë ose duke i konsideruar si aleat të Turqisë për t'i luftuar e dëbuar haptas bashkë me turq me qëllim që të grabitnin e gllabëronin ose t'i shndërronin në koloni sa më shumë toka shqiptare. Mjerisht për ndërmarrje të tilla kishin edhe miratimin e disa qarqeve zyrtare të shteteve europiane.

Sidoqoftë, ja tani përpekja jonë konkrete që duke shtjelluar lëndën nga kjo vepër e Vemiçit vërtetohet dhe i plasohet konstatimet e saposipërcekura mbi të vërtetën serbe e joserbe ose raportin numerik shqiptaro/serb në zonat përkatëse të kësaj pjese të Serbisë së Vërtetë të Vjetër (Kosovës), e cila, në të vërtetë kurrënkurrës nuk ka qenë me shumicë serbe, e vërtetë kjo, që do të argumentohet katërtcipërisht në vijim të këtij vështrimi.

NËNKREU III

KONSTATIME NGA TË DHËNAT NGA VITI 1866/68 PËR DISA VENBANIME NË SERBINË E VJETËR (KOSOVË) DHE PËRBËRJA E TYRE ETNIKE

Hyrje

Para se të japim konstatimet tona rreth përdorimit të fjalë-inicialeve nga legjenda e të tjera po sqarojmë se gjatë analizës rreth raportit të të dhënave të fshatrave ashtu edhe të shtëpive sipas etnive kemi përdorur po ashtu të njëjtat initiale siç i ka shënuar autori, por për ndryshim nga origjinali numrin e etnisë e kemi vënë pas inicialit, ngase ashtu kërkonte natyra e gjuhës sonë, por ne për hir qartësie kemi bërë edhe ndonjë ndryshim a përplotësim inicialesh. Së këtjmi, për t'i kuptuar më mirë si përkimet ashtu edhe ndryshimet me origjinalin po e japim tabelën e shkurtesave, me shifrat 1-4, zakonisht të përdorura në tabela me rezultatet përmblyëse sipas zonave a njësive zonale si dhe shumën totale:

Tabela e shkurtesave

(Nën 1) - *Nënnjësia* ose *grupimi*, *numri rendor* përkatës varësisht siç imponohet nga teksti ose sipas rastit.

(Nën 2) Në rubrikën *Fshatrat* kemi vënë këto pesë nënrubrika me inicialet përkatëse:

Nf – numri i fshatrave i përfshirë në atë nënnjësi ose grupim,

ST – numri i fshatrave serbë të përzier me etni të tjera.

S - numri i fshatrave serbë jo i përzier me etni, të tjera.

JOS – numri i fshatrave joserbë, të papërzier me etninë serbe,

PP - numri i fshatrave etnikisht të papërcaktuar.

(Nën 3) Në rubrikën *Shtëpitë* kemi vënë këto dy nënrubrika:

S – numri i shtëpive serbe,

JOS – numri i shtëpive joserbe.

(Nën 4) Në rubrikën *Vërejtje* kemi vënë këto dy rubrika:

a) Ps - numri i fshatrave të përsëritur gjetiu,

b) Kd – numri i fshatrave drejtshkrimisht të korrigjuar (zakonisht nga cirilicë në latinicë).

Shënim:

Për lehtësi studimi vështrim-analizëen tonë e kemi sistemuar në këto tri zona regjistruese:

- 1) Zona e Kadillëkut të Kurshumlisë
- 2) Zona e Kosovës Qendrore, ku bie në sy sidomos qyteti i Prishtinës me disa nahi dhe
- 3) Zona e Rrafshit të Dukagjinit (Metohisë), që përfaqësohet me tri qytetet e njohura: **Peja, Gjakova, Prizreni** me rrethina ose me malësitë e natyrshme të tyre.

Themi me malësitë e tyre të natyrshme, të cilat padrejtësisht qenë shkëputur që disa vise sot i takojnë Shqiprisë, por paksa edhe Malit të Zi. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjuhën e folur, që në disa raste pak a shumë pasqyrojnë gjurmë së vërtetës Milojeviçi i shënon në zonë të përbashkët, ashtu siç i shënon edhe botuesi i sotëm, edhe pse të mbuluara megjullisht sipas parimit makiavelist që ne gjatë analizës jemi përpjekur t'i zbardhim në po në këta tre tituj ose zona. Në të vëretë, meqë Kurshumlia tash për tash nuk bën pjesë në Kosovë, ne e trajtuam si zonë më vete, sepse në këtë vepër ajo paraprin si Pjesë e Serbisë së Vjetër (të vërtetë)/ *Deo Stare (prave) Srbije/*, ndërkaq hapësirën tjetër kryesisht Kosovën e sotme e trajtuam në dy zona. Kështu, krejt lëndën e kësaj vepre rreth numrit të vendbanimeve (fshatrave) dhe përbërje e tyre etnike (shtëpive) si dhe vërejtjet eventuale, duke respektuar konstatimet e autorit dhe të botuesit e kemi trajtuar statistikisht, duke rumbullakësuar të dhënat në këta tre nënkrerë ose Zona regjistruese:

- A) Konstatime nga Zona e Kadillëkut të Kurshumlisë,
- B) Konstatime nga Zona (nahitë) e Kosovës Qendrore dhe
- C) Konstatime nga Zona (nahitë) e Dukagjinit (Metohisë).

A) KONSTATIME NGA ZONA E KADILLËKUT TË KURSHUMLISË

1. Nënjesitë ose grupimet sipas numrit të përgjithshëm rendor

Sipas të dhënave të regjistruara në këtë burim në Kadillëkun e Kurshumlisë, gjendja ose raporti ndëretnik në vitet 1866-1867 është trajtuar në 4 nënjësi dhe rezultati del kështu:

1) Fshatrat lidhur me qytetin e Kurshumlisë

Kjo nënjësi, siç na mundëson teksti i origjinalit, trajtohet në 3 grupe:

a) Që në fillim në tekst nga numri rendor 1-53 janë shënuar emra të fshatrave me etni S, por pa të dhëna mbi numrin e shtëpive. Fshati me emrin Egrishte (Igrishte), i përmendur në këngën popullore: Shaqir Grisha, këtu del i shënuar si fshat serb në numrin e fundit rendor 53.

Përfundimi: fshatra S53.

b) Prej numrit 54-80, përkatësisht tash plus edhe me numër rendor grupimi 1-27, janë shënuar 9 emra fshatrash edhe këta të shënuar me S, dhe për secilin fshat shënohen nga 20 shtëpi që gjithsej del shuma 540 shtëpi ortodokse serbe, por për 9 emrat e fillimit shënohet vërejtje-sqarimi se përsëriten sipas numrit që figuron po në njësinë tjetër përkatëse të këtij regjistri.

Përfundimi: fshatra S27, shtëpi S540.

c) Prej numrit rendor 81-203, përkatësisht në numër rendor grupimi 1-125, ku përfshihet edhe qyteti i Kurshumlisë, janë shënuar 129 ose 125 fshatra JOS, por në dy numra, 62 dhe 219 nuk është shënuar fare emri i fshatit përkatës, madje 1(një) emërtim fshati del me etni çerkeze Suvi Do dhe vetëm për këtë shënohet numri i shtëpive 100. Në të vërtetë, 124 fshatra janë shënuar JOS (PA), pa asnjë shtëpi ortodokse (serbe) dhe pa asnjë me kombësi turke (osmanli)?!, pra 124 fshatra JOS, pa qytetin.

Përfundimi: fshatra JOS124, shtëpi JOS100.

2) Jankova Klisura –Kurshumlija

Në hapësirën Jankova Klisura – Kurshumlija, nr r. 204-209 ose sipas grupimit 1-6 prej 6 fshatrave vetëm 1 del me S (Çuçala) me 15 shtëpi. Serbë të përzier me të tjera etni, dalin ST2 fshatra, njëri me SA 30 (d.m.th. S15 A15) dhe tjetri me me SP36 (ose S6 P30). Kështu në këtë grupim dalin gjithsej 36 shtëpi serbe ndaj JOS115 shtëpive (me PA). Përveç ST2 dalin edhe me JOS2, d.m.th me etni shqiptare, përkatësisht dalin 79 shtëpi më shumë shqiptare.

Përfundimi: 6 fshatra: ST2, S1, JOS3; shtëpi S35, JOS 115.

3) Kopaonik-Glavnik

Në hapësirën Kopaonik–Glavnik, në nr.r. 210-230, ose 1-18, prej 21 fshatrave me etni ortodokse serbe, dalin vetëm 3 fshatra të pastra JOS (shqiptare): Paçarada, Mavriqi dhe Gllavniku. Në të vërtetë, Paçarada shënohet me etni JOS (PA 15 shtëpi), ndërkaq në tre fshatra me S shënohet numri shtëpive 75 (25, 30, 20), ndërkaq te shumica efshatrave me S dhe

JOS2 (PA) nuk del i shënuar numri i shtëpive. Edhe në këtë grupim, për nja 13 fshatra kryesisht të cilësuar me S ka vërejtje-sqarim sepse dalin të përsëritur gjetiu.

Përfundimi: fshatra 21 (S 18, JOS 3), shtëpi S 125, JOS 15

4) Qyteti i Kurshumlisë

Në qytetin e Kurshumlisë që mban numrin rendor 203, përkatësisht të grupimit 125, shënohet numri i shtëpive sipas etnive, si më poshtë: prej 2000 shtëpive: 1800 dalin poturë, 150 arnautë dhe 50 ciganë, pra dalin JOS2000 shtëpi.

Së këtëjmi, në këtë qytet prej 2000 shtëpive joserbe ose 1950 (1800+150) shqiptare nuk kishte asnjë shtëpi serbe (ortodokse) dhe asnjë shtëpi me kombësi turke (osmanli).

2. Konstatime të veçanta

Po shtojmë edhe këtë, që në këtë zonë, bie në sy emërtimi i vendbanimit *Arbanashke* nr. 167, çka dokumenton se banues më të hershëm se arnautët e poturët e asokohshëm (të islamizur shqipfolës!) kishin qenë arbanashët (iliro-dardanë-arbnorë) paganë ose të krishterë, term ky arbanash, që siç është konstatuar nga studiuesit dhe prej nesh pak më parë në gjuhën serbe me koncept shqiptarët, kishte shtrirje dominuese, gjithandej, në tërë territorin e Dardanisë së hershme, apo jo?

Sido që të ketë qenë, vallë si do ta ketë arsyetuar edhe vetë autori dhe të tjerët Luftën çlirimtare, kur pas 10 vitesh më 1877 serbët e *çliruan* qytetin e Kurshumlisë me rrethinë gjoja nga turqit !!, kur nuk paska pasur asnjë turk dhe asnjë serb për ta çliruar në atë qytet, apo jo?! Madje edhe në rrethinë përveç fshatrave me popullsi të përzier në margjina (shqiptarë e serbë) paska pasur 129 (123+6) fshatra joserbe ose 129 fshatra të pastra shqiptare, të cilët në atë luftë çlirimtare, që të gjithë u dëbuan me zjarr e hekur, nga ajo zonë nga ushtria *çlirimtare serbe*, misioni i së cilës ishte çlirimi nga Perandoria Osmane (Turke) jo me pushtue toka të huaja, apo jo?!?!

Po përsëris, atëherë siç shënohet në një dokument që e cek studiuesit Daut Dauti, (Shih portali *Telegraf*, 28.07.2021) me të cilin dëshmohet se në një pjesë e rajonit të Kurshumlisë në 68 fshatra shqiptare jetonin 1563 shtëpi me 12.734 banorë. Prej tyre 810 u vranë, ndërsa 11.994 u shpërngulën., po sidoqoftë, unë po i kthehem dokumentit të Milojeviçit (Vemiçit) , ku përveç qytetit (Kurshumli) pa asnjë serb dhe pa asnjë turk,

ishin gjithashtu edhe 129 ose 130 vendbanime shqiptare (fshatra), pa asnjë turk dhe pa asnjë serb, prandaj konstatimi i Reshid Avdiut se “atëbotë Kurshumlia dhe rrethina kishte qenë trevë shqiptare e banuar tërësisht me etnos shqiptar” po del i drejtë. Madje këtë e vërteton edhe studiuesi Jovo Bajiq (në internet 5.11.2018), kur konstaton se Milojeviçinë rrugën për Kosovë ka depërtuar në zonën në mes të Krushevcit dhe Kushumlisë, zonë kjo e tërë sidomos rreth Jankova-Klisurës ose Kopaonikut, sepse ajo në atë kohë ishte zonë ushtarake turke, prandaj si banues dominonin shqiptarët jo serbët. Atëherë përsëritet pyetja: Ç’u bë me ta? Me shqiptarët?! Me ç’farë të drejte njerëzore u pushkatuan, veç të tjerëve pa gjyq edhe shumë të mitur, si të gjithë nxënësit e medresës në mes të qytetit (R. Avdiu) dhe u dëbua pa mëshirë tërë ajo popullatë deri në zero nga trojet e veta? Kush ka ndërgjegje duhet ta kuptojë të vërtetën për përqindjen etnike që jetonte në ato vise dhe le të gjykojë sot si njeri modern europian pa urrejtje lidhur me atë gjenocid, apo jo?!

Përfundim: Zona e Kurshumlisë

Po përfundojmë këtë nënkapitull me tabelën me të dhëna për këtë zonë:

Tabela përmbyllëse

Nën-Njësia	Fshatrat					Shtëpitë		Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd
1. a	53	-	53	-	-	-	-	-	-
B	27	-	27	-	-	540	-	9	-
C	124	-	-	124	-		100	-	-
2.	6	2	1	3	-	35	115	-	-
3.	21	-	18	3	-	125	15	13	-
Qyteti Totali	221	2	99 43 %	130 57 %	-	690 23%	2000 2230 78%	23	-

Siç po shihet jo vetëm në qytet ku popullsia ishte 100% joserbe, por edhe sa u përket fshatrave dominonte po ashtu popullsia me shumicë joserbe. Pra, qoftë sa i përket numrit të fshatrave 58%, dhe sipas numrit të shtëpive, në Zonën e Kurshumlisë dominuese 78%. del popullata shqiptare (joserbe).

B) KONSTATIME NGA ZONA (nahitë) E KOSOVËS QENDRORE

Në këtë zonë si njësi më e dalluar zonale bëjnë pjesë 1) *Nahia e Prishtinës*, me disa nënnjësi e grupime të caktuara dhe 2) Raporti i të dhënave nga **hapësirat dhe grupimet e tjera** të këtyre njësive zonale.

1. Nahija e Prishtinës (Prištvska nahija)

Si nënnjësi a grupim të parë, në njësinë zonale të Kosovës Qendrore, po e trajtojmë, pra, *Nahinë e Prishtinës*, (nr. rendor 301-403 ose nr. i grupimit 1-104), pa qytetin e Prishtinës. Në këtë nënnjësi bëjnë pjesë 103 fshatra. Së pari, po e trajtojmë fshatrat dhe së dyti qytetin e Prishtinës.

a) Përbërja e fshatrave

Sa i përket përbërjes etnike gjendja e fshatrave në këtë nënnjësi del kështu:

S 41, ST 27 (SP 19, SA 7, SPA 1), JOS 35 (A12, PA 13, Ç 6 dhe P 4).

Sidoqoftë, edhe pse në këtë nënnjësi zone mbizotërojnë fshatrat me S ose me ST, të cilët i ndeshim në 68 fshatra (ST27+S41), por sa i përket numrit të shtëpive rezultati, siç do të shohim, del në dobi jo të etnisë ortodokse serbe, po të atyre JOS, sepse me sa pamë dalin me S 1426 shtëpi, ndërsa të tjerë JOS 2232, d.m.th. JOS 806 shtëpi më shumë, në krahasim me ato ortodokse serbe.

b) Qyteti i Prishtinës

Madje kjo distance ndryshimi në të mire të JOS, rritet, kur kemi parasysh gjendjen në qytetin e Prishtinës, i cili kishte: 3280 shtëpi, prej tyre S350 (serbë ortodoksë), ndaj JOS 2930 (2600 poture, 70 arnautë dhe 260 osmanli).

Sidoqoftë, meqë shumë fshatra shqiptare mbase edhe të përziera, nuk ishin përfshirë fare në statistikë, si p.sh. Marevci, Bërnica etj., mbesin mjaft gjëra të diskutueshme. Ne sa për ilustrim po cekim disa emra vendbanimesh me përbërje të caktuar etnike që për ndonjë arsye sot dalin ose veç janë në procesin e diskutimit sa i përket etimologjisë ose prejardhjes etnike, edhe pse aty figurojnë me S ose JOS, si: Motiçan S10, Sofalija S5, Lipljane S38, Koshare A30, Papaz A20, Çagllavicë /*Shagn-S30, Mirash A12, Firaja PA60, Jezerce P63 A62, Shtimje: S11 P12 A13

etj. Në të vërtetë, vetëm me A në këtë grupëzim janë shënuar fshatrat: Drenovac, Prugovac, Çuçulaga, Koshare, Banduliq, Guvno Selo, Mirash, Papaz, Fatiq, Vranidol dhe Belopolje, ndërsa si fshatra thjesht poture dalin Gadimje, Varosh Selo, Gornje Nerodimlje dhe Prelez.

Kështu, pra në këtë nënjesi zone edhe pse jo pak fshatra shqiptare janë lënë jashtë regjistrimi, kishte: S1776 (1426+350) shtëpi, kundrejt JOS 5162 (2232 + 2930) që dalin më shumë nga numri i shtëpive të etnitetit serb. Së këtejmi del se shtëpi JOS kishte më shumë nga ato serbe 3386 shtëpi (5162 -1776) ose vetëm shqiptare, pa popullatë çerkeze e turke 1100 (Ç840+O260 arrin numri i tyre 4062 (5162 -1100), përkatësisht ishin regjistruar 2286 (4062 – 1776) më shumë nga ato serbe (ortodokse).

Përfundimi: 103 fshatra: ST27, S41, JOS 35; shtëpi: S 1776, JOS 5162.

Sidoqoftë, nga numri i fshatrave, për shkak të mosshënimit të disa fshatrave me etni JOS, shkon në dobi të asaj serbe, megjithatë përqindja e etnisë shqiptare ndaj asaj serbe sipas shtëpive del në dobi të JOS. Por si qëndron ky raport në nënjesitë ose grupimet e tjera të kësaj Zone, po e paraqitim në vijim.

2) Raporti i të dhënave nga hapësirat e grupimeve të tjera të kësaj nënjesie zonale

1. Hapësira Podujevë –Prishtinë

Edhe pse autori Podujevën nuk e trajton në kuadër të Nahisë së Prishtinës, ne, duke e pasur parasysh gjendjen e sotme rrethëqark kësaj zone, të dhënat rreth saj po i paraqitim domosdo në kuadër të Kosovës Qendrore (ngjita-ngjitas) Qarkut të Prishtinës:

a) Jankova Klisura - Podujevë

Në hapësirën, Rruga Jankova Klisura – Podujevo (nr r.231 – 259), prej 28 fshatrave, 18 dalin vetëm me A, me SA 1 dhe me S3, ndërkaq, 6 fshatra dalin të papërcaktuar etnikisht, përfshirë edhe Podujevën. Pra rezultati del se vetëm 3 fshatra janë të shënuar me S, ndërsa i përzier ST (me SA) del vetëm 1, fshati Toçane. Është interesant se këtu shënohen 18 fshatra arnautë e jo poturë. Janë me interes emërtimet shqipe të fshatrave Kastrat, nr. r. 248 e Gërgur nr. r. 237. Në 3 fshatra me S, është shënuar numri i shtëpive 65 (25+29+10), ndërsa për fshatrat A18, nuk është shënuar numri i shtëpive.

Sidoqoftë, edhe pse nuk është shënuar numri i shtëpive të fshatrave shqiptarë, për JOS 24 (18 +PP6 të papërcaktuar, raporti del në të mirë të etnisë shqiptare.

Përfundimi: S1, ST3, JOS18 dhe PP6.

b) Kurshumli -Podujevë

Në hapësirën, Put Kurshumlija – Podujevo (Rruga Kurshumli – Podujevë), nr 260-274 janë shënuar 15 fshatra, ku lista përfundon me Podujevën. Të gjithë 15 fshatrat, janë shënuar pa të dhëna pëcjellëse, siç janë shembujt Tihovac /Tijovac, Vrela /Vrelo, Sibovac, Obrandza etj. Meqë nuk është shënuar asnjë fshat me S, kuptojmë se edhe këtu raporti del 15 fshatra në dobi të etnisë shqiptare, apo jo?!

Edhe për Podujevën si qytezë nuk është paraqitur ndarja në etni, por vetëm numri i shtëpive 259, Supozohet, siç del në një burim tjetër se të gjithë shtëpitë i takonin etnisë JOS (shqiptare). Meqë asnjë fshat nuk del me S as me ST, supozohet, pra, me të drejtë se të gjithë mund të vendosen në rubrikën JOS. Sidoqoftë ta kemi në dijeni se për 14 fshatra JOS nuk është shënuar numri i shtëpive.

Përfundimi: fshatra: JOS 15, shtëpi: Podujeva JOS259.

c) Podujevë-Prishtinë 1

Në hapësirën Put Podujevo-Prishtina1 (Rruga Podujevë-Prishtinë1) (nr. r. 275-287) prej 13 fshatrave, 10 dalin me A, me S1 (Makovce) dhe PP2. Në këtë grupim nuk shënohet numri i shtëpive. Jepet vërejtje-sqarim pothuajse për të gjithë këta emra përsëriten gjetiu, në nënnjësi të tjera sipas numrave përkatës të shënuar.

Sidoqoftë, edhe pse nuk shënohet numri i shtëpive sipas etnive, nga raporti i fshatrave A10, S1, vetvetiu kuptohet se edhe në këtë grupim mbizotëron elementi JOS 12 (10+2PP) ndaj S1.

Përfundimi: S1, JOS 10, PP2.

ç) Podujevë- Prishtinë 2

Në hapësirën Put Podujevo–Prishtina2 (Rruga Podujevë –Prishtinë 2), nr. r. 288-300, prej 13 fshatrave, JOS (P) dalin 6, ku për secilin fshat janë shënuar nga 20 shtëpi (7x20 = 140), si dhe për ST1 20 shtëpi, ndërsa të papërcaktuar dalin PP6 fshatra. Këtu pa përcaktim kombësie del emërtimi Kastrata (nr. r. 261). Përsëriten disa emra, nga grupi 1 (pika c)), por me të

dhëna të ndryshuara. Kështu fshati Kisela Banja del me SP 20, Grdovac P20. Ndërkaq, fshati Bariljevo (nr r. 299), del pa të dhëna.

Edhe në këtë nënnjësi mbizotërojnë fshatrat joserbe, gjithashtu edhe numri i shtëpive të shënuara.

Përfundimi: fshatra ST1, JOS6, PP6, përkatësisht shtëpi S 20, JOS 140.

Sqarim:

Kur kemi parasysh formimin makiavelist serbofil të regjistruarit, atëherë mund të konstatojmë, apo jo, që një lëshim i tillë në të tri nënnjësitë e mësipërme kur nuk e ka shënuar numrin e shtëpive për mbi 50 fshatra JOS, atëherë mund shprehet rezervë se kështu është vepruar subjektivisht me qëllim, apo jo? Sidoqoftë, vetë fakti i një *harrese të tillë* në perceptimin e numrit të përgjithshëm ndëretnik serbë / joserbë, nuk duhet të harrohet nga lexuesi ynë, apo jo?

2. Fshatrat e Drenicës (Sela Drenice)

Edhe pse Drenicën autori ia afron më tepër nahive të Metohisë (Rrafshit të Dukagjinit), ne po i sjellim këtu në nahitë e Prishtinës te dy Drenicat që e konsiderojmë si një nënnjësi më vete në kuadër të zonës së Kosovës Qendrore.

a) Drenica e Poshtme (Donja Drenica)

Në hapësirën Donja Drenice (nr. r 509-517 ose sipas grupimit 1-9), janë përfshirë 9 fshatra, dhe që të gjithë etnikisht dalin të përzier ST9. Sipas etnive ndeshim këtë rezultat shtëpishë: S15, JOS 170 (P138, A32) dhe C23 (ciganë serbë?!). Të vihet re, raporti S15, ndërsa shqiptarë ose JOS170 (138+32).

1) Ciganë dalin në 2 fshatra: Kuçishte 10 dhe Llaushe 13 shtëpi, gjithsej 23 shtëpi.

2) Serbët ndeshen në ST3 fshatra: Ovçarevo 5 shtëpi, Mirusha 5 dhe Svinjarine 5, ndërsa këta fshatra dalin me nga 15 shtëpi JOS: Radisheva 15 (P8 e A7), Klina 15 (P15 A5), Srednja Klina 15 (P10 dhe A5), gjithsej 46 shtëpi.

Siç po shihet shtëpi serbe (ortodoksë) janë 28 (15+!3), ndërsa shqipfolës ose JOS janë 170, përkatësisht 155 +15 shtëpi, gjithsesi më shumë se ato ortodokse serbe.

Përfundimi: fshatra ST4, JOS5, shtëpi S15, ndaj JOS 170 (155 + 23!)

b) Drenica e Epërme (Gornja Drenica)

Në hapësirën Gornja Drenica (nr. r. 518-542 ose sipas grupimit 1-25) janë përfshirë 25 fshatra. Sipas shtëpive del ky rezultat: S45, JOS 307 (P182 dhe A125). Së këtejmi, Krajmirovce del S5 P20, ndërkaq Dobroshevac P5 A5.

Edhe nga kjo statistikë konstatohet, që shtëpi serbe kishte 45, ndërkaq JOS 307 (P+A) ose 262 shtëpi më shumë se ato ortodokse.

Përfundimi: fshatra ST 12, JOS 13, shtëpi: S 45, JOS 307.

Përmbyllje rreth fshatrave të Drenicës

Prof. J. Drançolli, lidhur me këtë trevë konstaton se “akademikët serbë falsifikuan historinë e fshatrave të Drenicës, ngase sipas tyre Drenica përherë që nga shek VI fetarisht ka qenë me fe ortodokse të rritit rasian (serb), ndërsa sipas burimeve zyrtare osmane e papnore, që janë gjetur, të cilat ruajnë datat e fillimit të shek. XVIII, ofrohet një strukturë tërësisht tjetër fetare, katolike e osmane shumicë, ndërsa ortodokse pakicë “ dhe për këtë shënon nga origjinale 20 fshatra katolike dhe 5 muslimane... (Shih te portali *revista drini* dt. 26.03.2017).

Sidoqoftë edhe sipas fakteve të shënuara nga M. Milojeviqi, në të dyja Drenicat shihet se aksesit nuk ka dominuar elementi serb (ortodoks), S73 shtëpi ndaj JOS 477 (170+307 poturë e arnautë). Sa për kërshtëri po cek se vetëm familje arnautë dalin më shumë se ato serbe A 157 (32+125) ndaj S 73 (28+45). Fundja le të kujtohet edhe raporti i shtëpive JOS 477 ndaj S73 shtëpive serbe, të cilat edhe pse me fe ortodokse mund të thuhet pa mëdyshje se kanë ligjëruar shqip.

Përfundimi: ST 16 dhe JOS 18, ndërkaq i shtëpive: S73 ndaj JOS 477.

3. Nahia e Vushtrrisë (Vuçiternska nahija)

Në këtë nënnjësi (nahi), nr. r. 405-480, përkatësisht nr. i grupimit 1-77, janë shënuar 76 fshatra para qytetit të Vushtrrisë.

a) Fshatrat e Vushtrrisë

Në rrethinë të këtij qyteti me A janë shënuar katër fshatra: Ljubçe, Prapashtica, Ade dhe Strovce, ndërkaq janë shënuar S47 fshatra, të gjithë të tjerët dalin ST13 d.m.th. me popullsi të përzier me ose pa të dhëna

përkatëse. Kështu, përveç S47 dalin: me ST13 (SP10, SA2, SPA1) dhe JOS 13 (A4, PA9) dhe+PP 2).

Pra në këtë njësi hapësinore sa u përket fshatrave ST13, përkatësisht S47 kuptohet se mbizotërojnë fshatrat serbe. Kjo epërsi shihet edhe sa i përket numrit të shtëpive S 1266 ndaj JOS 321, d.m.th. S 945 shtëpi më shumë nga ato JOS.

b) Qyteti i Vushtrrisë

Sipas këtij burimi, qyteti i Vushtrrisë kishte 850 shtëpi, prej tyre me S 250, ndërkaq me JOS 600. Asnjë shtëpi nuk del e përzier me A (arnautë) ose me ndonjë etni tjetër, por vetëm me P (poturë).

Në të vërtetë edhe për nga numri i shënuar i shtëpive me 1266 ndaj JOS 331 rezultati del për 585 shtëpi më shumë me S. Madje edhe po të llogaritet edhe shuma e vetë qytetit të Vushtrrisë S250 ndaj JOS 600, përsëri rezultati i përgjithshëm del 1516 (1266 + 250) ndaj 931 (331+600) për S 585 shtëpi del më shumë ndaj atyre JOS.

Sa për ulustrim po shënoj se si më i dalluar del Gornje Stanovce që kishte banorë etnikisht të përzier me 31 shtëpi (S12 P4 dhe A15).

Pra për nga fshatrat, ashtu edhe për nga shtëpitë sipas këtij burimi në këtë nënjësi mbizotëron elementi ortodoks (serb), ndërkaq aktualisht Komuna e Vushtrrisë (sipas Regjistrimit të Komisionit 2004) ka 67 fshatra, me popullatë të përzier dalin 15. Sidoqoftë ne po japim të dhënat nga teksti në shqyrtim.

Përfundimi, fshatra ST 13, S 47, ndërsa JOS 13 + PP2), përkatësisht shtëpi S1516 ndaj JOS 931 (331+600).

4. Fshatrat dhe qyteza e Mitrovicës (Sela i varošica Mitrovica)

Mitrovica me rrethinë është regjistruar nën nr. 481-493 ose nën grupimin 1-13, po e trajtojmë në 2 pika:

a) Fshatrat e Mitrovicës

Në rrethinë të këtij qyteti janë shënuar 12 fshatra, ku mbizotërojnë vendbanimet me popullsi JOS (poture).

Rezultati në këtë grupim del ST3 (SP2, SPA 1), S3 dhe JOS 6 (P5 + Ç1), d.m.th., një fshat del me çerkezë; shtëpi S 63, JOS138.

b) Qyteza e Mitrovicës

Sipas këtij burimi qyteti i Mitrovicës kishte 420 shtëpi, prej tyre S80 ndaj P340, ndërsa me A nuk kishte.

Përfundimi: fshatra ST3, S3, JOS 6 (P5+Ç1), ndërkaq, shtëpi: S138 (58+80), JOS518 (178+340).

5. Disa fshatra nga Nahia e Gjilanit

Në këtë njësi, nën nr. r. 494-502 (ose sipas grupimit 1-9) janë shënuar vetëm 9 fshatra, të cilët sipas përbërjes etnike dalin kështu:

S1, ST3 (PSL1, SPA1 dhe SA1 Slivova), JOS 5 (A1, PA4), dmth me PA dalin 5 fshatra, vetëm me S 1, ndërsa ST 3.

Sa i përket numrit të shtëpive rezultojnë: S 21, JOS167.

Në të vërtetë ndër këta 9 fshatra, prej tyre dallohet Janjeva me 260 shtëpi, prej të cilave rezultati del: P60, dhe me LS 200, d.m.th. /latinski srbi (serbë të latinizuar). Është fjala për katolikë, ku do të lindë Gjeçovi i madh. Ishin, vërtet, serbë këto 200 shtëpi, apo jo?! Sidoqoftë, po t'i shtojmë numrit 21 të shtëpive serbe edhe këto 200 shtëpi katolike të Janjevës, atëherë numri i shtëpive serbe (21+200) del më i madh për 44 shtëpi ndaj atyre shqiptare JOS167).

Përfundimi: fshatra: ST2, S1, JOS 5 (+1?), ndërkaq shtëpi S 21 (+200!) ndaj JOS 167 (+200?).

6. Disa fshatra nga Nahia e Shkupit (Neka sela Skopske nahije)

Në nahi të Shkupit (nën nr. r. 503-506) janë shënuar vetëm këto katër vendbanime: 1) Kaçanik me 139 shtëpi, 2) Stari Kaçanik me 25, 3) Kameno Glava me 25 dhe 4) Provalije me 10 shtëpi.

Në këta katër fshatra janë shënuar A196 shtëpi, d.m.th. popullatë shqiptare që supozohet ardhacake si katolikë të islamizuar(!).

Përfundimi: fshatra JOS 4, ndërsa shtëpi JOS 196.

Tabela përmbyllëse rreth gjendjen etnike të Zonës së Kosovës Qendrore

Nën-Njësia	Fshatrat					Shtëpitë		Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd
1) a,b	103 +1	27	41	35	-	1426	5162	23	1
2)1.a	28	3	1	18	6			25	1
1.b	15	-		15		-	259	11	-
1.c	13	-	1	10	2	-	-	12	-
1.ç	13	1		6	6	-	-	12	-
2.	34	16	-	18		72	477	8	-
3.	76	13	47	13	2	1516	931	6	-
	+1 q.								-
4.	12+q	3	3	6		143	478	2	-
5.	9	2	1	5	1	21	167	-	-
6.	4	-	-	4	-	-	196	-	-
Gjithsej	306	74	71 50	71 50	17	3585 33	7231 67	99	2

Siç e pamë, në Kosovën Qendrore, në përgjithësi mbizotëronin familjet JOS (P+A).

Së këtejmi shikuar në përgjithësi assesi në këtë zonë as sa u përket fshatrave (50 me 50%), pra nuk dominonin fshatrat serbe, kur kemi parasysh faktin se shumë fshatra shqiptare nuk ishin shënuar fare, por sa i përket gjendjes së shtëpive atëherë elementi joserb, ç'është e vërteta, del mjaft i thellë, JOS 67% (shqiptarë), qoftë poturë, qoftë arnautë, po jo ai latin që do të dalë më i ndjeshëm në zonën tjetër.

Prandaj konstatimi se para Lidhjes së Prizrenit kishte shumicë serbe në këtë zone, nëse lexohet drejt, nuk del i vërtetë deri edhe sipas statistikës që e shënon vetë makiavelisti serbofil Milosh Milojeviç.

C) KONTATIME NGA ZONA E RRAFSHIT TË DUKAGJINIT (Metohija)

Këtë zonë, varësisht nga qytetet, ashtu siç e ka ndarë edhe autori, do ta trajtojmë në tri qarqe ose njësi zone: 1. Qarku i Pejës, 2. Qarku ose nahija e Gjakovës dhe 3. Qarku i Prizrenit.

1. Qarku i Pejës (Okrug Peçki)

Hyrje

Në Qarkun e Pejës, përveç Istogut, atëherë bënin pjesë edhe Ivangradi (Berani), Gucia etj, madje edhe sa i përket kufirit Pejë-Deçan-Gjakovë

mund të ketë pasur ndryshime, siç del edhe nga dokumenti që e kemi në shqyrtim, mirëpo, sido që të ketë qenë, ne, po japim disa nënnjësi a grupe regjistruese, siç dalin nga teksti i autorit për këtë nënzonë.

1) Nënnjësia 1, 63 fshatra (Rrethi i Rugovës)

Në këtë qark të dhënat fillojnë nga Rrethi i Rugovës (Srez rugovski). Siç dihet Rugova si krahinë është mjaft e gjerë, e cila përfaqësohet pak a shumë me 13 fshatra shqiptarë, ndërsa në tekstin në shqyrtim, nr. r.: 543-606 ose grupimi 1-63, autori fillimisht shënon 64 fshatra S63, ku vetëm Sushica del me popullsi të përzier ST 30 (S5 A25).

Këtu nuk shënoi asnjë fshat JOS, por ndër të tjerë, dallon Gorazhdecin me S130 shtëpi dhe Posranotrnje / Trnje me S400 shtëpi. Në të vërtetë vetëm tek disa shënohet numri i shtëpive, numër ky që arrin S925 shtëpi.

Përfundimi fshatra: ST1, S63 ; shtëpi S925, JOS 25 (A).

2) Nënnjësia 2, 13 fshatra

Nën nr. r. 607-619 ose 1-13 kalohet në njësi të re, ku shënohen 13 fshatra, prej të cilëve me ST9 (SP9) d.m.th. të përzier serbë $\frac{3}{4}$, e poturë $\frac{1}{4}$ po pa shënuar numër shtëpish. Aty shënohen S2 fshatra me 90 (30+60) shtëpi dhe 2 fshatra të përzier ST (SP42 (30+12) dhe P11 (6+5). Mbizotërojnë fshatrat me S si dhe sa u përket numrit të shtëpive S132 (90+42) ndaj JOS 11.

Përfundimi: fshatra ST11, S2; shtëpi S 132, JOS11.

3) Nënnjësia 3, 12 fshatra

Dallohet edhe një nënnjësi tjetër, nr. r. 620-631, ku shënohen 12 fshatra, të gjithë ST12 (të përzier), përkatësisht SL, d.m.th. të përzier serbë ortodoksë me latinë (katolikë).

Për 7 fshatrat e parë shënohet se kanë numër të përzier shtëpish, por pa shënuar numra konkretë, ndërsa për 2 fshatrat në vijim shënohet shifra, S 50 (35+15) e L 11 (8+3). Ndërkaq, për tre fshatrat e fundit shënohet shifra por e pandarë në etni. por edhe me vërejtje: disa shtëpi (*nekoliko*). Pra, në këtë nënnjësi dallohet qartë vetëm shifra S50 ndaj L11.

Përfundimi: fshatra ST12; shtëpi S50, JOS 11(L).

4) Nënnjësia 4,

26 fshatraPrej nr.r. 632–657 ose 1-18(?), ku janë përfshirë 26 fshatra, të gjithë të përzier ST26 (SL3,SP 18 dhe SPAL 5), tek të cilët nuk del i shënuar numri i shtëpive, por sugjerohet se shumica ishin ortodokse (serbe).

Përfundimi: fshatra ST26.

Shënim:

Siç po shihet në nënnjësitë ose grupimet përkatëse mbizotërojnë fshatra me ST dhe S, mirëpo shikuar jo vetëm nga gjendja e sotme, por edhe e atëherëshme dihet se në fshatrat përkatës kishte shqiptarë në numër të konsiderueshëm, por mbase edhe të shënuar si serb, përkatësisht serbët e shënuar mund të kishin qenë me etni malazeze ose boshnjake (muslimane), apo jo?!

Sidoqoftë, ne po e respektojmë statistikën e autorit, edhe pse siç dihet historikisht në ato hapësira jetonin edhe fise të njohura shqiptare (shqipfolëse).

5) Nënnjësia 5, 41 fshatra

Së andejmi nga numri rendor 658-698 kalohet në 41 fshatra, 39 janë shënuar me P (JOS), pa të dhëna shtëpish, megjithatë bën përjashtim vetëm Juniku P385 dhe dy fshatra S2: Loçani me 8 dhe Xhakovo me 17 shtëpi. Siç po vërehet për 38 fshatra me JOS (P) nuk shënohet asnjë numër shtëpish.

Përfundimi: fshatra S2, JOS 39; shtëpi S25. JOS 385 (Juniku),

6) Nënnjësi 6, 9 fshatra

Në nënnjësinë apo grupimin tjetër prej 9 fshatrash, nr. r. 699 – 707, prijnë fshatrat JOS7 (me P), ndërsa 2 të fundit me ST (SP). Marrë në tërësi mbizotërojnë fshatrat JOS, përkatësisht rezultati del P7 dhe ST 2. Te këta 2 të fundit është shënuar numri i shtëpive: Joshanica ST50 (S10, P40) dhe Shtupel 35 (S17, P18 (!), përkatësisht S27 ndaj P58. Edhe në këtë grupim, për 7 fshatra JOS nuk është shënuar numri i shtëpive.

Përfundimi: fshatra ST2, JOS7, shtëpi S27, JOS58.

7) Nënnjësia 7, 17 fshatra

Si nënnjësi a grupim i fundit, nën nr. 708 -724, janë përfshirë 17 fshatra. Në këtë grupim del ky rezultat: ST3 (SL1, SP2), S8, dhe JOS 4 (P3, PAL1) dhe PP2. Mbizotërojnë fshatrat serbe, pra S8 ndaj JOS 4 (P+AL 4) dhe

PP2. Numri i shtëpive edhe pse pjesërisht i shënuar del: S34, JOS 45 (L20+P25).

Përfundimi: fshatra ST3, S8, JOS4, PP2, shtëpi S34, JOS 45.

8) Qyteti i Pejës

Së fundi Qyteti i Pejës (nr.r 725), sipas këtij burimi kishte: 1850 shtëpi, përkatësisht S 550, JOS 1300 (P1200 dhe L100).

Sivërejtje: Në qytetin e Pejës asnjë shtëpi nuk del me A. Është fjala për periudhën në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, kishte arnautë shqiptarë atbotë ne Pejë, apo jo? Mbase shqiptarë quheshin faktikisht poturë, me të cilët Haxhi Zeka, bëri histori shqiptare, apo jo?! Mos vallë, rreth Pejës autori disi i ikën etnisë arnaute, ngase për arsye se tashti del etnia latine me 100 shtëpi, apo jo?!

Sidoqoftë, në Pejë kishte 550 shtëpi serbe, ndërsa JOS1345 shtëpi (P+L), d.m.th. 795 shtëpi më shumë ndaj atyre ortodokse.

Me sa pamë në këtë njësi zone, në të vërtetë, nga ana e Malit të Zi janë regjistruar 64 vendbanime me S dhe nga anët e tjera dalin të shënuara 12 që gjithsej kapin shumën S76 fshatra, që në krahasim me fshatrat thjesht shqiptarë që kapin shumën 50, prijnë sasisht fshatrat ortodokse (serbe) për 26 fshatra, mirëpo po të llogarisim edhe fshatrat ST që kapin shumën 56, atëherë 50+56 bëjnë 106 fshatra të tjerë jo plotësisht etnikisht ortodokse (serbe) që dalin pak më shumë se ata thjeshtë me S për afro 30 fshatra. Ka mendime se për hir të Manastirit të Pejës Miilojeviqi rriti numrin e etnisë serbe, sepse kur dihet fakti se së andejmi nuk ka pasur shpërngulje na duket reale sttaistika turke e viteve 1908-1909 që me përqindje del 75,5% shqiptarë dhe serbë (ortodoksë) 19%, ndërsa sipas statistikës së Autrohungaresë më 1916, rezultati del 83,1% shqiptarë, ndërsa serbë 11.9%.

Së këndejmi, mesa dime nga realiteti historik një numër i konsiderueshëm fshatrash JOS nuk janë shënuar fare, madje për një numër të konsiderueshëm të atyre të shënuar JOS45 (afro 50) nuk është dhënë numri i shtëpive, megjithatë, edhe pse e dimë se nuk është reale, ne respektojmë statistikën e shënuar nga Milojeviçi (Vemiçi).

Sidoqoftë, për hir të së vërtetës edhe këto fakte që sapa i cekëm si mungesë materiali lexuesi duhet t'i ketë parasysh, apo jo?!

Tabela përmyllëse, njësisë zonale Pejë

	Fshatrat	Shëpitë	Vërejtje
--	----------	---------	----------

Nën-Njësia	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd
1	65	1	63	-	-	1020	25	3	3
2	13	11	2	-	-	132	11	1	1
3	12	2	-	-	3	-	-	2	1
4	26	-	8	18	-	20	40	3	-
5	42	2	2	40	-	25	385	3	-
6	9	2	-	7	-	27	58	-	-
7	17	3	8	4	2	34	45	2	1
Qyteti						550	1300		5
Gjithsej	184	31	83	69	5	1798	1864	14	
						49	51		

Sidoqoftë, me marrë në përgjithësi, sipas tekstit, edhe te numri i fshatrave edhe tek ai i shtëpive mbizotërojnë ata joserbë, apo jo, ngase shumë fshatra shqiptare janë *harruar(!)*, ndërsa ato serbe (edhe pse malazeze a boshnjake) ndoshta edhe ortodokse shqiptare jo!?

Është interesant fakti se për të parën herë del në mënyrë më të ndjeshme etnia latine (katolike), edhe sa u përket fshatrave si dhe shtëpive gjithnjë e më pak këtu ceket etnia arnautë (katolikë të islamizuar!).

2. Nahia e Gjakovës (Djakovička nahija)

Nahia e Gjakovës trajtohet në 3 rrethe (nënnjësi), siç janë 1) Rrethi i Hasit, 2) Rrethi i Malësisë dhe 3) Rrethi i Rekës, ne e sajua një nënnjësi të re: 4) Grupimi i fshatrave rreth Gjakovës.

Këto nënnjësi po i trajtojmë me radhë:

1) Rrethi i Hasit

Rrethi i Hasit (Srez haske) përfshin 49 fshatra, nr. r.. 726-774. Sipas përbërjes etnike rezultati është:

JOS 49 (P11, L9, A6, PA 21 dhe PL2).

Siç po shihet në këtë nënnjësi asnjë fshat nuk del as me S as me ST, d.m.th. pa etni serbe. Sa për kërshtëri po cek se fshati Rogovo kishte këtë përbërje etnike P30 A15, ndërkaq Kuzhnini PA13. Ka vend edhe për ndonjë vërejtje a konstatime të tjera, por ne po i anashkalojmë.

Në këtë nënnjësi, mbizotërojnë familjet me P (poture), përkatësisht janë shënuar JOS 872 shtëpi.

Përfundimi: fshatra JOS 49, shtëpi JOS872.

2) Rrethi i Malësisë

Rrethi i Malësisë (Srez malesijski), si nënjesi më vete, përfshin 7 fshatra, nr. r. 775-771 dhe kanë këtë përbërje: JOS7 (PA2, P1, A2 dhe L2).

Sa për ilustrim po shënojmë se emërtimi Trapopoj, që numëronte P100 shtëpi, përmirësohet drejtshkrimisht në Tropoja nga botuesi, ndërsa Shipshaj PA300 ishte i shënuar Shtipsha. Në këtë grupim Bitiqi del me A220 shtëpi, Krasniqja me A550, kurse Nikaj me L275 shtëpi dhe po aq Merkuri L275. Sidoqoftë, gjithsej numri i shtëpive në këtë nënjesi del JOS 1420 (P100, PA300, A770 dhe L250).

Përfundimi, fshatra JOS 6 dhe shtëpi JOS 1420.

3) Rrethi i Rekës (Srez rečki)

Në këtë nënjesi, përfshihen 22 fshatra, nr. r. 772-803, sipas përbërjes etnike rezultati del kështu:

JOS21 (P17, A2, L1, AL1,) dhe ST1 (SPA1), ndërkaq, numri i shtëpive S 2, ndërsa JOS 377 shtëpi.

Sa për ilustrim po shënojmë se vetëm këta fshatra kishin etninë e përzier: Skornica (Korenica) kishte P5 A15 dhe Dolashac (Dollashaj) A6 L10, ndërsa Moliqe (Moliq) kishte S2, P16 dhe A8 shtëpi.

Përfundim: fshatra ST1, JOS 21; shtëpi S2, JOS 377.

4) Fshatra rreth Gjakovës

Për qëllime praktike e sajuam nënjesinë e re “Fshatra rreth Gjakovës”, në të cilën janë përfshirë 53 fshatra, që sipas etnive dhe për nga numri i shtëpive del ky rezultat:

ST16 (SAL1, SPA8, SL1, SA2, SP4), JOS 35 (A4, L8, P4 dhe PA18, PAL1) dhe PP2).

Siç po shihet, edhe pse nuk del asnjë fshat vetëm me S, shtëpitë serbe i ndeshem të përziera me të tjera etnitete në ST16 fshatra, qoftë të përzier me arnautë e latinë, qoftë me poturë e arnautë, ose vetëm me P ose A apo me L. Në JOS 35 fshatra janë regjistruara 1287 shtëpi, ndërkaq në fshatrat ST16 dalin S52 shtëpi.

Për veçoritë që ndeshem në fshatrat ST (serbë me të tjerë përzier), po i trajtojmë në dy pika:

a) *Së pari*, në këta pesë fshatra me ST del numri përkatës i shënuar i shtëpive, por nuk ndahet sipas etnive:

Tabela I

- 1) Grkovce SP 16
- 2) Jablanica SP 22
- 3) Zhabel SP 15
- 4) Mazniq SA 8 dhe
- 5) Dushanovac SPA 20 shtëpi.

Siç po shihet emnohen 3 fshatra me SP (serbë e poturë, një SA 1 (serbë e arnautë) dhe një SPA 1 (serbë, poturë e arnautë).

b) *Së dyti*, në listën e mëposhtme në këta 12 fshatra, po ashtu ST del i shënuar numri i shtëpive sipas këtyre etnive:

Tabela II

Fshati	S	JOS	(P	A	L)
1. Radojevac (Radonjiq)	9	20	(20	-	-)
2. Crmljan (Cërmljan)	10	21	(10	11	-)
3. Rashkovce Rakoc)	2	13	(8	5	-)
4. Duhjake (Dujak)	2	25	(-	5	20)
5. Grmoçell (Gramoçel)	3	24	(-	-	24)
6. Hejreçi (Ereç)	2	12	(-	12	-)
7. Gillogjan (Glodjane)	3	20	(10	10	-)
8. Babatloçit (Baballoç)	2	20	(12	8	-)
9. Iriqe (Rzniq)	7	24	(20	4	-)
10. Belega (Beleg)	5	20	(10	10	-)
11. Voksha (Voksha)	5	245	(100	45	-)
12. Moliqe	2	24	(16	8	-)
Gjithsej:	S52	368	(P206	A118	44)

Edhe pse janë shënuar ST17 fshatra vetëm në 12 prej tyre janë shënuar 52 shtëpi ortodokse, d.m.th. pak më shumë se ato latine (44), por gjuhësisht nuk mund të besoj se edhe ato 52 familje (shtëpi) në atë periudhë ishin të gjitha serbishtfolëse(!), aq sa edhe ato L44 ishin latinishtfolëse(!), apo jo?!

Sidoqoftë, mbështetur në realitetin e sotëm dhe atë historik gjuhësisht mund të themi pa shumë rezervë se shumica e familjeve ortodokse 15 sosh, që quheshin shkije, ngase fetarisht i takonin shkizmës, apo jo, flitnin pa mëdyshe të njëjtëm gjuhë sikurse JOS368 shtëpitë e tjera (P206, A118 dhe L 44).

Përfundimi: fshatra ST17, JOS 35, PP2; shtëpi S52, JOS 368

5) Qyteti i Gjakovës

Ndërkaq, sipas këtij burimi, qyteti i Gjakovës kishte: 2385 shtëpi, prej tyre S36, JOS 2349 (P2100, L129 dhe C (ciganë) 120).

Si mund të shpjegohet fakti pse asnjë arnaut (shqiptar ose latin i islamizuar!) nuk del i shënuar në Gjakovën e Sulejman Vokshit?! Vallë, të gjithë ishin poturë (serbë të gjysmëturqizuar!), të cilët dhjetë vjet më vonë do të luftojnë aq shumë e ndërgjegjësisht kundër tuqve, apo jo?! Sidoqoftë, le të vlerësohet e vërteta se Gjakova, atëherë paska pasur vetëm 36 shtëpi ortodokse (shkije), sigurisht edhe ata ishin shqipfolës, ndërsa përfaqësohej qyteti, sipas këtij regjistrimi, vetëm me P+L (poturë e latinë), gjithsej 2229 shtëpi apo 2193 më shumë shtëpi sa kishte etniteti serb (ortodoks).

Pra, njësia zonale e Gjakovës (pa ciganë 120 shtëpi) kishte JOS6913, ndërsa, shtëpi serbe kishte 88 (52 + 36), përkatësisht 6820 shtëpi JOS kishte më shumë ndaj atyre ortodokse.

Tabela përmblyëse: Njësia zonale Gjakovë

Nën-Njësia	Fshatrat					Shëpitë		Vërejtje			
	Nf	ST	S	%	JOS	%	PP	S	JOS	Ps	Kd
1	49	-	-	-	49	-	-	-	872	-	11
2	7	-	-	-	6	-	-	-	1420	-	3
3	22	1	-	-	21	-	2	2	394	-	5
4	53	16	-	-	35	2	42	42	1287	6	10
Qyteti	-	-	-	-	-	-	36	36	2693	-	-

Gjithsej	121	17	-	111	2	80 1	16765 99	6	29
----------	-----	----	---	-----	---	---------	-------------	---	----

Gjakova si njësi zonale kishte më shumë fshatra JOS 111 kundrejt atyre ST 17, përkatësisht, kishte shtëpi JOS 6677 më shumë nga ato S 80 ortodokse (serbe).

3. Nahia e Prizrenit

Autori nahinë e Prizrenit nuk e trajton të ndarë në rrethe, por kryesisht në bajraqe, mirëpo para se të japë grupime emërtimeve sipas bajraqeve të kësaj nahije, fillimisht, sirastësisht jepet një nënnjësi e veçantë.

1) Nënnjësi prej 4 fshatrash

Në këtë nënnjësi të parë të veçantë, nr. r. 858-861, përfshin vetëm ST4 vendbanime, ku përveç Rahovecit, për të cilin konstaton se ka etni të përzier, por pa shënuar numër shtëpish, shënon edhe këta tre fshatra me këto të dhëna: 1) Brnjaça me ST 16 (S1 dhe C15), d.m.th. një shtëpi serbe dhe 15 cigane, 2) Samodradza me ST (S6 P83) si dhe Retinje me ST 50 (S18 dhe P32) shtëpi. Në këta tre fshatra janë shënuar shtëpi S25, JOS 125 (P115 + C15) shtëpi.

Përfundimi: ST4 fshatra, shtëpi S 25, ndërsa JOS 125.

Fill pas kësaj fillohet me bajraqe si nënnjësi përkatëse regjistruese administrative.

2) Bajraku i Palluzhës (Polužni Bajrak)

Bajraku i Palluzhës (nr. r. 862-888) përfshinte 26 fshatra me këto të dhëna etnike:

ST 2 (SA1, SPA1), JOS 24 (A4, P5 dhe PA15),

Ndër këta 26 fshatra dalin S14 shtëpi të ngulitura në dy fshatra me etni të përzier: Bratotin ST 33 (S8 P13 A12) dhe në Bela Crkva ST 24 (S4 dhe A20) shtëpi. Dy fshatra dalin me yllth: Spijni A25 dhe Potok me PA12. Fshati më i madh në këtë grupim është Zatriqi, P70 shtëpi.

Përfundimi: fshatra ST2, JOS24, shtëpi S14, JOS789.

3) Bajraku i Hoçës së Vogël (Malohočni steg)

Bajraku i Hoçës së Vogël (nr. r. 889-908), përbëhet prej 20 fshatrash. Ka këtë përbërje etnike: ST 12 (SP9, SAC1, SPC1, SPA1), S1 dhe JOS 7 (A2, P1, PA1, AL1, PL1 dhe PCO1).

Pra dalin JOS7 fshatra, ndërsa S1 del vetëm një. Ndërkaq në këtë grupim dalin ST12 fshatra. Së këndejmi, numri i familjeve ortodokse nuk del i pavërejtur S348 ndaj JOS340.

Sa për ilustrim po shënojmë gjendjen në disa fshatra me popullsi të përzier: Velika Hoça ST106 (S100 P6), Medveci ST120 (S20 P100), Velika Krusha ST90 (S30 P30 A30), Mala Krusha ST60 (S30 A18, C12), Atmadza ST14 (S8 P6), Radobrava ST24 (S8 P16), Gornja Srbica ST21 (S16 P5), Donja Srbica ST30 (S15 P15), Zlaçishte /Zoçishte ST 65 (S45 P20), Mamusha JOS 128 (P40 C8 dhe O80). Pra Mamusha paska pasur përveç P20, C8 dhe+80 shtëpi osmanli, turq të deklaruar.

Përfundimi: fshatra ST12, S1, JOS7, ndërkaq shtëpi S348, kurse JOS340.

Në këtë nënnjësi numri i shtëpive serbe del më shumë ndaj atyre JOS, për 8 sosh.

4) Bajraku i Ostrozubit (Ostrozubni steg)

Bajraku i Ostrozubit, nr. r. 909-933), përfshinte 25 fshatra me këtë përbërje etnike:

ST2 (SA1, SPA1) dhe JOS 23 (A9, P3, PA11).

Pra JOS23 dhe vetëm ST2, ndërkaq raporti i numrit të shtëpive del S10, ndërsa JOS880.

Fshati, që mori emrin e bajrakut, Ostrozubi nuk është shënuar si fshati më i madh sa u përket shtëpive. Në të vërtetë, Ostrozubi si fshat sipas këtij burimi kishte P50 shtëpi, Lapushniku PA60, Crnilug JOS 44 (P19 A25), Pagarusha PA60, Guncati A60, Banja A60, Lubizhda A30, Mirusha P10, Vlashki Drenovac P50 etj. Në këtë grupim dalin vetëm dy fshatra të përzier me etni ortodokse (serbe), me nga 5 shtëpi: Orlate ST25 (S5 P10 A10), Domanek ST 20 (S5 A15).

Përfundimi: fshatra ST2, JOS 23; shtëpi S19, JOS 880.

5) Bajraku i Suharekës ose Disa fshatra nga Rrafshaku dhe Rrethbjeska e Therandës

Si nënnjësi të re, nga regjistri, sajuam një grup fshatrash nga Rrafshaku dhe Rrethbjeska e Suharekës (Therandës së sotme), nr. r. 934-973, të cilën e përbëjnë 40 fshatra. Edhe pse nuk del e shënuar si nënnjësi komogjene më vete, ne e sajuam, sepse e njohim paksa më mire që nga

fëminia dhe se vërtet i ka disa veçori që e dallojnë si trevë më vete, edhe pse në këtë vepër nuk paraqitet si bajrak i veçantë.

Sipas numrit të fshatrave edhe për nga numri i shtëpive sipas etnive në këtë njësi del ky rezultat:

S2; ST21 (SPA3, SL 2 SP16); JOS18 (P7, PA10 dhe L1).

Ndërkaq për me tregue numrin e shtëpive sipas etnive më poshtë po japim regjistrin e plotë, ku pas numrit rendor shënohet iniciali i grupit etnik dhe numri i plotë i fshatrave që i përkasin atij sinjali të grupit përkatës, pastaj fill shënohet emërtimi i fshatit dhe ngjitas me të shënohet numri i shtëpive, etnikisht i ndarë ose i përzier, ashtu siç është shënuar nga autori dhe në fund në rresht të ri, rumbullakësohet numri i shtëpive pas shkurtesë-sinjalit të etnisë:

Tabela e nënnjësisë 5

1. L 1: Novaka 15 shtëpi.

- **L15 shtëpi.**

2. S 2: Gelanca 15, Lutoglava 14.

- **S 29 shtëpi.**

3. P 7: Gjinoci 45, Karaçica 35, Neprebishti 25, Peçani 30, Savrova 15, Sllapuzhani 30, Stravçina 12.

- **P192 shtëpi.**

4. PA10: Dobërdelani 35, Kabashi 9, Kravaserija 30, Malisheva 20, Nishori 35, Semetishti 30, Seniku 20, Vraniqi 35 dhe Grekoci 45 (P10 A35) e Reçani 42 (P30 A12).

- **PA301 shtëpi.**

5. SP 15: Caparce 24 (S12 P12), Delovce 50 (S 30 P20), Dvorane 46 (S40 P6), Korisha 86 (S36 P50), Leshane 48 (S18 P30), Lubizhda 47 (S44 P3), Movljane 42 (S32 P10), Mushtishti 100 (S45 P55), Ofterusha 131 (S25 P106), Reshtani 25 (S6 P19), Sopina 26 (S12 P14), Studençani 94 (S19 P75), Suhareka 70 (S24 P46), Trne 12 (S5 P7), Zoçishte 65 (S45 P20)

- **S 393, - P475.**

6. SPA 3: Dulje 30 (S4 P13 A13), Popovljane 50 (S35 P8 A7), Selograzhde 68 (S8 P20 A40)

- **S47, -P41he -A60.**

7. SL 2: Shpinadia 10 shtëpi (S4 L6) dhe Velezha 20 (S12 L8)

- **S16, L 14.**

Përfundimi: S2, ST19 dhe JOS 20, ndërsa shtëpitë: S 485 (29, 393, 47, 16) JOS 991 (L29, P601, PA301, A60).

Shënim:

Nga nënnjësitë e tjera tërhoqëm dhe i sollëm këtu këto 4 emërtime fshatrash që faktikisht i përkasin këtij terreni: Budakova JOS60 (P20 A40), Bllaca JOS 60 (P10 A50), Samodradza: ST91 (S8 P83) dhe Dubrava: ST28 (S14 68).

Në të vërtetë, për këto dy të fundit druaj se mund të jenë ngatërruar me njësi të tjera që mund të kenë pasur të njëjtin emër, por sidoqoftë, ST18 i shtohen 2 fshatra: ST20, ashtu si JOS 20 +2= 22, ndërsa sa u përket shtëpive rezultati total del: S507 (485+22 ose 8+14) dhe JOS 1218 (991+227 ose 60+60+83+14).

Ç'është vërteta, disa fshatra, 15 sosh, që dihet se atëherë si edhe se sot i takojnë Therandës që mesa dihet, edhe atëherë ekzistonin po me këta emra si:

Buzhala, Papazi, Çadraku, Grejçeci, Krushica e Epërme, Krushica e Poshtme,

Maqiteva, Breshanci, Bukoshi, Dragaçina, Luzhnica, Kastërci, Tumiçina, Javori, Vërsheci,

e mbase edhe ndonjë tjetër dhe që të gjithë me popullsi shqiptare, nuk i kam hasur të regjistruara nga autori i këtij burimi as në nënnjësi të tjera, atëherë numri i fshatrave dhe i shtëpive JOS (shqiptare) në krahasim me ato ortodokse (serbe) pa mëdyshje do të ketë pasur diferencë edhe më të madhe/

Siç po shihet, nën pikën 4) dallohet numri i ndarë P+A, vetëm në dy fshatra Grejkoc JOS45 (P10 A 35) e Reçan JOS 42 (P30 A12). Po kjo ndarje, ashtu veç e veç, është bërë edhe për fshatrat e ndajshuar prej nesh Budakovë JOS 60 (P20 A40) e Bllacë JOS 60 (P10 A50), tek shembujt e tjerë nga autori shënohet vetëm numri i tërësishëm pa u ndarë në etni përkatëse P ose A.

Së këndejmi, mund të shihet se në këtë njësi numri i shtëpive serbe (ortodokse) që afrohen ose e kalojnë 500-shin, është mjaft i vërejtshëm, por shikuar në tërësi, afro 2 herë më shumë dalin të shënuara shtëpi JOS (shqiptare), madje nëse kemi parasysh edhe numrin e shtëpive të 15 fshatrave të pashënuar, që edhe atëherë si sot ishin fshatra të pastër JOS, del që përqindja e shtëpive shqiptare ndaj atyre serbe është edhe më e madhe.

Sidoqoftë, në përmbyllje të kësaj nënnjësie po bazohemi vetëm në numrin e tërësishëm, siç është shënuar në atë tekst për 44 fshatra dhe ja si del rezultati:

Përfundimi: fshatra ST20, S 2, JOS 22, shtëpi S 507 ndaj JOS 1218.

6) Bajraku i Opojës (Opoljski steg)

Bajraku i Opojës (nr.r. 974-989) përfshin 16 fshatra, dhe sa i përket etnisë rezultati del:

JOS15 (A2, P7, PA6) dhe ST1(SP1).

Ndër fshatra më karakteristikë veçuan: Breznja PA100, Bardisan PA 120. Belobrod PA 60, Opoljski Zjum A30, Beglere S16 P13 (!). Pra pa S dalin 15 fshatra, ndërkaq del i pëzier ST vetëm një (Beglere).

Përfundimi: fshatra: ST1, JOS15; shtëpi S16 ndaj JOS 428.

7) Bajraku i Lubisë (Ljubiski /Ljubljanski/ steg)

Bajraku i Lubisë (nr. r. 990-1033) përfshin 43 fshatra, sipas etnive rezultati del kështu:

S12, ST14, JOS 17 (A2, P8 dhe PA7).

Si më karakteristik dallohen këta fshatra: Kashtanjevo JOS35 (P20 A15), Bitinje ST31 (S5 P26), Mushnikovo ST75 (S60 P15), Ljubinje S120, Srečka S80, Gotovusha S120, Ljubiçevo PA80, Reçani ST31 (S1 P30), Kushtendin PA20. Siç po shihet mbizotërojnë për nga numri fshatrat ortodoksë me S. Rezultati del S12 fshatra, ndërsa JOS 7 Edhe gjendja e shtëpive del në dobi të etnisë S (ortodokse): S1289 ndërsa JOS 856.

Përfundimi: fshatra ST14, S12, JOS17; shtëpi S1289 ndaj JOS857

Në këtë nënnjësi numri i shtëpive me S del më i madh ndaj atyre JOS për 432 sosh.

8) Bajraku i Lumës (Lumanski steg)

Bajraku i Lumës nr.r. 1034 -1062) përfshin 29 fshatra dhe etnikisht dalin me këtë rezultat:

JOS 29 (PA5, P7 dhe A7), shtëpi JOS 1562.

Po e dallojmë në këtë grupim fshatin Zhur, i cili kishte P129 shtëpi, ndërsa Verbica PA90.

Përfundimi: fshatra JOS 29; shtëpi JOS1562.

9) Bajraku i Dukagjinit të Poshtëm (Steg Donji Dugadjin)

Në këtë grupim, Bajraku i Dukagjinit të Poshtëm (nr.r.1063-1076) janë shënuar 14 vendemërtime, të gjithë të komunitetit L (latinë), Sa për

kërshëri po i shënojmë këta shembuj: Mirdita me L100 shtëpi, Spasija me L400, Kashtedini L200 dhe Srosha L125 shtëpi etj.

Përfundimi: fshatra JOS14 dhe shtëpi JOS1450.

10) Bajraku i Gorës (Goranski steg)

Bajraku i Gorës përfshin 27 fshatra, me P 26 dhe vetëm një del ST1 (Ljubishte, por pa të dhëna shtëpish).

Po i japim disa shembuj karakteristikë me të dhëna nga ky grupim: Rapça P129, Orishke (Oreshke) P250. Restelica P350, Brod P700 dhe Dragashi me P25. Kështu, dalin JOS 26 fshatra dhe vetëm një ST1 (Ljubovishte SP).

Përfundimi: ST 1, JOS26, ndërkaq numri i shtëpive del JOS2825.me goranët mbase sikur sot, ishte oazë nashkefolëse, por assesi të deklaruar serbë, apo jo?

11) Grup fshatrash rreth Prizrenit

Sajuam këtë grupim-nënjësi fshatrash rreth Prizrenit, të përbërë nga 35 fshatra, tek të cilët sipas numrit të etnive rezultati del kështu:

ST 12 (SA1, SP4, SPA6 dhe SPAL 1), S6, ndërsa JOS 17 (P11, PA6).

Si më karakteristik dalluam këta fshatra ose krahinëza: Djaferëve PA 200 shtëpi, Miliçeviq ST50 (S10 P30 A10), Karmovik (Hramovik) ST71 (S15 P30 A20 L6), Ljuma: JOS185 (P105 A80). Dolnishte ST211 (S20 P80 A110).

Përfundim: fshatra 35, ST 12, S6, ndërsa JOS 17; shtëpi S392 ndaj JOS819.

Shënim:

Nën nr.507 dhe 508 shënohen dy fshatra të Prizrenit Jazhince me 60 shtëpi dhe Sevce me 50 shtëpi që të dy me etni serbe, për të cilët shënohet numrin përsëritës, për Jazhince 1014 ku përsëritet numri i shtëpive S60, ndërsa për Sevce nr. 1015 po me ndryshim të numrit të shtëpive nga S50 në S 120. Pa marrë parasysh në pasaktësinë statistikore ne pranuar statistikën nga grupimi i fundit.

12) Qyteti i Prizrenit

Prizreni si qytet i njohur që nga lashtësia, sipas këtij burimi kishte 6400 shtëpi, prej të cilave: S1200, JOS5220 (P4800, A 200, L100 dhe me O (osmanli) 120 shtëpi).

Siç po shihet në prag të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ky qytet si shqipfolës P+A+L kishte 5100 familje që do të thotë 3900 shtëpie më shumë nga ato ortodokse (shkije) që sipas këtij burimi ishin, 1200 shtëpi ortodokse (serbe).

Përfundim: shtëpi S 1200, JOS 5220

Tabela përmblylëse: Njësisë zonale Prizren

Nën-Njësia	Fshatrat					Shëpitë		Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd
1	4	4	-	-	1	25	125	-	-
2	26	2	-	24	-	14	789	-	1
3	20	12	1	23	-	19	880	1	-
5	40	20	2	22	-	507	1218	1	6
6	16	1	-	15	-	16	428	2	-
7	43	14	12	17	-	1289	857	1	2
8	29	-	-	29	-	-	1562	-	-
9	14	-	-	14	-	-	2825	-	-
10	27	1	-	26	-	-	2825	-	-
11	35	12	6	17	-	392	819	7	2
Qyteti	-	-	-	-	-	1200	5220	-	-
Gjithsej	66	254	21	187	1	3462 17%	17548 83%	12	11

Përmblylje e të dhënave për Zonën e Rrafshi i Dukagjinit

Siç po shihet, në tri nënzonat të Zonës së Rrafshit të Dukagjinit (Metohisë) ne respektoam të dhënat nga origjinali (botim Sanu 2005), edhe pse tani nuk përputhen me njësinë e sotme administrative të kësaj zone të Republikës së Kosovës, përkatësisht të ish Krahinën Autonome Socialiste të Kosovës apo të Metohisë, siç emërtohej në ISH-Jugosllavinë në gjuhën serbe. Ne jemi të vetëdijshëm se disa vise që Milosh Milojeviqi i konsideronte si Prava (Stara) Serbi të kësaj Zone, tani i takojnë Malit të Zi (ish-rrethina e Pejës) e disa të tjera siç është sidomos Malësia e Gjakovës si Luma, Mirdita etj. i Takojnë Shqiprisë, por këtë e bëmë në shenjë respekti të origjinalit, por edhe si fakt për të sotmen e për të ardhmen se cila trevë mendohej se ishte Qendra (Zemra) e Serbisë të

Vërtetë të Vjetër, e cila lypsej çliuar, ngase kjo jo vetëm në Periudhën e Mesjetës paska qenë e përbërë tërësisht nga serbët (!!!), por ajo edhe tani kishte përbërje shumë më të madhe banorësh serbë (serbishtfolës!!!) se JOS (shqiptarë), andaj qëllimi i misionit të Milojeviçit ishte që gjithnjë kjo trevë të tregohet para botës me shumësi serbe, qoftë edhe me falsifikime etj. Mjerisht, nga interpretimi dhe konstatimi i njëjtë i të dhënave edhe nga përpiluesi i hartës, duket se del i qartë po ai qëllim, apo jo?!

Sidoqoftë, siç u pa nga shtjellimi i deritashëm i punës sonë qëllimi ynë është që të pasqyrohet realisht e vërteta rreth përqindjes së djeshme dhe të sotme, përqindje kjo të cilën lexuesi ka mundësi ta shohë dhe ta verifikojë në tabelën përmbyllëse vijuese të kësaj zone:

Tabela e rezultatit të tri njësive zonale të Zonës së Rr. të Dukagjinit: Pejë, Gjakovë, Prizren

Njësia	Fshatrat					Shtëpitë		Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd
Peja	184	31	83	69	2	1778 49	1864 51	14	5
Gjakova	121	17	-	112	2	80 1	6765 99	6	29
Prizreni	254	68	21	194	1	3510 17	16613 83	28	18
Gjithsej	569	114	104	347	5	5368 18	25242 82	48	52

Siç mund të vërehet numri i fshatrave me S në njësinë zonale të Pejës del mbizotërues ndaj fshatrave JOS, ndërsa sa i përket numrit të shtëpive, edhe pse mungon numri i shtëpive nga mëse 50 fshtrave shqiptarë, sipas tekstit me një përqindje të vogël mbizotëron etnia JOS (51%), ndërkaq sa i përket njësisë zonale të Gjakovës mjafton të konstatohet se nuk del asnjë fshat i pastër me S, gjithashtu edhe sa i përket numrit të shtëpive ky identitet del fare në numër simbolik. Sa i përket njësisë zonale të Prizrenit, duket njëfarë laramanie fshatrash e shtëpish, megjithatë, edhe pa i llogaritur shifrat nga viset e sotme të Shqipërisë, si dhe shumë fshatra shqiptarë të paregjistruar, megjithatë shumësia e etnitetit JOS (shqiptar) as që mund të mohohet dot, prin një përqindje realisht jo të vogël që arrin mbi 80%.

Nuk po vazhdojmë me analizë më të hollësisht rreth pasqyrës së mësipërme, por në vijim në titull veçan do të japim disa nga venerimet tona për të tri zonat.

NËNKREU IV

VENERIME DHE SQARIME TË NATYRËS GJUHËSORE E KUPTIMORE RRETH LËNDËS SË TRAJTUAR

Hyrje

Në këtë nënkrye japim disa sqarime të natyrës gjuhësore dhe kuptimore të lëndës nga teksti në shqyrtim shqyrtim. Kështu që në fillim po sjell argumenta plus me disa sqarime të natyrës formale e gjuhësore rreth disa kuptim-sqarimeve e korrigjimeve të emërtimeve nga teksti në shqyrtim, qoftë nga autori, qoftë nga botuesi SANU. Në të vërtetë, ne konsultuam emërtimet e oikonimeve në tërë tekstin dhe gjetëm shkas për disa konstatime, së pari, paksa nga fusha byrotekniko-formale-administrative dhe së dyti, disa gjëra me interes për lexuesin nga fusha gjuhësore terminologjike, më drejt konstatime për emërtime të caktuara:

1) Disa konstatime të përgjithshme formale byroteknike-administrative

Këto vërejtje-konstatime po i përmbledhim në këto tri pika:

1. Kur është fjala e ndarjes në rubrika u përmend numri rendor i përgjithshëm dhe numri rendor i njësisë, përkatësisht i nënnjësive. Ne, konkretisht siç u pa më sipër, u mbështetëm domosdo në numrin rëndor të përgjithshëm, jo në atë të njësisë, ngase ai nuk del i rregullt, madje ka raste që vargu e njësive nga autori del i këputur. Së këndejmi edhe ne gjetëm shkak që për qëllime praktike nga vargu përkatës shkëputën numra dhe sajuam ndonjë nënnjësi të re.

2. Po sqarojmë gjithashtu se autori Milojevic bno origjinal e kishte shënuar emërtimin e toponimit (të oikonimit) në qirilicë, përpunuesi e shënon në latinicë, mbase si lehtësim e sqarim për lexuesit e përdor alfabetin latin, përkatësisht si barasvlerës të versionit anglisht që praktikohet si barasvlerës në tekstin e ripërtërirë anglisht nga botuesi për krejt tekstin shoqëruet të veprës në serbisht.

3. Siç theksohet nga përgaditësi i botimit afro gjysma e emërtimeve kanë pësuar ndryshime (korrigjime) në versionin latinicë në krahasim me atë qirilicë, gjë që e konstatuam edhe ne, madje në këtë

drejtim tash fill në pikën vijuese po japim disa konstatime të veçanta që ngjallin interes.

2) Përplotësime ose konstatime gjuhësore për emërtime të veçanta

E para, edhe pse thuhet nga botuesi se në rubrikën me alfabet latin janë shënuar trajtat e drejta që janë ndeshur në burime të ndryshme zyrtare arkivore e të tjera, ne konstatojmë se trajtat shkrimore të emërtimeve të tilla nuk përputhen plotësisht me tekstin zyrtar në fuqi që ka Serbia sot, sipas listës: *Okruzi, gradovi i sela Kosova i Metohije (Qarqet, qytetet dhe fshatrat e Kosovës dhe të Metohisë)*, që përsëritet në portale interneti, shih edhe më 13.02.2016, tekst ky që ne, në krahasim me tekste të tjera të kësaj natyre, e kemi konsultuar dhe trajtuar mjaft në hollësi në kreun V të veprës *Çështje të shqipes standarde në fushë të emërtimit të vendbanimeve VI, Era Prishtinë 2017*.

E dyta, në rubrikën 7, të listës së emërtimeve dalin disa emra të korrigjuar (qirilicë), ose të sqaruar nga botuesi ku mesa pamë numri i intervenimeve të tilla del në mbi 50 raste (54) dhe shikuar sipas inicialeve të etnive rezultati i intervenimeve del kryesisht kështu:

P1, A6, PA1, L3, P4, PA22, S5, SP9, SA1 dhe SPA1.

Siç po shihet më tepër korrigjime ose sqarim-konfirmime janë dhënë për etninë e shënuar PA (poturë/arnautë) 22 raste, SP (serbë/poturë) 9, ndërkaq A (arnautë) 6 raste. Për shembujt e tjerë numri sillet prej 1 deri në 5 raste. Çdo shembull, varësisht nga këndi i vështrimit, zgjon interes, jo vetëm në raportin shqip-serbisht, por edhe sipas raportit brendapërbrenda gjuhës serbe. Ndonjë rast të veçantë, sipas rastit, do ta cekim gjatë analizës po në këtë punim ose gjetiu,.

E treta, prej afro 300 rasteve që shikuam në të dyja versionet, mund të konstatohet se autori (Milojevic) për shënimin e disa trajtave ishte nën ndikimin e strukture folëse gjuhësore të shqipes ose të informatorëve të kohës, qoftë vendas, qoftë shoqëruar, me të cilët kontaktonte, ngase fjalët herë i shënon në trajtën e pashquar e here në trajtën e shquar, varësisht nga konteksti që përkojnë me natyrën e gjuhës shqipe dhe shumica e këtyre rasteve “korrigjohen” nga botuesi (në versionin latinicë), sipas natyrës së gjuhës serbe nga përgatitësi i botimit d.m.th., përmirësimi bëhet nga z. Vemic, duke i dhënë fjalë-oikonimit përkatës mbaresat e specifikuar të serbishtes së sotme letrare.

Po shtojmë edhe këtë lidhur me shqipen, edhe pse në këtë kohë nuk kishte as shkollë shqipe, as gramatikë të mirëfilltë shqipe, shihet ndikimi i shqipes së folur globale, ngase vitaliteti i kësaj gjuhe me rregullat atavike të standardit të saj global, pothuajse të ravijëzuar qartë në kodin e ligjërimit popullor, i cili njihej nga shumica e etnisë jo vetëm arbanase, por edhe nga ajo që quhej serbe (shkjeve tanë vendës). Së këtejmi, s’do mend që ky ndikim shihet qartë në vetë procesin e të shkruarit të emërtimeve përkatëse, ngase në këtë veprim ndeshim një serë shembujsh ku respektohet, pra, ai rregulli i trashëguar karakteristik atavik, veprues vetëm në gjuhën shqipe, siç është kategoria: shquarje-pashquarje. Kështu këtë ndikim konkretisht e ndeshim të një vistër emrash, shembuj këta që po i japin nga o botues igjinali (vepra e botuar). Në të vërtetë, shembujt jepen në të dyja gjinitë e emri, sipas versionet: *autori/botuesi*.

a. Gjinia mashkullore:

1) Motiçan –Motiçane, Labjan – Labjane etj,
 2) Sedlar/Sedlar, Lez/ Lez, Krajk/Krajk, Kajush/Kajush, Kabash/Kabash, Kosin/Kosin, Zhaç/Zhaç, Pet(ë)rc/ Pet(ë)rc, Kost(ë)rc/Kost(ë)rc etj., - ku emri në gjininë mashkullore bartet në trajtën e pashquar në të dy versionet *autor/botues*, veçori kjo e gjuhës shqipe për këtë gjini, d.m.th. është fjala për emrat mashkullore me konsonant fundor që si trajtë përfaqësuese përdoreshin edhe atëherë, apo jo, zakonisht në trajtën e pashquar (?).

3) Muzhaçi-Muzhaçe, Mikulanci-Mikulance, Selanci-Selance. Lozhani- Lozhane etj., ku fundorja e njëjësit të shquar e shqipes –I, përkon në raste me shumësin e serbishtes, por vetë përmirësimi në serbishte me – E fundore, jep për të kuptuar se ajo trajtë në versionin e parë më tepër kishte të bënte me ndikimin e shquarsisë së emrit të shqipes së folur, sesa me shumësin e serbishtes, apo jo?!

4) Vagov/ Vagovo, ku fundorja me –o e emërtimit, si duket nuk ishte e pranishme në emërvende të atëhershme te ne, madje në të dyja gjinitë e emrit në shqipen popullore të Kosovës Qendrore si dhe të Rrafshit të Dukagjinit e më gjerë, përkatësisht të Serbisë së Vërtetë të Vjetër (!!!), ashtu siç i del pa –O fundore edhe autorit, gjë që jepet me u kuptue ajo trajtë përdorej bnë atë periudhë sipas natyrës së shqipes së vendit, apo jo?.

b. Gjinia femërore:

1) Kleçka- Kleçke, Svarça – Svarçe, Prekopuca – Preko Puce etj.

2) Strbulova –Strbulovo, Papova –Popovo (a/o), Zhdrelja-Zhdrelo (shqiptimi shqip:l/ll) etj.

Siç po shihet, përveç dallimeve o/a, l/ll, rastet me –A fundore, që i përdor autori janë të natyrës së gjuhës shqipe që ishte trajtë përfaqësuese për emrat e gjinisë femërore që në njëjës in e shquar marrin A fundore, ndërkaq ato me –E e –O fundore ishin ose janë të natyrës së gjuhën së sotme serbe, apo jo?!

E katërta, autori kompozitat dygjymtyrëshe i njëfjalëzonte në shkrim, ashtu siç ngjante në shqipen e atëhershme popullorte por që zakonisht ashtu pëdoren edhe sot në shqipen standarde, ndërsa në serbishten e sotme shënohen ndaras: Suhareka/Suva Reka, Suhodol/Suvi Do(l), Vranidoll/Vrani Do, Belopolje/Belo Polje, Belobrdο/Belo Brdo, Dubokipotok/ Duboki Potok, Dobridol/ Dobri Do, Malohoqa/Malo Hoça, Belacrkvа/Bela Crkva etj.

Në të vërtetë, në shqipe fjalët e tilla, njëfjalëzohen, sidomos në rastet, kur gjymtyrat përbërëse të kompozitës janë me kuptim të errësuar, qoftë si fjalë të vjetra shqipe, qoftë të përvetësuar në kohëhapësirë të gjatë jo aq të qarta nga gjuhët e huaja, siç janë edhe shembujt e mësipërm dhe të tjerë që janë praktikuar që edhe sot ende zyrtarisht përdoren ashtu.

E pesta, në këtë grup ndikimi i shqipfolësve shihet edhe në shkrim-shqiptimin shkronjë-tingullit –h-, që në serbishten e mëpastajme, të vendësve sllavë, gjë që vërehet edhe në gjuhën e Milojeviqit, nuk shqiptohet, madje kemi shembuj që h-ja e gojës së shqiptarëve në serbishten e sotme zyrtare me dalë e zëvendësuar me –V ose J. si p.sh. kuhar/kuvar, muhati/muvati, bahorica/bajalica, Muho/Mujo etj. Po e përmend rastin e emërtimit të fshatit që unë e shënova siç e shqiptojmë ne Muhlan, i cili te Milojevici shënohet Movljane, ashtu si del edhe në rubrikën latinicë, të cilën botuesi e sqaron! në trajtën Mahovljanje, d.m.th., përgaditësi i botimit të veprës e përdor H-në si në versionin e shqipes, e cila konsiderohet me të drejtë se është trajtë më e hershme se ajo me V e të folmeve sllave të trevave tona. Mendoj se shënimi me h ose me v apo j si dukuri, kërkon sqarim plotësues edhe nga vetë ekspertët e gjuhës serbe, apo jo?!

E gjashta, si pikë më vete po i trajtojmë disa shembuj me fjalë-trajta shqipe, që nuk janë edhe aq pak:

a) Disa shembuj mund të jenë të diskutueshëm, si b.f. të shënuar nga autori Prbreqe (Pod Breg) në shqipe mbase Përbreg, përbrigje, bregje!), ngase breg ishte siç është edhe sot fjalë e përbashkët nga jeta e

përbashkët e të dyja gjuhëve, sikurse janë edhe jopak fjalë të tjera, si: reka, livadhi (livada), katundi, boka, kërshi etj.

b) Zgjojnë interes edhe trajtat: Buzmakahala (Burrëmahalle!) ose Buzmagaza (buzëmagaze!), Kodralja/Kodralija, Luga /Lug (l/l), Zoq Zoj..., Kotare/Kotore dhe sidomos këto trajta që i ndeshëm në njësinë ku përfshihej Deçani, siç janë oikonimet:

Lukasipra (Lluka e Sipërme)- Gornja Luka (sot Lluka e Epërme,,

Lukaposhtra (Lluka e Poshtër) -Donja Luka (sot Lluka e Poshtme

Lumbarli /Lumbardi që sqarohet me Beli Ljum (Lumbardhi),

Babaloç përkthehet në rubrikën Kd në Otac/blata etj.

Sigurisht kemi të bëjmë me karakteristikë të veçanta fjalëformuese të gjuhës shqipe që zgjojnë interes dhe kjo dukuri meriton trajtim të posaçëm.

Sqarim

Është e vërtetë, se tek ne ende është i gjallë përdorimi në toponimi me mbiemrin përkatës : *i sipërm/ e sipërme* dhe *i poshtër /e poshtër* si gjymtyrë e dytë e oikonimit dhe sidomos kjo fjala e dytë është trashëguese dhe nuk është përdorur me kuptim pezhorativ, por nën ndikimin e letrarishtes që në toponimi rekomandohen të zëvendësohen me trajtat barasvlerëse: përkatësisht f. N. *e Poshtme* ose N. *e Epërme*, përkatësisht m. N. *i Poshtëm* ose N. *i Epërm*, të cilat qëndrojnë si barasvlerëse të serbishtes të tri gjinive gramatikore të mbiemrit përkatës, po ashtu si gjymtyrë emërvendi: *Donje/a/i* N. ose *Gornje/a/i* N. Në të vërtetë, meqë në toponiminë e Kosovës trajta *i/e poshtër*, siç e shënon autori Luka e Poshtër (*Lukaposhtra!*) ndërkohë te ne e përgjithësisht në Kosovë e më gjerë ka marrë kuptim pezhorativ, atëherë zëvendësimi me barasvlerësin përkatës del i obligueshëm. Madje, në Kosovën Autonome në kuadër të Serbi-Jugosllavisë termi i serbishtes Gornji N. u kalkëzua./ N. *e Naltë*, dhe Donji N. në N. *e Ulët*, dukuri kjo ende e pranishme, edhe pse zyrtarja rekomandon, siç e cekëm më lartë trajtat: N. *e Epërme/ i Epërm* apo N. *e Poshtme/ i Poshtëm*. Ç'është e vërteta, jam i njohur me disa raste, si

1) serb. Gornje Dobrevë – shq. Dobrevë e Naltë - Miradi e Epërme.

2) serb. Donje Dobrevë – shq. Dobrevë e Ulët - Miradi e Poshtme.

Qytetarët shqiptarë fillimisht patën ngulur këmbë Dobrevë e Ulët, sepse në popull dilte pezhorativ emërtimi *Dobrevë e Poshtër*. Edhe sot del i

regjistruar ndojë rast si ky Rrafshi i Ulët (Gjakovë), mbase për të njëjtën arsye, apo jo?

c) Siç e pamë në nënnjësinë e parë të njësisë zonale të Gjakovës në asnjë fshat nuk ndeshim popullatë me S as ST (serbë të përzier me etni të tjera). Mirëpo, përveç fjalë-makrotopimit Malësi, në këtë grupim, bien në sy se disa emra të përkthyer ose që sqarohen nga përgaditësi i veprës në serbisht (në rubrikën e dytë), si: Kishaj PA20, i cili sqarohet me fjalën Crkva, Çolifat A5 përkthehet në Suvo Blato. Sigurisht trajta e fjalës është shënuar gabim, ashtu për shkak të mungesës së shqiptimit f/th (-fat /-that). Pra, kemi të bëjmë me emërtimin Lloçi i Thatë (çolifat/loçithat). Pastaj emërtimi Gjonaj PA40 (P10 A30), përkthehet në Jovanoviq (krahaso: Gjon – Jovan). Edhe trajta Kazalgjin?/ (ndoshta Kaza(j/l)gjin) Kazaja e Gjinit!!) del edhe Gjinaj A5, e cila përkthehet në Drenovac(!), ashtu si edhe Zhub PA 7 (P4 A3) përkthehet në trajtën Gubin! Pastaj: Dolan del në trajtën Dolj PA 25 (P15 A10), kurse Gusar korrigohehet në Kusare P12, ndërkaq Moglica L10 përmirësohet në Mogilica! Nuk dimë arsyen pse përforcohet emërtimi Lipovac PA11, mbase kemi të bëjmë me Blinajë a Blinishtë.

ç) Janë nja dy trajta të shumësit të shquar me shkronjën –T fundore, që i ndeshim te rastet: Babatloçit/Baballoç dhe Racajt. Edhe momentalisht përdoren trajtat e tilla të shumësit të shquar, por me kuptim banorësh, mënyrë kjo që assesi nuk duhet të jenë e këshillueshme në shqipen e sotme me u përdorë zyrtarisht si emërtim vendbanimi. Është interesant që edhe në versionin latinicë është korrigjuar si duhet trajta Racajt në Racaj si toponim.

d) Si pikë më vete po përmendin faktin se në të dyja rubrikat bëhet respektimi i trajtës –AJ të shqipes, e cila, parësorisht është prapashtesë e specifikuar për emërtimin e patronimeve në shqipe, por është pëdorur e po përdoret edhe në toponime mbi këtë bazë. Ja disa shembuj nga vepra në shqyrtim: Domaj, Gjinaj, Kishaj, Shipshaj!, Nika/Nikaj, Rupaj/Ripaj-Madanaj, Racajt/Racaj, Bicaj/Bica.

dh) Bien në sy edhe disa emra vendbanimesh me prapashtesa të tjera me –AJË, siç është rasti Firajë-a, d.m.th. me këtë prapashtesë të mirëfilltë, e cila ka të gjitha paradispozitat të specifikohet si formant special për emërtime vendbanimesh të shqipes, Kur fjala temëprodhuese tregon lëndën përkatëse që gjendet ose gjendej me shumicë në atë vendbanim, por për këtë çështje më në hollësi është bërë fjalë në një vend tjetër.

e) Janë edhe dy prapashtesa të tjera -OJ dhe -EJ që i ka ndeshur atbotë autori në përdorim vendbanimesh: Domoj dhe Gjonej, të cilat përmirësohen nga botuesi (përgatitësi) në rubrikën me shkrim latin, me – AJ, përkatësisht: Domaj dhe Gjonaj, për çka lypset përshëndetur përgaditësin e botimit të veprës, ngase po kjo prirje respektohet edhe në shqipen e sotme në fushën e emërtimeve të vendbanimeve.

ë) Edhe pse, për ne del fare e panevojshme pse përkthehet me trajtën Jovanoviq trajta Gjonaj. Krahaso shqip Gjon serbisht Jovan, raste të tilla këmbimi fjalësh, ndeshim edhe në tekste të tjera historike në kuadër të literatures përkatëse në fushë të doktrinës fetare në të dyja këto gjuhë.

f) Po sqarojmë paksa rreth trajtave Kostërc, Kastër dhe emrin e fshatit Kastrat të shënuar nga autori. Kastrati që është emër i një fisi dhe i një krahinëze të dëgjuar nga Shqipëria e Veriut, zakonisht popullsia i takonte konfesionit katolik, prandaj një fshat i tillë në hapësirën e Serbisë, na kujton faktin se në atë fshat mund të ketë pasur banorë shqiptarë (katolikë ose otodoksë), por që tashti, sipas asaj që e shënon Milosh MiIojeviçi, qenka fshat i serbizuar plotësisht. Sidoqoftë, përveç shqiptarëve ortodoksë (poturë) dhe katolikë (arnautë), të përzier edhe me ortodoksë (serbë) mbase shqifolës, kuptohet se në ato vise paskan jetuar edhe katolikë shqiptarë, apo jo?!

Ç’është e vërteta, me sa lexova nga studiuesit është vëretuar se edhe në thellësi të Serbisë së sotme, qysh atëherë paska pasur me qindra familje katolike shqiptare si dhe ortodokse shqiptare deri edhe në qendra urbane e rurale, si në rrethinë të Jagodinës etj., gjë që për një zonë tjetër argumentohet edhe nga Pjetër Bogdani, por që ndërrkohë një masë e caktuar me gjasë ose është dëbuar ose është serbizuar, jo vetëm me ndërrim riti fetar (katolik/ortodoks, por edhe me gjuhë tjetër (shqip/serbisht), apo jo?!

g) Rasti i toponimit Prush i shënuar si vendbanim në dokumentin në trajtim, i cili del i sqaruar me togun Qafa Prushit, na shpie edhe më larg në kohë se trajta kastrat, madje se edhe ajo feja arbanashke, ngase një fjalë e tillë na dërgon tek toponimi Dardani, emërtim më i hershëm ky i Kosovës dhe rrethinës së saj. Në të vërtetë historia e hershme përmend tri shtete me emrin Dardani, të cilat këtu dalin jashtë përmasave të këtij vështrimi, mirëpo, ne patjetër po e cekim faktin se Dardania ilirike, kontatohet se ka ekzistuar si emërtim 4-3-shekuj para e.r., kur edhe u pushtua nga romakët, po që kjo u këndell si shtet 3-6 shekuj më vonë. Fjala dardan darda+ni (si toponim) ndeshet në Tetrakinë e Diklocianit, por që ,

etimologjikisht shpjegohet se rrjedh nga fjala ilire darda, përkatësisht shqipja dardha, që ndërkohë pas pushtimit romak kjo fjalë u përkthye në latinihte prus, ku (S- fundore në shqipe shqiptohet -SH, ashtu siç supozohet edhe përkthimi serbishte të fjala krush(k)a, Andaj fjala Prush, u reflektua nga latinishtja në gojë e shqipfolësve, e cila u ruajt si oikonim me termin Prush, përkatësisht Qafa e Prushit, ku S-ja latine, siç u tha në shqipe reflektohet SH, ashtu si edhe në gjuhën serbe (dardha –krush?k?a) përkatësisht toponimet: Krush/evo, Krushevac, Krusha, Krushica, Krushik(!) që dalin edhe në gojën e shqipfolësve, edhe pse duke e kujtuar fjalën e vjetër *darda/dardha Dardania, aktualisht janë ripagëzuar ose janë rikthye emërtimet toponime, jo të qortueshme: Dardhë-a, Dardhinë-a, Dardhishtë-a, Dardanë-a e Dardani-a e ndonjë tjetër.

Sidoqoftë, rreth kësaj fjale dhe fjalë-termave të tjerë, si arbanion arban arbania/ b/arba e të ngjashme (por jo me kuptim barbar), që i ndeshim në dokumenta të vjetër, janë dhënë sqarime tng studiusit tanë de të huaj.

Sigurisht, nga vepra në shqyrtim mund të diskutohen edhe disa trajta me prapashtesa të veçanta ose të përbashkëta sllavo-shqipe që sot reflektohen me ndonjë ndryshim zanoreje apo bashkëtingëllojeje, po për këto më tepër është paraparë, të preken disa gjera në ndonjë vend tjetër, andaj këtu nuk po zgjatemi më tepër.

Sidoqoftë, nga teksti i oikonimeve shihet qartë se autori i ka shënuar ato nën ndikimin e gjuhës shqipe. Kjo vërehet veç tjerash edhe nga trajta e shquarsisë së emrit shënuar sipas gjinisë përkatëse, kategori kjo, të cilën e ka vetëm gjuha shqipe. Përveç kësaj, bien në sy disa tinguj, që i kanë vetëm emërtimet në gjuhën shqipe, të cilat i mungojnë serbishtes. Është edhe një veçori tjetër, autori kompozitat i shënon ashtu siç janë praktikuar dhe praktikohen të shënohen edhe sot në gjuhën shqipe. Me fjalë të tjera edhe nga këto detaje dëshmohet se shumica e banorëve ishin shqipfolës në trevat nga shënohen këto emërtime.

NËNKREU V

Përplotësim e përforcime rreth disa të dhënave përmbyllëse statistikore

Nga paraqitja e derikëtushme, edhe pse joshteruese, besoj se u kuptua qartë se elementi ortodoks ose serb, faktikisht sipas statistikës që pamë të shënuar nga vetë dora e Milosh S. Milojeviçit, del se nuk ishte shumicë në të tri zonat: Kurshumli, Kosovë Qendrore e Rrafshi i Dukagjinit.

Sidoqoftë, tashti në dy pikat vijuese, duke përsëritur rezultatet e sipërkonfirmuara po tash të përmbledhura në tabela përkatëse, do të japim përforcime plus lidhur me konstatimin që dhamë, lidhur me numrin e fshatrave, si dhe lidhur me numrin e shtëpive sipas etnive.

a) Statistika për numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse

Qyteti	Fshatrat					Shëpitë		Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd
Kurshumlia K.	222	2	99 43	130 57	176	690 23	2230 77	71	-
Qendrore	306	74	71 50	71 50	18	3585 33	7231 67	99	2
Rr i Dukagji.	569	114	105 23	347 77	5	368 18	25242 82	48	52
Totali	1096	119	275 33	548 66	199	9643 22	34703 78	218	54

Siç po shihet nga statistika, sipas numrit të fshatrave në asnjërën nga zonat regjistruese nuk del mbizotëruese popullata ortodokse (serbe).

Shih përqindjen: Kurshumlia S 43% JOS 57%, Kosova Qendrore S 50% JOS 50% dhe Rrafshi i Dukagjinit S 23%, JOS 77%. Ndërkaq totali del: S33% ndaj JOS 66%.

Në të vërtetë, rezultati i numrit të fshatrave sipas etnive del kështu: ST 104 (SA18, SP54, SPA32), S52, JOS 256 (P77, PA 99, A38, dhe L42) fshatra.

Pra prijnë për nga numri fshatrat e përzier JOS poturë e arnautë 99, vetëm paturë 77, vetëm serbë 52, serbë e paturë 54, vetëm arnautë 38, serbë e arnautë dhe serbë, paturë e arnautë 32, vetëm latinë 42, e kështu me radhë, vijojnë shembuj me numër gjithnjë më të vogël dhe gjithsesi me etni të përzier ku dominojnë shqipfolësit. Fundi i fundit si do që të dalë shuma, ajo pothuaj nuk ndryshon numrin e përgjithshëm, nga ajo që dhamë në tabelën e mësipërme, bazuar në statistikën me të cilën shërbehet

autori Milosh Milojevic, të paraqitur nga botuesi, ku fshatrat ose vendbanimet me popullsi JOS kapin shifren 256 (38,77,99,42) ose 83%, në krahasim me fshatrat serbë të pa përzier ku arrin numri 52 ose 37%), ndërsa të përzier dalin 104 fshatra (SA18, SP54 dhe SPA32), por edhe këtu mbizotërojnë shifrat me etni JOS (P, A ose L).

Së këtejmi shikuar edhe nga ky këndvështrim rezultati numerik tregon se në periudhën, 10 vjet para LSHP 1878, shumica asesi nuk ishte sllave, siç thuhet në burimet e caktuara serbe, ku mjerisht, siç do të shohim, del i implikuar edhe z. Mirçeta Vemiq, po është në dobi të palës JOS (shqiptare), madje jo për pak por prin me mbi 200 fshatra të pastër shqipfolës, pa llogaritur fshatrat e paregjistruar me popullsi të pastër shqiptare, siç e pamë konkretisht, që nuk është rast i vetëm, ku 15 fshatra vetëm në nënnjësinë e Therandës (Suharekës) nuk ishin shënuar fare, madje pa i llogaritur fakte tjera, siç ishte edhe rasti, ku në njësinë zonale të Pejës tek afro 50 fshatra nuk ishte shënuar fare numri i shtëpive. Mosshënim ky *i harruar* mbase me apo pa qëllim, le të vlerësohet?! Madje le të vlerësohet edhe veprimi i z. Mirçeta Vemiq, i cili po me këtë statistikë manipulon kështu:

1) S 244 vendbanime dhe plus islamizovani poturi (të të dyja versioneve 239 (P 130 + P109), ishin serbë.

Në të vërtetë, ne ngulmojmë të vërtetën se poturët 239 (të të dy versioneve) ishin JOS (shqiptarë), siç janë të njëjtë edhe sot nga trashëgimia ngase dihet se popullata nga ato vendbanime nuk është shpërngulur). Kështu edhe sipas kësaj paraqitjeje të z. Vemic S 244 ndaj JOS 239 (130+ 109 dalin vetëm 5 shtëpi më shumë serbe se poture (shqiptare).

2) S apo A – (serbë apo arnautë) ose-ose 77 vendbanime (shtëpi) – Edhe te këto 77 vendbanime, sipas nesh, kemi të bëjmë kryesisht me JOS, ngase arnautë e poturë kishin të njëjtën etni.

3) ST33 (SA18, SL15), ndërsa JOS 156 (PA 152 dhe PL 4).

4) ST 28 (SPA22, SAL1, SPAL 5) dhe JOS2 (PAL 2), ,

5) ST 3 (SC1, SPC1, SAC1) dhe JOS 2 (PC1,POC 1

6) Ç 5, PP 8.

Së këndejmi, nëse zërthehet drejt, sipas logjikës së sotme edhe statistika sipas zotit Vemic dalin këto rezultate përfundimtare:

ST 64 (SA18, SL15, SPA22, SAL1, SPAL5, SC1, SPC1 SAC1), S244 JOS 412 (P239,

PA 152, PL4, Ç5, PC1, POC1), PP8 dhe S apo A”ose ose”/ 77,

Sidoqoftë, për të kuptuar të vërtetën rreth gjendjes së përqindjes së etnisë serbe dhe joserbe në trevat që përfshihen në atë vepër-dokument, duhet interpretim i ri real, përndryshe ashtu siç është paraqitur nga z. Vemiq, vepra e tij del joserioze dhe shumë tendencioze. Po ashtu joserioz, siç do të shohim më poshtë nën pikë c) del edhe konstatimi i tij lidhur me numrin e shtëpive për qytetet e mëdha mbi 500 shtëpi, ngase sipas nesh rezultati real është ky:

b) Statistika për numrin e shtëpive sipas etnive për qytetet mbi 500 shtëpi:

Nr r.	Qyteti	Nf	S %	JOS %	(P	A	L	C	O
1	Kurshumlia	2000	-	2000 100	1800	150	-	50	-
2	Prishtina	3270	350 11	2829 89	2600	70	-	-	250
3	Vushtrria	850	250 29	600 71	600	-	-	-	-
4	Peja	1850	550 30	1300 70	1200	-	100	-	-
5	Gjakova	2385	36 2	2330 98	2100	-	129	120	-
6	Prizreni	6620	1200 19	5220 81	4800	2004	100	-	120
	Gjithsej:		2386 14	14279 86	13100	20	329	170	370

c) Vërejtje rreth disa të dhënave pa mbulesë po mbi këtë temë në veprën e fundit të z. Mirčeta Vemić

Meqë vepra e Milojeviqit, siç u cek më sipër, i takon zhanrit të shkrimeve të tipit nacional-romantiko-makiavelist, ku në njëfarë mënyre autorët i lejonin vetes shtrembërime të fakteve në dobi të serbizmit si ideal etj., shprehim habi, pse autori i sotëm i hartës (hartave) z. Vemiq nuk distancohet lidhur me të dhënat me tendencë të tillë nga ajo kohë, por bie edhe vet në makiavelizëm. Me fjalë të tjera, ky autor nuk ka mundur me i shpëtue atij ndikimi, madje bën edhe teprime, ngase i seleksionon dhe i komenton faktet paksa ndryshe se që janë aty, çka na bën me dyshue se shkencërisht vërtet me syhapur ka rënë në pus jo të pastër, ngase është zhytur në të përkrahurit e të së pavërtetës. Ne duke u bazuar në abjektivitetin shkencor dhe duke u mbështetur fort në të dhënat që me

pahir i ka shënuar vetë udhëpërshkruesi (më 1866/67), të cilat i përsërit verbërisht hartuesi i sotëm, në komentimin tone bëjmë pasqyrimin real të gjendjes së atëhershme, por paksa, duke e ndërlidhur me të sotmen e këtyre trevave.

Sidoqoftë, megjithatë ne shfrytëzojmë rastin me i falenderue autorët-hartues për ndihmesën që na dhanë me pahir në të mirë të pasqyrimin të realitetit, duke rishikuar gjendjen etnike serbe/joserbe pikërisht ashtu siç paraqitet numerikisht nga z. Vemic, por me interpretim real, duke shfrytëzuar emërtimet përkastëse të vendbanimeve dhe ertnive dhe në këtë mënyrë ia bëjmë me dije të vërtetën dhe vetëm të vërtetën, jo vetëm opinionit tonë, përfshirë edhe ata që e quajnë sot veten serbë në Kosovë, por njëherazi përpigemi të ndihmojmë edhe autorin Vemiç e opinionin e gjerë në Serbi, dhe të interesuarit e të painteresuarit në Europë e në botë rreth kësaj të vërtete, duke drejtuar gishtin se ku qëndronte atëherë e ku qëndron sot lajthitja ose ai gabimi i qëllimshëm makiavelist rreth Kosovës.

Ne, këtë punë po e bëjmë, pra, me qëllim për të ndihmuar edhe hartuesin e sotëm si dhe interpretuesit e tjerë të veprës në shqyrtim, sepse nga keqinterpretimi i të dhënave të tilla si kjo, duke injoruar gjuhën shqipe si kriter real etnie, jo vetëm janë plasuar e formëzuar koncepte jo të drejta makiaveliste false kundër shqiptarëve në atë vepër e si rrjedhojë gjithandej tek opinioni serbë, në Europë e në botë, gjë që, jo vetëm të mos vazhdojnë edhe më me një propagandim të tillë gafëzues, por edhe ta bëjnë përgenjshtrimin e duhur, në mënyrë që nga gënjeshttrat e tilla mos të bëjnë pavetëdijshtëm viktimizime të reja, qoftë nga njerëzit e thjeshtë, qoftë nga studiuesit përkatës pa tendencë makiaveliste, ku si të tillë konceptualisht, e themi me keqardhje, si duket kanë rënë viktima, mbase pavetëdijshtëm jo vetëm hartuesi, recensuesi, po edhe vetë drejtuesit e SANU-së që kanë lejuar e ndihmuar botimin e kësaj vepre pa vlerësim të duhur kritik paraprak.

Në të vërtetë, mesa parashtruam, si më sipër është realiteti i nxjerrë nga vepra në shqyrtim dhe bëjmë çudi ose nuk mund ta kuptojmë ku ka gjetur mbështetje dhe logjikë zoti Mirçeta Vemić, i cili në një paraqitje botim i fundit (serbisht e anglisht) prezenton harta të risht-hartuara për treva të veçanta përpiluar sipas materialit me të dhëna makiaveliste (të keqinterpretuara nga ai) të mbështetura në gënjeshttra nga vepra e Milojeviqit, madje edhe lidhur me përqindjen serbe/joserbe, jep konstatime, jo vetëm të diskutueshme, por fare të paqëndrueshme, të pabesueshme, realisht e totalisht të rreme. Veç tjerash edhe për numrin e

shtëpive për pesë qytete të mëdha (5 veça gradska nasela), pa shënuar emra, paraqet këtë tabelë: **JOS 92 (A69, L 21 dhe AL 2)**, të cilën nuk mund ta kuptojmë, sepse tek analiza statistikore e z. Vemiq nuk shohim se ka gjëra të vërteta. **Međutim Milojevićevim naseljima, koja su ucrtana i na karti dr Mirčete Vemića, 483 su srpska, 92 arbanaška i 230 mešovutih naselja.**

Ndër pasaktësi të shumta, po veçoj vetëm këto tri konstatime të paqëndrueshme:

1) **Në prag të luftës serbo-turke shihet se serbët në territorin e krahinës së Kosovës e Metohisë ishin shumicë, ndërsa shqiptarët pakicë(!)... (!!!)**

Përgjigje: Shih realitetin regjistruar 1866-67, sipas përqindjen shtëpi/: S 22%, JOS 78%.

2) Që në shikim të parë harta tregon prani më të madhe të serbëve ndaj shqiptarëve në Kosovë e Metohi para afro 150 vjetësh... (!!!)

Përgjigje: Harta e hartuar mbi bazë jo reale, false, prandaj për hir së të vërtetës shkencore vetë autori në bazë të realies duhet ta bëjë korigjimin e konstatimit,ta bëjë përgënjeshttrimin domosdo, apo jo?!?!/. Shih përqindjen reale sipas Milojeviçit: S 22% ndaj JOS 78%.

3) Shihet nga tabela se banorët e qyteteve: Prizreni, Prishtina, Peja, Gjakova, Kurshumlia mbi 90% ishin me etni Serbe... (!!!)

Përgjigje: Shih realitetin me përqindje, sipas vetë regjistrimit nga Milojeviçi 1866-67 (që ne i shtuam edhe qytetin e Vushtrrisë): **Kurshumlia S-, JOS 100%; Prishtina S11% JOS 89%; Vushtrria S29% JOS71%; Peja S30% JOS70%; Gjakova S2% JOS 98% dhe Prizreni S19% JOS 81%.**

Totali: S 14% ndërsa JOS 76%.

Siç po shihet, në tabelën tonë, duke llogaritur 2000 shtëpi JOS (shqiptare) të Kurshumlisë ku autori Milojevic nuk kishte shënuar asnjë shtëpi serbe. Madje në trevën e Kosovës së sotme, në këto 5 qytete kishte 2380 shtëpi serbe apo ortodokse ose 13%, ndërsa shtëpi JOS (shqiptare) kishte 14289 ose 87%, d.m.th. në qytetet e Kosovës kishte 11.909 shtëpi JOS (shqiptare) më shumë nga ato serbe, edhe pse siç e thamë si **shtëpi (familje) serbe janë llogaritur edhe shtëpitë shqiptare të besimit ortodoks**, që mbase fetarisht mund të ishin edhe laramane ose të padeklaruar si shqiptarë, ndonëse brenda familjeve të caktuara ortodokse dihej mirëfilli se si gjuhë komunikimi në numër të konsiderueshëm të

familjeve në qytete e fshatra përdorej shqipja, pra përdorej shqipja edhe pse nuk ishte as gjuhë zyrtare si turqishtja, as gjuhë sakrale fetare, siç ishte serbishtja.

S’do mend se, për statistikën e tillë ne patjetër duhet ta falenderojmë autorin, ndërkaq për keqinterpretim të realitetit të asaj kohe dhe në vazhdimsi, deri në ditët e sotme, duke llogaritur edhe veprimin e z. Mirčeta Vemić (për viktimizimin e tillë) për hartat e fundit, nuk dimë se kujt më shumë mund t’i hedhet faji. Gjithsesi për hartat e tilla ky (z. Vemić) për hir të realitetit, për me shpëtue me fytyrë, duhet të ndryshojë ngjyrat ose të japë përgënjeshttrimin e duhur, duke sqaruar të vërtetën, përndryshe e fut veten ndër falsstudiues që si joserioz, i bën dëm të madh shkencës bashkëkohore serbe, kishës e popullit serb dhe paqetimit ndëretnik serbo-shqiptar.

Lidhur me sa u tha, përgjigje më të plotë dhe më bindëse për këtë dhe për çështje të tjera, do të jepet në vijim me ripërsëritjen e tabelave përkatëse sipas përqindjes dhe gjatë shtjellimit të temës dhe nga përfundimi përmbledhës në përfundim të veprës, por edhe këtu e shohim të arsyeshme të përsërisim rezultatet tash fill në pikën ç).

ç) Tabelat përmblyëse mbi përqindjen e rezultateve

E veçanta e këtij kreu mund përmbliidhet me përsëritje rezultati rreth gjendjes së popullsisë (shtëpive) të tri zonave regjistruese dhe qyteteve kryesore të këtyre zonave në raportin S (serbë) ndaj JOS (shqiptarë):

1) Gjendja statistikore e popullsisë (shtëpive) në tri zonat:

S % JOS %

	S %	JOS %
Kurshumlia	23%	77%
Kosova Qendrore	33%	67%
Rr. i Dukagjinit	18%	82%

Gjithsej 74 ndaj 226 (shuma mbi tri here më e

madhe)

2) Statistika për numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse

Qyteti	Fshatrat					Shëpitë			Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd	
Kurshumlia K.	222	2	99 43	130 57	176	690 23	2230 77	71	-	
Qendrore	306	74	71 50	71 50	18	3585 33	7231 67	99	2	
Rr i Dukagj.	569	114	105 23	347 77	5	368 18	25242 82	48	52	
Totali	1096	119	275 33	548 66	199	9643 22	34703 78	218	54	

3) Gjendja statistikore e popullsisë sipas etnive në qytetet mbi 500 banorë:

Nr r.	Qyteti	Nf	S %	JOS %	(P	A	L	C	O
1	Kurshumlia	2000	-	2000 100	1800	150	-	50	-
2	Prishtina	3270	350 11	2829 89	2600	70	-	-	250
3	Vushtrria	850	250 29	600 71	600	-	-	-	-
4	Peja	1850	550 30	1300 70	1200	-	100	-	-
5	Gjakova	2385	36 2	2330 98	2100	-	129	120	-
6	Prizreni	6620	1200 19	5220 81	4800	2004	100	-	120
	Gjithsej:		2386 14	14279 86	13100	20	329	170	370

Totali: S 14% ndërsa JOS 76%.

Përmbyllje

Në fund të fundit, dua të pyes, po kujt t'ia drejtoj këtë pyetje përveç teje lexues i nderuar: Është e mundur që ky faktfalls, gënjeshërë e kulluar, mbi përqindjen shumicë serbe në Kosovë (1866-1868), 10 vjet para Lidhjes së Prizrenit (1878), të veprojë mbi 150 vjet pa u vërejtur e deshifruar si e tillë nga askush nga përgjegjësit tanë në detyrë?! Mos vallë, ende dikush mendon se **poturët shqipfolës**, vërtet, paskan qenë vetëm serbë të shqiptarizuar, apo jo?!?!

Sidoqoftë, edhe *enigma* rreth **poturëve** bashkë me termat: **shkizma e re, shkja shkini shkitë tanë (ortodoksë)** dhe **shqipo shqiptari**, edhe më do të sqarohet gjatë zbërthimit analitik, në vijim të këtij punimi.

Gjithsesi një veprim i tillë i Serbisë, kuptohet edhe i Vemiqit, me shikue nga interesi i përgjithshëm kombëtar e ndërkombëtar, aspak nuk shërbente në të mirë as paqes në Ballkan, madje nuk i shërbente për të mirë as vetë Serbisë e popullit të saj tash për tash, e cila pasi e kishte humbur luftën më 1999 kishte nevojë për paqe dhe konsolidim të

brendshëm, pasi ajo në të vërtetë ishte çliruar nga barra e kolonisë që si të tillë e mbante Kosovën pothuaj 100 vjet. Madje një vepër e tillë me interpretim të gënjeshtërt si kjo e Vemiçit njëherazi dëmton skajshmërisht imazhin shkencor të vetë SANU-s si institucion shkencor kombëtar pse dha leje dhe e botoi në emër të vet një vepër të tillë e cila mbështetet në statistikë e fakte të rreme fallse, por që fundi i fundit nëse lexohen drejt, siç e argumentuam në kthehet bumerang (grushtakreje) serbombëdhënjeve, ishte kundër programit të definuar nga autoriteti vazhdues i linjes politike të lëvizjes nacional-romantike shoviniste serbomadhe, ngase në vend të numrit shumicë të etnitetit serb siç propagandohej për atë periudhë para Kongresit të Berlinit e deri më sot, e vërteta po del vërtetën po del ndryshe. Pasqyra statistikore e verifikuar tregon shumicë shqiptarët jo serbët në Kosovë e gjithëkëndej e ande, madje kjo shumë del e vërtetuar që nga antika e mesjeta pa marrë çparasysht faktin se si do të jetë quajtur vendi, Dardani, Albani, Serbi, Kosovë, Shqipri. Është e vërtetë se regjimet mbi Kosovën kanë lënë gjurmë ashtu edhe edhe gjuha sllave mbi disa toponime, por sa i përket shumësisë numerike të etnitetit shqipfolës nuk ka dyshim, vetë përpunimi i gojor i toponimeve të administratës tregon këtë realitet. Edhe në pajtohemi me përmbajtjen e Apelit të 142 intelektualëve e studiuesve serbëtë dt. 25.11.2019 që mos t'u bëhet jehonë përkrahjeje qëndrimeve pseudohistorike e motonimike të M. Milojeviqit, përkatësisht mus t'u besohet qëndrimeve të tilla të tij. Që njëherazi ky mosbesim duhet të shtrihet edhe në tre dhënat që jep nga Putopisi rreth numrit të shtëpive, sipas etnive në Kosovë, të cilat janë shfrytëzuar dhe ende po shfrytëzohen aksiomativisht si të vërteta, siç dëshmon e edhe vepra e M. Vmiqiit në shqyrtimin tronë, të cilat u deklasuan me punën tonë, mirëpo jemi të vetëdijshëm se edhe përqindjet që dolën nga naaliza jionë, nuk do të thotë se e paraqitin plotësisht gjendjen e atëhershme reale, sepse numrat janë shënuar nga informatorët pa verifikim, madej siç e pamë për shumë fshjatra me kombësi shqiptare nuk janë shënuar banorët (shtëpitë) ose edhe nuk janë shënuar fare, prandaj përqindja reale mund të jetë nmë ndryshe, por gjithsesi jo në dobi të etnitetit ortodoks serb, madje ajo që është më e rëndësishme poturët shqipfolës, siç treron edhe gjendja e sotme nuk ishin serbëm por shqiptarë/

Sidoqoftë, Milojeviçi krejt veprimtarinë e vet krjuese e studimore e ka kryer gjatë periudhës deri sa Serbia, ishte Knezhëvinë (Principatë), atëherë kur nga Smederva u zgjerua në pashallëk me kryeqytet

Beogradin. Pas Luftës e fitores 1877. 1878 pothuaj u bojkotuan veprat e ti, ngase pas kësaj euforie veprat e tij u vunë në tapetë të kritikës dhe pas kësaj kohe nuk dimë se do të ketë kontribuar me ndonjë shkrimqoftë për të mirë, qoftë për të keq për serbët, qoftë për *shqipët e tij(!)*, siç e cek para përpalljes së *sifjalorthit të tij skip –serbisht* (1873, botuar me shpezime vetjake katër vjet më vonë më 1877).

Në fund të këtij kreu po rumbullakësojmë në katër pika:

ма; ~ Мешовито „или-или“ насеље; С – Срби; П – Исламизовани Срби (Потури); А – Арнаути (исламизовани Арба на си); О – Османлије; Л – Латини (католички Арбанаси); Ч – Черкези; Ц – Цигани; НВ – Наведено 930. 81. Јачиште Jančište 15 П 931. 72. Милановиће Milanović 60 П; А 932. 73. Погаруша Pagaruša 60 П; А 933. 74. Гориће Gorić 30 А 934. 75. Семетиште Semetište 30 П; А 935. 76. Нишор Nišor 35 П; А 936. 77. Крвосерија Kravoserija 30 П; А 937. 78. Добродољан Dobrodeljane 35 П; А 938. 79. Сеник Senik 20 П; А 939. 80. Малишево Mališevo 20 П; А Малешево 940. 81. Караџица Karađica 15 П 941. 82. Љубижда Ljubižda 47 44С; 3П 942. 83. Кориша Koriša 86 36С; 50П 943. 84. Кабаш Kabaš 9 П; А 944. 85. Грајковце Grejkovce 45 10П; 35А Греховце 945. 86. Ђиновце Ђinovce 45 П 946. 87. Муштутиште Mušutište 100 45С; 55П Мушетиште 947. 88. Деловце Delovce 50 30С; 20П 948. 89. Поповљане Popovljane 50 35С; 8П; 7А 949. 90. Дворане Dvorane 46 40С; 6П 950. 91. Саврово Savrovo 15 П 951. 92. Враниће Vranić 35 П; А 952. 93. Мовљане Movljane 42 32С; 10П Маховљане 953. 94. Старавучина Stara Vučina 12 П 954. 95. Речане Rečane 42 30П; 12А 955. 96. Целогражда Selogražde 28 8С; 10П; 10А 956. 97. Љутоглаве Ljutoglave 14 С 957. 98. Цапарце Saparce 24 12С; 12П 958. 99. Гељанце Giljance 15 С 959. 100. Обтеруша Opteruša 131 25С; 106П 960. 101. Злочисте Zočište 65 45С; 20П Зочисте нав: 908 961. 102. Сопина Sorina 52 12С; 40П 962. 103. Лешане Lešane 48 18С; 30П 963. 104. Трње Trnje 12 5С; 7П 964. 105. Пчинадија Špinadija 10 4С; 6Л Дпинадија 965. 106. Новакe Novake 15 Л 966. 107. Вележа Veleža 20 12С; 8Л 967. 108. Непробиште Neprebište 25 П Stara Srbija4.indd 67 tara Srbija4.indd 67 9.3.2005 20:50:20 .3.2005 20:50:20 68 ПОГЛАВЉЕ IV Ред. бр. У св. Назив насеља Савремени назив насеља Број кућа Становништво Примедба № In vol. Name of settlement Present name of settlement № of house holds Inhabitants Remark TABLES OF DATA Legend * Not in contemporary maps; ~ Mixed “or-or” settlement; С – Serbs; П – Islamized Serbs (Poturis); А – Arnauts (islamized Albanians); О – Osmanlis; Л – Latins (catholic Albanians); Ч – Circassians; Ц – Gypsies; НВ – Registered; Без под. – No data 968. 109. Студеничане Studenčane 94 19С; 75П 969. 110. Раштане Raštane 25 6С; 19П 970. 111. Пећане Pečane 30 П 971. 112. Запљужане Slapuzhane 30 П 972. 113. Дуље Dulje 30 4С; 13П; 13А 973. 114. Сухарека Suva Reka 70 24С; 46П Ополски стег / Opolje baryak (flag) 974. 115. Брезња Brezna 100 П; А нав: 1113

975. 116. Бучесело Вуџа 40 П 976. 117. Плавље Plava 70 П 977. 118. Рењце Rence 20 П 978. 119. Капр Капра 30 П 979. 120. Зјум Zjum (Orolje) 30 А нав: 1107 980. 121. Белобрде Belobrod 60 П 981. 122. Брутен Brut 75 П; А 982. 123. Златере Zgatare 50 П 983. 124. Бљач Блјац 45 А 984. 125. Заплуже Zapluže 40 П 985. 126. Брадосан Brodosavce 120 П; А 986. 127. Беглере* 29 16С; 13П 987. 128. Куке Kukovce П; А 988. 129. Косовце Kosovce 32 П; А 989. 130. Плехани* 35 П; А Љубљански стег / Ljubinje baryak (flag) 990. 131. Влашња Vlašnja 10 П 991. 132. Поулице Poslište 20 А нав: 1139 992. 133. Хочазаградска Hodža Zagradска 60 П 993. 134. Белуша Biluša 60 П; А 994. 135. Љубичево Ljubičevo 80 П; А 995. 136. Ешково Ješkovo 35 П; А 996. 137. Лез Lez 20 П 997. 138. Кустендин Kuštendil 20 П; А Куштедин 998. 139. Лесковац Leskovec 4 П 999. 140. Спружа Stružje 45 П; А 1000. 141. Јабланица Jablanica 60 П 1001. 142. Локвица Lokvica 70 65С; 15П 1002. 143. Манастириште Manastirica 48 П 1003. 144. Небребоште Nebregošte 64 6С; 58П 1004. 145. Љубиње Ljubinje 120 С Stara Srbija4.indd 68 tara Srbija4.indd 68 9.3.2005 20:50:20 .3.2005 20:50:20 69 ЗАГЛАВЉЕ IV Ред. бр. У св. Назив насеља Савремени назив насеља Број кућа Становништво Примедба № In vol. Name of settlement Present name of settlement № of house holds Inhabitants Remark ТАБЕЛЕ ПОДАТАКА Легенда * Није на савременим кар та ма; ~ Мешовито „или-или“ насеље; С – Срби; П – Исламизовани Срби (Потури); А – Арнаути (исламизовани Арба на си); О – Османлије; Л – Латини (католички Арбанаси); Ч – Черкези; Ц – Цигани; НВ – Наведено 1005. 146. Речани Rečani 31 1С; 30П 1007. 147. Живјане Živinjane 8 С Живљане 1008. 148. Плањане Planjane 38 30С; 8П 1009. 149. Среца Sredska 80 С 1010. 150. Драјчиће Drajčićе 53 50С; 3П 1011. 151. Мушниково Mušnikovo 75 60С; 15П Шушниково 1012. 152. Стајковце Stajkovce 15 С 1013. 153. Горњесело Gornje Selo 90 75С; 15П 1014. 154. Јажинце Ježince 60 С нв: 507 1015. 155. Севце Sevce 120 С нв: 508 1016. 156. Врбичане Vrbičane 30 С 1017. 157. Новосељане Novo Selo 20 С; П 1018. 158. Дојнице Dojnice 30 С Двојнице 1019. 159. Скорбишта Skorobište 70 П 1020. 160. Грчаре Grčare 30 П 1021. 161. Врбаштица Vrbaštica 50 С нв: 395 1022. 162. Штрбце Štrbce 120 С нв: 392 1023. 163. Беревце Berekce 68 С нв: 394 1024. 164. Готовуша Gotovuša 120 С нв: 393 1025. 165. Драјковце Drajkovce 28 15С; 13П нв: 399 1026. 166. Фираја Firaja 19 А нв: 401 1027. 167. Брод Brod 54 4С; 50П нв: 402 1028. 168.

Семање *Semanje* 16 П; А 1029. 169. Коштањево *Košťanjevo* 35 20П; 15А нв: 403 1030. 170. Вича *Viča* 69 65С; 4П нв: 396 1031. 171. Д. Битиња *D. Bitinja* 44 40С; 4П нв: 397 1032. 172. Г. Битиња *G. Bitinja* 34 8С; 26П 1033. 173. Шушиће *Sušice* 34 30С; 4П нв: 400 Стг Лјумански / *Ljuma baryak* (flag) 1034. 174. Жур *Žur* 120 П 1035. 175. Врбница *Vrbnica* 80 П; А 1036. 176. Добрушт *Dobrušte* 12 П; А 1037. 177. Морине *Morina* 45 П; А 1038. 178. Барловце *Barloci* 30 П; А 1039. 179. Џећи *Dean* 25 А 1040. 180. Шахија *Džahi* 15 А 1041. 181. Прбреће *Podbreg* 30 А 1042. 182. Штићани *Štićeni* 120 80П; 40А 1043. 183. Бица *Bičaj* 120 40П; 80А Бица *Stara Srbija4.indd 69 tara Srbija4.indd 69 9.3.2005 20:50:21 .3.2005 20:50:21 70 ПОГЛАВЉЕ IV Ред. бр. У св. Назив насеља Савремени назив насеља Број кућа Становништво Примедба № In vol. Name of settlement Present name of settlement № of house holds Inhabitants Remark TABLES OF DATA Legend * Not in contemporary maps; ~ Mixed “or-or” settlement; С – Serbs; П – Islamized Serbs (Poturis); А – Arnauts (islamized Albanians); О – Osmanlis; Л – Latins (catholic Albanians); Ч – Circassians; Ц – Gypsies; НВ – Registered; Без под. – No data 1044. 184. Рецепија* 10 А 1045. 185. Гостил *Gostilji* 20 П 1046. 186. Нанг *Nanga* 25 А 1047. 187. Колесњан *Koljesjani* 90 П; А 1048. 188. Имуште *Ujmište* 55 П 1049. 189. Лосња *Ljusena* 70 ¼П; ¾А 1050. 190. Калисе *Kališi* 200 П; А 1051. 191. Радомир *Radomir* 100 П; А 1052. 192. Церени *Sereni* 120 П; А 1053. 193. Пљаштан *Pljošta* 50 П; А 1054. 194. Дода *Doda* 20 П 1055. 195. Шуљани* 35 П; А 1056. 196. Вила *Vila* 60 40П; 20А 1057. 197. Буштрица *Buštrica* 100 П; А 1058. 198. Чаја *Čajlana* 26 П 1059. 199. Бузмакахала *Buzmagaza* 100 П; А 1060. 200. Топољани *Torojan* 20 П 1061. 201. Новасеја *Novo Selo* 100 П нв: 1112 1062. 203. Кокољани *Kokoljane* 40 П; А нв: 1102 Стг Доњи Дукађин / *Lower Dukadjin baryak* (flag) 1063. 204. Мирдита* 100 Л 1064. 205. Бучари* 15 Л 1065. 206. Лођаја* 10 Л 1066. 207. Уроша* 125 Л 1067. 208. Спасија* 400 Л 1068. 209. Маштрикор* 50 Л 1069. 210. Кашинор* 100 Л 1070. 211. Дибрија* 50 Л 1071. 212. Бисакућ* 40 Л 1072. 213. Шија домн * 70 Л Ђон 1073. 214. Ђуђа* 190 Л 1074. 215. Икони* 50 Л 1075. 216. Шећине* 50 Л 1076. 217. Каштени* 200 Л Горански стг / *Gora baryak* (flag) 1077. 218. Шајиновце *Šainovac* 40 П Соколовица 1078. 219. Рапча *Rapča* 120 П 1079. 220. Крстац *Krstac* 110 П 1080. 221. Д. Крстац *D. Krstac* 40 П *Stara Srbija4.indd 70 tara Srbija4.indd 70 9.3.2005 20:50:22 .3.2005 20:50:22 71 ЗАГЛАВЉЕ IV Ред. бр. У св. Назив**

насеља Савремени назив насеља Број кућа Становништво Примедба
№ In vol. Name of settlement Present name of settlement № of house
holds Inhabitants Remark ТАБЕЛЈЕ ПОДАТАКА Легенда * Није на
савременим кар та ма; ~ Мешовито „или-или“ насеље; С – Срби; П –
Исламизовани Срби (Потури); А – Арнаути (исламизовани Арба на
си); О – Османлије; Л – Латини (католички Арбанаси); Ч – Черкези;
Ц – Цигани; НВ – Наведено 1081. 222. Пакиша Paќiša 30 П 1082. 223.
Запад Zapod 40 П 1083. 224. Кошариште Košarište 30 П 1084. 225.
Очикле* 32 П 1085. 226. Бељани Belje 20 П 1086. 227. Оргосте
Orgosta 85 П 1087. 228. Орчужа Orčūša 40 П 1088. 229. Борја Borje
200 П 1089. 230. Црнолево Crnoļevo 40 П 1090. 231. Оришак Orešek
230 П Орешке 1091. 232. Шиштевац Šištevec 150 П 1092. 233.
Крушевац Kruševo 100 П 1093. 234. Глобочица Globočica 30 П 1094.
235. Злипоток Zli potok 120 П 1096. 236. Рестелица Restelica 350 П
1097. 237. Брод Brod 700 П 1098. 238. Баћко Ваќка 60 П 1099. 239
Диканце Dikance 70 П 1100. 240. Млике Mlike 40 П 1101. 241.
Враниште Vranište 73 П 1102. 242. Кукуљани Kukuljane 50 П нв: 1062
1103. 243. Луковишта Ljubovište С; П 1104. 244. Драгаш Dragaš 25 П
1105. 245. Радеш Radeša 50 П 1106. 246. Лештани Leštane 40 П 1107.
247. Опољска Zjum (Opolje) 30 П нв: 979 1108. 248. Ђафа Džafereve
200 П; А 1109. 249. Ђале* 50 П; А 1110. 250. Река* 80 П Реч 1111.
251. Краковиште* 25 П 1112. 252. Новосело Novo Selo 70 П нв: 1061
1113. 253. Брезне Brezna 50 П нв: 974 1114. 254. Ренса* 60 П 1115.
255. Планинке* 256 П 1116. 256. Шутман* 40 П 1117. 257. Станковци
Stankovce 45 СС; 40П 1118. 258. Милачићи* 50 10С; 30П; 10А 1119.
259. Крајићи* 38 8С; 25П; 5А 1120. 260. Палчиће* 50 30П; 20А Stara
Srbija4.indd 71 tara Srbija4.indd 71 9.3.2005 20:50:22 .3.2005 20:50:22
72 ПОГЛАВЉЈЕ IV Ред. бр. У св. Назив насеља Савремени назив
насеља Број кућа Становништво Примедба № In vol. Name of
settlement Present name of settlement № of house holds Inhabitants
Remark TABLES OF DATA Legend * Not in contemporary maps; ~
Mixed “or-or” settlement; С – Serbs; П – Islamized Serbs (Poturis); А –
Arnauts (islamized Albanians); О – Osmanlis; Л – Latins (catholic
Albanians); Ч – Circassians; Ц – Gypsies; НВ – Registered; Без под. –
No data 1121. 261. Хтејичиће* 72 12С; 40П; 20А 1122. 262. Раичиће*
42 12С; 10П; 20А 1123. 263. Љума Ljuma 185 105П; 80А 1124. 264.
Дољништа* 210 20С; 80П; 110А 1125. 265. Кармовик Gramovik 71
15С; 30П; 20А; 6Л 1126. 266. Петковиће Petković 12 С 1127. 267.

Мрсор Mrsor 30 20С; 10А Мрзор 1128. 268. Дубрава* 14 6П; 8А 1129.
269. Крајмирковце Крајмировце 68 40С; 6П; 8А нв: 519 1130. 270.
Браздјани* 30 С 1131. 271. Будаково Budakovo 60 20П; 40А 1132.
272. Вршевци Vrševce 51 6С; 15П; 30А 1133. 273. Радево Radevo 40
С нв: 339 1134. 275. Батуси Batusi 50 С нв: 336 1135. 276. Углиле* 40
С 1136. 277. Доланица* 68 8С; 60П 1137. 278. Пероче* 15 С 1138.
279. Шина* 68 8С; 60П 1139. 280. Послиште Poslište 45 П нв: 991
1140. ПРИЗРЕН PRIZREN.

Kreu II

INJORIMI POR EDHE DËSHMIMI ME PAHIR (1872) I GJUHËS SHQIPE DHE TË VËRTETËS JETËSORE SHQIPTARO-SERBE NË KOSOVË E MË GJERË

Hyrje

Përkundër mohimit të gjuhës shqipe dhe blasfemive nga krerët fetarë e të shovenomakievelistëve serbë e të tjerë, realiteti jetësor shqiptaro-serb trashëgimisht gjatë historisë njihet marrëdhënie e ndërlidhje, pothuaj normale shoqërore gjuhësore deri edhe familjare (martesore e krushqie) të ndërsjella të rëndomta: katolike-ortodokse, muslimane-ortodokse, madje edhe muslimane-katolike-ortodokse. Kështu kanë ndodhur jo vetëm ndërlidhje më të thjeshta baritore, rurale e urbane, por edhe të shtresave të larta shoqërore, fisnike, feudale e mbretërore, nga të cilat, pa përmendur të tjera që i njihet e nuk i njihet historia, po cek vetëm këto katër raste: e para, vajza e Stefan Nemanjes ishte e martuar për Dhimitër Prodonin, sundimtar i Principatës së Arbrit (Krujë), e dyta, Milesh Kopiliqi, fisnik luftëtar (drenicas), vrasësi i Sulltan Muratit, ishte dhëndër Knjaz Lllazarit, e treta, Teodora motra e Vëlk Brankoviçit, shtetar nga Kosova mesjetare (Prishtinë), ishte martuar për fisnikun Gjergj Topia (Durrës), ndërsa në edhe në Itali, djali i Skënderbeut Gjoni II ishte martuara me Erina Brankoviçin...

Na shkon mendja të pyesim, kush ishin në të vërtetë, këta, çfarë prejardhjeje kombësie kishin, cilën gjuhë e kanë përdorur atëherë, ose si janë marrë vesh këta miq e krushkë, kur dihet fakti se populli iliro-arbnor (arberfolës) nuk ka pasur preturbacione shpërnguljeje as më parë as në këtë epokë historike, atëherë po e zëmë se si zyrtare, gjuhë administrative paska qenë praktikuar gjuha greke ose latine apo staroslavenski crkveni jezik (gjuha e vjetër kishtarë sllave, jo e parapëlqyer si standard i serbishtes), po masa e gjerë, bashkëshortët, familjet e tyre në Krujë, Drenicë, Prishtinë, Durrës, në ekzil, vallë, në cilën gjuhë janë marrë vesh?! Dikush mund të thotë serbisht, ndërsa ne jemi të sigurt se atëherë masa ka folur kryesisht shqip (arbnisht), pasi për këtë ka më shumë argumenta, mjafton të nisemi nga realiteti gjuhësor që njohim dikur e sot. Unë njoh faktin se vetëm prindët e mi dhe unë me fqinjët tanë ortodoksë kemi përjetuar këto gjuhë fetare-zyrtare, si: arabo-turqisht, turqisht, nashke-serbisht, serbisht, gjermano-hungarisht, nashke-bullgarisht, bullgarisht,

serbo-frengjisht, serbisht, italisht, gjermanisht, shqip, ruso-serbisht, serbokroatisht, anglisht, por si gjuhë familjeje e gjuhë treve e kemi pasur në përdorim vetëm gjuhën shqipe, apo jo?!

Sidoqoftë, jo vetëm lidhur me këtë, por edhe për marrëdhënie të tjera familjare të asokoshme pagane e gjysmëpagane ndërfisnore e ndërfeudale-shtetërore dhe të mëvonshme shqiptaro-ortodokse (serbe)/romano katolike ose të *shkieve tanë* (ortodoksë shqipfolës bashkëvendës) me muslimanë e katolikë po shqipfolës, qoftë në raporte ndarjeje të së drejtës kanunore, në të ashtuquajturat pleqni pajtimesh të parive ndërfisnike e ndëradministrativo-ushtarake brenda shtetit kolonialist serb në Kosovë ose edhe brenda shtetit të sotëm serb, qoftë edhe rreth raportit të familjeve të thjeshta laramane (mikste) që atëherë para 150 vitesh ishin pothuaj të rëndomta nga tradita, pak ose aspak dimë, sepse mungojnë studime objektive të mirëfillta të paanshme për marrëdhëniet e tilla shqiptaro-serbe (ortodokse). Gëzon fakti, siç njofton studiuesi Aleksandar Popoviq se në Beograd qarkulluaka libri 3 vëllimësh i Petrit Imamit “*Srbi i albanci kroz vekove*” (Serbët dhe shqiptarët ndër shekuj), i cili, si dallim nga shumë libra të tjerë, cilësohet si “një libër i paanshëm rreth jetesës së përbashkët serbo-shqiptare... *ku autori ka provuar të krahasojë raporte të ndërsjella, nga jeta e përbashkët etnike, politike e historike serbo-shqiptare prej ardhjes së sllavëve në Ballkan e deri më sot, dhe të konstatojë veç tjerash se **serbët dhe shqiptarët gati 1500 vjet nuk kanë jetuar pranë njëri-tjetrit, por me njëri tjetrin... në shumë hapësira të Ballkanit...*** (Koha ditore, kulturë, 17.07.2017, f. 22).

Së këtëjmi, si kudo në botë edhe tek ne e në Serbi është absurditet të ngulmohet deri në ekstrem në gjakun e pastër fisnor historik e aq më teper edhe atë fetar/kombëtar të trashëguar gjuhësisht që nga antika, ose që nga përçafimi i fesë përkatëse monoteiste (fe/komb i pastër serb), apo jo? Madje sigurisht teprohet edhe lidhur me përçafimin e ideologjive përkatëse të fryra nga jashtë e nga brenda nga secila bashkësi a shtet, ngase secila fe e ideologji në vetvete ka antagonizma dhe nuk identifikon veçan kufijtë e një bashkësie a shteti, pa pësuar diçka në kohë-hapësirë, por njëherazi assesi nuk bën të mohohet formimi i formacioneve shoqërore edhe si bashkësi-shtete edhe popuj kombëtar, apo jo, ngase janë interesa të tjera politiko-shoqërore që i ndajnë ose i bashkojnë propagandisht bashkësitë përkatëse të veçanta njerëzore, fetare e gjuhësore, sipas gjoja pastërtisë së racave ose me lidhje gjaku të pastër kombëtaro-fetar(!) në periudha të caktuara historike, apo jo?! Mirëpo kjo

ndarje-organizim shoqëror e shtetëror mbi bazë kombësie ose gjuhe nuk duhet të kalojë në urrejtje kombëtare fetare e gjuhësore ndaj një bashkësie tjetër fetare ose kombëtare. Sigurisht formacionet e tilla organizuese ku nuk ka urrejtje e hegjemonizëm po ka mirëkuptim e shtrirjedore për të mirë ndaj të tjerëve, nuk duhet gjykuar si punë e keqe, përkundrazi.

Sidoqoftë, ka shumë argumenta që dëshmojnë bashkëjetesën fetare shqiptaro-serbe ndër shekuj edhe në Kosovë e më gjerë, mirëpo ne këtu po i trajtojmë tre argumenta konkretë përforcues në dy nënkrerët vijues, që dëshmojnë të vërtetën rreth raportit jetësor shqiptaro-serb, përfshirë sadopak edhe aspektin fetar e gjuhësor **në trojet tona e më gjerë**, i cili ose është injoruar e përçmuar apo edhe sot injorohet e minimizohet subjektivisht nga një pjesë e palëve të caktuara, siç ka ndodhur në veprën e M. Milojeviçit e pasuesve të tij, e vërtetë kjo që nëse kuptohet e përmbaret si duhet do të ndihmonte shumë jo vetëm për njohjen e ndërlikueshmërisë së çështjeve nga tema jonë, por edhe do të ndihmonte për paqetimin e sinqertë ndëretnik shqiptaro-serb, aq më tepër kur trajtohen e sqarohen tema si kjo jona që aktualisht zgjon interes. Në këtë kontekst tashti do të trajtohen këto dy tema të veçanta.

Së pari, kush ishin **poturët** (nga vepra M. Milojeviçit 1866), si u evolua, apo jo, ndërkohë emri i tyre si kuptim etnitetit jo vetëm: **potur** serbë / **poturët shqiptarë**, ndaj koncepti i shqiptarëve të islamizuar, por edhe arsyeja pse u zëvendësua atbotë fjala *potur* me atë **turk turq**, si nga ana e shtetit serb, ashtu edhe aq më tepër nga ana e shtetit turk dhe

Së dyti, a ka dëshmi rreth ekzistimit të ortodoksëve, por edhe të poturve shqiptarë gjithandj në Serbi, përkatësisht në viset potenciale serbe të quajtura pjesë e Serbisë së Vërtetë në vitet 1866-1873.

NËNKREU I INJORIMI POR EDHE DËSHMIMI ME PAHIR PËR POTURËT E GJUHËN E TYRE (1866-1867),

Nga analiza dhe shpjegimi që bëme në Kreun I të këtij punimi, mund të themi se shumë gjëra në raportin ndëretnik serbo-shqiptar nga teksti në shqyrtim e përgjithësisht tashmë i kemi të qarta, edhe pse autorët, jo nga padija por më tepër me qëllim makiavelizmi i kishin lënë të pasqaruara drejt. Sidoqoftë, s'do mend, ngase gjithkush sot e di, se **latinët**, të shënuar si etnitet më vete nga M. Milojeviçi, siç u konstatua në fillim të kësaj pjese të punimit, pa mëdyshje vetkuptueshëm pranohet edhe nga autorët që

realisht ishin shqiptarë. Prof. J. Drançolli (Revista Drini 25.08.2018) veç tjerash sqaron se nocioni "latin latinët" në Kosovë paraqitet si kategori socio-ekonomike, etnike dhe fetare, qysh atëherë kur në rrethe të Prizrenit identifikohen si romano-latinë (katolikë). Kështu sqaron autori se latinët si katolikë shqiptarë njihen si kategori e veçantë etnike e fetare që dalloheshin nga shkizmatikët serbë dhe **arbërit ortodoksë** (kuptohet shqipfolës). Njëherazi dhe në ndërlidhshmeri me latinët si katolikë shqiptarë (edhe pse sipas autorëve Vemic e Milojevic latinët e Janjevës konsedorohen serbë të latinizuar), disi ashtu mjegulisht shpjegohet edhe etniteti tjetër *Arnaut, të cilët mund të ishin katolikë shqiptarë të islamizuar*. Dhe, ç'është e vërteta, *Arnautët*, sipas milojeviçëve, shpjegohen se mund të ishin ose edhe ishin: *latinë të turko-shqiptarizuar* ose *serbë të shqiptaroturqizuar (!)*, por megjithatë si nënhije mund të konstatohet edhe sipas autorëve të tekstit, përgjithësisht nuk mohohet se edhe etnia *arnaute* vinte nga katolikë (latinë shqiptarë) të islamizuar, apo jo?

Sidoqoftë, sa i përket saktësisë rreth latinëve të malësive, ashtu si edhe arnautëve, të cilët, sipas milojeviçëve, mund të konsideroheshin, sipas konceptit të sotëm kombëtar, vetëm **shqipë-shqiptarë** me prejardhje latine (katolike), ne shprehëm rezervë të ligjshme, por për mendimin tone shtrohet një pyetje edhe më seroze: *Si qëndron çështja e të ashtuquajturve poturë në raport me serbët në njerën anë dhe arnautët e latinët si dhe shkiët tanë të vendit (ortodoksë serbë shqipfolës, në anën tjetër?*

Poturët, sipas veprës në shqyrtim jo vetëm në Serbi, por në veçanti këta në Kosovë (Prava Stara Serbi) të gjithë konsideroheshin serbë, andaj në statistikën e autorëve: Milojeviq, Vemiç e ak. Stojançeviç, llogatiten si serbë, gjë që sipas nesh dhe sipas realitetit nuk ishte aspak e vërtetë. Ne përveç asaj që kemi argumentuar në kreun I, për çka kaluan dekada dhe nga askush nuk pati reagim përgenjshtrimi, megjithatë tani do të përforcojmë atë që kemi thënë më parë, madje duke shtuar edhe ndonjë argument tjetër plotësues.

Siç e pamë në Fjalorin e Bashkimit (1908) fjala "**patur**" shpjegohej: *ai që e braktisë fenë e të parëve*. Po mund të lindë pyetja cilën fe të të parëve e braktisë poturët nga teksti i veprës në shqyrtim? Sipas ndonjë logjike, te ne, feja e të parëve të **paturëve tanë** (shqiptarë) si fe kristjane mund të ketë qenë vetëm **feja katolike(!)**, ndërkaq sipas logjikës serbe *poturët* e kishin braktisur vetëm **fenë ortodokse pravosllave (serbe) (!)**, andaj të gjithë ortodoksët ose të krishterët e këtyre trevave, sipas tyre, kanë qenë vetëm serbë(!?). Dhe pikërisht supozimi i fundi, sipas

studiuesve serbë, përkatësisht nga autorët e tekstit në shqyrtim, del i përforcuar propagandisht si e vërtetë absolute. Ne në kreun e parë të punimit nuk u dhamë të drejtë absolute autorëve, Milojeviç, Vemiç e ak. Stojançeviç dhe pasuesve të tyre, t'i quanin *poturët* (e trevave tona e më gjerë *serbë të islamizuar*!), vetëm pse supozohet se i paskan takuar dikur fesë ortodokse, por nuk e kundërshtuam fort faktin, ngase edhe sipas burimeve ose gjurmëve që paraqiteshin në tekst, ata mund t'i kenë pasë takuar me shumë gjasë fesë ortodokse, madje meqë i takonin po atij riti fetar, edhe mund të jenë quajtur serbë, por ngulmonim siç ende vazhdojmë me bindje të plotë që ata nuk kishin qenë familjarisht ortodoksë serbishtfolës e as prejradhjesisht serbë asnjëherë, ngase, sikurse e pranon dhe çuditet M. Milojeviçi që ata si ortodoksë po flitnin shqip. Madje, sipas tij *kishin qenë dhe ishin serbë* dhe lidhur me këtë merr si bazë faktin pse ata i festonin në gjuhën shqipe festat fetare serbe-ortodokse, si *Bozhiqin* edhe *Shën Premten*”, siç e thekson autori: “*sveti Petka slave na shkipskom jeziku*”/ *Shën Parashqevinë (Premte) e festojnë në gjuhën shqipe*/ e jo në gjuhën serbe, pasi sipas tij edhe nga kremtimi i tillë kuptohet se këta paskan qenë dhe ishin vetëm *serbë të pastër “čisti srbi”* (dhe jo *arnautë* me prejardhje katolike), gjë që as ne nuk e kundërshtojmë sa i përket bazës fetare, por e kundërshtojmë pikërisht mbi bazë të prejardhjes etnike dhe të gjuhës shqipe që e përdorte bashkësia e tillë, siç e pranon edhe vetë M. Milojeviçi, apo jo?!

Sidoqoftë, ne pikërisht nga kremtimi i tillë, siç e pranon, pra edhe Milojeviçi, nxjerrim përfundimin se *poturët* e quajtur sipas tyre **serbë**, nuk kishin qenë kurrë kombëtarisht serbë, po shqiptarë, që i kanë festuar jo vetëm **Shën Premten (Sveti Petka -Shën Parashqevinë)**, por edhe **festat e tjera ortodokse përfshirë edhe Bozhiqin** ose Pashkën e Vogël, si festa të veta, shoqëruar edhe me fjalë shqipe dhe për këtë të fundit sa për ilustrim po mjaftohemi me shprehjen e njohur kudo ndër ne e më gjerë:

Bozhiq, Bozhiq...

Baj dru e digj;

Bluej e gatuej;

Rri e mos luej!...

Pra ky është ai fakti i qindpërqind që identifikon shqiptarët, përkatësisht shkietë tanë ose ortodoksët vendës shqipfolës të këtyre trevave të cilët sidomos në ditët e ftohta të dimrit i shqiptonin, siç i shqiptojnë edhe sot vargjet e tilla të mbetura pothuaj si lojëfjalëshe, si shoqëruese të festave të veta pagane ose të ish festave të veta fetare ortodokse që i kishin të

përbashkëta që i kremtonin, pra *shkipski* sipas shenjtërve ortodoksë të shenjtëruar, qoftë nga Patrikana, qoftë edhe nga vetë Kisha Sllave (Serbe), apo jo?

Lidhur me këtë, edhe pse diçka e kemi thënë më përpara, madje dhe do ta përforcojmë edhe në kreun tjetër e në vazhdimësi, megjithatë e shohim të nevojshme ta përsërisim faktin me qëllim përforcimi se edhe tek arbnorët në trevën tonë kristianizmi ishte përhapur që në antikë. Këtë përforcim e bëjmë, jo aq për studiuesit e vërtetë e me përvojë, por për masën e gjerë, sidomos atë naive serbe e shqiptare, pasi fetarisht poturët supozohet jo pa të drejtë që mund të ishin edhe katolikë, por për masën lidhur me kohëhapësirën që po flasim konkretisht mund të themi me plot gojë që sipas veprës në shqyrtim më tepër ishin të ndërlidhur subjektivisht domosdo me ortodoksinë si fe kristiane të cilën e kishin të përvetësuar tradicionalisht shqiptarët e këtyre viseve shumë më përpara, sepse pothuaj të gjithë ose shumica e shqiptarëve autoktonë, ashtu ndërkohë si edhe serbët ardhacakë që në mesjetë, të cilët, si me thënë, e kishin pranuar kristianizmin nga shqiptarët, përkatësisht së bashku e përqaftuan edhe ritin ortodoks, ngase gjeografikisht, përkatësisht administrativisht i takonin *shtetësisë* së Perandorisë Lindore - Bizantit me qendër Konstantinopojën e jo asaj Perëndimore me qendër Romën. Lidhur me këtë, edhe pse dihet, po shtojmë edhe këtë të vërtetë. Para ose me ndarjen e Perandorës Romake në atë Perëndimore dhe në atë të Lindjes (Bizantit) studiuesit konstatojnë që njerëzit e tillë në viset tona (si dardanë - arbnorë) dhe në fqinjësi nga jugu e perëndimi si arbnorë- epirotë, ndërsa i takonin fenë ende pa ndarë në dy ritet e njohura kristiane zyrtarisht mund të jenë quajtur fillimisht *grekë*, *sllavoserbë* ose *sllavobullgarë*, por edhe *latinë e rumunë* varësisht nga gjuha e liturgjisë që praktikohesh ose sipas kristianoemërtimit të vend-trevës ku banonin e ndërkaq pas ndarjes definitive së kishes kristiane kryesisht sipas "*shkizmës së madhe*" në *katolike /ortodokse*, është krejt e natyrshme për kohën që ortodoksët këtej nga veriu ose lindja, varësisht nga gjuha e liturgjisë së trevës ose varësisht nga gjuha e zyrtare e sundimtarit mund të jenë quajtur edhe bullgarë, serbë ose rumunë, ndërsa andej nga jugu grekë (helenë, arabë, egjiptianë), sepse fatkeqësisht shqipja nuk ishte përzgjedhur si gjuhë liturgjike sakrale, edhe pse nuk mohohet realiteti se pikërisht parashqipja pellazgo-ilirishte ishte ajo që ushqeu edhe greqishten, madje edhe latinshten e gjuhë të tjera, madje sipas historianit gjerman Gottfried Schramm (1929-2017), duke e lidhur prejardhjen e shqiptarëve nga *besianët*, të cilët jetonin në trojet e

Dardanisë, ata shumë para ardhjes së sllavëve (shekulli VI) kishin përquafuar ortodoksinë dhe në lutjet e fetare paskan i përdorur gjuhën e tyre *besiane (shqipe)*, (Shih: *Koha ditore*, 14.09. 2019 f.33 dhe 36.), por si duket ndërkohë kisha shkizmatike sllave nuk u la gjurmë. Mirëpo, po në këtë vazhdë nga arkipeshkvi katolik **Pjetër Bogdani**, mësojmë se në të ashtuquajturën Sherbi (Servi –servire me shërbye sherbim) përveç shqipfolësve katolikë që i takonin **fesë arbanase “arbanashke vere”**, gjë që e dëshmoi edhe z. Dom Lush Gjergji, më 21.08.2019 (Seminar...38), ekzistonin shqipfolës që i takonin fesë shkizmatike serbe. Ta kemi të qartë se atëherë quhen serbë vetëm pse jetonin në zonën e quajtur Serbi nga servos gr, shërbyes, ngase fjala serb nuk e kishte kuptimin njënacioanal, siç e mori gjatë periudhës së *preporodit*, rilindjes serbosllave në shekullin XIX.

Sidoqoftë, sipas studiuesve të deritashëm konstatohet se shqipfolësit e Dardanisë Ilirike në jetën e gjallë, edhe pse ndërkohë joliturgjike, e përpunuan gjuhën e vet, d.m.th. të ligjëruarit popullor mbi atë bazë iliro-thrako-besiane (shek. III-X), e cila vazhdonte të përdorej, si me thënë, në komunikim si gjuhë e koinezuar, e cila edhe u cilësua ndërkohë si gjuhë mbizotëruese arbnore e masës popullore (Shih për këtë edhe te studiuesi Vedat Shehu, internet 9.12. 2018). Së këtejmi, edhe pse identifikoheshin me emra të ndryshëm, ata më fort jashtë sferës së mbyllur rajonofetare e administrative komunikonin me gjuhën e përditshme të veten, andaj vështruar nga sfera fetare-pushtetore, siç u tha, edhe pse kemi të bëjmë me të njëjtën etni gjuhësore, për shkak të shtrirjes së gjerë gjeografike të tyre, si popull i ndeshim të emërtuar me emra të ndryshëm, qoftë sipas trevave të caktuara gjeografike, qoftë me emra të ndryshëm varësisht nga sundimtari a *administrata* (fetare). Kjo ka ngjarë pra jo vetëm në viset nën pushtetin a ritin sllav (bullgar, përkatësisht serb), ku shqiptarët festat i kremtonin në gjuhën e vet (*shkipski*), por edhe në ato vise ku praktikohesh jo vetëm riti greko-bizantin, por sidomos edhe ai katoliko-latin, ku lutjet shqipe supozohet se kishin gjurmë më të theksuar në të shprehurit në arbnisht në krahasim me ritin sllavo e greko ortodoks me ndikim nga qendra brenda shtetit paraosman e osman.

Sido që të ketë qenë, po ritheksojmë faktin se është e vërtetë që për asimilimin e etnisë arbnore të kohës para e gjatë kohës së renesancës europiane në viset e caktuara edhe më tepër se Patrikana greke, ka influencuar ortodoksizmi pravosllav serb (që nga S. Nemanja), ngase që atëherë pasi Nemani e tradhëtoi katolicizmin, madje S. Dushani privoi

babain e tij, për pushtet, andaj si rrjedhim regjimi i tij paraqitej shumë agresiv për katolikët, bile edhe më i rrezikshëm heshtazi për arbnorët (shqipfolës) ortodoksë të trevave tona verio-lindore të ritit helen (grek), të cilëve u zuri frymën spontanisht e qëllimisht më vonë me të servuarit e sllavishtes së konsoliduar (nga Qirili e Metodi), si gjuhë kishtarë atbotë, por që në mënyrë të veçantë edhe nga pansllavizmi ortodoks, i cili u sforcua gjatë sundimit të Pushtetit Osman, ngase kishte marrëveshje veprimi e në veçanti u theksua ndërkohë gjatë *preporodit* (rilindjes serbe) me përkrahjen e Rosisë cariste. Kjo dëshmohet si kudo gjithandej e vende-vende edhe sot, ku shtrihej ajo kishë sllave si, në Kosovë, Shqipri të Veriut, Maqedoni, Mal të Zi, Bosnjë-Hercegovinë e gjetiu, ku që nga atëherë mban organizativisht si gjatë sundimit turk, edhe tani, punktet e tilla aktive ashtu, të cilat përpiquej, siç përpiqet t’i përfocojë edhe aktualisht. Në të vërtetë atëherë, elementi joserb (shqiptar) në principatën e sapoformuar serbe (shek XIX) si edhe më parë i ndjente ato presione të *preporodit*: ose *duhej të pranonte asimilimin e plotë në serbë ose do të gjente njëfarë shpëtimi shpirtnor si dikur nga bogomilizmi apo tani edhe nga islamizimi*, ku sadopak kjo masë mund të ruante si identitet gjuhën e vet shqipe, apo jo?! E themi “*shpëtim shpirtnor nga islamizmi si fe e jo si shpëtim*” nga mbrojtja e shtetit turk, sepse e themi me plot gojë, shteti turk në atë periudhë, siç tregojnë faktet, ka qenë në armiqtësi me shumicën e shqiptarëve muslimanë, ngase, si edhe vetë arabët (islamikë) e të tjerë, edhe shqiptarët (muslimanë e të krishterë sidomos katolikë) shpreheshin kundër reformave të tanzimatit, duke ruajtur e kërkuar edhe më tepër vazhdim lirie e autonomi vetëqeverisëse në trojet e tyre, apo jo?!

Prandaj, kështu në këso rrethanash pati lindur apo u shpeshtua ndërkohë edhe *paturizmi i shqiptarëve* ortodoksë në trevat në shqyrtim, por njëherazi edhe sllavizimi ose *shkienizimi i shqiptarëve ortodoksë*, jo vetëm në viset e Kosovës, por edhe më gjerë edhe në viset e përziera me serbë deri në Smederevë e në Pashallëkun e Beogradit, ku ortodoksizmi pravosllav vinte gjithnjë duke u përforcuar si pjesë e nacionalizmit serb dhe kështu duke u ravijëzuar njëanshëm edhe si element shteti, sidomos në Smederevë e Beograd, ku emri serb merr konotacion të ri kombësie, ku iu bashkua edhe një pjesë e dukshme e ortodoksëve arbnorë (shkije), siç do të sqarohet në kreun vijues, por ka dëshmi që një pjesë e tyre ishte e pranishme dhe faktikisht njihej edhe atje si *poturë shqiptarë*.

NËNKREU II

DËSHMI RRETH EKZISTIMIT TË ORTODOKSËVE POR EDHE POTURËVE SHQIPTARË GJITHANDEJ NË VISET POTENCIALE SERBE PARA VITIT 1866

Kjo dukuri e ekzistimit të elementit ortodoks shqiptar dhe e procesit të poturizimit të tyre në viset potencialisht të quajtura serbe del mjaft qartë i trajtuar në disa burime (siç ishte edhe ai i prof. Drançollit), por ne këtu do të ndalemi vetëm në dëshminë e dy autoriteteve të njohura të kulturës serbe: së pari, nga Vuk Karaxhiçi dhe së dyti nga Milosh Milojeviçi. Që të dy janë ballafaquar edhe me të shkruarit e gjuhës shqipe, i parë, duke shënuar disa këngë folklorike shqipe, ndërsa i dyti, duke shënuar jo aq lëndë folklorike po, një këngë. Kënga e Kumonës dhe dy vjersha ngucakeqe (lojëfjalësha), të cilat i përkthen, por më tepër ka kontribuar me sajimin e një Sifjalorthi prej afro 350 fjalësh e shprehesh shqip - serbisht, të cilin për të parën herë do ta prezantojmë para opinionit në kreun e fundit të këtij punimi.

Ja tani dëshmitë si argumenta të parrëzueshëm rreth ekzistimit të shqipfolësve ortodoksë të poturëzuar gjithandje, në shekullin XIX.

1) Dëshmi nga Vuk Karaxhiçi

Sidoqoftë, po ashtu si Pjetër Bogdani (shkrimtar shqiptar katolik) më herët, ashtu edhe Vuk Stefan Karaxhiçi (intelektual i shquar serb ortodoks) më vonë, ndihmon sqarimin e çështjes të sapocekur prej nesh lidhur me ortodoksët shqiptarë, gjithandje e gjithkëndej, në Arnautllëkun Verior (tash Serbi e Jugut).

Në të vërtetë, siç u cek më lart, Pjetër Bogdani (1635-1689), duke shërbyer deri edhe si arkipeshkv i kishës katolike në Arbni e Serbi, tre vjet para se ndërronte jetë më 1685, shpreh këtë dëshirë të zjarrtë për ta botuar librin, në mënyrë që kur të kthehet këndej (në Arbëni e Sherbi) « ... të keshe një qiri ndezunë në dorë për të ndritunë të vobek dhe t' Arbënit dhe të Sherbisë, i silli e madhe pjesë flet arbenisht ... ». Kjo më së mirë vërteton se në *Despotatin e i Sherbisë* (Arnautllëkutn Verilindor) shqiptarët ortodoksë arbërishtfolës shkizmatikë me katolikë kuptohet se ishin shumicë, të cilët serbët për automazi fenë katolike e quanin **arbanashka vera (fe arbanase)**. Kjo është provë e fortë që nuk mund të

mohohet dot, mirëpo prania e ortodoksëve shqiptarë gjithandej pohohet edhe nga vetë Vuk Karaxhiqi (1787-1864). E kemi fjalën për gjendje disa vjet para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit 1878. Siç dihet V. Karaxhiqi, formues i gjuhës së shkruar letrare serbe dhe një ndër themeluesit e kombit serb mbi bazë të fesë ortodokse të ritit sigrek (pravosllav), thuhet se asnjëherë nuk ka qenë në trevën e Kosovës së sotme dhe kjo, siç ankohej ai, ndoshta për mungesë leje-qëndrimi nga administrata turke. Mirëpo, faktohet e vërteta, përveç pagëzimit të emrit Vuk (sipas shqipes Ukë) se ai gjithsesi kishte pasur kontakt dhe e njihte fort mirë deri edhe psikologjinë e etnisë shqiptare, përveç asaj, muslimane, katolike edhe ortodokse shqipfolëse në treva të të caktuara serbo-shqiptare, si të ishte rritur e jetuar me ta. Edhe pse thuhet se Vuku nuk do ta pranojë prejardhjen e tij iliro-shqiptare, megjithatë për që ai njihte mirë shqiptarët dëshmohet jo vetëm pse mblodhi një material folklorik disa këngë popullore shqipe, por aq më tepër këtë e dhlshmon me këto dy sekuenca, nga të cilat mësojmë edhe për raportin e konceptimit të dallimit ose të afrimit të *poturëve serbë*, në ato vise aso kohe, në krahasim me *poturët arnautë* (shqiptarë), kuptohet jashtë Kosovës së sotme, ku kishte shqiptarë:

E para, sipas studiuesit K. Gjinaj, *Shqiptarët ndër shekuj* (Radio Drenasi, 02.04. 2010) Vuk Karxhiqi, lidhur me raportin ndërnjerëzor e ndërftetar të shqiptarëve theksonte:

Arnautët (shqiptarët) që janë të ritit perëndimor, dhe mund të jenë edhe të atij lindor, dhe që të gjithë thirren shqiptarë mund të themi se mesveti fare pak vërehen, ndërkaq, para të huajve sillen si vëllezër si të ishin të një riti. Kështu një i ritit turk (musliman) për një të krishterë do të mbyste dhjetë turq dhe po ashtu një shqiptar i ritit të krishtenë do të vriste dhjetë italianë për një shqiptar të ritit turk (musliman)...

E dyta, konstatim ky, i nxjerrë nga interneti prej nesh:

(Arnautski) poturčenici ostanu bez ikakve razlike od ostale braće svoje...

(Paturët... (shqiptari i islamizuar) ndaj vëllezërve të vet të tjetrës fe nuk vërehet fare (familjarisht)", përkatësisht "Shqiptari i poturëzuar nuk dallohet fare nga vëllezërit e vet ortodoksë apo katolikë".

Së këtëjmi, siç do të shohim, si nga sqarimet e të tjerëve dhe sidomos nga këto dy parafrazime (pohime) në bazë të V. Karaxhiqit, mund të nxjerrim jo pak të vërteta për ekzistimin e ortodoksëve shqiptarë ose të shqiptarëve

që jetonin veçan ose në familje laramane ose të përziera të krishtera/muslimane dhe për gjendjen e tyre brenda trevave të Serbisë së sotme e më gjerë, ndër të cilat (si të vërteta të pamohueshme) po përmendim:

Së pari, shqiptarët, pa marrë parasysh se si quheshin nga të tjerët ata atbotë paraqiteshin si entitet unik (sikomb a kombësi) me tipare të veçanta kulturore etnike psikologjike e gjuhësore të ravijëzuara, që kuptohet se i bashkonte (identifikonte), veç tjerash, ekskluzivisht gjuha shqipe, jo feja.

Së dyti, pohohet katërcipërisht që shqiptarët paskan qenë të shtrirë thellë gjithandej në Serbinë e sotme, të identifikuar, qoftë si ortodoksë ose si katolikë, duke pasur në gjirin e tyre edhe *paturët e vet muslimanë (arnaute poturçenike)*.

Së treti, të gjithë shqiptarët nuk paskan qenë pra të konvertuar në islam, por vetëm disa, me gjasë vetëm formalisht, edhe nga e njëjta familje, por ata të konvertuarit si poturë nuk qenkan urrejtur fare nga “vëllezërit e vet ortodoksë ose katolikë”, ngase me ndryshimin e fesë, siç kuptohet qartësisht, ata nuk kishin ndryshuar pothuaj asgjë, as gjuhën, as fisin, as vetëdijen etnike, as zakonet e traditë, veshë e mbathë, andaj nga vëllezërit e vet të së njëjtës gjuhë e etni nuk dalloheshin fare, nuk quheshin tradhtarë sikurse b.f. serbët e islamizuar “*poturçenici srbi*” që, siç kam lexuar në burime të caktuara, ata, në periudhën për të cilën po bëjmë fjalë, nëse nuk riserbizoheshin automatikisht, konsideroheshin: *izdajice srpske države, jezika i crkve, svoje pravoslavne (srpske) vere*, pra, quheshin: *tradhtarë të shtetit, të gjuhës dhe të fesë së vet pravosllave serbe*.

Së katërti, nënkuptohet që shqiptarët, qoftë ortodoksë, mbase edhe katolikë e muslimanë, nëse dikush prekte ose përçmonte identitetin ose nderin e tyre fisnor familjar sikombëtar, ata pa dallim feje ishin në gjendje të reagonin sikombëtarisht, të luftonin kundër turqve (muslimanë), ashtu si edhe kundër të krishterëve italianë apo kushdoqofshin ata, kuptohet edhe kundër serbëve (sllavë).

Së pesti, nga sa u cek, duhej nënkuptuar e vërteta, se shqiptarët ishin të gatshëm të sakrifikoreshin për çlirimin e tyre nga zgjedha e huaj, andaj, siç e cekin historianët, disa qarqe të tyre disa herë kishin kërkuar mirëkuptim edhe nga serbët si aleatë në luftën e armatosur për çlirim kundër otomanëve (bushatlijtë, zogollët, boletinët), mirëpo, meqë serbët disa herë jo vetëm nuk u deklaruan në favor bashkëpunimi, por, përkundrazi, ato përpjekje i shfrytëzonin dinakërisht e drejtpëdrejt, duke i

denoncuar e keqpëdorur idealin e tyre shqiptar, atëherë shqipfolësit jofanatikë të tri feve, gjithnjë e më tepër e ndien veten të tradhëtuar nga ana e serbëve. Ç'është e vërteta, në këso situatash shqiptarët nuk mund të ishin edhe më entuziastë e aktivë si pjesëmarrës në anë të serbëve si b.f. kishin qenë në Kryengritjen e parë serbe (1804) e në Çlirimin e Beogradit, për shtetin e ri serb, i cili sapo po u formua doli në kurriz të tyre, andaj *shumica e poturëve shqiptarë bashkë me vëllezërit katolikë, pa përjashtuar edhe vëllezërit ortodoksë*, natyrisht pasi ishin të zhgënjyer me sjelljen e serbo-shkieve të pabesë, filluan të mbanin qëndrim neutral, përkatësisht gjithsesi jofavorizues, madje edhe armiqësor, ndaj shtetit të ri serb, sidomos atëherë, kur filluan edhe represaljet e dëbimi me zjarr e hekur nga shtëpitë e trojet i tyre, të cilat tash serbët i konsideronin si pasuri potenciale serbe (plaçkë lufte), atëherë pati edhe ndonjë gjest apo përpjekje mbrojtëse spontane nga ana e disa shqiptarëve, po gjithsesi të paorganizuar, që më shumë shtonin panik e zhgënjim se shpresë për të qëndruar në trojet e veta, apo jo?

Së gjashti, nga krejt kjo del një mesazh që vlen të dihet dhe të përvetësohet si mësim për sot e nesër edhe nga komentuesit e negociuesit e sotëm ngadoqofshin ata se shqiptari nuk e ka urrejtur serbin as fenë ortodokse të vëllait të vet, por as fenë islame, as fenë kristiane katolike të *papatit*, por me të drejtë ka urrejtur zaptuesit, qoftë pushtuesin turk, qoftë atë romano-italian, qoftë (nënkuptohet) tani edhe atë serbopravosllav apo heleno-grek dhe për këtë shqiptari i ritit përkatës ishte i gatshëm, gjë që duhet të jetë gatshëm edhe sot e nesër, të sakrifkohet për mbrojtjen e vendit të vet, ngase kjo ishte dhe është amaneti i platformës kombëtare shqiptare e formëzuar atavikisht më herët, por, si me thënë, u zyrtarizua shprehjesisht në periudhën e Rilindjen Kombëtare Shqiptare, madje kjo shprehjesi pakashumë del e ravijëzuar në ngjarjet para, rreth e pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, por edhe në kryengritjet e mëvonshme kundër osmanëve deri sa arriti në gjendje mirëkuptimi rreth shpalljes së Pavarësisë (1912), e më vonë, por edhe me flijimin e fitoren me luftën e fundit çlirimtare të UÇK-së (1999) të ndihmuar nga NATO.

2) Dëshmi nga Milosh Milojeviçi

Milosh Milojeviçi, këtë dukuri të ortodoksizmit shqiptar në trevat e Arnautistanit e shpjegon fare qartë, vetëkuptueshëm prej nesh, se si në disa fshatra të zonës së Kurshumlisë e gjetiu, si: *Gjetinje* (30 shtëpi),

Paçarada, Tijovac, Stubla, Gubetin etj., banorët pasi flitnin shqip i shënon fillimisht me etni «ili ili» (“ose ose”), d.m.th. ose poturë (P) ose (A) arnautë të poturëzuar ose edhe (S) serbë sipas prejardhjes fetare historike dhe vendit ku jetonin, ngase siç e shpjegon ai, kur i ka pyetur informatorët për prejardhjen e tyre, në njërën anë, ata, nuk kanë pranuar se kanë qenë *serb* (edhe pse jetonin në Serbi (!), në anën tjetër nuk kanë pohuar se janë *arnautë*, ardhacakë, me ish fe katolike, por, së fundi kanë pranuar që ishin *paturëzuar* (ishin muslimanë), përkatësisht tashti *ishin turq !!!*, por, pasi nuk e njihnin fare turqishten, ata si të tillë fanatikisht e përdornin gjuhën e trashëguar shqipe, *shkipski jezik*, si gjuhë familjare dhe treve, madje për t’i mësuar fëmijët apo familjen sidomos ndonjërin nga gratë e tyre serbe me folë *shkipski*, paskan marrë gra katolike, qoftë *nga rrethina e Shkodrës ose e Gjakovës*, të cilat nuk *dinin fare serbisht* dhe kështu familjet e tyre (edhe fëmijët e grave serbe) plotësisht poturëzoheshin, më drejt, si me thënë, *poshkipëzoheshin*, sepse Milojeviçi të gjithë historikisht i konsideronte me prejardhje serbe (sigurisht tash mbështetej mbi bazë të ish-fesë ortodokse). Fundi i fundit, siç vetkuptohet, ata me këtë veprim jo si turq (!), por faktikisht, duke u identifikuar si *shqipjanë* konsolidoheshin gjuhësisht, ashtu siç edhe kishin qenë edhe më parë, d.m.th. si arbnorë (shqipfolës) apo si **shqipë (shqiptarë)**, gjithsesi jo serbë, apo jo?!

Ndonëse rreth mendimeve të Milojeviçit mund të **shprehet** ndonjë rezervë e ligjshme, megjithatë, mund të përsëritet pyetja: *Pra kush ishin këta*, meqë nuk pranonin se ishin ardhës *arnautë (katolikë), atëherë çfarë etnie dhe çfare feje kishin pasur më parë?* Përgjigjja për ne, siç e thamë dhe për lexuesin e interesuar del fort e qartë. Këta ishin pikërisht pjesë e masës së shqiptarëve autoktonë të fesë ortodokse brenda asaj treve, të cilët ndërkohë u islamizuan, ndoshta edhe për mos me u serbizue ose për ndonjë interes tjetër, siç është të ruajturit e trashëgimisë gjuhësore shqipe e trashëgimi të tjera etnike në ato treva ts shpallura zona ushtarake, apo jo?!

Ç’është e vërteta, kjo dukuri del e qartë edhe nga studiues të tjerë që kanë studiuar *dëbimet e popullatës joserbe në vitet 1830-1867 (Shih në internet 16.12.2018 «revista drini»)*, ku ndër të tjera jepen këto të dhëna atëkohë në Principatën Serbe, Beogradi kishte shtëpi S 842 ortodokse ndaj JOS 1480 (shumica shqiptarë), ndërsa Uzhica kishte S 600-700 ndërkaq JOS deri 3700. Në qytete të tjera si Valeva, Kraveva, banorët e ashtuquajtur serbë ishin në numër edhe më të vogël ndaj JOS, shqiptarëve poturë e të tjerë, të cilët ndërkohë u shpërngulën ose u asimiluan. Veç

masave të tjera të dhunës shtetërore banorët për të mbetur në trojet e veta, qoftë edhe prëkohësisht, duhej plotësuar këto kushte:

1. Të ktheheshin në fenë e stërgjyshërve (ortodoksë pravosllavë).
2. Të pohojnë konvertimin se janë serbë te fesë islame.
3. Të deklarohen (shkruhen) ciganë...

Me fjalë të tjera nga kërkesa e parë kuptohet që ata që tani ishin muslimanë shqipfolës (të poturizuar) më parë, sipas fesë së stërgjyshërve, gjithsesi paskan qenë ortodoksë shqipfolës, apo jo?

Pra, edhe pse nuk ka të dhëna sa prej tyre u kthyen në fenë e stërgjyshërve, serbopravosllavë është shumë i vërtetë konstatimi i ekzistimit të masës ortodokse shqipfolëse (shqiptare) gjithandej jo vetëm brenda po edhe jashtë kufijve të Knezhevinës Serbe.

Më duket se është me rëndësi me tregue një episod nga jeta ime. Në pranëverën e vitit 1956, isha *ushtar i vjetër* në Valevë, rastësisht kalova rrugës nga stacioni i trenit. U befasova që aty afër rrugës nga treni kthehej nga tregu Kadri (Fetiu) Peçani, mik i familjes sonë, burrë i dukshëm, me veshë kombëtare, me plis e shokë etj. Nuk u durova i fola, ai me tregoi se si tuxhar, paska pru qepë me shitë, i paska shitë e tash po kthehej. Natyrisht edhe në të ndarë e përqafova. Natyrisht në të larguar nganjëherë sillja sytë nga stacioni, nga baca Kadri. Një fshatar valevas, që dallohej nga veshja si fshatar, më kishte vënë re dhe për çudi timen më tha: «I mi smo bili takvi» (Edhe ne kemi qenë të tillë). Sigurisht donte të zgjaste bisedë, po unë nuk fola asgjë. E dija se çfarë kishte ndodhur po atë dimër te ne rreth gjoja *mbledhjes së armëve*. Ishte kohë që një ushtar nga ana e Gjilanit, u gjet i varur, andaj fjalët e atij fshatri më fort i kapa si provokim, por që tash pa sa e sa vitesh po e kuptoj të vërtetën që po i dëshmon historia. Dua të them se vetëm paqja shumë gjëra i kthen ku duhet.

Sidoqoftë, gjithsesi po del e vërteta historike sheshit se në të gjitha sanxhaqet e Knezhevinës serbe kishte pasur popullatë me etni e veshë shqiptare, të cilat u spastruan së andejmi, edhe me pëlqimin e Turqisë dhe kjo ngjalli oreksin te serbët që i njëjti spatrim ndaj shqiptarëve të vazhdojë, siç edhe vazhdoi pas 1878, pas 1912, pas 1918 dhe pas 1945-s, 1951-shit dhe së fundi pas 1998 dhe vazhdon në Luginën e Preshevës e gjithanmdejt deri në ditët e sotme.

Ekzistimi i etnisë shqiptare gjithandej duhet të njihet më mirë nga të gjithë dhe sidomos nga qarqet shkencore e intelektuale serbe, sepse

pikërisht kjo e vërtetë del e argumentuar me fakte nga jo pak burime që dihen, por do të sforcohet paksa edhe prej nesh në vazhdim - në krerët vijues të këtij punimi, prandaj ftojme lexuesin e nderuar që me vemendje të shtuar ta ndjekë dhe ta pranojë e përvetësojë këtë të vërtetë të mohuar jo aq nga Milosh Milojeviqi, sa nga pasuesit e tjerë makiavelistë, deri edhe nga dikush nga brezi i ri i studiuesve të frustruar serbë. Unë mendoj që nga kjo sisimbiozë ose jetë e gjatë e përbashkët kohore ortodokse shqiptaro-serbe, përkatësisht iliro-dardano-serbe është reflektuar edhe tek disa studiues serbë që veten e quajnë sot *me prejardhje iliro-dardane* (!), siç *rrëshqet* në një shkrim edhe M. Milojeviqi dhe për këtë sugjerim, një pjesë e tyre kanë vështirësi me ia sqarue vetvetes këtë fakt, sepse duhet ta mohojnë ose ta vënë në dyshim prejardhjen e tyre sllave dhe të serbishtes si gjuhë sllave parësore, apo jo (!!), ngase si sllavë njihen nga vetvetja, nga historia e sotme evropiane e botërore. Madje nëse e pranojnë një prejardhje të tillë josllave, duhet ta pranojnë faktin se para serbishtes si gjuhë të vetme, si shqiptarët e sotëm, do të kenë pasur gjuhën iliro-dardano-thrako-arbanase, pra gjuhën shqipe, apo jo?! Dhe për t'i ikur kësaj të vërtete, u shpik se gjoja serbët e vjetër ishn këndeje, qoftë të quajtur si pellazg, etrusk, besë e të tjerë, ku në këtë teori prin M. Milojeviç, po ky nuk i mohon edhe shqipëri e vjetër, siç po i përjashtojnë disa pasues të tij, studiues të rinj tendenciozë. Këtu fatkeqësisht ka paqartësi tek disa stuzdues tanë që çdi fjalë që ka ndonjë përekim me serbishten e quanë me prejardje serbe, pa e analizuar të vërtetën, siç ishte edhe fjala mos u keqav *ne kacavi se, trullavje trulenje* (kalbëzim) etj. Ose me dush[

Sidoqoftë, për studiuesit seriozë, një e vërtetë e tillë për një masë të konsiderueshme folësish e studiuesish të sotëm sllavë (serbë, malazezë, maqedonë) edhe nuk mund të mohohet dot.

Sido që të ketë qenë, këtë dukuri do ta kemi edhe më të qartë pasi ta njihemi me raportin sllavo –iliro-dardano-arbëror, shkije-shqiptarë etj, por edhe nga lënda e Sifjalorthit shqip- serbisht të sajuar nga Milosh Milojeviçi (1873).

Përmbyllje

Ne fillimisht konstatuam se ndërlihdhja shqiptaro-serbe ishte e njohur që në mesjetë nga ndërkrushqia mes fisnikësh serbo-shqiptarë që nënkupton edhe përzjerjen ndërgjuhësore shqipe e serbishte të kohës mes familjesh fisnike: Stefani Prodoni me qëndër **Krujë**, Llazari /Milosh Kopiliqi me qëndër **Drenicë**, Vuk Brankoviçi / Gjergj Topia me qëndër

Durrës, ku në të gjithë këta shembuj vajza ta quajmë **serbe** është martuar për fisnikët përkatës **shqiptar**, ka edhe raste anasjelltas, por ne po i mëshojmë faktit që sigurisht në familje shqiptare është folur shqip, ngase shqipja nuk piku nga qielli, ajo pa mëdyshje ekzistonte, pa përmendur pellazgët, sigurisht që nga iliro-dardano-arbnorët, siç ekziston edhe sot, e shtrirë në këto treva, edhe pse shumë e reduktuar, apo jo?

Mirëpo, meqë edhe në kreun vazhdues (të tretin), prej anës sonë, do të vijohet me sjellje argumentash që dëshmojnë se tek popujt tanë kanë ekzistuar marrënie pothuaj normale, por që nga fillimi i shekullit XIX, edhe në fillim të shekullit XX e në vazhdimësi deri në ditët e sotme ndodhën përkeqësim raportesh. S'do mend, se për keqësim del fajtoje pala ekspansioniste serbe. Shkaku qëndron se kasta politike serbomadhe me rastin e përqafimit të rrymës nacional romantike në programin nationalist rreth formimit të shtetit serb si pikë e të parë nuk parapau bashkëpunimin po injorimin e shqiptarëve e të gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës. Kështu jo vetëm prishi fqinjësinë sivëllazërore, por aq më keq shtoi orekse kolonialiste ndaj gllabërimit të pasurisë e trojeve shqiptare. Sidoqoftë, ne në këtë krye vazhduam sqarimin rreth kuptimit të etnisë poture, përkatësisht sqarimit të ekzistimit të ortodoksëve shqipfolës gjithandej në tokat tash të cilësuar si zona serbe, prandaj lidhur me këtë po mjaftohem duke u përqendruar në përmbajtjen e titujve të dy nënkrrëve të këtij kreu, duke shtuar si përforsim edhe ndonjë sqarim fare të vogël, vetëm sa për t'ia kujtuar lexuesit të pasionuar disa nga të veçantat kryesore të shprehura në këtë krye:

Së pari në titullin e nënkreut të parë: ***“Injorimi po edhe dëshmimi me pahir për poturët e gjuhën e tyre 1866/67, të cilët nuk ishin as serbë as turq po ishin rrënjësisht shqiptarë***

Sido që të ketë qenë, në këtë periudhë përmendet edhe një veçori tjetër e etnisë arbnore, ngase si rrjedhojë e historisë jetësore si dhe gjuhësore mund të ndeshnim atëbotë dukurinë e rrënjësor të familjeve mikste laramane: katolike/ortodokse /muslimane (ose poture) si etnitete të shënuara në veprën në shqyrtim si **arnautë**, d.m.th., latino-katolikët e islamizuar, ndërsa **poturë** zakonisht u quajtën shqipfolësit ortodoksë pravosllavë, që në të vërtetë ishin rrënjësisht shqiptarë e jo serbë (me kuptim të sotëm) të poturëzuar, përkatësisht gjoja serbë të *shqiptarizuar* (!!!).

Kjo që e u theksua më sipër vërtetohet lehtë nisur edhe nga realiteti i sotëm, duke pasur parasysh faktin se të gjithë këta poturë të shënuar në

trevat tona, Kosovën e sotme ose Serbinë e Vërtetë të Vjetër (Prava Stara Srbija) sipas Milojeviçit, pamëdyshje assesi nuk kishin qenë kurrënekurrës serbë serbishtfolës me tapi, ngase askush prej tyre asnjë familje *për be e rrëfe*, edhe pas 100 vjet sundimi serb (1912-1999), me sa dimë, qoftë me gjuhë, qoftë me fe, madje asnjë individ me zë nuk u *riserbizua*, po mbeten shqiptarë dhe përforcuan atë etnitet, me gjuhë e kombësi, shumica deri në sakrifikim. Së këtejmi, po përsërisim, pa mëdyshje kemi të bëjmë me një të vërtetë të parrëzueshme se kjo masë me t'u konvertuar në islam, sigurisht për ndonjë motiv e interes jo të vogël, e cila nga serbët në shekullin XVIII-XIX në serbishte quhej **etni poture**, në të vërtetë nuk u bënë assesi *poturçini* a *poturice* apo *po(l)turq(ini)* - (gjysmë)turq), ngase nuk dinin turqisht, po nuk mbeten as të ashtuquajtur me fe serbë (ortodoksë), sepse të tillët familjarisht më parë nuk flisnin serbisht, edhe pse mund të jenë quajtur serbë. Prandaj në këtë kontekst mund të bëjmë përsëri e përsëri disa pyetje retorike: çfarë ndodhi me këta të konvertuar, kush ishin, kush kishin qenë këta njerëz, kjo masë, që serbisht në trevat tona e më gjerë quheshin *poturë*? Çfarë raportesh kishin pasur e kishin tani me kishën serbe si dhe me pushtetin osmano-turk? Si quheshin, pra, këta njerëz nga rrethi i traditës fisnore dhe si nga administrata shtetërore turke dhe si dhe pse u organizuan në vazhdimësi dhe luftuan për identitetin e vet, siç edhe vepruan që me luftë të të përgjakshme të ndahen, qoftë atëherë nga Turqia Osmane, qoftë ndërkohë nga Serbia kolonialiste, apo jo?

Duam të themi që duke ruajtur e kultivuar gjuhën dhe zakonet e veta, siç i kishte të trashëguara që nga lashtësia pellazge-iliro-dardane, ashtu si katolikët e shumica e ortodoksëve vendas të pakonvertuar në islam, edhe pse ndoshta të regjistruar në dokumenta dikur si serbë flitnin kryesisht shqip dhe faktikisht i takonin etnisë shqiptare, edhe pse respektin për kishën mbi 500 vjet, qoftë ortodokse ose përgjithësisht për kishën kristjane si pjesë e perëndishme në vete, nuk e kishin braktisur, të cilën ende e respektonin dhe e respektojnë edhe sot si kult të shenjtë ose në shenjë kulture nga trashëgimia, që dëshmohet edhe me festat apo kremtimet e përbashkëta.

Rreth kësaj teme priten analiza më të thella, ndërsa ne tani për tani po ripërmendim faktin se **poturët**, ashtu siç ishin edhe dy etnitë e regjistruara në veprën e Milojeviçit, **arnautët** dhe **latinët**, pa mëdyshje në përqindje është dashur atëherë, siç bëmë ne në këtë punim (Kreu I), që edhe **poturët** të llogariteshin joserbë, shqiptarë, andaj për këtë të vërtetë,

gjithsesi duhet të esëllohen dhe ta kuptojnë edhe më mirë të gjithë, edhe studiuesit e sotëm serbë, ngase në atë periudhë nga piolitika turke ashtu si edhe ajo serbe shqiptarët ishin viktima, ngase, *kur te ne poturët (shqipfolës) me dhjeta mijë llogariteshin serbë, në të njëjtën periudhë nga Principata serbe me qindra mijë të tillë, edhe pse shqipfolës, dëboheshin barbarisht nga trojet e veta si turq?!*

Madje ky viktimizim u vijua me barabarizëm ndërkohë. Po rikujtojmë që pos nga qyteti i pastër shqiptar si Kurshumlia me afro 30 fshatra shqiptarë u *spatruan* (dëbuan) poturët gjithandej ashtu si nga shumë vise të tjera arnauete. Kështu vetëm nga Sanxhaku i Nishit, pos nga qyteti, sipas Reshat Avdiut (e të tjerë), u *spastruan* 620 fshatra poture shqiptarë, kurse sipas nënkonsullit anglez 997 fshatra.

Para se të përfundojmë këtë nëntitull po ritheksojmë që patjetër sotpërsot opinionit të gjerë, në radhë të parë atij serb, duhet t'i thuhet e vërteta për këto padrejtësi të rënda kolosale fatale që i janë bërë popullit shqiptar me injorimin e gjuhës së tij si kriter i së vërtets, sepse, siç u cek, nuk ishte vetëm politika serbe fajtoare, ishte edhe ajo turke, e cila u jepte të drejtë serbëve që poturët t'i trajtonin si turq, të cilët duhet dëbuar bashkë me ushtrinë e mundur turke, apo jo?!

Së dyti, në titullin e nënkreut të dytë: **Dëshmi rreth ekzistimit të ortodoksëve, por edhe të poturëve shqiptarë gjithandej në viset potenciale të shtetit serb para viteve 1866-1878**, përveç nga Pjetër Bogdani, i cili dëshmonte edhe fjalëtermin “arbanashke vere (fe arbanashe) të komunitetit arfbërishtfolës, mbase ende të paasimiluar ose të sapoislamizuar, sollëm fakte plus që një ndërlihdje të tillë gjuhësore familjare e vërtetojnë me dëshmitë e tyre mbase me pahir dy nga makiavelistët më të njohur të romantizmit (*preporodit*) serb: Vuk Kraxhiçi dhe Milosh Milojeviçi, të cilët përmendin praninë e shqiptarëve ortodoksë atëbotë, jo vetëm në familje të veçanta, por edhe si familje të përziera laramane: poture/jopoture, përkatësisht ortodokse/muslimane që ekzistonin në Serbinë Jugore të sotme e më gjerë.

Sidoqoftë, kjo e vërtetë, për **poturët dhe ortodoksët shqiptarë dhe gjuhën e tyre si kriter të së vërtetës**, qofshin të asimiluar ose jo që del sheshit si e vërtetë që ajo etni shqiptare ortodokse e pashpërngulur edhe pse me kohë gjuhësisht mund të jetë asimiluar, assesi nuk e ka humbur substancën e gjeneve të veta iliro-shqiptare, çka po dëshmon sot shkencërisht edhe ADN-ja. Andaj, kjo e vërtetë, le të përsëritet e përsëritet shumë herë derisa të kuptohet qartë realiteti nga të gjithë serbët, shqiptarët

e të huajt, ngase, e vërteta qetëson shpirtrat edhe të naivëve dhe të painformuarve të sotëm (serbë e shqiptarë) dhe shuan urrejtjen e imponuar nga propaganda e zezë mbishekullore nga qarqet e caktuara armike të të dy e tri etnive, që ua ka shpërlarë trurin një mase të tillë naive dhe injorante me propagandë pseudofetare sidomos pjesës serbopravoslave dhe asaj turko-islame dhe mjerisht ende, edhe sot e gjithë ditën, po vazhdon me të njëjtin avaz.

S'do mend të gjitha këto marrëzira i zbut dhe i shëron paqja dhe mirëkuptimi, duke respektuar të kaluarën pozitive dhe të tashmen me kërkimfalje dhe me dënim-gjykimin e fajtorit.

Kreu III
RRETH REFLEKTIMIT KONTAMINUES TË KONCEPTEVE
TË TERMAVE:
S(K)LLAVË E SERBË (SI ETNI) DHE S(H)KIZMË (SI DUKURI)
NË GJUHËN SHQIPE

Hyrje

Nuk është hera e parë që në gjuhën shqipe ballafaqohemi me konceptimin e fjalëtermave: **skllavë /sllavë** (si popull, etni) dhe **skizmë/ shkizmë** (si ngjarje dukuri), por nuk dimë sa do të jetë sqaruar në hollësi reflektimi kontaminues i tyre në antroponimin e shqipes:: *shka/shkja/shqa*, përkatësisht, shumësi: *shki/shkie/shkje /shqe-të* dhe emri kolektiv ose toponimi *shkini/Shkieni* me derivatet përkatëse në krahasim me barasvlerësit e ndërkohshëm dhe të sotëm *shqip shqiptar Shqipri*, që do të trajtohet më në hollësi në kreun vijues, andaj, edhe pse jo si specialist, marr guximin me trajtue këtë temë, duke e shtjelluar në tri pika ose nënkrerë:

së pari, rreth kuptimësisë dhe etimologjisë së fjalë-termave ndërkombëtarë: *skllavë /sllavë e serbë* (servë) dhe *skizmë/ shkizmë*,

së dyti, si i ndeshim këto fjalë të reflektuara fillimisht e aktualisht në burimet tona gjuhësore (kryesisht leksikografike) dhe

së treti, meditime rreth përkufizimit semantik të fjalëtermave **shka** e **shkizmë** me theks në Fjalorin e M. Elezit dhe dy derivateve të imponuara mbi këtë bazë **shkizmë** dhe **me shkavitë**, që domosdo temën e bëjnë të diskutueshme për opinionin e gjerë e në veçanti për atë shkencor studiues.

NËNKREU I
RRETH KUPTIMËSISË DHE ETIMOLOGJISË SË FJALË-
TERMAVE NDËRKOMBËTARË:
SLAV (SKLLAV) e serb (ShERB-) DHE SKIZMA (SHKIZMË)

S'do mend se fjalët *skllavë* ose **shkllavë** (!) si edhe **sherb'** (!), **serbë e servë** do të kenë ekzistuar edhe më përpara se të jenë regjistruar si terma në gjuhët klasike: qoftë në atë latine *sclavus* apo **serv servus**, përkatësisht

schlavoi apo *servos* si dhe lashtogreke **schizo schizma*) apo *shkjav-I, shki/e*, përkatësisht **sherb'** (!) shërbyes në shqipe, edhe cilësinë e fjalë-termimit ndërkombëtar fjala *shcisma* (*shkizmë*) qoftë në trajtën *skizma* ose *shkizma* e ka të ravijëzuar dhe parësorisht e ruan që nga mesjeta për konceptin “*çarje brenda një kishe a një organizate politike, për shkak të mosmarrëveshjeve të thella parimore*”, përkatësisht. “*përçarja dhe ndarja e një kishe në dy pjesë për shkak të mosmarrësveshjeve rreth dogmave dhe riteve fetare ose politike*”, siç e ndeshim në *Fjalorin e fjalëve ndërkombëtare* të M. Ndrecës (f. 644). Ndërkaq, edhe fjala *skllav /sllav* si edhe ajo *servos servus* (edhe pse që nga antika ndeshet në trajtën *sclav e ajo serb- që* në shqip *shkjav-i*), përkatësisht *sherb-* ka cilësinë e historizmit, por edhe të fjalës ndërkombëtare, sepse me të emërtohet një etni e gjerë e popujve sllavë (shkizmatikë), ndërkaq me *serbë* paksa më e ngushtë (kemi të bëjmë me *shërbimsi*).

**a) Rreth përhapjes në fillet e mesjetës të fjalë-termimit etnonimik
skllav /sllav e serb (sherb-)
në disa gjuhë të huaja dhe serbisht e shqip**

Etnonimi **sllav** dhe ai **serb** në mesjetë fillimisht në gjuhët klasike, sidomos fjala e parë ndeshet e shqiptuar dhe e shënuar në trajtën **skllav**: lat. *sclavus, sclaveni*, gr. *sklavoi, sklavenoi sklavinoi*, etni kjo që siç po shihet është shënuar sipas konceptit të *skllavit, të robit* (bujkrobit), *njeri pa mjete prodhimi dhe pa të drejta*, kategori kjo që i përkiste sistemit shoqëror skllavopronar, prej nga thuhet se e ka zanafillën. Ka supozime, siç lexuam nga burimet e caktuara në gjuhën serbe, që gjoja grekët, ashtu si edhe latinët, i paskan shënuar trajtat kështu me tendencë përçmuese?! Por ka edhe mendime të tjera që vetë sllavët fillimisht ashtu e paskan pasë quajtur vetveten *sklavini* (*Brahim Avdyli*), ndërsa studiuesi rus Vladimir Orel ka besuar se me trajtën **sclavus** kemi të bëjmë me formë post klasike. (Shih në *Internet Albania- Arbania*.)

Ndërkaq, edhe fjala e dytë **serb** që përfaqëson sot një etni të veçantë sllave, të cilën e paskan pasë quajtur lat. *servus*, gr *servos*, përkatësisht: *servin, servoi*, nga **sorbe* ose *serve serv* pejorativisht me kuptim *shërbëtori* (serb. *sluga*). Edhe lidhur me këtë ka mendime që trajtat *serb* si dhe ajo *s(k)lav*, në gjuhën bazë popullore nuk kishin konotacion pejorativ, ngase:

E para, sllavët ndërkohë etimologjinë e vet e shpjegojnë të përmirësuar me rrënjën *slava* “lavdi” (gloria) e kjo e dalë nga “slovo”, me kuptimin: njerëz *si të ditur* apo të një *gjuhe të njëjtë*(!), andaj edhe sot për emërtimin e tyre kanë dy trajta togjesh nistore sinonimike: **Slav-** Slaven Slaveni, Slavjani, përkatësisht **Slov-** Sloveni Slovjani dhe që të dyja versionet ndërlidhen edhe me emrin si gjymtyrë e dytë: –veni- (ven(d)eti), ndoshta në kontanimi me fjalën iliro-proshqiptare (ballkanizëm E. Çabej), siç e ka shqipja e sotme: vend-i (Krahaso në gjuhë të huaja: Sclaveni: *Wend slavs / vend sklav!*). Sidoqoftë, në fushën e terminologjisë shkencore edhe në gjuhët sllave mbizotëron sotpërsot trajta *slav-*: slavjanin, slavjani, slavista, slavenosrpски jezik etj.

E dyta, po kështu problemore del edhe emërtimi i fjalëtermi **serb**, sepse me emrin **serb ose serv** në gjuhën lashtogreke, gjë që është me rëndësi të dihet, thuhet se janë quajtur edhe etni të tjera barbare brenda një treve që atëbotë e ndeshim të emërtuar **Serbi** (shqip **Sherbi**), përkatësisht Servi, apo jo?! Prandaj, sido që të ketë qenë, ja tani tabela tri kolonëshe, në të parën: si quhej dhe quhet sot ky popull në disa gjuhë moderne dhe në shqipe, në kolonën e dytë, me kuptimin e sotëm **sllav** (popull sllav) si etni dhe në të tretën po e shënojmë trajtën **serb**, sipas dy kuptimeve edhe të **shërbëtorit** apo **shërbyesit**, edhe atë **serbë** (populli serbë) shoqëruar me folje:

Pasqyrza e fjalëtermave: sclavus e slave, servus +folja dhe scisma

<u>I. a. shkllav</u> (rob) e		<u>b. sllav</u> (etni) /		<u>II. serb +folja</u>	<u>III. shkizmë</u>
lat.	sclavus			servus	scisma (sciss/us)
angl.	slave	/	slave,	/	serbe (to) serve schism
fr.	esclave	/	slav,	/	serbe servir schisme,
it.	schievo	/	slavo,	/	serbo servire scisma
sp.	esclavo	/	eslavo,	/	servio servir cisma
gjer.	Sklave	/	Slawe,	/	Serbe (zu) dienen Schisma
hol.	slaaf	/	slaaf	/	serbier bedienen schisma
sll. rob	(sklaven?)	/	slaven ose sloven /	srbin	sluziti šizma, raskol
shq.	*shkllav (skllav)	/	sllav /serb (*sherb)	me shërbye)	<u>shkizma</u> (skizma).

shërbyes e shërbëtor

Shënim:

1) Në të vërtetë, në shqipe, koncepti i skllavit del në trajtën *skllav* me kuptimësi si në trajtës latine *sclavus* ose të greqishtes *sklabos*, ndërsa për kuptimin e dytë del në trajtën *sllav*, kurse po në shqipe trajta **serb** del edhe emërtim etnie dhe vepruesi.

2) Në burime të caktuara për emërtimin e fjalës në latinisht **serv/us**, greqisht **serv/os**, në shqipe fillimisht del me kuptim shërbyes shërbëtor. Kështu foljen *servire* të latinishtes në shqipe e kemi të pëftuar në trajtën *shërbej* (me *shërbye*), ndërsa për emrin e vepruesit që anglisht quhet *servant*, it *servitor* (omentico servo), në shqipe dalin dy emra paralelë po me diferencë kuptimore *shërbëtor* dhe *shërbyes*. Madje fjala shërbyes ka kaluar në emrin e vërtetë që ka marrë pastaj emërtimi *serv-os/* e *servus* në jetën bashkëkohore jo me kuptim social që kishte si rob e shërbëtor, por si *shërbyes*. Në të vërtetë në literaturën tonë të hershme leksikografike foljen *servire*, siç do ta vërtetojmë më poshtë e ndeshim me barasvlerësin *shërbej* me *shërbye*.

Kështu, nga historia mësojmë që **vendi i serbëve** (shërbyesve) që u avancua si gjysmë të pavarur as rob (sluga) skllav dhe as shërbëtorë, po nuk ishin as kmet (bujkërobë me ndonjë të drejtë pronësore) vazhdoi të quhet **Serbia (Servia) në shqipe Shërbia** (P. Bogdani) dhe si pasojë banorët ndërkohë si me thënë, u pavarësuan, formuan mbretëri më vite, siç supozohet se ishte edhe dinastia e Nemanë, tribale-serbe që supozohet se bartte (mbase) po këtë emër, por që nuk ishte shtet i serbëve (sllavë), sipas kuptimit të sotëm njënacional, por kryesisht i *shërbyesve* shqiptarë.

Sidoqoftë, meqë rreth kuptimësisë së fjalës **serbë** do të bëjmë fjalë në vijim këtu nuk po zgjatemi më shumë, andaj po i kthehemi sërish në pikën rreth kuptimësisë së fjalë-termi *Skllavë, Sllavë*, përkatësisht *shkllav shkllenisht* (B. Demiraj), **skllav... *Shkllav/i Shkja/u Shkje, /shkije(!)*.

3) Të vihet re lidhur me këtë se në të gjitha gjuhët shkrimisht, siç po shihet në kolonën e parë nga skema e mësipërme, ruhet kuptimi ose etimoni në koncept *skllav skllavi*, ndërsa në kolonën e dytë në disa gjuhë dallohet emërtimi i etnisë, qoftë vetëm nga konteksti, për shkak të homoformës, dhe në disa gjuhë të tjera qoftë me ndonjë dallim minimal shkrimor. Vetëm në gjuhën shqipe dhe në serbishte për dallim nga gjuhët e tjera për konceptin e parë në letrarishten e sotme përdoret trajta **rob**, madje në shqipen zyrtare edhe fjala **skllav**, me kuptim të përgjithshëm neutral e historik, ndërkaq për shembullin: *sllav sllaven*, në kolonën e dytë që nga mesjeta në gjuhën shqipe trajta **skllav** (me kuptim etnie në rrjedhë e sipër) del e përfutur në disa variante trajtash në numrin njëjës: *shkla/v – shkja/v- shkav-i, shkja, shka –u, shqa-u*, e cila shkrimisht edhe shqiptimisht, por edhe kuptimisht dallon nga gjuhët e tjera, sepse si në të kaluarën ashtu edhe në të tashpërtashmen fjala **shkja/v** nuk ka sinonimi as me fjalën *skllav*, as me konceptin e tërësishëm të fjalës *sllav* si etni, por siç do të shohim kryesisht ka të bëjë me një pjesë të etnisë skizmatike sllave, përkatësisht të përzier simbiozisht me etnitë fqinje me fe ortodokse kryesisht edhe të vetë *shkive vendës shqipfolës* të asimiluar ose jo, andaj ky fakt na ka shtyrë të gjurmojmë dhe të thellohemi rreth kontanimit të semantike të të dyja fjalëve: **shkja shka** nga ***shklav** dhe **shki shkije** (te ne) me fjalën **shkizmë (shki/...)**.

S’domend, mesa pamë, etimologjikisht trajta *shka (shkja) e shqipes* ndërlidhet patjetër me trajtën latine *sclavus sclaveni* ose atë greke *sklavenos sclavenoi* dhe ndërtimisht shpjegohet pa vështirësi si një zhvillim i brendshëm i rregullt i shqipes në bazë të proceseve fonetiko-fonologjike të sistemit të saj, dukuri kjo që do të sqarohet më poshtë, pasi të shohim se si fjala *shkja* me derivate, sidomos shumësi *shki/je shkite* dhe ajo *shkizmë*, të dyja këto fjalë në disa burime leksikografike të hershme shqipe e aktuale dalin të gërshetuara në kontanimit të semantike së bashku si një nocion, ashtu të kontekstyt ë shoqëruara me fjalë të tjera.

b) Së këtejmi, e shohim të arsyeshme që së pari, t’i themi pak fjalë si shpjegohet cilësimi i konceptit të fjalës *skizmë/shkizmë* si fjalë ndërkombëtare, së dyti, reflektimi i saj në disa gjuhë moderne dhe në shqipe dhe së treti, reflektimi i fjalëtermit *skllav (sllav) e serb (serv) - sherb-* që nga mesjeta në disa gjuhë të njohura dhe në historiografinë e gjuhës shqipe.

b) Rreth cilësimit të fjalës shkizmë si fjalë ndërkombëtare

Edhe pse ky term në stilin neutral përdoret edhe për ngjarje të tjera që shprehin: *ndarje, çarje, përçarje, shqyerje (shqyerje)*, siç nënkuptohet nga formulimi i mësipërm, por cilësinë e termit ndërkombëtar kësaj fjale ia ka stampuar një ngjarje e njohur që ka ndodhur brenda kishës së shenjtë kristiane, kur kjo u nda në dy pjesë: ***Kisha e Perëndimore latine*** me qendër Roma e udhëhequr nga **Papati** (Papa) dhe *Kisha Lindore* bizantine me qendër **Konstantinopoja** e drejtuar nga **Patrikana** (Patriku), çarje kjo, e cila në të Overtetë kishte filluar më herët që nga viti 324, kur perandori Konstatini i Madh (dardan, me origjinë nga Nishi), i cili si u bë zot i Perandorisë Romake bëri emër për dy të bëma ose ndryshime të rëndësishme në atë perandori: së pari, vendosi (politiko-pragmatikisht) që kryeqytetin e asaj perandorie nga Roma ta kalojë në Bosfor, të cilin e quajti *Roma e Re*, qytet ky, i cili ndërkohë e mori emrin e tij Konstantinopojë, (Është fjala për Stambollin e sotëm.) dhe së dyti, mundësoi legalizimin e fesë kristiane në tërë Perandorinë Romake, e cila edhe u shpall fe e vetme zyrtare e Perandorisë nga perandori tjetër Theodosius. Në të vërtetë kësaj *shkizme* (ndarjeje) i parapriu fakti që po në atë periudhë Perandoria Romake u nda në dy Perandori (476): të Lindjes dhe të Perëndimit, me dy kryeqytete e me dy perandorë, por mbeti me një autoritet kishtar, por që vepronte në dy qendra. Nga një ndarje e tillë administrative, autoriteti i Papatit, përkatësisht i Papës dhe i vetë kryeqytetit të Perandorisë historike romake, Romës, u lëkund dhe ndërkohë, për shkak të administratve të popujve si t'i quajmë invadues, vazhdonte të lëkundej gjithnjë e më tepër ndaj atij të Konstantinopojës, përkatësisht mosmarrëveshje e veprime jounitare ndodhën edhe lidhur me autoritetin e Patrikanës (Patrikut) nga qendra e re administrative-poitikeqë tashmë kishte marrë emrin *Perandoria Bizantine*. Kështu përveç mosmarrëveshjeve të natyrës politike u shfaqen edhe aso të natyrës fetare, konkretisht rreth interpretimeve të doktrinës biblike dhe, pas akuzave reciproke të herëpas-hershme pothuaj 1000 vjeçare (381-1054) që nuk reshtnin edhe me konflikte interesash, më 16.05.1054, ndodhi e ashtuquajtura *shkizma e madhe*, së pari blasfeminë kundër Patrikanës e përshpalli Papa, po njëherazi me të njëjtën mënyrë ia ktheu Patriku, përçarje kjo, e cila edhe u cilësua, siç e thamë: **Grande Scismo -Çarje (Shkizmë) e Madhe**, dhe faktikisht kjo bëri të mundur, si të fhuash, *zyrtarizimin kryenvete të ndarje0s së krishtërimit në dy qendra kishtarë, pse jo edhe rivale:*

1. Scismo del latini e Scisma d' Occidente,(Kisha Perëndimore romano-katolike me qendër Roma, sipas atributit: katholikos – universal, gjithsinor) dhe

2. Scismo d'Oriente e definito degli Ortodossi,/Kisha Lindore ortodokse, me qendër Konstatinopoja, me atributin: orthodox - besim i drejtë, burimor...

Sigurisht kjo shkapërdarje ndërkishtare e bazuar në dhjetë pika të natyrës fetare, kishte edhe arsye jashtëfetare, siç pati për pasojë, jo vetëm ndarje fetare, por ndërkohë në sferën politike shtetërore e kulturore, sidomos kur ndodhi edhe zhbërja e dy perandorive romake dhe lindja e shteteve të reja brenda përbrenda asaj perandorie (dykrenëshe), arsye këto që e imponuan edhe më ndarjen fetare, që përkundër ndonjë përpjekjeje autoritetesh për pajtim, shkizma ndërkishtare mbeti e tillë deri në ditët e sotme.

Pikërisht, rreth historikut ose reflektimit që nga mesjeta e deri sot të fjalës **shkizmë** (si dukuri) dhe të etnonimit **sllav (skllavë)** e **serv serb** në gjuhë të ndryshme dhe në gjuhën shqipe, **si etni**, siç u paracek, paksa do të bëjmë fjalë në vijim.

c) Rreth kuptimisë dhe përhapjes së fjalë-trajtës shkizmë që nga mesjeta në disa gjuhë dhe në shqipe

Fjalë-termi *shkizmë* në cilësi ndërkombëtarizmi (lat. *scissmus*, greq. *schismos*), e cila fillimisht mbulonte konceptin e një ndarjeje të madhe konkrete kishtare, ndërkohë ka pasur dhe ka marrë edhe kuptime të tjera zvogëluese ose zmadhuese, po sidoqoftë në disa gjuhë moderne aktuale, edhe pse ka sinonimi me fjalë përkatëse burimore në secilën nga gjuhët e tilla, ndërkombëtarizma e tillë shënohet kështu:

angl. schism,
sp. cisma,
fr. schisme,
gjerm. Schisma,
it. scisma,
hol. schisma
serb. e kroat. šizma, raskol
shq. skizma ose **shkizma**...

Siç po shihet vetëm në gjuhën e sotme shqipe si fjalë-koncept me cilësi ndërkombëtarizmi në përdorim e sipër ky term del i shënuar dy trajtash *skizmë*-a (letrarishtja) dhe *shkizmë*-a (praktikja), çka e bën të diskutueshme çështjen, por trajta e dytë **shkizmë** në shqipe del më pragmatike dhe si rrjedhojë edhe më e rekomandueshme, jo vetëm pse nistorja S- në ndërhuazimet e para me latinishten shndërrohet në Sh-, por edhe nga shtesa ose shqiptimi K-së pas kësaj nistoreje: S - SK- (lat. *sc - shc-*: *scissus* - shkyes, i çamë, i ndamë; *skindere* (*scindere*) – me shkye, shqyej) ndjehet në shqipe. Në të vërtetë kjo *sk / shk-* gjen shpjegim të arsyeshëm në shqipen e sotme, pa marrë parasysh faktin se në disa gjuhë fjala *shkizmë* shqiptohet pa këtë K. Kështu e ndeshim edhe në kroatisht **šizma šizama** šizmatik (shq. **shkizmatik**). Në të vërtetë **Sh**-ja e kroatishtes përkon me atë e shqipes, por jo me grupin shk- imponon sqarimin se latinishtes i mungon tirngulli Sh, ndërsa italishtja e ka SH-në, por zakonisht nuk e shqipton K-në te grupi **sc scisma** (shizma).

Sidoqoftë, këto dy veçori të shqipes, SH-ja nistore dhe shtesa e shqiptimi i K-së, siç u tha, janë karakteristika të shpjegueshme sipas natyrës, fillit a protoshqipes) dhe zhvillimit historik të gjuhës shqipe, andaj rreth kësaj pike sa për kërshtëri po përmend si mbështetje faktin se vetëm në FGJSH 2006 janë afro 90 fjalë-folje që fillojnë me nistoren SHK-, ndërkaq për ndërndikimin ose kalimin e S- latinishte me –SH-në e shqipes ose anasjelltas ka shumë shembuj ndërhuazimesh që identifikohen qysh nga takimet e para latino-iliroarbnore, nga të cilat këtu po i përmendim këta pesë-gjashtë shembuj:

Santa Maria - **Shën** Maria ose Maria e **Shenjtë**, Scripta –**Shkrimi**, Scipio (skopia)–**Shkopi**, Serv/us –**Sherb**/yes ose **Sherbëtor**, Stefan –**Shtjefën**, Spiritus - **Shpirt**, Scentia – **Shkencë** etj.,

andaj, edhe procesi *s/sh* te **schizma/shkizma** ishte dhe është i rregullt, dhe së këndejmë del që letrarishtja e sotme, me shikue pragmatikisht, është më mirë ta rekomandojë drejtshkrimisht trajtën *shkizmë-a* ndaj asaj *skizmë a shizmë*, apo jo?!

Madje në favor të trajtës **shkizmë** në shqipen e sotme popullore ndeshim trajtën **shkizëm** si emër konkret që ka të bëjë me nocionin e shkyerjes, ndarjes, copëtimit, copëzimit, që u panë paksa nga analizarëth fjalë-trajtave: *skllav sllav* e *serbë: serv sherb-*, duke i krahasuar trajtat e shqipes me trajtat e disa gjuhëve të huaja, po kjo dukuri do të shihen më konkretisht në nënkreun vijues.

NËNKREU II

FJALËT SHKJA/SHKIZMË NË KONTANIMI SEMANTIKE NË DISA BURIME SHQIPE KRYESISHT TË HERSHME LEKSIKOGRAFIKE DHE AKTUALE

Nuk përjashtohet mundësia, që këto fjalë të ndeshen edhe në burime të tjera të hershme të gjuhës shqipe ose lidhur me të, por ne, sa patëm mundësi volëm shembujt, duke filluar nga Fjalori i F. Bardhit (1635) deri te Fjalori e Bashkimit (1908), ndërkaq si burim aktual konsultuam vetëm Fjalorin e Mehmet Elezit (2006).

1) Nga Fjalori i Frang Bardhit (1635)

Në Fjalorin e Frang Bardhit (1635) si barasvlerës të fjalëve latine *Yllirias*, *Schiauonia* në shqipe ndeshim trajtën *Shkieni* (f.115). Shqipto: sipas leximit të sotëm: Ylliria - iliria, Schiauonia –s()hkhjavonia ndaj *Shkienia* – *shkjenia*. Mund të themi pa drojë që edhe përpara se të shënohej në këtë fjalor në gjuhën tone paskan qenë të pranishme te ne të dyja trajtat: trajta *shkjav-* *shkjav/o/nia* (më afër origjinalit), po ashtu edhe *shki-* (shkitë) *shkienia* - vendi i shkjav-it ose *vendi i shkie'*... (zhvillim brenda shqipes), gjë që u vërtetua nga *Dorëshkrimi* i Gjon Muzakës i vitit 1510, kur konstaton se fshati Opar populloj nga *skiavonë* (*shkjavonë*), etni kjo e emërtua kështu me qinda vite më parë, siç u trajtua më sipër. (Shih: **Lutfi Alia**, *Dinastia Muzaka në Albani dhe në Itali*, “*zembrashqiptare*”, 22,06,2023).

Sidoqoftë, shikuar e gjykuar nga aspekti i sotëm antroponimi del i identifikueshëm në trajtën e njëjësit *shkjav-i* (Krahaso: *schkiav*–*onia*, por sot edhe *shka-shkau-shkienia*), ose në kontaminim: vendi (**i**) **shkive** (**i shki**/zm/e), përkatësisht mbështetur te *shkjeni* vendi ***‘i shkje’** (sot te ne: “**vendi i shkieve, i shkie+nisë**”) ose edhe si toponim edhe si etnonim: **Shkjenia/shkienia**, raste këto të cekura si dukuri të mundshme (forma të fosilizuara) edhe te burimi: *Fjalor emrash gjeografikë të RSH-së*, Tiranë 2002 ose te N.Veselaj, *Shumësi dhe shquarsia...*, Prishtinë 2015, f. 426).

Pra, që në vitin 1635 ndeshim të identifikuar të dyja trajtat: *shkjav-* dhe *shkie- shki-*, ku përdorimi ose përtheksimi i zanores **i**, në të dyja trajtat e fundit del gjithnjë e më i intensifikueshëm në gjuhën tonë.

Sa i përket fjalës serb serv, folja **seruire**, në këtë Fjalor, del me barasvlerësin **me sherbyem**, me derivatet e rregullta. (Shih Fjalori latinsht –shqip 150.)

2) Nga Kuvendi i Arbnit (1703)

Në Kuvendin e Arbnit nuk ceket emri *shkja* (*shqa*) po në trajtën e shumësit: shqe **shqetë**, sigurisht jo si etnitet shqiptar kombëtar por si një sietni tjetër fetare shkizmatike ndaj. Në të vërtetë, në këtë burim *shqetë* përmenden si etni shkizmatike (ortodokse), ndaj asaj katolike: arbën arbnit arbënve (arbërve). Ashtu quheshin edhe urumët e Greqisë. Sa i përket emrit **serb Serbi** po e shënoj faktin se Pjetër Budi përdor trajtën latine **Servija servijan**, ndërkaq Pjetër Bogdani në vitin 1685 emrin e despotatit e shënon **Sherbi**, pra me SH jo me S, ngase, siç mendoj unë, e kishte të njohur barasvlerësin *servire - me shërbye*.

Sidoqoftë, për ne zgjon interes fakti që në këtë periudhë, trajta **shkja** del edhe me zhvillim: **shqa**, përkatësisht **shqe**, ku KJ kalon në Q (*shka/shqa*), proces ky morfo-fonetiko-fonologjik që ishte dhe është zhvillim i brendshëm i gjuhës shqipe, siç ishte edhe mdërndikim sh/s, madje edhe nga këto dukuri shihet qartë se trajtat e tilla janë veçori e sistemit trashëgimor të gjuhës shqipe dhe tregojnë jetëgjatësi shumëshekullore ekzistimi dhe gjallimi të gjuhës shqipe, përkatësisht të masës së gjerë shqipfolëse si gjuhë e formuar në kontinuitet në kohë-hapësirë relativisht të gjatë e të hershme kohore që dëshmon se shqipja i kishte të pranishme ligjshmëritë e veta të zhvillim-ndryshimit në trevat e caktuara, pra edhe para ardhjes së sllavëve këndeje e përzierjes me ta, por që tani (mbase pas periudhës së Mbretërisë së Dardanisë) nuk e kishte më një qendër rrezatuese burimore. Mirëpo, pa marrë parasysh, edhe kjo e vërtetë tregon vitalitetin e shqipes, edhe pse nuk dokumentohet se ishte apo jo, gjuhë administrative apo gjuhë sakrale fetare në atë periudhë.

Në të vërtetë, pasi nuk dihet sa ishte e gjallë shqipja lidhur me etnitetin ortodoks ajo sa i përket etnitetit katolik ndërkohë dihet se filloi mjaft herët me marrë dorë përdorimi edhe në aspektin fetar abrahamovit, madje dihet se ndërkohë gëzoi zhvillim me emërtim rishtar, si *gjuhë shqipe*, sinonim i *gjuhës arbnore*, të cilën erdhi duke e përqaftuar e zëvendësuar përgjithësisht si term.

3. Nga Fjalori Konstantin Kristoforidhit

Edhe në Fjalorin e Konstantin Kristoforidhit (f. 339), ndeshim përdorimin e këtyre trajtave derivate nga fjala **shkja**: *shqa-u shqe shqetë; shqeni /shqeri; shqenisht/ shqerisht;shqenishte-ja /shqerishte* (f.339-340), ku përveç emërtimit antroponimik që tregon pjestarin e besimit ortodoks grek ose serbo-eleno-bullgar *shqa shqetë* (njëjës e shumës), njëherazi tregon edhe emrin kolektiv etnik: **shqeni-a**, pastaj ndajfoljen *shqenisht* si dhe emërtimin e gjuhës *shqenishte-ja* si gjuhë serbosllavo-bullgare(!) si dhe emrin femëror, nga mashkullori *shqa shqau/shqetë (shqini!)* - *shqinkë* sh. *shqinkata*.

Në këtë Fjalor janë shënuar paralelisht edhe trajtat e rotacizuara, ndoshta të krijuara si raste me analogji si p.sh.: *Shqeri – shqeni, Shqerisht – shqenisht, Shqerishte – shqenishte*.

Edhe nga ky burim mësojmë se trajta *shkja*, që me kohë në këto treva (Shqipëri e Mesme dhe atë Jugore) paska qenë e ravijëzuar në trajtën *shqa*, me derivatet përkatëse, madje paska pësuar edhe rotacizëm, proces ky mjaft i hershëm në historinë e gjuhës shqipe, por që ndërkohë, siç thuhet, në periudhën para ose në kohën e përzier me sllavët, pushoi të jetë aktiv. Në këtë fjalor nuk shënohet fjala *sllav* fare, por si barasvlerës i fjalës *robënia* në greqishte ndeshet *sklavia*, ndërsa barasvlerës rreth emrit serb ndeshim: m. *serb- servos*, f. *serpkë – serva dhe shq. Serbia – gr. Servia*. Madje si barasvlerës për tri variante të emërtimit të profesionit *sherbëtuar, sherbëtuer e shërbëtur* në greqishte shënohen mbi gjashtë barasvlerës dhe plus trajtën e lat. *servus*, ndërsa për **sherbëturë** shënon trajtën **sklavia**.

Edhe në këtë Fjalor, as te toponimi *shqeni* as te antropinimi *shqa shqet* nuk ceket fare prania qoftë edhe e pjesërishme e etnisë shqiptare ortodokse, e cila realisht ekzistonte gjallueshëm gjithandej në shek. XIX, në kohën e hartimit të këtij fjalori nga autori, apo jo!?

4. Nga Fjalori i Bashkimit

Në Fjalorin e Bashkimit (1908, f. 424-425) si barasvlerës përkatës të shqipes në italishte ndeshim:

1) *shkjaa e shqaa-u, shkje e shqe –t /it.: slavo, slavo scismatico* (sllavë, sllavë skizmatikë);

2) *shkjenii-a –/ nazione slava e di religione greca scismatica* (popullsi slave në regjionin greko skizmatik);

3) shkjenisht, ndajfolje- /*alla slava*;
4) shkjenishte- /*lingua slava* (emërtim i gjuhës sllave);
5) shkinë-a shkina-t- / *donna slava e di religionne greca sigmatica* (grua sllave nga regjioni greko - skizmatik).

6) sklavii, robni - schivaitu.

7) skllavosi me skllavos' (*me robitë*) si barasvlerës të italishtes: /*schiavo, predare* (f. 400).

me shkjepue ose me shqepue për barsvlerësit it. /*zoppicare* dhe *storpiare* (me sakatue), përkatësisht fig. **me shkjepue me fjalë** –/essere incoerente (me qenë inkohorent).

Në këtë fjalor nuk dalin të shënuara fjalët as *sllav*, as *serb* si etni, por si barasvlerës për foljen **shërbej, me shërbye** në italishte del servire, por si të veçanta në shqipe dalin këto dy folje :

1. me skllavosë (me robitë), d.m.th. në kuptim skllavërimi (robërimi) si dhe

2. me shkjepue (me shqepue d.m.th. me kuptim shkepje /me shkepë/, ndarjeje (sakatim, përçarje), siç do të shohim kjo folje kuptimisht del e kundërta e foljes *shqipoj me shqipue*, e cila ka të bëjë me të qëlluar, me kohe

rencë, me bashkim, marrëveshje, me hapje rrugë, jo me ndarje, shkepje (shkizim).

Shënim:

Siç mund të shihet në asnjë barasvlerës nga këto burime të hershme të fjalës *shkja* e *shkizmë* nuk përmendën fare fqinj të shkizmatikë sllavojugorë me emra: serbë, malazezë e maqedono-bullgarë, por te K. Kristoforidhi për shqep /shqeni, ceken veç e veç etnonimo-toponimet përkatëse: *serbo eleno bullgare*, gjithsesi si etni skizmatike, d.m.th ortodokse, por nuk përmendet fare etnia shqipfolëse ortodokse (shqiptare), e cila në ato hapësira jo në pak treva kishte përhapje dhe ngulitje të gjerë, madje edhe shumicë, andaj aso kohe në ligjërimin turqisht edhe quhej Arnautistani (i Rumelisë), por edhe **Shqipri** nga vetë shqipfolësit, apo jo?

Por sidoqë të ketë qenë, për fat të keq ky konfuzion ose ngatëresë rreth përzierjes një fe një komb si për turqit ashtu edhe nga perëndimorët për hapësirën për popujt e Ballkanit konsiderohej e tëra me fe ortodokse (skizmatike), e cila megjithatë në njëfarë mënyre përfaqësohej me etnitë përkatëse ortodokse: sllave (serbe, bullgare, malazeze, maqedone),

rumune (vllahë), urume (rumeje) apo greke, duke përjashtuar fatkeqësisht mbase me pahir (e dikush me qëllim) ortodoksët shqipfolës(!!!), koncept ky, i cili (nga shmangia e tillë) ka ndikuar fatalisht në asimilimin e masës shqiptare në etni të tjera. Madje edhe Pjetër Bogdani ortodoksët shqipfolës nuk i quan arbër siç ishin me gjak e gjuhë, vetëm pse i takonin fesë shkizmatike. Për mos me pasë keqkuptim po i referohem punimit të At Zef Oroshit (Shih portali «rd»,19.06. 2019), ku veç tjerash theksohet se Pjetër Bogdani nga ipeshkv i Shkodrës dhe administrator i Tivarit u transferua arkipeshkv i Shkupit dhe administrator i Serbisë në vend të ungjit të tij Andrea Bogdani, i cili kishte pasur autoritetin edhe mbi Ohër e gjithandej, çka nënkupton shtrirjen e katolikëve shqipfolës këndeje e gjithandej, të cilët si shqipfolës ndërkohë kishin kaluar nën autoritetin e kishës ortodokse, pa përjashtuar edhe raste islamizimi. Madje për ne zgjon interes edhe ky fakt që u mbyll gojën shovinistëve garashanianë që manipulonin dhe ende manipulojnë me atroponime mbiemrat sllavë **Bogdani** (që e kishte vetë autori i veprës në gjuhën shqipe «Çeta e profetëve» (1685) i cili e shënon emri **Sherbi** (jo Serbi as Servi), duke respektuar foljen *shërbej me shërbye* dhe ai i censorit Nikollë **Bratishi**, të dy prizrenas që nuk ishin sllavë, po prifta katolikë shqiptarë (me gjuhë arbanase) që ishin barij të besimtarëve katolikë gjithandej në **Sherbi**, vendi i shërbyesve, siç e quan Bogdani. Sidoqoftë, duke mos u cekur qartë ortodoksia shqipfolëse e këtyre rajoneve pati rrjedhojë apo lëshim fatal që ende po e heqin shqiptarët, sepse këtë zbrazëti, e kanë shfrytëzuar atëherë dhe po e shfrytëzojnë ende edhe sot politikisht shqiptarofobët nga qarqet e popuj-shteteve përkatëse, sidomos më të zëshëm janë grekët dhe serbët pravosllavë e të tjerë, të cilët atëherë si sot e injorojnë pa të drejtë gjuhën shqipe si kriter të së vërtetës etnike shqiptare aktualisht e historikisht, apo jo?!

Sidoqoftë, përveç konstatimeve që u dhanë në shënimin si dhe për secilën pikë veç e veç që u trajtuan nga burimet e hershme, tani konstatimet tona po i drejtojmë e rumbullakësojmë rreth natyrës së proceseve ndërtimore gjuhësore të fjalëve si veçori e brendshme e gjuhës sonë, të cilat po i përmbledhim në këto pika:

e para, në të gjitha rastet si primare te trajta *shkja* del togu –KJ- ndaj asaj K, *shka*, por dallon rasti *shkinë* (FB) ;

e dyta, në disa raste vihet re shndërrimi i togut –KJ- në -Q-, si: *shkja* - shqa;

e treta, në të gjitha rastet S-ja nistore e latinishtes del e shndërruar në SH, si p.sh. scla/v ... shkja/v..., ku vërehet domosdo edhe shndërrimi i origjinalit –L- skLa/v (ose i LL-së shqipe) në –J- shkJa/v, fenomen ky fonetiko-fonologjik i njohur në historinë e gjuhës sonë;

e katërta, të gjitha fjalët *shkja-u shqa-u, shka-u ose shkav-I* e sidomos shumësi *shkije-t /shki-të*, dalin në kontanimi kuptimore me konceptin e termit *shkizëm-a (shkyerje, çarje)* dhe

e pesta, në asnjërin burim fjala **shkja**, nuk del në kuptim pejorativ, gjithsesi jo si armik, edhe pse nga informatorët sipas burimeve (katolike) që konsultuam paraqitet si etnonim i huaj (rival), i ndarë si besim skizmatik (ortodoks ndaj atij katolik).

Në të vërtetë, siç e pamë, tek emërtimi i tillë si bashkësi fetare nuk del e cekur ana kombëtare e etnisë, qoftë sllave (serbe, bullgare) ose greke, madje nuk paraqitet as me ndonjë antipati, por as me ndonjë simpati, deri as nga K. Kristoforidhi, i cili si elbasanas ishte i lindur shkizmatik, në fenë e *shkjaut*, ndonëse ishte i avancuar si *engjëllor* i njohur me punë, madje ishte rilindës i shquar prijatar, shkrimtar e gjuhëtar, sibaba i gjuhës shqipe, por edhe ky mjerisht në Fjalorin e tij nuk e cek fare praninë e një masë të *shqeve (shkizmatikëve) shqipfolës* jashtë ose brenda trevave të Arnautistanit shqiptar këta që rronin në bashkëjetesë (të përzier) me shkizmatikë të popujve të tjerë.

Këtë dallim e vën re edhe prof. Mustafa Ibrahim, kur flet për «Paragjykimet midis bashkësive shqiptare dhe sllavo-jugore kur shënon se në shqipe emërtimi «sllav» nënkupton personin në konfesionin *skizmatik, ortodoks* sllav, ndërsa siç del nga konteksti fjalën **shka**, si egzonim emërtimi, e quan «*nofkë përçmuese*» për një person ose grup njerëzish që përqasen me fqinjin **sllav** dhe vazhdon:

Toskët jugorë shklirë quajnë një grua të përdalë, ndërsa shqerëzim – humbje të nderit. Ndërkaq, fjala shka, nga arvanitët dhe arbreshët e Italisë përdoret me kuptimin joarvanit, përkatësisht joarbëresh. Autori dallon variantet e përdorimit shqa, shkla, sklja, përkatësisht shqirë, shklirë, shkinë (Prilep e Krushevë). (Shih: Sociolinguistika, Shkup, 2013, f. 118.)

Sidoqoftë, të gjitha këto çështje do t'i kemi më të qarta pasi t'i kosultojmë dhe diskutojmë

disa gjëra nga burimi aktual: Fjalori i M. Elezit.

5) Nga Fjalori i Mehmet Elezit (2006)

Në Fjalorin e M. Elezit (f. 1367), në krahasim me burimet e mësipërme, ndeshim material jo aq të bollshëm, por disi më të larmishëm rreth emrit **shka** dhe derivateve lidhur me të:

Shka -u ose *shkja, shqa, shkie-t, shqe-të* (prej lat. mesjetare: *sclavus*), emër ky, nocioni i të cili përmbledhet në këto dy përkufizime:

1. **Sllav, ortodoks, kryesisht serbë e malazezë, por edhe të tjerë.**

2. **Armik i kombit; vrasës, mizor; ai që prish e shkatrron çdo gjë.**

Për të dyja këto përkufizime do të bëjmë fjalë në nëntitull të veçantë, pasi të njihemi me 10 derivatet e fjalës **shka**, të shënuara në këtë Fjalor.

Fjalët derivate në Fjalorin e M. Elezit

Në Fjalorin e Mehmet Elezit ndeshim këto fjalë derivate:

1) **Shkavit (me shkavitë)** - (bëj ose veproj) si shka: Shkel me këmbë, prish, shkelmit;. fig. marr nëpërkëmbë.

2) Shkienishte -ja - gjuha serbe, serbishtja;

3) Shkineshkë, shkeneshkë – pulë e egër;

4) Shkinë-a - femra *shka*, fig. e fortë, e zonja, e pamëshirshme;

5) Shkini-a- Serbia;

6) Shkinisht- si *shkiet*;

6) Shkinizëm- *sllavizëm*;

7) Shkirajë - (kompozitë) *shkitë e shkinat* + rajë;

8) Shkinore - lloj dardhe erëmirë...

9) **Shkizëm –shkizmat** – copëtim i diçkaje, spirrë, copë e ndarë. / *I hyni një shkizëm /në dorë./*

10) Shkjenia - tërësia e shkieve, vendi i tyre.

Shënim

Meqë fjala **shka shkja shqa**, edhe pse ishte, siç edhe është në përdorim të përditshëm te ne si dhe në të gjitha viset shqipfolëse, dhe, me sa dimë, për arsye politike nuk është shënuar në asnjërin nga fjalorët tanë normativë të botuar në Prishtinë, por as në Tiranë, ne, si burim aktual për bazë studimi e morëm Fjalorin e Mehmet Elezit, i cili për kuptimin e kësaj fjale u pajis me lëndë të shënuar kryesisht nga trevat e Shqipërisë së Veriut, pa dalë këndeje, jashtë kufijve të shtetit të sotëm shqiptar e me u ulë

më për së rrafshi e më me nge për me mbledhë lëndë sa më shtruese për këtë fjalë-teme, ku vërtet konceptet e fjalës shka, shkja përveç një foljeje, 10 emrave dhe një ndafoljeje, sa janë shënuar në atë fjalor, do të ndesheshin edhe shembuj të tjerë jo të paktë, që, varësisht nga rrethet familjare, mund të ishin edhe më të larmishëm përmbajtësisht, qoftë të natyrës pejorative, qoftë të natyrës më të butë e neutrale, (për shkitë tanë ose shkitë e vendit!!), atëherë mbetet detyrë e studiuesve të sotëm e të ardhshëm që edhe lidhur me këtë fjalë-koncept si dukuri të bëjnë eksplorime e gjurmime, qoftë nga dokumentacionet eventuale, qoftë nga goja e popullit. P.sh. te ne janë të pranishme trajtat pejorative të shkallës më të lartë, femërorja, përveç *shkinë* edhe **shkinulkë shkinulkat** siparavan ndaj mashkullores po ashtu të shkallës më të lartë pejorative përveç shka shkja edhe **shkavell shkavellët** (*shkavellat*), por ndeshim edhe me kuptim joperojativ, si **shkitë tanë**, “*kumara shka të gjindet si vëlla*”, raste të tilla mirëkuptimi në raportin shqipo/shka do të cekim edhe më poshtë.

NËNKREU III DISKUTIM PËR ÇËSHTJE TË IMONUARA GJUHËSORE NGA FJALORI I MEHMET ELEZIT LIDHUR ME TERMAT SHKA E SHKIZMË

Së pari, do të diskutojmë rreth dy përkufizimeve të fjalës **shkja** dhe së dyti, për dy tema risimisht të imponuara: emri: **shkizëm** dhe folja **me shkavitë**.

(1) Diskutim rreth të dyja përkufizimeve të fjalës shka

Nga sa u shprehëm më sipër, e pamë të arsyeshme që tash fill të shpërfaqim mendimet rreth të dyja përkufizimeve lidhur me fjalën *shka shkja; shkie, shqe*.

1) Rreth përkufizimit të parë

Përkufizimi i parë përmban:

Shka shkau - "Sllav ortodoks, kryesisht serbë e malazezë, por edhe të tjerë"-

dhe ilustron me 6 shembuj, qoftë nga burime letrare të autorëve përkatës, qoftë nga krijimtaria popullore, zakonisht mallkime e fjalë të urta. Lidhur me këtë përkufizim shohim pak si pozitive që përveç serbë e malazezë aty përmendet edhe shtojca «*të tjerë*», ku, në të vërtetë, sipas njohurive tona, do të duhej përmendur domosdo si sllavojugorë ortodoksë, përveç *serbëve e malazezëve* edhe *bullgarë e maqedonë*, por si *shkije (skizmatikë)* në këto treva përveç këtyre sllavo-jugorëve, ndeshen edhe etni të tjera të njohura josllave, siç janë: *shki-ciganët (gabelët), (a)rumunët, vllahët* e sidomos *ordoksët shqiptarë*, shqipfolës ose jo, (**shkitë tanë ose shkitë vendës**), të cilët sot mund ta ndjejnë ose jo veten të tillë nga prejardhja, nga mbiemrat familjarë, nga fisi etj.

Po përsërisim me zë të fortë, që si shkie ortodoksë në shkrimet fillimisht të hershme e në vazhdimësi, me kuptim fetar neutral, nuk duhet kuptuar vetëm etnitë sllave (serbe, malazeze, bullgare e maqedone), por edhe *rumunë e arumunë, vllahë e shkiciganë*, por domosdo edhe **shkijet tanë** (shqipfolësit ortodoksë vendës te ne), ngase pikërisht në konstatime të tilla, duke injoruar prejardhjen ose gjuhën shqipe si kriter të së vërtetës në trevat tona përkatëse veriore për shqipfolësit e tillë apo duke mos shprehur me pahir ose nga fanatizmat fetarë të dy- a treanshëm (muslimanë, katolikë e ortodoksë) e përgjithësisht, *është bërë një gabim tejet i madh fatal në të kaluarën, që del i pajustificueshëm në ditët tona. Një anomali të tillë e pamë* (sipas gjykimit të sotëm) *jo vetëm te fjalorhartuesit shqiptarë (katolikë, ortodoksë a muslimanë), të cilët në atë kohë me dorën e (pa)mendjen e vet vepruan kundër etnisë shqiptare e në veçanti në dëm të trojeve të veta historike e aktuale, por aq më keq po i ntrashin me përsëritje të njëjtat gabime edhe faktorët e sotëm në funksione shtetërore e akademike, duke mohuar apo mospranuar e larguar shkijet tanë po edhe të tjerë shqipfolës nga bashkësia jonë shqiptare, apo jo??!!!*

Kështu kam menduar edhe më përpara. Edhe kur kam qenë i burgosur si nacionlistoshovinizist i pa qenë dhe i denuar më 1952/53, edhe më vonë dhe ku kam pasur rast e kam shprehur edhe më parë, si në një simpozium të paftuar më 1992, kur kërkova hapur si duhet të punojmë që t'i kemi *fannolët tanë*, përndryshe po e humbim historinë tonë dhe me monumentet madhore tona do të krenohen të tjerët. Po kush nga

përgjegjësit tanë atëherë e sot kanë menduar e vepruar mbarë për këtë çështje, për ortodoksët tanë shqipfolës.

Si u tha më sipër rreth përkufizimit të parë për fjalën **shka** gjithsesi e shohim të nevojshme të japim një sqarim të shkurtër plotësues. Është fjala rreth konceptit: *shkitë tanë vendës*, të cilëve për shkaqe fetare u është mohuar gjuha e kombësisë që familjarisht e flitnin ose që edhe ende e flasin. S' domend se ky fakt i imponuar nga tradita e kohës, duke injoruar bashkëshqinjfolësit e një gjaku ka shërbyer e po shërben edhe sot feja si argument për të mohuar ekzistencën historike e aktuale të pellazgo-iliro-dardano-epiro-arbnorëve në trojet përkatëse, me gjuhën vet të trashëguar, troje këto, të cilat ndërkohë terminologjikisht nga Iliria ose Dardania, Epiri e Maqedonia u shndërruan në toponimin Shkiavonia (*S(k)llavonia) - **Shkienia**, përkatësisht *Sherbia Servia/Serbia. apo si Sllavo-Bullgari apo Sllavo-Maqedoni dhe së fundi *Serbi e Vjetër* ashtu ishte edhe emërtimi që e bartnim ne si nënshtetas të RFSJ termin qytetarë *jugosllavë*, pjellë e federatës së fundit: *Jugosllavi* (jugo+sllavia), apo jo?!

Për një anomali të tillë në interpretim, me sa dimë, për çudi, nuk është reaguar e sqaruar deri në ditët tona në burimet tona relevante terminologjike nga askush. Së fundi lexova, në faqe interneti një sidiçka shumë pozitive si hap i parë, po ende i paorganizuar, sistemuar e thelluar strukturisht. Më vjen jashtëzakonisht mirë që në Shqipëri dikush po mendon e po vepron xhuvanisht e fannolçe, ndërsa në Kosovë po dalloj dy zëra ndër të tjerë që edhe pse pak vonë zërat e tyre që i dëshiroj vepra në aksion zbatimi, siç është fjala e Jusuf Buxhovit, me shprehjen «*Nuk duhet hequr dorë nga trashëgimia ortodokase e Kosovës* » dhe e dyta, z. Fahri Xharra , i cili apelon që shkencëtarët tanë të dëgjuar «*nuk duhet t'ia mohojnë vetvetes një pjesë të madhe të historisë dhe të varrosin gjenerata të tëra shqiptarësh ortodoksë ... dhe kështu pa asnjë brengë shkencore, me sa mend, ne shkitë, shqiptarët ortodoksë, po ua falim serbëve...*

Sidoqoftë, edhe ne do të përpiqemi këtu të shtojmë diçka po mbi këtë çështje shumë aktuale e shumë të ndërlikueshme, por gjithsesi me shumë interes shkencor e historiko-kombëtar shqiptar, andaj për një qasje të këtij problem kërkohet mbështetje, mirëkuptim nga të gjitha palët.

2) Rreth përkufizimit të dytë

Përkufizimi i dytë përmban :

Armik i kombit; vrasës, mizor; ai që prish e shkatërron çdo gjë,
i cili përveç një mbiemri ilustrohet edhe me 16 shembuj, shumica, mallkime e fjalë të urta, si:

“Ruejna Zot prej shkaut të dejun e prej turkut të untë” dhe të dy mallkimeve:

1) *Ia marrtë shkau tokën!* dhe **2) *Ia preft shkau kryet!***

Edhe pse nuk kontestohet e vërteta nga këto shprehje, na merr mendja se para të thuhet disa fjalë sqaruese ia vlen të konstatohet sesa ia arriti nacional-shovinizmi serb ta shfrytëzojë e njollosojë për keq këtë emër *shka shkije (pravosllavë)* me ngjyrim fetar kundër katolikëve e muslimanëve, kundër popullit shqiptar, po tregojnë vetë fjalët e regjistruara. Në së pari shohim të nevojshme të bëjmë fjalë rreth një *fjale të urtë* dhe së dyti rreth *dy mallkimeve*.

1. Rreth fjalës së urtë “Ruejna Zot prej shkaut të dejun e turkut të untë”

Siç u cek më sipër në Fjalorin M. Elezit dalin të shënuara disa fjalë të urta të ndërlidhura me konceptin *shka, shkije*, sipas përkufizimit të dytë si hezitim ndaj shkjavofobisë e turkofobisë dhe nga këto shprehje e fjalë të urta, veçiam: “*Ruejna Zot prej shkaut të dejun e turkut të untë*”, për të cilën po i themi dy fjalë nga përvoja jonë.

Është e vërtetë se këtë vërejtje si mësim-porosi kam pasur rast ta dëgjoj qysh si fëmijë, para 80 e sa vitesh, por paksa në një version tjetër: *Sa më larg shkavit të pitë e turkit të untë*, por pas vitit 1944 në Prizren e kam pasë dëgjuar edhe në versionin tjetër me përmbysje të funksioneve të personazheve: *Sa më larg shkavit të untë e turkit të pitë*, sepse tash si duket sapo kishin ndërruar raportet. Zotnitë turqeli e shqiptarë që po thuaj para 4 vitesh për një kohë që quhej « **Shqipni** » u ringjallën, rikthyen pasuritë e mëparshme të konfiskuara nga regjimi i Kravevinës Jugosllave e dhuruar serbëve, por tashti ndërkohë kur regjimi serb (komunist) u rikthye, 1944-1945, të dëshpruarit që rihumbën pronat gjenin ngushëllim te gota e rakisë, ndërsa *shkitë serbë* të këndellur, zakonisht të lidhur me pushtetin e rikthyer edhe me sundimtarë të rinj nga Serbia, ishin të pangopur në grabitje të pasurisë së turqelive e të shqiptarëve me autorizimin e shtetit, madje duke u hapur këtyre varësve dy rrugë ose emigrimin në Turqi ose të bëheshin spiunë kundër shqiptarëve.

Me fjalë të tjera edhe nga kjo fjalë e urtë kuptohet se shqiptari ka qenë i shfrytëzuar dhe i maltretuar nga armiqt e tij shekullorë, qoftë nga *turku i untë e shkavit i pitë*, qoftë nga *turku i pitë e shkavit i untë*, që të dy të pangopshëm si pushtetar të huaj për shqiptarin vendas të robëruar.

2. Rreth dy mallkimeve dhe gjeneza e tyre

Nga një mori shprehjesh të tilla veçuar këto dy mallkime: e para **“Ia marrtë shkau tokën!”** dhe e dyta, **“Ia preftë shkau kryet!”**!

Edhe pse sotpërsot mund të gjykojmë se të dyja këto mallkime për mjedisin tonë tashmë mund të konsiderohen të tejkaluara, megjithatë besojmë që për lexuesin historik zgjon interes gjeneza e tyre. Në të dyja këto shihet se fjala fjala *shka* identifikohet me emrin malazez (nga Mali i Zi) e më fort me atë serb (nga Serbia). Konkretisht na shkon mendja te periudha e gjysmës së dytë të shekullit XIX, e cila nuk ishte luftë e vërtetë rivale fetare ortodokse–muslimane, po ishte kryekreje luftë kundërshqiptare për grabitjen e pasurisë e të trojeve të tyre, andaj edhe pësonin besimtarët e rëndomtë shqiptarë muslimanë e katolikë.

Ç’është e vërteta, lufta pushtuese për troje u përsërit edhe gjatë luftave ballkanike 1912-1915. Vetëm Luma më 1913 pati 2400 vikima nga ushtria gjakatare serb, ndërsa në Kosovë deri në vitin 1941 pati shumë më shumë. Në këtë periudhë tokat e shqiptarëve u jepnin kolonëve serbë, besa kjo u përsërit edhe me rastin ripushtimit të viseve shqiptare më 1944-1945, andaj të dy mallkimet, edhe pse nuk përjashtohen raste të mëparshme, kryesisht ishin ravijëzim i ngjarjeve para e pas vitit 1877-78 e në vijimsi. Po në anën tjetër, edhe pushteti i atëhershëm malalez, siç bënë serbët, edhe ky me masakra jashtëmarramendëse dëboi qytetarë e malësorë e bregdetarë të shumtë nga trojet e veta.

Së këtëjmi te shqiptarët u nguliten aq thellë mallkimiet e tilla saqë edhe sot shqiptohen në raste mllefë, apo jo ?!

a. Rreth gjenezës së mallkimit të parë

Nga sa u tha më sipër kuptohet se mallkimi: **Ia marrtë shkau tokën** të shpie tek ajo periudhë ogurzezë rreth ngjarjeve para Kongresit të Berlinit 1878 kur Principata serbe ua merrte tokat shqiptarëve me barbarizëm, duke shfrytëzuar edhe një ferman të sulltanit, por ajo u intensifikua sidomos gjatë vitit 1877/78, ndërsa në Kosovë më vonë u vazhdua e njëjta grabitje tokash e pasurish gjatë Kralevinës Jugosllave (1918-1941). Tash, edhe me metoda legale, siç ishte edhe *reforma agrare*, kur gjoja *ligjërisht me drejtësi (!)* ua merrnin tokat e bukës shqiptarëve dhe ato ua jepnin kolonistëve serbo-malazezë, të cilin kishin të drejtë të pronësonin deri 14 hektarë (Hakif Bajrami) e shqiptarët as katër ari (!) të tokës së vet.

Sidoqoftë, për ne, është e qartë se ky mallkim në viset e Shqipnisë së Veriu, pati po aso dhimbjesh me duhi por aq sa dëbimi i shqiptarëve nga Greqia dhe sidomos e muhaxherisë nga Serbia e sotme Jugore, ku me dhjeta mijë shqiptarëve ua paten marrë tokat me dhunë, dhe nuk ua kthyen kurrë, por ka mjaftuar që të thellohej ky mallkim gjithsesi edhe nga dëbimet e shqiptarëve nga viset e Malit të Zi që edhe këtyre ua mori *shkjau* tokën e bukës dhe nuk ua ktheu kurrë më, prandaj kjo është përgjigjja pse ka mbetur e gjallë deri në kohën tonë shprehja në fjalë, edhe në ato vise banimi që mbeten brenda kufirit të shtetit të sapoformuar shqiptar, apo jo?!

Së këndejmi, po ky mallkim për emrin **shka shkja** me kuptim të thellë armiqësor që e fabrikoi me sukses armiku serb, përkon me dhimbjet që ende i ndjen me shpirt muhaxheria e Kosovës të dëbuar nga Serbia si dhe gjithandej të dëbuarit e shumtë nga Mali i Zi si dhe nga Greqia.

b. Rreth gjenezës së mallkimit të dytë

Gjithsesi mallkimi i dytë, “**Ia preftë shkau kryet**”, ka gjenezë edhe më të hershme se mallkimi i sapotrajtuar, sepse në lufta pushtuese si dhe në rivalitete fetare, por edhe në grindje për pushtet, në luftat e mëpërparshme, vërtet, priteshin kokat. Po këtë dukuri «prerje kokash» M. Milojeviçi e ndërlihd me historinë e etimiologjisë të emrit dhe të etnitetit serb, ngase sipas tij :

«*Kod starih persa sar znači glava ... Sarb ili Serb znači glavoseca (u ratu seće glavu... tako je vladika crnogorski zabranjivao ubijanog neprijatelja to, no nije mu pomoglo)*»

/Tek persët e vjetër **sar** do të thotë **kokë** (krye)... Sarb ose Serb do të thotë **kokëprerës** (në luftë i prenin kokat... Kështu *Vladika* i Malit të ZI ndaloi këtë ndaj armikut të vvarë, por kjo nuk ndihmoi!/?

Mendoj që ky fakt-konstatim i theksuar nga ana e *historianit* Milojeviç për atributin e serbëve si «**kokëprerës**» të kundërshtarëve të vvarë në lufta», tash për tash njafton të kihet në dijëni nga lexuesi, i nderuar, apo jo ?!

Por fundi i fundit, siç dihet prerje kokash praktikohet si më përpara edhe më vonë edhe në kuadër të qarqeve më të larta osmane për shkaqe pushteti, kështu që edhe serbët në luftë për «gjysmë autonomie» morën këtë *yrnek* nga turqit, andaj për të fituar besnikinë ndaj Portës së Lartë, pa iu dhimbsur fare, patën vepruar me kokën e Karagjorgjit, udhëheqësit të Kryengritjes së parë serbe, koka e të cilit iu dorëzua turqve kumara i tij Millosh Obrenoviçi, pa ndonjë përulje kombëtare serbe, ngase, sipas kuluareve thuhet se këtë e bënë për arsye, sepse ai kishte prejardhje *shkipe kelmendase*, apo jo?!!

Sidoqoftë, u tha se raste të tilla kanë ngjarë edhe më përpara. Tani me qëllim ne do të shënojmë disa vargje, fragment nga një këngë popullore shqiptare (kosovare), ku bëhet fjalë për një luftë me ngjyrimet fetare brenda trojeve të Artnautllëkut Verior (sot Serbia Jugore), në të cilën, sipas këngës, lufta ishte si kundërpërgjigje ndaj masakrave të mëparshme të *kaurrëve* serbë kur ka pasur vërtet prerje kokash, andaj kjo u shëmbëllua edhe nga ana e turko-shqiptarëve. Sigurisht historianët e specialistët e folklorit tonë ngjarjen rreth kësaj lufte mund ta dijnë e shpjegojnë më mirë se ne, por sidoqoftë po i rikujtojmë vargjet e paharruara që së pari i kam pasë dëgjuea nga daja Jakup Kuçi i Suharekës para 80 vjetësh:

Kënga «Prej Prokupje deri në Nish»

Prej Prokupje deri në Nish
Na u mbush fusha plot dervishë...
Dervishlerët po luten,
Bajraqet s'po këputen...
Dervishlerët po falen
Bajraqet s'po ndalen...
Bajraku i Zeqit
Mirë po i prin Vezirit.
...Maliq Pasha në at dori
Ugurolla, moj Shqypni
Shqypnia shkon fushës
Na mbloi tymi i pushkës...
Bini djem t'i bijmë
Timat t'i përziejmë...
Bini djem qafirit
Për hatër t' Vezirit...
Dërvishlert po luten
Bajraqet s'po ngulen...
...Kur i ramë tabes së parë
Me kaurrin ballë për ballë
Bini djem dushmanit
Për hatër të Sulltanit !
Kur i ramë tabes së dytë
Me dyshmanin fyt për fyt...
Bini djem dushmanit
Për hatër të Imanit!
...Kur u ramë në tabe të tretë
me dushmanin **perç** për **perç**...
Bini djem dushmanit
Për hatër t'vatanit...

Sqarime

1. *ugurolla moj Shqypni* – përshëndetje moj Shqipni. /Edhe nga ky fakt kuptohet se që në shek. XVII dhe fillim të shek. XVIII fjala *shqipe Shqipni* kishte përhapje masive edhe te ne dhe përfaqësonte etninë

shqiptare kryesisht muslimane ose jo. Këtu kuptohet ushtria shqiptare, vetë shqiptari. Komandant e ushtar shqiptari. Së k[ë]ndejmi shihet se do të rilind, apo sa ka rilindur emri shqiptar. Këtë fakt e quajmë shumë të rëndësishëm. Le ta vlerësojnë studiuesit,

2. *Timat t'i përziejmë* - sulm flakëpërflakë brenda llogoreve.

3. *Tabë –llogore (prita)*.

4. *Bajraçet s'po këputen* – vijnë trupa luftëtarësh varg e vi.

5. *Bajraçet s'po ngulen* – lufta po vazhdon.

6. *“Perça”* - tuf flokësh lënë me qëllim në kokë të luftëtarëve.

Siç kam dëgjuar *perça* praktikohet sidomos te djemtë e bajraktarëve, por edhe më gjerë edhe tek të tjerët. Muslimanët sipas traditës lëshonin perçe më afër ballit, ndërsa kristianët maje kreje, në mënyrë që nëse eventualisht luftëtarit i pritej koka në betejë (kodi i kohës), koka e prerë si trofe të bartej (kapej) më lehtë nga perçja (flokët) jo nga goja, gjuha. Kjo bëhej për mos me iu çartë fytyra luftëtarit, ky ishte njëfarë kodi, sepse nëma më e forte ishte: **T'u çartë fytyra e gjenazës!...** (T'u marroftë fytyra e gjenazës (kufomës) !)

Në të vërtetë, për lufta ku praktikohet ende prerje kokash në anale historike përmenden si raste edhe në vitin 1879, kur gjatë spastrimit të Arnautllëkut Verior (Serbisë së Jugut) nga mbetjet e shqiptarëve (muslimanë), serbët një veprim të tillë e paskan realizuar, duke i ngulur kokat e disa të rinjve të martirëzuar shqiptarë në kunjat e rezhnikave të qerreve dhe i kanë ekspozuar nëpër katunde, ku ende qëndronin eventualisht shqiptarë të pashpërngulur mbase të painformuar për shkak të hapësirës së gjerë gjeografike të shtrirjes së tyre në trojet e veta ose të gënjyer nga besa e fqinjve të pabesë apo duke shpresuar nga ndonjë premtimi ndërkombëtar.

Sa më sipër, përmenda fakte me qëllim, ngase ia vlen për t'u ditur e vërteta, sepse rrënjët e një shkizme të tillë shqiptaro-shkie (serbe) mbi bazë fetare ishte mjaft e gjatë dhe thellë e trashëguar mjerisht dhe gjithsesi e nxitur nga politikat e huaja turke e ruso-serbe, por ekzekutues më fort ish në një anë militantë komandues serbë proruse, ndërsa në anën tjetër edhe komandues turq e turkoshakë (shqiptarë), por populli si popull liridashës, kurr nuk ka prekur në nderin familjar.

Megjithatë, përkundër provokimeve nga aparatet e shteteve okupuese, populli edhe pse fetarisht i ndarë, gjithmonë ka gjetur ndonjë mënyrë të suksesshme bashkëpunimi e bashkëjetese me fqinjët (deri edhe

me kumari e vëllamërim), jo vetëm brendapërbrenda shqipfolësve të feve të ndryshme, por edhe në raporte me serbo-malazezët e popujt e tjerë sipas devizës “*turbullina shkon tretet, zalli mbetet*”.

Pa u zgjeruar shumë në kohë-hapësirë, po e kujtoj vetëm kryengritjen shqiptare, të udhëhequr nga Isa Buletini të vitit 1910, i cili, edhe pse ishte i njohur për të gjithë ato masakra e dëbime kundër shqiptarëve nga serbët, sidomos gjatë viteve 1877-1879, duke pasur për ideal kryesor *çlirimin* nga Turqia, gjatë organizimit të kryengritjes 1910 u furnizua në njëfarëdore apo bashkëpunoi me Serbinë, madje pas dështimit të Betejës së Carralevës, një grup i konsiderueshëm luftëtarësh kryengritës shqiptarë gjetën strehë shpëtimi pikërisht në Serbi, ndersa vetë Isa në Mal të Zi. Ne këtu nuk po ndalemi rreth aftësive ose paaftësive politike, strategjike ushtarake, mospërkrrahjes nga fuqitë e mëdha e të tjera, si dhe rreth faktit më të tejdëmshëm se të gjitha të këqijat e tjera ishte shkëlja e besës nga shtetet fqinje etj., andaj si rrjedhojë gjithë ajo përpjekje shqiptare antiosmane nuk doli aq me sukses asokohe, megjithatë, ndër të tjera dua të përmend një gjë të vërtetë që e kam dëgjuar nga prof. Hilmi Agani, santaksolog, po fillimisht ishte edhe ligjërues i *folkloristikës shqiptare* në Fakultetin e sapohapur Filozofik të Prishtinës –Dega e gjuhës shqipe, kur veç tjerash ne studentëve na pati ligjëruar se jo vetëm disa nga krerët shqiptarë, por edhe individë të caktuar, në luftën e tyre kundër turqve kishin kërkuar ndihmë nga sivëllezërit apo kushërinjtë e vet shkieortodoksë. Kështu sipas tij shqiptari qoftë katolik, qoftë musliman, kur ka qenë në zor prej turkut i asht drejtuar bashkëfqinjtë të tij po shqipfolës për ndihmë:

O ti shka, të paça vëlla, /gjejma ‘i pushkë turkun me vra !...

Kuptohet quhej **turk** ai që bë[n]te zullum në enër të pushtetit turk. Ngjashëm disi e gjejmë të shprehur edhe në literature serbe para fillimit të shekullit XIX, kur serbi (ortodoksi) ka kërkuar dhe ka marrë ndihmë nga fqinji i vet musliman, katolik ose ortodoks, por edhe e kundërta. Kujto shprehjet: “*Brat je mio ma koji vere bio*” - (**ngjashëm**) *Shqiptarin e kam vëlla s’pyes çfare feje ka!*

Kështu ishte atëherë kur feja nuk ka qenë plotësisht e *zhytur* fanatikusht në shërbim të *nacional-shovenizmi serb* ose *osmanizmit ekstrem turk*, kur edhe marrëdhëniet ndëretnike shqiptaro-serbe ende ecnin, si me thënë, në binarë normalë. Ishte koha kur populli shqiptar me *shkitë tanë vendës* sidomos te ne, përkundër propagandës politike turke, si dhe asaj zyrtare të kishës ose knezhevines serbe, jo vetëm nuk kishte

hasmëri ndërmjet katolikë-muslimanë e ortodoksë, por jetonin në njëfarë harmonie, pra edhe me fqinj të sllavë të Serbisë ose të Bullgarisë. Nuk janë pak raste kur individët nga «shkitë tanë», edhe gjatë luftës së fundit i kanë shpëtuar fqinj të vet, jo vetëm nga plaçkitjet e represaljet, por kanë shpëtuar konkretisht edhe shpirta njerëzish nga vargu i të dëbuarve shqiptarë ose atyre të pashpërngulur, siç isha edhe unë prej një Stanisllavi të Shtërpcës, milic që e shoqëronre një rus, apo jo?! Në të vërtetë, kjo temë, po përsëris, është pjesa më e pazbërthyeshme dhe më delikate e aktuale nga shkenca serbe e shqiptare të ne, edhe pse nuk mund të mohohet një prani e tillë pozitive në mbamendjen e masës shqiptare katolike, muslimane dhe të shkive shqipfolës e ortodoksëve të tjerë gjithandej e gjithkëndej, jo vetën në Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi, Serbi e viset e tjera ballkanike, por edhe më gjerë. Në të vërtetë, episode të kësaj teme do cekim konkretisht në vijim të punimit tonë. Fundja varësisht nga situatat dhe nga vetitë e njeriut nuk janë pa vend shprehjet ekstreme: *shkau si vëllau (!)*, por edhe e kundërta: *vëllau si shkau (!)*, ngase te çdo popull në situatë të caktuara gjendet ose tregohet: *njeriu njeri dhe njeriu jonjeri!*

Sidoqoftë, edhe ky fakt u mbetet penë në dorë ose detyrë imediate studiuesve të pasionuar jo vetëm shqiptarë e serbë, por edhe të tjerë, e cila nëse arrihet së zbrëthyeri sa më mbarë, do të ishte një ndër hallkat më të rëndësishme të paqetimit serbo-shqiptarë, paqetim ky, që duhet të arrihet me bindje e ndërgjegje të lartë, sepse siç u pa shkaktare kryesore e acarimeve ishte jo lufta fetare, sa lufta për shtrirje terrioresh ose lufta për ruajtje kolonie nga shteti, natyrisht e nxitur dhe e përkrahur nga propaganda fetare e gërshetuar me interesa politike, sepse fajtor nuk ishte shkau si fetar ortodoks, por nocional-shovinizmi barbar shtetëror serbomadh, siç ishte më parë fajtor ishte pushteti turk osmanli jo populli turk, apo jo?!

Ç'është e drejta, luftë e fundit në Kosovë, nga shteti i Serbisë ishte luftë për mbrojtjen e kolonisë e të kolonializmit, ndërsa nga ana tjetër lufta e shqiptarëve ishte luftë çlirimtare kundër kolonializmit të shtetit serb, jo kundër serbëve dhe shkive tanë si ortodoksë, apo jo?!

Po përsërisim një temë e tillë pret të zbrëthet prej dorës e mendjes së studiuesve të disiplinave dhe të profileve të ndryshme, madje jo të fshehen gjërat, por e vërteta të dalë në dritë, ngase fundi i fundit *shkinat*, ashtu si edhe *shqiptaret*, gratë ortodokse simbolikisht si edhe më parë nuk ishin e nuk janë vetëm *pula të egra*, por edhe *dardha të buta*, por edhe *nëna serioze*, apo jo ?!

Mjerisht urrejtja e tillë e shprehur në mallkime, edhe pse ne e quajtëm tashmë mallkime të konsumuara (të tejkaluara), duhet të zbutet edhe më nga të dyja palët dhe kjo do të arrihet me respektimin bashkëjetësës ndëretnike, duke respektuar emërtimin e etnisë përkatëse, pa e mohuar asnjëherë të kaluarën historike, si dhe gjuhën shqipe, aty ku duhet dhe ku ia vlen të përdoret si *kriter i së vërtetës*.

(2) Diskutim për dy derivatet e imponuara risimisht nga Fjalori i M. Elezit

Tash fill po i trajtojmë dy fjalët derivate, risimisht të veçanta nga Fjalori i M. Elezit, siç janë: **1)** emri: **shkizëm shkizma** dhe **2)** folja: **me shkavitë**, të cilat edhe imponohen si tema interesante të veçanta.

a) Rreth emrit shkizmë si emër konkret

Fjala shkizëm shkizma si emër konkret e fondit aktiv të shqipes në kuadër të konceptit të gjerë kontaminues: **shkizmë/ shkie, shkja/v** te Fjalori i M. Elezit, ngjall interes veçan vetë rasti **shkizëm shkizma**, si fjalë e gjallë aktive e vjelë nga goja e popullit, e cila, siç po shihet shkrimisht, madje edhe sipas konceptit të përgjithshëm strumbullar që mbulon, siç do të shohim, ka ngjashmëri me *ndarje, copëtim*, shkepje, *çarje*, siç e pamë ashtu siç e ka të ravijëzuar konceptin edhe ndërkombëtarizma **shkizmë shkizma**. Lidhur me këtë shtrohet pyetje: Trajta e fjalës aktive popullore shqipe **shkizëm shkizma** e shënuar në krahinën e Lumës, por që ndeshet edhe në Kosovë, ka gjurmë trashëgimie apo është ko incidencë, një si puçje e rastësishme me trajtën e ndërkombëtarizmës në shqyrtim?!

Sidoqoftë, për studiuesin e gjuhës shqipe dhe përgjithësisht zgjon interes të veçantë ky fakt, sepse imponohet si diçka tejet e rëndësishme që duhet hulumtuar parësisht në fushën e marrëdhënieve të shqipes me trajtën *scissmus* të latinishtes apo *schismo* të greqizmes apo të latinishtes vullgare, me fillet e formimit të atyre gjuhëve, apo jo?!

Ne edhe më përpara për konceptin e ndërkombëtarizmës **shkizmë (skizmë)** si dukuri e patëm shënuar lirshëm barasvlerësit sinonimikë, si: *shkyerje (shkiej) me shkye (shkym-), përçarje, çarje, ndarje, shkapje, shkarje, shkasje (rrshasje), me shkasë (me rrëshqitë), shqas me shqasë/ rrëshkas, pastaj shkep / shqep, me (u) shqepë shqepje* etj, - dhe të gjitha këto fjalë sinonime në raste kanë të bëjnë me konceptin strumbullar: *ndarje, hapërdarje, copëtim*, ashtu siç duhet konstatuar që e paska të trashëguar që nga antika fjalë termi *shkizmë-a* me koncept dukurie, ashtu siç e ka edhe trajta e emrit konkret të shqipes së sotme **shkizëm shkizma: copë nga ndarja e diçkaje**, e dëshmuar nga fjalori i Mehmet Elezit edhe nga të folmet në Kosovë, i cili sipas sistemit aktual fjalëformues të shqipes

edhe mund të foljezohet normalisht në trajtën **shkizmoj, me shkizmue** (*me ça, me përça (!), apo jo?!*)

Së këtejmi, pyetja e mësipërme arsyeton vetveten, sepse edhe kjo fjalë nga Fjalori, sipas sinonimisë që ka me fjalë të tjera referuese, siç do të shohim, mbulon koncept të ngjashëm: *çarje, përçarje, copëtim*. Në të vërtetë fjala shkizëm (shkizma) në këtë fjalor e përgjithësisht del në referencë me fjalën e ngjashme *shkimëz* (f.1380), ku vetëm fundorja del me njëfarë metateze: *-zëm/-zmë*. Fjala *shkimëz* shkizma (apo shkizme shkizma!) ose folja *me shkimë(z) apo me shkimzë*, zërthehet në këto kuptime sinonimike: *me fikë (me shkymë!)*, *me shuajtë* (një dritë), fig. *me fikë një "yll", një dukuri*, ndërkaq, fjala *shkimëz* ka sinonimi me fjalët *bjezgë* dhe *spirrë-a*. Kështu nga *bjezgë me bjezgue* dhe *spirrë me spirravë* (apo **me spirrue**) del koncepti i qartë i të coptuarit : *coptoj me coptue diçka* ose në polisemi: *me shkapë të kaptën* etj.

Mos me zgjatë, në përputhje të kësaj sa u paraqit, edhe në bazë të këtij gjurmimi, shqipja ose protoshqipja, më tepër se asnjë gjuhë tjetër, ka të drejtë me kërkue hisen e vet etimologjike (më tepër dhënëse se marrëse) te trajta *scisma* (shkizma), apo jo, qoftë si ndërndikim popullor në latishten vulgare që e kishte ose ishte bashkëpronë e saj në trojet e veta, qoftë në greqishten e vjetër, e cila siç po thuhet, në fillimishte formohej, duke thithur ushqim në pëqinë e nënë-gjyshes së shqipes pellazgo-ilirishte, apo jo?!

Sidoqoftë, nga studiuesit pritet që sa më parë kjo çështje të zërthehet me seriozitetin e duhur. Po përsërisim: fjala *shkizëm shkizma*, sipas këtij Fjalori, së pari i referohet prejardhjesit fjalës shqipe *shkimëz* (metatezisht **shkizme!*), përkatësisht foljes *shkim me shkimë* geg. edhe *shkym me shkymë*, përkatësisht *shqym* ose *shqim*, që sipas fjalorit ka këto kuptime sinonimike: *shuaj, fik, zhduk, asgjësoj, çaj, sakatoj*. Gjithashtu fjala *shkizme*, sipas këtij fjalori, u referohet edhe këtyre dy sinonimeve: *bjezgë* dhe *spirrë*, që të dyja me kuptim konkret: *copëtim* ose *pjesë nga coptimi i diçkaje* përkatësisht: *me bjezgue – me coptue* (f. 216 apo **me spirravë** (f- 1323) ose **me spirrue** –(*me ba shkizma!*) ose *me ba copa* (druri, qelqi), fig. *me ça dërrasa (dru), me ba spirra* (shkizma), me sakatue.

Siç e pamë më sipër, pothuaj të gjithë studiuesit shumësin e antroponimit shkja shki/e, jo vetëm kuptimisht, por edhe etimologjikisht e lidhin me shumësin e emrit të latinishtes: sclavi (shq. **sci /shki*) sing. sclavus (shq. **scla /shkla-shkja-shka*) në kontanimi kuptimore me trajtën

shkizmë, duke u mbështetur në theksin e zanores -I të temës ose të togut nistor shki ose shkij (shkyej), me kuptimin *çaj me ça*.

Profesor Çabej, për konceptin **çaj me ça**, shënonte këto dy folje njërrökshe sinonimike me fundoren -I të theksuar:

e para, **qij** (me qi) nga shqit, duke krahasuar me gr. *ski/'o* dhe lat. *schindo* (*çaj, shqyej*) /Shih: *St. gjuhësore II*, Prishtinë 1986, f. 113/ dhe

e dyta, **kij** (me ki', (rënja e njejtë, prej nga derivati: kizë-a), përkatësisht lat. *incidere* (me ça, me gdhendë) /*St. gjuhësore I*, Pr. 1986, f. 282).

Gjithsesi kjo dukuri rreth dytingullit *shq/shk*, përkatësisht të rrënjës **shki-** të fjalës konkrete *shki'/zmë/* ia vlen të jetë objekt trajtimi më në hollësi nga gjuhëtarët specialistë, apo jo?!

b) Rreth foljes me shkavitë

Trajta e emrit shkav-i (shka-u) si dhe folja prejëmërore: *shkavit me shkavitë* gjithashtu ndeshet në Fjalorin e M. Elezit, me përkufizimin:

Nën 1. **Shkel me këmbë, prish, shkelmit** dhe

Nën 2. fig. **marr nëpërkëmbë**.

Kjo trajtë foljore e formuar mbi bazë të emrit *shka*, si temë fjalëformuese përkatësisht nga trajta më e hershme: **shkav-I** haset në të folme të caktuara shqipe, siç dëshmohet edhe nga pejorativi i shkallës më të lartë: *shkavelli* (*shkav-ell*), e shënuar edhe prej nesh si variantin e fjalës së urtë: *Rueju shkavit të pijtë e turkit të untë*.

Sidoqofë, përftimi i foljes *me shkavitë* ka model prejëmëformimi dhe ndërtimi saj shpjegohet lehtë: (***sclav shklav shkjav shkav**) shkav + it shkavit (shkavis) **me shkavitë**.

Është i ditur fakti se etimologjikisht tema prodhuese *shkav-* e foljes shqipe shkavit me shkavitë ka origjinë ose ndërmikim nga lat. *sclavus /skllav*. Në shqipe, siç është cekur më përpara procesi i tillë arsyetohet si zhvillim i brendshëm i saj: *shklav, shkjav shkav*. Këtu kemi të bëjmë me dukurinë e rregullt morfo-fonologjike të shqipes: nga **s(h)klav* në shklav-i, shkjav:shkjau ose shka-u, ngase sipas ligjshmërive të njohura S-ja nistore latine që në takimet e para të këtyre gjuhëve në shqipe reflektohej në SH. Kështu shpjegohet kalimi i S-së në Sh edhe te fjala sklav lat. *sclavus*, gr. *sclavos* = **shkla/v**, (*Bardhyl Demiraj*), ndërkaq shqipja e sotme si huazim të ri aktualisht pason trajtën: *skllav-I*. Në të vërtetë, po përsërisim, nga ballafaqimi i shqipes së asokohshme mesjetare

me trajtën *sclavus* të latinishtes (spas procesit marrje-dhënie ose dhënie-marrje) u reflektuan trajtat në evoluim e sipër: shklav - *shkav-i* e së fundi rezultoi: *shka shkau, shki shkitë*, përkatësisht pati këto faza përkallëzimi, si:

a) 1. lat. a) singular *sclavus* - njëjësi shq.: 1. shklav shklavi! (skllav-D) *me skllavos*,

shklav shklavan, shkla (*trajtë e gjallë arberore* në Greqi, Itali, Ukrainë),

2. shkjav shkjavi; shkja, shkjau,

3. shqa, shqau ; shqas (*me shqasë*)!

4. shkav, shkavi; me shkavë, me shkavitë, (*shkavos me shkavosë*), (*shkavis me shkavisë*!), (*shkavoj (me shkavue)*)...

5. shkavell-i (!)

6. shka shkau; shkas (*me shkasë*);

b) 1. plural *sclavi* - shumësi ; shklavë-t!, shklevë-t! ; shkle-të,

2. shkjavë-t!

3. shkje-të,

4. shqe-të

5. shki/-të, shki/e-t shkijoj (*me shkijue*), shkijav (*me shkijavë*), shkijos (*me (u) shkijosë*), shkizoj (*me shkizue*), shkiezoj (*me shkiezue*), shkjezjoj (*me (u) shkjezue*).

Si rrjedhojë, përveç dy rasteve foljore që ndeshëm në burimet e caktuara: *me shkavitë* dhe *me shkllavosë* (Bashkimi) që asociacion trajtën *shkavos me shkavosë*, trajtat e tjera edhe pse duket si me qenë si të përfutuara ose të shënuara nga ndonjë burim, ato i sajuam arbitrarisht, por mund të themi se jo vetëm këto, por edhe të tjera, sipas sistemit në strukturën foljeformues të shqipes janë të arsyetueshme që hapakrah mund të qëndronin , apo mund të qëndrojnë aktualisht si rezervë e gatshme që në rast nevojë mund të përdoren pa ngurrim varësisht nga konteksti komunikativ ligjërimor, poetik që ofrohet a nesër, apo jo?!

Sido që të jetë, kur kemi parasysh versionet e emrit *shkja*, përveç rastit S/Sh, që u trajtua më sipër, për dallim nga trajta e latinishtes shihet edhe rasti ose procesi tjetër: velarizimi i –L-së në LL, pastaj procesi kur kjo l ose ll pothuaj normalisht shndërrohet në J, andaj del trajta edhe sot e gjallë aktive *shkjav/shkja* nga *shkla/shkja*, poashtuedhe zhdukja J-së te trajta *shka* e *shkinë*, ndërsa shumësi

shki shkije nën ndikimin e shumësit të latinishtes *sclavi*, përkatësisht nga kontaminimi i konceptit me fjalën **shki**+zmë). Është interesant përkimi

njëjës e shumë të ne i emrit **shka-u shkie-t** me *ka-u kie-t*, përkatësisj *shka-u shqe-të/ ka-u qe-të*.

Sidoqoftë, në këtë kompleks ndodhi edhe procesi tjetër, nga trajta **shKJav, shhkjav-i**, -KJ-ja e mesit në treva të caktuara të Shqipërisë së Mesme dhe të asaj të Jugut u shndërrua në Q: *shqa e shqe*, ndërkaq në disa të folme gege –J-ja edhe u zhduk fare, andaj doli trajta **shkav shkavi**, prej nga u përftua folja prejëmërore **shkavit me shkavitë**, ku v-ja duket si epentetikë, ndërsa I-ja i takon temës fjalëformuese, morfemë kjo e cila ka shërbyer si temë prodhuese për formimin e emrit pejorativ të shkallës më të lartë shkavell (*shkav-ell*).

Po mbi këtë bazë brenda shqipes është zhvilluar edhe dukuria e rotacizmit. Kështu, ndërsa në viset veriore e qendrore ndeshim trajtat: *shka, shkja* ose *shqa shqe, shkjeni shqeni, shqenisht, shkienisht, shkinisht* e *shkinë*, në viset jugore: *shkjeri* e *shqerisht* edhe *shqirë*. Siç dihet dukuria e rotacizmit ishte e shfaqur që në periudha të hershme, gjithsesi para ose gjatë takimit të shqipes me gjuhën sllave, apo jo?!!

Gjithsesi, folja *me shkavitë* në kuadër të sistemit foljor të shqipes del e arsyetueshme, por sikurse edhe emrit **shka** edhe ajo duhet me u cilësue si historizma, përkatësisht duhet shtuar si sqarim plotësues rreth përcaktimit të nënfushës semantike që mund të përdoren edhe aktualisht, varësisht nga stili ose konteksti që ofrohet.

Përmbyllje

Si e veçanta e këtij kreu vërehet fakti se pëveç trajtimit të gjenezës së dy apo tre termave ndërkombëtarë shkizmë (si dukuri) dhe sllav (skllavë) e serbë (*sherb-) si etni u imponua më në hollësi analizë-trajtimi i kontaminimit të këtyre dy koncepteve në gjuhën shqipe, sipas asaj që ofrohet në burime leksikografike, por edhe sipas koncepteve të gjuhës së sotme aktuale.

Sidoqoftë, edhe në këtë krye u konstatua se *inJORIMI I DERITASHËM I GJUHËS SHQIPE SI KRITER I SË VËRTETËS DHE I MOSSTUDIMIT TË MIRËFILLTË TË SAJ SOT BIE BUMERANG NDAJ MOHUESVE TË SHQIPES E KOMBIT SHQIPTAR DHE APATRIDËVE PERVERS*, sepse sot gjithnjë e drejta dhe e vërteta po del sheshazi në të mirë të saj. Siç dihet për shkak të trysnive e intrigave të huaja të atëhershme një pjesë e konsiderueshme nga **shkitë** dhe **shkinia** shqipfolëse nga trevat tona mohuan në proces gjuhën e vet dhe u serbizuan. Së këndejmi edhe lidhur me atë dukuri ende kanë mbetur jo pak

gjëra të pandriçuara, ndër to është e hapur edhe çështja e *shkive tanë* shqipfolës, të cilët sipas rrethanave të caktuara nuk ndryshuan as gjuhën e vet as fenë e të parëve, edhe pse te ne nuk patën ndihmë as mirëkuptim të duhur nga palët e tjera fetare katolike e muslimane, madje as mundësi për kujdesjeje nga autoqefalia shqiptare, të cilës i kanë munguar dhe po i mungojnë *fannolët e rinj* apo jo!

Si do që të ketë ndodhur, shkenca shqiptare, si dhe ajo botërore sot e nesër duhet të njihen me të vërtetat e reja shkencore të panjohura ose të mohuara ndër shekuj rreth shqiptarëve ortodoksë të viseve tona veriore në kohë e në hapësirën e deritashme dhe të sotme. Së këndejmi, ne nga ky nënkrye punimi, duke lënë hapur mjaft çështje për studiuesit, ofrojmë mjaft risime, qoftë si nisma, porosi ose propozime e ndonjë zgjidhje, të cilat shpresojmë se do të ndihmojnë në të mirë të zbrëthimit dhe konsolidimit pozitiv të mëtejshëm të disa çështjeve mjaft komplekse nga tema në shqyrtim, ndër të cilat i ofrojmë lexuesit dhe sidomos studiuesve të gjuhës shqipe, që t'i kenë në konsideratë këto:

E para, kërkohet që trajta e fjalës *shkizmë* drejtshkrimisht të legalizohet ose të parapëlqehet si parësore ndaj asaj *skizmë* për gjuhën shqipe standarde për këto arsye:

së pari, sepse tregon ndërlidhshmëri përftimi me fjalë-trajta e hershme ndërndikuese në raportin ndërhuazues shqipe/latinishte, ku S-ja nistore dhe përgjithësisht e latinishtes në shqipe reflekttohej SH.

së dyti, trajta **sc-** e latinishtes në shqipe të shënohet e shqiptohet SHK-, edhe pse italishtja zakonisht për disa fjalë nuk e shqipton K-në,

së treti, togu konsonantik nistor SHK- konsiderohet si veçori e shqipes për faktin që nga trashëgimia, që ilustron edhe me argumentin se vetëm në FGJSH 2006 janë të pranishme afro 90 fjalë-folje të shqipes standarde që fillojnë me këtë formant nistor **shk-** dhe

së katërti, fjala *shkizma*, e konsideruar si ndërkombëtarizëm ose fjalë e huazuar, nuk është vërejtur që është e pranishme dhe aktive nga trashëgimia në gjuhën tonë popullore të përditshme, madje edhe si fjalë gjalluese (jo si fosil) në të folmet e caktuara të gjuhës shqipe, madje edhe përkon me konceptin strumbullar që ka **shkizma si ndërkombëtarizëm: ndarje, coptim, shkyerje** (shqyerje shkymje / shkyemje, andaj studiuesit duhet ta japin përgjigjen: ka, apo jo, të drejtë shqipja, me kërkue pjesë-hisen e vet burimore në krijim-formimin e kësaj fjale, qoftë brenda latinishtes apo të asaj vulgare ose të gjuhës lashtogreke, apo jo?

E dyta, edhe emri *shka shkja/v* krahaso lat. e gr. *schlav-* që në shqipe fillimisht doli shkla(v) e derivate e variante të tjera si fjalë aktive: **shkja shka**, edhe kjo duhet të shënohet në fjalorët tanë normativë, por gjithsesi lidhur me këtë duhet pasur parasysh:

së pari, faktin që edhe me këtë shembull përforcohet konstatimi nga pika e mësipërme se S-ja nistore e latinshtes në shqipe në kontaktet ose ndërhuazimet e para ishte reflektuar SH (sclavus – shkla/v, shkja...),

së dyti, ndryshimet e trajtave në shqipe *shklav shkjav, shkja shka, shqa* shpjegohen si zhvillime të brendshme të shqipes të bëra sipas rregullave dhe proceve fonetiko-fonologjike të ligjeve të saj në rrethana të ndryshme gjithsesi të pavolitshme shoqërore për shqipfolësit,

së treti, edhe pse shumësi i fjalës nga *shka (sclavus)* përkon paksa me shumësin e latinishtes lat. *sclavi (shkie shqe)* është konstatuar jo pa vend që sipas rrethanave të caktuara në kohë-hapësirën në trajtim kjo formë funksionalisht më tepër afrohet me togun nistor të fjalës *shki /z*, përkatësisht me ndërtim-kuptimin e fjalës *shkizmë*,

së katërti, gjithashtu për shkak të rrethanave të caktuara trajta e sotme e shqipes *shka* e *shkie* nuk përkon me kuptimin që ka fjala *skllav* ose *sllav* në gjuhë të ndryshme, sepse fjala *shka shki/e* në shqipe ka marrë kuptim të specifikuar që mbulon nocionin, qoftë të sllavojugorit skizmatik, qoftë edhe vetë shqiptarit ortodoks (shqipfolës) – **shkive tanë**, ose **shkive të vendit**, të cilët ende flasin shqip edhe pse i janë afruar edhe gjuhësisht bashkësisë sllave pasi kanë mbetur vetëm skizmatikisht të krishterë në kuadër të kishës serbe, për mungesë të autoqefalisë së vet shqiptare dhe

së pesti, në shqipen e sotme fjala *shka* (serb), *shkinë* (serbe)nga kuptimi neutral ka marrë kuptimësi pejorative të shkallës më të lartë, me derivate derivate përkatëse si te emrat në gjininë mashkullore **shkavell**, në gjininë femërore **shkinulkë**, pastaj edhe folje, si: *me shkavitë, me shkavosë* (edhe pse pejorativisht, tashmë duhet të jenë të konsumuara), por si fjalë-folje ose si emra kanë mundësi përfthimi edhe me prapashtesa të tjera po mbi këto tema prodhuese, andaj duhen shfrytëzuar si pasuri potenciale gjuhësore të shqipes, apo jo?!

së gjashti, edhe lidhur me fjalë-termin **serb**, pa u zgjatur, siç doli nga analiza del e domosdoshme të njihet e vërteta se në shqipe për konceptin **servus, serbos e serb-** në shqipe i kemi të reflektuara tre barasvlerës jo aq sinonimikë: **shërbyes, shërbëtor** dhe **serb**. Madje edhe rasti i P. Bogdanit që toponimi quhet Sherbi (sherbej servire) ka sqarim,

apo jo?! Gjithsesi edhe kjo dukuri zgjon interes, ngase në shqipe sidomos trajtat *sherbyes* e *serb*, madje edhe *shërbëtor* nuk kanë pasur as nuk kanë edhe sot kuptimësi pejorative ndaj etnisë *serbe*, ngase si duket hapsinisht kanë pasur identitet të përbashkët bashkëjetese e veprimi, apo jo?!

së shtati, bëmë vërejtje që nga përdorimi i këtyre fjalëve *sllav*, *shkizëmë skizmatikë*, (*serbë*) kryesisht nga pala fetare katolike shikuar sipas kuptimit dhe interesit të sotëm kombëtar shqiptar është bërë pa qëllim lëshim shumë i madh fatal në burimet leksikografike të shqipes ndaj popullsisë shqiptare të fesë tjetër kristiane, ortodokseve shqiptarë, ngase etnia shqiptare duke mos u përmendur fare në viset që quhen vetëm *sllave* ose *greke skizmatike* apo *serbe*, *bullgare* dhe kështu me këtë fakt është ndihmuar formimi i konceptit të gabuar shumë të padrejtë ndaj historio-geografisë shqiptare dhe njëherazi është ndihmuar përshpejtimi i asimilimit të tyre, ngase kjo etni shqiptare në shumicën e viseve të tilla deri vonë ishte numër shumicë ose numër i konsiderueshëm që identifikohesh, por që edhe sot mund të identifikohet edhe me gjuhën shqipe.

Së teti, ky lëshim ,sipas pikës paraprake, në të vërtetë fatkeqësisht ka ndodhur dhe është shfrytëzuar si *sherr me rrugë* nga kancelaritë joshqiptare ose shqiptarofobe, sepse në mesjetë deri në rilindje banorët quheshin e shquheshin sipas besimit fetar ose emërtimit të toponimit e, jo sipas etnisë së vërtetë historike e aktuale ose të gjuhës që e flitnin, kështu që nga *shkizma e madhe* fatale shqipfolësit pësuan së tepërti, sepse pjesa më e madhe gjeografike e tyre i takoi gjeografikisht Perandorisë Bizantine e si rrjedhojë edhe fesë ortodokse të ashtuquajtur skizmatike (greke, sllave ose rumune), dhe kështu meqë shqipja nuk ishte gjuhë sakrale, ortodoksët shqipfolës pësuan rëndë, madje si me thënë, ndiheshin si *të huaj* jo vetëm fetarisht, po aq më keq edhe gjuhësisht, sepse edhe sipas burimeve të hershme të gjuhës shqipe, edhe pse jetonin në trojet e veta nuk shënoheshin si arbnorë (epirotë shqiptarë) as nga vetë nga vetë shqiptarët (e shkolluar!), po cilësohej e tnia e tyre nga emërtimi gjeografik i vendit apo sundimtarit apo shtetit, ku banonin., por më gjerësisht për këtë në kreun vijues.

Kreu IV
ARBËRIA GJATË PERIUdhËS SË SUNDIMIT OSMAN,
RAPORTI TURKO-SHQIPTAR/ SLLAVO-SHKA
DHE PASOJAT FATALE
MBI SHQIPFOLËSIT NGA SHKIZMA E RE

Hyrje

Në këtë krye do të bëjmë fjalë rreth injorimit të gjuhës shqipe në Arbëri gjatë periudhës së sundimit osman, raporti *turko shqiptar /sllavo shka* dhe pasojat nga **shkizma e re** fatale brenda **arbër-shqiptarëve** dhe në këtë kontekst gjeneza *shqipo/shka* me theks në dy pika:

a) rreth konceptit kontaminues *shkie sllavë* (serbë e malazezë) ndaj **shkiet tanë** vendës ortodoksë (shqipfolës)/*shqiptarë* dhe

b) pasojat nga fanatizmat fetarë dje dhe sot në raportet shqiptaro-serbe, si çështje e hapur ogurzezë si dhe do të përpiqemi me hedhë dritë rreth etimologjisë së apelativit **shqiptar** lidhur me foljet **me shqipë (shqip)** dhe **me shqipue (shqipoj)**.

Ç’është e vërteta, siç mësojmë nga parahistoria, historia mesjetare dhe ajo e mëvonshmja, shqiptarët historikë përjetuan disa *shkizma* (çarje a shkyemje brenda vetvetes) të shkaktuara me intrigancat e të tjerëve, por edhe me fajet ose mosmarrëveshjet nga vetvetja, por të gjitha këto shkizma ishin me pasoja të pashërueshme fatale për mbarëvajtjen e shqipfolësve në kohë-hapësirat vijuese, pasi prishej shumëçka, ngase për shqiptarët pa shtet të vetin, ishte i pamundur rrezatimi unik nga një qendër drejtuese.

Pa hyrë në parahistori rreth pellazgëve parailirë, kur protoshqiptarët mitologjikë në periudhën politeiste kanë përjetuar disa *shkizma* (çarje, përçarje, ndarje, emigrime). Ndër të tjera, më me shumë pasoja ishte edhe Lufta e Trojës e shkaktuar, siç po thonë studiuesit, mes protoshqiptarëve, pastaj ndodhën përçarje mes fisesh ilire e pasilire dardano epiro-albane si dhe pas futjes së Ilirisë në sundimin e Perandorisë Romake, përveç kryengritjeve të prira nga “*batot*”(bacët iliro-dardanë), përmenden shkizma edhe gjatë kontakteve barbaro-dardane e në veçanti sllavo iliro-dardane, bogumile, tribale e të tjera, nga të cilat pos tjerash si rrjedhojë ndodhen edhe simbioza konkrete sllavobullgaro-shqiptare, pastaj edhe serbo-shqiptare, ku masa të gjera protoshqiptarësh gradualisht etnikisht e gjuhësisht u tjetërsuan në popuj të tjerë, por si shkizma të

periudhës historike monoteiste fatale për shqiptarët, po i përmendim dy, **të parën** si “*shkizme të madhe ndërkristiane*”, të cilën vetëm po e rikujtojmë, sepse paksa e trajtuam në kreun më sipër, kur shqipfolësit i preu në palcë shpata e asaj shkizme kristiane, ngase ata detyrimisht *u shkizuan* në dy rite rivale brenda të njëjtës fe: *ortodoksë* në njërën anë e *katolikë* në anën tjetër dhe si pasojë pati edhe konflikte apo ndarje pa kthim mes tyre në plan të gjerë. Ndërkaq **shkizma e dytë “e re”**, sipas nesh, ka ndodhur më vonë, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, shkizme kjo e cila për mendimin tonë për shqipfolësit, pati pasoja edhe më fatale gangrenëse, për të cilat do të flasim në vijim. Kjo shkizme që po e quajmë kushtëzimisht **shkizme të re** në krahasim me të parën, pasi nuk kishte të bënte me ndarje në dy rite kristiane, por me dy fe të ndryshme të mirëfillta: **kristiane/ islame**, fetarisht ishte edhe më me pasoja të rënda se **shkizma e parë**, pikërisht në stroullimet tona ballkanase, sepse tani kemi të bëjmë edhe me ndarje ndërfitare e gjuhësore të një natyre tjetër, ku armiqtë e shqiptarëve kishin edhe më shumë mundësi manipulimi përçarëse në mentalitetin e masës së gjerë shqipfolëse.

Kështu shqiptarët përveç raporteve të ndërlikuara, siç ishin raportet *shqipo-sllave*, *shqipo-greke* e *shqipo-latine*, tashti kemi të bëjmë edhe me një raport tjetër me marrëdhënie **shqipo-turkoarabe** dhe pikërisht kjo ndodhi për një kohë mjaft të gjatë, kur edhe ndodhën mjerisht edhe rivalizime të reja të shpifura, pikërisht atëherë kur fillon edhe konsolidimi i kombeve në Europë e më gjerë mbi bazë feje e gjuhe. Së këndejmi, rreth kësaj dukurie shumë të ndërlikuar që përjetuan shqipfolësit gjatë kësaj periudhe në zhvillimin historik të tyre, do të përpiqemi me qartësue sadopak brenda dy nënkrerëve të këtij kreu.

Nënkreu I RAPORTI ARBËR/SHQIPTAR DHE SHKIZMA FATALE IDEO- FETARE, NDODHUR GJATË PERIUDHËS OSMANE

1. Dy fjalë rreth identifikimit gjeografik të Arbërisë

Siç dihet populli shqiptar si pasardhës i pellazgo-ilirëve, pëfkatësishst në anën tonë Dardanisë, që nga koha e mesjetës së hershme del i identifikuar në hapësirën e Tetrakisë së Diklocianit (*Provalis* - Shkodër, *Epiri i Ri* - Durrës, *Epiri Vjetër* -Nikopol (Prevezë) e *Dardani* - Shkup) deri në shekulli VII-XVIII me emrin, **arbër (arbën) Arbëri (Arbëni)**, duke i lënë nën hije termat, si: iliro-prevalis, iliro epirot ose iliro-dardani etj. Fakti që emërtimi Arbër Arbëni (albën Albëni! Albani) ishte i njohur që në fazat më të hershme në latinishte e i.e. **alb* me kuptim “*bardh*” që sugjeron trajtën **alp** (Alpet malore), njëherazi del e përftuar edhe rrënja **arb** në atë fazë antike bizantine *Arbanon, Arvanita*. Kështu ky emërtim qoftë me *alb-*, qoftë me *arb-* nistore, gjë që e dëshmojnë popujt e shtetet e reja përkatëse (pas romane latine e bizantine) siç janë edhe popujt e hapësirave Sllaveni, Servia (Serbia) a Sherbia në kontakt ose të përzier me paraardhësit tanë iliro-dardanë në atë kohë, të cilët edhe do ta emërtojnë këtë popull e vend po mbi këtë bazë:

- it. albanese Albania,
- fr. albanais Albanie,
- gjerm. Albaner Albanien
- angl. albanian Albania,
- gr. arvanitis Arvania,
- sll. arbanas Arbanija, Albanija
- turq. arnaut Artnautllëk, Arnautistan,
- shq. arben Arbeni/arbër Arbëri/ dhe ndërkohë: shqiptar

Shqipni/Shqipëri.

Sido që të ketë qenë, këto emërtime me ndryshim konsonanti të parë të rrokjes nistore **r/l**; *arb-/alb-*, *arv-*, *arn-*, mbetën të qëndrueshme. Kështu ndërsa për botën e jashtme perëndimore: –L- alb /an mal bardhësi, njeri i malit, njeri i bardhësisë(!), ndërkaq për arbërit e kohës dhe botën lindore identifikohet -R-ja: AR/ban, njeri i arës, njeri i fushës(!), ose njeri i Ar-të me vlerë ! apo jo? Për iliro-shqiptarët simbolika e nistoreve të emrit Alb-Albani, bota bimore, përkatësishjt **Arb -Arbni**, bota fushore ka nxit studuesit që të gjurmojnë fjalë-emërtimet përkatëse të kësaj natyre në krahasim me gjuhët e popujve të tjerë. Kështu për shembull studiuesi serbo-jugosllav Bogomilj Hrabak (1927-2010) konstaton se shqiptarëtme gjuhën e tyre ndaj gjuhës serbo-sllave me shekuj kanë përparësi, jo vetëm sa i përket emërtimitnga bletaria: *bleet, mjaalt, dyyll*, por edhe emërtimit të drunjve, dhe vërtet, pa hyrë në hollësi, vetë dukuria e këtyre emërtimeve, si: *bung, qarr, lis, dushk; daardh, mooll; shtag, shkop, kunj*,

thumb etj. kryesisht njërrrokësha, identifikohet një kohë-hapësirë lashtësore gjallimi të shqiptarëve e të gjuhës së tyre gjithkëndej e gjithandej, gjë që lashtësia e tyre nuk mund të mohohet dot, apo jo?!

Sidoqoftë, ndërkohë shumë fjalë nga bota e brendshme arbërfolëse mbeten të gjalla në përdorim, po jo pak prej tyre, u pasivizuan, për shkak të rrethanave në ndikim simbiozor greko-arvanitis e sllavo-arbanas, apo në pushtimin turko-arnaut, si dhe të gjuhëve neolatine- albanese etj. dhe kështu, që nga shek. XV edhe emërtimi: **arbën Arbni** filloi të pasivizohej, dhe kështu që nga shekulli XVII -XVIII e këndej vetë banorët vendas e ripërtrinë ose e përqaftuan emrin **shqiptar**, ndërsa atdheun, edhe pse të robëruar Albani e quanin *Shqipri (Shqipni)*. Pse ndodhi dhe si ndodhi kjo? Kjo çështje nuk ka mbetur pa përgjigje, mirëpo shpjegimet e derisotme rreth gjenezës së fjalës *shqipe shqiptar Shqipni*, edhe pse rreth kësaj çështjeje gjithnjë e më tepër po hedhet dritë me shpjegime të reja, megjithatë hipotezat kanë mbetur ende në nivelin e supozimeve. Ne përshëndesin çdo tentativë në këtë drejtm.

Ndërkohë në gazetën “Bota sot”, 13.12.2019, f. 20, në fund të artikullit; “*Origjina e fjalës “Shqipëri” dhe pse bota e quan “Albania”*”, pasi sqarohet përhapja e fjalës **arbër Arbri Arbni**, prej nga del ajo albanez *Albania* jepen këto konstatime me interes:

Përsa i përket emrit shqiptar, Shqipëri Shqipni, ky si emër populli e vendi që zhduki (!) emrin e vjetër: arbër Arbni... rezulton gjatë kohës së sundimit turk... Shtysat konkrete për një zëvendësim të tillë nuk mund të ndiqen... Vetëm një gjë mund të thuhet me gjasë të madhe, që shqip në krye të herës ka qenë emri i gjuhës. Ky si i tillë ka qenë mbase me përdorim më të mocëm, ndoshta paralel me emrin arbën arbër si emër etnik dhe pastaj do të ketë shtrirë fushën e përdorimit, duke përfshirë edhe popullin e vendin.

Kështu disi me dallim se nuk pajtohem me fjalën **zhdukje** të emrit arbër, jam shprehur edhe unë më parë, siç do të përpiqem ta sqaroj më në hollësi tash fill, me tekst të rishikuar:

Sidoqoftë, me qenë që është fjala për një periudhë kur populli shqiptar (arbnor) pas vdekjes së Skënderbeut u gjend në situata të reja shumë të vështira dhe delikate, sepse Turqia si ripushtuese pas luftave me Skënderbeun, ishte e pamëshirshme kundër arbër-epirotëve, e cila veç tjerash atëherë e rëndoi situatën edhe me taksa e obligime të reja. Ai regjim në mënyrë të jashtëzakonshme pati shprehur alergji kundër të gjithë shqipfolësve, jo veç disa ortodoksëve t’i quajmë të moderuar

filoskënderbegas nga jugu dhe të Shqipërisë së mesme unitas, ajo në veçanti u shpreh egërsisht kundër etnisë katolike në veri, e cila, edhe pse mbase ishte më e vogël në numër, sa i përket shtrirjes gjeografike si arbërfolëse përfaqësonte zemrën e idealit të asaj popullsie kundërosmane, sepse ishte e lidhur dhe e ndërlidhur fetarisht e politikisht me Perëndimin, armikun më të madh të asokohshëm të Perandorisë Osmane, por edhe të Patrikanës ortodokse të Stambollit. Për atë popullatë shqipfolëse (*katolikë e ortodokse unite por edhe muslimane atdhetare, të rebeluar kundër pushtuesit, për t'u shpëtuar represaljeve të pamëshirshme të Turqisë u hapën dy, përkatësisht tri rrugë shpëtimi: e para shpërngulja jashtë, e dyta, disi më e mëshirshme: konvertimi i tyre në fenë islame (sunitë), por njëherazi, si mundësi e tretë, për ortodoksët shqiptarë u la e lirë edhe një rrugëzgjdhje, lojalizimi me nënshtrim ndaj autoqefalive sllave e greke, ku nuk praktikohesh si gjuhë sakrale shqipja. Kështu një pjese jo të vogël të shqipfolësve ortodoksë rrethanat u diktuan të kërkonin mbrojtje nën hijen e Patrikanës, e cila edhe ishte aleate zyrtare e Sulltanatit dhe kishte imunitet të përkujdesej për besimtarët e vet (ortodoksë) drejtpërdrejt e nëpërmjet autoqefalive përkatëse.*

Në të vërtetë, siç është thënë më sipër, po që tash po e përsërisim, arbnorët pas periudhës së hershme pasilire nën perandorinë romake-bizantine, përkatësisht bizantino-sllave dhe tani nën perandorinë osmane, periudhë kjo afro 500 vjeçare për shkak të rrethaneve të imponuara, sidomos me islamimin e shumicës të tyre, emërtimin **arbër arban** gradualisht e pasivizuan. Dhe pas këtij pasivizimi, siç theksohet nga studiuesit, tashti për shqipfolësit arbnorë të ne disi u përlindën dy emërtime të reja me konotacion të ri antonimik: **shkja** (për ortodoksët) dhe **shqipo shqiptar** (për arnautët shqipfolës muslimanë). Dhe pikërisht, jo vetëm lindja e emërtimeve të tilla, por vetë ndarja e tillë shoqërore ishte shkak-pasojë e asaj çarjeje që ne e quajtmë **shkizmë të re** po ashtu **shkizmë të madhe fatale për shqipfolësit**. Kështu e pagëzuan dhe e njohim si **shkizmë** me pasoja vërtet gangrenëse për arbërit, ngase kjo shkizmë e re preku dhe vrau gjuhën e një pjese të konsiderueshme të arbërishtfolësve. Nuk është fjala vetëm të shpërngulurit gjithandëj nga Perëndimi, por edhe nga Lindja muslimanë e ortodoksë, dukuri kjo që ndodhi, pikërisht në epokën e konsolidimit global të kombeve në Europë si shtete të rijosajuara, kryesisht mbi bazë gjuhe e feje. Të rikujtojmë faktin se ndërsa **shkizma e madhe**, siç qe konstatuar më sipër, që ne e quajtmë si **shkizmë të parë historike**, ishte më fort një ndarje të një feje që e kishte Biblen si kod

orientues, ndonëse me interpretime doktrimore të papajtueshme rreth disa pikave nga katolikët e ortodoksët, tashti pjesa shumicë shqipfolëse e konvertuar në islam, edhe pse sa me thënë, ngase vazhdonte me respektue **Krishtin** dhe **Biblën**, megjithatë si libër kod të shenjtë orientues e zbatues e kishte **Kur'anin** dhe si profet absolut të ri më të autoritetshëm se profetët e tjerë e njihte **Muhameddin**, madje tani gjuha e riteve, për këtë pjesë, nuk kryhej as mbi bazë latine as greko-sllave, por mbi bazë arabo-turke, edhe pse ajo fillimisht e në vazhdimësi bëhej vetëm me ndonjë formulë arabo-turke, ngase të tjerat (lutjet) në namaz në heshtje kryesisht i kryente imami.

Ne nuk do të prekim rastin e shkizmave të tjera rreth asimilimit të parailiro-protoshqiptarëve gjithandej në viset e Azisë e të Afrikës në turko-arabë e të tjerë, por do të ndalemi vetëm në viset e hapësirës së sotme ballkanike (kryesisht hapësirën e *tetrakisë dioklociane*), ku në të vërtetë pati prekur me ashpërsi kjo **shkizmë e re**, e cila sipas hipotezës së cekur nga z. Piro Prifti, mbështetës i F. Xharrës, paska pasë filluar tek shqipfolësit, pikërisht që me pushtimin e tokave të Arbnit nga Perandoria Osmane, përkatësisht që nga momenti kur fillon pranimi i islamizimit nga banorët shqipfolës të Arbnisë. Ç'është e vërteta, siç shpjegohet, përqaqimi, mbase edhe vetëm formal, i islamizimit, së pari, ka filluar nga qarqet e larta, pastaj të mesme e kështu me radhë, por, më me intensitet të shtuar kjo dukuri u dallua si shkizmë ose ndarje fetare që në shekujve. XIV-XV dhe në vijim në vijim (XVI, XVII, XVIII) e sidomos më e fuqishme ishte në fillim e gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe, siç spikasim ne, vazhdoi pa shenja dobësimi në shek. XX, madje propagandisht është e pranishme edhe në ditët tona.

Kjo dikuri si njëfarë hipoteze do të sqarohet paksa më në hollësi si pikë më vete pak më poshtë, pasi tash fill të themi ca fjalë rreth pasojës së pasivizimit të emërtimit *arbnor* e *Arbni* tek shqipfolësit dhe si lindën ose u fuqizuan fjalë-termat e rinj, *shqipo/shkja*, nën hijen e termave të përforcuar *serb e Serbi*, ndaj shkja e shkieni, që u cek më sipër, dukuri kjo që ka të bëjë me fuqizimin e ndërlikimit të *shkizmës së re* si pasojë.

2. Rreth pasivizimit të termit arbër dhe nxjerrja kokë e termave me konotacion rikonfrontues nga turk e shkja në shqiptar/shka

Për të zbërthyer temën rreth pasivizimit të fjalëtermit **arbër**, edhe pse paksa e shumë në gojë më sipër, tash fill do të përpiqemi të zbulojmë burimin dhe konfrontimin dikur dhe sot të koncepteve të antonimeve *turko/shka*, përkatësisht *shqipo/shka*, pa harruar pasojat e shkaktuara nga fanatizmi i pakontrolluar fetar dikur dhe sot si dukuri shumë përçarëse dëmsjellëse rreth konsolidimit të kombësisë e të kombit shqiptar.

Pa marrë parasysh faktin se gjatë shtjellimit të deritashëm të kësaj teme, në momente që na imponoheshin kemi dhënë ndonjë sqarim ose plotësim që na është dukur i domodoshëm, tani do të përpiqemi me hedhë dritë pak më fortësisht pse ndodhi pasivizimi i fjalë-termit **arbërArbëri** dhe arsyeja e imponimit të emërtimeve të ripërqafuara: turko-shkja, përkatësisht *shqipo/shka*. Sipas studiuesve Prifti/Xharra, pa hyrë në prejardhje etimologjike, fjalë-termat: *shka/shkie/shkizmë* në krahasim me emrin *shqip shqipo*, *shqipës shqipjan shqiptar* u përdorën nga shqipfolësit pothuaj në të njëjtën kohë-hapësirë, dukuri kjo, të cilën do të përpiqemi ta parafranojmë në vijim, me qëllim që ta zbardhim sadokudo kontaminimin konfrontues e semantik të këtyre dy antonimeve të natyrës shkizmore *shqipo/shkja*, si veçori karakteristike e gjuhës shqipe.

3. Rreth përkufizimit të fjalë-termit shqiptar në raport me shka

Gjatë shtjellimit të derikëtushëm të temës u përpoqëm me i bë sa më të qarta konceptet e dy termave *shkja e shkizmë*, qoftë si koncepte të veçanta, qoftë kontaminuese, ndërsa tashti, duke u mbështetur në të dhënat e derisotme, jemi të interesuar me bë përpjekje që sadopak me zbardhë çështjen rreth burimit të fjalës *shqipo* që u përftua ose u fuqizua në konfrontim semantik me termin *shkja*, ngase që të dyja këto fjalë, kishin dhe ende kanë përdorim mjaft të gjerë në gjuhën tonë të përditshme, edhe pse, as njëra as tjetra fjalë, ndoshta për ndonjë arsye madhore politike(!), nuk figurojnë në fjalorin e standardit të sotëm të shqipes (2006). Në të vërtetë, nuk i ndeshim në Fjalorin e gjuhës shqipe (2006) as fjalën *shqipo* as atë *shka*, por, në FGJSSH (1980), edhe pse në atë burim nuk është përfshirë fjala *shkja*, aty e ndeshim emrin *shqipo shqipoja* (f. 1915), për të cilën jepet ky përkufizim:

Shqipo-ja - Shqiptari, si mishërim i virtyteve më të larta kombëtare më tipike të popullit tonë,

e shoqëruar me shprehjen ilustruese:

Shqipon as e kanë trembur as e kanë gjunjësuar dot.

Përkatësisht në FGJSH 2006 (f. 1047), për fjalën **Shqiponjë** lexojmë pothuaj ngjashëm sqarimin poetiko-stilistikisht:

Shqiponjë-a - fig. nën 2.: *Njeri trim, i guximshëm e sypatrembur, njeri shumë i zoti dhe i shkathët.*

Siç po shihet, në këto dy burime, përkufizimi është pozitiv i shkallës më të lartë. Le ta risjellim në kujtesë tani sa për krahasim përkufizimin e fjalës *shkja*, sipas Fjalorit të M. Elezit (2006 f. 1367), ku nën 2. dilte:

Shka-u – **Armik i popullit, vrasës, mizor, ai që prish e shkatërron çdo gjë.**

Sidoqoftë, meqë për fjalën **shka** e derivatat e saj prejardhjesht e kuptimisht është bërë fjalë më sipër, lus lexuesin e nderuar që konstatimet e tilla mos t'i qesë largmendsh, ndërkaq, ne tani po i themi ca fjalë rreth etimologjisë dhe procesit historik të fjalës *shqip* dhe shndërrimit të saj përmbajtësisht në *shqipo*, përkatësisht deri në përkufizimin e sotëm të sinonimit të tij parësor *shqiptar*:

Shqiptar-i ... - pjesëtar i shoqërisë shqiptare (FGJSSH f. 1916), respektivisht:

Banor vendës i Shqipërisë etnike ose me prejardhje nga Shqipëria etnike, pjesëtar i kombit shqiptar; ai që lidhet me shqiptarët e Shqipërinë; ai që flet qartë e kuptueshëm shqip.
(FGJSH 2006, f. 1047.)

Së këndejmi, duke mbajtur gjallues në kujtesë krejt përkufizimin e fjalës **shqiptar** bashkë me konfrontimin semantik **shqipo/shka** do ta kemi më lehtë me i kuptue në nënkreun vijues disa opsione ose opinione si supozime të shprehura rreth etimologjisë ose burimit të fjalë-trajtave: *shqip shqiptar Shqipëri*.

Nënkreu II OPINIONE RRETH PREJARDHJES SË FJALËTERMIT “SHQIPTAR”

Lidhur me këtë, nga përvoja e të lexuarit i kam në kujtesë afro 20 opinione si supozime a hipoteza rreth prejardhjes së fjalës *shqip shqiptar*, që këtu po e cek nja 5, të cilat nuk janë cilësuar aq të qëndrueshme:

1) nga emri *petrit* -“sifter” (*skiftar skiptar*) - shqiptar,

- 2) nga *Shkup* (shkup'tar, *shkyptar*, *shkiptar*) - shqiptar,
- 3) nga “*qipi-a*” (mullar (dru), mullar bari, fig. zhgulje 'qipash! –sh/qip-i (shqip) ‘qip’tar (!) shqiptar,
- 4) nga “*shkrep-tar*” (banor shkrepash) - shqiptar,
- 5) nga mbiemri familjar *Schipudar*, Schepuder... - shqiptar...

e ndonjë tjetër si ai nga një shkrim enciklopedik në gjuhën serbe onomatope gjoja nga klithja e zogut të shqiponjës *shklpi shkrip shqlip* ose edhe të vetshqiponjës. Lidhur me këtë ne përmendim edhe këto tri opinione të tjera, të cilat ia vlejné të trajtohen pak më gjerësisht, ngase, për merndimin tim, këto tri hipoteza, qoftë edhe të pjesërishme nuk mund të quhen të lehtërrëzueshme apriori, le të vlerësohet.

1. Opinione rreth tri hipotezave jo tërësisht të lehtërrëzueshme

Për konceptin që ka sot fjala: *shqip shqipo shqiptar Shqipni Shqipri*, nga studiuesit janë të njohura tri hipoteza jo të lehtërrëzueshme:

e para, termi shqiptar, shpjegohet sipas totemit **shqipe (shqiponjë)**;

e dyta, termi shqiptar është shfaqur sipas dukurisë antonime si produkt i shkizmës së re: *shkja - shqipo* nga *shqep /shk/ie/p* (!?) dhe

e treta, sipas trajtave foljore: *shqipoj me shqipue*, si tezë më e pranuar siç arsyetohet në burime të caktuara edhe nga «**Port albi**» (9.07.2012 internet), që ne po shoqërojmë edhe me trajtën tjetër foljore më të rrënjës: *shqip me shqipë*.

Po i përzbërthejmë pra guximtarisht të tri këto hipoteza radhazi, veç e veç, duke përdorur si mbështetje realiteti me ndonjë risim ilustrues, gjetur e shprehur me fjalë tona.

1) Rreth opsionit simbol joshës: shqipe – shqiponjë

Nisur nga gjendja e sotme e nocionit që ka emri *shqipo shqiptar Shqipri* ne nuk e mohojmë as hisen që ka marrë ky nocion si mbulesë nga varianti i shkurtër *i* emrit shqiponjë: *shqipe (*ipe)*, përkatësisht në përgjithësimin e trajtës: *shqipe shqiptar e Shqipri*. Studiuesja Fatbardha Demi (Shih portalin “zsh”, 19.09.2020) prejardhjen e fjalës **shqiptar**, i cili mbart në vete mitin e lashtë të krijimit të njeriut nga Zoti ..., si emërtim etnik e ndërlihd mitologjikisht me besimin popullor të lashtë e etimologjikisht me fjalë-rrënjën “*IPE*” për shqiponjën dhe së andejmi gjuha *shqIPE*, apelativi **shqIPEtar**, emërtim ky që e shoqëroi këtë popull gjatë gjithë historisë mija vjeçare deri në ditët e sotme.

Është shumë me vend konstatimi që kjo fjalë, *shqiponjë-shqiptar*, si opsion është shfrytëzuar kontanimisht nga rilindësit tanë, të cilën e motivuan si akt joshës shpirtëror për përvetësimin dhe zgjerimin sa më masiv të këtij emërtimtotemi. Nuk thuhet kot se populli e masivizon dhe e mban mend më së miri dhe e mban më për zemër një ngjarje a dukuri, kur ajo mitizohet, andaj edhe ky veprim në formëzimin kombëtar, assesi nuk mund të cilësohet si i qortueshëm as atëherë në zanafillë as sot. Madje në “Port-alb” lexojmë se “*argumentet e kësaj teze janë në përshtatje me*

rregullat gjuhësore të fjalëformimit, me etnografinë dhe psikologjinë mbarëkombëtare.” Megjithatë, ka studiues që shprehin rezervë lidhur me këtë. Po e përmendim vetëm një rast anësor. Mehmet Elezi në Fjalorin e tij (f. 1416) ndajfoljen: **shqiptore**, përkatësisht shprehjen: **E thashë shqiptore** e shpjegon: **E thashë shumë qartë, shkoqur e kuptueshëm** dhe shton:

“Në Malësi të Gjakovës etj. kjo fjalë shqiptohet me **-i**, ndërsa shqipe shqiponja me **y**, çka duket se dëshmon edhe njëherë për dy fjalë të ndryshme”.

Sidoqoftë, pa marrë përasysh, rezervat e studiuesve të caktuar dhe si përdoret më zonat përkatëse, te ne janë shumë të pranueshme shprehjet si:

Shqiptarët si bijtë e shqipes përherë kanë siguruar frymëmarrje të lire jo vetëm në malet po edhe në fushat tona

ose

Ansamblu ynë në këtë festival ligjëroi mahnitshëm pikërisht “vallen e shqipeve”, me ç’rast “shqipe-shqiponjat tropojane” e ekzekutuan aq mrekullisht sa që shikuesit nuk do ta harrojnë kurrë!...

si dhe emrat e përveçëm poetikë: *Shqipoi e Shqipe* që i krijoi Zeqir Gërvalla në poezitë e tij, ashtu si edhe krijues të tjerë, ku bën pjesë edhe trajta *Shkipe*. Sigurisht përfitimet e tilla kanë qenë, janë dhe do të jenë të përqafoeshme shpirtërisht e kuptimisht për jetë e mot, për çdo shqiptar, ashtu si edhe emrat e rinj: *Shqipran, Shqipron, Shqiprron, Shqiprim e Shqipon*, apo jo ?!

Gjithsesi, kjo dukuri ndihmohet edhe nga historia që lidhet me Pirron e krahët e tij shqiponje, andaj fjala **shqipe, gjuha shqipe**, emri **shqiptar**, atdheu i përbashkuar: **Shqipria**, si dhe folja nga shqipe **shqipoj** (edhe pse hepërhe mbase nuk shkon aq si në vaj: shqipe+OJ shqip+OJ) nuk është e pamundshme dhe jo pa lehtësi mund të ndërliidhen simbolikisht me **shqipe - shqiponjën** si totem, simbol ky që ka histori, andaj secilit shqiptar kjo e vërtetë i shton emocionalisht ndjenjën e krenarisë dhe të detyrimsisë...

Me një fjalë, bazua në faktin se shkenca është më e kokëfortë se çdo ndjenjë krenarie, këtë opinion nuk e kundërshtojnë, jo vetëm për hisen përkatëse simitike që kishte dhe që e ka edhe sot lidhur me përqafoimin e konceptit të apelativit **shqiptar**, por edhe në bazë të ndërliidhjes me sistemin fjalëformues të gjuhës sonë.

2) Opinioni rreth shëzizmës (shëzëjes) dhe kundërvenia: shëzipo/shka

Para sa kohe Pirro Prifti e Fahri Xharra, fjalën *shëzipo shëziptar* e ndërlihdhën etimologjikisht me nocionin e dukurisë së *shëzizmës së re* për shëziptarët, si ndarje, dukuri kjo që ilustrohet me barasvlerësin: *shëzëp me shëzëpë* dhe së andejmi *shëzëp shëzëptar (shëzëptar, shëziptar shëziptar)*.

Sido që të jetë, edhe pse Pirro Priftit nuk i del e shënuar si ilustrim parësorisht trajta *shëzipo shëziptar shëziptar*, megjithatë nuk gjykon keq kur shprehet që përfëtimi i fjalëve *shëzipo shëziptar Shëzipëri* ka zhvillim të ngjashëm oponent dhe pothuaj të njëkohshëm siç ka ndodhur me përfëtimin e fjalë-koncepteve të rishtuara me konotacion të ri kohor të trajtave *shka, shki/e, shkitë, shkini , Shkini-a* (nga *shkitje, shqyerje, shkizma* etj.), opinion ky interesant, që mbase nuk e kemi kuptue mirë sa për t'u bindur, po sidoqoftë kjo na ka shtyrë ta sajojmë e trajtojmë antonimin: *shëzipo/shkja*.

Në të vërtetë, kur autori konstaton se këto dy fjalë *shëzipo/shkja* edhepse kanë të bëjmë me *shkizëm* (ndarje) si ngjarje-dukuri, por nuk ndërlihdhën konkretisht me *shkizëmën* si fjalë ndërkombëtare të vitit 1054 ose 1092 (siç e shënon autori), po me periudhë më të vonshme, ka mbase plotësisht të drejtë. Them i kështu, ngase kjo *shkizëmë* (ndarje) si dhe oponentimi i fjalëve: *turko/shkja/shëziptar*, përkatësisht *shkja/shëziptar*, si dukuri, për të cilën flet autori ka ndodhur dhe është masivizuar ose është rimasivizuar, brenda shëzipofolesve, jo më herët po në periudhën nën sundimin e Perandorisë Osmane, kur këta shëzipofoles ndërkohë *u dyzuan* fetarisht, përkatësisht *u shkizuan*, u ndanë në dy fe: **islame/kristiane (ortodokse)**, pa përmendur ndarjen e mëparshme ekzistuese **katolike/ortodokse**. Kështu kjo masë shëzipofolesish nga një u nda në dy etni kombëtare: *serbo-shkije* dhe *shëziptare* (muslimane e katolike) dhe njëherazi edhe në dy fe të ndryshme: *shëziptare muslimane në njërën anë* dhe *serbe-shkije ortodokse (sllave)* në anën tjetër, kjo ndodhi kryesisht në veri e verilindje, ndërsa në anën tjetër po ashtu *shëziptare muslimane* ndaj *shëzijevarnitate ortodokse (greke)* në jug të Arnautistanit (Shëzipoërisë).

Ç'është e vërteta, autori, ndër të tjera, paraqet edhe disa të dhëna të ndodhura paraprakisht lidhur me këtë shëzizmë ose çarje të re. Sipas tij deri në shek. XIV-XV në Siujdhesën Ilirike (Ballkan) shëzipofolesit arbënorë pothuaj të gjithë fetarisht ishin ortodoksë të drejtuar nga Bizanti dhe me gjuhën e veçoritë e tjera të tyre e kishin ravijëzuar, pothuaj *afro 500 vjet*

edhe hapësinisht emrin dhe *shtetin e vet etnik gjuhësor* të ndërkthyer nga Iliria në të ashtuquajtur *Arbëri*, fakt ky që e dëshmojnë edhe të huajt, sepse prej tyre po mbi këtë bazë u quajt edhe etnia edhe vendi gjeografik ngulitës i shqipfolësve: nga sllavët: *arban* ose *raban Arbania*, nga grekët: *arvanitis Arvanoi*, nga perëndimi: *alban albanes Albania*, madje edhe nga turqit: *arnaut Arnautllëk (Arnautistan)* ..., por pas vdekjes së Skënderbeut, i cili me luftat kundër Turqisë ishte lidhur *shtetërisht e fetaro-ushtarakisht* me Perëndimin katolik, Sulltanati, menjëherë e ndërkohë dhe në vazhdimësi i ndëshkoi arbnorët shqipfolës (pa dallim feje) me masa të egra, duke e ndaluar me ferman deri gjuhën e folur të tyre në vende publike, por në mënyrë të veçantë mori masa kundër katolikëve shqipfolës dhe ithtarëve proskënderebejanë ortodoksë *unitë*, duke u hapur si mundësi ekzistence njëherazi dy rrugë: e para, privilegje shtesë të konvertuarve shqipfolës në muslimanë dhe e dyta, të shpërngulen jashtë, ku veç katolikëve shenjohej komuniteti ortodoks unit nga e mesmja dhe nga jugu (arbëreshët), por më së rënde e pësoi katolikizmi në veri, ndërsa në anën tjetër, islamizimi si në veri si në jug, mbase më fort deklarativisht, pati sukses, sepse komuniteti musliman shqipfolës numerikisht u rrit shumë. Madje të konvertuarit edhe fituan privilegje shtesë administrative, ekonomike, deri edhe ushtarake e vetadministrative, por edhe në esencë e ruajtën gjuhën arbnore (shqipe). Në këtë kohë shtypjesh për fenë kristiane një masë ortodoksësh, sidomos fqinj me sllavë (serbë, malazezë, bullgarë,) por edhe me rumunë e grekë për t'u shpëtuar masave shtrënguese e represaljeve të politikës turke e turkofilëve arnautë dhe për të ruajtur besimin gjetën mbështesë mbrojtëse tek kisha ortodokse autoqefale sllave, rumune ose ajo greke, të cilat i mbronin me autoritetin e vet Patrikana, e cila, siç u cek më sipër, edhe kishte imunitet të njohur zyrtarisht nga Sulltanati për përkujdesjen ndaj grigjes së besimtarëve të vet. Kështu ndërkohë, pothuaj një masë e konsiderueshme shqipfolësish ortodoksë, jo vetëm fetarisht, por edhe gjuhësisht gradualisht pa kundërshtim iu bashkuan kombit tjetër. Është fjala për atë periudhë kur kjo masë shqipfolëse që humbnin gjuhën por e mbanin fenë ortodokse nga masa tjetër shqipfolëse (muslimane) u quajtën *shkije* (nga shkizma) dhe në anën tjetër masa e shumuar e islamizuar u quajtën *shqiptarë* nga ortodoksët e shkizmuar, që edhe kjo fjalë ishte me kuptim ndarjeje.

Ç'është e vërteta, e themi me fjalë tona, kjo *shkizmë* ose përcarje ishte intriguar nën trysinë e tri komponenteve, e **para** shkaktarja kryesore ishte politika *përçaj e sundo* e Portës së Lartë Osmane, e **dyta**, politika e

Patrikanës si prijatë e përkujdesës e ortodoksizmit dhe e **trëta** nga vetë shqipfolësit, për shkak të humbjes graduale të ndjenjës etnike-gjuhësore të tyre. Është krejt e natyrshme, që si çdo shtet i huaj edhe Turqia mbështetur në interesa të veta, shfrytëzonte zyrtarisht doktrinën e fesë islame sunite dhe në anën tjetër nuk ishte jo normale që mori ndihmë politike e ideore qetësisht në veçanti nga shteti vasal serb, përkatësisht edhe nga kishat autoqefale sllave në veri dhe nga ajo greke në jug, të cilat të përkrahura nga Patrikana (Selia e Shenjtë Ortodokse), qetësonin masën, kështu përthithen dhe asimiluan ndërkohë turma shqipfolësish ortodoksë të shkijezuar, ish ithtarë të zhgënjyer ndaj autonomisë politike skënderbejane. Sigurisht një dukuri të tillë kundërbërëse e ndihmuan edhe politikën e huaja si (Rusia), por edhe vetë turmat shqipfolëse skkizmatike, të cilët faktikisht edhe nga intereset shoqërore- ekonomike e psikologjike më shumë ishin të përkushtuara ndaj gjuhës fetare sesa gjuhës shqipe, prandaj e potencojmë faktin se nga **shkizma** e tillë triooponentëshe mbi bazë fetare u bë ndarje e shqipfolësve në tri fe:

a) serbo-shkije, b) turko-arnaute dhe c) arbore-latine

dhe në të vërtetë kjo **shkizmë (ndarje)** pati efekte tejet fatale, mirëpo të gjithë shqipfolësit për fat nuk e përjetuan këtë asfiksion, ngase, në të vërtetë masa e islamizuar shqipfolëse në atdhe, edhe pse nga shteti osman quheshin *turq*, ata nuk e quajtën veten ashtu, siç diktonte Turqija, përqaftuan emrin *shqiptar* dhe kështu nuk e humbën gjuhën, por nuk e ruajtën as emrin *arbër* ose ndryshe, siç quheshin më përpara, që tash kishte mbetur ose kishin mbetur si emra të pasivizuar në përgjithësi, edhe pse emri arbër ose epirotë ende ruhej vetëm nga disa të krishterë të pasllavizuar e të pagreqizuar (ortodoksë-epirotë!) si dhe për masën e mbetur katolike (latine) shqipfolëse, po gjithsesi si arbnorë ose si epirotë fetarisht kishin mbetur pakicë.

Pra, ishte një zgjidhje e volitshme mbase jo krejtësisht spontane, sepse emri *shqiptar* u pranua si më praktik dhe më për zemër jo vetëm nga shqipfolësit muslimanë, por edhe nga katolikët dhe ortodoksët shqipfolës. E veçanta e hipotezës së z. S. Prifti dhe z. F. Xharra është se ndërsa *shqipfolësit* tash si popullsi kompakte muslimane i quajtën ortodoksët që u shkizuan, u ndanë dhe iu nënshtruen kishës sllave: **shkie shqe**, si ndarës përçarës *me kuptimësi gjuhe*, ashtu ua kthyen edhe vetë *shkijet ose ortodoksët skkizmatikë* si kundërpërgjigje me kuptimësi feje, përkatësisht shkizmatikët:

*“shqipfolësit e islamizuar dhe të ardhurit që e flisnin po atë gjuhë(!), i quajtën **shkëpetarë** ose **shqipetarë**, duke përdorur fjalën arbërisht **shkep** ose **shqep** në kuptimin që edhe këta ishin të shkëputur apo të shqepur nga identiteti i tyre fillestar (ortodoksia n.v.)... kështu ata u quajtën shkëpetarë **shkëpetarë** dhe vendi i tyre **Shkeperia** ose **Shkipëria**...*

fjalë-emërtim ky, i cili :

filloi të përhapej në veri dhe në lindje ku kontakti ishte kryesisht me sllavët që konfirmohet edhe nga sllavët të cilët përdornin fjalën «shkëptarci», për shkëptarët muslimanë.

Sidoqoftë, një tezë e tillë rreth raportit **shqipo/shka**, sidomos për emërtimin e ri të shkëptarëve ka mbështetje edhe në faktin se në shkrimet e Milosh Milojeviçit (1866), 10 vjet para Lidhjes së Prizrenit (1978) shkëptarët përveç si **arnautë** (term teksti marrë nga turqishtja) që ishte edhe term zyrtar cekën fjalë-trajtat si: *shkip/o, shkipsi shkipjani* (sipas tij *serbë të shkëptarizuar!!!*), ndërkaq fjalët e tyre:, *shkipske reçi (shkipski jezik)*, ku siç po shihet sipas serbishtes së tij (pos të huajve) nuk njihej parësorisht trajta e emrit me –TAR, shqipTAR “shkëptarci”, po **shkipi**, madje nuk vërehet as zbërthimi i K(J)-së në Q: **shkip/shqip**, edhe pse e ka të njohur edhe atë trajtë nga shqipja e mesme elbasanase e tutje toske, por të përdorur aso kohe edhe nga studiuesit përkatës të para e të asaj kohe.

Sidoqoftë, edhe pse ne tek emri ose trajtat e M. Milojeviçit: *shkip, shkipski, shkip+S shkipës* ose *shkip + JAN* nën hije shohim edhe koncept foljeje **shkipoj shqipoj** si mundësi, gjithsesi me kuptim *shqipuesi*, që na kujton jo aq shqiponjën si shpend grabitës, por *shkëptarin* si **shqipfolës** (që *shqip*) dhe si **veprues** (që shqipon). Prandaj për mendimin tonë kjo (hipo)tezë (e P. Priftit)që e rumbullaksuar më 2022:

“Emri shkëptar vjen nga përplasja përbuzëse e të dy palëve, ku njëra palë e quante kundërshtarin othodox si –shkie dhe pala tjetër e quante kundërshtarin musliman si –shkëptar, nga fjala shqipe (shqyej) shqyej”...

gjithsesi ka nevojë për kapital plotësues mbështetës, qoftë rreth përvetësimit të emrit etnik serb e toponimit Serbi (Sherbi), Shkini (Sllavoni) Shkjavoni, në raport me termat përkatës turq, qoftë rreth trajtës *shkep+TAR*, ngase pikërisht duke e cekur si argument fjalën *shkizmë* dhe shembullin *shkep shqep*, pa pasur brendë të sforcuar zanoren **I** rrokjesore të sforcuar të foljes: **shkip (me shkipë)** ose **shqip (me shqipë)** apo **shkipoj (me shkipue)** ose **shqipoj (me shqipue)**, duket si një zgjidhje paksa si me

zor (jo si në vaj) që do ta vështirësonte atbotë e sot përgjithësimin, përhapjen e përqaftimin e rrufeshëm të vetë koncept-fjalës **shqip shqiptar në mënyrë aq masive**, siç ndodhi në të vërtetë atëbotë. Madje, siç u cek edhe në Fjalorin e Bashkimit, trajta *shkjep me shkjepë* ose ajo nga autori *shkep shqep* (me shkepë), përkatësisht *shkjepoj me shkjepue* (shqep me shqepue (me qillue) me shkop), trajtë kjo që përdoret edhe në serbishte,) vërtet kishte kuptim shqipimi (sakatimi, përçarjeje, inkoherence), por që me shikue semantikisht nga vetë shqipfolësit tashti ndodhi e kundërta e kuptimit që mori ndërkohë fjala **shqip e shqip/oj shqiptar e Shqipri nga masa**, sepse tani, shikuar edhe nga prizmi i sotëm, me këto fjalë: **shqip shqipoj e shqiptar, Shqipni Shqipri**, nuk kemi të bëjmë aspak me ndarje (inkoherencë) shqepje as me fjalën serbisht *šćepati* (ndarje, mbërthim), por me të kundërtën: kemi të bëjmë me: *bashkim (përbashkim), marrëveshje*, pra me koherencë dhe aq më tepër *deri edhe me tolerance të vazhdueshme fetare*, prandaj sqarimi i shprehur si arsye vetëm me kuptim *shkizme* këtë hipotezë, pa një sqarim më të thellë e më të plotë, e bën fort të diskutueshme, apo jo?!

3) Rreth opinionit: folja me shqipë apo shqip ose shqipoj apo me shqipue dhe ndërtimi i emrit shqiptar, shqipo-i

Ne, i bashkohemi jo pa rezervë sugjerimit nga **“Port albi”**, ku thuhet se *“teza më e pranuar nga studiuesit ndër të tjerat është se emri shqiptar duhet të jetë një formim me –ar i foljes shqipoj (shqipëtoj, shqiptoj) me kuptim të dikurshëm “kuptoj, marr vesh”, ngase mbështesim në parim vetëm shembullin e parë foljen: shqipoj me shqipue*, por edhe atë me një farë dozë rezervimi, së pari, kemi të bëjmë me prapashtesën - **TAR shqiptar**, jo me -**AR shqipar** (!) dhe së dyti, për arsye se nga trajta **shqipoj** madje as nga shqipëtoj shqiptoj nuk arsyetohet prapashtesa – TAR, prandaj, ne, në bazë të studimit që bëmë për konceptin dhe mënyrëndërtimin e fjalës **shqiptar** mbështesim *si zgjidhje: jo një* po dy trajta foljore:

së pari, më fuqishëm e përkrahim, foljen **me shqipë** apo **shqip** (unë *shqip*, ti *shqip*, ai *shqip*; ne *shqipim*, ju *shqipni*, ata ato *shqipin*), e cila shërben ose do të ketë shërbyer mirëfilli edhe si temë fjalëformuese për apelativin **shqiptar (shqip+TAR)** dhe trajtën foljore *shqipë+toj* a *shqip+toj* etj, dhe

së dyti, foljen **shqipoj me shqipue**, e cila më tepër jashtë veprimin ose ndërtimit të brendshëm gjuhësor del e specifikuar semantikisht ndërlidhur jo me ndërtimin, por **me veprimin** e apelativit **shqiptar**.

Me fjalë të tjera, në punimin tonë do të përpiqemi ta sqarojmë moton se me foljen **shqip me shqipë** (që ndeshet edhe si emër) kuptojmë shqiptarin si *shqipfolës aktiv*, ndërsa me foljen **shqipoj me shqipue** kuptojmë të *shqiptuarit* e shqiptarit si *veprues aktiv*, madje fillimisht e përgjithësisht kjo dukuri nuk përkufizohet me emërtimin gjeografik të trevave të banimit të shqiptarit, apo jo?!

Për qartësim konteksti, po i rikthehemi paksa njëres nga hipotezat e para për apelativin **shqiptar**, që ishte ajo e G. Mayerit, i cili foljen lat. *excipio excipere* (ekskip/ere, përkatësisht ek/ skip[ere-shkip-oj/-ere) – me barasvlerës në shqipe bazuar në foljen **shqipoj, me shqipue** (Krahaso **ex/s**–sh, **c-k/q, ip-ip, io**–oj; **ere-** ue) ose: *kuptoj, marr vesh (!)*, barasvlerësi kjo që sipas nesh kuptimisht nuk është e saktë, po nuk del e saktë as sipas *Fjalorit latinisht shqip* të H. Lacajt e F. Fishtës (Pr., 1980 f. 165), as sipas konstatimit të prof. E. Çabej. Ç’është e vërteta, ndër 10 kuptime polisemantike që mbulon në shqipe folja *excipere*, asnjëri prej tyre nuk kishte barasvlerësi të tillë: *kuptoj (me kuptue), marr vesh (me marrë vesh)* por, siç e shënon prof. Çabej në shqip folja lat. *excipere* ka këta përgjegjës: **marr, vë mënjanë, parashtroj, pranoj**, megjithatë nga rishikimi i këtij polisemantizimi i fjalës *excipio*, sipas studiueses Anita Omari, dalka edhe kuptimi i sipërsprehur *shqipoj flas shqip(!)* e si rrjedhojë, sipas saj edhe edhe apelativi shqiptar, andaj, edhe pse teoria e G Mayerit mund të rivlerësohet, megjithatë, edhe ajo vëren se, folja **shqipoj** (*shqipëtoj, shqiptoj*) në krahasim me foljen latine *excipere* për apelativin **shqiptar** “nuk është parësore”, sepse “mbetet kritike për karakterin e prejardhur dhe përhapjen e kufizuar të saj në shqipe.

Këtu po e shtoj edhe një konstatim të profesor Çabejt, që nuk e dija që ky dijetar emrin **shqiptar** nuk e sheh si krijim në periudhë të vonë, por si bashkekzistues ndërshekuj brenda së njëjtës gjuhë **me emrin arbën**, si doli edhe nga analiza jonë modeste:

“ *Të dy emrat (shqiptar e arbën) do të kenë luftuar shekuj me radhë me shoq-shojnë gjersa nga fundi i shekullit XVIII emri i ri doli fitues, shkas i kanë dhënë ndofta shtektimet e shumta të fiseve shqiptare të kohës së mesme dhe formimet e fiseve të reja dhe dyndjet osmane*” .

(Shih Eqrem Çabej, ASHAK, Studime shqiptare, vepra të zgjedhura, Prishtinë.2008, f. 696).

Në punim ka edhe konstatime të tjera që gjithsesi ia vlejnjë të konsultohen.

Mirëpo në këtë vazhdë, për ne dhe jo veëm për ne, por edhe për shkencën shqiptare zgjon interes se si i madhi, **Atë Gjergj Fishta**, i cili edhe si njohës i latinishtes, në fjalimin e tij të mbajtur në Konferencën e paqes, Paris 1919, veç tjerash, pasi sqaron se “... fjala “shqiptar” e “*albanensis*” nuk shënon individualitetin etnologjik të familjes së këtij kombi, por .. shenjon kombin”, prejradhjen e tij dhe së andejmi kuptimin e fjalës **shqiptar** e shpjegon sipas dy fjalëve barsvlerëse të gjuhës latine: **enuntiare** dhe **exprimere**, duke theksuar:

*“Fjala **shqiptar** vjen prej verbit **me shqiptue** që do me thanë **enuntiare**, **exprimere**, që e shënon njeriun që mundet me folë dhe me kenë kuptue në këtë gjuhë prej të tjerëve... E prandej **shqiptar** asht francezi për francezë, kinezi për kinezë, indiani për indianë etj., pra mjaft ta kenë gjuhën amtare së bashkut... Për antonomizi vetëm para kombit fjala **shqiptar** shënon **kombësi**, sepse në vetvendi, si e thamë ma sipër, nuk e ka këtë kuptim... nuk përcakton si ajo albanesis, individualitetin etnologjik të një familjeje kombëtare, por shenjon popullsi që banon në Albani ose Shqipni... mjaft që ta kenë gjuhën amtare së bashkut”* (Shih “zsh”, 01.06.2019).

Si po shihet, autori prejardhjen, edhe pse për ne e diskutueshme, e nxjerr nga folja e shqipes **me shqiptue**. Nuk e përmend fare foljen *excipio excipere*, po dy folje të tjera të latinishtes: **enuntiare**, e cila sipas *Fjalorit latinisht-shqip* (Lacaj-Fishta f. 158), në shqipe ka këta barsvlerës:

1. shpjegoj, shpreh, parashatroj; 2. zbuloj (*enuntiatia* – shpjegim parashitës: gram. fjali).

Ndërkaq për foljen **exprimere**, po aty f. 170, në shqipe jepen këta barsvlerës:

1. shtrydh, shtyp; 2. detyroj, shtrëngo, nxjerr me pahir; 3. Shqiptoj, shqiptoj shkronjat; 4. ngre naltoj; 5. imitoj, shkërbej, exprimere incessum – me imitue dikë në ecje; 6. përkthej,

Lidhur me këtë, meqë edhe me shembujt e Fishtes: **enuntiare** dhe **exprimere** nuk mund të shpjegohet prejardhja e emrit shqiptar lus lexuesin e studiuesin e nderuar që me rastin e leximit të mendimeve tona për fjalën bazë “**shqip**”, përkatësisht foljen **me shqipë** dhe atë **me shqipue**, ose përqpajet rreth hipotezës rreth konceptit të shtrirjes së fjalës **shqiptar** si

veprues dhënë kryesisht nga të huajt edhe me kuptim “*edukimi me shkop*” ose “*displinimi i shkopi*”, t’i ketë parasysh edhe barasvlerësit latinisht që jep Atë Gj. Fishta si dhe përgjegjësit barasvlerës në gjuhën shqipe që sfidojnë potencialisht rreth kuptimit të fjalës: *shqip, shqiptar*.

Sidoqoftë, gëzon fakti që këtë temë tash vrik e mori në shqyrtim edhe studiuesi i matun Shefki Sejdiu, i cili në një kumtesë të lexuar në ASHAK, ndër të tjera: “*ekucionin: excipioshqip(e)+shkabë (+shqiponjë) për të arritur deri te paradigma (me pak ndryshime): shqip(e)- shqip(e)tar – Shqip(e)ni –Shqip(e)ri apo edhe më qartë: (flas) shqip- (gjuhë) shqipe- (popull) shqiptar, (vendi) Shqipëri*” e ndërlihdh me: “*sistemin e kujtesës së popullit*”, ku “*shqipja si koncept dhe totem kishte qëndruar në vertikalen: gjarpër –shqipe (shqiponjë)- diell (qiell), paradigme mitike për shumë popuj*”, andaj “*në këtë sistem të të menduari*” e sheh përfitim e ndajfoljes **shqip** ose të fjalës **shqip** (kuptueshëm), si barasvlerës semantik i foljes *excipio excipere*, që kjo fjalë e shqipes, ku “*mund të ketë shërbyer si nukleus për krijimin e paradigmes: shqip (flas)...etj.*

Ne që të tri këto konstatime: *karaktarin prejardhjesor të pazgjidhur* të emrit **shqiptar** e Shqipëri nga shqiponjë e shkabë, si dhe *përhapjen e kufizuar* të foljes **shqipoj** në gjuhën shqipe, ashtu si edhe kontekstin rreth ndajfoljes **shqip** ose të fjalës **shqip**, si temë prodhuese, aktualisht i quajmë të drejta, mirëpo gjatë analizës do të përpiqemi t’i arsyetojmë me fakte të reja, andaj:

së pari, sjellim si risi pikërisht lidhur me atë që si duket e pati maje gjuhe po nuk e tha prof. Sejdiu: foljen **me shqipë** ose **shqip**, korresponduese e natyrshme e togfjalëshit: unë **shqip** (unë **flas**), por këtë e tha prof. Vedat Shehu, siç do të sqarohet tash fill

së dyti, e trajtojmë semantikën specifike në perspektivë të foljes **shqipoj me shqipue**.

Në të vërtetë, studiuesi Vedat Shehu brenda një punimi shumë cilësor, por jo edhe pa ndonjë vërejtje fjalëformuese (Shih interenet, 9.12.2018), ku veç tjerash rrah temën “**Etimologjia e emrit Shqiptar**”, dhe jep konstatime të gjykuara drejt, ndër të cilat si më të veçanta përzgjedhëm:

“E folura shqip, si fjalë e lashtë e trashëguar është një vlerë që ka grupuar një etni pa kufi administrativë, brenda perandorive përkatëse disa etnike... fjala “shqipe” përfaqësonte një gjuhë ndryshe prej gjuhëve hyjnore fetare e të institucioneve shtetërore, prandaj shpjegimi i gjuhës shqipe dhe i emrit shqiptar e Shqipëri

*me prejardhje të një shpendi: shqiponjë (shkabë apo shqipe) është gabim i madh shkencor, sepse fjala “shqip” është fjalë rrënjë, edhe pse si ndajfolje funksionalisht tregonte dhe tregon të folurit e shqiptarëve, e folur kjo që ishte e kundërta e gjuhëve liturgjike të pakuptueshme, të paqarta për masën... Nga ndajfolja “shqip” në cilësinë e mbiemrit, emrit apo të foljes shpjegohen konceptet e derivateve mbiemërore, emërore e foljore ngjashën si të emërtimeve **gjuhë shqipe**, **shqiptar** (shqip+tar), **Shqipëri** (shqipë+ri) etj.*

Po shtojmë edhe këtë se në Drejtshkrimin e gjuhës shqipe (1973) f. 45, 53, 61, 147, 166, trajta **shqip** konsiderohet temë fjalëformuese (prodhuese) për fjalët: *shqiptar, shqiptoj, shqipëroj, Shqipëri*.

Po vazhdojmë me plotësimsqarimet.

a. Rreth semantikës së foljes shqip me shqipë

Sidoqoftë, siç e bëmë me dije pak më sipër edhe nga titulli i kësaj pjese të punimit, ne si fjalë bosht, për sqarimin e fjalës **shqipe** (gjuhë), **shqiptar** **Shqipri**, sikurse z. Fetah, e konsiderojmë si më të kualifikuar pikërisht trajtën temëprodhuese **shqip**, e cila është përdorur rastësisht si ndajfolje (te Buzuku), sepse sipas logjikës si fjalë ajo ishte më e hershme dhe *si çdo fjalë fillimishte njërrokshe (monosilabike) e futur brenda sistemit ligjërimor, që në start ka qenë e paraqitur në funksion shumëkuptimor (polisemantik), si emër, mbiemër, përkatësisht si folje, madje edhe si ndajfolje*, andaj ne po e shfrytëzojmë si folje, sepse, fundi i fundit, pyesim: Ku ka ndajfolje pa e pasur të ndërlidhur kuptimin me konceptin e foljes, apo jo?!

Siç provohet në gjuhën tonë nga asnjë ndafolje nuk kemi emër vepruesi me –TAR, ndërsa nga foljet monosilabike po, si: *mih-tar (me mihë), fol-tar (me folë), ngroh-tar (me ngrohë); prestar (pres)!, vrashtar (vras)!* etj. Prandaj ne shfrytëzojmë kuptimin i trajtës përfaqësuese të foljes: **me shqipë** (paskajore) apo **shqip** (veta I e dëftores), e cila zbërthehet qartë se vjen si barasvlerës i plotë i togut: **me folë shqip** apo **flas shqip** = “**me shqipë** ose unë **shqip, shqipa, kam shqipë**”, ngase vetë procesi *i shqipimit*, dmth, i kuptimit të fjalës **me shqipë** apo **shqip (flas shqip)** imponon zgjidhjen më mirë se ai emëror nga sistemi foljor i gjuhës sonë pikërisht ashtu siç e ilustron studiuesit: **me folë** ..., apo **flas** ... ose **me shqipë**: “**qartë**”, “**hapur**”, “**troç**”, përkatësisht, siç arsyetohet

cilësorisht me zhvillim eptimi e fjalëformimi, si: **shqip shqiptar, Shqipëri (Shqipni).**

a. Nga sistemi foljor:

1) **shqip** - njëjësi i kohës së tashme të dëftores si trajtë përfaqësuese me zgjedhimin përkatës (*unë shqip, ti shqip ai (ajo) shqip ne shqipim, ju shqipni ata (ato) shqipin*); mënyra lidhore: *të shqip, të shqipësh, të shqipë; kam shqipë apo kam shqipur* etj.

2) **me shqipë** - paskajorja;

3) **shqipë** (pjesore e shkurtë) / **shqipun/shqipur** (pjesore e zgjeruar);

4) **foljet prejpjesore** me prapashitesat **me –o të zgjeruar:**

a) qoftë në përdorim, si: **shqipëlloj(!), shqipëroj, shqip(ë)toj,**

b) qoftë të tjera të mundshme dhe formëzimisht nga sistemi foljeformues të lejueshme: *me -LO shqipëlloj, me -SO shqipësoj!, -RRO shqipërroj, -ZO shqipëzoj, -SHTOJ shqipshtoj, -OS shqipos, -AV shqipav (me shqipavë), -AT shqipat (me shqipatë), -IT (me shipitë), -NO: përshqipnoj (me përshqipnue)* etj., trajta këto, të cilat, varësisht nga konteksti, mund të përdoren (natyrshëm) si trajta të veçanta në praktikën ligjërimore

c) edhe prof Vedat Shehu jep shembuj të formuar nga temë-folja **shqip** si: *prestar, vrastar, por edhe shqiptar, Shqipëri.*

b. Nga sistemi emëror

1) emëzimet prejfoljore, me pa prapashitesim si: *shqip-i, shqipës, shqiptar f. shqipe/ja;*

2) emëzimet prejprejpjesore si: *shqipë-a, të shqipët, e shqipura, pastaj me prapashitesat: -Ë, -IM, -JE, -ESË, -OJË* (si dukuri por edhe si veprues) etj. që sistemi lejon deri mbi 15 trajta prejardhjesorësh varësisht nga konteksti.

Me fjalë të tjera, z. Fetah, përforcon guximshem, atë që jam përpjekur e po përpiqemi ta sqarojmë edhe ne, prandaj nuk di pse ngurrohet në mundësitë që ka ofruar atëherë e ofron edhe sot vetë sistemi eptimor (zgjedhor e fjalëformues) i gjuhës sonë, konkretisht pse mos të shfrytëzohet struktura e gjallë foljeformuese e saj e atëhershme dhe e sotme dhe së këndejmi, sa për ilustrim e kërshëri, pa hyrë në zgjedhim) po i shënojmë si model katër-pesë shembuj foljesh njërrrokëshe, nga FGJSH si model fjalëformues përdorimi. dy me –P dhe tri me –M fundore:

1) **sh/qep, me sh/qepë** sh/qepje të sh/qepët, e sh/qepura, të sh/qepurit etj.

- 2) **shqim**, *me shqimë* shqimje të shqimët etj. ,
- 3) **im** (me imë) i imë, i imtë, *imtoj, imshtoj, imtësoj, imëzoj*, imcake, imshajtë etj.

dhe

- 4) **njom**, *me njomë*, të njomët, njomë-a, njome / njomje, të njomurit etj. me zhvillim foljesh sinonimike –O me zgjerim: *njomështoj, njomësoj, njomëzoj e njomtoj* (FGJSH 2006 f. 714). dhe

të gjitha këto me me mundësi të hapur shumimi, apo jo?

Pra, një model i tillë zhvillimi eptimor (zgjedhor e fjalëformues) nuk mund t'i mohohet as trajtë-foljes njërrrokëse **shqip me shqipë**, apo jo?! Së këndejmi mund të themi që ky fakt shpjegues ngjashmërisht, tregon se fjala **me shqipë shqip** strukturisht që nga fillim-përftimi kishte edhe **nacion të foljes, emrit e mbiemrit** në të folurit e gjallë të shqiptarit, andaj nuk është pa vend sugjerimi që vështirë të besohet që gjoja koncepti i tillë i *të folurit shqip* fillimisht do të ketë ardhur vetëm nga ndikimi i një huazimfoljeje të latinishtes (pa bazë shqipe), siç ishte *excipio excipere* apo ndonjë tjetër dhe kështu shpjegimi të ishte i mjaftueshëm me trajtën **shqipoj** apo edhe **shqipëtoj** e aq më pak nga **shqipëlloj** si parësore për zbulimin e prejardhjes dhe të përhapjes së apelativit **shqiptar** nga **scipio** (shkip-) me barasvlerësin e diskutueshëm në shqipe: *kuptoj marr vesh* (!) dhe përgjithësimin e fjalës shqiptar, sepse, siç mendohej periudha pas shek. XV – XVI, kur vihet re (diktohet) në gjuhën e shkruar trajtë-fjala *shqip* përfutuese e shpifur si ndajfolje (nga Buzuku 1555), por që pa dyshim mund të ishte edhe më e hershme, siç mendon edhe z. Fetah Shehu, apo mund të ishte kontaminim konceptesh të ndryshme kuptimore, ngase gjuha popullore e shqiptarëve ishte gjuhë e formuar dhe e formëzuar shumë shekuj më përpara, madje tashti në këta qindvjetorë si sistem ishte nën presion-ndikimi të gjuhës turke-arabe apo të gjuhëve fqinje e jo assesi nga një fjalë ekstreme latine ose të ndonjë gjuhe neolatine, aq më tepër kur mendohet se masa e konvertuar shumicë muslimanë ishte shtrati i lindjes (apo i përtëritjes) dhe i përvetësimit të fjalës **shqip shqiptar**, sidomos në shek. XVII-XVIII kur ndodhi edhe islamizimi masiv i shqiptarëve, sepse gjuha latine ose fjala e latinishtes ose e neolatinishtes nuk do të kishte mundësi të joshte aq masivisht masën shqipfolëse shumicë muslimane për përgjithësimin e popullarizimin apelativ e asaj fjale aq për zemër dhe me shpejtësi të *rrufeshme përvetësimi*, apo jo?!

Kjo që sapo u tha aspak nuk e përçmon ndikimin e italo-latinishtes në gjuhën e përkthimit të Buzuku e shkrimtarëve të tjerë të vjetër gegë, por ne kërkojmë edhe prova të tjera më bindëse dhe për këtë po shprushim për me gjetë gacë të forcë pikërisht në kuadër të gjuhës shqipe në hinin ose pluhurin e harresës dhe duam të besojmë se aty e gjetëm foljen **me shqipë**, si barasvlerëse e shprehjes **me folë shqip**, të cilën e quajmë të mjaftueshme si bazë mbështetëse ndërtimore edhe për fjalën **shqiptar**, por edhe për ta kuptuar atë fjalë si apelativ, pra për ta kuptuar edhe më mirë **shqiptarin** si ligjërues dhe veprues në procesin e *të shqiptuarit*, prandaj këtë nocion e përmendim si më të kualifikuar pikërisht foljen në trajtën tjetër *shqipoj me shqipue* dhe ndihmesën tonë lidhur me këtë po e shprehim në vijim.

b) Rreth semantikës së foljes shqipoj me shqipue

Është e vërtetë se për të sqaruar objektivin tonë dalin vështirësi objektive po edhe subjektive, sepse për të dyja konceptet, pikërisht togfjalëshin perifrastik në formën përfaqësuese *“me folë shqip”* ose *“flas shqip”*: *flas hapur, qartë, troç*, në burimet tona të deritashme normëzuese të shqipes së sotme mungon paskajorja e mirëfilltë: me shqipë, nënkupto: *me folë hapur, me folë qartë, me folë troç*, si barasvlerës i natyrshëm i asaj perifraste, në anën tjetër mungon së shënuari po mbi atë bazë edhe folja me –Oj: **me shqipue**, e cila në të vërtetë në trajtën **shqipoj** del e implikuar vetëm në analiza qëmtimesh, siç e ndeshëm si shembull të parë nga *“Port albi”* e burime të tjera, koncepti i së cilës mesa pamë, nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me **gjuhën shqipe**, sepse sinonimisht nga folja **shqipoj me shqipue** del emri i vepruesit - i **shqipuesit**, jo i shqiptarit shqipfolës, madje si nocion nuk mund të mbulojë as aq lehtë as natyrshëm ose as fare shprehjet tashmë të njohura: *me folë qartë, hapur, troç*, madje edhe *me folë kuptueshëm* e *me theksim të veçantë në gjuhën tënde amtare*, siç i mbulon, pra, folja në trajtën **me shqipë**, apo jo?!

Sigurisht njëra nga arsytet pse trajtat e tilla foljore *me shqipë, shqip* si dhe ajo *shqipoj me shqipue* nuk dalin të shënuara në burimet tona të deritashme normëzuese, mbase mund të jenë të arsyeshme për dikë vetëm nga shkaku pse që nga Buzuku e këndeje nuk qenkan ndeshur gjëkund të shënuara në gjuhën tonë të shkruar këto trajta foljore, ndërkaq ne mendojmë se një arsyetim i tillë del i flashkët, madje edhe arsyetimi që kjo trajtë nuk qenka e përdorur nga arbëreshët, sepse supozojmë se foljet

e tilla kanë mundur me qenë në përdorim dhe është pak e çuditshme pse nuk janë hetuar deri tani nga gjuhëtarët, ngase për koncepte të ngjashme ose të gabuara, trajtat e tilla ndoshta edhe kanë qarkulluar, madje është e pamundur të mos ndesheshin në thjeshtëligjërime (stilin bisedor) gjatë 4-5 shekujve të kaluar ose të mos ndeshen në përdorim e sipër, pa u ndarë konceptualisht nga fjalët frekuentuese *shqiptar* e *Shqipëri*, edhe sot brenda opusit të fjalësisë aktual të gjuhës sonë ligjërimore, apo jo?! Fundi i fundit gjithkush duhet ta dijë se pasurinë e gjuhës nuk e tregon një fjalë, po sistemi me strukturat e veta, ndërtuese, shprehëse, fjalëfomuese, stuktura këto që duhet të ndiqen të mësohen dhe të kultivohen nga studiuesit, ortologët dhe vetë folësit...

Sido që të jetë, mbase për dikënd e *pabesueshme*, por ne, siç do të përpiqemi ta argumentojmë, nga opusi i gjallë i ligjërimeve tona popullore prej nga ofrojmë prova pikërisht për ekzistimin e të dyja trajtave, por në veçanti për foljen: *shqipoj me shqipue*, e cila mbase vetëm pse paska “*përhapje të kufizuar*”, siç e cilëson studiuesja Anita Omari, nuk del e shënuar në burimet tona normative standardizuese, edhe pse sipas semantikës që bart, konkretisht te ne përdorej e përdoret me edhe pa përforcuesen nistore **SH**. Pra e ndeshim: *qipoj me qipue*, por edhe *shqipoj me shqipue*, trajtë foljore kjo e para, e cila ka përdorim mjaft të gjerë, pothuaj gjithkund haset në ligjërimet tona të përditshme por edhe e dyta (*shqipoj me shqipue*) nuk mungon, por ndoshta vërtet *me përhapje të kufizuar*.

Ç’është vërteta, trajta *qipoj* (edhe pse nuk del e shënuar në FGJSH (2006), sipas konceptit që mbulonte dhe mbulon ajo në FGJSSH 1980, f. 1598 që del e shënuar si *krahinarizëm* në trajtën me ndërrim të zanores së parë i/e: *qepoj* dhe shpjegohej:

“godit me diçka që është me majë a me thep; qëlloj. E qepoi me shkop”.

Edhe në Fjalorin e M. Elezit ndeshet trajta *me qepue* si barasvlerës i trajtës: *me rrahë*, d.m.th. pa u cekur: *thep*, *majë* apo *shkop*.

Lusim lexuesin e nderuar që fjalën **qepoj**, ta mbaj mend bashkë me sinonimet “*qëlloj*”, “*rrah*”, “*godit*”, si dhe përkufizimim ilustrues “*E qepoi me shkop!*”, sepse do ta ketë më lehtë me përkapë e me zbërthye vete zgjidhjen e enigmës, e cila në njëfarëdore, sipas mendimit tonë ofrohet si zgjidhje e mundshme në këtë punim nisur nga folja *qepoj* që te ne del edhe në variantin *qipoj me ia qipue*.

Ç’është e vërteta trajta **qepoj**, në gegnishten tonë shqiptohet me – **i: qipoj me qipue**, dhe njëherazi në stilin normal përveç nocionit sinonimik: (sh)qipoj/**qëlloj** (geg. **qilloj me qillue**) kuptohet edhe varianti i të të shprehurit: *Ia shqipova (qipova) me guri, me shtagë (me shkop), me shufër, me grusht...* (dikuj, një objekti), veprim ky, në të cilin mund të hyjë në përdorim, qoftë edhe metaforikisht edhe *sqepi, qepi* ose *qip-i* për vetën e tretë: *ia sqepi* (“*qipi*” sipas Nolit), si b.f. ia sqepoi (me sqep a si me sqep), por jo me kuptim përgjithësues përfaqësues, apo jo?!

Sidoqoftë, te ne dalin dy folje **me sh/qepue** dhe **me sh/qipue**. Kështu, folja **shqipoj qipoj**, ndeshet në përdorim të natyrshëm, si p.sh. Rrushja “... *ia qiponte guri në lulë të ballit me llastik...*” (*Lirim Gashi, “rd”, 18.08. ’19*), assesi nuk ngel e rrudhur vetëm te nocioni: *sqep sqepoj, sqepim, të sqepuarit*, madje, le të dihet se në viset tona sqepit i thonë **kaqep**, apo jo?!

Së këtëjmi mendojmë që folja **shqipoj (qipoj) me shqipue** ose **me qipue**, me prejppjesorët e mundshëm të saj duhet të konsultohet po jo patjetër ndërlidhur me sqepin (e shqiponjës), por as parësisht me gjuhën (si mjet shprehjeje), po patjetër duhet trajtuar ndërlidhur me etimologjinë e apelativit **shqiptar**, përkatësisht si një sinonim që ndërlidhet me kuptimin e foljeve: *godit, rrah* dhe sidomos *qëlloj, përkatësisht qilloj me qillue, qëllova (qillova)*, e cila përveç sinonimit **shqipova me shqipue** mbulon edhe nuancimin *ndodha me ndodhë*.

Pra, tani nga konteksti del që kemi të bëjmë me dy folje homonime: 1. *Me ia qillue me diçka* (me goditë, me rrahë një objekt me ...) dhe 2. *Me qillue dikund* (me ndodhë diku në një vend rastësisht). Dhe vetëm shembulli i parë: *me ia qillue me diçka një objekti* ka sinonimi, qoftë me kuptim asnjës, qoftë metaforik, me veprue si veprues: **me ia shqipue me diçka...**

Këtu del edhe një problem tjetër që këtu vetëm po e cek. Edhe në serbisht si shqip me qipue, përkatësisht me shqipue ngjashëm dalin trajtat foljore *çepati* dhe *shçepati*. Sipas Fjalorit serbokroatisht shqip trajtat e tilla kanë këtë barasvlerësi

1) **čepati**, čepam čepujem – shkel, shtyp (shqelmoj me këmbë)

2) **ščepati** (zgrabiti) – rrëmbej, kap, rrok, mbërthej (f. 847)

Mesa po shihet trajta **čepati** nuk përkon plotësisht me trajtën **qepoj, me ia qepue** e aq më pak me trajtën gegnishte *qipoj me ia qipue* me një mjet, jo *shkel me këmbë*, madje edhe trajta tjetër **ščepati** aq më tepër nuk përkon me kuptimin e përforcues të foljes as **me shqipue as me shqepue**.

Si përfundium, **gjithsesi folja me shqipë**, mbetet e ndërlidhur vetëm për gjuhën (fjalët) e shqiptarit, ndërsa folja **qipoj shqipoj me shqipue** (me qillue, me rrahë, me goditë) me ndonjë mjet a send (jo me sqep!) mbetet e ndërlidhur me cilësinë e apelativit **shqiptar** dhe kështu prejardhjesisht tregon **shqiptarin** kryesisht **si veprues (shqipues)**, që nuk *rrëmben, mbërthen*, po vepron manipulon me... + mjetin përkatës, edhe me gjuhën si mjet, apo jo?!

Sidoqoftë, e themi me bindje të plotë dhe me përgjegjësi se që në moshë të re kam dëgjuar, gjë që mund të vërtetohet çdo çast te ne, foljen, **me (ia) shqipue, me guri, me shtagë, me grusht etj.**, por atëherë edhe në bisedë burrash metonimisht dilte edhe folja: **me shqipë** (me fjalë), por figurativisht edhe trajta **me ia shqipue me fjalë**, kur fjala: *godet, rrah, qëllon, qepon ose qipon*...

Kështu, më kujtohet kur në odë të burrave rastësisht ngecej në temat e muhabetit, i zoti i odës (konkretisht im atë), ftonte me emër dikë të dalluar si llaftar: **Hajde (filan) shqipja dikah, çilna laf!** Dhe kur gjendej tema e bisedës, e lavdonte: **Ia shqipove mirë, qysh duhet, e vrave shejin ... , e qillove ku duhet...**

Shprehjet e tilla figurative metaforike ose metonimike edhe sot janë të pasosme në *shqipimet me fjalë*, të cilat gjithsesi duhet të jenë të goditura, sipas kriterëve të veçantisë stilistike, të të shprehurit: *troç, qartë, saktë, me mend ose me rend e me vend*, apo jo?!

Lidhur me raportin **qipoj me qipue / shqipoj me shqipue** po e shtojmë si sqarim edhe këtë fakt. Natyrisht rreth zbërthimit të kësaj teme, në mënyrë të veçantë duhet me pasë parasysh përveç nevojës rreth pertheksimit të fjalës përkatëse edhe ndërtimin e fjalëfoljeve ose të emrave, ku përveç SHK-së nistore: *shqip ose shqipoj /'kipoj/* edhe me SHQ nistore: *shqip me shqipë ose shqipoj me shqipue/ qipoj me qipue*, gjithsesi të vihet re edhe *I-ja e theksuar e gegërishtes në përdorim* si dhe ekzistimi i *-P-së fundore* të temës prodhuese, qoftë si emër: *shqi/P/, shqi/P-o, ShqiP –tar, ShqiP-ni, ShqiP-ri* , qoftë si folje: *shqiP, shqiP-oj, shqiP-toj etj.*

Ç'është e vërteta, edhe rreth raportit **qipoj/shqipoj**, po sqarojmë edhe këtë, ngase sot dihet Sh-ja përdoret zakonisht si parashtesë fjalëformuese që fjalës pasuese i jep kuptim të kundërt si *fajësoj /shfajësoj, qep /shqep* (geg. *kep/shkep*) etj., por njëherazi, sipas shembujve që konsultuam në FGJSH (2006), mësojmë edhe atë që duhet të dihet kjo e vërtetë, sepse Sh-ja nistore përdoret edhe si mjet përforcimi sinonimik, jo

me kuptim të kundërt, si: nga *tra trau:trazë/shtrazë, pastaj: lirim/shlirim, mendoj/shmendoj, këput/shkëput, këmbëj/shkëmbej, qit/shqit, ndrit/shndrit, paguaj/shpaguaj, prehje shprehje, përndaj/shpërndaj* etj. që vetëm në atë burim janë të regjistruara mbi 10 raste, ku bashkëtojnë shembujt, po secila fjalë del e specifikuar për konceptin përkatës me përshkallëzim të veçantë semantik, prandaj edhe raporti sinonimik, qoftë si **karpë/shkarpë edhe** emri **qipi/shqipi**, qoftë si folje **qipoj/shqipoj**, del i vetkuptueshëm dhe i arsyeshëm për të dyja konceptet sinonimike. Pse trajta **qipoj** ka përdorim më të madh nga **shqipoj**, për të njëjtin koncept ose të përafërt mund të studiohet, por kjo, mund të ketë ndodhur edhe nga procesi i ekonomimit brenda gjuhësor, por edhe nga fakti i mosshënimit të trajtave të caktuara në fjalorët tanë normëzues të deritashëm, apo jo?!

Së këndejmi, b.f. nga vetë trajta *shqip*, siç del edhe në FGJSH edhe e përfaqësuar qoftë si *ndajfolje a mbiemër*, në kuadër të saj si nga çdo fjalë tjetër aktive ndërthehet edhe emri shqip-i, (Shqipi - mësuesi i gjuhës shqipe (!) përdoret si zhargon), pra mund të përdoret edhe folja **me shqipë (shqip)** etj., ashtu siç e lejon vetë sistemi fjalëformues i shqipes, që ishte i tillë edhe para kohës së Buzukut, i cili mundësonte që nga çdo temë prodhuese fjalëformuese, sigurisht edhe nga fjala **shqip** të përftoheshin konkretisht, qoftë emri konkret (shqip-i), qoftë folja (shqip, me shqipë, prejpjesorët *shqipje, të shqipët, e shqipura, të shqipunit* etj., siç i shënuam pak më sipër në shembull-ndërtimin tonë. Madje, është krejt normale, siç u veprua në “*Port-alb*” e burime të tjera, siç bëme edhe ne, duke futur në përdorim prapashtesat përkatëse të specializuara ose të specifikuara foljeformuese: me –O, **pa – e me zgjerim**, e si rrjedhojë doli edhe folja: shqip+Oj **shqipj me shqipue**.

Gjithsesi nga të dyja trajtat foljore në shqyrtim: **shqip me shqipë** dhe **shqipoj me shqipue** mund të formohen menjëhershëmrisht prejpjesorët *shqipJE, shqipTAR (shqipëS)* etj. ashtu si edhe nga **shqipoj: shqipIM, shqipUE/S** etj., me fjalë të tjera të dyja trajtat duhen pasur në konsideratë **për hiset e tyre**, sidomos trajta e parë që e kishte dhe e ka aktualisht hisen rreth përfutimit ose gjallimit të sotëm të fjalëtermave: **shqipo shqiptar, Shqipri (Shqipni)**, që deri më sot konsiderohet si çështje e pazgjidhur etimologjikut e ndërtimisht. Pra dallimi semantik në mes të trajtave **shqip** (me) **shqipë** ndaj **shqipoj**, (me) **shqipue** a **shqipuar** si dhe **qipoj** (me) **qipue** a **qipuar (qipoa)** duhet pasur parasysh në analizat e caktuara, apo jo?!

Së fundi, t'i risjellim në kujtesë nga FGJSH (2006) dy përkufizimet e fundit të emrit **shqiptar** dhe t'i krahasojmë me barasvlerësinë (zëvendësimin) që e ofrojmë ne me foljet përkatëse në trajtim:

E para: *Shqiptar quhet: ai që lidhet ose ka të bëjë me (për) shqiptarët e Shqipërinë.*

ose ai që **shqipon** (që duhet **me shqipue - të shqipojë**) të punojë për shqiptarët e Shqipërinë.

E dyta: *Shqiptar quhet: ai që flet qartë e kuptueshëm shqip ose ai që shqip (ka për detyrë **me shqipë – të shqipë**) qartë e kuptueshëm (shqip).*

Sa i përket strukturës fjalëformuese në raportin **emër/folje** kemi të bëjmë me proces paravajtës ose prapavajtës le të vlerësohet, për ne ka rëndësi pragmatika e sotme e përdorimit të emrit **shqiptar** dhe aktivizimi i dy trajtave foljore: **me shqipë shqip** dhe të asaj **me shqipue shqipoj**.

Kështu, po përsërisim që me trajtën **me shqipë shqip** (*shqipje të shqipët*), si p.sh.: *Shqiptari duhet me shqipë qartë e kuptueshëm në gjuhën e tij* kuptohet fjala *shqiptar* ndërlidhet *si folës, shqipfolës*, ndërsa me trajtën **me shqipue shqipoj** (*shqipim të shqipuarit*), si p.sh.: *Shqiptari ka për detyrë përherë me shqipue (të shqipojë apo të flasë, përkatësisht të manipulojë: të flasë e të shkruajë në të mirë të atdheut të tij, ku kuptohet shqiptari si veprues (shqipues), zhvillim ky i brendshëm i përligjur i shqipes, andaj pikërisht rreth formëzimit ose implikimit të konceptit të emrit shqiptar si veprues, në veçanti rreth rrënjës shqip- nga shqip+O/j: shqipoj me shqipue (shqipues) në krahasim me gjurmë koincidentesh ose puçje me gjuhë të huaja do të bëjmë fjalë në vijim.*

c) Rreth konceptit të foljes shqipoj si veprim dhe të emrit shqiptar si veprues në koincencë ose puçje rrënjëzimi fjalësor me disa gjuhë të huaja

Gjatë hulumtimit ose konsultimit të materialit rreth kësaj teme hasëm disa fjalë në gjuhë të huaja diçka sikoincencë me fjalën ose puçje me rrënjën e fjalës **shqip shqiptar**, shembuj këta që na tërhoqën vëmendjen, fakt i imponuar konkretisht, qoftë si fjalë të ndërhuazuara kontaminuese, jo vetëm nga gjuhët klasike, latinishtja e lashtogreqishtja, por edhe nga italishtja, serbishtja, rijogreqishtja etj.

Është fjala për ngjashmëri të shqipes me rrënjë-fjalën *skip-* (*shkip-*, *ship-*) në gjuhë të huaja, ndërlidhur kuptimisht me konceptin e **të shqipuarit të shqiptarit**, përkatësisht të foljes **shqipoj**, me **shqipue** që ndërlidhet me mjetin përkatës të veprimit me rrënjëzim të njëjtë ose të ngjashëm të përdorur nga **shqiptari** gjatë përshkallimit jetësor të trashëguar gjatë këtyre 6 fazave të zhvillimit historik shoqëror, duke filluar nga faza më e thjeshtë kur përdorej *grushti* (dora, gishti) si mjet veprimi, deri tek më e komplikuarja *pushka*, si:

Të shqipuarit:

1. fizikisht, me grusht (dorë) e mjete të tjera kujto jehonën e motos shqiptare: “dora-doras -grushtbashkuar”, kur me grusht (dorë). **shqiponte** ose *shkyente shkyetari!* *shkipi* ***shkjyeptari** –*shqyptari*, shqiptari;

2. me gur, shkëmb, shkrep - (**hipoteza** shqipe –**petrit** (petro-shkëmb) shkrep **shkreptar-i** – kulti i gurit ose *pesha e gurit - fjala e burrit*, - /, identifikim me *shkye punë, shqipimi* i shqiptarit (shkreptarit);

3. me shkop (lat. **skop-** dhe **scipia** (lexo: *shkipja*) sot shkopi - shqipuesi ose përdoruesi i shkopit (shkipit), si mjet pune, shkopi i bariu, mjet luftimi edukimi e sundimi (**shkiptar**/shkoptar!);

4. me shigjetë .. **shqy'tar** - shqiptari përdorues i shqytës (shigjetës), shprehur metonimisht, ku nënkuptohet *shqiptari shigjetar - shqytar!*, por edhe si *shqitar!*;

5. me shpatë, ***schipos** (*shqipos/shpatë*) që nga goja e Eskilit, sipas Wincenso Dorsës e në vazhdimësi shqiptari dallohet si *shqipues - përdorues i shpatës (shpatëtar – i shqipos!-it)*;

6. me pushkë it. **scipioppu** (shkipio' - pushka) dhe **shipetare** - shqiptari si etni, përkatësisht **shkipet** (gr. **skippetto(n)**, it. **schioppetto**) “**pushkatar**”- shqiptari *zot i pushkës (pushkëtar)*. Shqiptari shkyes(shkipës) i punëve me çdo mjet

Pra na duket se lexuesi tani e ka të qartë se emri i **shqiptarit** ose atributet e cekura, në gjashtë pikat e mësipërmeku ishte e implikuar edhe gjuha e etnive fqinje ishte i ndërlidhur me aktivitete të cekur në rrënjën ose kuptimin e fjalës së tillë te shqipo-shqiptarit në kohëhapësirën përkatëse gjatë zhvillimit shoqëror të tij, duke filluar nga mjeti më i thjeshti primitiv **grushti i shqip-it (dora e shkye(p)sit të gjahut–shkipit** deri tek mjeti më i ndërlidhur **pushka (shkipe/tos)**. Kështu, siç e shënuam shqiptari (**shqip-i**) në çdo fazë zhvillimi e jetese përdori mjetin me të cilin *shqiponte, (qiponte)* mbronte ekzistencën e vet, mjete këto, siç janë:

grushti (dora), guri, **shkopi apo shkipi**, shigjeta, shpata, pushka, që e shoqëronin po me atë emër apo me atributin “**shqip**” të përdorur e shqiptuar si më vetvetja, gjatë tërë zhvillimit të formacioneve shoqërore në kohëhapësirën vertikale, si të thuash, siç edhe njihej vetë, përkatësisht ashtu njihej apo atributohej në njëfarë mënyre edhe në gjuhë të huaja si “**shqip**” *shqipo shqiptari*, andaj lidhur me koincidencën e fjalës përkatëse në gjuhë të huaja të ngjashme me fjalën *shkip shqip shqiptar*, përkatësisht të foljes **shqipoj me shqipue** ose **me shqipue (me veprue) me mjetin përkatës** imponohet pyetja fjala *shqiptar* ose foljet **shqip** apo **shqipoj** apo **shkip shqipoj** ishin fjalë marrëse nga ato gjuhë apo ishte (proto)shqipja *pellazge* dhënëse e kësaj fjale gjuhëve të huaja gjatë kontaktit (*kur Roma fliste shqip*) që kishin prto-shqiptarët me popujt e ndryshëm ose ishte gjurmë e mbetur në ato gjuhë me rastin e shkrirjes së folësve përkatës proshqiptarë në popujt të tjerë?!

Në të vërtetë dhe më i forti, më miri e më i vështiri për t’u mbrojtur është gjuha, mbrojtja dhe sulmi me fjalë, me të shqiptuarët. Me sa pamë përveç pikës së parë të theksuar prej nesh si si veprimi i shqiptarit: “**dora-dorës grushtbashkuar neve jemi...**” në të pesë pikat e tjera kryesisht rrënja e fjalës nuk ndryshon rrënjësisht: “**shkip shqip shqiptar**”, ashu si reflekton ky emër tek emërtimi i mjetit përkatës, gjurmë e mbetur semantike të emërtimit përkatës që tregon simbolikisht vazhdimësi veprimi, e gjallimi të “**shqipit**”, apo jo?!

Sido që të ketë qenë, ngjashmëria e tillë është e evidente, andaj çështja kërkon zgjidhje. Për mendimin tonë, ka më shumë argumenta identiteti që origjinali i fjalës dhe konceptit **shqip** (me derivate) i (proto)shqipes t’u ketë imponuar gjuhëve të huaja (klasike) me apelativin e vet të identifikuar bashkë me mjetin, qoftë me si folje ose si emër. Kështu themi, kur kemi parasysh të vërtetën historike, që gjithnjë e më tepër po del në dritë, se protoshqiptarët vërtet kishin pasur shtrirje të gjerë gjeografike si shumicë jo vetëm në Siujdhesën Ilirike, por edhe në Siujdhesën Apenine (Italinë e sotme), pa përmendur venbanime në hapësira të Azizë e të Afrikës, dhe me punën dhe kulturën e tyre vetjake **pellazge** kishin bërë emër si ndërlidhës edhe të gjuhës e kulturës lashtogreke e latine, por edhe të popujve të tjerë që nga lashtësia e deri në ditët e dokumentimit të koincidencës së emërtimeve përkatëse, sepse siç dihet që atëherë **lashtoshqiptarët** gjuhën e tyre e kishin sado të konsoliduar dhe në veprimtarinë e tyre në vazhdimësi dalloheshin pikërisht me përdorimin e mjeteve përkatëse që u cekën në gjashtë pikat e

sipërcekura përshkallëzuese (me forcën fizike, grushtin (dorën), pastaj me mjetet përkatëse që i siguronin ekzistencë, punë, mbrojtje ose edhe shërbenin si mjet sulmi, si **shkrepi** (gr. petro –shqiptari petrit (guri ose shkëmbi, shkrepi), **shkopi** (lat. scipia dhe scopia, mjet bariu ose shkop me shkip (**skepter**) si mjet urdhëri disiplinimi i Zeusit apo Hermesi djali i tij; **shigjeta** ose **shqyta** (shqy'tar), **shpata** (gr. vj.. scipios) dhe së fundi **pushka** (it. shkípio) si mjet mbrojtës e sulmi, apo jo?!

Lidhur me përhapjen e shqipes si gjuhë e masës në oponencë ndaj gjuhëve liturgjike na elaboroi me fakte z. Vedat Shehu. Zgjon interes gjithashtu edhe propozimi e të nderuarit z. Fahri Dahri, i cili kërkon formimin e një **Komisioni** « në rang kombëtar (përfshi edhe diasporën) që emri **shqiptar** si **një emërues i përbashkët të jetë gjithpërfshirës i të gjithë shqiptarëve: çamëve, arbëreshëve, arnautëve, arvanitëve... Kështu emërtimet e ndryshme sipas ndarjeve territoriale për të njëtin popull kudo ndodhur të marrë fund**».

Ne përkrahje të *kërkesë-propozimit* e z. Dahri për përforcimin dhe shtrirjen e emrit **shqiptar**, në fund të këtij kreu, do të ritheksojmë edhe arsye të tjera, sepse që nga fundi i sekullit XVIII, gjatë tërë shekullin XIX dhe XX shqipfolësit kudo janë identifikuar parësisht mbi bazë gjuhe, por edhe mbi bazë të prejadhjes dhe veçorive ose attributeve etnike **si shqiptarë**, të pajtur me mjetin përkatës, ku qëndronte edhe gjuha shqipe si mjet veprues, pa dallim zone gjeografike (nuk përjashtohen apriori as arbreshët e as arnautët në vende të lindjes etj. Pra, pa marrë parasysh kushtet e rrethanat e pavolitshme të të jetuarit edhe sot shqiptari (arbnori) mund t'i japë dritë emrit e gjuhës së vet duke *shqipue me mjete mbrojtëse e sulmi*, të sipërcekura, por sidomos me mjete pune të llojllojshme dhe me dije shkencore, arti, sjellje humane, për çka fatlumisht edhe mund të mburremi, me kuadro të dalluarta vepruese kudo nëpër botë, por gjithsesi pa e harruar **shqipjen** dhe **shqipimin** shqip, apo jo?!

Sidoqoftë, kjo që u shtrua deri këtu duhet të vlerësohet, mirëpo meqë shkopit (shkipi) si mjet i përpunuar nga druri që u cek në pikën 3. ka marrë konotacion simbolik (metaforik) gjatë procesit historik lidhur me shqiptarin, qoftë si mjet pune, ekzistence (jeta baritore e mitologjike), gjithsesi edhe si mjet mbrojtës identiteti, qoftë edhe si mjet edukimi e sundimi, madje edhe me konotacion përçmues(!) nga dikush, që kryesisht ishte ose ende është aktual edhe sot dhe që shërben veç tjerash edhe për zbardhjen e raportit të brendshëm të shqiptarëve, por edhe në raporte me popuj e gjuhët klasike, madje-madje edhe lidhur me marrëdhëniet etnike

shqiptaro-serbe dhe të kombeve të tjera (italianë, bullgarë, rumunë, greke e turq-osmanë), ne më poshtë po e trajtojmë më në hollësi këtë çështje si temë bë pikën vijuese si një hipotezë më vete që ndërlihet qartësisht me zbardhjen e etimologjisë së fjalës **shqiptar** dhe të **gjuhës shqipe**.

ç) Përforsim-përcaktimi i koncepteve: “shqipja shqip”, “disiplinimi i shkopit” dhe mitizimi i të “shqipuarit me shkop” që nga lashtohistoria shqiptare

Konstatim hyrës

Në këtë pjesë do të përpiqemi të zbardhim prejardhjen e fjalës **shqip shqiptar** nga ***shkip** e ***shkop**, duke lansuar një sihipotezë e cila pothuaj u pahua (doli në pah) edhe si rezultat i zberthimit të deritashëm të kësaj teme prej nesh, por edhe nga të tjerë, siç do argumentohet në vijim. Së këtëjmi, në tri pika shtjelluese do të shprehim mendimin tonë:

së pari, sjellim prova rreth përforsim-konstatimit: emërtimi **shqip** për gjuhën tonë është temë bazë edhe për apelativin **shqiptar**;

së dyti, trajta **shkip /shkop** apo “**disiplinimi i shkopit**” plotëson të gjitha kriteret të konsiderohet si etimologji e fjalë-ligjërimit shqip dhe të etnonimit **shqiptar** dhe

së treti, edhe mitizimi i të “**shqipuarit me shkop**” që nga mitolashtohistoria shqiptare ndihmon përforsim-konceptimin e prejardhjes së etnonimit **shqiptar** lidhur me përpunimin e përdorimin e një vegël-mjeti drunor të quajtur: **shkip** apo **shkop**.

a. Rreth prejardhjes së etnonimit shqiptar nga fjalë-tema scip/scop shqip- (shkip e shkop – si mjet drunor)

Në disa pika po i vargëzojmë disa nga të dhënat kryesore që ndikuan në sajimin e kësaj sihipoteze:

E para, fjalë-emri **scip/ shkip/ scop (shkop)** në indoeuropianishte etimologjikisht shpjegohet se rrjedh nga trajta ***Skel.P**, “copë a prerje nga druri”, siç është në të vërtetë edhe nocioni i shkopit, me kuptim të përgjithshëm neutral. Sa për fillim, për ta kuptuar procesin, të vihet re fenomeni i ndryshimit të tingujve vokalë **a:e:o:i** te folja e shqipes **shoh me pa**: *me pa: shoh, sheh, shih!*). Këtë ndryshim tingujsh e hasim te fjala **shkop e shkip**, siç do të shohim në shembuj konkretë

përkatës që imponohen nga gjuhët e huaja ose të vjela prej nesh nga burime të caktuara në gjuhën tonë.

E dyta, po shtojmë mendimin e studiuesit të nderuar, **Nezir Myrta**, që e mësova më vonë, i cili me akribi të hollë e trajton këtë çështje në punimin: “Etimologjia e emrit –Shkup”, i cili, duke karakterizuar gjuhën *pellazgo-ilirodardane* **kuniforne**, përkatësisht cek që Shqipja e Parë me *origjinë linguistike kuniforne*, si fjalë të para kishte fjalën **kun** (sot kunj-i), me zhvillim gjarpëror **S- nistore Skun** dhe shënon këto tri fjalë-trajta njërrrokëshe: **skop skip skup - s/kun** dhe krahason fundoret: –N/-P dhe nistoret S/SH që në gjuhën e sotme dalin emërtimet: **Shkop (skop), Shkip (skip), Shkup (skup)**...

Lidhur me këtë për ne zgjoi shumë interes shpjegimi i kuptimit të këtyre trajtave si fjalë të nisfillta të shqipes: e para **kun** (siç desha ta kuptoj: *kunj shkop i vogël druri*) dhe e dyta **skop** (*shkop, dru i hollë, i gjati, që përdoret si mjet për punë të ndryshme*). Po sqaroj se në fëmijmëninë time, si mjeshtri e parë sprovë ishte *si me gdhendë një kunj thesi*, dhe si me g/dhendë *shkopin (shtagën)*, shkop i posaçëm bariu që quhej **kërlik** dhe shërbente me zënë cilëndo nga delet për një këmbë. Gjithsesi *kunji* (i thesit) dhe **kërliku shkopi** (i bariut) “*lidhen me kuptimin e përpunimit të një cope druri*”... përkufizim ky i ngjashëm që u dha për trajtën e sanskritishtes (Krahaso: trajtën ***skel.P.** me **skun** dhe **skop /kunj e shkop/**), fjalë këto lidhen me nocionin e një vegël-mjet nga druri. Po aq më tepër ka meritë autori **Myrta**, që tenton që nga trajta **skip** (shqip), duke shëmbëlluar me rrufeshmërinë e shqipe-shqiponjës, **zogut të qiellit** në ajri, karakterizon njerëzit në tokë, duke bërë përcaktimin karakterit të **shqiptarit**, si etnonim me gjuhë dinamike etj. Pra edhe te ky studiues kemi përputhje koncepti nga fjalë-folja **shqip me shqipë**, po edhe **shqipoj me shqipue**, të trajtuara prej nesh prej nga del **vepruesi** (shqiptari) simbol si *folës e shfrytëzues i një mjete a vegle të thjeshtë të përpunuar prej druri (kunj a shkop (kërlik), thupër)*, apo jo?

E treta, në Fjalorin latinisht shqip ndeshëm trajtë-fjalën **scipion - shkop, spektër** si dhe **scopa – thupër**, shkop i hollë. Pra dy trajta, pothuaj për të njëjtin koncept, ashtu siç del edhe në burime të shqipes, sipas studiuesve përkatës.

E katërta, kështu studiuesi, Aristidh Kola, gjë që zgjon interes, nocionin e shqipes *shkop* e ka ndeshur në veprat e Homerit në trajtat **skipton, skiptro**, pra me **I** jo me **O** (shkop) apo **E** (skeptro).

E pesta, ndërkaq në një shkrim anglisht në internet ndeshëm që në protoshqipe (EPA) koncepti i fjalës *shkop* del e shënuar në trajtën **skap/a**, me –A- në temë, ashtu si edhe shembujt e tjerë si: emri *motër – mater* dhe dy foljet: *shtoj – stanj/a* (shtaj!) dhe *lodh – lad/a* (ladh!), që na ku jtojnë konstatimin e historianëve të gjuhës që në i.e e lashtë, primare ishte tingull-shkronja –A (skapa) e temës, prej nga rrodhi pastaj tingull-zanorja –O apo I : **shkop** apo **shkip** apo **shkep** (**skep/ter**, shkopi i Zot-Zeusit).

E gjashta , prof. Kolec Topalli me fjalën **shkipij**, shënon nocionin “shkopinj të lidhur bashkë”, që e shpjegon nga shumësi i emrit shkop, me metaforën shqip **shqipi-nj**. (Shih *Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, f. 1419).

E shtata, Mehmet Elezi, në Fjalorin e tij me rrënjën **çip-** (**ç/q/k!**) shënon tri fjalë: 1) **çipërr**, *krande e thatë* (krahaso ndër këmbimet: **ship- /çip-/qip-/l/ërr**), 2) **çipiduk**, *lojë barijsh me shkop* dhe 3) *çiprrinat, krande e barishte me të cilat zogjtë bëjnë çerdhën*. Dhe siç po shihet që të tria fjalët etimologjikisht lidhen me drurin, me sishkopin - lëndë drusore.

E teta, madje edhe në gjuhën serbokroate, trajta **šip-** (*ship – thep, šipka, šiba* (**p/b**) - *shufër* (copë druri, thupër), na nxit që të thellohemi në përimtime të mëtejshme rreth kësaj dukurie. Kështu në serbisht: **shipci** pejorativisht emërtohen shkipi shkipci *shqiptarët!!*, pastaj del edhe folja *šibati – rrah me rrahë, përkatësisht çepati* (*shkelmoj me shkelmue*).

b. Shqiptari dhe përdorimi me kuptim të zgjeruar figurativ të shkopit (shkipit)

Edhe këtë nëntitull po fillojmë me ilustrue me disa shembuj:

E para, në *Fjalorin e fjalëve ndërkombëtare* të Radomir Aleksiqit, Beograd 1978, f. 687, në cilësinë e ndërkombëtarizmes, po me rrënjë-fjalën **scip-**(shkip-) po këtu plus edhe me formantin prapashtesor emërformues –TAR ndeshëm: emrin **skiptar** (*shkiptar !!*) të sqaruar si fjalë me origjinë greke(!) me përkufizimin: **skiptar** (gr nga *skepteroi*) - “*shkop i jashtëzakonshëm si shenjë e forcës, sundues ose sundim i hekurt*”, që siç do të shohin *spektri* implikohet me mitologji..... Të vihet re se fjalë=emri *spektër* shpreh nocion të një mjeti të jashtëzakonshëm që nënkuptonte një “**shkop të posaçëm, i gdhendur e i stolisur me gurë të çmur e me ar që e mbanin në dorë mbretërit si simbol të pushtetit të**

tyre". Të ndiqet ky përkufizim edhe në pikat vijuese rreth mitologjisë zeusiane.

E dyta, siç e kemi cekur më lartë **mullarit** me konceptin: dru (shtyllë e drejtë e përpunuar) që ngulej mes stivash të kashtës, stogut të sanës, tallës ose në mes të lëmës, ku i shtronin duajt e grurit për me i fshi, ku lidhej litari nga qafa e kalit, i cili detyrohej të *sillej rreth mullarit*, duke ndërruar drejtimin deri sa kryhej lama e asaj dite, prof. E. Çabej i paska gjetur sinonimin në trajtë-emrin **qip-i**, përkatësisht **shqipi** me shtesën **SH-**nistore përforcuese (*qipoj/shqipoj*)dhe kështu fjala **shqip** paska marrë zgjerim kuptimi (!) dhe figurativisht mund të ketë dalë edhe si *emërtim i njeriut (shqip-it shqiptarit)* , i cili merrej me *ngulje-zhgulje /shqipash*, ose me *bërjen e zhbërjen e mullarëve* dhe së andejmi supozohet nga ky profesion (mjeshtri) u përftua emri kombëtar *shqiptar* (Shih Astrit Lulushi, “zsh“, 10.09.2019), ku nuk përjashtohet as formimi i emër-foljes **shqip me shqipë, me punue shqipa** apo jo?!

E treta, po e përmendim si emër familjeje **Shkip/udar** që është identifikuar gjithandej nga Shkodra si emërtim familjeje dhe së andejmi është supozuar se ka mundë me dalë etnomimi shqiptar e Shqipni.

E katërta, këtu po shtojmë si fakt shumë të rëndësishëm nga shekulli XIX, pikërisht konceptin për termin **shkip shkipi** që e përdor Milosh Milojeviç në veprat e tij, të botuara para vitit 1873, trajtë kjo për nocionin e etnisë shqiptare, emërtim ky, i cili nuk është përdorur nga askush tjetër, qoftë nga intelektualët, qoftë nga studiuesit serbë.

E pesta, ç’është e vërteta në këtë kontekst, del e nevojshme të jepen disa sqarim-shpjegime se si shfaqet fjalë-trajta **scip shkop** në burime të huaja e në shqipe, me nocion shkopi ose jo, por që asociacionon edhe kuptimin e etnisë. Kështu ndeshen të dyja trajtat *skiptari a Skipi* për “*albano*” e “*Albani*”dhe *Scopio* për nocionin **shqiptari** dhe **shkopi** nga Nikollë Keta më 1753 (Shih Port Alb – Internet).

E gjashta në vokabularin e gjuhës italiane, si barasvlerë i mbiemrit shqiptar, përveç mbiemrit **albanese** ekziston edhe trajta sinonime **shipetare**, por edhe emri **schioppa** me kuptim pushka. Kështu nga rrënja *schip-* ndërlihet emri i shqiptar me konceptin e pushkës që e cekëm më lart.

E shtata, po shtojmë si sqarim, nuk duhet të na hutojë fakti pse të dyja gjuhët antike **latinisht** e **greqisht**, e ndeshim fjalë-trajtën **skip-** e **scop-** jo me **Sh-** nistore, sepse këto dy gjuhë (mbase si gjuhë standarde

artificiale jo popullore), përkundër gjuhëve të tjera popullore, nuk kishin tingull **SH**, andaj kërkohet mirëkuptim pse ne krahas shënuam në kllapa po e shonjmë trajtën e shqipes me **SH nistore**. *skip* (shkip) e *skop* (shkop).

E teta, sidoqoftë në këtë vijë po e shënoj fjalën italiane *scipetto* (shkop) dhe atë në shqipe **shqipi**(Çabej) si dhe shqipij për shkopij nga prof. Topalli. Njëherazi, krahaso shembullin nga përkufizimi i foljes *shqipoj apo qipoj ose rrah*, “*E shqepoj me shkop!*, por që trajta gegnisht *shqipoj qipoj*, humb çdo mbështjellim ndikimi ndër-gjuhësor, madje edhe prej 9 nënfushave polisemantike që mbulon fjala **shkop**, sipas FGJSSH 1980, ka edhe nocionin figurativ: “**disiplinimi i shkopit**”, që më gjerësisht do të sqarohet në nëntitullin vijues, sepse ndërlidhet me mitizime kulturi të trashëguara nga lashtohistoria antike pellazgo-iliro-shqiptare.

c. Lashtohistoria e shqiptarit dhe mitizimi i të shqipuarit rreth “disiplinimit të shkopit“ si kult-mit i trashëguar

Lëndën rreth këtij nëntitulli do ta rrahim në tri pikat në vazhdim: e para, do të preket mitizimi, e dyta, kulti i trashëguar dhe e treta, raste të tjera mpleksur nga realiteti ynë.

a) Rreth mitizimit të sintagmës “disiplinimit të shkopit”

Së pari, kujtojmë se **miti me shkopin** dhe **disiplinimi i shkopit** ndërlidhet me **Zeusin**, kryehyun, i cili sundonte me shkop varësit: *njerëzit, gysmëperënditë dhe perënditë*. Në imagjnatën e piktorëve paraqitet si njeri sundimtar që kishte formë-forca të tjera por që sundonte “**disiplinonte me skeptër-shkop**”.

Së andejmi njeriu, jo veç mbretëritparaqiten me shkop, por jo aq rrethprataruar si e kishite Zeusi, siç u cek më sipër, po me shkop në dorë dhe me veshje jomodeste përfaqësohej masa punonjëse, shërbyesit, siç

është edhe *bariu me shkop në dorë*, apo jo?! (Shih lidhur me këtë edhe te Astrit Lulushi, zsh 8.10. 2019).

Sidoqoftë, po rikujtojmë se vetë fjala **Zot** e shqipes së sotme, e cila zëvendëson sinonimisht emrin përkatës të *Fuqisë më të lartë absolute të të gjitha familjeve të feve të importuara te shqiptarët*, shpjegohet etimologjikisht se ka zanafillen tek fjala **Ze/us** (E/-O, Ë/A s-T): ZO/T, ZË/ZA/T. Sa ishte i trashëguar te protoshqiptarët pellazgo-etruskë ose iliro-shqiptarë e shqiptarët (epirotto-albanezë) më vonë miti rreth kompleksit “**Zeus**”, nuk kuptohet vetëm nga fjala **Zot, Zë**, por edhe në rrugë të tjera. Së andejmi del edhe *miti i shkopit*, ngase shkopin që e përdorte vetë **Zeusi** (Zoti) e kishin në njëfarë mënyre sitrashëgim edhe bijtë e tij si: Alkaeu, Alkidu, Anohu, Herakliti, e sidomos Hamesi, i cili edhe paraqitet me shkop, mbase i autorizuar nga *Zot-Shpia*, kryefamiljari **ZEUS**. Themi kështu, sepse te ne së andejmi na vjen trashëgim **kulti i Zotit të Shpisë** që ende respektohet si poshtet, apo jo? Kur e kemi fjalën te trashëgimia, po shtojmë edhe këtë se nëna e *Anohut* quhej **Arba**, emër ky që reflektohet në Itali e Greqi, por më mirë e më bindshëm identifikohet te shqiptarët në Shqipërinë e natyrshme, siç ishte edhe miti i *dhisë, qumëshdhënëse Ameletas apo Ameldhias, Dhizanaushqyese e foshnjes së zogshenjtit Zeus (Zotit), andaj* kjo kokëdhie si simbol del në **përkrenare të Skënderbeut** tonë. Madje edhe e bija Druopa që reflektohet në formë **lisi** në mitrologjinë klasike jo vetëm me marifete tremb kundërshtarët, por edhe favorizon njerëzit, duke ruajtur kopetë (me shkop) dhe duke rritur pasardhësit si nipi Pan, djali i Hamesit dhe i nimfes së **Pemës**... Siç po shihet edhe këtu kemi të bëjmë me simbole të botës bimore, *lisit, pemë, shkopit*. Në një *Wikipedi*, në gjuhë të huaj lexova që Zeusi, jo vetëm *urdhëronte me shkop (shkipspektrin)* fatet e njerëzve e të gjysmëperëndive e perëndive nga maja e Olimp, po ai pranë vetes në lartësi froni mbante shkabën, **shqiponjën e artë**, si simbol *force, guximi dhe drejtësie*, ndërsa nga bota bimore adhuronte **lisdushkun** (*bung e qarr*) po ashtu simbol fuqie e qëndrese ndaj furtunave, po në duar i vërehej edhe ndonjë sispektër (shkop ulliri). Së këndejmi, gjithsesi në këtë kompleks simbolesh kryesor del **shkopi** ose **shkipi** si pjesë e drurit të gdhendur, si mjet manipulimi, i cili në gjuhën homerike (paragreke) sipas studiuesve shkruhej e shqiptohet si edhe në shqipe **Shkop** edhe **Shkip**, po në shqipen e sotme mbizotëruese del trajta **shkop**, si mjet druri, mbase për dallim të kuptimit figurativ që mori dhe u specifikua trajta **shqip** si përforcim

përdorimi si emërtim **etnie e gjuhe: shqip shqiptar, shqip (ligjërojë), gjuhë shqipe** etj.

Si rrjedhojë e kësaj kur kujtojmë mitet e prejardhjen tonë pellazgu-ilire e në këtë kompleks *përkrenaren e Skënderbeut me shenjë e dhiqumështushqyesës (Tamël a Amëldhisë!)* së Zotit Zeus si dhe *shqiponjën në flamur*, pyesim a ka mundur që edhe **kulti i shkop-skeprtit** të Zeusit të ketë ndikuar si metaforë fjalëndërtimi shkipo shqiptari ndëridhur me në kultin **disiplinimit i shkopit i shqipo-shqiptarit** si mito-trashëgim nga **Zeusi, Zoti mitologjik i shqiptarit**, apo jo? Së fundi, edhe lastari, *pipi, fidani, vishkulli*: lisi i ri, ashtu si edhe sinonimi **pinjoll** (pip trunçu) me koncepte ripërtëritjeje të jetës bimore në tokë, ashtu mund të përdoret figurativisht edhe për përtëritjen e botës njerëzore, botës kombëtare. Krahaso: **pinjoll familjeje, pinjoll fisi, që** nënkupton pasardhësin e **familjes shkipi, të fisit (kombit) shqiptar** apo jo?

Së dyti, sidoqoftë, ne mendojmë se duke e pasur si koncept në nënvetëdije edhe fjalën **shkip shqip** me koncept *shkopi si vegël, mjet pune, mbrojtje e sulmi*, ajo gjithsesi semantikisht ka mundur të rilind të përtrihet semantikisht apo të pësojë zgjerim a specifikim koncepti figurativ, të marrë *nocion etnie* dhe kështu u përftua fjala bazike: **shqipe shqiptar Shqipni** në periudhën kur termat arbër, epirot, alban, arnaut, serbo-arbanas ose shqipëserbë (shqiptfolës) apo arvanito-grek, pësuan pasivizim sa që nuk paraqitnin më tërësinë e duhur etnike shqipfolëse as simbolikisht në kohëhapësirën historiko-gjeografike përkatëse, apo jo?

Së treti, sa ka asocionuar po fjalë-rrënja **shqip** a **shkip si emërtim familjesh** ose **etnie**, kur kemi parasysh të vërtetën që lexuam në një *Wikipedia* emërtimin e një familjeje të njohur aristokrate të Republikës së Romës **Scipio (s(h)kipio)** sh. **Scipione (s(h)kipjone)**, familje historike kjo, me shumë autoritet, madje njeri nga pinjojt e asaj familjeje me emrin **Scipio Africanus** shquhet si luftëtar komandant në luftë kundër Hanibalit. Andaj, lidhur me fjalën **scipio (shqip-ja)**, rrënja **shqip-** qoftë si atribut ose patronim i një familjeje të dëgjuar që në lashtësi, para erës së re na cyt me shtrure këtë pyetje: Vallë, me fjalë-trajtën **“shkip”** kemi të bëjmë, vërtet, me një fjalë parashqipe pellazgo-etruske, apo jo, prej nga si fjalë parahomerike e morën latinishtja e lashtogreqishtja?!

Së katërti, studiuesi Brahim I. Avdyli, (“zsh”, 27.06.2020), duke folur për historinë protoshqiptare, ndër të tjera përmend konsulin romak **Skipionët** (Shkipionët) **Paul Emilian** me të birin **Scipion** “bashkëxhelat”, të cilët në qëndvjetshin e fundit para erës së re shkatërruan 70 qytete

pellazgo-ilire, duke lënë kështu gjurmë të pashlyeshme gjenocidi në historinë e vjetër të Ilirisë dhe Epirit...

Sigurisht për ne zgjoi interes apelatvi *Shkipion* si dhe zbatim verbërisht i urdhërit si ushtarak: *me zjarr e hekur* që lidhen fosilizimin ekzistues të sintagmës “disiplinimi me shkop”, për të cilin do të flasim në vijim:

b) Rreth rastit “disiplinimi i shkopit” si kult i trashëguar te ne, apo jo?

Si do që të ketë qenë, duke pasur parasysh ngjashmërinë shkrimore e shqiptimore, besa edhe kuptimore nga opusi i fjalëve latine që figurojnë në fjalorin e sipërcekur **scipia** e **scopio** (f. 471), shqiptimi shqip *shkipja* ku përveç kuptimit neutral shkopi **scopia** (**shkopi**) përdorej kuptimi si emërtim mjeti vegle, ndërsa me trajtën **scipion** (**shqipjon**) kemi të bëjmë me emërtim familjeje, përkatësish etnie në latinishten vullgar, ku mund të ketë pasur hisen e vet edhe protoshipja, apo jo?

Kështu, pikërisht fjalë-trajta **Shkipjon** (**Sqipjon**) për nocionin e etnisë ose të apelativit imponohet edhe sot si fjalë si të ishte e ndërtuar sipas rregullave shqipe, aktuale, apo jo?! Pikërisht kështu, sepse përveç zanores **I** të theksuar, ka S(h)c-/shk-, ndërsa **Shk-** (dialektore) në shqipen standarde, në të shumtën e rasteve, shndërrohet rregullisht në **Shq-** dhe plus kësaj ka edhe fundoren -P + prapashtesën -JON. Në të vërtetë ky patronim latin me kuptim atributi familjar si dhe **shkopi** apo **qipi shqipi**, si mjet pune, mullar lëme, mullar stive, mjet mbrojtës, mjet luftime, shkop-kërlik bariu etj) ose nga greqishtja fjala **shqiptar** (*skeptar!*), si edhe ajo *shkeputto(n* (!), *shkipetto po në italishte* për konceptin -*shqiptar* “*pushktar*”, që janë cekur më sipër, mund të përdoret si s/provë të **sihipotezës** rreth origjinës etimologjike të rrënjë-fjalës **shqip shqipe shqiptar Shqipëri**.

Siç po shihet fjalë-trajta trajta **shkip-** edhe pa u foljezua tregon diçka, por nëse foljezohet (që ishte edhe është dukuri normale) edhe më mirë e ravijëzon atë origjinë, pikërisht trajtën: **shkip** (me shqipë, të shqipët të ligjëruarit shqip, ose fjalë-trajta tjetër **shkipOJ**: *shqipoj*, (*me shqipue të shqipuarët*) e cila identifikohet si fjalë-rrënjë në funksion veprimi të temës fjalëformuese me mjetin që asociacionon shqiptarin si apelativ, apo jo?

Meqë sugjerimi për **sihipotezë** që u tha si me drojë prej nesh, po që po hap rrugë për **hipotezë** apo **tezë** kërkon mbas e edhe më shumë

fakte, andaj po shtojmë sqarimin se çka nënkuptojmë me shprehjen: *disiplinimi me shkop* që nuk do të thotë vetëm *goditje ose të sh/qipuarit, rrahje me shkop* (me thupër), *si masë edukimi ose sh/qipimi*, po diçka edhe më tepër, siç janë edhe këto nocione që i ndeshim në fjalorin tonë shpjegues të gjuhës standarde, si shprehja “*vet Zot, vet shkop*”, “*shqiptarit s’ja ha qeni shkopin*” etj. dhe së këndejmi, kujto edhe foljen në rastet: *me shkopitë* (me shtagitë)- *me rrahë me shkop*, pastajme shkopue, “*me shkop me pru në mend,... me pru në din e iman*” etj.- etj., dukuri kjo që tregon në njëfarë mënyre ndërlidhjen e kësaj fjale edhe me konceptin e shqiptarit si veprues në kalim të shekujve, të ndërlidhur veprimtarisht edhe me këtë mjet, qoftë drejtpërdrejt me shkop në dorë, qoftë në mënyrë figurative me rrahë me fjalë (i dha një daskë! ose me ndonjë mjet tjetër). Të kuptohemi edhe popujt e tjerë e kanë përdorur shkopin ashtu si edhe shqiptarët, por vetëm në shqipe sfidon në njëfarë mënyre emri i mjetit me emrin e apelativit, pikërisht në variantet *shkip-*, *shkop-*, *shkep-*, *shkap(!)*, apo jo?!

Së këtejmi, kur kemi parasysh sa e sa shprehje të tjera mbi këtë bazë, nuk është diçka si e paqenë saqë mos të shtyjë të mendosh për dukurinë lidhur me vetë nocionin e *shkopit* (**të shkipit/arit*) si mjet pune, mjet lufte e mjet edukimi madje figurativisht edhe si autoritet luftëtari, kujto familjen Scipiones, por kujto edhe përkufizimin “*sundimi i hekurt*” ose “*edhe disiplinimi me shkop*”, përkatësisht kujto mjetin, i cili si barasvlerës në latinisht e greqisht e paska pasur emrin e folës-vepruesit *scip*: shkip -i përkatësisht “*shqipo shqiptar!*”.

Kështu sot nga studiuesit apasionant mund të thuhet se latinishtja e lashtogreqishtja e morën dhe e përdorën pikërisht trajtën *skipja*, shkipja *shqipja*, madje mbase edhe trajtën *skiptar* (*shqiptar*), koincidencë kjo që përkon me apelativin e shqipfolësit *shqiptar* ose të etnisë *shqiptare* mbase të simbiozuar me *masat shqipo-latine ose shqipo-helene apo të sapohelenizuara*, apo italianizuara, por që e ripërtëriu konceptin e *shkipit* nga lashtësia e pashuar, pikërisht në momentet kur u errësua sadokudo *enërtimi rabën/arbër, arban, alban, arvan, arnavut, epirot, hyllin, shkie-arbanas* e ndonjë tjetër, prandaj kemi të drejtë apo jo që sot konceptin e **shkipit*, si mjet pune etj. në gjuhën shqipe ta quajnë të modifikuar në njëfarë mënyre, me sinonimet: *shkop, shtagë, shufër, thupër, lis vishkullor*, pinjoll etj., të cilat ndërkohë shqipja në stilin përkatës më tepër i ka bërë për vete se fjalën *shkipoj me shkipue shkipime* përdor *si veprim* ose *shkipitar* si *veprues* me ato koncepte siç u quajtën shqipfolësit atbotë nga shqipolatinët ose shqipolashtogrekët, apo

neolatinët e rijohelenët, emër që nuk ishte i huaj kur edhe u përvetësua masivisht tek shqipfolësit si apelativ i përgjithshëm, që do të zëvendësonte sinonimet e sipërcekura.

Pse nuk është dëgjuar e gjetur në shkrimin e Buzukur dhe të Matrëngës etj, mbase mund të jetë edhe rastësi, apo jo?! Jam i vetëdijshëm se këtu shprehet amatorizëm në dukje, andaj edhe ndkimi metonimik me shqipen totem nuk mund të mohohet.

Është interesant se si Milojeviçi dëshmon se në serbishte ekzistonte fjala **shkip** si emërtim. i një etnie të lashtë dhe bashkëhore me emrin e gjuhën shkiye (shqipe) dhe assesi ai nuk e ngatërron fare me trajtën *skip. skipa skipovi* që në serbishtne ka nocionin *lug lugu, govatë* (Shih Fjalori serbisht shqip 847). Në të vërtetë, kjo ngjashmeri **shqip shqiptar** në raportin *shkipja e shkiptar* dhe sidomos *disiplinimi me shkop* nga shqiptari si koncept (që dikur rrahja me shkop nuk ishte e pamoralshme në rrethe apo shtresa të caktuara shoqërore) nuk është dukuri e panjohur masivisht nga populli shqiptar dhe të tjerë, andaj për ne faktet e mësipërme ishin të mjaftueshme që këtë çështje mbase të rastësishme ta ofrojmë një sihipotezë për konsultim para studiuesve të matur, sepse edhe kjo sihipotezë nuk bie ndesh me atë që u tha: rreth kuptimit strumbullar (polisemantik) të ndonjë hipoteze të ofruar si dhe të foljes: **shqip me shqipë** ose *shqipoj me shqipue* në raport me emrin *shqiptar, Shqipni/Shqipri*, ashtu siç u inkorporua gjatë historisë në nocionin **shqiptar** edhe veprimet me mjete të tjera mbrojtëse luftarake, jo vetëm me shkop (*scipia shkipia*), po edhe të tjera edhe me **shqip-je**, e më në fund **edhe me fjalën shqipe**, si mjeti më me vlerë mbrojtës i ekzistencës së sotme kombëtare para botës, apo jo?!

Sidoqoftë, me shikue sipas një gjykimi të lirë kjo fjalë, në rrethanat kur u shfaq ose u rishfaq dhe u masivizua në trajtën *shqip shqiptar Shqipni* shek. XVII –XVIII mund të na e kujtojë pushtetin e hekurt jo vetëm të otomanëve me vezirë e pashallarë arnautë, por edhe të disa pushtetarëve vasalë shqiptarë me bindje fetare islamo-sunite ose shitte, apo jo!?

c) Raste të tjera të trashguara nga realiteti ynë rreth “disiplinimit të shkopit”

Kështu, veç tjerash, si si raste apo ngjarje më të vonshëm rreth “disiplinimit të shkopit” apo “**sundimit të hekurt**” po sjellim në kujtesë edhe ndonjërin nga sundimtarët lokal shqiptarë gjatë shek. XVII -XVIII e

ndër ta po veçojmë te ne, *Maliq Pashë Gjinollin*, Selim Pashën e pashallarë të tjerë, përkatësisht në Shqiprinë e Jugut: *Ali Pashë Tepelenën*, të cilët siç thuhet imponuan vërtet “*sundim të hekurt*”, të parët kundër “*latinëve*” karadakas kosovarë të *pabindur në din e iman*” dhe i dyti, ishte edhe më *shkophekur* kundër *shklikeve* stigmatikë shqipfolës të *pa bindur* (siç ishte Mirko Boçari e boçarët e tjerë), etni kjo ortodokse edhe pse shqipfolëse, e cila, duke u gënjyer e nxitur asokohe nga hileja ruse (ortodokse) u përballua me të keqe të rëndë, sepse pas dështimit të rebelimit në ballafaqim me sundimtarin **shkophekur** Ali Pashanë, u detyrua nga halli të shpërngulej, madje, duke gjetur mbështetje e strehim në gjirin e popullit e të kishës greke dhe të simbiozohet me ta, duke rrezikuar ose sakrifikuar papandehur gjuhën shqipe në favor të fesë e interesave të tjera jetike, edhe të tjetërsohej ndoshta plotësisht e përgjithmonë, apo jo ?!

Po shtojmë edhe këtë fakt se edhe mendimin e eruditit tonë **Faik Konica**, i cili konstaton dhe komenton shprehjen se “**Zoti nuk është shqiptar**”, dmth. **i pamëshirshëm**, duke sqaruar:

”Grekët qindra vite me radhë i kanë njohur shqiptarët vetëm si pushtues... si ushtarë të dërguar ndër ekspedita ndëshkimore, si xhandarë ose si mbledhës taksash...”

Dhe kështu , përveç në ekspedita, mund të jetë aplikuar **sundim i hekurt** nga individë të caktuar më përpara dhe nën hijen e osmanëve edhe në vise të tjera të Arnautistanit shqiptar të asaj kohe, pra edhe te ne, ku administronin shqiptarët turkoshakë, që përdornin masa drakonike edhe kundër shqipfolësve të pabindur jo vetëm ortodoksë e katolikë, por edhe atyre muslimanë kundër “*miletit arnaut*”, të cilët si të pabindur në raste: *në vend të bukës hanin barut!* Ne i kemi të panjohura edhe disa nga rezistencat kundër sundimit të tillë të hekurt nga vetë muslimanët vasalë shqiptarë, siç rezultojnë edhe shumë këngë popullore, ku në një këngë trimërie “*Halit Hamza*” thuhet “*mos ia mat burrave shtagën, (se) me ma matë s’e duroj as babën...!*”. Edhe nga këto fjalë kuptohet se edhe pushteti (pashai), po edhe **agai** si pushtet, por fundja edhe baba si mjet disiplinimi e paskan pasë përdorur shtagën (shkopin), madje edhe hoxha si mësues fallakun (këmbëve), siç bënë edhe oznistët e udbashët e rankoviçit më 1944-e këndeje, dhe sidomos në muajt e dimrit më 1965-66, kundër masës shqiptare gjatë aksionit famkeq për gjoja mbledhjen e armëve, apo jo?!

Ne kuptojmë faktin që sjellje të tilla të vrazhda kanë ndodhur, siç po ndodhin edhe sot, nga çdo pushtet si aparat i dhunës, po ne, madje pa

hyrë në shkak-pasoja politike të atëbotshme, si lufta mbrojtëse çliruese, ploja hakmarrëse etj., më fort po na djeg fakti i luftave me ngjyresa fetare mes sivëllezërve të një gjaku e gjuhe që mbase fatkeqësisht zënë e shfaqen në shek e XVII -XVIII dhe do të zbatohen egërsisht edhe në shek XIX -XX nga serbosllavët kundër shqiptarëve. Dhe lidhur me këtë na shkon mendja të pyesim, fatkeqësisht a nuk ishin vargjet e mësipërme të këngës *Prej Prokupje deri në Nish* si përgjigje hakmarrëse ndaj masakrave dhe dëbimit paraprak të shqiptarëve që nga Jagodina, Valeva, Beogradi e përgjithësisht nga Arnautllëku i Veriut të motivuara fetarisht, sidomos gjatë e pas Kryengritjes së parë sidomos të dytë serbe, të udhëhequr nga ortodoksë serbë bashkë me shkie-shqiptarë, mjerisht të frymëzuar dhe të kequdhëzuar nga fryma fetare ortodokse serbo-ruse në njërën anë, duke mos i respektuar sivëllezërit e një feje tjetër, apo jo?! Edhe kundër përgjigjja ushtarake ndaj tyre me *dorë të hekurt*, nga ana tjetër, gjithashtu *ishte e frymëzuar nga fryma rivale fetare turke me shqipomuslimanë fanatikë*, apo jo: Së këndejmi, pyesim: Në *Qele-kullë* të Nishit (1807, vepër e Turshum Pashës turk), kush mund ta dijë sa ishin koka të prera të *rebelëve* shkie-ortodoksë shqipfolës e sa serbishtfolës?! Në këtë kontekst po i rikujtojmë këto vargje të një kënge tjetër popullore nga një kënd ose arenë tjetër luftrash, reaksion ndaj qëllimeve imperialiste, edhe këtu, siç po thuhet, me hile ruse (pansllaviste) po të kamufluara me frymë fetare:

Jakup Ferri, mor ku je
 Thërrasin malet me piskamë
 Tridhetë krena o i ke pre
 Me shtatë plagë po rri në kambë ...

Në të vërtetë, meqë studiuesi *Ahmet Asani*, shprehet se *Qele Kulla* qenka ndërtuar fill pas “pas humbjes së betejës së Kosovës 1369 nga ”*jerniçerët serbë të Vuk Brankoviqit*,” me krenat e ushtarëve serbë (nënkupto edhe shqiptarë) *vullnetarë të krahut të princ Llazarit*”. (Shih “rd”, 23.06.2019), gjithsesi lypset sqarimi në pyetjen: Turshum Pasha e (ri)ndërtoi atë kullë mbi gërmadhat e të vjetrës, apo jo?! Gjithsesi edhe kjo mbetet çështje e diskutueshme, por nuk është e diskutueshme e vërtetat që e thamë për gjuhën e viktimizeve.

Sidoqoftë, me folë *kah del shpirti*, personalisht mendojmë se luftat e mëvomshme për çlirim të serbëve, malazezëve kundër turqve, madje

edhe e grekëve nuk i quajmë të padrejta, por mosbashkëpunimi me shqiptarë, injorimi i gjuhës shqipe, prerja e tyre në besë, dëbimi i tyre lojalë nga trojet e veta etj. i gjykojmë si tejet të padrejta, skandaloze, ngase nga këto dëbime, shoqëruar me masakra makabre, janë krijuar hasmëri e urrejtje shumë të thella edhe mes sivëllezërve të një gjuhe e gjaku me fe e ideologji të ndryshme të imponuara armiqtë apo sundimtarët për interesa të tyre.

Mjerisht, përlëshje të tilla mes shqipfolësish, ku pësonin sivëllazërit e një gjuhe e gjaku po me fe të ndryshme të imponuara nga armiku, kur nuk kishte qeveri njënacionale as shqiptare as serbe, ka ur, edhe shumë raste të tjera në Siujdhesën Ilirike, si nga ana e Malit të Zi, Serbisë, Greqisë, por edhe Bullgarisë, të shtyrë nga Perandoritë e huaja dhe për ambicje primitive pushtimi, mjerisht!

Ne mendojmë se edhe ky opsion rreth konsolidimit të trajtës *shqiptar* me konotacion luftëtari etnie ose “*disiplinimi i shkopit me shkop*”, *shufër, shtagë*, duke i kujtuar edhe vargje të këngëve të tjera meriton të konsultohet, si ndikim i kësaj dukurie në përvetësimin dhe shtrirjen e fjalës “**shqip**”, *shqipja shqiptar në gjuhë të huaja dhe në ligjërimin tonë*, sidomos kur kemi parasysh jo vetëm emrin, por edhe foljen *shqip me shqipë* dhe *shqipoj me shqipue*, me rrjedhojat, hipotezë kjo si afro 20 të tjera propozojmë të konsultohet, edhe pse lidhur me të nuk kemi shumë rezerva, sepse sipas nesh emri *shqiptar, origjina e tij* si dhe ajo foljes *me shqipë* si dhe tjetra *shqipoj me shqipue* del mjaft e qartë si (hipo)tezë. Unë mendoj se origjina e fjalës shqip shqiptar mbi këtë bazë, ndërlihur me botën bimore, ka shpjegim më të arsyeshëm më tepër se çdo shpjegim tjetër, siç do të sqarohet më poshtë, pasi t’u rikthehemi me pak fjalë tri opinionëve të hipotezave, kontaminuese sipas nesh, dhe së këtejmi *jo të lehtërrëzueshme* që u paraqitën më sipër.

d) Rikthim rreth tri hipotezave jo të lehtërrëzueshme rreth etimologjisë “shqipo- shqiptar”

Sidoqoftë, e shohim të nevojshme të rikthehemi paksa rreth tri hipotezave kontanimisht jo të lehtërrëzueshme, duke ritheksuar se ne i vlerësojmë të tri opinionet e sipërtrajtuara dhe këtë e pohojmë edhe tashti, duke i shoqëruar edhe me ndonjë shprehje të re sidomos rreth opinionit strumbullar ose rrënjësisë burimore: *shqip shqipo shqiptar, Shqipri*. Kështu, ne, për të tria këto opinione, të cilat i shohim si pjesë përbërëse

kontaminuese në konceptin që ka sot fjalë-emri kompleks: **shqipo shqiptar Shqipëri (Shqipni)**, shprehim qëndrim pozitiv. Andaj lidhur me këto tri hise, edhe pse anojmë në të tretën, megjithatë qëndrojmë në përkrahje të të tria opsioneve, andaj po rirrefehemi simbolikisht me disa shprehje ose edhe me ndonjë pyetje të shkurtë retorike:

E para, a nuk e bën për zemër çdo shqipfolës: **shqipja shkabë-shqiponjë** ose shprehja **shqipoja shqip!**, kur kemi **në mendje e zemër** ligjërimin **shqip**, por edhe mitin historik të **shqipe-shqiponjës shqiptare**, ku, sipas një vjershe në dorëshkrim, thuhet:

Anembanë Shqipri-Kosovë!

Bija - bijë: *shqip-shqipojnë...*

Krenari, kjo botë shqiptare,

Kur bashkë me *shqipe* hedhen valle!...

Madje edhe ne pajtohemi por jo plotësisht me konstatimin e vlerësuesve të caktuar që *argumentet e kësaj hipoteze janë në përputhje me rregullat gjuhësore e fjalëformuese me artografinë dhe psikologjinë mbarëkombëtare*. Gjithsesi hipoteza shqipe (shqiponjë) shqiptar e ndërlidhur me jetën eptimore e etimologjike të fjalës, ka histori.

E dyta, si shkak pasojë, nuk përjashten konfrontimet inatçe primitive subjektive që krijojnë armiqësi qoftë nga egoizmi vetjak, qoftë nga shtysë të jashtëm që robërojnë fetarisht e ideologjikisht botën e brendshme shpirtërore, kur pejorativja kalon në konfrontim, siç ishte përplasia: **serbo-shkja/turko-shqiptar**, shkas *shkizma e re*, prej nga edhe përplasia **shka/shkiptar** që në raste e bëri edhe më të fortë dallimin: *shqip shqipo shqiptar Shqipni*, në krahasim me dy antipodet: **turk e turqni** ose **arnaut e Arnautllëk** në njërën anë dhe **shka e shkini, Serbi** nga ana tjetër, sepse nga fjala vendëse: **shqipe e shqiptar e Shqipni** është ruajtur e ringjallur krenaria mitike si substancë kombëtsie në kohëhapësirën e vet, duke respektuar nën ombrellën e Shqiptarisë të tri fetë tona, të ashtupërvetësuese sikombëtare (*islame, katolike e ortodokse*), sipas motos: **Fe që Zotynë e bekon/ shqiptaria feja jonë**, duke respektuar çdo besim, apo jo?!

E treta, përmendim dy fakte:

Së pari, sa i përket shtrirjes a nuk i plotëson folja: **shqip me shqipë, shqipje, shqip-i, shqipe/ja, të shqipët**, në njërën anë ose në anën tjetër **shqipoj me shqipue, shqipim, shqipojë-a, të shqipuarit etj.** si fjalë vendëse, të gjitha kriteret për prejradhjen e apelativit etnonim **shqiptar**, nocion i tillë ky, që mund të ilustruhet edhe me shprehjet:

1) *drejtpërdrejt*:

a) *me shqipë* nënkupohet: *me folë qartë, hapur, troç*;

b) *me shqipue, shqipoj*: - nënkuptohet gjuha shqipe, fjala shqipe si mjet i të qëlluarit: *Shqipoja!* (shkrepja, qëlloja shqiptarçe) *ashtu siç e lypi ose Mirë ia shkrepë (ia shqipo) shqiptari; Me fjalë të forta e me mend Shqiptari e qillon (e shqipon) atë që duhet...* etj.

2) *figurative, vargëzime humoristike*:

a) *O ti shqipo kalavesh,/ mos shqip vargje lielesh/ si pa lugë me zhibi përshesh/ se as muzëjotja s'të merr vesh!...*;

b) *Shqipja shqip me gojë e zemër/ shqipo frymën që të bën emër/ që të josh rrastash kokë e thembër!...*

Së dyti, meqë rreth prejardhjes më tepër është manipuluar me trajtën shkop shkopi, koncept ky që indieuropeanish deshifrohet me trajtën “*Skel, P” me kuptimin: *copë druri*, koncept ky që në gjuhë të huaja, sidomos të gjuhëve klasike del **skop** e **skip** (*lexo shkip*) që asociacionon **shkopin** a **shkipin**, si mjet, dru i përpunuar, vegël që me zgjerim koncepti tregon profesionin e drupunuesit, vegëltarin, që me zgjerim të mëtejshëm mund të kalojë normalisht në emërtimin që sot e ka fjala si **si etni** që përfaqëson edhe **shqiptarin** edhe **gjuhën e tij shqipe**. Lidhur me këtë mund të shtojmë që kjo zgjidhje më tepër ka logjikë, si në aspektin formal ashtu edhe në atë kuptimor e fjalëformuese, po ka edhe mbështetje historike e mitologjike etj. por për këtë lypset një mendjembushje edhe nga njerëz më me kompetencë. Këtë rast mund të them se arsytimi nuk duhet bërë vetëm duke u mbështetur në kuptimin e ngushte botën bimore, të mjetit shkop thupër fshikull, vishkull filiz, por duhet kuptuar figurativisht, botën e gjallë edhe njerëzore, konkretisht pinjoll i familjes, lis-prijësin si zotshtëpie, “vetë zot vetë shkop”, apo si anëtar me vlerë i një shoqërie e kombi, ngase në stilin normal njeriun e madh, i zoti, krahasohet me lis, Krahaso shprehjet e respektueshme në shqipe: *lisi i gjakut, lisi i tamlit, lisat e mrizeve* si dhe: **Nuk ka mal pa lis, nuk ka fis pa prijës!**

dh) Dy fakte anësore shtesë

Për lexuesin po i sjellim si shtesë edhe këto dy fakte periferike:

E para, studiuesi Asqer Boçi, në punimin *Mëmëritjet e Homerit*, nga gjuha e veprës *Odisea*, pos tjerash vëren edhe shprehjen “*SKJIPTRON e koo-n*”, të cilën e zbërthen: *SHQIPTRON e koon-e (e qenë)* që në mbase nuk lajthis shumë kur kam dëshirë ta zbërthej: *Shqiptron't e qenë*

(ose në variantin gegë: **Shqiprront** e *kanë/n* ose të *hanedan të kanë/n*, d m.th. të dëgjuar, të dalluar.

Sidoqoftë, nëse specialistët këtë fjalë të para 3000 e sa vitesh **Shqiptron** e ndërlihdin me **Shqipronin** ose **Shqiprronin** e sotëm, do të ishte një zbulim epokal, apo jo?!

E dyta, është shumë simpatik, për ne, titulli **ShqipON** i lëvizjes, folesë, akademisë (sipas dr. Ledian Drobovnikut) me simbolin digjital ngjites: ON (*njësh*), i cili veç tjerash edhe formalisht fjalën e imponon edhe si folje pavetore **shqipon(!)**, ose me eptim **shqipoj** (me shqipue) që na kujton shprehjen: “*Shqipja dikah, çilna llaf*”, edhe pse me këtë *lëvizje shoqërore* nuk **shqipet** pak, por **shqipohet** ose synohet, gjithsesi, më shumë se “*çilna llaf*”!, sepse:

ShqipONët (si shqiptarë të ndershëm, patriotë guximtarë e punëtorë) synojnë emancimin e shoqërisë, zgjerimin e demokracisë si e vetmja mënyrë për të dalë prej dogmës neoliberaliste dhe kurthit social, ku partitë-shtet e kanë futur Shqiprinë e popullin e saj...

Sidoqoftë, edhe këto dy raste e bëjnë më të dinjitetshëm emrin **shqipo shqiptar Shqipri**.

2. Edhe disa konstatim-venerime të hijesuara me përgjërim

Para se të përfundojmë këtë nënkrye dhe të kalojmë në kreun tjetër do të përmend disa konstatim-venerime vlerësuese përgjëruese që dihen, por ato edhe duhet të na mbajnë të disponuar dhe me mendje e vemendje të zgjuar:

E para, në gjendjen e sotme, të gjithë e dimë se fjala **shqiptar** nuk ka barasvlerësi me fjalën shqiposhka, *arvanitas*, ngase tani emri **shqiptar** qëndron ballaballas me krenari ndaj çdo emri kombëtar të popujve të tjerë si: serb, bullgar, maqedon, malazez, turk, anglez, amerikan etj.

E dyta, kemi vënë re që fjala, **arbër Arbëri**, e cila me kuptim etnie mendohet se kishte shtrirje (mbase edhe pse të shkruar për mungesë shtetësie për tërë popullatën shqipfolëse në kufijtë e ish-tetrakisë së Dioklicianit para përqaimit gjith popullor të fjalë-termimit **shqiptar Shqipëri**, nga dikush po kujtohet jo vetëm me nostalgji, por edhe me njëfarë kërkese në funksion të plotë(!) rehabilitues, andaj tërheqim vemendjen që fjala e tillë *arbër, Arbëri* mund të rikthehet ose duhet të kthehet patjetër, por vetëm e gjithsesi si një sinonim joshës, po jo si

zëvendësim “i plotë” i fjalës **shqiptar Shqipri**, prandaj i quaj jo të paqortueshëm, të gjithë ata që gjoja, duke kërkuar rikthimin në rrënjët e vjetra, pra tek kthimi *arbër Arbni* në vend *shqiptar Shqipri* na bëka më europianë, më perëndimorë, më të afrueshëm ndaj Europës (katolike), ngase një sidiçka e tillë *shqiptar Shqipri* paska qenë *pyllë* muslimane e kohës së Turqisë e jo si një sinonim bashkekzistues i trashëguar, madje, duke gjetur si vjegë po kërkohet botërisht deri edhe për ndërrim, kalim masiv nga feja islame në fenë e vjetër të gjyshërve: **katolikë (!)**, duke harruar të vërtetën, apo jo, që ne megjithatë përveç paganizmit e ateizmit, shumicën historike kristiane, siç doli edhe sipas P. Priftit e të tjerëve, e kishim ortodokse, ose laramane, sidomos Kosova e Maqedonia, si dhe të vërtetën e sotme se brenda fesë kristiane perëndimore po paraqiten e qarkullojnë aktivisht rryma sektashe të shumta, po si më aktive më me autoritet si rivale ndaj katolikizmit te ne ofrohen: *protestantët (engjëllorët)*, *jehovajt* etj.?!

E treta, sidoqoftë, një kërkesë e tillë çislamizimi masiv me urysh, siç u cek në pikën e mësipërme veneruese pa kurrfarë parapëgatitje, sidomos te ne, me gjykue thellë e drejtë, duhet vlerësuar, siç e tha dikush, si një *veprim apragmatik individësh*, njëherazi edhe si kundërshoqëror, sepse kështu pa kurrfarë takti, po krijon problem të paqenë, po shkakton reaksione kundërproduktive të afro 90 - 95 përqindëshit të masës shqiptare, apo jo, llogarisim edhe katolikët e matur, si b.f., z. Pal Shtufi, i cili te Portali “*revistadrini*”, më 07.07.2018, ndër të tjera thekson: *Respekti për fetë nuk do me thënë me u bë apologji atyre... Prioritet duhet dhënë ndërtimit të shtetit sekular... luftës kundër ekstremizmit fetar dhe në veçanti për shkollë e dije...*, ngase faktikisht, feja islame, siç bënë edhe arabët dikur, nuk e ka penguar as luftën çlirimtare të shqiptarëve muslimanë kundër Turqisë Osmane, as luftat e tjera çlirimtare kundër çdo zaptuesi, sepse siç e thekson Nue Oroshi (“zsh”, 16.19.2017), ka pasur “*klerikë atdhetarë (muslimanë) që kontribuan në favor të çështjes shqiptare gjatë gjithë historisë sonë*”, madje asesi nuk e kundërshtojnë as sot afrimin me kulturën pozitive perëndimore, përkundrazi, janë qarqe krejt të tjera sektare ose individë të izoluar, të cilët duhet të identifikohen dhe të luftohen intelektualisht e shtetërisht, madje edhe nga vetë qarqet fetare muslimane, të cilëve, qofshin edhe prijatarë fetarë të grupeve përkatëse sektashe, ashtu si edhe të dy feve të tjera e sekteve të ndryshme fanatike ekstreme, u duhen dhënë gjithsesi më tepër doza njohurie rreth

vetëdijësimi kombëtar e vazhdimi të paqetimit të mëterjshëm ndërkonfesional, apo jo?!

E katërta, ne e themi me plot përgjegjësi, që gjithsesi fjala *shqip*, *shqiptar* *Shqipri*, përkatësisht folja: *shqip me shqipë* ose *shqipoj me shqipue* etj. që në fillim, dhe më vonë e riaktivizuar si apelativ ishte dhe tashti mbetet krijim i mençurisë shqiptare për atë kohë, me vlerë për të gjitha kohët. Ajo, edhe në qoftë e ripërtërirë nga tradita në faza të caktuara ose e përfuar spontanisht, sidomos në periudhën që po trajtohet këtu, gjithsesi jo si term fetar islam (musliman), u përqafua rrufeshëm me vetëdije në shekujt e kaluar nga parijsa, gjithsesi, mençurake shqiptare muslimane ose kristiane (katolike apo ortodokse) dhe u bë si mbulesë e bëgjeshme në kujtesën kombëtare ndaj konceptit të mbetur bosh (për shumicën shqipfolëse) nga pasivizimi i fjalës *arbër/ Arbni* ose *epirot* e *maqedon*, hapësisë kjo e cila fatmirësisht edhe u zëvendësua, madje edhe më me plotni po me fjalën gjegjëse shqipe: **shqiptar Shqipri**. Them i kështu, ngase atëbotë ishte në pyetje ekzistenca: zhdukja ose tjetërsimi i plotë i substancës së masës shqipfolëse në përgjithësi. Është koha, kur ortodoksët, *shkijet* si masë ishin në serbizim e sipër, poashtu edhe *arvanitasit* ishin në gojën e grekëzimit, dhe jo pak *arnautë* ishin matufosur me arabizëm, me turqë e osmanllizëm, andaj kjo është arsyeja që i quajmë lar pamës aktivizuesit dhe përqafuesit e këtij termi, sepse siç tregon fakti emri **shqipo, shqiptar** u bë për zemër, pa përcaktim treve, si fjalë më e qëlluar (*e shqipur dhe e shqipuar*) jo vetëm nga krerët e klerikët, ashtu i edhe nga masa e shqipfolësve *muslimanë e katolikësh shqiptarë*, por edhe për ata *arbër ose epirotë ortodoksë* që nuk ishin tjetërsuar, përkatësisht, nuk i ishin nënshtruar asimilimit gjuhësor nën ombrellën e gjuhës së meshës përkatëse në gjuhët greke, rumune ose bullgare, e aq më tepër serbe dhe kështu fjala **shqiptar Shqipri** u bë term i pranuar me dëshirë të zjarrtë nga ata, e cila ndërkohë si sot mbahet me nder e krenari nga të gjithë bashkëkombasit. Kjo ishte arsyeja, pra, që ne e potencuam foljen **shqip me shqipë** (me folë shqip: *qartë, troç dhe hapur*), përkatësisht **shqipoj me shqipue**, në mënyrë që shqiptari si veprues edhe figurativisht gjuhën shqipe, fjalën shqipe ashtu ta përdorë me zemër *qartë, troç dhe hapur*: për *me qëllue shenjën, me arritë objektivin, me fitue e kultivue shqiptarizmin pra, po me fjalë tona shqipe*.

E pesta, gjithsesi ne jemi të bindur se fjala **shqipe** ose **shqiptar** (e ushqyer reciprokisht me paravajtje ose prapavajtje, qoftë si emër, qoftë si folje), me të cilën të parët tanë të mençur muslimanë e të krishterë e

emërtuan vetveten, ka ekzistuar si fjalë-koncept edhe më përpara seç e kemi dëgjuar e kuptuar ne, madje edhe para monoteizmit, ngase edhe përpara që nga lashtësia anasit tanë e kishin të pranishme si intuitë ndjenjën e *shqipjes shqip dhe të të shqipuarit* si veprim për të ruajtur përbashkësinë e vet shoqërore bazuar në gjuhën shqipe e veçori të tjera bashkuese (*si lekë e malësorë kanuje që e shqiponin objektin kundërshtues armik me mjetin përkatës (me grusht, me gurë, me shkop, me shigjetë, me shpatë, me pushkë)*), por gjithsesi edhe me fjalë, me gjuhë shqipe që ishte dhe mbetet amanet si arma ose ai mjeti më i vlefshëm trashëgues për brezat, andaj dhe këtë rast, qoftë edhe spontanisht, e më fort vetëdijësisht (të nxitur e të edukuar nga tradita paralirindëse e rilindëse) dijetarët tanë të ndritur u shprehen e po shprehen “qartë, hapur, troç” për mëvetësinë kombëtare dhe me këtë fjalë të qëlluar (*të shqipur dhe të shqipuar*) u kthyen mbarë, morën drejtimin me shqipë me zemër drejt kauzës, idealit dhe për kohën u mishëruan mendjesisht me këto attribute:

1) *mençuri* (të ruajturit e trashëgimisë së gjuhës dhe të veçorive kombëtare),

2) *trimëri* (valle në gojë të ujkut!),

3) *profesionalizëm* (të shenjuarit e idealit edhe nën rrogos),

4) *guxim* (mundësi me shkye punë),

5) *urti* (bashkëpunim edhe ndërftetar),

6) *politikanizëm* (eskivazh ndaj tehut të shpatës së sundimtarit),

7) *pasuri* (fitim nga tregtimi i lirë, mirëkuptimi),

8) *sundim* (pjesëmarrje në pushtet, administrim lokal e pozita shtetërore) dhe së fundi

9) *shpëtim* etj.

ngase duke ruajtur substancën gjuhësore kombëtare në ato kohëhapësira shumë të vështira e delikate përthelluan e ravijëzuan në vazhdimësi, historio-gjeografinë e vet në trojet e veta, duke krijuar edhe taban të fortë për një shqiptarizëm të ardhshëm me një ravijëzim të qartë: me një tolerancë të vërtetë fetare dhe për një shtet të përbashkuar kombëtar, i cili edhe pse nuk u arrit më herët, kryesisht jo nga shkaku i mosangazhimit e pamundësisë të organizimit të brendshëm të shqiptarëve mendjendritur, por në radhë të parë nga mjedisi armiqësor fqinjësor dhe mospërkrahja nga shtetet e caktuara të mëdha europiane të asaj periudhe.

E gjashta, kjo që u tha e nuk u tha po nënkuptohet është në frymën e propozimit të këto dfitëshme të studiuesit atdhetar Fahri Dahri, të cekur më sipër, i cili shprehet kështu:

Meqë emërtimi « shqiptar » është më i vonshëm nga mesjeta dhe nuk përmbush plotësisht preferimet e të gjithëve le të jetë fryt i një komisioni në rang kombëtar (përfshi edhe diasporën) që ky emër si një emërues i përbashkët të jetë gjithpërfshirës i të gjithë shqiptarëve: çamëve, arbëreshëve, arnautëve, arvanitëve... Kështu emërtimet e ndryshme sipas ndarjeve territoriale për të njëtin popull kudo ndodhur të marrë fund.

Sidoqoftë, ne si prof. Çabej e të tjerë mund të sendërohet kjo kërkesë, madjer duke respektuar të gjitha virtytet e sipëcekura dhe tani gjithsesi vetëdijshëmrisht kjo kauzë njëzimi i emrit **shqiptar** e **shqiptarësi**, duhet të ruhet, mirëmbahet, të ngritet e të përfomësohet dhe gjithsesi të arrihet në mënyrë dinjitoze: **me demokraci, tolerancë, humanizëm e shqiptarizëm.**

E shtata, t'i rikujtojmë lidhur me këtë vargjet simbolike të Fan Nolit të madh (peshkop ortodoks), i cili, edhe pse në raste zhgënjimi, megjithatë pati paraparë si duhet rrugën e njëzimit të emrit dhe të përbashkimit kombëtar sepse :

...Urën e ruan, urën e mbron:

Stihia shqiptonjë me qip e me thonj!

Stihia (kauza), siç duam ta kuptojmë ne, nga spontaniteti do të shndërrohej gjithnjë e më tepër në realitet me vetëdijësim të lartë dinjitoz ose me një pjekuri mbarëkombëtare që thadrohet me ngrohësi stinash dhe kështu populli shqiptar, siç e ka kryesisht: **gjuhën NJË, flamurin NJË, kombi NJË, besimin në ZOTYNË NJË** (edhe pse me tri fe), përkatësisht me kauzën historike të thadruar në ndërgjegje: **Fe që Zotynë e bekon/Shqiptaria feja jonë**, ku me **shqiptari** kuptohet çdo besim në tisin e Shqiptarisë, ku do ta ketë edhe më përzemër **shtetin NJË të përbashkuar**, njëherë shpirtërisht, siç e kemi, por gjithnjë më të fuqizuar demokrativisht, **gjithsesi pa vizë të zezë kufindarëse**, dhe kjo arrihet me përgjërime nëne: kudo që të jeni ju bijtë e shqipes **me shqipë shqip dhe me shqipue shqiptarisht**, por pa përçmuar **gjuhën e lirinë e askujt, as atë fetare**, apo jo?!

Së fundi, pa marrë parasysh këto që u thanë më sipër ne mendojmë, që rreth zbardhjes së burimit prejardhësor të fjalës **shqip shqiptar Shqipri** dhe dukurisë së përhapjes së derivateve foljesore **shqip (me shqipë), shqipoj (me shqipue)** etj., duhet të vazhdojë: përforcimi i hulumtimi dhe zbardhja e mëtejme e çështjes.

Përmbyllje

E para, në periudhën e sundimin turk për shqipfolësit krahas fjalës me konotacion të ri negativ përgjithësisht *shkja shkie shkini për ortodoksët*, u shfaq ose u rishfaq i ripërtërirë dhe emërtimi me konotacion pozitiv shqipo *shqiptar Shqipni* kryesisht për shqipfolësit muslimanë, emërtim ky i cili pothuaj e zëvendësoi në tërësi emrin e mëparshëm kombëtar *arbër Arbëri, maqedon e epirot*, të cilit iu bashkuan edhe arbërit katolikë si dhe arbër-epirotët e arbërmaqedonët ortodoksë shqipfolës, të cilët ende nuk e kishin thithur plotësisht qumështin gjuhësor të asimilimit nga populli dhe kishat autoktone sllave (serbe, malazeze e bullgare maqedone) ose greke e rumune. Gjithsëi propozohet që edhe fjala *shkja* duhet të zërë vend në fjalorët tanë normative, jo vetëm si historizëm i fosilizuar, po me shpjegimin e kuptimit përkatës të *zbutur* aktual.

E dyta, pasojat e *shkizmës së re* në kohë të Turqisë ishin me dhëmbje të mëdha, ngase me forcimin e feve antagoniste rivale u shkaktuan edhe lufta me frymëzim fetar, por me të rilindurit, me rritjen dhe aktivizimin e termit: *shqipo shqiptar, Shqipëri*, pa hyrë në shkaqet e pasivizimit të termit *arbër Arbëri*, u bë një përparim i madh në të mirë të identitetit të kombit shqiptar, sepse:

së pari, me përqafimin e këtij emërtimi, në shqipe iu vu lehtë dukurive, e para, që shumë me rëndësi fakti që masa shqipfolëse me përqafimin e emrit **shqiptar** u shpëtua nga termi fetar *turk*, siç quheshin shqiptarët muslimanë nga shteti osman dhe njëherazi edhe nga emërtimi zyrtar turk: *arnaut*.

së dyta, u bë distancim i rreptë (deri armiqësor) kundër *shkive (sllavo-serbë)*, të cilët ruajtën fenë po humbën gjuhën, shenjën e parë të kombësisë dhe si të tillë tërësisht u futën nën shërbimin e interesave ekspansioniste sllave (serbe), armiqve të përbetuar ndaj shqipfolësve dhe

së treti, nën këtë emërtim (shqiptar) nënkuptoheshin jo vetëm muslimanët, por edhe katolikët e ortodoksët shqiptarë (shqipfolës), dhe kjo ishte e arritura me e madhe e këtij termi, ngase përfaqësonte kombin e ri me konotacion të ri, mbi bazë gjuhën shqipe tashmë pothuaj të rilindur ose në formim e sipër, i cili gjithnjë e më i vetëdijësuar, pa dallim feje deri në sakrificë të përbashkëta do të angazhohet për identitet vetjak dhe të drejta deri edhe për shtetin e vet kombëtar me gjuhë letrare e shtetërore të kultivuar, madje këtij emërtimi *shqiptar* iu bashkuan edhe disa muslimanë edhe pse si gjuhë familjeje nuk e kishin mirëfilli gjuhën shqipe (torbeshët, goranët etj.).

E treta, në këtë punim u trajtua edhe hipoteza rreth etimologjisë së fjalës **shqip shqiptar Shqipri**, ngase prej afro 20 hipotezave të plasuara deri më tash asnjëra deri sot nga studiuesit nuk konsiderohej e vetmjaftueshme ose e pranuar shkencërisht. Sipas lëndës së paraqitur në këtë punim edhe pse nuk rrahët gjoks për zgjidhjen përfundimtare të disa çështjeve të prekura, nuk mund të mohohet fakti se u ekspozuan disa risime me material e interpretim të ri, duke u pozicionuar në mbështetjen e këtyre tri (hipo)tezave kontaminuese, jo të lehtërrëzueshme, si:

Së pari, rreth totemit shqipe (shqiponjë), ngase vërtet, edhe ky fakt ka shërbyer dhe shërben, sidomos, pa hyrë në etimologji, kjo tezë motivohet emocionalisht, siç ishte motivuar edhe nga rilindësit tanë dhe kështu ka ndikuar për përqafimin shpirtërisht me shumë dëshirë të termit **shqipe shqiptar**, *bijtë e bijat e shqipes* etj. Gjithsesi kjo (hipo)tezë ka histori të pamohueshme.

Së dyti, konfrontimi i trajtave *shqipo / shkja*, vërtet në periudhë të caktuar ka ndikuar në distancimin siinatçe dhe përgjithësimin e termave përkatës, ngase, siç konstatohet, që të dyja këto fjalë kanë të bëjnë me konceptin e shizmës (të ndarjes, shkyemjes), por për shqipfolësit e sotëm, koncepti i parë fjalës *shqiptar* u përqafua kombëtarisht, si diçka ideale, si fjalë bashkuese shumë pozitive joshkizmuese, ndërsa fjala e dytë *shka shkie shkini* nga shqiptarët u pranua emocionalisht me kuptim shumë keqësues, përçarës, ngase *shkijet*, duke u kapur fort vetëm pas fesë liturgjike të të parëve(!) tradhëtuan gjuhën shqipe të të parëve dhe si rrjedhojë një shumicë e tyre u sllavizuan (në serbë, malazezë e maqedono-bullgarë), madje edhe u shfrytëzuan në luftë me ngjyresë fetare kundër shqiptarëve, sivëllezërëve të një gjaku, historie e gjuhe. Ndërkaq *shqiptarët* duke ruajtur gjuhën edhe pse shumica muslimanë, gjetën zgjidhje, duke respektuar edhe fenë kristiane (katolike e ortodokse) të sivëllezërve të tyre të një gjuhe e gjaku dhe kështu u krijua tolerancë me vetëdije të lartë, e cila çoj edhe në formëzimin e kombit të veçantë shqiptar dhe rrojtjen e tij, sipas motos **Fe që Zotynë e bekon: Shqiptaria feja jonë**. duke toleruar të tri fetë të pranuar sikombëtare: **muslimane, katolike, ortodokse**, dhe besime të tjera, pa pasur nevojë për ndonjë kodifikim zyrtarë të tyre, apo jo?!

Së treti, dolën në dritë nga anonimiteti jo vetëm si të mundshme, por edhe të natyrshme, gjithsesi me interpretim ti ri koncepti i dy foljeve:

E para, folja **shqip, me shqip ose të shqipësh**, si barasvlerës i perifrazës: **me folë shqip ose me shqipë: qartë, hapur, troç** që njëherazi

shërben mirëfilli edhe si temë fjalëformuese për emrin **shqiptar** e derivate të tjera, folje kjo, e cila edhe pret aktivizim të natyrshëm në gjuhën shqipe të kultivuar dhe

E dyta, folja **shqipoj me shqipue**, e faktuar edhe nga portali “Port-albi” dhe burime të tjera, e cila gjithashtu kërkon të aktivizohet si e specifikuar për kuptimin semantik që ka të bëjë *me shqiptarin si veprues (shqipues)*, i cili për të mbrojtur ekzistencën e vet është shërbyer me mjete mbrojtëse, pune e sulmi, duke përfshirë nga ato më të thjeshtat deri tek më të komplikuarat, si p.sh. nga veprim: me grusht (dorë), me gur, shkop, shpatë, shigjetë e pushkë, por edhe me armën më të fortë e më të shtrejtë me **shqipimin** ose me të shqipuarit **shqip**, me kultivimin e gjuhën shqipe kulturisht e shkencërisht. Së fundi, u konstatua se fjalë-folja **me shqipë**, në sistemin gjuhësor që simbolizon ligjërimin shqip dhe ajo **me shqipue** si **vegël veprimi e shqiptarit**, që i miraton sistemi i sotëm ligjërimor i shqipes do të kenë ekzistuar që nga lashtësia apo antika në gjuhën tonë dhe që prej asaj kohe si **fjalë të vjetra** që në atë lashtësi ishin mishnuar si **veçori veprimi e veprimtarie të shqiptarit** supozohet që si e tillë fjala **shqip** jo e huazuar, qoftë si folje a si emër si fjalë huazuese qenka përhapur (huazuar) edhe nga gjuhët e huaja, klasike dhe të mëvoshme aktuale, andaj edhe sot si fjalë shqipe emri **shqiptar** me meritë historike bën pjesë si ndërkombëtarizëm në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare në të gjitha enciklopesditë e gjuhëve më të zhvilluara të botës.

Me fjalë të tjera, në këtë krye, veç tjerash, veçmas tërheq vëmendjen trajtimi i kuptimisë dhe i etimologjisë së fjalës **shqiptar** (zëvendësim i fjalëtermave të mëparshëm *arbër, epirot* e të tjerë), ku lidhur me këtë si mbështetje dalin të rindërtuara (konstatuara) foljet strukturisht të natyrshme: **shqip me shqipë** dhe **shqipoj me shqipue**. Gjithsesi në punim janë shprehur edhe mendime e ide në dukje të guximshme, të cilat gjithsesi mund të shfrytëzohen si sfidë edhe përpjekje në të mirë të zgjidhjes shkencore të problemeve të caktuara që ende konsiderohen të diskutueshme në gjuhësinë shqiptare, por që ndikojnë edhe në të mirë të mirëkuptimit në raportin prejardhësor etnik, jo atij fetar që mjerisht ndan, por në pikëpamje njerëzishmërie të doktrinës humaniste që bashkon, ngase për shqiptarin: *Zot - hyll drite, janë tri fetë monoteiste: islame, ortodokse, katolike*.

Sidoqoftë, materiali dhe interpretimi që u ekspozua në këtë krye punimi mund të shërbejë jo si sfidë, por si nxitje ndaj studiuesve të sotëm

e të ardhshëm për të vlerësuar këtë punim jo *si shprazje pushke në hava* po si një **të shqipuar në cak** që njëherazi ka për qëllim të shpjerë më tej dijen rreth kësaj teme kaq të rëndësishme për gjuhën shqipe dhe për emrin **Shqiptar e Shqiptari, sepse shqiptari me fjalën shqip, shkrep, sqepoi, shkopoi, shpatoi, pushkoi** - me një fjalë **shqipo e po qipon** ku duhet **dhe** po vazhdon hapërimin krenar **me shqipen** si armën më të mirë mbrojtëse e zhvillimore kombëtare.

Kreu V
FEJA ORTODOKSE SI SHKAK-PASOJË NË PËRCAKTIMIN
E KOMBËSISË TË SHKIVE TË VENDIT NË PËRGJITHËSI
DHE ATYRE TË FSHATIT REÇAN TË THERANDËS
NË VEÇANTI

Hyrje

Edhe në këtë vazhdim të temës *Injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës...*, ndër të tjera bëhet fjalë rreth identitetit që prej nesh u quajtën ose vazhduan të quhen **Shkitë tanë** ose **Shkitë e vendit** në Kosovë e më gjerë, të injoruar, jo vetëm nga Shteti e Kisha pravosllave serbe, por edhe nga sivëllezërit e tyre muslimano-katolikë, madje për mungesë koncepti edhe nga vetëvetja dhe për shkak të kushteve që pamundësuan një ndërgjegjësim të tillë, prandaj në këtë krye, për t'u kuptuar më mirë shkaku i injorimit të gjuhës shqipe si *kriter i së vërtetës* edhe në përcaktimin e etnitetit **shkitë tanë** (ortodoksët shqiptarë të ne) në përgjithësi në konkretisht po flasim për ortodoksët e fshatit tim të lindjes Reçan të Therandës, në veçanti, me aq sa di, dhe bazuar në përmasat e këtij kreu të punimit, do të trajtohen këto tema:

së pari, pak fjalë rreth historikut të fshatit,

së dyti, rreth prejadhjes ritofetare shqiptare paramuslimane përgjithësisht dhe në veçanti të familjes sonë Veselaj,

së treti, rreth rolit konsolidues-pajtues të pleqnarit të njohur *Mehmet (Vesel) Reçani*, brendapërbrenda familjes, fshatit dhe jashtë,

së katërti, dilemat rreth përkatësisë *pagane/ritokristiane* të *Varmuranë-kishëzës* ose kenotafit të fshatit tonë,

së pesti, do të shpalos paksa me njëfarë nostalgjie përjetimet e mia 80 vjeçare rreth bashkëkjetesës fqinjësore *muslimane/ortodokse* apo *shqiptaro-shkive tanë (serbë!)* të këtij fshati e pak më gjerë, në tri periudha: a) gjatë Krlevinës jugosllave (1918-1941), b) gjatë LDB (1941-1944) dhe c) në periudhën pas LDB në Jugosllavinë federative deri në shpartallimin e saj (1944/45-1999) dhe

së gjashti, politika shqiptarofobe milosheviqiane vazhduese e politikës kolonialiste të Serbisë dhe të Kishës serbe ndaj Kosovës me injorimin e gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës me pasoja edhe për *ortodoksët shqipfolës* në përgjithësi, ndër ta edhe të fshatit tonë, të cilët pasi i përbalti, i ndrydhi e shtrydhi deri sa edhe i gjakosi me fqinjët e vet të një gjaku e një gjuhe, fatkeqësisht më 1999, me rastin e tërheqjes pa kthim të Ushtrisë serbe nga Kosova, i shpërnguli edhe ata në Serbi.

Nënkreu I RRETH HISTORIKUT TË FSHATIT REÇAN TË THERANDËS (SUHAREKËS)

Nuk di që dikush nga etimologët ta ketë trajtuar në hollësi etimologjinë e fshatit Reçan, por nga bisedat e lira përgjithësisht kam dëgjuar se flitet për këto tri hipoteza:


E para, duke marrë për bazë relievin, ngase gjurmët e shtëpive të hershme të fshatit tregojnë se fshati i tipit grumbullues ishte i ngulitur kryesisht mes gjirit derdhës të dy silumenjve (rekave), që vijnë nga drejtime të ndryshme përafërsisht si të formës V, njëri silumi (Reka e Dragaçinës) që përmlledh ujrat që nga një pjesë e Grejçecit (Gjytetit), ndërsa silumi tjetër (Reka e Bukoshit), i cili vjen nga Maja e KryeZotit (Bogogllava) apo Bjeshkëve të Buzhalës dhe që nga bashkimi i dy rrjedhave nën fshat formohet lumi Toplluh i Suharekës, i cili derdhet në Drinin e Bardhë, andaj supozohet se emri i fshatit vjen nga fjala *reka (sapas studiueses Fatbardha Demit me burim pellazg (shqipe e sotme lum lumi. lumi, dikush e konsideron këtë fjalë reka fjalë e sllavishtes mesjetare, por si fjalë *reka* del e përvetësuar edhe nga banorët vendës josllavë. Ndërkaq nga Komisioni Qendror për Standardizimin e Emërtimeve të Vendbanimeve të Kosovës del i propozuar emërtimi i fshatit **Lumar-i**.

E dyta, është e hedhur një hipotezë tjetër savante se emri Reç/an, në bazë të artefakteve të gjetura ka qenë një vendbanim shumë i lashtë, andaj për këtë emërtim supozohet se mund të jetë shfrytëzuar rrënja e fjalës ilire *rak / rek req re e huazuar nga pellazgishtja , po nga *Fatbardah Demi*), siç quhej në ilirishte *rrushi*, përkatësisht *vendi i rrushit*: *Rak+anë -Ana e rrushit(!), ose *Rak' (rek /req/re): *vend i rakisë së rrushit*, ngase vërtet ky fshat ka qenë i njohur deri vonë për pjekjen e prodhimin e rakisë e të venës së rrushit nga vetë *rekjanët (reçanasit). Sidoqoftë, edhe pse nuk janë bërë gjurmime, kjo dëshmohej jo vetëm nga pohimi i pleqve tanë ortodoksë e muslimanë, por edhe me gjetjen e një qypi të madh në një lokacion të këtij fshati, madje, siç mësojmë edhe nga udhëpërshkruesi Ami Boue, i cili më 1836 (Shih edhe te: *Koha ditore*, 13.01.2018.), konstaton se në Suharekë (shumë afër Reçanit) kishte një venëtoare (venari), vend grumbullimi i rrushit për prodhimin e mushtit të venës, ndërkaq, siç e dimë shumica e vreshtave atëherë ishin prona të raçanasve.

E treta, përveç këtyre dy hipotezave, ekziston edhe një tjetër etimologji thjesht popullore, se goja emri i fshatit vjen nga fjala sllave **reç** (shq. **fjalë**). Është interesant që edhe Milojeviçi emërtimin e fshatit Reçan në Maqedoni e konsideron me prejardhje nga fjala **reç**. Sidoqoftë, epiteli i dhënë nga të tjerë rreth fjalës **reç (fjalë)**, por i pranuar dhe i përvetësuar me krenari nga vetë vendasit josllavë, të cilëve u shkante përshtat, ngase në këtë trevë që nga lashtësia njerëzit e këtij fshati paskan qenë të dalluar si *të zotë për fjalë, muhabete*, ndaj edhe e shqiptojnë me **ç** më afër fjalës – **sh-së resh** - mbushullon me të mirae jo me **q-** më afër **k-së rekë!** Dhe, vërtet, për këtë dukuri mendjemprehtësie e urtësie trashëgimisht paskan dhënë shembull, qoftë si njerëz gojëtarë, pleqnarë, këngëtarë, por edhe si hokatarë, së këtejmi, nëse Komisioni në fjalë i merr në rishqyrtim emërtimet e vendbanimeve, edhe unë pajtohem me propozimin e ri nga vendësit, që emri i fshatit mund të riemërtohet **Fjalëmir Fjalëmiri**, emër ky emocionalisht gjithsesi më i pranueshëm se *Lumar*, kalk i propozuar në vend të fjalës *rekë Reçan*.

Sidoqoftë, shikuar nga një aspekt tjetër, ky fshat, me pozitë mjaft strategjike në të kaluarën, rrëzëmalë e buzëfushe, banorët e të cilit më tepër mbaheshin si malësorë e me malësorë sesa me rrafshakë podrimçakë (anadrinas). Fshati ishte i banueshëm që nga periudha pallazgo-ilire-dardane, siç mësojmë nga disa gjurmë rrënojash si dhe nga disa rrënjë toponimesh ende në përdorim e sipër deri në ditët e sotme, ku identifikohen emra të vjetër parasllavë, si *Kili, Gjini, But(d)i, Kozma, Gjergji, Buçi, Pali, Arashi, Barbeshi* etj., natyrisht me ndonjë ndajshitesë a mbaresë arbnore-shqiptare apo latine ose edhe lashtosllave, si *Kiliqishtë, Gjinovishtë, Shi(n)Buti, Kozmatok, Murana e Shingjegjit, Bluda e Palit. Buçalla e shembuj të tjerë, që disa do t'i (ri)përmendim më poshtë.*

Në të vërtetë, edhe sipas burimeve të shkruara, Reçani nuk është pa histori të lashtë. Zgjon interes fakti se emri i këtij fshati përmendet edhe në një *kartë* të Stefan Dushanit të vitit 1348, ku ai si mbret (ende nuk ishte shpallur *car i serbëve, bullgarëve, grekëve dhe arbanasve*, këtë vendbanim të dalluar nga kjo anë, të shënuar me emrin **Reçan**, më 1346 ia dhuron Manastirit (të vet) *Sveti Arhangela* (shenjtoreve): Grabriel (Arhangjel) dhe Mihal (Mëhill)) afër Prizrenit, duke ia përmendur qartë edhe sinoret, ku sipas këtij dokumenti dhe kujtesës së vendasve kufijtë e fshatit Reçan shtriheshin në një sipërfaqe mjaft të gjerë që sot mund të rumbullakësohen kështu:



Fotofaksimili i kartës së S.Dushanit (!), Beograd 1862

Nga jug-perëndimi deri te Lloçaku i Sopisë së sotme, në perëndim deri te Gradina e Ledinat e Gjana (afër Suharekës) kurse në jug-lindje kapej: me Sllapuzhan, Rrezina, Biraçi, Buçalla, përmendet Dragaçina (jo si kufi), Mbishibuti, e së andejmi kalon vija nga lindja afër Muhlanit dhe përtej Bludës së Palit nga Krushica e Poshtme, del afër Gurrës së Kaçanikut mbi Hudhrarevë, për skaj Qarrit të Bukoshit, shkon pak përtej Rrotullakut, kap Ledinën e Katundit nën Bukosh, (fut nën sjetull Starakuqat (Shpiat e Vjetra) e del në krye të Livadheve të Gjana të Reçanit dhe nga jug-perëndimi shkon drejt e puqet me Lloçakun afër Sopisë. (Shih foto-faksimilin më sipër).

Siç po shihet, fshati Reçan edhe pse pas *Lidhjes së Prizrenit* nuk përmendet si fshat i madh, megjithatë, për që kishte në pronësi një sipëfaqe mjaft të gjerë faktohet deri në ditët tona, sepse banorët e këtij fshatit “*të vogël*” edhe sot kanë prona të trashëguara nga krejt kjo hapësirë, edhe pse ndërkohë, qoftë të uzurpuara nga shteti për vreshta (Qesta nga ana e Sopisë, Barbeshi, Rrezina. Biraçi, qoftë edhe për arsye të tjera disa nga ato prona kanë kaluar në pronësi të shtetit apo të individëve të fshatrave të tjerë.

Është e vërtetë, siç tregohet që, gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, tokat më të mira (bukanike) të këtij fshati, ndoshta për merita lufte e ku ta dimë, ua kishin dhuruar disa personave turkofilë, bejlerë e agallarë të Prizrenit. Këtë e dëshmon fakti se trojet e arat më pjellore e vendet më të përshtatshme të fshatit për jetesë, deri vonë dihej qartë se kanë qenë prona të zotnive (agallarëve) prizrenas. Këta *zotni të shehrit* (Prizrenit) edhe pse nuk jetonin përherë aty, pikërisht këtu kanë pasur shtëpi-kulla të pajisura në mënyrë mjaft komode për kohën, me kafeoxhaka, yklyka (dollapë për tesha, shtrojë e mbulojë), trapazana, tavana me yllëza e hajmalia, divanhane të gjera, sibalkone rreth me xhama etj., mirëmbajtjen e të cilave e bënin çifçitë, të cilët siç thuhet, kishin shtëpitë e tyre të stilit të vjetër me themele trekëndëshe (formë piramide) me oxhak në mes. Mirëpo si kudo edhe në këtë fshat mund të ketë pasur ngulje e shpërngulje të popullatës, por siç dëshmojnë disa fakte, megjithatë dikush prej tyre ka mbetur autotokton, dhe ky fakt do të ri/dëshmohet më poshtë edhe me emrat e disa toponimeve të mbajtur mend, të cilët janë trashëguar, duke kaluar gojë më gojë, brez mbas brezi, deri në ditët e sotme. Gjithsesi, flitet se ka pasur pakësim banorësh për shkaqe sëmundjesh (epidemive) e luftave, por edhe shpërngulje familjesh që nga fundi i shekullit XVIII dhe nga gjysma e dytë e shekullit XIX, për shkaqe të ndryshme ekonomike e politike më fort në Prizren e gjetiu, por jo në Turqi ose në Serbi, atëherë kur Serbia sapo kishte filluar me ngre krye si principatë-shtet më vete.

Sido që të ketë qenë, ne pa humbur në të dhëna të tilla jo fort të njohura, si pikënisje rreth Reçanit e banorëve të tij po e shfrytëzojmë Regjistrin e Milosh S. Milojeviçit (të shënuar nga z. Vemic), që e kemi në shqyrtim, i cili më 1866-1868 faktonte se ky fshat nuk paska qenë edhe aq i vogël, paska pasur **JOS 42 shtëpi** (30 poture dhe 12 arnauete). Pra, sipas tij momentalisht fshati ishte pa asnjë turk, pa asnjë latin (katolik) dhe pa asnjë cigan apo serb (ortodoks), por krejt ky fshat fetarisht ishte

muslimanë (poturë e arnautë), po, sipas meje, ndoshta, vërtet me emra muslimanësh, por, me besim të shkruar islam, ngase nuk dëshmon se kishte mesxhide apo xhami. Mirëpo për prejardhjen fetare trashëguese paraislame të reçanasve do të flasim pak më poshtë.

Ndërkaq, në portalin www.theranda-ks.com, lexova se në një regjistër të vitit 1871 Reçani paska pasur gjithsej 17 shtëpi: 10 shqiptare (muslimane) e 7 serbe (ortodokse) që nuk përputhen me statistikën e Milosh Milojeviçit të regjistruar 4-5 vite më parë (1866), ku shënohen vetëm dy etnitete muslimane (*poture* (30) e *arnaute* (12), por, po përsëris: as serbe, as latine, ndërsa tani dalin 32 shtëpi shqiptare më pak, ndërsa shtohen 7 shtëpi ortodokse (serbel!), mbase, siç do të sqarohet më poshtë, këtu do të jenë llogaritur 7 shtëpi të Starakuqes, pllajë vendbanimi jo fort larg Reçanit, por edhe këta otodoksë shqipfolës. Gjithsesi, edhe nga kjo pikë mbesin paqartësi.

Po sido që të ketë qenë, gjendja e dhënë nga autori Milojeviq në parim për qendrën e fshatit plotësisht përputhet me historikun e vetë fshatit, siç e kemi dëgjuar nga të parët tanë. Vërtet, në këtë periudhë, d.m.th. 10 vjet e më herët para Lidhjes së Prizrenit, ortodoksë (serbë!) në lagjen qendrore të fshatit Reçan nuk ka pasur, ngase që më parë banorët ishin islamizuar, por nuk përjashtohen raste që edhe në prag të asaj Lidhjeje të jetë vendosur aty ndonjë familje rajë ortodokse. Së këtejmi, me sa dimë, ndërkohë janë vendosur, me kërkesë të zotnive dy familje po i quajmë me rezervë *serbe*, mbase më drejtë është me i quajtë familje ortodokse (skizmatike) ose *shkije shqipfolës*, sepse çipçitë e mëparshëm shqiptarë të islamizuar, paskan pasë shprehur mosbindje ndaj zotnive, madje qenkan rebeluar kundër tyre dhe kundër shtetit, andaj paska pasur shpërngulje, sidomos në qytetin e Prizrenit e gjetiu dhe kjo ishte arsyeja që zotnitë kërkonin çifçinj të tjerë më të dëgjueshëm e më punëtorë, jo muslimanë as katolikë, po parapëlqenin rajë (ortodoksë), madje edhe të rritnin numrin e tyre, duke u ndarë parcela të reja, si tokë bukanike në Lluga, vend nën fshat (atëherë vend gjysmëmoçalishtë). Kështu, së pari, si familje ortodokse thuhet se zbret nga fshati Muhlan familja **Mitri** (e më pas edhe një familje e islamizuar Ramaj po nga ai fshat), e cila vendoset në trojet e prindëve të Haki Efendisë (Xhemajl Agës) në qendër të fshatit, ku ishin të vendosur edhe shumica e banorëve më të hershëm të lagjes së **Veselajve** tashmë të islamizuar.

Ndërkohë nga “Starakuça” (*Shpiat e Vjetra*), një kodrinë-pllajë jo fort larg Reçanit nga ana e fshatit Bukosh (gërmadhat e atyre

vendbanimeve i mbaj mend edhe unë), siç na tregonte plaku, *kumara Nikollë*, pa joshje nga zotnitë, familja e **Petrit** zbret në katund, dhe zë Grykën e sipërme të lumit në atë drejtim të Bukoshit. Kjo familje ose një pjesë e saj, thonë që paska pasë ardhur shumë më përpara nga Vranja, e cila mbahej me fis *morinë* dhe është përzier me familjen tjetër vendëse po ortodoks të fisit *gash me të cilën simbiozohet*, nga pakësimi i banorëve për shkak vdekjesh epidemike . Mbaj mend që Kumara Nikollë, na tregonte se dikur krej fusha e katundit ka qenë liqen, por kur Gurra e Kaçanikut, nën Krushicë, mbyllet me lesh, dru, e gurë (!) ajo rrafshinë, bashkë me Hurdharevën (Hudarevën) shndërohet në moçalishte dhe shkallë shkallë vjen e bëhet livadhe e ndërkohë tokë buke me pronarë të rinj jo aq varur prej zotnive, po prej vetë banorëve autoktonë dhe ardhacakë. Kjo ishte arsyeja, por edhe sëmundja e murtajes, që ata nuk kishin ra më heret në Reçan, por kur janë “z djergë” poshtë familja e tij paska hy në një shpi me themel trekëndësh (formë piramidë) me oxhak në mes, në të cilën edhe momentalisht banonte bashkë me vëllain Ristën, babën e Llazës, shokut tim të fëmijnisë. Vërtet për ne fëmijët ishin tregime që nuk harrohen dot. Shtëpia e tyre e madhe me oxhak në mes që qëndronte mbi tre lëndë (trana) shumë të larta të lidhura me shokë-druri në mes e së andejmi puqeshin në majë, po e përforcuar edhe me dyreq deri në kat, deri vonë ka qenë atraktive për ne. Aty ku banonin këto dy familje, dimnit i futnit edhe lopët me viça të vegjël, por edhe delet me qingja. Atë shtëpi e ka prishur Jefta i Ristës, në vitet e 50-a të shekullit të kaluar pasi është ndarë me Jovanin e Nikollës dhe në vend të saj ndërtoi shtëpi të re jo aq të madhe.

Familja e tretë, më e vonshme, nga gjysma e dytë e shek. XIX, po ashtu shkije (shqipfolës) ishte familja e **Simës**, me origjinë, siç thoshin, dikah nga ana e Malit të Zi, por që si familje ishin ndarë në dy grupe një pjesë e saj ngulitet në Sopi, ku paraqitet e islamizuar, ndërsa kjo e fshatit tonë jo, ngase edhe zotnitë (shteti turk) nuk kanë kërkuar islamizimin e tyre, për shkak taksave të veçanta e dëgjueshmërisë që duhej jetësuar nga ana e tyre. Madje supozojmë se kjo familje mund të ketë qenë edhe katolike ose laramane, por për arsye punësimi është paraqitur si ortodokse. Sidoqoftë edhe kjo familje vendoset në afërsi të familjeve Mitri dhe Veselaj, duke zënë vend në rrënzën e Bokës në drejtim të vargmaleve të Qarrit të Reçanit

Që të tria këto familje ortodokse (shkije): *Mitrajt*, *Petrajt* e *Simajt* (që unë në këtë punim po i shënoj kështu për lehtësi shprehjeje praktike, edhe pse dihet se familjet e ngushta të tyre, mbi 40 shtëpi, ndërkohë kanë

marrë patronime të tjera. Sidoqoftë, thuhet që edhe që të tria këto familje, para se të vendoseshin, sipas rregullit të vendit, ashtu siç kanë vepruar edhe ardhacakë të tjerë joortodoksë, mbase më herët edhe nga Malësia. Luma, Rrafshi i Kosovës, Drenica (Xajt) e ku ta dimë, por më vonë edhe nga fshatrat për-rreth, siç më ka treguar im atë **Muharrem Uka (1888 – 1951)**, paskan pasë marrë edhe pëlqimin nga kryeplaku (miftari) i fshatit, qoftë fillimisht nga **Vesel Topalli**, qoftë më vonë nga djali i tij **Mehmeti**, i njohur me mbiemër fshati: **Mehmet Reçani (1826-1918)**, i cili, përveç autoritetit të trashëguar nga i ati, si shpi e fortë fisi me meshkuj e pasuni, ishte dalluar edhe më shumë me odëbuke e burri, madje ndërkohë edhe me mençuri e dijeni saqë fiton emër nderi në rang **pleqnari** e ndërkohë edhe si **stërplak**, rangu më i lartë në hiarkinë e sistemit juridik fisnor popullor shqiptar të asaj kohe. Ky përveç njohurive sipas kodit të Kanunit të Lekës ose Kanunit vendës (ngase pleqnitë bëheshim më fort me improvizime mençurake), thonë se kishte pasur njohuri edhe nga kodet e **shariatit** (të së drejtës islame), por edhe nga kodet e **kishës** e **të shtetit**, por zgjidhjet sipas kishës e shtetit si dhe të shariatit nuk i pëlqente. I konsideronte me të drejta zgjidhjet që jepnin pleqtë e fiseve sipas Kanunit të Lekës.

Sidoqoftë, për kultin e të bameve të tij brenda familjes, fshatit e më gjerë do të bëjmë fjalë në tjetër vend dhe paksa edhe më poshtë, pasi t'i themi dy fjalë si supozim rreth prejardhjes paraislame (pagane ose ritofetare kristiane) të të parëve të familjes Veselaj në veçanti dhe të fshatit në përgjithësi, e cila del mjaft e paqartë dhe e ndërlikuar, po i themi dy fjalë rreth emrit **Vesel**, që thuhet se me këtë e ka bartë i pari ynë i ardhur nga Blinishti i Shkodrës, emër ky që në mënyrë të rregullt është bërë emër familjar me prapashtesën e specializuar –AJ: Vesel+aj **Veselaj**, po lind pyetja si shpjegohet prejardhja e emrit **Vesel**, nga cila gjuhë dhe cilës fe i takon. Sipas Fjalorit të Mikel Ndrecës, kjo trajtë si emër musliman vjen nga arabishtja nga emri i udhëheqësit shpirtëror të esnafëve, saraçë fisnikut *Uways al qarani* (Aty f. 728) ndërsa sipas Fjalorit etimologjik të Kolec Topallit (f. 1559) mbështetur në foljen veselis (me veselitë) huazim nga sllaviashtja që u përdorka në Shqipërinë e Jugut edhe emri Vesel mbështetur në foljen *veseliti* del po nga ai ndikim. Mjerisht shpjegimet e mësipërme kanë mbizotërue dhr kështu janë plasuar, siç e pamë edhe studiuesit tanë. Një poltronizëm i tillë i studieve tanë ka ardhur jo aq nga mospuna e tyre sa nga sistemi që ka mbretërua në institucionet tona. Duke falenderuar studiuesin Qazim Namani (Shih zsh,

05/12.2021) mësuam se studiuesi zaroarbëreshi Aleksandër Stipçeviq në ishullin Braç të Dalmacisë kroate paska ndeshur emrat *Veselia Felicitas* të dytin fjalë latine me kuptimin *fat* ndërsa të parin **Veselia** e konstaton me prejradhje **ilire** (para sllave. Dhe vërtet, etimologjia e emrit Vesel imponon sqarim. Kështu trajta e shqipes **Vesel**, e cila qëndron si mbiemër familjar edhe të katolikët, si familja e Nikollë Veselit nga Shpinadia e Prizrenit, si dhe në një shumicë të familjet muslimane, assesi nuk përputhet me emrin Uveys (Uways) të arabishtes, madje as me atë Veselin, Vesko (jo prodhimtar) të serbishtes, sepse në shqipe qenka e trashëguar që nga ilirishtja dhe për këtë ka model fjalëformues. Edhe nëqoftë e krijuar mbi bazë të rrënjëtemës vesë- (pika uji) Ves+EL **Vesel** fjalë shqipe me prejradhje i.e. ose edhe pa të ngase përkon me shembuj në pëdorim e sipër, si *Ukel (Ukë+el)*, *Cubel (Cub+el)*, *Zukel*, *Kacel*, *Rrotel*, *Babel*, *Zenel (Zejnullah)*, pastaj *Mikel*, *Daniel*, *Evangjel*, pastaj *micel*, *bubazhel*, *bardhavel*, *buzavel*, *rrokotel*, *personel!* etj., kurse prejradhja *Uveys+al* apo **el (U)Vejs+el** që në arabishte **al** shërben si një nyje e përparme shquarsie si *al-lah* etj. është një hamendësi fort e diskutueshme, apo jo. Është i pranishëm emri katolik *Vasel (vas+EL)*, siç e bart i lahutari i njohur **Vasel Shkreli** (Shih portali “ZSH”, 18.11.2022)

Së këndejmi, emri *Vesel/ia Veselaj*, përkatësisht *Vesel* paska të bëjë me një fjalë të trashëguar kombëtare nga ilirishtja e jo si emër fetar (musliman e aq më pak pravosllav), ndonëse asocianisht mund të ketë pasur ndonjë ndikim të tillë subjektiv anësor, apo jo?! Këtë e vërteton edhe studiuesi etuziat Andi Zeneli në një emision të tij në internet.

Nënkeu II

I. PAQARTËSI RRETH PREJARDHJES PARAISLAME RITOKRISTIANE TË FAMILJES VESELAJ E PËRGJITHËSISHT

Është interesant se si im atë herë-herë na i kujtonte disa ngjarje sihistorizma lidhur me familjen tonë rreth trashëgimisë ritofetare. Sipas

asaj që e kam dëgjuar e lexuar më vonë islamizimi në këtë fshat si dhe kryesisht në mbarë Rrethbjeshtë e Anadrininë zyrtarisht kishte filluar të përqafohej pjesërisht që në shekullin e XVII, kur kur emri *Vesel* veç ishte i instaluar ashtu si edhe feja islame, sigurisht joshur nga ndonjë privilegjë ekonomike ose edhe për ndonjë të drejtë plus qytetare, si leja për bartjen e armës etj. Atëherë muslimanë janë deklaruar zakonisht të zotët e shtëpive, duke marrë emra muslimanë e pastaj pak nga pak edhe grania e pjesëtarët e tjerë të familjes dhe kështu emrat e vjetër vetjakë paganë e kristianë përshtateshin ose zëvendësoheshin me ndonjë ndryshim apo shkurtim që konsideroheshin si emra të pranueshëm si p.sh. Vasil/ Vesel/, Nelë/Zenel, Stefë/Sefë, Llazë/Ilaz, Daniel/Danush, Simon/Osman, Simë/Asim etj. etj.,. Sidoqoftë, siç ndodhi edhe tek të tjerët edhe në familjen Veselaj duke braktisur pak nga pak edhe ceremonitë e fesë së mëparshme, e cila edhe ashtu kishte qenë mjaft e brishtë, sigurisht kjo shkriftësi ka ndodhur ndoshta edhe për shkak të ndryshimeve të riteve përkatëse kristiane në rivalitet të ne: ortodokse/katolike që varej nga aktiviteti i klerikëve të rritit përkatës, po edhe sipas përkrahjes e kërkesës së pushtetarëve, të shtetit e të fiseve. Për lexuesin po i cek nja tri sishaka (barsolëta) që i mbaj mend nga femënia që tregojnë brishtërinë fetare, por mesazhi edukativ në dobi të islamimit del i qartë:

E para, në një natë të gjatë dimni vjen me bujtë në fshatin tonë një *emisar*, ndoshta i shtirur si hoxhë, me një musaf në dorë, të cilit pas darke i zoti i shpisë i thotë:

-Hajde, hoxhë, hape qitabin e tregona diçka!

Hoxha e merr librin në dorë, e shfleton mbarë e mbrapsht disa here dhe pas pak shikon të zotin e shpisë dhe të tjerët dhe duke e mbyllur librin përgjigjet:

-*Sa ka, sa ka, shumë ka!... Po ma mirë po e mshelin e po e lamë e luajmë kapuçat!*

Të gjithë, plot oda, mezi pritnin këtë zgjidhje-përgjigje dhe kështu me plot gëzim është vazhduar si netëve të tjera me mahi lojra, e lojë e kangë kapuçash.

E dyta, njëfarë Tahiri, ishte i një lagjeje anësore të fshatit, sa ishte mësuar me u falë jashtë dhe një natë i mbushet mendja me u falë në shpi të vet. Nana, në moshë, që e kishte djalë hasreti dhe nuk e kishte parë askë asnjëherë duke falë namaz, kur e sheh djalin, i cili luante buzët e nuk fliste, binte e çohet... Kjo gjë e shqetëson, andaj i thërret disa herë:

- *Tahir, Tahir!*

Mirëpo, meqë ai nuk i përgjigjej, dyshon se mos djali kishte lajthitur, i flet disa herë me shqetësim dhe më në fund i del përpara e duke ia kap duartë, përvajshëm i thërret!

-Tahir, Tahir, loke çka të gjet?!

Atëherë, Tahirit i priset namazi dhe e qetëson Nanën, por edhe e qorton pse ia ka prishë të falmen e muslimanit!

E treta, një bijë e familjes muslimane, martohet me një bjeshkatar, ku burri e kishte vetëm emrin musliman. Në muaj të ramazanit i shkon për vizitë motrës i vëllai medresand. Motra i përgatit krejt çka duhet për iftar, madje edhe dhëndrri merr abdes e falet pas mik-kunatit etj. Gjithçka shkonte në rregull. Mirëpo kur e shoqja e zgjon burrin për syfyr, ai mamurshëm, nuk përmbahet dot, shfryhet me të madhe:

- Po a hahet buka natën! He, shihe o Zot, e ti Shenjti ynë?!

Kështu, medresandi vetëm atëherë e merr vesh që dhëndërrin nuk e paska has musliman!

Pra dhe nga këto tri sishaka si dhe të tjera që tregoheshin shpesh në fëmijninë time merret vesh shkrihtësia e fesë muslimane, por që ajo vinte duke u konsoliduar në kohën tonë, fe e cila nuk pengohej nga qeveria e Kravevinës Jugosllave, përkundrazi, andaj edhe mesazhi i këtyre barsoletave ishte në të mire të konsolidimit të asaj feje.

Në të vërtetë, edhe kur është fjala nga cili rit kristian u bë konvertimi në musliman i familjes sonë, edhe pse ishte temë tabu për ne fëmijët me pyetë, edhe para 80 vjetësh si nën hije, patëm kuptuar se edhe burrat e odës sonë nuk kanë qenë të një goje. Dikush në biseda të lira ngulmonte se ne të gjithë, më parë *kemi qenë shkije (ortodoksë) e jemi baturq!*, por që *kemi folë kështu, shqip*, dikush tjetër shprehej që nga prejardhja e hershme *kemi qenë katolikë*.

Sidoqoftë, hipoteza e pare përkrahej edhe nga Mixha Hoxhë (**Mustafë Uka (1885- 1948)**), djali i **Ukë Mehmetit (1851-1923)**, gjyshit tonë, sepse sipas tij, feja islame dhe ajo ortodokse kishin pasur dhe kanë shumë afri njëra me tjetrën, i ndan, si me thënë, vetëm një tis i hollë sa maza e qepës, ndërsa me fenë katolike ndarja nuk është sa maza e qepës po sa lëkura e buellit, sa *opanga!!!* Ndërkaq baba kishte mendim tjetër, ky anonte nga hipoteza e dytë, me prejardhje katolike me prirje muslimane, ngase ashtu kishte dëgjuar nga Bababplaku se ne kemi prejardhje nga Blinishti i Shkodrës, prej andek vjen edhe emri Veseit të parë, andaj i takojmë që në origjinë fisit krasniqe, nuk jemi *dukagjinat as podrimçakë*, po *jemi malësorë*, dhese të parët tanë kanë qenë me lidhje katolikë, ngase

me ta na lidhë kanuni, respektimi i normave fisnore malsore, madje e aq më tepër mënyra e të folurit (diksioni) që dallon shumë nga poturishtja shqipe me prejardhje rrafshake ortodokse podrimçake. Shtonte edhe këtë, siç e kishte vërejtur në Malësi e në Shkodër, se ne me malësorë deri edhe me shkodranë na lidhin adete, burrnia, mikëpritja, gjuha, po edhe veshja, plisi, gajtanat e tirqve, stili i xhurdive, guja, kallçinjtë, stili i shpive, kullave etj.- etj.

Sidoqoftë, më duhet të sqaroj që atbotë popullsia shqipfolëse te ne zyrtarisht apo në thjeshtligjërime rekomandohej e ndarë në tri grupe (etnitate): **turq** (*muslimanët*), **shkije** ose **serbjanë** (*ortodoksët*) dhe **latinë-shqiptarë ose fanë** (*katolikët*).

Mbase për këtë arsye, për qëndrimin që shfaqte Baba ia kishin pasë dhënë ofiqin **katolik**. Po kështu, tregonin që edhe mësi, kushuri i Nanës: Sejdë Bajraktari i Suharekës për fejesë-martesën e Nanës me Babën, kur kërkon pëlqimin e dajës së Nanës, nga Musli Bajraktari i Budakovës, ia paraqet Babën: **Muharrem Uka** përveç *si nip e lozë e Mehmet Reçanit*, djali i **Ukë Mehmetit** ia përmend përveç *si komit*, edhe ofiqin **katolik**. Kështu, edhe **Baba Meta**, gjyshi i nanës, i Suharekas, paska pajtuar me *kysmetin*. Po e rikujtoj të vërtetën, se atëherë me ofiqin *komit e katolik* ndër burra të rrallë odash nënkuptohej në njëfarë dore: *njeriu parimor, fisnik, burrë kanuni, bukëdhënës e trim, jo paluskë e turkut,...*, ngase baba një kohë vërtet ka qenë edhe komit (kaçak) apo ishte i ndërlidhur me ta në kohë të Turkut, të Bugarit dhe të Serpit të parë (1912) dhe paska qenë një kohë edhe gjatë Serpit të dytë (nga fundi vitit 1917 dhe fillim vitit 1918).

Mësa më kujtohet, prania e paganizmit nuk përmendej fare, edhe pse elemente paganizmi kishim të shumta, madje besëtytnitë i kishim të njëllojta me ortodoksët vendas, ashtu si edhe ceremonitë festive pagane (festat e motmotit) etj., sidomos festa e Shëngjergjit, lagia e shtatit me hitha e larja me lule e shelqe, barnishta, prerja e dashit (qingjit), përseshi me tamël e haje të tjera ishin të njëjta, ashtu si edhe përshepirnitë, nejzrat, lidhja e penit në dorë, në këmbë, hedhja e një cukle rrobe te kroni i *ujtë e thartë* në Sllatina etj. Këtë rast po e kujtoj vetëm formulën që veç tjerash ma pati mësuar Llaza i Ristës: *Kush hin nër hije para shëngjergjit, dhimbtën e kresë e ethet e verës*, që e shqiptonin duke e kthyer krye e duar drejt qiellit.

Së këndejmi, një gjë dihej që sa i përket besimit mund të themi, siç kuptoj tani, kishim prejardhje me elemente trizashë (laramane):

pagane/ortodokse/katolike. Sipas babës, *Babaplaku*, familjes “*Veselaj*”, të parit tonë të islamizuar, i ishin bashkuar ose “*i ishin mbathë*” familje të krishtena të pa - apo të sapoislamizuara, andaj edhe jemi ba mahallë e madhe *me të ndajmbathurit*. Kjo që u tha nuk duket se ishte krejt pa bazë, sepse pikërisht *të ndajmbathurit*, edhe pse që të gjithë tani të islamizuar, me pasuritë që gëzonin, grykat, malet, madje edhe me trashëgimin e çifllëqeve të ara-livadheve edhe të ndonjë zotnie etj., dëshmohet edhe sot që ata kishin qenë autoktonë të vërtetë në këtë fshat, ndërsa këta të Mehmetit (para Vesel Topallit) pasi nuk kishin pasuri të tilla të trashëguara, madje as të parazitëve dhe as të zotnive të rinj, mund të supozohet se vërtet, i pari i tyre mund të ketë qenë i ardhur, ndoshta vërtet nga Blinishti i Shkodrës katolike, siç e ka lënë me gojë Babaplaku apo jo?! Ku ta dimë?!

Ç’ është vërteta, im atë në vitet 1914-1915, edhe unë (viteve të para të këtij shekulli), paksa jemi interesuar të dimë së paku, nga cili Blinisht e paskemi prejardhjen: nga Blinishti i Lezhës (më afër Shkodrës), nga Blinishti i Pukës (më me afri gjeografike), nga Blinishti i Mirëditës (kanunisht më i fismë), apo nga ndonjë Bilinisht tjetër, po as Baba as unë nuk kemi hasur as në ndonjë shenjzim, qoftë edhe gojëdhanë, nga këta Bilinishta (!). Megjithatë, po e përmend një rast. Ndërsa isha duke udhëtuar nga Lezha për Shkodër, në autobus, një i moshuar nga Bushati i Shkodrës (i thethjanë me prejardhje), më ka treguar se në krahinëzën e Thethit ka ekzistuar, mbase ende është i banuar, fshati Blinishtë Blinishta, ku ekziston gojëdhana që njëri prej vëllezërve të një familjeje, për shkaqe gjaku e ku ta dimë (ligje fisnore kanunore), qenka larguar dikah pa shenj pa dukë dhe nuk është kthyer kurrëmë, edhe pse hisja e tij e barabartë si vëlla ka qenë e shenjzuar *me gurë mexhet*. Sipas kësaj të dhëne, me fort ka gjasë, në mos qoftë iluzion sajesa e Mehmet Reçanit, që i pari ynë, mund të ketë ardhur së andejmi dhe në Reçan të ketë gjetur rast të përshtatshëm atëbotë të njihej, të vendosej e të ndihmonte ndonjë familje në nevojë, madje dhe të martohet me vendase, sepse në atë kohë, familjet rajë (boguline) kishin nevojë për trima mbrojtës fisnikë, ngase vetëm familjet e forta të bashkuara mund t’u bënin ballë telasheve që krijoheshin e krijohen përherë në raste anarkie. Ndërkohë **I ardhuri** (nga Malësia e Madhe e Shkodrës), pasi atëherë s’ka pasur kufi shtetërorë mund të ketë treguar zotësi të lloj-llojshme, andaj edhe e ka merituar me marrë edhe zotshpillëkun, drejtimin e familjes dhe, së andejmi si familje e fortë ka përthithur edhe të ndajmbathur të tjerë dhe kështu mund të ketë pajisur

familjen e tij të gjerë mahallë edhe me veti malësore edhe gjuhësore, jo thjeshtë poture boguline, apo jo? Pra në këtë mënyrë, mund të jetë formuar edhe lagjja kompakte Veselaj, edhe pse nuk kishin trashëgimi të njëjtë, por mahallisht nuk dalloheshin dhe të gjithë konsideroheshin, siç konsiderohen edhe sot, si kushërij të një familjeje të madhe, mahallë dhe bartin edhe sot mbiemrin familjar të njëjtë Veselaj.

Sido që të ketë qenë, për këtë harmoni ndërfamiljare të mahallës, me të cilën si nënhije mbaheshin e mbahen edhe sot ardhacakë të tjerë të rinj, ndonëse jo me këtë mbiemër, meritën e kishte **pleqnari Mehmet Reçani**. Madje nën ndikimin e tij kjo harmoni shtrihej në krejt katundin, përfshirë edhe tri familjet e shkive dhe të dy mahallave anësore, Hasanaj e Fetaj, e më gjerë, po secila me të veçantat e veta, të cilët (banorët) edhe pse prejardhjesisht nuk ishin aq unikë, ngase e para, me sa flitej del e formuar me tri trashëgimi të ndryshme (Hasani, Deliu e Veliu), ndërsa e dyta gjithashtu me tri (Destani, Ibra e Feta), megjithatë i lidhte mbijetesja, por atbotë kishin mirëkuptim. Disa nga të bëmat konkrete të kryefamiljarit dhe pleqnarit **Mehmet Reçani** në të mirë të rolit drejtues të tij, po i rrëfejme tash fill.

Nënkreu III

PAK FJALË RRETH ROLIT DREJTUES-KONSOLIDUES TË PLEQNARIT MEHMET REÇANI SI BRENDA PËRBRENDA FAMILJES E FSHATIT SI DHE JASHTË

Ç'është e vërteta, para se të sjellim ndonjë hollësi rreth kësaj veprimtarie si brenda si jashtë familjes së kryefamiljarit dhe pleqnarit **Mehmet Reçani (1826 -1918)**, me që krejt këto që do t'i them i kam të dëgjuara kryesisht nga baba im **Muharrem Uka (1888-1951)**, i cili që nga vegjëlia mbase që nga mosha 10-12 vjeçare, ka qenë i **zgjedhuri** i gjyshit ose i **Babaplakut**, siç quhej familjarisht **Mehmet Reçani**, andaj edhe tregonte me admirim për të bëmat e tij. Dhe kështu, si nip i dalluar, im atë, ka pasur nderin ta shoqërojë Babaplakun për disa vite, në shumë raste e sipas nevojës, me detyrë: **djalëmbasplaku**, një profesion sistazhisti (praktikanti), i cili fillimisht do t'i shërbente pleqnarit e shoqëruesve të tij, për raki ose kafeservim në odë, qoftë si gacëdhënës nga oxhaku ose me brincë, unur e eshkë jashtë, pastaj dredhës i cigareve të duhanit kaçak nga qesja ose kutia e babagjyshit, njëherazi shërbente edhe si mirëmbajtës i kalit të tij etj.- etj., por gjithsesi qëllimi kryesor ishte që të ushtrohej si

trashëgimtar për me nxanë *mjeshtrinë e ndarjes së pleqnive* (pajtimet të ngatërresave mes njerëzve), mirëpo siç do të shohim, edhe pse nga kjo *shkollë* (pa letër-diplomë) baba fiton shumë përvojë në zotërimin e këtij zanati, ky si i ri rreth moshës 17-19 vjeçare, kur baba i tij *Uka* ndahet nga familja e gjerë e Babaplakut dhe del pa hise, dhe për shkak se pikërisht atëherë ishte periudhë *hallakamash*, ngase baba aktivizohet në kryengritjet e shqiptarëve kundër Turqisë, nuk qëndron aq i disiplinuar ndaj shoqërimit me Babaplakun, tash fillon ta dëgjojë edhe ndërgjegjen e vet. Kështu pa lejen e tij inkuadrohet në atë lëvizje. Kështu siç tregonte ai ka marrë pjesë si vullnetar Tubimin afër Ferizajt, Rrugën për në Shkup, pastaj në Luftën e Carralevës, edhe për shkak të luftave ballkanike dhe LPB, detyrohet ta ndëpresë po thuaj tërësisht atë shoqërim, dhe kështu gjen shoqërim me kaçakë, para kapitullimit të Turqisë, dhe pas depërtimit të ushtrisë të *Serpit të parë*, me shumë shokë detyrohet me kaluar si muhagjerë në Malësi të Gjakovës dhe të Shkodër, por edhe pas kthimit detyrohet me u lidhë me komitë, sidomos në kohë të Bugarit e rikthimit të *Serpit të dytë*, kohë kjo kur edhe Babaplaku dërgjej dhe fundja ndërron jetë në fillim të vitit 1918.

Është e vërtetë, meqë Baba konsiderohej si i **knueshëm**, ngase kishte kryer shkollën e **pleqnarit** si **djalë mbas plaku**, madje tashti konsiderohej edhe si i **kërkueshëm**, pasi kishte qenë në *Malësi e Shkodër*, kishte kërkesa nga hallexhinjtë e ndryshëm dhe elita e pleqnarëve të rastit, që të merrej me *zanatin* e pleqnarit si babagjyshi, mirëpo ky kishte refuzuar një përkushtim të tillë, me arsyetimin sepse tashti kishte ndryshuar gjithçka. Nuk ishte më si në kohë të **Babaplakut**, kur pleqnari në suitën e tij veç **djalëmbasplaku**, sipas rasteve kishte të emnuem edhe **trimbasplaku**, i cili ishte i armatosur, pastaj kishte **mengues** (ai që mbante mend mirë se çka vendosej në kuvende pajtimesh, kishte edhe **dorëzanë** e dorëzani si dhe **ndihmës-pleqnarë** e **betarë** (dëshmitarë me be).

Kështu Baba njihte punë. Edhe pse nuk përjashtohej ndonjë rast ai përgjithësisht nuk e vazhdon atë *mjeshtri*, madje as në "*islihat*" (1941-1944) nuk dallohet, duke u arsyetue edhe me faktin se, siç e kishte thënë edhe Babaplaku: *Ai që kryen punën e pleqnarit duhen me pasë, së pari grazhdin e fortë*, grazhdi i fortë të bën *oda sajbi*. Madje përveç *grazhdit të fortë e oda sajbi pleqnari lyp me pasë argatëpune për me pasë hamarin plot*, se hamari plot ta hijeshon *sofrën e odës*, dhe së fundi *pleqnari duhet me pasë edhe shpinën e fortë*, d.m.th. me pasë përkrahje nga ndonjë forcë

mbështetëse qeveritare që tashmë të gjitha këto kushte ky nuk e kishte ose ishin të diskutueshme.

Sidoqoftë, siç tregonte im atë, edhe Babaplaku për kohën e vet, dhe pse kishte fituar famë, mbase edhe njëfarë kulti të gjitha këto parakushte nuk i ka pasur aq të plota, po megjithatë ka mundur me veprue me sukses, mbase edhe nga ndonjë ndihmë sihyjnore(!), ngase edhe në atë drejtim ka qenë i sugjestinuar. Pikërisht lidhur me këtë Babës i paska pasë treguar që si i ri kishte përjetuar diçka të tillë spirituoze... Kështu, njëherë në të kthyer nga Tetova, ku pasi ndalet me pushue diku afër Gurit të Dellocit, dhe pasi freskohet me ujë kroni, shtrihet paksa, duke pasur ndërmend dëshirën, si i ri 17-18 vjeçar, se si me gjetë rast me u dallue si luftëtar dhe të bëjë aso trimnie që të mundet me e rrokë edhe kënga, atëherë... aty befaz i përftohet një plak me mjekër e me xhybe të bardhë, pas një bisede me të ai farë Plaku i paska thënë:

Ti, tek je djalë i mirë e për me u bë burrë i mirë veç edhe njëherë mundesh me marrë pushkë në dorë e kurrmë, sepse fjalët e mendjen e paske jo për pushkë me vra, por fjalë me pajtue gjinen, sepse nuk ka ma se vap se me i pshtue gjinen nga ngatërresat e belatë e vjetra e të reja...

Pas këtyre fjalëve ai farë Plaku largohet, ndoshta ishte *Hazreti Hid(h)ri (!)*, i cili herë-herë edhe mbasandej iu paska shpifur në andërr. Sidoqoftë, Babaplaku edhe më përpara ka marrë pjesë në pajtime, por këto fjalë të atij Plaku, qenë shumë mbresëlënëse e detyruese. Dhe vërtet Babaplaku, veç edhe njëherë e paska pasë përdorë pushkën në Luftën për Plavë e Guci (dimër 1879-1880) si prajatar i një grupi vullnetarësh, ku i vritet kushërini Abazi dhe një kushëri fisi i Kadojve të Bukoshit e ndonjë tjetër. Në atë luftë tek asht njoftë me shumë shokë, por edhe me një shkodran me të cilin kishte lidhë shokni. Shkodranit ndër të tjera i kishte pëlqye shumë Babaplaku, kur në një rast ndërsa qëndronin përballë dhe pritej një sulm nga malazezët, në pyetjen:

- O Mehmet Reçani, a ke kenë ndonjëherë më në siklet se tash kur t'u vranë dy njerëz të afërt dhe mund të vritesh edhe ti?

Mehmet e kishte dhënë, këtë përgjigje:

-Po, kam kenë më në zor njëherë në Bjeshkë të Bukoshit, kur më zuni një furtunë, ma hoq prej vendit derën e stanishtes, ku e kisha gruen me fëmijë e ma shkymi edhe zjarmin. Në ato raste, më shkoj mendja se nuk isha i zoti me ruejtë prej ujqve as gjanë e gjallë as grue e fëmijë, se këtu

deka ka hije në luftë burrë me burrë, siç u ndodhi Kadollit dhe Abazit tem që ranë shehidë për vatan...

Kështu, pas pushimit të asaj lufte, para se të ndaheshin me Shkodranin në shenjë mos-harrimi i ndërrojnë pushkat. Ky ia jep pushkë-perzenianen dhe e merr prej tij pushkë-shkodranen, të cilën, siç tregonte baba, Babaplaku e mbante në odë *për antikë*, por kur është kthyer Baba nga ekzili nuk e ka pa më atë pushkë. Nuk dinte se çfarë ka ndodhur me të.

Sidoqoftë, është e vërtetë se Babaplaku pas Plavë e Gucisë nuk ka marrë pushkë në dore, por është marrë me Pleqni (pajtime ngatërresash e gjaqesh), por njëherazi nuk ka harruar me dhënë ndihmesën e tij për harmoninë ndërfamiljare e ndërfaqinjësore dhe të krejt katundit (shqiptarë e shkie), por është marrë edhe me punë e të bëma të tjera të jashtme, për të cilat, sipas tregimit të Babës, do të bëjmë fjalë në vijim, duke shprehur së pari, disa nga të bëmat e Babaplakut me jehonë të brendshme dhe së dyti, për ato me jehonë edhe të jashtme.

a) Të bëma e veprime me jehonë të brendshme, familje e fshat

Kështu, për me i hecë fjala dhe me riejtë autoritetin në punët brenda familjes, të mahallës Veselaj, po edhe të katundit e më gjerë ai ka vepruar, si vijon:

E para, edhe pse kishte çobanët e vet, ai loparit të fshatit i paguante hakun si të tjerët, ashtu vepronte edhe për ruajtësin e fushës, të vneshtave, bostanishtave etj.

E dyta, miqt (edhe ata me lidhje martesore), qoftë të mahallës, qoftë të mbarë fshatit edhe ata ortodoksë i konsideronte dhe nderonte si miqt të vet, jo vetëm me fjalë, por edhe me të bëma respekti.

E treta, oda e tij, për hir të përshtatshmërisë që kishte, përdorej si vendtubimi i të gjithë katundësve, sidomos gjatë ceremonive të darsmave e të të pameve.

E katërta, jo vetëm shtegtarët e rastit gjenin konak në odën e tij, por aq më tepër, edhe njerëzit zyrtarë, pushtetarë e fetarë të të gjitha feve e tarikateve.

E pesta, obligimet e familjarëve të mahallës, por edhe të katundit në raport me shtetin e zotnitë (qifligarët) i dorëzanonte me afatëzime që të jenë sa më të arsyeshme dhe pa pasoja.

E gjashta, Bajram e Bozhiq, po edhe Pashkë ndër shokë të fisit, si dhe në gazmende, darka e dreka, nuk bënte dallime. Në raste të tilla i priste, por edhe i vizitonte, duke i nderuar shpi për shpi, ose në odat e tyre, madje i vizitonte edhe nanat e mahallës, zojat burrneshat të familjeve përkatëse.

E shtata, vërtet, jo vetëm ai por krejt familja e gjerë dhe pothuaj tërë fshati, mikun e ka nderue si mik, kumarën si kumar, jaranin si jaran, dajën si dajë, kushëririn e fisit si kushëri fisi (pa dallim feje), po edhe pushtetarin si pushtetar.

E teta, gjithsesi, edhe pse ishte koha e Turqisë, marrëdhëniet me familjet ortodokse asnjëherë nuk i ka lënë pasdore, madje edhe ka ndihmuar ntrashjen e miqësisë me ta edhe me bekimin e tij. Është fjala për një ngjarje me shumë rëndësi për kohën dhe familjen tonë. Në të vërtetë, gjatë bashkëjetesës fqinjësore një vajzë e familjes së *Mitrajve e quajtur Llatinka (Tinka)* për "*fajin*" që kishin bërë me Abazin, *djalë të familjes Veselaj, i bien në dorë Babaplakut dhe ky bashkë me Mitrin e bën punën për me u bekue martesat e tyre...* Mos me zgjatë, Nga ai bashkim **Tinka** (e konvertuar): **Nifa/Abazi**, lind **Dauti**. Fatkeqësisht Abazi, vdes në luftë, duke e lënë nusen me fëmijë të vogël, Mehmeti, në marrëveshje me krushkun, *nusen* e kushëririn me fëmijë e merr nën mbrojtje, duke ia dorëzuar për *përkujdesje* si grua) djalit të vet **Ukës**. Tani nga bashkimi **Nifa(Tinka)/Uka** u linden për t'u përmendur dy djem: **Mustafa** dhe **Muharremi**. Kjo grua-nënë që vërtet dallohej si e vyeshme dhe shumë mençme, siç tregonte halla Shiqeri, të cilën si vajzë të burrit, **Nana e Madhe** e merrte me vete, pothuaj kudo, edhe kur shkonte në gjini, ku gjithsesi edhe atje respektohej si *Bijë e Madhe, Motër e Nderuar*, nga kunatat quhej *Jenxha Hanifa...*

Sido që të ketë qenë, Babaplaku, duke pranuar e bekuar këtë ndërlidhje krushqie dhe më pas me mirëmbajtje miqësie, sigurisht ka ndikuar që marrëdhëniet ortodokse/muslimane ndërfamiljare të trashëgohen, përkatësisht të jenë të shkëlqyeshme që nga ajo kohë deri në Luftën e fundit, e cila rezultoi pa fajin e tyre me humbje fatale nga të dyja palët.

E nënta, është e vërtetë se Mehmet Reçani, siç thonë, si musliman, ishte i pari që praktikoi me marrë-hoxhë për ramazan në fshat dhe teravitë në mungesë mesxhideje faleshin në odën e tij. Madje, në atë kohë dy djem të familjes Veselaj kishin ndjekur dhe kryer medresen në Prizren. I pari Mulla Murseli, i cili për arsye politike, sidomos rreth kundërshtimit me

forcë rreth tentimit të përvetësimit të varr-muranës si kishë nga *kaurrët serbë të nxitur nga Bogosllovia* e Prizrenit, detyrohet me u largue me 1912, së pari në Bagdad e së andejmi në Kairo të Egjiptit, ku edhe ka ndërruar jetë. I dyti, Mulla Mustafa, mixha im, si medresist, si i ri, ka pasur disa polemika interesante me Babaplakun, nuk ishte si temë vetëm kërkesa që rakia të hiqej nga sofrë, por edhe ca kërkesa të tjera, ngase si duket Babaplaku ka qenë i prekur paksa nga bektashizmi, andaj ishte shumë më liberal, se medresisti i Nysret Efendisë nga Prizreni, por kjo çështje meriton të trajtohet më gjerësisht në tjetër vend.

Së fundi, lidhur me të bëmat e tij me jehonë të brendshme në familje e fshat së fundi vetëm po konstatojmë. siç thuhet, që në saje të autoritetit të Babaplakut edhe jeta jashtë- e ndërfitare mes muslimanësh dhe ortodoksësh të fshatit ishte relativisht shumë e qetë. Kjo ka vazhduar edhe në vijimsi, jo vetëm mes dy familjeve ish-krushke, por në tërë fshatin pa marrë parasysh dallimet fetare dhe si e tillë parimisht ka vazhduar respektivisht edhe me fshatra të tjerë deri në ditët tona, ngase kurrë nuk ka pasur përçarje e ngatërresa të mëdha mes tyre, edhe pse që nga Lufta e ashtuquajtur Serbo-Turke 1877-78, përkatësisht nga Lidhja e Prizrenit 1878, pasojat i ka ndjerë edhe fshati ynë, ashtu si fshatrat e tjerë të Kosovës e më gjerë.

b) Veprimtari, me vlerë me jehonë të jashtme shoqërore

Si veprime apo të bëma nën influencën e autoritetit të Mehmet Reçanit me vlerë të veçantë, pa hyrë në ndërmarrje luftarake, por vetëm nga ajo shoqërore humanitare për me u mbajtë mend, po i spikas vetëm disa:

1) Kur mbërrinjë muhaxheria e parë të dëbuar nga Serbia (1877-1878) në fshatin tonë Babaplaku, kërkon që ata të pranohen si vëllezër, madje pas ndihmës së parë të menjëhershme me ushqime, ku merr pjesë pothuaj tërë fshati sipas mundësive (muslimanë e ortodoksë), ky (Mehmeti), siç thoshte baci Beqë Zeneli : *Hap grykat e koshave të kallamoqit për ta dhe garanton me i qitë në shëngjergj*, por ndërkohë, dikush prej tyre kishte lëvizur në fshatra të tjerë, ndërsa aty kishin mbetur vetëm disa të sëmurë, të cilët, mjerisht, siç tregohet, pothuajse të gjithë ose shumica prej tyre kishin vdekur, sapo pinin ose hanin diçka. Kështu, qoftë nga sëmundja, qoftë nga lodhja e mërzia, si kujtim për ta ka mbetur vetëm

toponimi Vorret e Muhaxherëve dhe ende ndonjë gurëvarri si gjurmë, pikërisht në zabelin afër shtëpisë sonë të sotme.

2) Sa e si i ka nderuar adetet ose ligjet e trashëguara të vendit, pa dallim feje, siç ishte edhe **e pamja**, tregonte im atë për një rast, ku kishte qenë prezent dhe ai. Diku në një fshat jo aq të njohur të Rrafshit të Kosovës, duke kaluar Babaplaku vëren se ishte hapur një e pame, ky papandehur ndalet me tërë bashkëshoqëruesit për kryeshëndoshë. Dhe pasi përshëndet me **Koftë mirë!** dhe njihet për rastin, prezantohet kush ishte dhe me kë ishte ua shëndodh kryet (shpreh ngushllimin) edhe në emër të shoqëruesve. Natyrisht si mësues i mirë i traditës popullore, pas lejes nga e zoti i konakut, në mënyrë të veçantë thekson faktin që në përhajrime dhe në varrime e në të pame nuk është si në darka e zifafete të ftuarish, ngase në rastet e tilla, pa marrë parasysh fenë, qoftë në urime qoftë në ngushëllime, është e njerëzishme dhe detyrë me marrë pjesë edhe pa u njoftë më përpara, ashtu siç u veprua këtë rast.

3) Madje edhe në raste të fatkeqësie, nga zjarri, uji, shteti (bastisje, burgosje) e raste të ngjyshme, kushdo qoftë, katolik, musliman apo ortodoks, sipas Babaplakut edhe pa u kërkua, duke shprehur keqardhje duhet ofruar ndihmë sipas mundësisë.

4) Këshillonte që mos të keqpëdoret autoriteti i kujtdoqoftë edhe i tij, nga miqtë, katundësit apo edhe djemtë e tij dhe, si shembull si një pikë të zezë, merrte Zenelin, djalin e vet dhe fqinjin e parë të së njëjtës moshë Rrahmanin, të cilët pas një faji të madh që kishin bërë me shkeljen e një besëpaqeje, kishin pas ikur dikah, duke ia lënë belanë në derë Babaplakut për ta zgjidhur. Ndërkohë derisa edhe për këtë *gverrë* arrihet njëfarë mbarimi mes pleqsh, por gjithsesi në dëm të autoritetit të Babaplakut, të dy të ikurit ende ishin në arrati. Meqë në atë periudhë në Kosovë paska pasur një farë "*hallakame*" *politiko-ushtarake*, të dy këta të ikur si të dyshimtë diku në rrethinë të Prishtinës i paska burgosur ushtria e kryesuar nga Shaban Binaku. Kur merren në pyetje, këta tregojnë se kush janë: ishin djem të Mehmet Reçanit dhe si të rinj paskan ardhur *me lypë nga një pushkë- martinë*. Shaban Binaku, si bashkëpleqnar i Babaplakut, dhe si kushëri fisi, u beson, u jep nga një pushkë dhe i përcjell me të fala për Mehmet Pleqnarin. Sidoqoftë, edhe pse qe arritur pajtimi që kishte lejuar kthimin e tyre, kaq e kishte vrarë plakun ajo besëpaqshkeljeje, saqë sa herë falte namaz, ngase lutej vetëm me fjalë shqipe, veç tjerash shqiptonte me zë: *Ruejna Zot prej shejtanit, prej Zenelit e prej Rrahmanit*, shprehje kjo që edhe sot ceket si slogan në stilin përkatës te ne.

5) Pleqnarët e rinj dhe këdo i këshillonte që të gjykojnë drejt dhe të flasim me fjalë petake e jo rumbullake, pra të gjykojnë pa ryshfete, pa dredhi e gënjeshttra.

6) Edhe pse Babaplaku i ka ikur politikës shtetërore, grindjeve të politikanëve, ngase me pajtue kren të politikës është si *me pajtue* grenza me anza, që s'kanë besë. Prej tyre në vend të faleminderes ka vetëm thumbime, ndërsa ky ishte i përgatitur *me pajtue* bletë (vegjëlinë). Madje edhe te këta (vegjëlia) ndonjë grindavec mundet me pasë pakënaqësi (kundërshti) ndaj vendimit të **pleqnisë** a **pleqnarit** të caktuar, po ai duhet me dijtë se me thumbue të drejtën e tillë, ashtë si bleta që kur thumbon e lë thinin po e lë edhe jetën, andaj kërkonte vetëm respektim ndaj vendimeve të *Pleqnisë*. Fundja sipas tij, gjithnjë si dëmshpërblim bleta lë *mjaltën, ashtu edhe pleqnia që lë paqen, apo pajtimi i pleqve që sjell mbarim* është e ëmbël dhe shëruese si mjalta, apo jo?!

7) Megjithatë Babaplaku ka pranuar për konsultim edhe krenë fisesh e njerëz të politikës. Kështu pas një bisedë-konsultimi me një pashë, Babaplaku shprehet që ishte kundër bandave jo vetëm atyre sllave (bullgare e serbe) e junane (greke), por edhe kundër atyre shqiptare, ngase sipas mendimit të tij lufta për vatan kurrë nuk fitohet me komitë bashibuzukë, por fitohet e mbrohet duke u ndihmuar e përkrahur nga shteti me **grazhd të fortë** (ekonomia) e nga **shpina e fortë**, përkrahje shtetesh të njohura. Pasi atbotë asnjë shtet nga Europa *me grazhdë e me shpinë të fortë* nuk i mbronte dhe as i përkrahte shqiptarët të fitojnë mëvetësinë, Babaplaku e shihte shpëtimin në lejimin e një autonomie nga **Turqia**, e cila kishte ushtri të rregullt të prirë nga zabitë të aftë, andaj kërkonte marrëveshje e paqe me të. Një mendim i tillë i pëlqen pashës, andaj në shenjë respekti dhe ndoshta me qëllim përvetësimi të mëtejshëm propagandisht, Babaplakut ia dhuron një gëzof pashe. Por kur Babaplaku i thotë se ky qyrk s'është për mue po për ty që je pashë. Ai i përgjigjet: **Unë jam pashë i Davletit, ti je më me peshë se unë, je Pasha i Miletit!**

8) Po e shënoj edhe këtë të bame të Babaplakut, që edhe baba e kishte të *ndime* nga të tjerët, ngase atëherë ishte komit e pastaj muhaxher në Malësi e Shkodër. Thuhet se kur vjen *Serpi i pare* (1912) një përfaqësues i Kraljit të Serbisë e paska vizituar Mehmet Reçanin dhe i propozon në emër të Kralit me pranue me i lidhë ndihmë materiale në mënyrë që ai si njeri i mençur me autoritet të ndikojë që të dorëzohen kaçakët (shqiptarë), ngase çdo rezistencë tanimë ishte e kotë, sepse Serbia kishte treguar se ishte shumë e fortë. Ushtria e saj e kishte mujtë Turqinë,

duke e bërë të veten jo vetëm Kosovën, por edhe Malin e Zi, Maqedoninë, madje edhe Shqipninë, të cilën e kishte në grusht... Mehmeti i përgjigjet:

Paret ktheja Kralit se i duhen, sepse mesa mora vesh paskët korrë shumë po i hala i paskët dorëzat pa i ba duej, sepse nuk i dihet motit, një frymë sado e vogël mundet me i shkapëderdhë ato e nuk asht kollaj me i ba punë e pale me i fshi e me ba bukë!? Paret i duhen për argatë, se Ju këto të korra ndoshta nuk i keni ba vetë po edhe me argatë të huej...?! Argati i huaj pa sofër të majme mundet me Ju lanë në lloç?!...

Thonë që kinse Krali kah ka ikur për Shqipni, nga Duhla (fshat afër tonit ku paska bujtur më 1915 i çon përshëndetje plakut të mençëm, fjala e të cilit i paska dalë, sepse jo vetëm dorëzat, po edhe vetë ka mbetë në lloç dhe po ka zor me shpëtue kryet prej furtunës...

Sido që të ketë qenë, ndërkohë, kur kthehet *Serpi i dytë* (1918), duke falenderuar **grazhdin** e **shpinën e fortë** të Francës, Anglisë e të Ruisë etj., të cilat e bëjnë dhe sofrën e interesit plot, përsëri vjen një i deleguar nga Mbreti i Serbisë (tash i Jugosllavisë) me pa Babagjyshin, por ai disa ditë më parë në moshën 92 vjeçare e kishte lënë këtë jetë.

Thuhet se edhe gjatë kësaj sëmundje të fundit të pleqërisë, dergjën e ka krye në odë, ku priste edhe musafirë dhe lajme. Ishte koha e Bullgarisë. Herë pas herë kur nuk kishte vizitues paska gjëmuar dhe i thonë këta të shpisë:

-Mos gjëmo Babaplak, se na ke mësue që burrat e fortë nuk gjëmojnë.

Ai përgjigjet.

Mos me më dhimbtë nuk gjëmoj, po kam dhimbtë të madhe e gjama po ma leton pak.

Në ato kohë i vjen nipi Mulla Mustafa që ishte i burgosur nga Bullgarët. Babaplaku gëzohet shumë që kish kapitullur Bullgaria, andaj shprehet:

Tash nuk do të gjëmoj se më erdhi një ilaç i fortë që po ma pushon dhimbjen!...

Mirëpo, kur i thanë se Serpi po kthehet, u dëshprua shumë dhe para se të ndahej nga kjo jetë, kishte folë këto fjalë:

Oha!... Në këtë jetë: çka e deshta nuk më dashti, çka s'e dashta më dashti!

Dhe vërtet mesazhi i këtyre fjalëve mund zërthehet kështu: Ai deshti së paku *Autonomi* nga Turqia, po ajo me kohë: nuk **deshti**... Nuk e **deshti Serbinë**, po **ajo e deshti**!...

Dhe vërtet Serbia (Jugosllavia) vetëm në saje të shpinës së fortë të Rusisë e të Europës, ato dorëza të shkapërderdhura i mblodhi dhe i përmbodhi, madje edhe i bëri për njëfarë buke të përllotë që e hëngri me dy Jugosllavi e gjysmë, sepse kur edhe kolonia: *Kosovë e Metohi* i doli nga dora, mbeti edhe pa atë brumë buke, pa të cilin nuk po mund ta qetësojë barkun e vet imperialist kolonialist, sepse **Kosova** u çlirua dhe e mëvetësua më 1999, duke e pasur përkrahjen nga **shpina e fortë** të vendeve mike: si SHBA dhe të shteteve të Europës demokratike me argatin e pathyeshëm NATO dhe me Luftën e shenjtë të luftëtarëve të UÇK-së.

Përmenden edhe shumë raste të tjera mendjemprehtësie e pleqnie të Mehmet Reçanit që fliten në popull, por ato meritojnë të mblidhen dhe të trajtohen në studime të veçanta nga ekspertët përkatës.

NËNKREU IV PAQARTËSI E SERBO-DHUNË RRETH PËRVETËSIMIT TË VARR-MURANËS SIPERMENDORE TË FSHATIT NË KISHË SERBE

E thamë në fillim se Reçani i vjetër, mesa dihet, zinte meskëndin e takimit të dy ujnave të dy silumejve aty ku gjendet edhe sot shumica e lagjes së Veselajve dhe ku gjendeshin para luftës së fundit edhe dy familjet ortodokse Mitri e Sima, por edhe disa të tjerë, duke e pasur përpara Gjinovishten. Ç'është e vërteta, vendpuqja e dy silumenjve (rekave) karakterizohej në shekujt e kaluar, me Plepat e Mëdhenj të Reçanit si dhe me Livadhin e Plepave para tyre, ku thonë se janë mbajtur takime dhe mezlishte pleqnish e tubime popullore, sidomos për Ditë të Shëngjegjit, Në të vërtetë, ngjit me Plepat mbiudhë ishte një zabel me lisa të mëdhenj, me mija e mija vjet moshë dhe në këtë mal-zabel jo fort larg rruge sipas një legjende ishte një varr i hapur, atëherë e sot i mbetur bosh. Konsiderohej dhe respektohej si një varr shenjtori, i cili here-pas here, vizitohej nga pelegrinë të fshatrave për-rreth e më gjerë përveç ditës së Shëngjegjit, edhe ditëve të tjera, ku lënin përshpirtje (nejzra). madje në të kaluaren bëhej edhe ndonjë flijim, mbaj mend edhe ndonjë pulë, mirëpo, siç tregonte kumara Nikollë, më përpara në atë vend, që tash u ba kishë, janë pre kurbana dhe mishi u është shpërnda fukarave. Lidhur me këtë vend kulti (varr-muranë) tregohet një gojzhanë, e cila ishte e njohur në

fshat e mbase edhe më gjerë, po sidomos në familjen tonë, të cilën tash fill po e parafrazoj ashtu siç ma pati treguar im atë.

a) Gojëdhana rreth Kenotafit ose Vorr-Muranës bosh te Lisat e Mëdhenj

Sipas Babës: “Gjoja kur **Dija** prej detit, me anije nëpërmjet Bunës, që në atë kohë paska qenë e lundrueshme, paska zbarkue në Shkodër Shkodra ka ndalë aqsa ka dashtë **Dije** për vete, tjetrën e ka shpërnda me zogj **shkodranë në Malësi e në katër anë**. Kështu njëfarë Gjergji bashkë me do shokë **Dijen** e paska sjellë prej Shkodre drejtpërdrejt në Gjakovë. Për ata ka mbetë: Gjakova si krah i Shkodrës. Prej Gjakove ai farë Gjergji me shokë asht nisë për me shpërnda dije drejt Shkupit. Rrugës tek asht ndalë me bujtë në Reçan, në katundin tonë. Këtu aq mirë i paska pasë pritë oda e katundit dhe aq shumë i paska pasë pëlqye vendi e muhabeti, saqë Gjergji i përcjell shokët tutje e vet ndalet me rrnue këtu. Këtu edhe paska dhanë **dije edhe të odës – fjalë burrash**, edhe mësim **të gjallnisë –për punë bujqësie e blegtorie**. Dhe në këtë mënyrë edhe më mbarë seç kishte qenë ishte kthye katundi. Së këndejmi Reçani bahet shembull për katunde të tjera, Si rrjedhojë, në vazhdimësi ky katund për besë e mikpritje asht përmendë në këtë Rrethbjeshe e Anadri (Podrimje). Gjergji, siç thuhej, shpesh paska pasë shkue kah Plepat në fund të katundit. Atje qenka ndalë tue shikue vorbullën ku bashkoheshin ujnat e dy silumejve, dhe pastaj Ai paska kaluar te Lisat e Mëdhenj, ku ka qëndrue më gjatë dhe aty paska meditue e meditue... Ndërkohë, kur u plak, thërret krentë e katundit dhe u lë këto pesë mësim- amanete:

E para, me pasë kujdes që në odë burrash me ditë me u sjellë se je nën sundin e të Zotit të asaj Ode,

së pari, duhet me përshëndetë si duhet me “koftë mirë”!, së dyti, e mos me u ungjë në vend të huej po aty ku të thotë i zoti i konakut, së treti, mos me u ngutë e me folë pa rend, së katërti, me folë me mend, po edhe me dijtë me u ndalë, së pesti, me dijtë kohën me kërkue izën për me u çue dhe së gjashti, në të dalë me dijtë me thënë tumirëmbecen.

E dyta, puna (bujqësore) që bëhet sot, kurrë mos me u lanë për nesër. Për me punue tokën duhet me gjetë ndërmjetëzen ndaj të thatit e të lagtit,

E treta, gjanë e gjallë (kafshë e shpendi) gjithmonë me i pasë parasysht, me i respektue si njerëzit e shpisë: me i dashtë, e me i ushqye, sepse pa to nuk mbahet shpia.

E katërta, me shfrytëzue kohën e pushimit tue u argëtue me fjalë e me lojna dhe

E pesta, lyp që te lisat e mëdhej Atij me ia çelë vorrin për së gjalli.

Katundi, sipas porosisë, edhe pse jo aq me qejf, pa vonue shumë ia çelin vorrin. Por!..., Për çudi, Gjergji, atëherë, tretet dikah. Prit e prit se po kthehej, ai nuk kthehej! Vorri kishte mbetun hapun...

Ndërkohë, kryeplakut të katundit iu paska përftue Gjergji në andërr dhe ia paska përsëritë katër këshillat e para si amanet, për vorr kurrnji fjalë. Atëherë katundi e besojnë se paska pasë qenë njeri i shenjtë (evlija), dhe atë vorr për mos me rredhë dheu e rrethojnë me gurë përsëmbrendshmi, pastaj, e bëjnë sivarrosh, si njëfarë sityrbe dhe ia zbukurojnë ballinën me yllëza, fleta-fleta e therça-therça.dhe te kryet vorrit ia lane çelë një sidritare...

Kjo ishte gojëdhëna, për vorrin cenotaf të Gjergjit e mbetur si legjendë që unë e kam kuptuar atëherë edhe sot vërtet si fjalëmbasdarket(!).

Po sidoqoftë, thuhet që reçanasit e vjetër e deri tek Mehmet Reçani nuk janë dalluar aq si luftëtarë, por si dashamirë të dijes e si llaftarë, ngase janë përpjekun që katër-pesë mësim-amanetet e para të Gjergjit me i zbatue dhe për këtë kanë pasun sukses të plotë:

E para, gjithmonë, në oda e kudo i kanë ditë me u sjellë, kanë ditë me folë, por edhe me ndëgjue, fjalët i kanë matë para se me i thënë, bile nganjëherë i kanë tjerrë e përtjerrë pak tepër hollë;

E dyta, ndaheshin në shenjë si punëmirë e si gjallnikë, madje edhe si odasajbi, dalloheshin për mikpritje e bujari;

E treta, edhe më të njohur kanë qenë për bylyqe bagtisë e majmërinë e tyre bile edhe në Bjeshkë të Bukoshit i kanë pasë stanet e tyre dhe E katërta edhe më shumë kanë qenë të njohur për shaka, këngë e lojna në kohë ndejash...

Por, këta të tashtit, kur shumë ujna kanë kaluar lumit për në Dri e det, kur janë përtri shumë pranvera, janë hanger shumë shëngjergja, nuk u dihet, sa përpiqen edhe më në atë drejtim... Por një gjë dihet që sa për fjalë e për punë gjallnie, në mos qëndroshin më mirë, aspak nuk qëndrojnë më keq se të tjerët, ndërkaq sa u përket kangëve, lojname e humorit, nuk di, sa vetë

ata e kanë lënë Lojën e Shëngjergjit apo *Loja e Shëngjergjit i ka lënë ata?! Le të vlerësohet.*

b) Reagimi fshatit kundër tentativës për ta konvertuar këtë sivarrosh (kenotaf) në kishë pravosllave

Sidoqoftë, lidhur me këtë kult-sipërmendore pelegrinazhi tregohet se kah fillimi i shek. 20 mbi atë vorr-muranë, dikush nga shkitë të porosur nga Bogosllavia e Prizrenit ndoshta me leje të pushtetit turk, kishte paguar e dërguar *gogë* për me ngritë mbi të një *kishë serbe* dhe kishin lypë prej katundit bashkëpunim, për me u ndihmue: me bukë, me i furnizue me gurë, zallë, lëndë drusore etj. Krejt katundi paskan kundërshtuar me forcë dhe lidhin “*sull*” jo vetëm mos me i ndihmue, por edhe me i pengue, *me i përzanë* (bojkotue) *gogët*, sepse aty, sipas tyre, kurrë nuk ka pasë kishë serbe, sepse ai vorr nuk kishte pasë as kryqa, as eshtna, por ishte një varr shumë i vjetër i një njeriu që ka pasë emnin Gjergj dhe për hir të atij emri janë luajtur aty Lojnat e Shëngjergjit vit për vit (!). Pra, ishte një vorr-muranë me mure të trasha, dhe me një sidritare dhe në ballë kishte vija gjetore e rrumbullake si shenjë yllzash (diejsh). Ishte një Varr-Muranë ose sivarrosh, i cili pëtrihej shëngjegj për shëngjergj edhe me lojna populllore, edhe pse ka pasur ide që ai sivarrosh të pagëzohet si tyrbe e Hazreti Hid(h)rit, megjithatë me forcimin e islamit gjithnjë e më shumë lojnat ishin pakuar e harruar(?!). Madje nga Mulla Murseli, hoxhë i ri i Veselajve kundërshtimi ishte edhe më i vendosur, kërkonte që katundi të jetë edhe më energjik. Po nëse duhet prekur ai vend më mirë me u ndërtue mesxhide-xhami, por assesi kishë. Mirëpo kjo ndërmartje rreth konvertimit të Kenotafit (varrmuranës) në kishë serbe nuk ndalet me kaq. Është interesant se ortodoksët (serbët) ardhacakë të fshatit nuk ishin *përzier* fare rreth kësaj çështjeje, madje as pronari Ukë Mehmeti, ngase ngjarja kishte të bënte jo me pronën, po vetëm me varr-muranën, por puna shkon deri atje, saqë një *kapadai*, i katundas joserb, tregon mendjemadhësi, thyen vendimin e fshatit: pranon kryenvete *me i ndihmue gogët*, duke u ofruar gogëve gurë, ushqim etj. Atëherë këtë besëshkelje, katundi e dënon. Besëthyesi vritet katundisht. Kështu pas kësaj ngjarjeje tragjike gogët ikin pa krye punë. Por, sipas *Pleqnisë së Babaplakut*, edhe pse kapadaiu ishte gabimtar i pafalashëm, katundisht i paguhet gjaku i plotë, ku sipas rregullit hisen e vet të pagesës e heq edhe sivëllai i të ndjerit, të cilit edhe i dorëzohet shuma e plotë e pagesës.

Kështu mbyllet çështja e gjakut, por çështja e varr-pas viteve 1912, përkatësisht 1918.

c) Okupimi i Kosovës (1912, 1918) konvertimi i muranës si kishëz serbe më 1926, rindërtimi më 1960 dhe evidentimi si monument historik nën mbrojtjen e shtetit serb më 1990

Si e thamë më sipër çështja e varr-muranës u hesht përkohësisht, por pas luftave okupuese pa u pyetur as fshati as pronari më 1926, në kohë të diktaturës së Kravevinës Jugosllave një pjesë e murit të dëmtuar të Muranës iu adaptua dhe kështu mori formën e një sikishëze, ndërkaq, vetëm pas LDB në vitin 1960 në Jugosllavinë e tito-rankoviçizmit, kompletohet si kishë, e cila, në serbisht merr emrin: **“Crkvica Sveti Gjorgje”** /Kishëza Gjergji i Shenjtë.

Kështu në *Mala Enciklopedija Prosveta* 3, Beograd 1978, f. 59, lexojmë:

Reçani - Selo na putu Priština – Prizren, kod Suve Reke, ima crkvica sv. Djordje,

koju u XIV veku podigao nepoznati srpski vlastelin, i u kojoj ima očuvanih fresaka.

/Reçani -Fshat në rrugën Prishtinë –Prizren, te Suhareka, është kishëza Shën Gjergji,

të cilën në shek XIV e ka ngritur një bujar i panjohur serb, në të cilën ka freska të ruajtura.

Ndërkaq në *Vokopedija* të ditëve tona në serbisht, veç tjerash për këtë monument lexojmë:

Crkva Svetog Djordja u selo Rećane kod Suve Reke, severno-istočno od Prizrena, je zadužbina nepoznatog srpskog vojvode...

/Kisha Shën Gjergji në fshatin Reçan te Suhareka, në veri-lindje të Prizrenit, është vepër përshpirtnie e një fisniku (vojvode) të panjohur serb.../

Siç po shihet janë dy variante me ndryshime të vogla stili: *kishëza* u bë **kishë** dhe *vlastelini* u bë **vojvodë**, po kryesore aktori mbetet në të dyja variantet, gjithsesi **serb i panjohur**. Për ne del indikativ emërtimi **vojvodë serb (!)**, atribut ky që me të drejtë del i diskutueshëm, për disa arsye që do të cekem më poshtë, po sidoqoftë, ky tempull sivarrosh u serbizua me emrin kishëz pas LPB në vitin 1926, madje u ngrit si tempull i ri *kishë* në vitin 1960, kur iu bë gjoja konzervimi i freskave vizatimeve e pikturave

murale të brendshme të ikonografisë të shek. XIV që duhet t'i kishte pasur dhe si e tillë e kompletuar si kishë u vu nën përkujdesje të shtetit serb, vetëm në vitin 1990, kur u pa se filluan me i luejtë themelet atij shteti kolonialist në Kosovë, apo jo?! Pra, edhe kjo kishë bë pjesë ndër 53 kishat politike të ndërtuara në shek. XX në Kosovën e okupuar të shënuara si duket të sjellë nga harresa për të parën herë në regjistrin zyrtar të sajuar nga ipeshkvi Artemije i Prizrenit. (Shih Enver Rexha, Revistadrini, 9.03.2018). E gjithë kjo punë rreth muranës shihet si përvetësim i një tempulli të vjetër, që lë pas vetes shumë dyshime të ligjshme, apo jo?!

Pa marrë parasysh përvetësimin, pa të drejtë, si monument kishtar serb(!), shprehim keqardhje që gjatë luftës së fundit (1999) nuk ka mundur të mbetet i paprishur deri në themel ky cenotaf, shenjë i vjetër kulti i fshatit tonë dhe përgjithësisht.

ç) Si ndërlidhet vendi (prona) dhe vet kishëza apo kulti i kenotafi me familjen tonë të ngushtë?

Meqë, historia e këtij sitempulli ndërlidhet së fundi, me familjen tonë dhe se unë mbeta si më i moshuari i familjes së **Ukë Mehmetit** (1851 -1923) edhe pse kam qenë krejtësisht i painteresuar, e ndjej obligim të shpreh disa mbamendje mbase tash në dukje të guximshme, lidhur me këtë çështje, ashtu siç i kam dëgjuar, madje edhe përjetuar:

Së pari, siç tregonte im atë, në kohë të Tuqisë, kur Uka djali i madh i gjallë i Mehmetit, i cili kishte pasur ajllëk (rogë) si *suhari* (*kalorës-postier*) i *mbretit* (sulltanit) *Shkup-Shkodër*, u nda nga shtëpia e madhe e **Babaplakut (Mehmet Reçanit)** dhe doli pa hise, pas ca ecejakesh, ai i ndihmuar nga djali Muharrem (*komita*), dhe paratë e veta, në marrëveshje me një zotni, Ahmet Agën nga Prizreni, qenka vendosur në kullën e tij, njëherë si çifçi, duke zëvendësuar çifçiun e mëparshëm ortodoks, i cili paska kaluar në një fshat tjetër Sallagrazhdë dhe Uka me të bijtë Mustafën e Muharremin ndërkohë ia blen krejt hisen e Ahmet Agës, ku asaj hise i paska pasë takuar dhe Livadhi me Plepa të mëdhenj si edhe pylli me Lisa të mëdhenj në fund të katundit, ku ndodhej edhe Vorr-Murana (cenotafi) me kompleksin: lendenën, zabelin per-rreth, pra tërë sipërfaqja Nënudhë e Mbiudhë. Ndërkaq, meqë edhe më tej, si më përpara, siç tregonte baba, vizitohej ky Sivarrosh-Muranë nga besimtarë të ndryshëm, sidomos granimi nga fshatrat për-rreth, ku linin "*nejzra*" ("përshpirtje"), si: ushqime e veshëmbathje, deri edhe vezë e ndonjë pulë (që e prenin aty)

etj., të cilat më përpara i kishte shfrytëzuar ai farë çifqiu, baba tani është përkujdesur që të gjitha ato “**të falne**” t’ua shpërndante të varfërve të fshatit, kryesisht rajës (ortodokse).

Së dyti, sidoqoftë, siç e dinë familjet tona dhe katundi, kur janë nda baba Muharrem me mixhën Mustafë, meqë ai si hoxhë, nuk ka dashur t’i përzihej emri assesi as me kultin (!) pagan të Vorr-Muranës, as me Kishës e diskutueshme kristiane, atëherë tërë **Mbiudhën**, d.m.th., ledinën me zabelin dhe malin me lisa të mëdhenj ku gjendej vendmurana ia ndan hise babës, ndërsa për vete kishte ndalë tërë **Nënu dhën** me Livadhin me Plepa të mëdhenj që sipërfaqësisht ishte pak më e vogël, ngase dëmtohej nga vërshimi i lumit, andaj ka marrë plus një parcelë në Rrezina. Thuhet, që mbase edhe tapia qoftë në emër të Ahmet Agës ose të Ukë Mehmetit, mund të gjendet në Shkup, atëherë qendër vilajeti, po ashtu edhe qendër banovine në Jugosllavinë e Kralit, por atmosfera e derisotme politike ndaj familjes sonë ka qenë e tillë që nuk ka lejuar një ecejake të tillë interesimi rreth asaj pronësie, ngase në Jugosllavinë e Kralit, ishte e hapur kanosja për shpërngulje, ku nuk ishte në pyetje vetëm kjo, por humbja e tërë pasurisë, madje në epokën komuniste ishte aktual kolektivizimi i tokave të fshatarëve, ashtu siç edhe ndodhi deri sa u shpërbë kooperativ e fshatare e katundit Reçan, kur edhe mixha edhe baba nuk ishin më në jetë.

Së treti, si tregonte mixha Nazif Haziri, atëherë djalosh, në kohë të kralit, pak pa u vra prifti i Zymit (Atë Shtjefën Gjeçovi), paska pasë ardhur me kalë të bardhë në katundin tonë. Së pari, ka hulumtuar te Vorret e Llatinëve përmbi fshat, afër *Gurit të Ukit* në rrugën kah Krushica dhe diçka paska futur në duçi nga ato vorre. Kah ashtë kthye, është takue edhe me Bacin Hoxhë (Mulla Mustafën, axhën tonë), kanë folë diçka. Nuk dinte që Prifti i Zymit vetëm apo edhe me Mulla Mustafën ka shkue te kisha, ende e pandërtuar? Së këtejmi, shtrohet pyetja: Çfarë ka ndodhur me ata *shenja* që i ka marrë Atë Shtjefën Gjeçovi, ngase në atë kohë vetëm ai ka pasë njohuri dhe ka mundur të dijë diçka edhe për këtë tempull, uzurpimin e tij nga serbët, apo jo?! Mos, vallë, u vra edhe për shkak të kundërshtimit të tij lidhur me përvetësimin e këtij monumenti pagan ose katolik gjithsesi shqiptar nga kisha e shteti serb, kush e di?!

Së katërti, ndërlidhur me pronësinë e asaj parcele si pronë e Ukë Mehmeti, as që e ka vënë kush në dyshim ndershmërinë e familje sonë, sepse kjo familje nuk ka pasur as lakmi as nevojë me uzurpue pasururinë e huaj, aq më tepër pronë kultu fetar, pagan apo kristian, sepse atë vërtet e kishin blerë nga Ahmet Aga. Madje, pas okupimit më 1912-ës e 1918 nuk

është *shqyrtuar fare kjo çështje as nga kisha e Prizrenit as nga shteti serb as nga ai bullgar*, vetëm më 1926, tri vjet pasi vdes Uka, bëhet njëfarë meremtimi i tempullit në përmasë të vogël, kur sanohen pjesë muri dhe merr formën si një kishëze, Në të vërtetë asnjë herë më parë çështja e pronësisë së këtij vendi nuk është kontestuar, madje as lokacioni i vet tempullit. Por mesa dimë manipulimin dhe përkujdesjen ndaj kishës në periudhën e Kravevinës baba ia ka pasë lënë Kolës së Simës, i cili gëzonte pensionin e luftëtarit nga Fronti i Selanikut.

Së pesti, ndërlidhur po me pikën e mësipërme, gjatë periudhës së Luftës, në të ashtuaquajtën kohë të Shqipnisë 1941-1944, përsëri njëfarë përkujsejeje e patë marrë baba. Edhe pse në këtë kohë kishëza kishte më pak vizitorë, Baba përkujdesej për shpërndarjen e *të falneve* nga përrshpirtjet (nejzrat) dhe pak a shumë edhe ne si fëmijë përkujdeseshëm rreth pastrimit të asaj kishëze, sidomos kur linin ose prenin ndonjë pulë, vendi mbushej buburreca dhe dukeshin edhe qen laskuca. Kjo kishëz, mësa më kujtohet para afro 80 viteve, në ballinë ka pasur disa shenja si yllëza, por në brendi ka pasur dy-tri fotografi që më frikësonin me sy(!).

Së gjashti, që vendi i Kishës, nuk ka qenë i përdhosur e i shfrytëzuar as në kohë të Shqipnisë (gjatë luftës) nga tjetërkush, dëshmoj se unë i kam mrizuar dhentë nën krekëz jashtë kompleksit të kishës, më afër rrugës, ndërsa Dosa i Mitrajve pak më në brendi, po jo afër ishës kenotafe e varreve ortodokse, të cilat, ashtu si edhe varret e muslimanëve aso kohë nuk mirëmbaheshin fare.

Së shtati, pas LDB, për familjet tona u rikthye gjendje edhe me keqe politike se përpara. Tashti, siç flitej edhe u bë. Tërë pasuria jonë e paluajtshme si edhe të tjerëve u kolektivizua me formimin e *Kooperativës fshatare*. Ndërkohë Mulla Mustafa ndërroi jetë më 1948, ndërsa im atë Muharremi më 1951, duke na lënë në kooperativë pa prona të paluajtshme bujqësore. Madje edhe edhe kur u prish “kolektivizimi”, ngase kishim aq tokë pune, sa që nuk mund ta shfrytëzonim në tërësi, edhe pse kurrkush nuk e ka kontestuar pronësinë e familjeve tona te Kisha e rreth saj. Në të vërtetë pas burgosjes tonë që kishim ngapak shkollë, unë mësues e vëllai më i madh (b. Ramë) nëpunës, ajo tokë rreth kishës mbeti djerrë.

Së teti, sa i përket kishës në kohë partizanie përkujdesjen e ka pasë marrë djali i Kolës Zllatani, i cili, edhe si partiash, ka shfryzuar gjithçka rreth kishës, sidomos pjesën Nënudhë te Plepat e mëdhenj, e ka pasë bërë arë, por me familjen tonë ai edhe serbët e tjerë nuk janë sjellë keq.

Së nënti, po shtoj edhe këtë se me ledinën e zabelin jashtë lisave që ka qenë e pashfrytëzuar edhe në kohë të Partizanisë e më vonë, me të, para e pas kolektivizimit, ka manipuluar në njëfarëdore vëllai ynë i madh Smajli që ishte zotshtëpie. E di edhe këtë që në Ledinën e sipërcekur është vendosur në marrëveshje me vëllain tonë një familje shqiptare Sali Papazi, pastaj Ahmeti i Fejzës, e më vonë aty ka jetuar një familje serbe Vasil Sellagrazhda dhe momentalisht, me sa kam parë, tani aty gjendet një shtëpi-gërmadhë.

Së dhjeti, e di edhe këtë se Baci Ramë, vëlla më i madh, nëpunës, jurist i njohur, ka pasë reaguar më fort në vete e me ne, pse njëfarë Trajku i Simës, i shpërngulur (mesa dihet në Vojvodinë) pa na pyetur fare, e pati ngritur një sikalibë-varrosh, në Lëdinën afër Kishës, mirëpo, për të gjitha këto pa kënaqësi, tre vëllezërit e mi më të mëdhenj që banonin në Reçan, moskënaqësinë e mbanin në vete, pa e bërë të madhe, sepse e dinin se pushteti nuk ishte në anën tonë dhe nuk e shihnin të arsyeshme me rrezikue sadokudo mirëqenien e familjes për këtë pasuri, për të cilën nuk ishin në zor aspak as atëherë as deri sot.

Së fundi, po shtoj edhe këtë siç e ceka më herët se Nënudha (Livadhi i Plepave) që i takonte familjes së Mixhës Hoxhë, para se të ndërtohej shkolla shfrytëzohej nga Zllatan Simiqi, pushtetar absolut i fshatit, sekretar i Partisë etj., i cili ka sjellë aty edhe sepse nga fshatra të tjerë (edhe gjatë viteve të '70-a), madje thuhet që ishte përpjekur që atë pronë ta regjistronte si pronë të veten, por s'ka pasur sukses, sepse në vitin 1988, shteti në bazë të propozimit të pop Pavlit nga Prizreni qenka kërkuar që kjo pasuri (nuk di se në çfarë përmase) të regjistrohet si pronë e kishës, e cila, mesa dimë, nuk ka qenë e kadastruar si e tillë më përpara, as si pronë e fshatit, as si vakëf xhamie (siç e cek i përndershmi pop Pavle!), po as pronë e kishës, ngase siç e thamë ishte pronë e Ukë Mehmetit, por, si duket e paevidentuar dokumentisht nga pasardhësit, pas vitit 1945, për arsyet që i cekëm më sipër. Nuk dimë se çfarë manipulimesh lidhur me këtë pronë mund të jenë bërë dje ose po bëhen sot nga shteti e kisha pravosllave?!

Sidoqoftë, kur është ndërtuar shkolla e fshatit, askush nuk ka kundërshtuar, as Kisha, as Zllatani, madje askush as nga familjet tona, përkundrazi e kemi përshëndetur. Gjithashtu edhe pas Çlirimit 1999 në vend të shkollës së vjetër të dëmtuar, e kemi inauguruar vetë me shumë vullnet Shkollën e re të fshatit.

d) Disa çështje të paqarta rreth këtij kenotafi dhe konvertimit të tij në kishëz serbe

Sidoqoftë, pa e riaktualizuar çështjen e pronës, siç u tha më sipër tash për tash, ringritja e këtij monumenti mbetet çështje që duhet bërë patjetër institucionalisht, por para se të ringritet ose të sanohet ky sivarros *“kenotaf”- “vend-kulti fetar”*, ekspertët e zyrtarët përgjegjës, së paku duhet t’i kenë në konsideratë përgjigjet e mundshme të pyetjeve tona të mëposhtme, të cilat assesi nuk shtrohen për ndonjë interes të ngushtë vetjak familjar, por i për interes shoqëror të përgjithshëm të karakterit historik kombëtar e shkencor:

E para, pasi më 1346, me rastin kur mbreti S. Dushani (ende nuk ishte shpallur car - perandor), këtë fshat të dalluar ia dhuron **Manastirit** (të vet) **Sveti Arhangelja të Prizrenit**, nuk ceket fare kjo kishë, por cekën qartë sinorat (mexhat) e fshatit, atëherë si duket vërtet nuk paska ekzistuar fare ky monument si kult monoteist, edhe pse në shkrimet e vonshme serbisht përmendet se mbase edhe atëherë ka ekzistuar kishë, por ne e themi, jo kishë, por gjithsesi nuk mund të përjashtohet **murana** sivarros *kenotaf* e karakterit pagan, ndoshta jo aq i rënë në sy nga pushtetarët sa ta përvetësonin, ngase ishte *fshehur(!)* mes lisash të mëdhenj, për të cilët ekspertët thonë se sipas moshës së tyre ata ia kalonin me shekuj lashtësisht periudhës së dinastisë së Nemanajve, dhe kjo jep për të sugjeruar se ky ishte një shenjëzimj i vjetër iliro dardan, parakristian, siç shënohet në historikun e fshatit nga Komuna e Suharekës sot. gjë që shumë gjëra mund të dalin në dritë, nëse bëhen gërmime në shpatin mbi të ose për-rreth varrosit gjithandej, apo jo?

E dyta ky dyshim shtohet, jo vetëm pse nuk përmendet fare si kishe as nga Manastiri i Prizrenit i ripërtërirë më vonë nga serbët, të cilit dikur i ishte dhuruar fshati, por edhe për faktin se nga *wikipedia* e sotme (serbisht) kushtuar kësaj teme, thuhet qartë se të dhëna të sakta lidhur me dedikuesin e përshpirtnisë mungojnë, atëherë shtrohet pyetja si ka ndodhur paradoksi, që në një shkrim tjetër thuhet në atë kenotaf askush nuk është varrosur varrosur ndërsyja një shkrim të ditëve tona ngulmohet se se **i panjohuri**, mund të ketë qenë *vojvodë serb(!)* nga i njëjti fshat dhe qenka varrosur më 23.12.1370(!). pesin prej nga doli kjo datë, që nuk të vërejtur më përpara nga askus?! Është trill si shumë trille të tjera, apo jo?!

E treta, në kohë të Dushanit dhe sidomos pas tij në kohë të Turqisë e më parë, si vojvodë në kisha ortodokse kanë shërbyer ekskluzivisht

fisnikët e dalluar shqiptarë, të cilët i kanë mbrojtur me besë këto thesare fetare, ngase siç dihet shqiptarët vendas autoktonë qindra vjet përpara ardhjes së sllavëve këndeje kanë qenë të kristianizuar, fakt ky që duhet pasur parasysh me rastin e vlerësimit të atributit *serb* nuk kishte nocion njënacional e aq më tepër me kuptim të sotëm sllav.

E katërta, për varrin bosh më ka treguar edhe bashkëfshatari im Ali Ramadani Delia (Hasanaj), i cili më 1960 ka qenë punëtor fizik në ekipin që e rindërtonte kishën. Sipas tij, pikërisht ai nga kenotafi, varroshi bosh e ka nxjerrë një pllakë të shtrirë, të cilën e ka pastruar dhe ka vërejtur që ajo ishte thyer në një cep të saj, madje afër pjesës së hequr ka vërejtur se ka pasur diçka të shkruar. Pas kësaj pllaka është kthyer në vend në atë sivarrosh, ku nuk ka as kryq, as eshtna.

E pesta, lidhur me pikën e sapocekur, lind pyetja pse është thyer ajo pjesë e pllakës dhe kur?! Mos është bërë ky dëmtim më herët ose më 1926, kur edhe është përvetësua sivarroshi, vetëm për arsye pse të dhënat nuk kanë qenë të përshtatshme për frymën e politikën shtetërore pansllaviste të dites, apo jo?! Pastaj, ku ruhet ajo copëz e thyer, sepse në burimet serbe, siç u cek më sipër ndeshim datën 23.12.1370, të lexuar nga ajo pllakë, datë kjo që shpjegohet tri mënyrash: 1) si dita e varrimit të fisnikut të panjohur, 2) si dita kur fisniku e ka hapur (shënuar) varroshin për vete sa ishte e gjallë? dhe 3) datë kur këtë përshpirtje fisniku ia paska kushtuar shenjtit kristian Sveti Gjorgje (Shëngjergjit), Që të tria këto konstatime të përmjegullta, vërtet dalin shumë të diskutueshme, ngase asnjërin supozim as arsyeja më e thjeshtë nuk mund t'i pranojë, si plotësisht të saktë, apo jo?!

E gjashta, ndërlidhur me pikën e mëparshme, sidomos konstatimi i tretë: kushtimi shenjtorit Sveti Gjorgje, ngase dita e shënuar **23.12.1370** nuk përputhet as me lindjen as me vdekjen e supozuar të shenjtit Gjorgje, pra as me shenjtin serb të emërtuar *Gjurgjiq* që përkujuhet më **16 nëntor** dhe as me *Gjurdjevdan-in* që kremtohet me **6 maj**, përkatësisht si festë ortodokse më **23 prill**?

E shtata, gjithkush e di se *Shëngjegji, si festë e fillimit të pranverës, si festë pagane* e bujqësisë dhe e gjelbrimit (Krahaso: greqisht *georgios* (*bujk*) *ndërsa*, arab. për të njëjtin koncept *hid(h)ri* (*gjelbrim*), pas lindjes dhe sforcimit të feve monoteiste kjo festë pagane u përvetësua në emër të një individi personal apo që ka të bëjë me shenjtërimin e Gjergjit martir ose luftëtar si kult fetar (!!!).

Krahaso: gr. *H/agios Georgios*, lat *Sanctus Geogius*, serb. *Sveti Gjorgje*, shq. *Shën Gjergji*, arab-turq. *Hazreti Hid(h)ri(!) etj.*

Sipas studiuesit Fahri Xharra (“rd”. 07.04.2020, *Shën Gjergji* (pellazg) nga Kapadokia (Azi e Vogël) si katolik i divotshëm, bie fiktimë, më 6 maj 303 pas Kr., nga pertandori antikristian Dikli=ociani, dhe ndërkohë si simbolikë e viktimës ndaj paganizmit, vjen e shenjtërohet që nga ajo kohë nga perandorit tjetër Konstantini i Madh, lejues i kristianizmit.

Kështu, sido që të ketë qenë, në gjuhën tonë popullore festa del me emërtimin **Shingjergji, Dita e Shingjergjit**, ndërsa emri personal shumë i njohur **Gjergji**, ndërsa në stilin fetar shenjtori del në trajtën **Shën Gjergji** ose edhe më qartë **Gjergji i Shenjtë**, ku vihet re në shqipe qëndrueshmëria e trajtë-rrënjorit **gjergji**, edhe si festë e datë kalendarike, si emër shenjtori edhe si emër vetjak, që në gjuhë të tjera si në serbisht b.f. del në disa variante Gjorgje, Gjurgje etj. Kështu në serbisht si festë del me rrënjor *Gjurgje* në të dyja festat: **Gjurgjiq më 16.11.** të vitit përkatës, ndërsa **Gjurgjevdan më 23.04**, përkatësisht më **06.05**, të vitit përkatës, si festë popullore. Së këtejmi ngulmimi se dedikuesi gjithsesi, kishte qenë *bujar serb* për rastin konkret del jo vetëm i diskutueshëm, për edhe i paqëndrueshëm, edhe nga faktet e sapocekura, por edhe për faktin tjetër se për Reçanin dhe rrethinës si emër parësor del Gjergji nga festa Shëngjergji si festë e pranverës në shqipe, e cila del e rrënjosur, kurse në serbishte festat dalin me rrënjorin *Gjurgj-* : Gjurgjevdan, dhe Gjurgjiq, ndërsa shenjtori në serbisht del Gjorgje me gjasë përkthimi serbisht është bërë nën ndikimin e emërtimit shqip të fjalës Gjergji –Gjorgje. Ndëkaq trajtat *Shën Gjergji si shnenjtor*, përkatësisht *Shingjergji*, si vazhdë e festës të pagane sematikisht le të vlersohet.

E teta, vetvetiu, **i panjohuri** me emrin **Gjergji** (*Gjorgje*), sugjeron shumë a pak se mos kemi të bëjmë me një kult të ritit fetar katolik, sepse kur i **panjohuri** qenka varrosur ose kur e paska bërë dedikimin më 1370(!), historikisht vërtetohet se Prizreni me rrethinë, pra edhe ky fshat, ishte nën sundimin e Balshajve të Shkodrës, të cilët fill pas vdekjes së Dushanit (1355) veç ishin të kthyer në fenë e të parëve, në ritin katolik, kurse varri qenka hapur ose dedikuar 15 vjet pas rikthimit të tyre në fenë e të parëve katolike, apo jo?!

E nënta, lidhur me katolikizmin e këtij fshati nuk e dëshmon edhe sot vetëm toponimi Vorret e Latinëve, e disa emra të tjerë toponimesh, por që dëshmohet edhe sipas priftit **Shtjefën Gaspari (relacioni i Gregor Mazrekut)**, i cili në vitin 1671, konstatonte që në Reçan paska hasur ende

katolikë, ku i janë paraqitur si të tillë 8 vetë, por në njëfarë mënyre gjurmën e prejardhjen katolike përgjithësisht e dëshmon paksa, jo vetëm emri i vajzës Llatinka Tinka, nga familja Mitri, emër ky, i cili del i ripërtërirë në vazhdimësi nga “ortodoksët” tanë (zakonisht shqikpfolës).

E dhjeta, dihet se pas vdekjes së Gjergj Ballshës, Prizreni dhe ky fshat bie nën sundimin e V/Ulk Brankoviçit, shkizmatik ortodoks, tempulli i tillë i një bujari të **panjohur**, duke qenë i frymës pagane ose mbase i frymës katolike apo i nënritit rival rumei, gjithsesi jo i frymës pravosllave serbe, lihet pa përkujdesje zyrtare pravosllave, sepse ndoshta konsiderohej i huaj, andaj edhe nuk shënohet gjëkund, shkak ky që do të quhet më vonë, në kohën e zgjimit kombëtar pansllavist varr i një *bujari të panjohur*, apo jo?!

E njëmbëdhjeta, mesa u tha në pikën e mësipërme që sforcohet edhe nga udhëpërshkruesi Aubeu-s më 1837, i cili konstaton që të gjithë ortodoksët (serbë po edhe shqiptarë!) të Prizrenit i përkisnin ritit greko-bizantin, gjë që është konstatuar edhe nga të tjerë, madje edhe nga vetë ekspertët serbë, të cilët kanë konstatuar që themeli i kishës së Reçanit qenka ngritur jo sipas stilit *rashkjan pravosllav*, po sipas stilit *vardar me hapësirë të vogël*, d.m.th., rit ky që e kishte nën përkujdesje drejtpërdrejt kisha greko-bizantine, me imunitet zyrtar të fituar që nga fillimi i shtrirjes së Perandorisë Osmane në Ballkan në shek. XV. Lidhur me këtë mund të shtrohet edhe një çështje tjetër, me që sipas një legjende që u përmend pak më sipër, varri do të jetë hapur para shkizmës, gjithsesi para pravosllavës së Sveti Savës, mbase edhe më herët, kur muri qënka bërë me gurë të palatuar, ndërsa kati përdhec në vitin 1370 tribial, thuhet se është vazhduar me gurë të latuar me suvatim, mbase pikërisht atëherë kur qenka tentuar të përvetësohet nga monoteisti i **panjohur** jopravosllav(!). Gjithsesi edhe ky fakt-sugjerim duhet pasur në konsideratë rreth përcaktimit të ritit dhe kohës së ndërtimit, gjithsesi jo nën autoritetin pravosllav serb, apo jo?!

E dymbëdhjeta, gjithashtu, po i cek edhe dy të dhëna të dyshimta kundërthënëse që i ndeshëm në shkrimet serbisht që mbase lypset korrigjuar nga vetë autorët, lidhur me mirëmbajtjen e këtij sitempulli

e para, gjoja kjo ndërtesë paska qenë shfrytëzuar si njëfarë bujtine zori për shtegtarë të rastit, për çka me të drejtë dyshojmë dhe

e dyta, në anën tjetër ndërkohë paska shërbyer deri edhe si ahër dhish(!) etj.

Ne për vërtetësinë e këtyre dy konstatimeve shprehim rezervë të ligjshme, sepse siç pranohet në burime të tjera po serbe, ai ndërtim-kulti, një pjesë e

murit dhe kulmi assesi nuk qenka prishur nga vandalizmi i dikujt, po nga dhëmbi i kohës por për shkak të themelit të dobët, bile mjaft vonë kah mesi i shekullit 19, gjë që nuk kontestohet aq. Ndërkaq për të dhënat rreth shfrytëzimit si bujtinës ose ahur, duke u pasur parasysh sipërfaqja tejet e vogël e objektit, qoftë për bujtinë, e aq më tepër si ahur dhishë e ku ta dimë, e vërteta e tillë nuk qëndron aspak, aq më tepër, kur dihet fakti se deri në fëmijërinë time e më vonë objekti konsiderohej vend shenjëtërimi, vetë njerëzit e asaj periudhe të çdo feje nuk do të lejonin përdhosjen e një kulti të tillë, apo jo?! Fundja po shtojmë edhe këtë ngase në shek. XIX ai mirëmbahej së paku edhe për interes të përshpirtjeve nga çifqiu i Ahmet Agës qi ishte me fe ortodokse, keqpërdorimi si ahur nuk mund të qëndrojë, fundja sepse ahur larg shtëpisë nuk ka pasur asnjëherë.

E trembëdhjeta, sido që të ketë qenë, pasi ai vend konsiderohej vend i shenjtë, ku lireshin “*nejzra*” përshpirtje dhe për këtë shkak ai asnjëherë nuk qenka prishur nga dora njeriut, po paska qenë i lënë pasdore sikurse vetë *Manastiri Sveti Arhangela*, pyesim, pse ndonjë faktor autoritativ fetar ortodoks pasi fshati figuronte si pronë e atij manastiri, nuk u interesua për këtë kishë!, mbase paska qenë tempull *kishë e shqiptarëve iliro-dardanë* ashtu si edhe vetë manastiri (!), apo jo?! Në të vërtetë sipas studiuesit të mirënjohur të kësaj problematike, Dr. Rexhep Doçit, Kisha e Arhangjelit dhe Mëhillit të Prizrenit, e cila sipas tij ceket më 1348, të cilën turqit e kishin rrënuar, sepse ajo nuk është marrë nën mbrojtje nga Qendra Kishtare Ortodokse e Stambollit, sepse si duket nuk kishte qenë as manastir ose kishë pravosllave dhe as grekobizantine, po *kishë qenë kishë iliro –arbnore*, e përvetësuar nga mbreti Stefan Dushan, i cili edhe nuk është shikuar me simpati as nga Fanari grek i Konstantinopojës, Madje po shtojmë edhe këtë, sipas studiuesit Enver Rexha, në atë Manastir, 17 vjet pas vdekjes së S. Dushanit më 1372 qenka varrosur kryezoti ballshian Strazimir Balsha, pra disa vjet pasi balshajt ishin rikthyer në katolikë, apo jo, andaj edhe varr-murana ose kisha e Reçanit u përvetësua nga katolike në serbe vetëm pas LPB (Shih: (Bota sot 04.01.2018 f. 21.) Së këtejmi, mbase dilte i arsyeshëm edhe interesimi i Atë Shtjefën Gjeçovit për shenjat katolike në fshatin tonë dhe të kishës, siç u cek më sipër si pikë e veçantë, të cilën pas LDB për qëllime thjesht politike e ndërtuan dhe e shpalli nën mbrojtje Qeveria serbe.

E katërmëdhjeta, meqë gjatë konsultimit të origjinalit të veprës së Milojeviçit (III sveska) vumë re që zoti Vemic, i cili, në të vërtetë, e kishte shënuar gabim 12 shtëpi arnautë në vend serbe (prandaj analizën

tonë nga kreu I, lypset kuptuar të ndryshuar pjesërisht *n. v.*), ne po e plotësojmë këtu duke e përshtatur me vërejtjen që vetë e patëm konstatuar më që në fillim, Në të vërtetë z. Milojević në Reçan paska evidentuar 30 shtëpi poture dhe 12 serbe mbase ato të Starakuqës që i kami cekur ne që ishin të ndara paksa hapsinisht nga fshati. Sidoqoftë, Milojevići në kontekst në jug nga fshatrat Muhlan e Staravuçinë në vëllimin e tretë shton për Reçanin:

Recane – juzno ½ çasova, kuca 30 potura, 12 srpskih. Ima jednu razvalenu (crkvu) i jednu iza sela na brdu malu, sa jednim kubetom od tesanog kamena, celu crkvu sa natpisom i ogromnim starosrpskim grobljem sa natpisimin (ali n.v.) ni ukrasima i natpise, ni s crkve ni groblja, ne moralismo dobiti. U crkvi se na nadgrobnoj poklopnici jedva poznaju ovo nekoliko reci: +... sin grob vojvode Stefana Dusana, A. cara i imperatora Grckom, Srpskom, Bugarskom, Ougrovlahije, Ougroij...

*/Reçani, gjysmë ore (në jug të fshatrave Muhlan e Stravuçinë), 30 shtëpi poture dhe 12 serbe. Ka një kishë të rrënuar dhe një pas fshatit në një kodër të vogël me një kub-mbulesë me gurë të latuar, (mirëpo n.v.) tërë kishën me mbishkrime dhe me varre serbe të vjetra me epitafe e zbukurime, as në kishë as në varre, nuk mund t'i gjenim. Në kishë në mbulesën e sipërme mbivarrorë mëzi dalluam këto fjalë: /Tekstin e cituar vijues e ka të shënuar me shkronja të gjuhës së vjetër kishtarë: /+... **djalë varr.. vojvodë i Stefan Dushanit, A. car dhe perandor i grekëve, serbëve, bullgarëve, ougovllavlahije, ougrove.../...***

Siç po shihet teksti është dhënë me tahmin (kuturu), ngase të gjitha konstatimet janë të diskutueshme, përkatësisht të paqëndrueshme dhe kontradiktore. Po cek vetëm rastin kur thotë se “Mbi Reçan është *Selograzhde*, fshat ky që në të vërtetë i takon një reliefit tjetër më afër Prizrenit. Madje, siç e kemi sqaruar më parë në Starakuça dhe në fshat, në atë periudhë nuk dihet se ka pasur gjurmë kishash. Dihen vetëm toponimet *Vorret e Latinëve* mbi fshat dhe *Vorret e Poshtra* nën fshat, Madje te Lisat e mëdhenj tek Varr-Murana (kenotafi) nuk ka pasur varre me epitafe etj. Edhe në këtë pasus shihet qëndrimin tendencioz antishqipar i Milojeviçit, i cili edhe pse e dinte faktin se askush nuk i kishte prishur varret e “natpiset” (që nuk kanë ekzistuar), madje edhe faktin se Stefani Dushani e kishte shpallur veten “A. car e imperator” mbase **arbanashki** car ai në

sajesën e tij arbitrare nuk e shënon qartë këtë fakt, apo jo?! Madje edhe shtojca gjoja me shkrim të vjetër kishtar, “*sin grob vojvode Stefana Dushana*” del i gënjeshtërt si “*fakt*”, edhe pse ndoshta prej këndeje është kopjuar nga ky shkrim i Milojeviçit vetëm fjala “*vojvod i panjohur*” në burimin më të ri të *Vokopedisë*. Por, sidoqoftë, është pozitive nga Milojeviçi që shënon se nuk ka parë kurrfarë “*ocuvanih fresaka*” (afreska të ruajtura), gënjeshtërt kjo që siç e pamë del e shënuar në Enciklopedinë serbe (1978), por nuk e shënon as emrin *Sveti Djordje* të kishës, d.m.th. emri i kishës del se është përkthyer nga emërtimi popullor i festës pagane të pranverës – *shëngjergjit* të gjuhës shqipe vendëse vetëm në pas vitit 1918, apo jo?!

Sidoqoftë, konstatimet tona rreth paqartësë lidhur me Varr-Muranës si dhe çështja e starakuçave ndaras paksa nga fshati mbesin të sakta si më parë.

E pesëmbëdhjeta, pyesim, ekziston ndonjë fakt i fundviteteve të shek. XIX dhe fillimvitet e shek XX nga organet kishtarë të Prizrenit që të jetë i shënuar historiku i këtij monumenti si edhe a do jetë shënuar diku incidenti me fshatin, lidhur me tentimin e përvetësimit pa sukses të varr-muranës si kishë serbe, përkatësisht ekziston më në fund apo jo akt-dokumenti i përvetësimit të pronës nga kisha më 1987/88 apo 1926 ose arsyetimi i përvetësimit si thesar serb në vitin 1990, kur vihet nën përkujdesjen e shtetit ky sitempull /kenotaf(??!), edhe pse dihet se administrata zyrtare serbe tek ne ka akzistuar jo vetëm afro 80 vjet më parë që nga viti 1912, por edhe më parë, ngase shkolla e bogosloivisë në Prizren ka qenë themeluar shumë para kohës së misionit të Milojeviçit. madje pse kjo mbrojtje-përkujdesje u bë vetëm në prag të luftës së fundit, kur shihej se po i lëkunden themelet shtetit kolonialist serb në Kosovë, apo jo?!

E gjashtëmbëdhjeta, me sa lexova, nga shkrimet përcjellëse nga interneti, më vjen mirë që objekti momentalisht i rrënuar paska pasur disa vlera të mëdha artistike ikonopërshkruese, por më duket se vlera historike dhe stili letraro-artistik piktoral vlerësues është gjithsesi ekzagjerues, kur dihet fakti se ato vlera pikturale nuk ishin më të vjetra se viti 1960, madje edhe më të vonshme, apo jo? Sidoqoftë, duhet të konsultohen dokumenta rreth së vërtetës si është përvetësuar kjo sipërfaqe si pronë e Kishës dhe në çfarë përmasash, përkatësisht të shihet mundësia ligjore që kjo pasuri, qoftë tërësisht, qoftë pjesërisht, fundi i fundit edhe me dëshmitarë, pa e cenuar lokacionin e vendmuranës, dhe të shkollës, t’u

kthehet pasardhësve të familjes së Ukë Mehmetit, përkatësishtnjë pjesë e hapësirës me lejen apo dhurimin e familjes Veselaj të shfrytëzohet për objekte kulturore me interes shoqëror.

dh) Çfarë ndodhi me këtë tempull viteve të fundit para dhe gjatë Luftës së UÇK-së

Është e vërtetë, se që nga vitet 1948-1956 (gjatë periudhës së shkollimit, burgut, ushtrisë etj.) dhe kohës së mëtejshme 1956-1966, por edhe më vonë, meqë nga organet e shtetit e atyre partiake isha i etiketuar *si person i papërshtatshëm, si i dënuar politik, i parehabilituar*, për mua ka qenë i ndaluar jo vetëm punësimi në atë rreth, por edhe prania pa paralajmërim, qoftë si musafir e me musafirë, qoftë si studiues për gjurmime gjuhësore-historike gjithandej, si dhe qëndrimi në fshatra të tjerë të Kosovës, andaj nuk di shumë hollësi për gjendjen e fshatit e të asaj kishë. Mirëpo, megjithatë e di që më 1956-1960, nga shteti serbo-jugosllav, është ndërtuar kishë e re. Në të vërtetë, ndërkohë, gjatë vibrimeve të tensioneve politike-shtetërore të fundit, fundvitet e '80-a dhe fillimvitet e '90-a ndërsa e ndërtoja një shtëpizë banimi atje pata vërejtur se disa nga lisat e mëdhenj rreth kishës nga ana e rrugës i kishin pasë prerë e dëmtuar shumë, jo tjetër kush, po të rinjtë serbë të fshatit, bile rastësisht në kalim e sipër njëherë e ndala veturën dhe intervenova me pyetjen: Pse është shëmtuar kështu **vendi i Kishës sonë?** Më është mbyllur goja po në gjuhën shqipë: ***Hec udhës tande! Kisha asht veç jona!***

E thamë më sipër po e përsërisim, edhe lufta e fundit e kishte prishur kishën deri në themel, gjithsesi ai vend kulti duhet të sanohet, të rregullohet patjetër dhe kjo të bëhet me obligim shteti, po fundi i fundit diçka-diçka mund të ndërmerret edhe me vetëiniciativë të familjes së pasardhësve të Ukë Mehmetit, së paku të bëhet spastrimi nga shkurret e drizat rreth **Varr-Muranës ose Kishëzës së Gjergjit të Shenjtë**. Kur them kështu kam parasysh edhe fjalën përshëndetëse të mbajtur prej nesh me rastin e përirimit të **Përmendores kushtuar Dëshmorëve të Reçanit (2001)**, të ngritur jolarg atij vend-kulti, kur edhe pata propozuar që afër kësaj Përmendoreje dhe atij **vend-kulti** (në Ledinë) duhet me u ngritë një **shtëpi-muze me bibliotekë**. Së këndejmi, gjithsesi *me Varrmuranën e ringritur* si vend-kulti, qoftë edhe *si kishëz e stilit rumeas (kenotaf)*, dhe në anën tjetër *me përmendore ekzistuese të dëshmorëve, me shtëpi muze*

të re me bibliotekë, me hotel a motel, me rregullimin e Kronit të uji të thartë (mineral) dhe patjetër edhe me shkollë të re më të madhe te Livadhi i Plepave, Reçani do të bëhet vend historik, strategjik, vërtet Fjalëmir, ashtu si i ka i ka hije me qenë, por edhe si vend yll-turistik, apo jo?!

Sidoqoftë, një veprim i tillë njerëzishmerie rreth spastrimit të terrenit rreth këtij sitempulli do të na nderonte në radhë të parë vetë ne, familjen tonë, fshatin, por në veçanti fqinjët tanë shekullor ortodoksë, prej të cilëve kurrë nuk kemi pasur asnjë të keqe, por vetëm të mira, disa prej të cilave do t'i kujtojmë e rikujtojmë me nostalgji pakëz më poshtë. për mos me u harrue kurrënekurrës.

Nënkreu V

SI KANË QENË MARRËDHËNIET TONA FQINJËSORE ME SHKITË E FSHATIT GJATË MBAMENDJES SIME 90-VJEÇARE, QË NGA DHJETËVJETËSHI I FUNDIT PARA LDB-SË (1933-1941) DERI NË LUFTËN E FUNDIT 1996-1999?

Hyrje

Përjetimin vetjak si dëshmi nga vendlindja e paksa edhe nga rrethina rreth marrëdhënieve të natyrshme njerëzore ndërfaqinësore mes shqiptaro-muslimanëve(!) nga njëra anë dhe serbo-ortodoksëve(!) ose *shkive tanë*, nga ana tjetër, do të përpiqem ta shpreh në vijim në disa pika, por paraprakisht i mëshoj faktit se një shumicë e konsiderueshme e ortodoksëve (*shkive tanë*) edhe pse të evidentuar si etni serbe, para 80 vjetësh e deri në ditët luftës së fundit në Kosovë, duke u marrë si shembull fshati ynë, gjuhësisht nuk kanë qenë të serbizuar, andaj për lehtësi paraqitjeje kujtimet e mia për këtë periudhë 80 vjeçare po i ndaj në katër nënperiudha:

- 1) Ndihamat reciproke konkrete shqiptaro-serbe në fshat në periudhën e Kravevinës Jugosllave ..., 1935-1941,
- 2) Bashkëjetesa shqiptaro-serbe në kohën e LDB, në të ashtuquajtur *Koha e Shqipnisë* 1941-1944,
- 3) Bashkëjetesa shqiptaro-serbe në Jugosllavinë federale nën regjimin titist dhe
- 4) Ndikimi i politikës serbe në periudhën milosheviçiane në ftohjen dhe prishjen e raporteve serbo-shqiptare edhe në këtë fshat.

Sido që të ketë qenë, tani do të përpiqemi të përzgjedhim diçka–diçka nga kujtimet kryesisht personale nga katër periudhat 1999e sipërcekura.

1) Nga bashkëjetesa në vitet e tridhjeta (1933-1941)

Së pari, po i mëshoj të vërtetë se që nga tredhjetëvjetshat e fundit të shekullit XIX, jo vetëm im atë, por edhe të tjerët para tij e pas tij, meqë mbarë familja shtëpitë i kishin afër familjeve ortodokse të Mitrajve dhe të Simajve po më vonë edhe të Petrajve, ne si fëmijë e ndieshim veten se jetonin si në një familje të madhe, të përzier, por gjithsesi me veçori që dallon çdo familje e aq më tepër një etnitet dykonfesional, edhe pse kryesisht shqipfolës. Megjithatë, meqë atëherë në *Jugosllavinë e Kralit* shkolla dhe administrata praktikoheshin vetëm në gjuhën serbe, nuk do të thotë se nuk bëhej përpjekje nga të dyja palët me mësue serbishten, qoftë nga ortodoksët që ishin më të motivuar, qoftë prej muslimanëve që e kishin më fort si ngarkesë nga halli. Në atë kohë të dyja etnitetet jo vetëm zyrtarisht: **serbjanë ortodoksë/muslimanë turq(!)**, por edhe në stilin bisedor nga ndonjë *i mësuem* ose *i kërkuem* si babai im dalloheshin: **shkijet tanë** si *shqiptarë ortodoksë*, në njërën anë dhe **shqiptarët muslimanë** në anën tjetër, si etnitate të veçanta fetare, por kryesisht me mbizotërim të gjuhës shqipe *pa tendenca të caktuara nacionaliste*.

Së dyti, ç'është e vërteta, ndërlidhur me pikën e parë, ky nacionalizëm nuk vërehej nga as te ne si barij e në përgjithësi. Sidoqoftë, vërtet po në këtë moshë 4-8 vjeçare, pa dallim entiteti, përjetonim ngjarje të caktuara që i diktonte koha. Kështu, qoftë gëzimet, qoftë edhe shqetësimet i kishim të përbashkëta, edhe pse neve, na quanin **turq** (*elhamdylilah*) edhe *drzhavni imamët*, ndërsa ata, *shkiet tanë: pravosllavnisrbi*, siç i quante jo vetëm *drzhavna shkolla*, por edhe *popat*, të cilët dukeshin jo aq rrallë këndeje, ndërsa ne si barij familjarisht (turq e shkie serbjanë!) po përsëris flisnin e merreshim vesh njëri me tjetrin vetëm shqip.

Së treti, ndër ngjarjet më të rëndësishme që mbaj mend po shkëpus nga mbamendja, edhe pse si fëmijë 4 vjeçar, entuziazmin që mbretëronte në krejt mahallën e katunditn (serbë e shqiptarë) kur Ramë Bllaca (si kren me autoritet zyrtari, si mik (krushk) erdhi në familjen tonë me bë përhapr fejesën e bijës (Emines) për një kushuri tonin (Abazin). Ndërkohë, e kam marrë vesh që ai farë Rama (me mustaqe të mëdha) paska qenë person me

autoritet për të gjithë, poslanik (deputet) në Skupshtinën Jugosllave të Kralit, ngase edhe atëherë deputetët zgjidheshin me votën e popullit. Mbjaj mend shprehjen popullore muhabetore që më është pjekur kuptimisht më vonë:

**Ashtë e njime'të,/ që më parë 40 vjet, /miku mikut i ng(j)et!/
Kështu që si Ramë Bllaca që kishte ndërtuar kullë-shtëpi si akt rezistence,**

si shembull për mosshpërngulje, vepruan edhe të tjerë sipas mundësive, ashtu kishin vepruar edhe në familjen tonë të gjerë: Baci Rizah (miku (krushku) i ri i Ramës), pati ndërtuar odë të madhe (në dollma), tejet moderne për kohën që ishte në funksion të tërë mahallës deri kur u dogj nga piromanët milosheviçjanë më 1998. Mixha Hoxhë bëri shpi të re e plantazh mollash në Gjinovishtë, im atë plantazh kumbullash në arën nën shtëpi. Dikush mbillte vneshta të rinj, dikush shtonte bylykun me dhenë, me dhi, me lopë, me buellica etj., por, kur u vra Ramë Bllaca, shqetësimi u përshkallëzua shumë tek të gjithë fshatarët, edhe te ne. Kudo kishte drojë. Kujtoj dajën Sejdë Bajraktari nga Suhareka (me tirqi të galëm), i cili erdhi te ne dhe jepte zemër për mos me u demoralizue. Ka pasur raste që për mos me u shpërngulë, pleqt i luteshin edhe Zotit për ndihmë, jo vetëm gjatë namazit, por edhe në arë, në livadh, kudo, deri edhe kur i vilnim pemët dhe disa “kokrra” i linin për *shpeni e çobani*.

Së katërti, më duket se është vendi të rrëfej një sishaka (një barsoletë) të asaj kohe, por që pasqyron sadopak gjendjen reale të marrëdhënieve ndërfaqinjësore mes *shkive tanë e turq-muslimanëve* (!), por që të gjithë flisnin shqip.

Kur mixha Musë (fqu i parë yni, i Fetajve), i nqefuar nga pija e rakisë, gostitur nga Toma i Mitrajve, shprehet:

-O Tomë shoqi, bre, shkuem prej shkaut!

Toma i cakrron gotën me një –*ËËËËH!*

Atëherë këtij i kujtohet se edhe Toma qenka **shka**, përmirësohet:

-Shkuem prej shkaut të Serbisë!

Kjo sishaka e vërtetë, përsëritej shpesh, prej shakaxhive të fshatit tonë.

Vetë fjala *shkuem* (*mbaruem!*) *prej shkaut të Serbisë!* - jep me kuptue se çfarë marrëdhëniesh kishin bashkëfshatarët tanë në krahasim me politikën shfarosëse shtetërore të Serbisë, e cila me çdo kusht donte t'i hiqte qafet shqiptarët: t'i shpërngulte (si turq) ose t'i asimilonte në serbë, gjithsesi t'i çorientonte duke i quajtur fillimisht edhe si *muslimanë serbë ose serbë muhamedanë*.

Së pesti, është e vërtetë, siç e përmend në një rast prof. Rexhep Doçi, se pa marrë parasysh kërkesat e Serbisë ne as në *deka e dreka*, në krushqi e argatshti dhe në festa bajram e velikdan, gjatë Krlevinës Jugosllave, nuk jemi ndarë (*as si turq e as si shkie*), Po kështu është vazhduar në kohë të *Shqipnisë* (1941-1944) tash si **shqiptarë** e **shkije tanë**, deri diku edhe më vonë pas LDB, si **shqiptarë** e **serbjanë**. Mbaj mend se në odën tonë, si në atë të Gjekës, ose të bacit Rizah, dhe në kohë të Krlevinës edhe më vonë në pasdarket e netëve të gjata të dimrit, luhej kapuçash, këndohej (shahej!) shqip. Madje edhe në dasma serbe te granimi këndohej me def. Kujtoj Dadën Dudë (bijë Mushtishtit) shoqja e bacit Bajram (ish- muhlanas), që dallohej si këngëtare tek të dyja palët, kryesisht këndohej shqip, por edhe ndonjë këngë *nashke mushtishtanke*.

Së gjashti, mbaj mend kur Stanisllavi i Cfetkit thirri jo në darsëm si krushq, si ftoheshin burrat zakonisht, por si tha a ai. *Po thërret baba me dalë në "zjarm"...* Me këtë kuptohej se po përcillkan nuse një vajzë të tyre. Me fjalë të tjera me fjalën **zjarm** kuptohej, pritje-përcjellje e krushkdarsmorëve, ngase kështu dikur motit gjatë kësaj ceremonie qenka ndezur zjarr simbolik në logun përkatës të pritje-përcjelljes, edhe pse tashti nuk ndizej kurrfarë zjarri.

Së shtati, po e shtoj edhe këtë të vërtetë dhe e konfirmoj me përgjegjësi, se as në kohën e Serbi-Krlevinës (1912-1941, serbishtja nuk ishte dominuese as mbrenda familjeve të tyre. Pra, pohoj se prej se mbaj mend tash 80 e as vjet ata sidomos burrat ndërmjet veti, kanë folur shqip, por ka ndodhur që ndonjë nuse e ardhur nga larg me *nashken* e saj më fort bullgare-maqedone se serbe, kishte vështirësi me shqipen, por edhe ajo adaptohej shpejt. Me këtë nuk them se në familjet e tyre nuk ka pasur përpjekje me mësue serbishten, sidomos gjuhën e shkollës, por për këtë kishin shumë vështirësi, ashtu siç kishim edhe ne. Lidhur me gjuhën po shtoj edhe këtë që edhe fëmijët e mi, para dhjeta vitesh çuditëshin që Lubini i Petrajve, me shapkë shkau (serbjane), jo pse flisnin shqip me vëlla Çedën, po ai si bari, i truante delet e *padisiplinuara* shqip: *Ku po të rruejnë dreqnit atje! Të humbtë fara e keqe! Të preft uki, të preft!* etj.

Së teti, për të dëshmuar etnicitetin e përbashkët me emrat që bartnin para islamizimit të parët tanë malësorë, po i përmend disa emra vetjakë gjatë kësaj periudhe të pleqve të shkive tanë bashkëfshatarë:

Tomë, Ivë, Stankë, Kolë. Simë, Nikollë, Ristë, Jovan, Borë, Gjekë, Gjokë, Nelë, Llazë, Mirk, Mark, Dosë, Savë, Vasë, Todë, Stalë, Tanis

etj., pastaj: Tinkë (Llatinkë), Stanë (Stanije), Anë, Marë, Mirë, Lutë, Lenkë etj.,

emra këta pothuaj të ngjashëm me ata të malësorëve shqiptarë të krishtenë, katolikë e ortodoksë, apo jo?! Si me thënë, asgjë serbo-sllave të veçantë nuk ka pasur, por pas vitit 1918 janë praktikuar edhe emra të rij të modës shtetërore serbe, të pagëzuar nën ndikimin e kishës e shkollës shtetërore serbo-sllave, Bllagojë, Zllatan, Miroslav, Biljka, Ruzha etj..

Së nënti, flitej se në kohë të Turqisë, kur paska pasë ardhur njëfarë popi shetitës (misionar nga Serbia ose Rusia), dhe paska tentuar të bisedojë me përfaqësuesit e tri familjeve të fshatit tonë, ata i paskan pasë thënë, fol si na në dash me të marrë vesh (!). Mbase është trillim, por edhe këtë e kam pasë dëgjuar prej Kumara Nikollës, babë i Jovanit, bashkëbarij i fëmijnisë, kur ai e Llaza i iatëssi serbjanë ortodoksë pravosllavë s'e kuptonin *Oçe Nash-en*, po aq sa unë si turko-arab(!) *Elhamin!!!*

Së dhjeti, edhe diçka me shumë rëndësi ndërlidhur me atë që u shprehëm deri këtu, po e thjeksoj një të vërtetë të fortë që përgenjeshtron konstatimin e vitit 1866 të shënuar nga M. S. Milojeviçi, për sugjerimin se gjoja 30 shtëpi poture kishin qenë serbe, por që ndërkohë ishin **poturëzuar**, por *aq më keq* nuk mbeten **serbishtfolës** por gjuhësisht u **shqiptarizuan** të cilët sipas logjikës milojeviçjane etnikisht e gjuhësisht kishin qenë dhe kishin mbetur gjithsesi vetëm serbë(!) që paskan ditur vetëm serbisht, andaj i llogarit serb si edhe Vemiqi në analizat përkatëse. apo jo?! Atëherë, lind pyetja jo vetëm poturëve, por edhe ardhacakëve **arnautë** ndërkohë kush ua mësoi emërtimet e mikrotoponimeve të fshatit gjithsesi të trashëguara nga lashtësia, me elemente të shqipes së hershme(!), të cilat ndërkohë i trashëguam edhe ne fëmijët si unë **Nuhiu i Muharremit, Hasani i Xhemës etj, nga familjet e paturëzuara!**, por edhe **Llaza i Ristës e Nedelku i Kërstës etj.** serbë të familjeve të *paturëzuara*, si të gjithë barijt e tjerë, që atëherë në vitet 1939-1941 (si shtatë-tetë vjeçarë i shqiptonin dhe i dinim se ku ndodheshin vendet e këtyre emërtimeve:

Kiliqishtë (Kili...), Gjinovishtë (Gjini...), Liplak (Ili+ plaku), Shi(n)buti (Budi i Shenjtë!), Barbeshi (Arbneshi), Kozmatok (toka e Kozmit, Buçalla, Qarri e ndonjë tjetër...

pastaj:

Gurtë e Shpuem, Gryka e Buçallës, Prroni i Kaprrollit, Shpati i Rrezinës, Gryka e Arashit, Lisat e Marinit, Prroni i Fellë, Livadhi i

Cungave, Samari i Vezirit, Ledina e Katundit, Bluda e Palit, Vorret e Llatinëve, Bunari i Vasilit, Guri i Ukit etj.

pastaj:

Ngurina, Zallina, Hudareva, Arat e Gata, Nerjazi, Mullini i Naltë, Bunarishta, Bostanishta, Lisat e Mëdhaj, Rrafshi Madh, Rrafshi i Vogël, Teqershija, Kroni i Biraçit, Uji i Tharbtë, Rrotllaku, Shpati i Hijes, Shpati i Rrezes, Bërryli i Xhades, Te Mrizet etj.

Por edhe mbi bazë përzjerjeje me ndonjë fjalë apo ndajshtesa të përbashkëta serbo-shqipe, si p.sh.:

Zhevina, Jaruga, Grebenishta, Jazbina, Trska, Prroni i Kotlinës, Llugat, Rekat, Pojata e Rexhepit, Pojata e Sefës, Starakuça, Agraxhat, Boka, Armica e Mixhës Hoxhë, Shpati i Jarugës, Tepojata, Sllatina etj.

Siç mund të shihet mbizotëronin emërtimet në gjuhën ose në trajtën popullore shqipe.

S'do mend që edhe nga ky këndvështrim dëshmohet qartë epërsia e gjuhës shqipe që nga periudhat më të hershme, sigurisht para sllave e osmane e deri në ditët e fëminisë sonë e më vonë, kur ne (shkije e turq!) i quanim ashtu pa ua ditur etimologjinë se cilës gjuhë i takonin këto emërtime, apo jo?! Si rrjedhojë del e vërteta se në fshatin tonë, ashtu si edhe në fshatra te tjerë të Kosovës të shënuar si poturë (serbë të islamizuar) nga Milojeviçi ata nuk ishin as nuk kishin qenë serbë po pa dyshim ishin e kishin qenë shqiptarë. Madje, kjo vërtetohet mjaft qartë në kontinuitet, siç e pamë më sipër edhe nga mikrotoponimet mbizotëruese në gjuhën shqipe.

Së njëmbëdhjeti, është e vërtetë se te ne, në të gjithë fshatrat e kësaj ane kishte ndërlidhje familjare gjithsesi: *farefisnie, vëllamërie e kumbarie* e ndërlidhje të tjera përkatëse të rëndomta miqësie mes muslimano-ortodokse-katolike, të realizuara natyrshëm, mbase edhe nga rasti e halli, në relacionin brenda e jashtë fisnor, fshat me fshat ose fshat/qytet, si: Bukosh e Dvaran, Papaz e Popolan, Mushtisht e Budakovë, Reçan e Muhlan, Buzhal e Prizren (me Gapiqët), madje kishte edhe ndërlidhje krushqie edhe brenda fshatit, si Reçan, Mushtisht etj.- etj., sepse edhe feja nuk ishte aq e fortë, siç rëndon e pandehet sot, sa të ndërpriste këto lidhje që ishin substanciale edhe për mbijetesë gjuhësore.

Me thënë të drejtën, ndërlidhjet e tilla ishin imponuar jo si tash *ad hoc* me bashkim e ndërrim partishë politike për ndonjë interes të ngushtë karrierist, por nga nevoja dhe përvoja shumë shekullore e luftës për

ekzistencë, sepse vetëm në këtë mënyrë ka mujtë me u ruejtë gjuhësisht substanca e etniveve njëgjuhësore, ndërjetare e si edhe harmonia ndërsociale dhe ndërtnike kundrejt gjuhës administrative ndërfisnore e fetare osmane e sllave. Për një bashkëjetesë e qeverisje të tillë e ka ndihmuar për atë kohë sigurisht sistemi fisnor shqifolës disashekullor i trashëguar nga brezi në brez, që nga lashtënia e trashëguar iliro-pellazge.

Së dymbëdhjeti, meqë në vitin 1940-1941 kisha arritur në moshën për shkollë kisha brengën më të madhe se si duhet të paraqitesha në serbishte te njëfarë daskalli, nëse më bie hise(!). Thuhej që atëherë në shkollën serbe në Suharekë punonin një *daskall* dhe një *daskallicë*. Daskallica ishte më e butë, ndërsa daskalli më i egër., sepse siç është shënuar edhe nga *Naxhije Doçi* në gazetën *Bota sot* (06.12.2016, f. 26), *daskalli* ishte militant ekstrem, ai praktikonte si detyrim që mengjes për mengjes, nxënësit shqiptarë pothuaj ushtarakisht të raportnin atij, sipas kësaj formulë-fraze që duhej mësuar përmendësh:

Ja (N.N-o/viç), serbin muslimanske vere, dobro jutro, gospodine!

/Unë (N.N,) serb i besimit musliman, mirëmengjesi, zotni!)

Me thënë të drejtën unë e ushtroja këtë me ndihmën e bacit Ramë, i cili e kishte kryer atë shkollë me sukses, por në vend Ramadan Uka, mësuesit i kishte raportuar:

Ja sam, V/Ukovic Ramo, serbin muslimanske vere...,

Ndërsa mua sipas konsultimit me Milen e Mitrajve më duhej që në vend Nuhi të ushtroja Nuvo:

Ja sam Nuvo V/Ukovic,.../ jo NuHi ose NuHo, po NuVo sepse serbishtja *nashke* (siç e fliste Nana e Llazës), nuk kishte **-h-**! Krahaso zyrtarisht: SuVa-Reka në vend të popullores: SuHa-Reka.

Sidoqoftë, fundja unë pata fatin e bardhë që të shkoja po në atë shkollë, po tani *nxënës i shkollës shqipe*, e cila për ne, tash jo si *turq e as si srpski muslimani*, po si **shqiptarë në Kosovën e Lirume të Bashkueme me Shqipninë Nanë**, ishte shkrepje e një dritësie hyjnore brenda shpirtave tanë, ishte një rilindje e vërtetë kombëtare, ishte një mrekulli që as sot s'mund të shprehet dot me fjalë?!

Së trembëdhjeti, nuk mund ta kalojmë pa e përmendur faktin që edhe më parë familja e Mitrajve i ka dhënë ndihma të shumanshme e të shumëfishtë familjes sonë të ngushtë, por unë do ta spikas ndihmën e dhënë në të korra të të lashtave (sidomos grurit). Me që ne kishim disa ara të mbjella me grurë, po argat pak, prandaj të korrat zgjatnin shumë, sepse

atëherë korrej me drapër, andaj familja e Mitrajve që nga koha e Jugosllavisë së Kralit dhe në vazhdimësi, prej se e mbaj mend, deri edhe në kohë të partizanisë e pas prishjes së *kolektivizimit* (kooperativës fshatare), pa i kërkuar ndihmë fare, duke njohur punë, dhe pasi kishte argatë më shumë, veç kur e shihnim të korrur ndonjëren nga arat e caktuara ose ka ndodhur, ndërsa ne ishim duke korrur në njëren anë, papandehur veç kur shihnim në anë tjetër të arës vargun e korrësve të *shkive tanë!* Vërtet, mrekulli! Ku ka sot një solidaritet të tillë ndërfaqinësor të etnitive të ndryshme kombëtare e konfensionale, që në vapën e verës me ta korrë arën, pa kurrfarë kompensimi?!?!

Këta ishin *shkiet tanë* që kurrë kurkuj nuk kanë ditë me i ba keq, por gjithkuj, e sidomos ne vetëm mirë!

2) Nga bashkjetesa shqiptaro-muslimane /shqiptaro-ortodokse (1941-1944)

Periudha, duke filluar nga pranvera e vitit 1941 deri në dimrin e hershëm të vitit 1944, ka qenë periudha më fatbardhë për ne të ashtuquajturit *turqit* ose *muslimanët serbë* që tashmë u bëmë siç kishim qenë dembabadem **shqiptarë**, por ishte edhe një periudhë anarkie, që për serbët kolonizues që nuk ishin sjellë mirë me shqiptarët ishte vërtetë atmosferë shqetësuese, disa prej tyre u shpërngulën në Serbi, por edhe për serbjanët, *shkiet tanë* gjithandej fshatrave të tjera nuk ka qenë aq lehtë, sidomos për ata që nuk i kishin ruajtur ndërlidhjet miqësore ndërnjerëzore të mëparshme me fqinjët shqiptarë, si *kumarinë*, *vëllamërinë*, *ndihmën reciproke* si kojshi etj. Por në fshatin tonë, të ashtuquajturit *serbjanë* ose **shkitë tanë** as që u ka shkuar mendja për shpërngulje, ngase nuk e kishin bërë veten për një verpim të tillë. Atëherë, pas ikjes të ushtrisë serbo-jugosllave ve dhe administratorëve të shtetit pushtues vendasit ndjenin kthjellësi, andaj edhe krahasoheshin situatat si furtuna që trazojnë përkohësisht ujnat e lumejve por edhe të projeve, por pas *tallazave shkëmbij* e *zalli mbesin më të paqtë...* Por megjithatë, dhe pse bashkëfshatarët tanë ishin **të paqtë**, situata nuk ishte pa shqetësim edhe për shkitë tanë, ngase vetë emri i Serbisë, duke i quajtur serbë të gjithë ortodoksët, edhe ata që ishin shqipfolës kishte krijuar mëllëf tek shqiptarët e shtypur gjithandej prej Serbisë kolonialiste. Madje propagandat e zeza mllëfosnin naivët që atë ta shprehnin mllëf e hakmarrje ndaj *serbëve* vendës. Pikërisht këtë situatë mllëfosëse e njihnin edhe prindët tanë,

prandaj rreth mbrojtjes së fqinjve u organizuan familjarisht, mahallisht e katundish prë mb rojtjen e tyre dhe të fshatit. Me autoritetit e babës u tubuan përfaqësuesit e mahallave u besatuan si katund për mbrojtjen e shkive tanë, nëmënyrë që kjo punë të shkojë sa më me pa telashe.parashikimi ishte me vend. Pikërisht këtë situatë, po e kujtoj në disa pika, ashtu siç e mbaj mend:

Së pari, kujtoj, që në fshatin tonë ato ditë deri edhe me pushkë në dorë jo vetëm im atë, por të gjithë fqinj të shqiptarë e katundësit mbronin sidomos natën bashkëfshatarët tanë ortodoksë, që atyre mos t'u ndodhte ndonjë e keqe nga kushdoqoftë në atë kohë *hallakamash*.

Së dyti, lidhur me këtë situatë hallakatjesh, kujtoj vetëm nja katër veprime konkrete të babës ndërlidhur me mbrojtjen e fqinjve ortodoksë:

E para, ato ditë pas çlirimit nga forcat kolonialiste serbe më kujtohet se nga fshati Vraniq ishin paraqitur dy njerëz te familja e Simajve dhe *ditë më drekë* kishin kërkuar *hak*, sepse Gjoka një i familjes së tyre deri sa paska shërbyer në kabinetin e naçelnikut në Suharekës i paska maltretuar me xhandarë, andaj kërkonin dëmshpërblim ose do të përdornin vetëgjyqësi. Baba sapo u informua, të dy i ftoi në odën tonë. Pasi isha i pranishëm, u jepja gacë për cigare, mbaj mend, që baba pasi i ndëgjoi ankesat, e kuptoi se ata kërkonin dëmshpërblim në të holla për diçka që e ekzagjeronin. Baba, ua shpjegoi të vërtetën se Gjoka tashmë kishte vdekur dhe këta të gjallët s'kishin kurrfarë faji, madje kishin rënë keq nga pasuria, sepse zotnitë nga Prizreni automatikisht kishin rifituan pronësinë e tokave dhe u kishin marrë përqindjen e hakut. Kështu ata momentalisht kishin vështirësi se si me mbetë gjallë, andaj kërkoj prej tyre të hiqnin dorë nga kërkesa, përndryshe do të armiqësoheshim me fqinj të tyre shqiptarë e katundin, pasi katundi i kish marrë me besë si *mendore* (nën mbrojtje obliguese). Po nëse vërtet kanë ndonjë hak borgj, le të vijë dikush nga krenët e fshatit të tyre, të cilët i njihte mirë im atë dhe këtë punë e bëjmë pleqni si burrat. Ata ikën e nuk u duken më.

E dyta, po ato ditë një *harambash* i bajraktarëve të Budakovës, u kishte mbetur në derë, po ashtu ditë më drekë, familjes së Mitrajve, duke inskenuar diçka të paqenë, kërkonte dëmshpërblim deri veshë e mbathë. Baba e mori vesh se kush ishte, në marrëveshje me Bajraktarin e vërtetë e largoi kapadiun, madje edhe me të shtyme e kërrcënim. Pas kësaj nuk pati kërrcues të tjerë.

E treta, kujtoj një mbrëmje vonë, u dëgjuan klithma e vaje nga familja e varfër e Ristës së Petrajve, shtëpia e të cilit nuk ishte fort larg shtëpisë sonë, po në anë tjetër të lumit. Dikush i tregoi babës që dhunuesit ishin të armatosur dhe donin t’ia merrnin lopën e ku ta di, Ristës. Baba mori pushkën dhe pasi zuri një pozicion stomë reke, afër shtëpisë së Ristës, filloi me gjuajtje në drejtim të tyre. Ata kthenin të shtënat. U alarmua fshati dhe Baci Rizah në anë tjetër, si kryeplak i fshatit, duke shtënë herë pas herë i afrohej vendngjarjes nga ana tjetër. Kështu dhunuesit morën ikën malit e nuk u dukën më. Në këtë mënyrë u shpëtua edhe shtëpia e Ristës dhe e të gjithë të tjerëve, pasi pas kësaj nuk ka pasur incidente të kësaj natyre, megjithatë, baba me fqinj ka qenë përherë vigjilent. Kështu im atë me fqinj e katundas duke rrezikuar deri edhe jetën i patën mbrojtur me sukses *shkitë tanë* gjatë kësaj periudhe, nga njerëz të pandërgjegjshëm.

E katërta, mbase duket e parëndësishme, por për kohën kishte peshë dhe kjo që im vëlla Aliu, si bari i pati marr nën mbrojtje barijtë e *shkive tanë*, gjatë tërë kësaj periudhe, për mos me i ngucë kush, jo vetëm nga barijtë e mahallave të tjera, po as të katundeve fqinje.

Së treti, ç’është e vërteta kujtoj ndërkohë edhe hapjen e shkollës shqipe në Suharekë dhe entuziazmin lidhur me këtë. Në shkollën e sapohapur tani me mësim në gjuhën shqipe së bashku me ne, ndiqnin mësimet edhe dikush nga serbët (shkijet tanë), sigurisht pa vështirësi gjuhe. Gjatë rrugës e në shkollë ishin nën mbrojtje të shokëve shqiptarë të fshatit. Këtë rast po e përmend faktin se shkollimi i përbashkët ishte lejuar e organizuar nga shteti i atëhershëm shqiptar. Së këndejmi Ali Harshova, kryeinspektor, më 9 shtator 1941 e njoftonte ministrin Ernest Koliqi që në Kosovë janë hapur 202 shkolla me 30.000 nxënës, me 491 mësues dhe pikërisht për serbët autoktonë (*shkitë tanë n.v.) në përgjithsësi shprehej kështu:

“Serbët e vendit nuk janë veçse shqiptarë e vllahë të semisllavizuar nga shkaku i fesë së përbashkët me serbët. Shumë syresh, sidomos në katundet e përziera... ata që e quanin veten serbë flasin shqipen fare mire si edhe ne”.

E vërtetë kjo që, pa kurrfarë rezerve mund të dëshmohej nga gjithkush atëbotë e në vazhdimësi, fakt ky që do sforcohet edhe prej nesh, madje duke e cekur edhe ndonjë shembull konkret të parrëzueshëm.

Së katërti, është e vërtetë, se disa serbjanë edhe të fshatit tonë në vend të shapkave kthyen plisat (e bardhë) në këtë kohë (1941-1944). që i

kishin përdorur si veshë të veten edhe në kohën e Turqisë deri në vitin 1912, përkatësisht deri në vitin 1918. Mendoj se këtu është vendi të theksoj se dukuria e veshës nuk ishte aspak artificiale, po krejt e natyrshme, siç e kishte vërejtur edhe udhëpërshkruesi Ami Boue më 1835, d.m.th. 20 vjet para Milojeviçit duke konstatuar:

“Në fshatin shqiptar dhe serb Rapotovë serbët (lexo e kupto ortodoksët n.v.) ishin veshur me veshë shqiptare, qysh ka ndodhur edhe me serbët përgjatë gjithë Rashkës antike”. (Shih Koha ditore, 13.01.2018.)

Lidhur me konstatimin: *që në në Rapotovë (fshatin e përzier) serbët (ortodoksët n.v.) të veshur si shqiptarët fqinj (lexo e kupto shqiptarët muslimanë ose katolikë) dhe sidomos për gjatë Rashkës antike*, ku *masa ortodokse*, të cilët autori i quan *serbë me veshë shqiptare*, dëshmon të vërtetën jo vetëm simbiozën e kulturës së veshjes shqiptaro-serbe, por edhe simbiozën gjuhësore atbotë, fakt ky që shkenca e re pa tendenca nacionalshviniste tashti duhet ta thotë të vërtetën, apo jo? Edhe kjo çështje do përgjigje, ngase në atë kohë si edhe më vonë edhe te ne të gjithë ortodoksët shqipfolës (shqiptarë) quheshin **serbë** edhe në burimet e shkruara në gjuhën shqipe, siç e kemi vërtetuar katërçipërisht në nënkreun e mëparshëm të këtij punimi. Sido që të ketë qenë, gjithandej e dimë dhe dëshmojmë që te ne në jetën e rëndomtë, si për nga vesha ashtu edhe për nga gjuha sidomos burrat, nga ndonjë i huaj, nuk mund të dallonte serbët nga shqiptarët. Megjithatë, unë po shtoj, se te vesha e grave në fshatin tonë kishte pësuar dallime. Sepse te gratë muslimane, sidomos nën ndikimin e prindëve tanë (Mixhës Hoxhë) sidomos gjatë akupimit serb kishte ndërruar vesha e grave, kishte filluar edhe mbulesa (manteli i zi) etj. që ishte shtrirë edhe në fshatra të tjerë e më gjerë në Kosovën e okupuar.

Së pesti, lidhur me sapo u cek, gratë ortodokse bartnin pshtellakë, ngjashëm sikurse edhe disa gra e vajza muslimane në fshatrat anësore bjeshkatore. Së këtejmi, edhe pse gratë e shkive tanë vërtet ishin të lira, ngase siç dihet nga tradita ishte në nderin e shqiptarit respektimi ndaj gruas, çfarëdo feje qoftë, por në një rast do gra të Mitrajve, për pak e me pësue rëndë(!)... Këtë e kam me të dëgjuar. Ato një ditë në të kthyer nga një *e pame* te Lenka e Tanisit në Suharekë, të cilës i kishte vdekur djali Tanisi, sapo dalin në rrugë për Reçan, me veshën e tyre i bien në sy një konvoji gjerman që ishte në kalim e sipër. Dikush u sugjeron gjermanëve se këto nuk ishin shqiptare-muslimane, po ishin jevreje (!), gjermanët tentojnë me forcë me i futë në një kamion, Baci Rizah, kryeplaku i fshatit,

fatbardhësisht qëllon aty afër intervenon me shpejtësi, i pranon se ishin të familjes së tij (gjë që në njëfarë mënyre edhe ishte e vërtetë), dhe kështu i shpëton nga më e keqja.

Besoj se vetëm këto që u shprehen *ad hoc* nga mbamendja ime mjaftojnë sa për të pasqyruar paksa të mirat dhe të pamirat që familjet tona *shqiptare muslimane* në raport me ato *serbjane ortodokse* i kanë përjetuar aso kohe lufte e robërie për të dyja palët, por, mund të them me plotgojë se ne kishim më shumë të drejta si shqiptarë në krahasim me regjimin e mëparshëm kolonialist serbo-jugosllav shqiptarofob.

3) Nga bashkëjetesa në Jugosllavinë e pas LDB-së

Edhe nga periudha e mbas LDB-së, kur në Juosllavinë federale erdhi në fuqi Partia ose diktatura komuniste me në krye Josip Broz Titon, deri tek regjimi i Milosheviqit, po i shpalo disa kujtime që më duken më me peshë për temën tonë lidhur me raportet ndërfaqinjësore shqiptaro serbo-ortodokse të fshatit tonë:

Së pari, kujtoj se edhe shkijet tanë ose serbjanët e fshatit tonë me rastin e rikthimit të qeverisë serbo-partizane 1944/45, gjatë hallakamave të para, mesa di, asgjë nuk kanë shpifur kundër fqinjve të vet shqiptarë (tani jo turq), apo jo?! Përkundrazi kur i patën burgosur prindët tanë babën, mixhën e të tjerë, serbët e Reçanit paten intervenuar për lirimin e tyre.

Së dyti, sa për rikthimin e kolonistëve, edhe pse në fshatin tone nuk ka pasur kolonistë, po e përmend faktin që ne si familje kemi qenë të detyruar me ndërtue në Sopi një shtëpi për serbë kolonistë të rikthyer.

Së treti, edhe pse parullat komuniste ishin në dobi të bashkëjetesës, politika serboçetnike jo edhe aq nën rogoz si edhe ajo titiste nënrogoz, kundër shqiptarëve vepronte, pothuaj, si në kohën e Krlevinës, megjithatë për shkitë tanë mund të them se si serbë nuk di se do të kenë qenë të privilegjuar, prandaj do të më lejohet të shpreh si prova që në raportin *serbjanë/shqiptarë* të fshatit tonë në çastet e para të regjimit komunist edhe më vonë, nuk janë bërë dallime të caktuara shqiptaro-serbe dhe këtë e dëshmojnë edhe këto fakte:

E para, më 1944 sapo erdhën partizanët, në Brigadën V Sulmuese Shqiptare u mobilizuan *vullnetarisht* katër bashkëfshatarë, vëllai im Smajl Muharremi, Bajram Bajrami (i cili ra dëshmor në Bosnje), Bllagoja i Dosës si dhe Gjorgji i Vasilit (miq e fqinj). Po ashtu pas një kohe, edhe vëllai tjetër Rama u mobilizua bashkë me Lubinin e Simës, të cilët i fusin

në *eshalonin e të dënuarve*(!) në rrugën Prizren-Kukës-Shkodër drejt në kasaphanën *Tivar*. Me fjalë të tjera, të gjithë serbët e shqiptarët e Suharekës këtë rast nuk i kanë pasë ndarë fare sipas etnive.

Po shtoj lidhur me këtë sa për kërshtëri që shakaxhitë e fshatit tonë thoshin: *Mos, vallë, pushteti partizano-çetniko-komunist shkitë tanë nuk i ka konsideruar serbë dhe i dënoj si neve, vetëm pse këta nuk mundën me mësue serbishten gjatë Jugosllavisë së Krlevinës, apo jo?!/*

E dyta, në vitet fill pas LDB, si nxënës, gjatë rrugës për në shkollë, Reçan-Suharekë, iu afrova dy bashkudhëtarëve që i njihja, Stales së Simës dhe Stefan Muhlanit (nip Reçani), të cilëve si zgjatosh, u kanë pasur hijeshi plisat, por që tash i kishin vënë shapka (shajkaqe), edhe pse bisedonin shqip, po sipas gjestikulacionit kishin të bënë për gjëra shumë serioze, andaj Stefani, më tha; *Ik, djali i mirë, çka po i hap sytë, nuk jemi tue hangër pite? S' shkoj shumë kohë, Stefanin si të arratisur e vranë forcat partizane-komuniste, po ashtu si armiq i vranë pa shenj pa dukë, dy simixhët e burgosur të familjes sonë: Bacin Aziz dhe Bacin Qazim, si dhe nipin Haki Hajra.*

E treta, që muhlanasit, reçanasit e sallagrazhdasit me emra serbë ortodoksë si dhe në disa fshatra të tjerë, flisnin e kuptonin kryesisht ose vetëm shqip, ngase serbishten ende nuk e kishin përvetësuar, e dëshmon edhe kjo e vërtetë, sepse për këtë arsye në vitin 1945, një pushtetar i lartë, Spasoje Djaković, aktivistëve të rinj serbjanë nga Reçani e Muhlani u jep **detyrë partije** që ta mësonin serbishten dhe ta përdornin edhe në takime me fshatarët shqiptarë, por mesa dimë kjo detyrë ka qenë e pamundur të zbatohet, jo vetëm me masën e gjerë shqiptare, por varësisht nga rrethanat që u imponoheshin, as edhe brendapërbrenda familjeve të tyre. Kështu si Bllagojë Mitroviqi, nëpunës komune si dhe Zllatan Simiçi, udhëheqës partiak i pazëvendësueshëm i fshatit tonë, edhe pse të lindur e të shkolluar në kohë të Krlevinës serbe, gjatë gjithë kësaj periudhe pas *Çlirimit* (1945), asnjëherë, me palë ose në tubime e oda nuk e kanë provuar ta përdornin serbishten (!), por vetëm shqipen e vendit, madje merrnin pjesë dhe në pajtime mosmarrëveshjesh kryesisht mes palëve shqiptare.

E katërta, më 1952, si mësues në fshatin Mushtisht vura re se shqiptarë e serbortodoksë në një lagje kishin mbiemrin e përbashkët Bytyçi (Bitiqi), emërtim i një fisi të njohur shqiptar. Me këtë dua të them, pa u futur në përimtime, që vetvetiu kuptohet që këta bashkëfshatarë i lidhte etnia e përbashkët fisnore, por i ndante vetëm përkatësia fetare dhe mësimi në shkollë, edhe pse momentalisht ortodoksët flisnin me

nashkesllave, ndërsa muslimanët “*shyp*”, po kuptoheshin qartë me njeri tjetrin në të dyja gjuhët.

E pesta, po në Mushtisht një lagje tjetër quhej me mbiemrin *Budakova*, d.m.th. kishin prejardhje nga ai fshat, në të cilin tani nuk kishte as ortodoksë as katolikë. Këtë fakt po e ndërlihdh me konstatimin e Milojeviçit, e cili këtë fshat Budakovën e shënon pa asnjë serb (ortodoks) që na jep me kuptue se shpërngulja e tyre si ortodoksë në Mushtisht mund të ketë ngjarë më herët se 10 vite para Lidhjes së Prizrenit. Së këtejmi merret vesh se një pjesë e familjes nga Budakova, për ndonjë interes qenka ndarë fetarisht në dysh, të muslimanizuarit mbesin në Budakovë dhe e kanë ruajtur shqipen, ndërsa ortodoksët e shpërngulur në Mushtisht e kanë ruajtur fenë, ngase aty kishte kisha e popa aktivë, por e kanë anashkaluar gjuhën, Raste të tilla kur vëllezërit e së njëjtës familje përqafonin fe të ndryshme që nuk ishin të rralla që dihen edhe sot, si: Bukosh-Dvaran, Reçan–Sopi etj., por ata që e pranonin fenë muslimane (paturizoheshin!) ruanin shqipen, ndërsa ata që mbetnin në fenë e të parëve ortodokse e pranonin emrin serb (pravosllavizoheshin) dhe ndërkohë disa sipas rrethanave e përvetësonin gjuhën nashke, ngase e kishin si gjuhë feje, sigurisht të ndikuar nga gjuha e vjetër kishtare sllave që e përdornin popat në kishat ortodokse pravosllave.

E gjashta, përveç ndihmës në kontinuitet rreth të korrave nga familja Mitri e të tjerë, po vazhdoi ta përmend si mrekulli të pabesueshme se edhe vitet 1952 -1954, kur mua dhe im vëlla na patën burgosur të akuzuar si nacionalistë për veprimtari kundër pushtetit serbosllav!, ajo ndihmë me fuqi punëtore e të tjera ndaj familjes sonë nuk është ndërprerë fare, madje ka vazhduar edhe pas *aksionit famkeq* të dimirit 1955/1956, aksion ky i intrumentuar nga lart, sidomos ndaj familjeve më me autoritet me synim që të prinin për shpërngulje, ku pësoi rëndë edhe familja jonë, ku, djali i mixhës dhe dy vëllezër të mi, për jetë morën deformime këmbësh, por e dinin se pësuan pa fajin e shkive tanë, të cilët edhe pas asaj ngjarjeje u treguan solidarë me ne. Konkretisht, Bllagojë Mitroviqi, sa ishte nëpunës komune, si edhe Zllatan Simiqi funksionar partiak, pas liritimit nga burgu, përkatësisht sapo u ktheva nga shërbimi ushtarak patën nënshkruar deklaratë në dobi të biografisë sime, e vlefshme kjo sadokudo në të mirë të punësimit tim, edhe pse vetëm jashtë krahinëzës dukagjinase.

E shtata, ishte një ngjarje shumë emocionale te ne kur në vitet e’70-a të shekullit të kaluar, na u lejua flamuri kuq e zi, edhe pse me një shenjë-hylli jugosllav, e drejtë kjo që në fshatin tone u jetësua në darsmën

e djalit të Osman Sylës (Veselaj) Nysretit. Si zakonisht në dasëm si krushkë dasmorë ishin ftuar edhe familjet e serbëve. Ishte ftuar edhe Zllatani, sekretari i Partisë së LKJ-së së fshatit. Ky, mësa mësova heziton me ardhë, ngase ishte hidhëruar se ditë më pare disa të rinj të prirë nga im vëlla Baftiu, nipi Kadriu si dhe plaku pleqnar Qamil Hasanaj, nisur nga shtëpia jonë duke brohoritur për *Flamurin KUQEZI, Liri, Bashkim!* dhe ndonjë parullë tjetër të palejueshme për kohën,.. me flamur në dorë, nuk ecin rrugës, por u mëshojnë drejt arave pa rrugë (Agraxhave) e hyjnë mes shtëpive të familjes së gjerë të Simajve dhe pak a shumë ndalen mbase me qëllim provokimi para dyerve të shtëpisë së Zllatani, Mbase dikush nuk e ka pritur mirë këtë manifestim, por siç më kanë treguar po thuaj të gjitha familjet e serbëve i përshëndesin *manifestuesit dhe flamurin shqiptar, të lejuar shtetërisht*. Zllatani paska pasë hezituuar me dalë. Por në ato çaste gruaja e Stales (bijë e Muhlanit) shkon e qorton duke i thënë:

Njëqind vjet fqinj të tanë shqiptarë e kanë nderuar flamurin tonë e ti nuk po ua nderon sot flamurin e tyre. Çohu dil përshëndeti, mos u korit.

Kështu edhe Zllatani disi del sa për të përshëndetur, por mbajti inatin, krushk në darsën e bacit Osman, ku do të printe flamuri shqiptar nuk erdhi, por në vend të tij e dërgoi djalin. Kështu në atë dasëm, ku mora pjesë edhe unë, si kushq së bashku me përfaqësuesit e *shkive tanë* nga Reçani deri në Vraniq në të shkuar e në të kthyer jemi gëzuar duke hedhur valle e duke kënduar këngë me flamur e për flamurin tonë.

E teta, po në vazhdim të viteve të '70-a në Gjimnazin e Suharekës, hartimin më të mirë në shqipen letrare, sipas rrëfimit të drejtorit të gjimnazit, profesor i gjuhës shqipe R. Shala., e kishte shkruar Mirkë Kërstiqi (i Simajve), djali i Stalës, vallë, kah e mësoi aq mirë ai gjuhën *e huaj*, apo ndoshta e kishte *gjuhë nane*, siç është e vërteta, apo jo?! Ishte nip Muhlani. Muhlanasi ortodoksë si edhe e ama e tij flisnin vetëm shqip, madje ajo mbante edhe veshë pothuaj shqiptare.

E nënta, ngjashëm ka ndodhur po ato vite me një vajzë adoleshente shkollare të Brank Dushanit, prindët e së cilës edhe nana edhe baba si selagrazhdas, mesa di, si tërë ai fshat ku kishte edhe katolikë, si më parë, flisnin vetëm shqip, e cila më pati takuar në rrugë dhe më pyeti se *Kush ishin ata kombëtarisht?* Unë i tregova se edhe ata janë shqiptarë sikurse edhe na, sikurse shkrimtarët Anton Z. Çajupi, Fan S. Noli, Mihal Grameno, Asdeni - Aleksanër S. Drenova, Aleksandër Xhuvani, Milosh Gjergj Nikolla etj., veprat e të cilëve mësohen në shkollën shqipe, por që

ata e shumë të tjerë si ata ishin me fe ortodokse, fe kjo, siç e ka edhe familja e saj, ashtu, e ka pasur me gjasë edhe familja ime para islamizimit...

...Mirëpo, fatkeqësisht, edhe nga shkaku i keqkuptimit të *sivëllezërve bashkëfshatarë* muslimanë të prirë edhe nga disa të ashquajtur *profesorë partiashë të asaj kohe* (!), të cilët nuk donin ta qasnin dot farën e tyre *shkavelle*(!) në paralele shqipe, andaj edhe kishin intervenuar për shkollimin e tyre në serbishte, ashtu siç kërkonte edhe Beogradi. Kështu *shkive tanë* ua “*pamundësuan*” ndjekjen e mësimimit në gjuhën shqipe, duke ua siguruar shkollimin gjoja në *gjuhën e tyre amtare*, që në të vërtetë dikush prej tyre nuk e kishte serbishten “*gjuhë të qumështit të nënës*”, apo jo?!

E dhjeta, për dike mbase duket tejet e pabesueshme, por është e vërtetë se edhe gjatë turbullirave të fundit edhe pse mbi 100 vjet serbishtja në këto troje zyrtarisht ka qenë dominuese, ngase ishte gjuhë shteti, gjuhë feje dhe gjuhë shkolle dhe ishte obligativisht e motivuar, sidomos për ortodoksët, janë dëgjuar *serbë* muhlanas e reçanas e të tjerë duke qajtur hallet në mes tyre në gjuhën shqipe?! Kush i detyronte të shpreheshin tash në gjuhën *armike*?! Vallë, e kishin shqipen të ngulitur me dhunë apo e kishin të trashëguar brez mbas brezi si gjuhë komunikuese amtare të veten të rrënjosur me shekuj, apo jo?! E vërteta sigurisht kuptohet, por ka pasur e ka nevojë të esëllohen edhe disa nga shqiptarët, të cilët mbase ende nuk e njohin sa e si duhet nocionin rreth identitetit të shqiptarit, të cilët ende mbase i përziejnë shqipfolësin autokton me nocionin fetar: turko-arab, latino-italian apo greko e serbo – bullgaro ortodoks(!).

Si përfundim mund të themi edhe nëse kanë ndodhur ndryshime ose acarime politike në Federatën jugosllave ose në relaçonin Serbi-Kosovë, nga sa u shprehëm deri këtu mund të konstatohet se në fshatin tonë raportit shqiptaro-serb në periudhën gjatë sundimit të Titos kryesisht ka qenë në raporte normale.

NËNKREU VI

POLITIKA SHTETËRORE ALBANOFUBE ME PASOJA FATALE NË RAPORTE NDËRFQINJËSORE SHQIPTARO-SERBE EDHE NË FSHATIN TONË

Në këtë nënpjesë në raportin fqinjësor shqiptaro-serb të fshatit tonë në periudhën e acarimit politiko-shoqëror pastitoist në Jugosllavi, sidomos kur milosheviqët morën masa gjoja për mbrojtjen e serbëve në Kosovë, duke i kufizuar edhe më shumë të drejtat institucionale e njerëzore të shqiptarëve e njëkohësisht edhe të shkive tanë, do të permendim vetëm disa masa e ngjarje të sprovuara, gjithsesi të përjetuara edhe personalisht lidhur me fshatin e vetveten, të cilat po i shpreh në tri aspekte:

Së pari, disa hallka të pakëputura njerëzishmërie në të mirë të respektit të ndërsjellë të trashëguar ndërfaqinjësisht, përkundër politikës zyrtare shtetërore përçarëse.

Së dyti, disa nga masat intriguese shtetërore të imponuara ndaj shkive tanë në dëm të bashkëjetesës ndërfaqinjësore shqiptaro-serbe në fshatin tonë e më gjerë, dhe

Së treti, pasojat e vazhdimit të një politike të tillë të vjetër dhe të re në ntrashjen me lloj-lloj diskriminimi dhe hegjemonizimi kolonialist nga shteti i Serbisë në njërën anë dhe kërkesat në rritje të lëvizjes shqiptare për çlirim nga ai kolonializim, nga ana tjetër, që sollën Luftën UÇK, lufta sollti viktima dhe si rrjedhojë edhe dramatizimin fatal të shpërnguljeve.

1) Disa nga të mirat e përjetuara prej nesh nga shkijet tanë fqinj gjatë e deri në periudhën e fundit që kujtohen me respekt dhe që nuk mund të harrohen dot

Meqë gjatë kësaj periudhe unë nuk kam jetuar në fshat, do të përmend vetëm disa nga të mirat e përjetuara personalisht gjatë fazës së fundit që nuk mund t'i largoj nga kujtesa:

Së pari, kur fillova me ndërtue një shtëpizë në Reçan, në truallin e trashëguar, Zllatani, i cili ende mbahej si i pari i fshatit më takoi ma bëri përhap, duke theksuar faktin që edhe pse ka humbur ai solidariteti fqinjësor që kemi pasur përpara në raste të tilla, ai më ofroi ndihmë bile si argat: *djalin me traktor*. Në të vërtetë, nuk pati nevojë me kërkue fare ndihmë nga askush, edhe pse pothuaj të gjithë pa dallim e sidomos vëllezërit e katundësit pa dallim mëzi pritnin me më ndihmue për çdo rast, derisa shtëpizës dykatëshe i vuna çatinë.

Së dyti, kur në Kosovë kishin filluar acarimet shqiptaro-serbe të nxitura dhe të orkestruara kryesisht nga politika shtetërore milosheviçiane edhe në fshatin tonë ishin dërguar gjoja për siguri të popullatës serbe disa

policë nga Serbia etj., pata rast të dëgjoja mendimin e bashkëfshatarëve ortodoksë të moshuar nga të tria familjet: të Zllatanit të Simajve, Stanomirit të Mitrajve dhe Jovanit të Petrajve, të cilët pothuaj ishin të një goje që ndihmat e tilla ishin me sherr dhe shumë të dëmshme për vetë serbët, ngase policët e huaj të pamoralshëm po futeshin në shpiti të tyre të ndershme pa nevojë, sepse në rast trazirash, sipas tyre, kush mundet, pos fqinjve të vet shqiptarë, me i ruajtë një grusht serbësh, 30 familje ndaj 200 e sa shqiptare vetëm të fshatit, pa e llogaritur rrethinën, pothuaj krejt shqiptare!? Vërtet gjykime me vend që ia vlen të atëherë dhe ia vlen e sot të mbahen mend e të respektohen nga të gjithë edhe nga krentë e Beogradit. Po si duket disa të rinj edhe të fshatit tonë atëherë ishin infektuar nga propaganda politike kolonialiste serbomadhe.

Së treti, pikërisht në këtë kohë pati ndodhur një aksident shumë i pamirë mes shtëpisë sonë dhe familjes së Mitrajve. Një djalë i asaj familje vishet si për ditë feste dhe niset me shkue të halla Tinka që ishte e martuar me Nisën e Todës (të Petrajve) në anën tjetër të fshatit. Rruga binte rreth lumit, jo larg shtëpisë sonë. Fatkeqësisht, një djalë i djalit të vëllait adoleshent ndodhej te lumi dhe gjuan atë me gur ashtu kot dhe për fat të keq guri ia përgjak fytyrën. Djali kthehet në shtëpi i përgjakur. Çështja alarmohet keqas. Familja *e të përgjakurit* kishte dhimbje e shqetësim. Familjen tonë gjithashtu e kaplon ankthi. Çka do të ndodhë?! Pritej që milicia, e cila veç qëndronte në fshat, të ndërmerre masat e duhura. Pritej propagandë kundër shqiptare përmes masmedias, si pasojë priteshin edhe marrje në pyetje, arrestime etj. Aq më keq druhej që babës së *dorasit t'i* merrej pasaporta dhe do të humbte punën në Gjermani, etj.- etj. Mirëpo, mos me zgjatë, familja Mitri, përkundër dëshirës së nxitësve të konflikteve vendosin ndryshe. Aksidentin e klasifikojnë si *punë fëmijësh*. Nuk vonojnë, Zllatani, Bllagoja, babai çunit të lënduar erdhën në odën tonë dhe si burrat *e falën fajin e fëmijës axhami*. Vërtet, nuk ishte ky vetëm gjest bujar në ato situata, po ishte vepër tejet madhore njerëzore që nuk mund të harrohet dot për jetë e mot.

Së katërti, pas fushatës së parë të djegieve nga ushtria serbe edhe pse pak e dëmtuar kishte shpëtuar pa u djegur vetëm shtëpiza ime pjesërisht e meremetuar, por e pabanuar, e cila u gjet ndërkohë si një strehë e domosdoshme gjatë kthimit të familjes së vëllezërve pas fushatës së dëbimit të parë, por njëherazi na shërbeu si vend tubimi ku u krye ceremonia e varrimit të një bijes sonë, vajzës së vëllait, e cila kishte humbur jetën në një aksident komunikacioni në Gjermani. Droja ishte e

madhe, pasi dikush nga fqinjët serbë kishte njerëz të humbur dhe kishte mundësi të zgjidhte një kënd dhe pa u vënë re me tejkëqyrë tëurvejonte terrenin rreth shtëpisë sime, meqë pritej që disa e sidomos vëllai i së ndjerës, i cili ishte njëfarë eprori në UÇK, mund të vinte për takimin e fundit përshëndetës me motrën e ndjerë... Por në saje të burrnisë e njerëzishmërisë së tyre (serbëve të fshatit) nuk ndodhi kurrfarë spiunimi. Madje edhe e **pamja** përfundoi pa kurrfarë incidenti. Së këndejmi, edhe ky rast tejet burrnor i *shkive tanë* fqinj, meriton falenderim e respekt të veçantë njerëzor, apo jo?!

Së pesti, po aso kohe, duke shkuar në fshat pata aksident me veturë në Grykë të Carralevës, dhe m'u desht sipas rregullit qytetar rastin me paraqitë në Stacionin e Policisë në Suharekë, ku Stacioni ato ditë ishte vënë nën kontrollin e forcave të shumta policore të ardhura nga Serbia. Në ato momente kur më ka parë dikush duke hyrë në *Stanicë*, lajmërohet **Mirku i Simajve**, i cili vrik e vrik erdhi me më shpëtue, dhe kur e mori vesh të vërtetën më përshëndeti për zemërsisht dhe dolëm së bashku prej andej, secili në punë të vet. Vërtet gjest bujar që për jetë të jetëve nuk mund të harrohet dot?!

Së gjashtë, po ashtu në ato situata të turbullta, m'u desh patjetër me i nxjerrë disa dokumenta në Suharekë, për vete e për fëmijë që ishin jashtë. Të gjithë nëpunësit shqiptarë ishin përjashtuar. Disa nëpunës serbë të mbetur mezi pritnin të bojkotonin, sidomos të kacagjeloheshin ndaj ndonjë intelektualit me emër *nacionalist-iredentist* shqiptar nga Prishtina, mirëpo përkundër vërejtjeve interne nga **bosët sheshelistë**, më thanë se punën në Komunë po ta kryen një **yti**, një i familjes Mitri ose Sima që unë nuk e njihja, ndërsa në postë të Suharekës, edhe pse dikush më parë më refuzoi, **Sava i Angjellkit** tonë, nga familja e Petrajve, madje duke u fjalosur me të tjerë, m'i rregulloi dokumentat. Së këtejmi, assesi nuk mund të harrohen edhe këto të mira, andaj edhe i shënova në shenjë respekti të veçantë për mirëbërësin e panjohur dhe Savën e teta Velikës së Angjellkit.

Së shtati, po në ato situata i dërgova disa dokumenta e dorëshkrime e libra në shtëpizën time në fshat, duke menduar se ajo shtëpizë nuk do të digjej, pasi për shtëpinë në Prishtinë nuk isha i sigurt. Sapo kreu punë, me që isha pa veturë, me t'u kthyer në qendër të fshatit, dy vajza të familjes Mitri, më treguan se meqë nuk kishte kurrfarë mjeti udhëtim të pritja një minutë se tani vjen një autobus punëtorësh nga Muhllani dhe unë mund të udhëtoja me të. Vërtet, autobusi erdhi, po pasi ai ishte i destinuar vetëm për punëtorë serbë të Uzinës së shiritave në

Suharekë, hezitova me hypë. Të dyja vajzat, duke respektuar përparësinë, pothuaj më detyruan të hipja në autobus. Pati reagime nga dikush, Mirko që kishte qenë aty i qetësoi, duke më afruar pranë vetes dhe e ndali autobusin te Stacioni, ku duhej të zbritja. Edhe ky gjest i dy vajzave Mitri dhe i Mirkos, kur kemi parasysh situatën, ishte vepër e veçantë që assesi nuk do harruar, apo jo?!

Së teti, po e përmend si pikë të fundi edhe një vepër madhështore të jashtëzakonshme të Stanomirit të Lubinit të Petrajve, që tash së voni e kam dëgjuar nga bashkëfshatarët e mi. Stanamiri i Lubinit, edhe pse ato ditë e kishte pasur një djalë shkollar e një mik të humbur, në vend që të shprehte mllef, ky, burrë, njeri, në fushatën e fundit të dëbimit të shqiptarëve i shpëtoi nga më e keqja, pa ra në dorë të militarëve serbë, dy të rinj djelmossa të fqinjve, nipin e Durmishit dhe djalin e Muhametit, të cilët i strehoi në familjen e tij, duke rrezikuar kështu veten e familjen, ngase atëherë ishte urdhëri që kush ndihmon shqiptarët dënohet dhe me pushkatim. Ndërkaq Stanamiri aq më tepër, këta dy të rinj ndërkohë shëndosh e mirë i ka përcjell sipas kanaleve të sigurta që të bashkohen me familjet e tyre në Shqipëri.

Sigurisht kanë mbetur edhe shumë e shumë të mira të tjera pa u përmendur të **shkive tanë**, përkatësisht të bashkëfshatarëve tanë ortodoksë që u kanë bërë fqinjve të vet shqiptarë, por ne po përfundojmë me kaq.

2) Disa nga të pamirat e imponuara nga qeveria serbe, plagë të hapura për të dyja palët

Këtu do të përmend disa nga të këqijat që nuk duhen harruar, të cilat nuk ishin sajim i fqinjve tanë otodoksë, por ishin masa të planifikuara nga lart, nga shteti kolonialist antishqiptar i Serbisë, siç ishin:

Së pari, nxitja e të rinjve dhe anëtarësimi i tyre në partitë nacionaliste ekstreme serbo-pravosllave dhe mosshoqërimi me shqiptarë.

Së dyti, ndërprerja e të pameve dhe të darsmave në fshat, si dhe injorimi i shqipes dhe i ceremonive dhe të ndërmarrjeve të përbashkëta në fshat.

Së treti, sjellja e policëve serbë nga Serbia, gjoja për ruajtjen e tyre, por qëllimi ishte inskenimi i konflikteve ndërfaqinjësore me shqiptarë.

Së katërti, veprimi propagandues me muzikë serbe provokuese, duke lëshuar këngë e marshe

çetnike nëpërpërmjet altoparlantash me zmadhim enorm zëri etj.

Së pesti, vendosja e parullave shesheliste anë e mbanë mbi rrugë përballë kishës e në dalë të fshatit me qëllim iritimi të bashkëfshatarëve shqiptarë, por edhe udhëtarëve të fshatrave të tjera gjithandej.

Së gjashti, aq më keq disa të rinj jo vetëm pranuan të armatoseshim, por edhe të kacagjeloeshim dhe me armë të llojllojshme ndaj moshatarëve fqinj shqiptarë.

Së shtati ndërkohë aktivizimi e uniformëzimi i të rinjve në milici dhe bashkëpunimi me policinë e ushtrinë serbe që shërbenin edhe si informatorë, ku shihej qartë distancimi me bashkëfshatarët shqiptarë.

Së teti, aq më keq me inskenime dhe me të shtëna armësh njëherë në formë ahengjesh e pastaj edhe kundër shtëpive të shqiptarëve, gjoja me pahir pa këkuar falje.

Së nënti, pjesëmarrja aktive si të mobilizuar në dëbimin e fqinjve shqiptarë, (pleqve, grave e fëmijëve) nga shtëpitë dhe djegia e tyre, pa harruar sidomos ato me karakter historik (odave) të shqiptarëve gjatë fushatës së parë etj.

Së dhjeti, mosofrimi i asnjë ndihmë, së paku ngushëlluese, me rastin e kthimit të fqinjve në shtëpitë e djegura të tyre pas afensivës së parë të ushtrisë serbe kundër popullatës së pambrojtur.

Së njëmbëdhjeti, aktivizimi provokativ i tyre në rafalimin e shtëpive të fqinjve shqiptarë që përpiqeshin me i sanue shtëpi-gërmadhat e tyre, para e gjatë përgatitjes së fushatës së dytë.

Së dymbëdhjeti, refuzimi i propozimit nga shqiptarët për aleancën mbrojtëse reciproke të familjeve (grave, fëmijëve, pleqve etj.), qoftë nga UÇK-ja, qoftë nga Ushtria e Milicija serbe.

Së trembëdhjeti, pjesëmarrja aktive në fushatë-ofensivën e dytë të dëbimit të shqiptarëve, zbraze rafalash të panndërprera kundër masës shqiptare në ikje.

Së katërbëdhjeti, pjesëmarrja në plaçkitjen dhe djegien e shtëpive edhe atyre gjysmë të djegura si dhe dëmtimit të shkollës dhe të xhamisë së fshatit.

Së pesëmbëdhjeti, pjesëmarrja në maltretime ndaj familjeve të dorëzuara ose të zëna robë maleve e rrugëve të parrugë.

Së gjashtëmbëdhjeti, pjesëmarrje në vrasje tek tuk dhe prekja në moral (dhunimi i grave, nuseve e vajzave shqiptare) gjatë kohës së Luftës, para depërtimit të tyre jashtë vendit etj.

Së shtatëbëdhjeti, maltretim e plaçkitje të kolonave shqiptare në ikje e sipër për Shqipri e Maqedoni etj.

Për të gjitha këto nuk duhet fajtuar masën ortodokse, por vetëm individët e caktuar të përlyer edhe pse ishin të nxitur nga regjimi kolonialist antishqiptar i Serbisë milosheviçiane.

3) Pasojat fatale në raportin ndëretnik të fshatit si rrjedhojë e politikës shqiptarofobe milosheviçiane dhe e luftës së papastër gjenocidale

Nga pasojat e vazhdimit të një politike të tillë shqiptarofobe të vjetër dhe të re gjithnjë diskriminuese e hegjemoniste ndërfaqinjësore nga shteti kolonialist i Serbisë ndaj Kosovës e shqiptarëve në një rën anë dhe kërkesat në rritje të Lëvizjes shqiptare për çlirim nga kolonializmi serbian, në anën tjetër, sidomos në vitet e '80-a u krijuan probleme të mëdha të ndërlikuara në raportin Serbi-Kosovë që nuk mund të mbetnin të panëpërdokshme, edhe për syrin e logjikës të disa shteteve të mëdha, të cilat në bazë të etikës të së drejtave të njeriut dhe paksa dhe për interesa të ruajtjes së paqes në rajon, ngase paqja ruhet kur të gjithë i gëzojnë të drejtat që u takojnë, u përzien për të mirë rreth zgjidhjes së kësaj çështjeje që kishte rrënjë kolonialiste që nga koha e shpartallimit të Perandorës Osmane në Ballkan, më parë dhe sidomos në vitete e para të shekullit XX. Në të vërtetë ndonjëra prej atyre fuqive të mëdha në njëfarë mënyre drejtpërdrejt e kishte mundësuar atë kolonializim në dobi të Serbisë, andaj edhe filluan tëurvejonin situatën, e cila gjithnjë e më tepër përshkallëzohej me acarime që jepnim shenja parakonfliktuoze serioze, së pari u organizuan demonstrata, u shfaq dukuria e formimit i partive politike demokratike mbi bazë nacionale, lindën edhe organe e organizma ilegalë e gjysmëilegalë, madje edhe gjysmështetëror dhe shtetëror nën hije, u orgnaizuan edhe zgjedhje pa leje të regjimit zyrtar, u zgjodh presidenti (popullor) i Kosovës, madje u formua edhe qeveri paralele e Kosovës (në ekzil). Ndërkohë u shfaq tek-tuk edhe guerila dhe në fund plasën beteja guerile si dhe më në fund u legalizua UÇK-ja, e eila si ushtri forcërisht aspak nuk mund të ishte e balancuar me Armatën e rregullt ushtarake të Serbi-Jugosllavisë. Në këtë atmosferë lufte Shteti i Serbisë, duke angazhuar forca paramilitare, policore dhe ushtarake bëri krime gjenocidale fatale ndaj popullsisë së pambrojtur civile shqiptare dhe si oponentë ngjau edhe animi i disa shteteve të mëdha demokratike në dobi

të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe më në fund ndodhi edhe konfrontimi politik ndërkombëtar i hapur kundër qëndrimit arrogant të shtetit serb që nuk pranonte me zgjidhje çështjen me marrëveshje, në mënyrë paqësore. Sidoqoftë, lufta si lufta solli viktima dhe si rrjedhojë ndodhën krime tejet monstruoze nga ana e Serbisë ndër to edhe ofensiva e parë (1988) kundër banorëve të pambrojtur shqiptarë banorë të fshatrave anembanë Kosovës, pra edhe të banorëve të fshatit tonë, të cilëve ua dogjën shtëpitë, por ndërkohë përsësi u kthyen në shtëpi-gërmadha të veta, duke bërë përpjekje adaptimi sa për ekzistencë, mirëpo shteti serb nuk ndalet me kaq.

Ndërkohë, nga ai shtet u vazhdua me masakra edhe më të pamëshirshme, më makabre kundër popullsisë civile dhe njëherazi paraqitej gjithnjë e më arrogant ndaj kërkesave paqësore nga shqiptarët e ndërkombëtarët, andaj u bë edhe konfrontimi që solli edhe bombardimin e forcave serbe nga NATO. Pikërisht në këtë kohë Ushtria serbe në fshatra e qytete të Kosovës përdori afensivën e dytë, duke përsëritur djegien e shtëpive dhe njëhazi duke bërë dëbimin masiv të shqiptarëve jashtë. Kështu pësuan edhe banorët shqiptarë të fshatit tim, të cilët u detyruan të kërkonin shpëtim në male dhe më në fund, shumica e të cilëve gjetën ekzistencë në Shqipëri, por edhe në Maqedoni dhe së andejmi në Europë, Amerikë e anembanë botës. Mos me zgjatë ndërkohë si kusht i Marrëveshjes së paqes, përkatësisht i armëpushimit që u detyrua ta pranojë Serbia ishte që para se të ktheheshin shqiptarët e dëbuar nga ekzili Ushtria akupuese serbe patjetër duhej me u tërheqë nga Kosova. Ashtu dhe ndodhi. Mirëpo ajo ushtri tërhoqi me vete në Serbi edhe një numër të konsiderueshëm të *shkive tanë, edhe ata* nga fshati ynë. Në të vërtetë, këtë shpërngulje të serbëve si edhe atë muaj më parë të shqiptarëve i kam ndjerë si dhembje dhe humbje e pariparueshme tragjike për vetë shkitë fqinj të tanë, por edhe për ne si fqinj shekullor të tyre.

Po përsërisim, një tragjedi e tillë ka ndodhur si *“pasojë e politikës së hershme e të re kolonialiste serbomadhe të Kishës e të Qeverisë serbe, e cila vetëm e vetëm për interesa të veta kolonialiste, duke shfrytëzuar krishtërimin si fe të përqafuar nga shqiptarët me qindra e qinda vitet para ardhjes së sllavëve këndej dhe duke injoruar njëherazi gjuhën shqipe dhe ortodoksinë shiptare si kriter i së vërtetës si dhe me luftën tejet të papapastër shnjerezore që zhvilloi për të ruajtur Kosovën si koloni, arriti që edhe shkitë tanë me i përbaltë dhe me ua gjakosë duart e shpirtin, duke i keqpëdorur si vegla qorre kundër fqinjve të vet, pa pasur dhimbje që në këtë mënyrë vetë atyre po ua humbë pasurinë më të madhe që kishin:*

autoktoninë dhe bashkëjetesën me shqiptarët në këto troje, me të cilët e kishin të përbashkët historinë, gjakun, madje edhe gjuhën e zemrës e të mendjes, apo jo?!

Ç'është e vërteta, personalisht më duhet të rrëfhem rreth këtyre ngjarjeve. Deklaroj, me përgjegjësi morale e të tjera se prej se jam bërë me dijtë, unë kam qenë me mish e shpirt që me çdo kusht e masë gjithsesi edhe me luftë për Çlirimin e Kosovës dhe të shqiptarëve nga kolonializmi serb dhe për bashkimin e trojeve shqiptare të ndara padrejtësisht, për çka edhe kam vepruar me të gjitha fuqitë e mia, ilegalisht e gjysmë- ilegalisht, por edhe drejtpërdrejt e guximtarisht me punë e shkrime. Kështu kam vepruar edhe pa e sidomos kur sadopak më është dhënë mundësia, madje e kam pasur të formuar bindjen se për një kauzë të tillë ia vlente me flijua edhe jetën time dhe të fëmijëve të mi, Kjo është arsyeja që i kam duruar stoikisht pasojat e burgut tito-rankoviçian, të izolimeve e të arrestimeve të herëpas-hershme, të përjashtimeve 7 herë nga puna në arsim, i kam duruar përndjekjet, poshtrimet, bojkotimet rreth botimit të krijimeve letrare e shkencore, madje për këtë kauzë gjatë luftës nga zona e lirë jam kthyer në Prishtinë, në shtëpinë time të rafaluar e të granatuar pasi djalin e kam udhëzuar drejt mobilizimit në UÇK që fundi i fundit që veç tjerash ta kishte për motiv edhe çlirimin e vendlindjes, kur i presin prindërit ose të gjallë ose së paku varret e tyre. Pas këtij amaneti, me gruan dhe me vëllain jam kthyer në Prishtinë, ku kam vepruar sipas kaçikut tim dhe vërtet jam tejet i lumtur që ndodhi Çlirimi e Pavarësia e Kosovës. Por kurrë nuk më ka shkuar mendja që në këtë luftë do të pësonin e përjetonin siç kanë pësuar e përjetuar bashkëfshatarët e mi paqësor nga të dyja palët krejtësisht të pafajshëm. Pra, jo vetëm vuajtje të papara morale e materiale, por edhe humbje më të dashurish (fëmijëve të tyre). Kurrë nuk më ka shkuar mendja që politika shtetërore serbe do jetë aq e paskrupullt antihumane sa të helmojë aq shumë marrëdhëniet ndërfaqinjësore të *shkive tanë me shqiptarët* e të njëjtit gjak e gjuhë kombëtare në fshatin tim të lindjes. Këtë ajo e arriti, së fundi jo aq propagandisht, por me zjarr e hekur, duke i detyruar në njëfarë mënyre që edhe *shkitë tanë* të jenë pjesëmarrës në dy fushatat e egra e në vazhdimësi kundër fqinjve të tyre shqiptarë, duke ua djegur shtëpitë dhe njëherazi pas lloj-lloj presionesh e maltretimesh i bëri pjesëmarrës në dëbimin e fqinjve jashtë vendit. Me që unë, siç e thashë, më mirë e kam pranuar vdekjen se shpënguljen me dhunë, sipas devizës:

...dhe në vuaj, le të vuaj, të mos tretim në dhe të huaj...!

*vërtet kam shprehur kënaqësinë, zemra më është bërë mal, kur u shpall paqja dhe filloi kthimi i bashkëfshatarve nga ekzili, por njëherazi kam ndjerë dhembje në shpirt kur arrita në fshat nga Prishtina pothuaj një ditë pas shpërnguljes së Ushtrisë Serbe që i kishte marrë me vete në rrugën e vet pa kthim, edhe **shkitë tanë** (ortodoksë) gjithandej, pa fajin e tyre e as të fqinjve shqiptarë, por për fajet e grumbulluara me qinda vite të kolonialistëve të pashpirt serb të Beogradit zyrtar të ndihmuar edhe nga kisha pravosllave serbe, uzurpuese e kishave tona, apo jo?!*

Përkundër të gjithë kësaj tragjedie të ndërsjellë që u ka ndodhur të dy palëve të bashkëfshatarëve të mi, sot e ndjej njëfarë krenarie, sepse, siç do ta shpreh më poshtë asnjëra palë nuk shpreh mllef e urrejtje ndaj palës tjetër:

Së pari, e kam me të dëgjuar drejtpërdrejt, është intresant edhe pse *shqiptarët* (muslimanë) të fshatit tim gjatë kësaj katrahure patën aq shumë vuajtje morale shpirtërore e materiale, por edhe viktima në njerëz (një të humbur e 4 dëshmorë të kësaj lufte dhe me dhjeta të plagosur që ende dikush plumbat nga lufta i mban në shtat) prej askujt e nuk kam dëgjuar fjalë që fajësojnë konkretisht *shkiet tanë* bashkëfshatarë, për këto vuajtje, edhe pse, me sa pamë nga 17 pikat e mësipërme, edhe ata nuk ishin krejtësisht të anashkaluar si pjesëmarrës në vuajtjet e fqinjve të vet shqiptarë dhe

Së dytë, po në anën tjetër, e kam me të lexuar nga masmedia, edhe *shkitë tanë* (ortodoksë) edhe pse tashmë si serbë të shpërngulur në Serbi, në intervistat e dhëna nuk kanë shprehur ndonjë ankesë në sjelljen e fqinjve të tyre shqiptarë, përkundrazi vetë Tanisi e Slobodanka e Simajve, që i paskan dy djem të humbur, nuk kanë folur keq për fqinjët, përkundrazi, te fqinjët shqiptarë kanë gjetur ngushëllim e keqardhje, me të cilët përherë kanë kaluar mirë, madje edhe në atë kohë lufte kanë vizituar miqtë familjarë pothuaj me lidhje sivëllamërie në fshatra të tjerë shqiptarë, pa pësuar gjë. Madje as familja e Stanamirit të Petrajve që ka humbur birin shkollat, jo vetëm nuk fajëson fqinjët, po ai i shpëtoi dy djem të fqinjve, madje as nga ai e familja e tij nuk është dëgjuar asnjë fjalë e keqe për fqinjët e vet, ashtu si dhe nga të gjithë shkitë tanë tani të hapërdarë gjithandej nëpër Serbi.

Kështu, nga mendjet e shëndosha të dyja palëve si më përpara dhe tashembastashti, përkundër fatkeqësive e katrahurave të përjetuara kanë fytyrë, jo vetëm të takohen, por ata edhe mund e duhet të bashkëpunojnë e ta gëzojnë jetën dhe shmallen fqinjërisht.

Përmbyllje

“Rreth injorimit të gjuhës shqipe si kriter për shkak të fesë ortodokse në përcaktimin e kombësisë të **shkive tanë** në përgjithësi dhe të atyre të fshatit Reçan në veçanti”, ndër të tjera është konkretizuar e vërteta e mohuar nga pala serbe, po e pamohueshme nga realiteti, e vërteta e sotme dhe historike, ngase sipas ndërlidhjes etnike e gjuhësore shqiptaro-serbe vërtetohet që nga mesjeta simbioza shqiptaro-serbe, siç pohohet pa mëdyshje në dy nënkrerët e mëparshëm të këtij punimi po në këtë pjesë del edhe më konkretisht në fshatra e qytete anembanë Kosovës e më gjerë e në veçanti në fshatin e lindjes së autorit Reçan të Suharekës, fshat ky, i cili në bazë të disa mikrotoponimeve në përdorim, pasqyron realitetin historik që nga lashtësia, ku gjuha shqipe del parësore, por pa përjashtuar edhe edhe elemente të gjuhës së vjetër sllave sidiglosi, emërtime këto që nëse merret si e vërtetë historia serbe janë më të hershme se shekulli XIV, kur përmendet ky fshat në një kartë të Stefan Dushanit. Veç tjerash në këtë nënkrye u manipulua për të mirë edhe me termin perifrastik popullor **shkitë tanë** ose **shkitë e vendit** me kuptimin *ortodoksë shqipfolës* të popullatës së Kosovës kundrejt **serbëve të Serbisë** dhe si shembull u morën shkitë e katundit Reçan e të disa fshatrave të tjerë si Muhlan, Sallagrazhde etj., po të asaj ane, por që nuk përjashtohen dhe shumë e shumë fshatra të tjerë e familje qytetare në mbarë Kosovën, në Serbi, Mal të Zi e Maqedoni.

Sidoqoftë, meqë qëllimi kryesor i kësaj vepre është që opinioni i gjerë jo vetëm serb e shqiptar por edhe ai europian e më gjerë, të njihet me të vërtetën, për shkakun se ku dhe te kush qëndron faji kryesor për prishjen e atyre marrëdhënieve që shkaktoi luftën, ku fajtorë adlin levizjet nacionalëiste ekstreme serbe në njërën dhe ajo osmane naciobaliste rijotrurke në anën tjetër, ngase që nga filltet e shekullit XIX edhe Turqija sunduese, për qëllime vazhdime pushtetore, ka shfrytëzuar fenë islame ashtu si edhe Serbia fenë ortodokse si mjet përçarës vëllavrasës në kurriz të etnisë shqiptare. E para me ruajtje pushtimin, ndërsa e dyta për synime jo vetëm autonomizimi, por edhe ekspansioni e robërimi të asaj etnie. Së këtejmi ne duke zbardhur këtë të vërtetë, duke u mbështetur në realitetin e sotëm, duam të ndihmojmë konkretisht në arritjen e një paqëtimi të sinqertë e të plotë pa intriga e ndërskamca mes etnive serbe e shqiptare, pa lënë asnjë shibël urrejtjeje mes tyre, bile edhe me kërkimfalje për vuajtjet e popujve për shkak të politikës kolonialiste serbomadhe të deritashme,

ashtu siç e kërkon njerëzishmëria dhe bashkësia demokratike europiane e amerikane, andaj ne këtu po e mbylлим, këtë paraqitje, duke bërë me dije lexuesin që edhe në kreun vijues do të paraqiten fakte plotësuese të vjetra e të reja në dobi të këtij synim paqetimi.

Së këtejmi kërkojmë të esëllohen të gjithë të frustruarit, por edhe të manipuluarit e sidomos të vijnë në vete edhe krerët e Shtetit dhe të Kishës Serbe, në njërën anë dhe tdisa oponentë shqiptarë mos të shfaqin ndonjë krenari e mendësi folklorike euforike hakmarrëse me ngjyresë fetare, në anën tjetër, në mënyrë që të arrihet një paqe e vërtetë me ndërgjegjësim të plotë mes dy popujve serbë e shqiptarë, deri në atë fazë mirëkuptimi saqë edhe shqiptarët mund t'i kërkojnë paqesisht kushërijtë e vet Gërgurë, Gashiq etj, etj deri në Nish e përtej, ashtu edhe shkitë, kushëri të moçëm serbë nga Nishi e përtej tutje, e sidomos *shkitë tanë* të saposhpërngulur, shqipfolës ose jo, edhe nëse i kanë shitur pasuritë e tyre, ata me fytyrë njerëzishmerie, të kthehen së paku si musafirë te fqinjët e miqtë vet shqiptarë, te varret e të parëve, ngase ata nuk ishin aspak fajtorë për fatkeqësitë e shkaktuara mes dy palëve, fatkeqësi e përbashkët për të dyja palët tash 200 e sa vjet, sidomos në ngjarjet e fundit, por fajtores kryesore ka qenë dhe mbetet politika hegjemoniste ekspansioniste kolonialiste serbomadhe e ndihmuar nga Kisha Pravosllave, e cila mbase pavetëdijshëm ka mbjellë e po mjell edhe sot urrejtje serbo-shqiptare, duke injoruar gjuhën shqipe deri edhe të bashkëfetarëve të vet ortodoksë, duke mashtruar shumëkënd dhe veveten me trillime të gënjeshtërtë (izmislotina) që Kosova me kishat e manastiret ortodokse ka qenë vetëm trualli i të parëve njënacional serbë, duke injoruar shumicën e përhershme autoktone shqiptare ortodokse, që për islamizimin e tyre me qendrimet e veta nacionaliste ka ndihmuar turqit osmalli, sepse të dyja palët edhe serbët edhe turqit ia mohopnin etninë, injoronin gjuhën shqipe si kriter të së vërtetës.

Themi kështuj, ngase mjerisht etniteti që prej nesh u quajt **shkitë tanë** në Kosovë e më gjerë, del i injoruar jo vetëm nga Shteti e Kisha pravosllave serbe, por edhe nga sivëllezërit e tyre muslimanë e-katolikë shqiptarë, madje edhe nga vetvetja për mungesë koncepti dhe për shkak të kushteve që ende po pamundësojnë një ndërgjegjësim të tillë, po për këtë me shumë e më qartë në kreun vijues.

Kreu VI

SHQIPJA SI PROMOTOR I ZGJIMIT DHE RITËS SË SHQIPTARISË NDAJ NACIONAL-SHOVINIZMI SERBOMADH, DHE VATRAVE TË TJERA PENGUESE

Hyrje

Për të qenë më i qartë mesazhi që del nga titulli i këtij kreu: *“Shqipja si promotor i zgjimit dhe rritës së shqiptarisë ndaj nacional-shovinizmi serbomadh dhe vatrave të tjera penguese”* që ndërlidhet me temën rreth vlerësimit kritik të veprës së M. Milojeviçit (1866-1873), si pjellë e veprimeve të vatanëve të nacional-shovinizmi serbomadh e të tjerë që u shfaqen që në shek. XIX nga *“Naçertanie”* e Garashaninit (1844), projekt ky, të cilën e përpunuan në vazhdimësi dhe kështu në atë frymë deri sot *“u hartuan 40 projekte gjenocidale për shfarosjen biologjike të shqiptarëve”* (H. Hyseni, *Kosova sot*, 14-15.IV.2018, f. 8) dhe si e tillë cilësohet edhe vepra në shqyrtim e M. Milojeviçit, andaj e shohin të arsyeshme që këtu në hyrje fillimisht të shënojmë një mendim gjithsesi jo të një politikani, as të ndonjë shkencëtari, por të një njëriu modest, po me përvojë pleqnarie popullore nga gjysma e shekullit XIX dhe fillimvitet e shek XX, mendimin e stërgjyshit tim, pleqnarit *Mehmet Reçani*, i cili me rastin kur një serb nëpunës i administratës turke (taksildar) Haxhi Rrustë Kabashit, kren i anës së Rrethbjeshtës së Prizrenit në fshatin Korishë, në prak të festës së Bajramit (1905), ndoshta vërtet siç e tregojnë nga paniku, gjoja në vetmbrojtje, ia kishte vlarë te dera e mullinjve dy djem dhe pas kryerjes së veprës, edhe pse merret nën mbrojtje nga pushteti turk, pritej që si familje *fisi vendase ortodokse* do të kërkojë rrugë besëpaqeje nga familja e Rrustës, andaj ishte fjala me pranue atë ofertë besëpaqeje apo jo, stërgjyshi im për të lehtësuar dhimbjen dhe për ta shpëtuar nga telashet e tjera shokun e mikun e ngushtë, me të cilin që më parë kishin pajtuar gjaqe me sukses si në Kabash e Lubishtë të Vitisë etj. si dhe njëherazi i edukuar kanunisht për të ulur gjakrat dhe për të shpëtuar në parim nga hakmarrja pa kontrollë me vetëgjyqësi, familjen ortodokse shqipfolëse të Korishës, ku ishte strehuar përkohësisht deri sa të kalojë në fshatin e tij, ngase konsideronte se as strehuesit e përkohshëm as krejt familja e shkaut nuk ishte fajtores, siç tregonte im atë (temë kjo më hollësisht do të trajtohet në një vend tjetër), veç tjerash rreth këtij rasti, sipas mbamendjes së babës, ishte shprehur kështu:

*Me këso punësh të rënda të papritne Zoti provon durimin e arsytën të njerëzisë e mirë. Në këto raste burrat kallëzohen burra. **Burrat e fortë**, jo veç nuk nguten, por nëse mujnë **nuk i bajnë keq, nuk ia teprojnë me të keq as hasmit**. Simbas rastit lypin derëdalje ose falin, ose kërkojnë hak. *Ata që kërkojnë dhe pranojnë besëpaqen janë të njerëzishëm. Çfarëdo me ndodhë burri me burri kurrë nuk prek as në fëmi as në gra e pleq. Te shkitë tanë hala ka besë e burri. E nderojnë dhe kurrë nuk e poshtojnë hasmin, nuk i gjymtojnë gjenazet si shkitë e Serbisë... të cilët qysh kam marrë vesh, janë ba për mazomakeq, përveç paburnisë sllave janë veshë edhe me pabesi turke, edhe me egërsi ruse!...**

Ne, duke kërkuar falje sot edhe në emër të stërgjyshit për tri atributet që prekin për të keq tri kombe: **shkitë e Serbisë** për **paburni sllave, turqit** për **pabesi** dhe **rusët për egërsi**, sepse duhet me veçue popullin prej ndonjë invidi, kaste ose organi keqbërës shtetëror, sepse atëbotë e sot, rrallë ka pasë e ka me pasë: **mal pa therrë, dhe luftë pa tmerr**, por ky stërgjyshi im fort si lirshëm ua shton këto tri attribute *shkive të Serbisë*, që e paskan zdashur veten nga cilësia e **njerëzishmërisë me besë e burri**, siç ende i paskan **shkitë tanë (!)**, sepse nuk dua të besoj se të gjithë serbët e Serbisë kanë një “*veshë*” të tillë (!), ..., megjithatë ne e kuptojmë dhe nuk e fajësojmë aq pleqnarin, ngase stërgjyshi ynë e shokët e tij pleqnarë në vitet e para të shekullit XX sigurisht ishin në dijeni, në njërin anë, për **pabesitë turke**, ndër të tjera, siç ishte edhe ploja në qytetin e Manastirit, më 30 korrik 1830, kur pashai turk i *preu në besë* mbi 500 burra krenë shqiptarë të *asaj ane*, vetëm pse kishin nisë me ndie flladin e zgjimit të ndjenjës kombëtare, madje, në anën tjetër, i kishin të freskëta masakrat e shumta monstruoze të **serbëve** (*shkive të Serbisë*), *të cilët vërtetë të shoqëruar me ushtarë vullnetarë rusë*, me rastin e shpënguljes me dhunë të “*muhaxherisë*” shqiptare nga trojet e veta autoktone, jo vetëm bënë vrasje monstruoze, por ka ndodhur edhe aq më keq të gjymtonin për së gjalli viktimat e të gjitha moshave(!!!). Kështu vetëm në Kurshumli, ku nuk kishte anjë banorë serb, sipas Milojeviçit (siç kam lexuar nga R. Avdiu), shkitë e Serbisë, serbë e rusë vranë në qendër të qytetit të gjithë nxënësit medresistë (!!!) dhe kuptohet dëbuan së andejmi krejt popullsinë shqiptare, pa përmendur raste të tjera edhe më skandaloze, siç ishte djegia për së gjalli e tërë një familjeje shqiptare lidhur rreth “qipit”, stogut të sanës (!!!), pastaj ngulja e krenave të shqiptarëve në kunjat e rezhnikave dhe i kanë bartur gjithandej për të futur tmerr në mënyrë që shpërngulja e

shqiptarëve të jetë edhe më e vullnetshme etj., por..., e them me keqardhje, pleqnarët e malësorët tanë atëbotë e sot nuk kanë ditur me formue e me mbajtë shtet si rusët e turqit, madje as si serbët, të cilët, kur vunë bazat e shtetit të vet morën yrrnek prej tyre (Turqia e Rusia).

Si duket pleqnari ynë nuk i kishte njohur mirë, as disa nga shkitë e fqinjve të vet, të cilët në atë kohë ishin në fazë dozimi nga rryma e *serbizimit ekstrem*, ngase veç sa ishin infektuar pikërisht me të tria këto viruse: me **paburni vetjake**, me **pabesi turke** dhe me **egërsi ruse**, sepse pikërisht dikush nga këta nënmbrojtës korishas, qoftë përnjëhershëmrisht u bënë spiunë turq dhe vepronin si çetnikë serbë kundër levizjes shqiptare për liri e pavarësi, gjë që pak më vonë, u dalluan **për paburni, pabesi dhe egërsi** si pjesëmarrës e organizatorë masakrash në emër të shtetit serb, pikërisht kundër fqinjve të vet shqiptarë, siç ishte edhe masakra te Kisha e Keqe (1913) në Kabash (Manastiri i Shën Markut), ku në *besë*, u prenë me sakica kokës, një nga një, në një kthinë të veçantë, gjoja se u jepnin dëshmi-lirie, afro 100 burra, duke ua hedhur kufomat përposhtë rrëpinës (!!!), pa përmendur edhe po aq e më shumë të vrarë ose të mbytur në shtëpitë e tyre vetëm në Korishë.

Por sidoqoftë, nga lexuesi i nderuar, kërkojmë të vërehen sa e si janë respektuar ose keqpëdorur këto attribute: qoftë **njerëzishmëria** (*shqipoortodokse*), të cilën e kishte për zemër stërgjyshi im si ne, në njërën anë, qoftë, **paburnia** (vetjake kleriko-shtetërore ortodokse serbe), përkatësisht **pabesia** (*serbo-turko-otomane*) dhe **egërsia** (*serbo-ruso-shpelllore*) brenda veprimeve të palës serbe ndaj asaj shqiptare, në anën tjetër, gjatë shtjellimit të temave vijuese deri në ditët e sotme:

e para, nisur nga e sotmja, si qëndron aktualisht përkufizimi i prejardhjes së shqiptarëve dhe serbëve sipas burimeve të plasuara studimore serbe;

e dyta, ku shohim të mirët të shprehur me pahir ndaj çështjes shqiptare nga lënda e veprës së Milosh Milojeviçit, edhe pse e sajuar fillimisht më 1866-1868 dhe e botuar në fillim vitet e 1871-73, në kuadër të vatrës së nacional-shovinizmit antishqiptar pansllavist serbomadh;

e treta, cilat argumenta duhen njohur sot, tanët dhe të huajt, nga realitetit historik, ngase zbardhin të vërtetat e mohuara ose të keqinterpretuara në rutinë qëllimisht nga qarqet serbe të arsyetuara nga disa pseudo-historianë albanofobë serbë, të huaj e të tjerë;

e katërta, si nuk u përfill dhe aq më keq si u keqpërdor kontributi i shqiptarëve gjithandëj në të mirë të shteteve të sapoformuara të popujve

bashkëjetues në Siujdhesën Ilirike, të cilët ose kusuriteshin ose shfrytëzonin mirësinë e tyre, duke vrarë shqiptarë e duke ua pushtuar tokat dhe

e pesta si çau përpara **gjuha shqipe**, e zgjedhur nga rilindësit si promotor i shqiptarisë, përkundër pengesave turko-serbo-greke e gjithandej?

Në përmbyllje, pas analizës më tepër nga pikëpamja logjiko-filozofike duke pasur parasysh tri- katër karakteristikat e cekura të aplikuara nga aparati i shtetit serbë: **gënjershtren, paburninë, pabesinë e egërsinë** si dhe **njerëzishmerinë** e përdëshiruar si metodë, vihet theksi në sugjerimin se çfarë duhen bërë palët, sidomos pala serbe si provë për të arritur një paqetim të vërtetë të sinqertë ndëretnik shqiptaro-serb për sot e nesër, jo vetëm me fjalë, por me vepër.

NËNKREU I RRETH DIFERENCIMIT E PËRKIMIT TË ETNOGJENEZËS SHQIPTARE E SERBE KRYESISHT NGA BURIMET BASHKËKOHORE SERBE

Pa hyrë në ekstremizma e fundimentarizma që nuk janë të pakët, si faktografi të parë rreth dallimit ose përkimit, përkatësisht rreth pranisë shqiptaro-serbe nëpër shekuj disa studiues shohin dallime e përkime nga vetë prejardhja e këtyre dy popujve mbështetur kryesisht edhe në përkufizimin e shënuar në wikipedinë më të re në gjuhës serbe e burime të tjera, ku lexojmë:

-Shqiptarët (albanci) e konsiderojnë veten pasardhës të drejtpëdrejtë të ilirëve, banorë të lashtë të Ballkanit

ndërkaq:

-Serbët, sipas të dhënave gjenetike dhe antropologjike janë pasardhës të fiseve sllave dhe

të banorëve të lashtë ballkanikë (ilirë e thrakas etj.).

Pra, siç po shihet nga përkufizimet e mësipërme në raportin e prejardhjes shqiptare në krahasim me atë serbe ka paqartësi, por ka disi edhe pikëtakim tek *ilirët*. Sidoqoftë, nga sa lexuam edhe në burime të tjera, po spikasim se disa gjera dalin si të vetëkuptueshme aksiomativisht për një shumicë studiuesish:

Së pari, shqiptarët si autoktonë konsiderohen pasardhës të drejtpëdrejtë të **ilirëve**, dhe për këtë tezë sadokudo ekzistojnë elabore

studimesh multidisiplinare e të veçanta, sidomos nga fushat studimore nga: *gjuhësia, arkeologjia, gjeografo-historia* etj. Kështu prejardhja nga ilirishtja është një ndër tezat më të përkapshme edhe nga analiza e shëndoshë logjiko-filozofike që shkencërisht nuk mund të shkualifikohet dot edhe pse disa studiues serbë shprehin rezervë e mohim ndaj qëndrueshmërisë së kësaj teze, duke e quajtur të konsumuar dhe kështu bien më poshtë se konstatimet e Milojeviçit(!), i cili shkipët i konsideron si popull i lashtë.

Së dyti, edhe serbët, me sa lexuam, gjithsesi konsiderohen sllavë, por edhe në simbiozë me ilirët. Dhe vërtet lidhur me këtë ka gjëra shumë të diskutueshme.

Sidoqoftë, edhe serbët ashtu si sllavët e Ballkanit, janë të ardhur andej nga Rusia e sotme (**përtej Karpateve**) është tezë e pranueshme që faktotet që në antikë në sistemin skllavo-pronar, ngase analet greko-latine, të cilët këtë *popullatë të sapoardhur* e quajtën: (in latini) **Sclavieni, sclavus** përkatësisht / (in greese) **sclab/os Sklavenoï**, me koncept **skllavi** (robi), i cili në shqipe nga ajo trajtë e gjuhëve klasike u reflektua në trajtat **shklav/ shkjav shka/v shkia shqa shka (*s-sh)**, madje po në atë kohë kjo popullatë në trevat jugore njihej edhe me emërtimin sinonimik **serb**, popullatë kjo që nga gjuhët latine e greke quhej: ***serv. servus servos, sarb, serb(* v/b-p)**, shq. **sherb-** (*sherb/yes, sherbë/tor*). Krahaso : servir – shërbej, pra me konceptin e afërt të sklavit, robit (*sherbëtor* serb. **sluga**). Ne, në kreun III, duke shpjeguar trajtën **shkja shki/je shkie shkitë**, cekëm se ka studiues sllav që emërtimin **sklavus** (të latinishtes e greqishtes) e quajnë tendencioz, ngase ata i paraqitnin sllavët si skllavë (robë), ndërsa vetë sllavët e ndërlidhin shpjegimin e fjalën *sllav* ose *slov* (slloven) me fjalën “**slava**” shq. *lavdi* (*lat. gloria*), madje edhe fjala **serb** që në gjuhët klasike del e reflektuar në trajtën **servus**, po ashtu kuptim përçmues ***serv** (*fjalë bizantine sipas Xharrës*) serb. **sluga**, përkatësisht “**Servia**” shq. Sherbia (P. Bogdani), vendi i serbëve (i shërbyeve), të cilët në të vërtetë edhe kishin kryer punë të tilla për grekët, të cilët, sipas Milojeviçit, grekët “*nuk dinin të punonin, por vetëm të këndonin e urdhëronin*”, mirëpo (pa ricekur rastin “sarb”/**serb** si kokëprerës (!) nga Milojeviçi), nga serbët e sotëm në mënyrë hipotetike ka përpjekje të sqarohet ndryshe ky emër. Gjoja rusët para se të shpërngulej së andejmi ky fis, e paskan quajtur me atributin **srp**, përkatësisht **serb (sarab)** a **sa(r)b(a)la** (b/p) me kuptimin **shpatë** (*njerëz të shpatës*). Madje, që edhe vetë serbët ashtu si edhe rusët nocionin e fjalës **shpatë (sablja)** e ruajnë paksa të përpunuar te fjala serb.

srp, rus. **serp** (shq. *drapër*), ashtu si edhe trajtën **Srbul** (1437) si emër personal dhe **srbula** me kuptimin “**tekst i vjetër**”(!).

Sidoqë të ketë qenë, tashti po i kthehemi edhe njëherë pikëtakimit të shqiptarëve e serbëve lidhur me **ilirët**. Disa studiues serbë, ndër ta edhe prof. *Rade Mihalçiq*, pranon që sllavët e vjetër (përkatësisht serbët) në Ballkan gjeten fise **ilire**, dhe disa nga ato fise edhe u *sllavizuan* (*serbizuan*), gjë që nuk kontestohet, madje nuk kontestohet aq edhe konstatimi tjetër se: “**shqiptarët janë ata që kanë ruajtur doket, gjuhën dhe vetitë e tjera popullore (ilire)**, ku shtohet konstatimi “**një pjesë e sllavëve të ardhur kanë marrë gjuhën dhe doket e shqiptarëve dhe janë shkrirë bashkë me ta**”. (Shih. Adil Fetahu, *Kosova sot*, 31 O3.2018, f. 27.), konstatim ky, që mbase nuk mund të hedhet poshtë arbitrarisht, mirëpo këtu del si hipotezë me sherr, ngase siç e ndeshëm edhe te Milojeviçi, i cili shqiptarët e paturëzuar (islamizuar) i quan *serbë të shqiptarizuar*, dhe për të arritur përnqidjen serbe në Kosovë (Prava Stara Srbija) ata i shënon si serbë. Në këtë kontekst zgjon interes fakti që në **Wikipedinë** më të re serbisht me titull “**Arbanasi**” (*IV deo - pjesa IV*) jepet ky shpjegim-konstatim tejet i guximshëm e pa arsytim-mbulesë: “**Arbanasi–srpsko pleme albanskog govora**” (*Arbanasët – fis serb me gjuhë shqipe*”). Sidoqoftë, a e vret kush mendjen prej tyre se me këtë pranohet katërcipërisht se paska pasur **fis të quajtur serb** që paska folur shqip?!?! Është menduar mbase për arbanasët (pellazgo-ilir) me fe ortodokse, apo jo, paskan prejardhje serbe?!!

Në të vërtetë në këtë proces bashkëveprimi asimilues sipas dukurisë simbiozore, pati edhe serbizim të shqiptarëve arbanas, si para edhe gjatë periudhës së lindjes dhe formimit të shtetësisë serbe para e gjatë shek. XIX e deri në ditët e sotme, apo jo?! Sipas asaj që lexuam serbët makiavelistë paskan të drejtë me kërkue një hise të gjakut serb tek albanezët e hershëm, përkatësisht te shqiptarët e sotëm, po nuk lënë hapur çështjen, vallë, shqiptarët a kanë të drejtë apo jo ta kërkojnë të njëjten gjë tek serbët e sotëm(?), kur dihet mirëfilli që jo vetëm protoshqiptarët, por edhe një pjesë në masë të konsiderueshme e shqiptarëve, sipas analizës ADN 40% në rrethana të caktuara, jo edhe aq moti, të quajtur *shkije*, janë serbizuar., madje edhe sot familje të tëra nartin mbiemra me prejardhje shqiptare. Së këtejmi, pa ia dhën më haptë, a ka farë logjike të mohohet ende e aq më keq të injorohet, substanca shqiptare, gjuha shqipe sot te shkitë tanë (ortodoksë vendës), përkatësisht, aq më keq, të urrehet populli shqiptar, vetëm pse paska qenë më i vjetri në këto troje, nga i cili serbët *gjenetikisht*

e antropologjikisht qenkan simbiozuar, sidomos me pasardhësit e **ilirëve: dardanët, thrakasit (dakët)** që konsideohen *sipjella* historike të **pellazgoilirisë?!!**

Sidoqoftë, duke pasur parasysh kohën dhe rrethanat nuk di pse studiuesit serbë së paku këta bashkëkohorët nuk e cekin *serbizimin e shqiptarëve* nën presionin e fesë (kishës) ortodokse, kur pa dallim gjuhe e prejardhjeje të gjithë skizmatikët në treva përkatëse të Servisë a Sherbisë, quheshin *serbë, (shërbetorë)* dukuri kjo që ende vazhdon me viktimizimin e *shkive tanë*, apo jo? Madje dihet fakti, siç konstatohet qartë se harta gjenetike e serbëve në Serbi përkuaka 90% me hartën e shqiptarëve në Shqipri, apo jo?! (Shih: *Krstarica forum*, në internet.)

Por, në këtë proces, nuk është vetëm ky problem prejardhjesor ndëretnik shqiptaro-serb rreth ilirëve, por ka të bëjë edhe me kërkime rrënjësie edhe më të hershme. Siç dihet rilindësit shqiptarë pa e mohuar prejardhjen ilire, dhe jo vetëm ata, etnogjenezën e shqiptarëve si paragreke e paralatine e ndërlidhnin me **pellazgët** a pellazdët (hyjnorë), prej të cilëve dolën shumë popuj, ndër të *cilër hetitët, etruskët, thrakasit, dakët, besët, ilirët*, e së këndejmi: *dardano-epirotët, arbërit - shqiptarët e sotëm*, si më të veçantë me gjuhë e histori, temë kjo që para shkencës botërore po del gjithnjë më e pranuar dhe shumë aktuale, ku me të vërtetë po dalin argumenta bindës në saje të studimeve logjiko-filozofike e multidisiplinare, tezë kjo që vërtet nuk mund të hedhet poshtë apriori, mirëpo, në anën tjetër është interesant se edhe lidhur me lashtësinë, jo aq të gjuhës serbo-sllavishte, po të popullit serb në përgjithësi, është aktualizuar po ashtu një hipotezë, ku gjeneza e popullit serb nuk lidhet fort me sllavizëm të sotëm, por me rrënjësi shumë më të lashtë. Kështu disi ndeshëm edhe në shkrimet fantastike (izmislotine) të Milosh Milojeviçit (140 vjet më parë), kur shkruan që *shkipët e maqedonët serbët i gjetën këtu...*”, andaj me një iluzion të tillë përpiqen me arsytue që pikërisht **serbët** janë *popull hyjnor*, duke u ngjitur aq nalt në parahistori, saqë edhe gjuha aramishte para hebrije e librave të shenjtë, sipas tyre, nuk është gjë tjetër por një *serbishte arkaike(!)*. Është atraktiv fakti se këta neoromantikë serbë në analiza të veta ndjekin ose shfrytëzojnë metodologjinë e pellazgologëve tanë. Kështu duke zëvendësuar (në koncept) **pellazgët** me emrin **serb (sorb *SRB-të e lashtë**, argumentojnë gjoja *shkencërisht (!)* se **serbët** dalkan populli më i vjetër në botë, prej tyre, rrjedhkan edhe *arabët, indianët, ilirët, etruskët, dardanët, dalmatët, latinët, trojanët, helenët (gjuha e homerit)* etj.-etj. dhe për mendimin tim,

këtyre historianëve *sorbjanë*(!), të cilët mendojnë se glosat si: *ilirë (i lirë)*, *-veni (vendi)*, *dardan (darda, dardha)*, *dalmat (delja)*, *troja (trolli)*, *bilë (bij)*, *helinë (hyllini)*, *zeus (zë zot)*, *Thoti-Zoti!*, *hëlë-ja (h(y)ll) ose al-lah, gjy gjysh etj- etj*, që **sorbit* si *nebeski narod* (serbët e lashtë, popull hyjnor) i koinserojnë fjalë të tyre, studiuesve të tillë u mungon vetëm një veprim taktik: **me pranue që protoserbët** ishin vetë **protoshqiptarë (pellazgë)**, apo jo?!). Prandaj, nuk e them aq me ironi, studiuesit e tillë për me shpëtue nga *trillet e tilla apo “mitet e nacionalizmit romantik”*, përkatësisht nga *“falsifikimi dhe vulgarizimi i historisë për lashtësinë e popullit serb”* (Adil Fetahu, *Kosova sot*, 31.O3. 2018 f, 27)), ata pa vajtur aq larg në *hyjnizime absurde* duhet ta pranojnë logjikisht më të pranueshmen atë që vetë po e servuakan: *ta pranojnë faktin që gjuha e serbëve të lashtë paska pasur mbështetje (jo vtëm në iliro-thrakishte, por në gjuhën pellazgo-ilire-protoshqipe, apo jo?!)* Përkatësisht, shikuar nga ky pikëvështrim del që gjuha shqipe, sipas këtyre glosave që u cekën e plot të tjera **dalka mbishtresë e gjuhës së sotme serbe (sllave)**, andaj a kishte arsye të urrehej apo të urrehet ende sot nga njerëzit normalë e kisha serbe gjuha shqipe, e cila qenka **vetë ama e gjuhës hyjnore serbo-sllave**, apo jo?!

Sidoqoftë, duke u uruar punë e rrugë të mbarë në shtektime të tilla fantastike, po ua lëmë mbi tryezë diskutimin rreth qartësimit të prejardhjes së këtyre dy etnive: shqiptare e serbe edhe në trevat e Serbisë së sotme. Ndërkaq ne ftojmë lexuesit edhe ata serbë që për katër temat në vazhdim të këtij kreu të konstatojnë se cila gjuhë më shumë i ka borxh tjetrës serbishtja shqipes apo shqipja serbishtes sa i përket ndërndikimit fillestar , përkatësisht sa i përket **njerëzishmërisë**, cila etni i ky hyrë më shumë në hak tjetrës, duke i shkaktuar dëme: **me paburni, pabesi dhe egërsi**, që nga lashtësia e sidomos që nga gjysma e dytë shek. XIX e deri në luftën e fundit 1999), si dhe aktualisht, cila po e pengon tjetrën *paburnisht, pabesisht dhe egërsisht* që të ecën në rrugën e vet të pavarur, tema specifike këto, të cilat jemi përpjekur me i trajtue në mënyrë sa më objektive. Pra le të vlerësohet dhe sa është e mundur të zbardhet e vërteta edhe më mirë rreth këtyre çështjeve që po trajtohen në nënkrerët vijues:

NËNKREU II
ARGUMENTA PARA E MESJETARË, GJITHSESI PARA
SHEKULLIT XIX QË DËSHMOJNË VIJIMSINË E
SHQIPTARËVE DHE BASHKËPRANINË E TYRE
ME SERBËT (KRISTIANË) NË KOSOVË

Sido që të ketë qenë, siç u paralajmërua në nënkreun e mësipërm tani do të bëjmë fjalë rreth pranisë së parashqiptarëve në Siujdhesën Ballkanike e më gjerë që nga antika, gjatë priudhës së sundimit romak, pastaj po në këtë trevë ndërkohë del e identifikuar bashkëprania me emër shqiptaro-sllave, gjatë mesjetës dhe në veçanti para dhe gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, gjithsesi para shekullit XIX. Krejt kjo periudhë historike preket paksa në disa pika me qëllim që të jetë më e qartë për të tria palët:

së pari, për opinionin e gjerë, studiuesit e huaj dhe për të vërtetën shkencore në përgjithësi,

së dyti, të jetë edhe më sfiduese edhe për studiuesit shqiptarë që tashmë nuk i mungojnë shkencës shqiptare e më gjerë dhe

së treti, në veçanti, të jetë ndihmesë e vërejtje për studiuesit serbë si për adhuruesit e makiavrlizmit mohues të së vërtetës shqiptare në njërën anë, dhe, në anën tjetër të qëndrojë si sfidë e orientim i duhur për ata që duan dhe duhet ta njohin realitetin objektivisht rreth shkaktarit të vërtetë të armiqësisë serbo-shqiptare dhe që janë të interesuar sinqerisht, si ne, të arrihet një paqe e vërtetë ndëretnike shqiptaro-serbe për jetë e mot. Andaj, po fillojmë me paraqitje argumentash:

E para, pa hyrë me i vlerësue në hollësi studimet më të reja për prejardhjen pellazgo-ilire-dardane të (proto)shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre, si dhe ato të lashtësisë së gjuhës serbe, patjetër, siç pohojnë studiuesit, duhet ta kemi parasysh domosdo të vërtetën që identiteti i shqiptarëve me gjuhën, traditën kulturore të formëzuar të tyre imponohet jo vetëm në periudhën parasllave, por edhe para asaj latino-greke, dhe se ky identitet del i formëzuar më qartë po në Siujdhesën Ilirike që ne po e cekim fillimisht ekzistimin e shteti të Dardanisë me epiqendër trekëndshin sipërfaqësori Naissus (Nish), Scupe (Shkup), Ulpiana (Lypian), madje shkonte përtej Krushevcit të sotëm (*Dardhës* sipas N. Myrtës) dhe kthehej në anë tjetër, ku domosdo përfshinte shumicën e hapësirës së Serbisë Jugore- Qendrore, po edhe të Shqiprisë së sotme etnike, ku puqej me Epirin e epirotët të së njëjtës etni-historike. Ajo që sapo u tha, sipas

studiuesve, vërtetohet më vonë edhe pas ardhjes së sllavëve edhe nga trajtat shkrimore e shqiptimore në serbishte të qyteteve: Nish, Skopje, Ulpiana (Ljipljane), të cilat janë standardizuar nën ndikimin e ligjeve fonetiko-morfologjike të shqipes së hershme dhe të shqipe-serbishtes së pastajme e të sotme. Siç dihet edhe vetë fjalë-emri *Dardani shpjegohet që* vjen nga fjala ilire *darda*, në shqipen e sotme **dardha**, e përkthyer latinisht në **prus** dhe serbisht *krush(k)a*. Është interesant se studiuesit në anale të gjuhës serbe kanë ndeshur edhe trajtat: *Dardasi, Dardishte, Dardiç, Darllan, Dardusi. Dardas (Iliaz.Rexha.)*, andaj disa nga neoromantikët aktual serbë si Deretiqi, adhures së veprës së Milojeviçit, aludojnë që dardanët ishin vetë *serbët e parë ose të simbiozuar me ta(!)*. Kjo zgjon interes, prandaj edhe shtrohet pyetja, vallë gjuha ilire ose e gjuha e serbëve të lashtë mos ishte parashqipja pellazge, apo jo?! Sidoqoftë, fjala *prus* e latinishtës del si toponim edhe në tekstin e Milojeviçit, e shënuar në trajtën shqipe *Prush*, përkatësisht e plotësuar nga botuesi *Qafa Prushit*, që edhe kjo shpjegohet me ligjet e fonetiko-morfologjike të gjuhës shqipe, ku s-ja latine në shqipe ka dhënë rregullisht **sh**. Ky është vetëm njëri nga faktet që argumenton se shqipja ligjëronte në këto troje para e pas pushtimeve të Ilirisë nga romake, para shek III p. e. re, kur Dardania identifikohet si shtet i konsoliduar ilirik.

E dyta, madje edhe brenda Perandorisë Romake del e rikonsoliduar kultura iliro-protoshqiptare, dhe si e tillë del e inkuadruar edhe në kulturën botërore të antikitetit e të mesjetës së hershme, ku përmenden perandorët me origjinë vendëse (ilire) me atributet dhe kontributet e tyre të larta për kulturën antike-mesjetare botërore protoshqiptare, gjithsesi parasllave, si p.sh:

1) **Diokleciani (284-305)**, i cili *e shpëtoi perandorinë nga shpërbërja, përmes miratimit të reformave*, përkatësisht përmendet ai për identitetin e shpallur administrativ, i cili vendosi gjeografikisht **tetrakinë** (dy prefekturat), për ne zgjon interes pikërisht prefektura në trevat e atëhershme të supozuara e deri të sotme vërtet gjalluese shqiptare: a) **Prevalis** me kryeqytet Shkodrën, b) **Epiri i Ri** me kryeqytet Durrësin, c) **Epiri i Vjetër** me kryeqytet Nikopolin (afër Prevezës) dhe ç) **Dardania** me kryeqytet Shkupin.

2) **Konstatini i Madh**, ilir nishjan, i cili bashkë me administratorin dardan Ricin përmendet për identitetin kishtar që shpalli "*Paqen e Kishës*", përkatësisht gjatë sundimit të tij 324-37 e barti kryeqytetin e

perandorisë prej Romës në Bizant (si Romë të Re ose Konstantinopojë) dhe

3) **Justiniani**, burrë shteti, i cili sundoi 527-65 dhe u bë i pavdekshëm për identitetin politik pushtetor të afirmuar, duke kodifikuar të drejtën romake, i cili shtriu sërish kontrollin e perandorisë mbi territoret e humbura dhe për t'u mbrojtur nga fiset barbare (edhe nga ato sllave) në Dardani ndërtoi e rindërtoi afro 70 kështjella, ndër to edhe atë të Rashës. (Shih edhe te *Koha ditore*, 29.03.2018, f. 20.)

Pra, (proto)shqiptarët, gjuhën e tyre, e cila sot konvencionalisht quhet **gjuhë shqipe**, edhe pse qëndronte nën hijen e gjuhëve greke e latine si gjuhë zyrtare e sakrale, sipas logjikës së shëndoshë, ajo që më parë ekzistonte në popull dhe përdorej masivisht. Së këndejmi, *shqipja iliro-dardane*, siç shpjegohet, dilte si sistem gjuhësor i ravijëzuar, koine e veçantë e shtrirë në shtetin e Dardanisë e më gjerë, përkatësisht gjithsesi në tërë **Tetrakinë ilirike** (*Provalis, Epiri i Ri, Epiri i Vjetër dhe Dardania*). Së këtejmi, studiuesit konsiderojnë që atëbotë shqipja dilte me struktura unifikuese pikërisht në kufijtë, ku historia njihte mbretëritë e njohura ilire, ku mbretëronin: Bardhyli, Agroni, Teuta, Genti, Bato, Manuni, Glauku, Leka etj., por është indikativ fakti, siç u cek edhe Tetrakia e Diklocionit se edhe në vazhdimësi në periudhën paslatine, ku në këtë trevë identifikohet kjo popullatë edhe me sundimin e perandorisë bullgare me feudalët arbanas, madje para tri shteteve mesjetare albaneze para e pas zhbërjes së perandorisë të ashtzuquajtur Perandori e Dushanit, dhe aq më tepër gjatë sundimit të Perandorisë Osmane, u identifikua po në këto troje e ashtquajtura "**Turqi shqiptare**" e 4 vilajeteve me kryeqytet: Shkodra, Shkupi, Manastiri e Janina, që shembëllen jo vetëm me Tetrakiusë, Perandorinë e Dushanit, por me gjendjen e sotme të Shqipnisë Etnike: Shqipëri, me shtrirja: Kosovë, pjesë të Mal të Zi, Serbi, Maqedoni dhe Greqi (Çameri), apo jo?! Gjithsesi kjo koincidençë terreni të vandinimit të shqiptarëve atëherë e sot nuk mund të mohohet dot, apo jo?!

Sidoqoftë, ardhja e sllavëve (serbëve) mbase për së dytë –(!) sipas Milojeviçit u bë formëzimi i serbëve si etni dhe si shtet në Ballkan, në hapësirën bashkë me arbanasit që nga shek. VII e më vonë, andaj duhet pranuar e vërteta që në këto troje paska ndodhur bashkëjetesë iliro-dardano-sllavoserbe, natyrisht e përzier me gjuhën e pranishme të parakonsoliduar shqipe, e cila si gjuhë iliroshqipe gjallonte si gjuhë popullore në këto treva së paku 9 shekuj më parë. Për ndryshe s'ka sesi të

shpjegohet ekzistenca ose jeta e derisotme e gjuhës shqipe në trojet e pjesës kryesor të ish-Tetrakisë, me sistemin gjuhësor relativisht të konsoliduar për të qenë e cilësuar si gjuhë (degë) më vete, në kuadër të familjes së gjuhëve indoeuropiane, apo jo?!

E treta, të shohim tashti sesi qëndron edhe çështja fetare-kulturore, në raportin shqiptaro-serb. Është i njohur fakti se Shën Pali (10-67) që në shekullin I, në moshën 47 vjeçare me apostujt e vet *mësimbesimin kristian* ose "*lajmin për ngjalljen e Krishtit*" (J.D.), siç e pranon vetë, e ka përhapur edhe në tokat e Ilirisë, mision ky, i cili, del i vërtetuar edhe nga studiuesit shqiptarë e të tjerë, edhe pse dihet se besimet pagane ende nuk ishin shtrënjësor plotësisht, ngase, ç'është e vërteta, kristianizmi është legalizuar më vonë nga Konstantini i Madh e pasradhësi i tij në shek III, pra, 300 vjet para dukjes historike të sllavëve në trevën e Dardanisë. Prandaj, s'do mend se sllavët kristianizmin e kanë gjetur të përfaquar më parë nga banorët, përkatësisht prelatët e këtyre trojeve (prandaj e kanë përvetësuar fenë kristiane ashtu siç e pranojnë edhe vet me karakteristika të veta (shenjtorësh), ashtu si edhe me disa elemente gjuhësore iliro-dardane-thrakase, apojo?!

E katërta, sigurisht, siç shpjegojnë studiuesit, këto dy të vërteta, fakte të forta për ekzistencën e protoshqiptarëve: e para, **identiteti dardano-shqiptar si etni** (brenda Tetrakisë) me gjuhën e vet dhe e dyta, **përvetësimi përgjithësisht i kristianizmi si fe**, duhet të njihet e të kihet parasysh që edhe logjikisht të jetë e pranueshme dhe e parrëzueshme edhe nga të gjithë shkencëtarët e intetelektualët serbë, apo jo?! Përrallat e broçkullat se shqiptarët e gjuha e tyre paska pikur në Dardani (Shqipri ose Tetraki) nga qielli turko-aziatik, apenin, arabik(!), e ku ta dimë, duke injoruar Ilirinë dhe se qenka sforcuar te shqiptarët (ardhacakë) nga vetë sllavët e sllavishtja apo serbët kristianë(!!!) etj., vërtet e dëmton historinë e vetë prejardhjes sllave të kombit e të gjuhës serbe, apo jo, edhe pse ne përhëndesin përpjekjet për kërkim rrugësh të reja jo sllave të serbishtes, ngase goja e teorizimeve të ndryshme edhe pse në dukje pa mbulesë, me fantazi të shfrenuar ose jo, s'mund të mbyllet dot?!

E pesta, është e vërtetë se protoshqiptarët si dardanë autoktonë që janë, duke pasur një shtrirje të gjerë me sivëllezërit me *provalisë* e *epirotë* të së njëjtës bazë gjuhësore, sidomos në Ballkanin Perëndimor e Qendror, duke u bashkuar në simbiozë me popuj të tjerë morën edhe emërtime të ndryshme si etni, patën pësuar shumë keqas nga ndarja e Perandorisë romake në dy Qendra, përkatësisht në dy hapësira sipas dy doktrinave ose

dy rrymave fetare-politike e kulturore, njëra me qendër *Konstantinopol* dhe tjetra me qendër *Romë*. Lidhur me këtë konstatohet nga studiuesit që kanë pësuar vërtet shqiptarët pikërisht në Siujdhesa Ilirike, ngase *Dardania*, *Epiri* gjeografikisht i takuan Lindjes - Bizantit, ndërsa trevat e *Prevalisit* (*sepse shkodranët dhe albanët rreth bregdetit, Ulqin, Tivar, Kotorr*) më tepër ishin të përkapura me kulturën perëndimore ndërlidhur me Dalmacinë, sepse Tivari - Raguza me pertejdetas , por edhe me lidhje tokësore kulturisht ishin tejet të mishnuar. Kështu, një pjesë e mirë, sidomos pjesa e Provalisit (1/3 nga tërësia e këtij etniteti) assesi nuk i këputi asnjëherë lidhjet me Romën, ndërkaq pjesa tjetër shumicë 2/3, domosdo ishin të lidhur me Lindjen, Konstantinopolin, andaj kishte mbështjellim në respektimin e riteve, por edhe të gjuhës fetare, ngase rruga ndërmjet bregdeteve në mes të sivëllezërve të së njëjtës fe e gjuhë të trashëguar ligjërimore popullore iliro-shqipe-kristiane nuk mund të ndërpritej dot. Është e kuptueshme, edhe pse, si me thënë, ishte një fe, rivaliteti Vatikan /Patrikanë kishte kaluar herë-herë në armiqësi të thellë, kështu armiqësia i riteve të tyre politikisht vinte gjithnjë e mëtepër duke u acaruar deri edhe me përplasje luftash. Po kur është fjala për shqiptarët gjuha popullore (shqipfolëse), edhe pse jo gjuhë rituale e zyrtare duhet t'i ketë mbajtur të pashkëputura lidhjet e tyre etnike lashtofisnore ashtu edhe rijofisnore malësore rurale e urbane, andaj edhe feja a fetë sipas valëve politike të kohës në shumë vise shfaqeshin ose jetonin të formëzuara në mënyra laramane ritualizimi, mbase jo aq pa ngjashmëri, siç përhapen edhe sot rrymat ideologjike apo sektarizmat e ndryshëm partiakë e shoqërorë (lindje-perëndim). Sidoqoftë, ngjashmëri mund të kishte pasur, ngase gjurmë të një dukurie të tillë ndeshim edhe në periudha më të vona, kur kihet parasysh trashëgimia e njëjtë gjuhësore e jetësore e masës së gjerë nëpër shekuj, edhe pse në anën tjetër ndasia rituale, interesat kishtare e kanë bërë të veten, por megjithatë toleranca fetare atavikisht me simpati ndaj perëndimit del e reflektuar për të mirë pikërisht te shqiptarët.

E gjashta, edhe pse gjuha shqipe, si e tillë me prejardhje pellazgo-iliro-dardane, siç e argumenton logjika e shëndoshë, ngase ndryshe nuk mund të shpjegohet kjo që është sot, siç u tha, që më parë ishte e ravijëzuar dhe e rrënjësuar thellë si sistem me strukturat e ligjësitë e domosdoshme ligjërimore në masën e gjerë, por jeta e saj, tash e ndarë në dy perandori e më vonë në shtete të caktuara si rrjedhojë pati mbështjellim në të gjitha fushat e jetës, si me thënë, shkaktoi njëfarë dallimi edhe në gjuhën ligjërimore sipas viseve, që njihet me dukurinë e ndarjes së shqipes në dy

dialekte: *toske në jug e gege në veri*, dhe kështu ndodhën edhe komplikime, mirëpo, siç na mëson historia, nga kontakti me sllavët, sidomos bashkëpunimi *pasdushan* i princërve dhe popullit shqiptarë pa dallim kufiri jug-veri pushon ndarja e tillë e mëtejme drastike ndërdialektore *rotacizëm/jorotacizëm* në gjuhën shqipe, apo jo.

E shtata, me siguri, dukuri ndërndikuese pati edhe në raportin shqipe-sllavishte pikërisht edhe në periudhën sllavo-bullgare, kur serbët edhe shqiptarët e Dardanisë e më gjerë bien nën sundimin e Bullgarisë, kështu u huazuan edhe fjalë e trajta të sllavizuara bullgare, në të dyja gjuhët, por ndërkohë kur u fuqizuan fiset serbe, përkatësisht serbo-shqiptare (tribale), shqipja e asaj kohe u ndikua edhe më tepër nga shprehje e fjalë sllavo-bullgaroserbe, sidomos në afikse oikonimesh, por këto huazime a ndërndikime nuk e lënduan sistemin e trashëguar të të dyja gjuhëve, të shqipes që ishte e arrirë në këto troje dhe të serbishtes që po mernrte shtat. Tashti, në këtë periudhë të mëvonshme, mund të thuhet, që serbë e shqiptarë, ishin në një simbiozë ose diklosi të shumëduarshme, shoqërore, fetare edhe gjuhësore të imponueshme dhe pa mëdyshje pikërisht kjo dukuri diktohet edhe në përpunimin e toponimeve me prejardhje gjoja të gjitha sllave (bullgare serbe) nga goja e shqipfolësve.

E teta, kjo prani simbioze shoqërore, po edhe gjuhësore vërehet sadopak edhe në shtetin e parë mesjetar shqiptaro-sllav në Duklea, nga familja Nemani. Është fjala për organizma të shtetit të **Zetës (Xentës - Gentës)**, që sipas J. Drançollit, ishte formuar në kuadër të Arbërisë (Shih “zsh”06.09.’19). Kështu fjala **zeta** priret të shpjegohet me fjalën shqipe: *zezë-a*, e **zeztë-a** / e vrantë (*vranilo, crna*), që mund të jetë reflektuar më vonë si koncept në mbiemrin si m. *i zi (Mali) apo f, e zeza (Malet)*; *f. e zezë (Maja) e zezta (Majat)* ose *neutri të zeztë(!)*, Krahaso: Monte **Negro-Crna** Gora-Mali i **Zi** (Maja e Zeztë, e vrantë!). Krahaso *negro, crno/crna- e zezë, i zi*, përkatësisht asnjësi: **të zütë** (*e ullirit*) ndaj **të zeztë** (*e kresë sate!*). Madje dikujt i shkon mendja se edhe rrënjori i **Cet-** (*Zest /c/z) toponimit Cetinje, vendbanim ky i themeluar nga Lleshi i Shkodrës, supozon emrin e Zetës së lashtë, supozime këto që duhen vlerësuar, ngase edhe në Hercegovinë e Kroaci janë identifikuar emra me nocionin “crn” si *zez(t)a: *Sesa e Ceci/ qose e zes(h)kta*, e zeshkët/a (P. Shimonoviq). Sido që mundet me qenë, shtetin e dinastisë Nemani ka mendime që përbënin katër hise popullatë shqiptare, ndaj një hise sllave, çështje kjo e diskutueshme, por është vërtetë që ndërkohë është konstatuar se shumica

e fiseve malazeze kishin prejardhje shqiptare, deri edhe Vuk Karaxhiqi e dinte, por nuk donte ta përtërinte.

E nënta, nuk di pse në burimet serbe përgjithësisht nuk është theksuar e vërteta, përkundrazi mohohet që populli shqiptar (arbanas ose albanes), pikërisht në mesjetë ka treguar vitalitetin e vet edhe në aspektin pushteto-shtetformues. E kemi të njohur faktin që jo vetëm që i njeh historia mbretëritë e Ilirisë, por edhe **Tetrakinë** apo prefekturat shqiptare të sapocekura të Dioklecianit, të organizura para ardhjes së sllavëve, por njihet kjo veprimtari shtetformuese edhe gjatë mesjetës, edhe pas ardhjes së sllavëve kryesisht bullgarë e serbë

Këtë po e argumentojmë me listën e mëposhtme, ku janë shënuar 15 principata shqiptare të krijuara gjatë asaj periudhe të caktuara ata u dalluan edhe në aspektin shtetformues vetjak, si:

1. *Principata e Dukles (nga Rrethina e Shkodrës) me principinjollin e familjes krajane **nemanase**, Gjon Vladimiri 917- 1016.*

2. *Principata e Arbrit, 1190-1255, mbi 200 vjet pas Dukles me kryeqytet Krujën, nga shtetarët Prodoni, Gjini, Dhimitri që kishin krushqi me Car Dushanin e Nemanjasve rasianë.*

3. *Mbretëria e Arbrit, themeluar nga Karli I Anzhu (1266-1350), me kryeqytet Durrësin, ku vetë emërtimi tregon që kemi të bëjmë me shtet shqiptarësh.*

4. *Despotii Angelokastronit dhe Lepontoni, 1358-1374 (16 vjet qëndresë).*

5. *Principata e Vlorës dhe e Kaninës, 1332-1617 (285 vjet qëndresë).*

6. *Principata e Artës, 1358-1416 (58 vjet qëndresë).*

7. *Principata e Gjirokastrës 1386 -1434 (58 vjet qëndresë).*

8. *Lidhja e Lezhës 1444 –1479, shteti i Skënderbeut me kryeqytete Krujën (35 vjet luftë e qëndresë).*

9. *Principata e Muzakajve 1335-1444 (pas 109 vitesh ekzistence u bë shkrirje përbashkimi).*

10. *Principata e Kastriotëve 1389- 1444 (pas 55 vitesh ekzistence u bë shkrirje përbashkimi).*

11. *Principata e Dukagjinit 1387- 1444 (pas 157 vitesh ekzistence u bë shkrirje përbashkimi).*

12. *Principoata e Topiajve 1274- 1444 (pas 170 vitesh ekzistence u bë shkrirje përbashkimi).*

13, Shteti i Arianitit 1432- 1444 (pas 12 vitesh ekzistence u bë shkrimi për bashkimin).

Me këtë dëshmohet vitaliteti pushteto-shtetëror i etnisë shqiptare edhe pas ardhjes së sllavëve në bashkëpunim me ta e të tjerë, siç dso të spreheni në vijim.

Së pari, Gjon (Jon, Ivan, Jovan) Vladimiri (970-1016, iahte krajan, mbret i Dukles, me trashëgimi të familjes fisnike ilire shqiptare Nemani, i cili në përkrahje të Perandorisë Bizantine humbi luftën kundër Samoelit, mbretit bullgar, mirëpo për hir vasaliteti Samoeli i lejoi të vazhdonte djejtimin e shtetit deri sa Gjon (Jon, Ivan, Jovan) Vladimiri (970-1016, isahte krajan, mbret i Dukles, me trashëgimi të familjes fisnike ilire shqiptare Nemani, i cili në përkrahje të Perandorisë Bizantine humbi luftën kundër Samoelit, mbretit bullgar, mirëpo për hir vasaliteti Samoeli i lejoi të vazhdonte djejtimin e shtetit deri sa pasardhësi i tij organizoi komplotin, të cilin Gjon i pranoi me divite flijimtarie, siç ia përshkruajti kisha serbe, kur edhe ajo kishë e përvetësoi dhe shekuj më vonë. e shpalli si mbret- shenjtor serb Mirëpo, hiq përrallat mashtruese të kishës serbe, u japim plotësisht të drejtë historianë tanë të sotëm, të cilët me guximin që u jep dija shkencore Gjon Vladimiri i dhanë emrin e merituar si mbret i shtetit të parë shqiptarë në filltet e epokës së re mesjetare. Kështu pas mbretërive ilire dhe drejtuesve të prefekturave ilire-shqiptare të Dioklecianit, vazhduan të hdimësia e traditës parasllave, del edhe shteti i Dukles nën drejtimin e Gjon Vladimirit por që vazhdoi edhe nga të tjerë. Në përkrahje të *guximit të tillë* ka shumë argumenta historikë, gjeografikë, shoqëror gjuhësor e fetar të parrëzuesëm dalin në ndritë, përkundër propagandës mohues shqiptarobe serbe Mirëpo është e vërtetë, që di i brendshëm ka ndikuar në thyerjes e asaj rezistence që pikërisht kjo dokemntohet edhe me faktin që 5-6 fise ortodokse malazeze deri vonë ende kishin të përbashkëta jo vetëm doket por edhe gjuhën me fiset shqiptare (katolikë e muslimanë). Së këndejmi, duke pasur edhe fakte të tjera studiuësit tanë të gjuhës e të historisë me guximin që jep dija, jashtë atyre përrallave të sajuara nga murgjit serbë shekuj, duhet të përplotësojnë gjuhën dhe historinë shqiptare me ë vërtetën e munguar shqiptare edhe në aspektin gjuhësor edhe në atë historik, sepse e patëm fatin e tillë si komb që ende nuk i kemi të studiuar plotësisht shkencërisht as mjaftueshëm, as gjuhën as historinë tonë.

Së dyti, besojmë se pas deklasimit të falsiciteteve e të propagandave jo vetëm fetare serb e greke do të zbulohen edhe posuri

të tjera të fshehura, po një gjë dihet pas 200 (220) e sa vitesh nga shteti i Dukles shfaqet Principatës së Arbnit shtet i pavarur shqiptar që që, drejtohej zyrtarisht në periudhën 1190-1255, nga shtetarët: Prodoni, Gjini, Dhimitri, me kryeqytet Krujën. Këtë e dëshmon, sipas Drançollit) edhe kodiku “Vaticianus Greaus”, i dorëshkruar më 1226 në manastirin *Shën Andrea*, Krujë; Faktete flasin që 11 vjet pas përfundimit të Principatës së Arbnit në tokën shqiptareformohet Mbretëria e Arbnit (1266 -1350) themeluar nga Karli I Anzhu, me kryeqytet Durrësin.

Së treti, deri sa mbretëronte shteti Anzhu, e pak më vonë në tokat shqiptare lindën disa principata, në listën tonë përveç Despotatit Angelokastronit dhe Lepontonii i Lepontonit, ishin Principatat: e Vlorës dhe e Kaninës, ajo e Artës dhe e Gjirokastrës, të cilat dëshmojnë përpjekje shtetësie. Këtu po shtojmë nga dorëshkrim, ik Gjon Muzakës Së dyti, nga dorëshkrimi i Gjon Muzakës (1510)veç të dhënave të tjera shumë të rëndësishme thuhet se kjo familje ishte pasardhëse e Perandorit romak Konstatini IV (668-685) dhe si familje sunduese fisnike del e njohur 1272 nga nga Karli I Anzhu. Si principatë e ka ruajtur mëvetësin edhe në luftël me carët bullgarë e Stefan Dushabin. Në Ludf[ën e Kosovës princi Muzaka si alet me Lazarin e Serbisë bie viktimë, por si familje fisnikke një pjesë detyrohet të shpërngulet më në fund në Itali, e një pjesë nga ajo familje pranoi turqizimin. Për ne është me rëndësi që edhe kjo principatë më 1444 u shkri në besëlidhjen e Lezhës nën komandën e autoritetit të Skënderbeut.(Shih Lutfi Alia, Dinastia Muzaka në Albania e në Italia, te Portali *zembrashqiptare*, 22.06.2023.)

Së katërti, të vihet që pesë prncipatat me karrierë historike si Princpata e Muzakajve, e Kastriotëve, e Dukagjnit, e Topiajve dhe Shteti i Artës, nuk u shuan, por për hir të idealit të shenjtë kombëtar u shkrinlëtë përbashkuara në Lidhjesn e Lezhëa 1444, duke formuar shtetin e vërtetë të Shqipërisë të udhëhequr nga Gjergj Kastrioti Skënderbeu (1405- 1468) me kryeqytet Krujën, i cili për 35 vjet luftë e qëndresë i dha famë popullit shqiptar, i cili krenohet edhe sot me autoritetn e Skënderbeut që shkëlqeu në histori jo vetëm kombëtare, por edhe europiane, por sidoqoftë populli shqiptar për pasojë përjetoi edhe shkizmën nga sllavizimi e grekëzimi i një pjese ortodoksish shqipfolës, por edhe nga turqizimi i një pjese muslimanësh, por në këtë sfidë populli shqiptar (muslimanë ortodoks e katolikë) u rilind si fenik me shqiptarizëm, me gjuhën e tij shqipe që do ta bëjë kombin tone të pavdekshëm, por që nga gjysma e shekullit XIX e deri më sot kjo ngjallje

shitetformuese e kombit tonë është në thumb nga nacional-shovinizmi serbomadhi, i cili mohon e përçmon çdo aftësi shqiptare, sidomos në Kosovë rreth rregullimit shoqëror, se gjoja “*Shqiptarët nuk dinë të bëjnë shtet dhe duhen sunduar nga Serbia deri sa të aftësohen për shtetndërtim*” (Enver Bytyçi), megjithatë populli ynë në kuadër të orbitës të jetës së vet rrokullie dhe me frymë e famë kastrote e bashkokohore, ka arritur të organizohet në dy shtete shqiptare (Shqipëri e Kosovë) dhe pritet të gjejë lumturi zhvillimore e përbashkimi mes vëllezërish e miqsh pa vizë të zezë kufindarëse.

E dhjeta, sidoqoftë ajo që po ndodh le të ndodhë, ndërlidhur me dinastinë nemanas del edhe shteti i dytë mesjetar 200 vite pas atij të Dukles, i themeluar edhe ky jashtë Kosovës por edhe jashtë Nishit e Krushevës (dardano-arbnore) i quajtur shteti i **Rashës** ose Rash(k)ës, mirëpo edhe ky me popullsi të përzier iliro shqiptare e serbosllave, gjithsesi nuk mund t’i ikën gjuhës shqipe, ngase konstatohet se fjala **rasha** vjen nga etimologjia e fjalës shqipe ***rasa** me kuptimin **rrasë rrasa - pllakë guri (kamena ploça)**, lëndë kjo ekzistuese në ato treva, me të cilën ishte ndërtuar edhe kështjella e njohur dardane në atë vend! Është interesant se pikërisht rreth Rashkës a Rashës, në shekullin XIX siç flasin dokumentat (Bue, Milojeviq, J. Bajiq) më tepër kishte vendbanime shqiptare muslimane, miqasuar me ato katolike albaneze se me të ashtuquajtura sllavo-ortodokse (serbe), ngase ajo zonë, sidomos krahinëza rreth Kopaonikut ishte *zonë ushtarake turke* (Bajic). Në të vërtetë shteti i Rashës u themelua në kohën kur lufta bëhej kundër bogomilëve nga ana e kristianëve (ortodoksë e katolikë bashkë) e jo kundër ndonjë etnie brenda kristianizmit. Në këtë kohë familjet fisnike pa dallim etnie kishin raporte të mira edhe marrëdhënie familjare krushqie e konstitutive njëra me tjetrën. Ka mendime në burime shqiptare që në 13 principatat e cekura më sipër në përbërje të asaj popullsisë vetëm vetëm 1/4 mund të ishin të përzier me joshqiptare, por fatkeqësisht ka pasur ndasi të trashëguara në atë shoqëri të shkaktuara politikisht e fetarisht, siç ishte raporti: të krishterë/bogomilë e ndërkohë pas ndarjes së kishave kristiane, varësisht nga ndikimi i qendrave, unitë e katolikë në njërin anë që mbanin lidhje me perëndimin Romën dhe ortodoksë në anën tjetër që mbaheshin me Konstatinopojën, pati armiçësi. Mjerisht në rrethanat pas rënies nën sundimin e Perandorisë Osmane shumë shqipfolës pësuan shkizmë të re disa ortodoksë u serbizuan e u greqëzuan, por edhe disa katolikë e ortodoksë u islamizuan, e disa prej tyre edhe u turqëzuan. Por mu në këtë

kohë kemi një ogur të bardhë, një ringjallje fenikse nga shumica e të islamizuarve, të cilët bashkë me paganëo-laramanë e të krishterë (qoftë katolikë, qoftë ortodoksë) që ruajtën gjuhën, gjetën shpëtimi-bashkimin në **shqiptarizëm**, në forcimin rilindjen kombëtar mbi bazë të gjuhës shqipe, **si veçori e parë përbashkuese e shqiptarit**, pa dallim feje, ideje përshkalëlëzimi shoqëror. **Dhe kështu kombi shqiptar gjeti vetveten.**

E njëmbëdhjeta, edhe pse mbizotëronin turma të përziera popullore fetarisht laramane të krishtenësh e paganësh, gjithsesi shqiptarë ose me prejardhje shqiptare: katolikë e ortodoksë, pa përjashtuar edhe elementin ortodoks (sllavo-serb e vllah), konstatohet me të drejtë se ritet fetare e të tjera tek një pjesë e shqiptarëve në disa treva mbizotëroi elementi katolik, ndërsa te serbët e përzier me shqiptarë, edhe pse ka pasur luhatje të shtetet e paratribale (serbe) nemanjide, ndërkohë, në ndikimin rus, u fuqizua ortodoksizmi i riti pravosllav, mirëpo, nuk dimë mirë, sa pati edhe influencë rryma ikumenike apo ishte rezultat i gjeturisë mençuriake të krerëve fetarë të hershëm ortodoksë pansllavistë aso jo. Sido që të ketë qenë kisha serbe politikisht bëri punë shumë të madhe në paravijëzimin e kombësisë serbe me fitimin e autoqefalisë ortodokse *pravosllave*. Madje, edhe kjo ishte mençuri e dinakëri që në vend që të kërkonte dhe të merrte leje autoqefalie nga Patrikana ortodokse greko-paarvanitase (qendra bizantine) e Konstatinopolit, kleri proserbjan, thuhet se shfrytëzoi rastin dhe e mori autorizimin e duhur nga Kisha e Ohrit e sforcuar nga ish-Perandoria Bullgare, e cila tashmë ishte pothuaj drejt shthuarjes. Dhe me këtë, kisha serbe fitoi të drejtën që u miratua edhe nga Fanari që në liturgji ta përdorte gjuhën e vjetër sllave (*staroslavjenski crkveni jezik*), gjuhën e Qirilit dhe të Metodit, si dhe të shenjtëronte, të 26 orakujt e vet etj. Sidoqoftë, edhe pse Patrikana greko-bizantine (eksdardane), politikisht nuk e pëlqente këtë autoqefali, shteti serb i nemanjidve i forcuar ndërkohë me arbanasit e sforcui edhe më shumë këtë pavarësi kishtare sllavo-serbe, madje edhe në rivalitet ndaj nënritit grek pati njëfarë avantazhi ndaj një mase shqipfolësish. Studiuesit theksojnë të vërtetën, që edhe pavarësia ose autoqefalia e **pravosllavës**, ndërlidhur jo me Konstatinopojen po me Ohrin (bullgar), nuk lindi e u përformëzua fillimisht në Kosovën e sotme, por në **Zhiça të Rashës**. Gjithashtu konstatohet nga studiuesit se me këtë pavarësi kishtare shqiptarët e besimit ortodoks të kësaj ane pësuan jo pak mbëshjellim kombësie, sepse për ta për popullsinë e njëjtë të përbashkët globale popullore shqipe u krijuan dytri ose edhe katër variante të ndryshme gjuhësore lutjesh fetare: përveç

lutjeve pagane ose të adaptuara në gjuhë të vet, tashti në fe ta quajmë të re, zyrtarisht u imponua, së pari varianti oficial burimor: riti në gjuhën greke që ishte zyrtar në Jugun e Shqipërisë dhe kudo ku shtrihej ajo influencë, së dyti, në atë të rritit *cirilometodist* në gjuhën lashtosllave (bullgare e serborusee) që ishte gjithnjë e më dominues në ish Iliro-Dardani, dhe së treti, njëherazi nuk ishte larg njohjes as riti rumun neolatin nga vllaho-shqiptarët, por siç dihet, atëherë në përdorim ishte i fuqizuar edhe riti latin nga sivëllezërit e një gjuhe e gjaku (katolikët), i cili në të vërtetë u shërbente jopak familjeve të përziera me ortodoksë të të njëjtit fis malësorësh, ku respektoheshin të dyja ritet, apo jo?! Në të vërtetë, autoqefalia bullgare ishte e njohur nga Turqia që në vitin 1868, ndërsa sipas F. Xharrës, (Shih “rd”, 18.08.2019) Serbia që për ta legalizuar **autqefalinë** qenka detyruar në vitin 1923, t’i paguajë Patrikanës së Stambollit 1,5 milion franga zvicëranë.

E dymbëdhjeta nuk di pse nuk thuhet e vërteta, që të shtrirët e shtetit të nemanjidve, i lindur jashtë Kosove në Zeta e Rasha, u ndihmua dhe u fuqizua pikërisht në Kosovë nga shtresat popullore me prijësit e vet ortodoksë kryesisht joserbishtfolës (shqiptarë). Kjo vërtetohet, ç’është e vërteta, se në shtetin e dinastisë Nemanjide jo vetëm feudalët ortodoksë shqiptarë (arbanas arbnorë) por edhe masa e të të gjitha shtresave, ishin pothuaj të barabartë me të ashtuquajturit serbë (pakicë), ngase e kishin të njëjtën fe ortodokse (me ose pa hijesë pravosllave), ndërsa ndaj katolikëve kasta nemanjide kishte qëndrim armiqësor. Prania e shqiptarëve në këto vise me emra grekë e sllavë ishte e rekomandueshme, por nuk mungojnë as emra të trasëguar nga shqipa, si: Lesh, Gjini, Lul, Dash, Arban etj. Kjo dokumentohet edhe nga regjistrat e librave fetarë të kishave të para ortodokse serbe. Është me rëndësi siç e cekin studiuesit, që në shtetin e Milutinit arbanasët (mbase aludohet në katolikë) nuk përmenden vetëm si barij, por edhe si bujq e ushtarë (sipas *Duan Danit*), ndërkaq në shtetin e Dushanit shqiptarët ortodoksë si etni janë popull i barabartë i emnuem konstitutiv, madje kishte edhe ushtarakë të dalluar, komandantë lufte si dhe princër-feudalë të njohur pronash që fuqizonin materialisht perandorinë. Është i njohur fakti, se Stefan Dushani, sipas studiuesve serbë, e quante veten: *car* (perandor) i serbëve dhe i arbanasve, por edhe i bullgarëve edhe i grekëve, edhe pse bullgarët e grekët nuk mundi plotësisht t’i bënte për vete sikurse shqiptarët. Sepse, siç thuhet, pothuaj, të gjithë shqiptarët, profanë, ortodoksë, katolikë e laramanë si popull, ishin në kuadër të kufijve të atij shteti (nëse mund të quhet shtet). Bënte

përbashkim vetëm vetëm shteti miqësor i Arbërit (Durrës), por, si me thënë masa popullore gjallonin e vepronin nën patronazhin e feudalëve vendës, gjithsesi aleatë të Dushanit, ndoshta vetëm të deklaruar si pravosllavë. Sidoqoftë, meqë serbë me kuptimin e sotëm kishte fare pak, shqiptarët, sidomos ata ortodoksë ishin epiqendrë dhe e ushtrisë së Dushanit, madje edhe të vëllait të tij (Shih: **Titos Jachalas, Arvanitika ...** (fejton) *Koha ditore*, 27 – 30. 08.'19,) dhe kjo vërtetohet katërcipërisht me faktin se ata, arbanasit, shfrytëzuan pikërisht atë forcë të përbashkët perandorake për të invaduar thellë në tokat e ashtuquajtura bizantino-greke, depërtuan gjithandej deri në Poliponez, Kreta etj., mbase të kushërijtë e hershëm të tyre pellazgo-iliro-dardano-hyllenë, apo jo?!

Po përsërisim, është i drejtë konstatimi që ndërsa shtetet arbanase karakterizoheshin me orientimin e tyre properëndimor (katolik e unit), shteti i dinastisë së nemanjidëve ndërkohë u karakterizua kryesisht me orientim lindor ortodoks, edhe pse jo fort në miqësi me vetë Bizantin, ngase Dushani synonte primatin mbi tërë atë Perandori, apo jo?!

E trembëdhjeta, që shqiptarët ishin vërtet aleatë dhe forca kryesore në shtetin e Dushani, shihet qartë pas vdekjes së *carit*, kur u shpërbë ajo perandori dhe nga ajo shpërbërje dolën të identifikuar, si me thënë, shumë familje të forta feudale shqiptare (si minishtete arbanase) edhe dolën më vete ndërsa pak ose aspak familje të ashtuquajtura të pastra serbe, apo jo?! Krahaso, familjet feudale shqiptare më kufi të qartë shtetformues: Jonimët, Muzakajt, Kastriotët, Dukagjinët, Topiajt, Blinishtët, Zenebishtët, Gropajt, *Shpatajt*, *Gërgurët* etj. dhe sidomos *Ballshajt*, të cilët kishin nën administrim edhe vise të Dukles dhe të Dardanisë së vjetër, pjesë të Kosovës, ku domosdo shqiptarët, ishin popull shumicë, apo jo?! Ndërkaq si shtet serb pravosllav (edhe pse edhe ky i diskutueshëm) përmendet, sidomos ai i knez Lllazarit me kryeqytet Krushevën, ku nuk mund të thuhet se nuk kishte në principatën e tij nënvartës e aleatë të popullsisë shqipfolëse.

E katërbëdhjeta, ndërlidhur me pikën e mësipërme, studiuesit konstatojnë se shumica e krerëve shqiptarë, kur u futën në aleancë me Lllazar Hrebeljnoviçin në Betejën e Kosovës, krahas me ta ishin edhe dy dhëndurët e tij shqiptarë: Ulk Brankoviçi, sundimtar i një pjese të Kosovës Qendrore, i cili u dallua ndërkohë si shtetar virtuoz edhe pas asaj beteje dhe fisniku tjetër drenicas Milosh Kopiliqi, i cili thonë se u vra në atë beteje, pasi e kishte shuar nga jeta Sulltan Muratin I. Në atë beteje u vra edhe Lllazari e princ Muzaka nga Jugo-Shqipëria dhe si rrjedhojë aleanca

kundërosmane e kryesuar nga Lazari e humbi betejën. Pra edhe në këtë luftë, serbë e shqiptarë ishin aleatë, andaj kuptohet se edhe vetë popullata në Kosovë assesi nuk ishte pa popullsi shumicë shqiptare ortodokse, apo jo?!

E pesëmbëdhjeta, është e vërtetë se ardhja e turqve, bëri ndryshime të mëdha në Siujdhesën Ilirike, po pas vdekjes së Lazarit dhe të Sulltan Muratit I, Princesa Elena, e veja e Llazarit, bëri politikë paqësore me turqit, më tepër se bënë feudalët e nënshtruar e të panënshtruar arbanas. Kjo lidhi krushqi me Sulltan Bejazitin, duke ia përgëzuar për grua vajzën Olivera dhe me këtë gjest fitoi privilegje të mëdha për serbët, jo vetëm në krahasim me disa arbanas, por edhe me vetë Ulk Brankoviçin, sundimtar i Kosovës Qendrore me shtrirje drejt Smederevës, i cili më fort qëndronte nën hijen e pushtetit të Elenës sesa si pushtetar ose vasal i pavarur, siç tentonte të ishte. Madje, Serbia në këtë drejtim si ogur afatgjatë paqtimi me turqit kishte faktin se Sulltan Murati II që shtirej sinip i serbëve, kishte në konsideratë po atë argument paqetimi. Në të vërtetë, nëna e Sulltan Mehmetit ishte serbe e cila quhej quhej Despina (Hatun Binti Abdullah) ndërsa vetë ky sulltani i kishte dy gra serbe (“rd, 03.02. 2029).

Kështu siç konstatohet në historinë e popullit serb, vasaliteti i krerëve serb ishte aq proturk dëshmon fakti sa që atëherë treva e Serbisë shërbente si bazë e sigurt prej nga Turqia përgatiste invazione zgjerimi në vise të tjera edhe kundër arbanasve rebelë. Së këtëjmi për ortodoksët në përgjithësi, ku bënë pjesë 2/3 e numrit të përgjithshëm të shqiptarëve, sidomos për pjesën ortodokse shqiptare që jetonte në trevat e ashtuquajtura *serbe* u lejuan edhe më shumë lehtësi fetare, në krahasim me 1/3 e katolikisë shqiptarë jo përherë të dëgjueshëm, sidomos në periudhën para e pas Skënderbeut, kur pas këtij të fundit popullata shqiptaro-ortodokse epirote unite dhe sidomos ajo katolike veriore e pësoi rëndë. Madje, kur Sulltan Mehmeti e shpalli veten sulltan udhëheqës sovran i fesë sunite muslimane shtoi se ishte sovran edhe i fesë ortodokse (bizantine). Kështu, atëherë feja ortodokse përgjithësisht në atë frymë paqësore nënshtruese fitoi edhe më shumë privilegje, duke bashkëpunuar edhe me pashallarët e Vezirët serbë, të cilët haptazi ndihmonin popullin serbë dhe pravosllaven. Së këtëjmi, ndonjë rezistencë e rastit nga ndonjë qeveri vasale serbe ndaj Perandorisë Osmane, assesi nuk mund të krahasohet me rezistencën e arbërve në mbrojtje të Europës Perëndimore dhe me pasojat që patën arbërit në këtë drejtim.

E gjashtëmbëdhjeta, në historinë serbe (garashiniane) fatkeqësisht të përqaftuar nga studiues e pushtetarë serbë naivë ose të frustruar të mëparshëm e mjerisht edhe të sotëm mohohet ekzistimi i shqiptarëve ortodoksë, madje aq më keq thuhej që në trevën e Kosovës, siç ishte pjesë e Dardanisë, nuk ka ekzistuar elementi arbanas fare (!), duke tkurrur kështu me qëllim kuptimin e fjalës arbanas, përkatësisht arnaut, në kuptim vetëm për shqiptarët e fesë katolike që vërtet gjallonin, por sipas tyre, si masë kompakte kanë jetuar vetëm në disa treva të Shqipërisë së Veriut, por nuk donin të vrisnin mendjen se edhe në vise të tjera edhe pse zyrtarisht mbizotëruese ishte feja ortodokse, gjithandej kishte familje të tëra katolike siç dokumentohet me Kishën e Trepçës dhe të Janjevës dhe të tjera, por më herët dëshmohej si katolike ishte edhe Kisha e Graçanicës, madje tek shqiptarët edhe pse të quajtur serbë ose ortodoksë zyrtarisht kishte familje shqiptare laramane (kriptokatolike), ku respektoheshin të dyja ritet: ortodokse e katolike. Sidoqoftë, ndër të tjera përmendet fakti se asokohe afro 100 familje katolike jetonin në Jagodinë, në afërsi të Pashallëkut të Beogradit! Gjithashtu konstatohet e vërteta, si u cek më sipër, që Ballshajt, të cilët fill pas zhbërjes së Perandorisë së Dushanit u rikthyen në fenë katolike dhe kishin shtrirje sundimi edhe në trevën e Kosovës, tërë Rrafshin e Dukagjinit (metohinë) dhe kështu bënë të mundur që një masë shqipfolëse të ktheheshin më lirshëm në ritin e dëshiruar, nga ortodoksë në katolikë.

E shtatëmbëdhjeta, në të vërtetë, siç u cek më sipër, katolikët shqiptarë siç ishin në shënjestër në kohë të nemanjiçve (Dushanit), ata në shënjestër do të mbesin njëkohësisht edhe nga qarqet përkatëse të Patrikanës, para, gjatë e pas sundimit osman, sepse ajo (Patrikana) shprehte urrejtje patologjike kundër katolikizmit më shumë se ndaj islamizmit, me të cilët pothuaj, gjatë tërë kohës së sundimit të Perandorisë Osmane, ishte në aleancë bashkëpunimi politik. Së këtejmi, në këtë fazë edhe më haptas e më me egërsi për interesa të ngushta, katolikët në Kosovë, sulmoheshin edhe nga vetë kisha ortodokse pravosllave, e cila në këtë luftë e kishte krah edhe Patrikanën e Turqinë me ndonjë pashë serb të turqizuar. Pra, jo vetëm Turqia, e cila ishte në aleancë bashkëpunim me Patrikanën, si përherë e tash e konsideronte fenë katolike si fe armike, sepse konsiderohej fe politikisht e ngarkuar me ideologji të shteteve perëndimore dhe ushqehej shpirtërisht, organizativisht e materialisht prej tyre, të cilat pati synuar t'i pushtonte. Kjo ishte arsyeja që ndihmën e Patrikanës dhe të kishës serbe, kundër katolikizmit, Turqia e çmonte, e

shfrytëzonte dhe e ndihmonte në shumë raste me tërë aparatit shtetëror, apo jo?

Sido që të ketë qenë, ne duam ta plasojmë të vërtetën se te shqiptarët, për hir të prejudicimit të përbashkët atavike etnike-gjuhësore, zakonore psikologjike dhe fisnore, që nga lashtësia, një urrejtje e tillë ndërfetare *ortodokse/katolike* parimisht nuk mund të përqafohej, madje faktet tregojnë se shqiptarët si popull respektonin që moti jo vetëm raportin dyshor **ortodoks/katolik**, por edhe atë të ndërkohshëm treakatërfishor: **musliman/ortodoks-katolik-tariko-sektar e profan**, duke u bazuar në gjuhën e përbashkët komunikuese të trashëguar popullore që nga Iliro-Epiro-Dardania siç pati ndodhur në kohën e Skënderbeut, i cili si shpëtimtar e mbrojtës i kombit dhe kulturës perëndimore luftoi kundër armiqve të çfarëdo feje që do të kishin qenë, prandaj edhe u mjaftua me simbole profane jo eksfetare, simbole këto jofetare që u vijuan edhe në kryengritjet e mëvonshme shqiptare edhe muslimane kundër Perandorisë Osmane e të tjerëve.

Është interesant, se si Vuk Karaxhiqi, siç u cek më sipër, e dëshmon faktin se shqiptarët kur kishin të bënin me interesa të mëdha njerëzore e kombësie, fetarisht tregoheshin jofanatikë dhe për kauzën e shenjtë dilnin në mbrojtje të saj të përbashkuar, pa dallim feje.

E tetëmbëdhjeta, në kohë të fundit thuhet se qenka zbuluar një defter turk pikërisht mbi popullatën e despotatit Vuk Brankoviç (Kosovë), emri i të cilit në atë defter shënohet U(ë)LK (***vlk**). Një zbulim i tillë për serbofilët naivë ka bërë bujë senzacionale që shprehet propagandisht si në shtypin e verdhë të tyre si në "*Krstarica forum*" etj., ashtu edhe nga faktorët e caktuar të pseudohistorisë serbe, duke potencuar faktin se sipas atij dokumenti gjoja përforcohet e vërteta se kinse qysh atëherë del i qëndrueshëm slogani: "*Kosova djepi i Serbisë*", ngase shqiptarë arbanas sipas atij dokumenti paska pasur një përqindje fare=farew të vogël, ndërkaq serbët përqindje me mija herë më të madhe (!). Ne nuk e patëm në dorë atë Defter (Regjistrim), por në bazë të reagueve joserbë, dhe në mbështetje të vetë titullit dhe të të dhënave anësore shoqëruese, në formë rezerve, sipas logjikës së shëndoshë, mund të japim këto konstatime që kërkojnë sqarime e vlerësime plotësuese nga ekspertët:

Së pari, *Defteri* qenka i vitit 1455, d.m.th. 58 vjet pas vdekjes së Vëlkut, madje dihet se edhe Uëlku edhe pasardhësit e tij, qoftë si vasal të Osmanëve, qoftë ende nën hijen e Elenës e pasuesve të saj, nuk e kishin sundimin e shtrirë në Rrafshin e Dukagjinit (Metohisë), e cila sundohej

nga Ballshajt, të cilët pas vdekjes së Stefan Dushanit, menjëherë u kthyen në fenë katolike(!). Në të vërtetë, thuhet se Metohinë e vise të tjera gjithandej, Uëlk Brankoviçi, i futi nën administrim vetëm pas vdekjes së Gjergj Ballshajt më 1438, madje ndërkaq Gjuragji pasardhësi i tij, si vasal i Osmanëve, zbeh sundimin në Kosovë, ngase bëri shtrirje që konsiderohet si ikje, andej nga Smedereva etj., prandaj krahasimi i fshatrave 480 me 13, përkatësisht i shtëpive 13000 serbe me 46 arnauete, duhet parë me rezervë të ligjshme, ashtu si edhe rezultati te Karta e Deçanit (1330), ku dalin të shënuara vetëm 89 vendbanime arbanase (katolike) të tjerat ortodokse. Gjithsesi duhet ditur se edhe shqipfolësit si etni shumicë, siç u pohua disa herë prej nesh e nga të tjerë, ishin ortodoksë. Gjithsesi lidhur me regjistrin e emrave vetjakë të tatimpaguesve të nahisë së Vuk Brankoviçit, lypset konstatuar saktë se me cilën hapësirë ka të bëjë ai regjistrim, afro 60 vjet pas vdekjes së tij, madje ato 46 familje pakicë kanë të bëjnë me familje të konfesionit katolik, apo jo, sepse siç dihet në atë kohë në këto vise shumica e shqiptarëve, ndoshta për arsye politike deklaroheshin se i takonin ortodoksisë, qoftë të nënritit greko-bizantin, qoftë atij ortodoks pravosllav, edhe pse sipas logjikës flisnin dhe mbaheshin familjarisht pa dyshim kryesisht si shqipfolës me simpati ndaj kanunit me fyrmë perëndimore, apo jo?

Së dyti, pra duke ditur faktin se atëherë mbizotëronte elementi ortodoks në Kosovë dhe si gjuhë e ritit fetar zyrtar këtu ishte serbishtja e vjetër, atëherë sipas emrave ortodoksë serbë, assesi nuk mund të përcaktohet përbërja e etnisë, pra as përqindja, sa ka pasur serbë e sa shqiptarë, vllahë, apo të tjerë, andaj përjashtimi i shqiptarëve (shqipfolësve) arbitrarisht nga llogaritja si etni në Kosovë, pse nuk paskan pasur emra karakteristikë shqiptarë (katolikë ose profanë) kurrsesi nuk qëndron, sepse shqiptarët ortodoksë normalisht ishin pagëzuar me emra karakteristikë të fesë së vet ortodokse (pravosllave ose greko-bizantine), mirëpo është shumë pozitiv fakti që del nga ai dokument, nëse ato 46 shtëpi që dalin të identifikuar si familje arnauete ishin familje arbanase (arbnore katolike), sepse ky fakt është argument i fortë që flet se në ato treva të Kosovës, si në kohë të Dushanit ashtu edhe tani, nuk paska qenë popullsia thjesht ortodokse serbo-shqiptare, por paska pasur edhe katolikë shqiptarë. Këtë gjendje e ndeshim edhe në regjistrin e Milojeviçit (1866), sikurse është edhe sot gjendja e tillë reale rurale, ngase ky popull ka qenë i përzier më fort fetarisht se etnikisht, por fatlumisht populli arbnor qëndronte i bashkuar gjuhësisht pa marrë parasysh fenë, duke u bazuar në

fise anase të trashëguara, ose edhe të reja, ku brenda një fisi mund të bashkëjetonin dy apo tri konfesionë apo sekte të ndryshme, siç ka ndodhur konkretisht më vonë dhe siç mund të ngjajë e po ngjan mjaft natyrshëm edhe sot, apo jo?!

Së treti, ndërkohë nga një punim i osmanologut **Iljaz Rexha**, ndër të tjera nxorëm edhe këtë fakt lidhur me Deferin **vlk** (1455). Autori kur trajton toponimin e fshatit **Ujmir** (Onemir, Unjemir!) të Rrafshit të Kosovës, i cili atëherë paska pasur “*12 shtëpi, emrat e kryefamiljarëve vërtet ishin të sferës sllavo krishtere, por bënin përjashtim dy kryefamiljarë: Bogavec i biri i Plak-it dhe Pec-in i biri i tij*”. Së këtejmi, për ata që duan ta marrin vesh të vërtetën mjafton ky argument, për të kuptuar praninë e elementit shqiptar edhe në këtë fshat, sepse së pari, emërtimi **Ujmir**, është kompozitë e qëndpërqindtë e gjuhës shqipe: *ujë+i mirë*, apo **ana e mire** (Onemir), së dyti, sipas regjstrave kishtarë ortodoks paska ekzistuar toponimi shqip shumë para vitit 1455, përkatësisht me mija vjet, para se se kjo pjesë e Dadanisë të emërtohej Serbi ose Kosovë apo Prava Stara Srbi nga Milojeviçi dhe së treti, ndër 12 familjet me emra ortodoksish ishin dy kryefamiljarë me emra shqip, prandaj edhe kjo dëshmon ekzistimin e shqiptarëve në këto treva me emra si anas paganë, siç ishin edhe antroponimet **Plak-i** e **Pec-i**, që në kontinuitet ende i bartin familjet e sotme shqiptare, pa dallim feje e krahine, apo jo?!

Së katërti, studiuesi Qazim Namani, na bëri me dije se se dy studiues boshnjankë nga Sarajeva, lidhur me deshifrimin e oikonimeve nga ky Regjistër, meqë nuk e njihnin gjuhën shqipe dhe në serbishte etimonin e disa oikonimeve nuk i dilnin të qarta, si:

Burçak, Lan, Grah, Kurtesh, Burrnik, Bujanc, Drenicë, Llapashticë, Kuçlan, Trim, Kenuzi, Mur –Guli,, Arbanash, Lanishtë, Mirash etj.,

atëherë qënkas shprehur kuturu se këto fjalë mund të kenë prejradhje persiane(!!!). Siç po shihet prejardhja e tyre nga gjuha shqipe është e zbëthyeshme dhe fortë e qartë, apo jo?

Së pesti, edhe konsultuesi i defterit “Oblast Brankoviqa”, prof dr. Rexhep Doçi, në një punim më të ri, (S Bota sot, 11.07.2019, f. 11), duke folë rreth Artanës të shënuar në atë dokument si Nouo monte (Novo Bërdo) si kala, qendër banimi e xehtarie, konstaton bindshëm se asnjë vendbanim, përkatësisht asnjë banor i regjistruar i kësaj treve (Kosovës) nuk “*përcaktohet me termin etnik si grek, romak, sllav, serb, vlleh, turk etj, por përcaktohen si banorë arbanash në latinisht ose arnaut turqisht,*

sinonime këto, nga të cilat nënkuptohet qartë e vërteta se popullsia e kësaj treve aso kohe ishte shqiptare. Sidoqoftë, veç fakteve të sapocekura, edhe sipas asaj që pamë në titull, dhe në bazë të biografisë që lexuam për Vuk Brankoviçin, dalin fakte që asociaconojnë që edhe vet familja e despotit ka qenë serbo-shqiptare, nëse nuk ka qenë thjesht shqiptare, edhe pse disa studiues e pohojnë këtë (R. Doçi), pa mëdyshje ajo familje ishte e lidhur me shqipen e me shqiptarët. Kjo në njëfarë mënyre dëshmohej edhe nga trajta e emrit **vëlk** që asociacionon barasvlerësin e shqipes **ulk**. Shkronjat e para: **V/U**, atëherë edhe sot janë të këmbyeshme në shkrim e shqiptim në gjuhën shqipe. Krahaso, së paku *eyro/euro*, *Budua/ Budva*, *Aulona /Avlona/Valona (Vlora) kualitet/kvalitet*, *pinguin/pingvin* etj. Kështu, **v(ë)lk** e **u(ë)lk** (*wëwk/os, wolf) është e njëjta fjalë, me një ndryshim të vogël në transkriptim, sepse në shkrimin arabo-turk të kohës, që përdorej nga Perandoria Osmane, përkatësisht regjistruesi, sipas natyrës së atij shkrimi, zanoret, si sot në arabo-hebraishte, nuk shënohen, andaj trajta serbisht **vlk**, shqip **ulk** në atë kohë mund të ketë qenë e njëjta mënyrë shqiptimi e shenjimi të fjalë-konceptit përkatës. Madje, sipas ligjeve të historisë fonetiko-fonologjike të gjuhës shqipe zberthimi është shumë i lehtëpranueshëm, kur **v**-ja del e shëndërruar në **U**: **ulk**, dhe njëherazi. Ndërkaq, në anën tjetër është provueshme në shqipe që **L**-ja konsonante të kalojë në **J** ose të zhduket, ndërsa në serbishte, sipas burimeve përkatëse edhe pse shpjegohet se konsonanti **l (lë)** ka kaluar në **-U**, do të thoshim se ky proces është shumë më i vështirë për të kuptuar dhe pranuar, në krahasim me atë që shpjegohet sipas gjuhës shqipe, ngase ndër 10 variantet e gjuhëve të sotme sllave, të emrit të bishës në fjalë *wëwk/os, vetëm serbishtja e ka të shqiptuar zanoren **-u** si në shqipe, të cilën e përforcon me **v**- në nistore **vu+k** (rus.volk, ukr, voek etj.), kurse në shqipe krahaso derivatet: m. **ulk** f. **ulkojë**, ashtu si edhe në serbishte m. **vuk**. f. **vuçica (q/kj)**, ku theksi gjithsesi i mëshon **u**-së. Krahaso edhe derivatet e shqipes që si rrjedhojë zhvillimi kanë dalë: **ulk**, **ujk**. Kështu sipas procesit normal në shqipen e sotme si edhe te fjala bulk – bujk, **L**-ja është shëndërruar në **J** ose del e zhdukshme. Krahaso: variantet sinonimike të emrave vetjakë mbi këtë bazë në shqipe: *Ujkan Ujk*, *Ujkash* ose *Ukë*, *Uki*, *Uk (Uuk!)* apo *Ukshin* (*Uka i shenjtë) apo serb. *Vuka+shin*, të shpjeguar si *Vuka+sin*, përkatësisht *vukov sin!! /djali i v/Ukës!), po shtoj që në krahasim me shqipen *UkShin* ose *ShinUka!* (Uka i shenjtë) që trajtën – **Shin** e lidhim me lat. *San* Santa (i shenjtë), serb *Sveti*, sjellim si shembull të ngjashëm emrin vetjak (ose mbiemrin) tek serbët **Vukashin** (*Vuksha*

Vuço i shenjtë Vuk sveti/ Sveti-Vuk), le të krahasohet me trajtën në shqipe: **Vuksan** - Vuk + i shenjtë, pra lat. **san santa** – i, e shenjtë. Le të krahasohet edhe emri i personazhit të De Radës: MiloShin, që ka të bëjë apo jo, me zërthimin Milo (lat. miles -ushtar)+ Shin (shq. i shenjtë) – **Luftëtar i Shenjtë**. Krahaso edhe Kolashin, pastaj *Shingjergj* etj. Sidoqoftë, edhe ky sugjerim le të vlerësohet, ngase edhe Milojeviçi trajtën shqipe **shin** (shën) në Fjalorthin e tij e përkthen në serbishte me barasvlerësin **sveti**. Së këndejmi: **Vukashin/ Vuksan** e **Ukshin** si emër i përbërë më tepër ka gjasë të ketë qenë koncepti **sveti**—i shenjtë vuk/sveti /Uk/shin/ Vukashin -ShinUka si ShinGjergji etj. .

Sidoqoftë, pyesim, a nuk tregon edhe ky fakt gjurmë të pranisë ose të ndërndikimit të gjuhës shqipe në emrin Vuk UK /Vlk /Ulk dhe në emërtimin e despotatit, kur vetë emri i sundimtari qenka shënuar nga regjistruesi sipas alfabetit arab i kohës **vlk**, ku mungojnë zanoret, prandaj në alfabetin sllav është lexuar vlk dhe kjo deshiofrohet lehtë në krahasim me shqipe e vjetër: ***ulk/vlk (u=v)**, apo jo?! Pra, ne flasim për nëndikim, pa e mohuar trajtën e vjetër parasllave, ngase supozohet që mbase ashtu *ulk/vlk/*, do ta ketë dëgjuar të shqiptuar regjistruesi atbotë nga informatori? Edhe kjo dukuri le të vlerësohet, apo jo, ashtu si edhe fakti pse Milojeviçi trajtë-emrarin **ujk** të shqipes e përkthen në serbisht me barasvlerësin **kurjak**, ndërsa trajtën *vuk* nuk e shënon as si trajtë sinonimi?!

Së gjashti, sigurisht mbi bazë të asaj që sapo u tha, le të vlerësohet, pati të drejtë apo jo, studiuesi Noel Malcolm, i cili mendon se nga emri i sundimtarit **Vuk**, rrjedh edhe emri i toponimit me-, sipas shkrimit araba pa zanore)sjetar *Vuçitërnë*, të cilin e nxjerr si ne shembullin Vuksan **si emër albanofolës**(!) dhe që ishte në përdorim në veçanti edhe në rrethet e Dukagjinit (B. Rexhepi –J. Sallahu; *revista drini*, 20.12.2016). Këtu mendoj të shtohet nga studuesit tonë të dëgjuar historiani Jusuf Buxhovi, i cil ndërkohë n ë librin Kosova – histori e shkurtër , Prishtinë 2021 konstaton:

Vuk Brankoviçi, vazal turk, i cili ka sunduar edhe në Deçan, Prishtinë Shkup që nga serbët quhet Vuk, që në burimet shqiptare ndeshet edhe në trajtën Ujkan e në ato turke osmane Vlk -“Vlk-oglu”, në shqip zërthimi “vlk” do të thotë Ujk ose Ukë që i përgjigjet patronimit Ujkan... Rasti “Vlk Vilajet” , përkatësisht emërtimi “Obllast Brankoviça”, duke e kthyer emrin Ujk ose Ukë në “VUK”, tregon më së miri përmasat e falsifikimit të

historiografisë serbe për ta sajuar me çdo kusht të ashtuaquajturin shtet mesjetar serb me qendër në Kosovë me despotë serbë, gjoja të legjitimuar edhe nga Osmanët, kur e gjitha flet për një feudal ortodoks nga Dardania shumë burime të kohës të cilësuar si tribal, emri i të cilit shpjegohet në gjuhën shqipe... (Shih “zsh”, 19.06.2022).

Së shtati, vetë emri i vëllait të Vëlkut (*Ulkut Ujikut Vukut/ Vuksanit Ukshinit!*) **Gërgur** (*gur-gur), emër ose mbiemër (patronim) që kishin fisnikët shqiptar (dhe jo vetëm ata), siç ishte edhe emri babai i Vojsavës, nënës së Skënderbeut, që etimologjikisht lidhet me emrin *gur* (kamen, *Petr!, *Grigor!), përveç si emër fshati të shënuar në Kosovë, nga Milojeviçi, këtë patronim e mbartnin më parë, siç e mbartin edhe sot shumë familje të dëgjua shqiptare dhe gjithandej në Serbi, deri edhe ajo e Karagjorgjit(!). Madje edhe ky fakt e përforcon bindjen tonë se ky emër (me prejardhje shqipe) ishte i përbashkët në jetën e përbashkët, atëbotë e sot, për serbë e për shqiptarë e më gjerë deri në Bosnje e Kroaci (ortodoksë, katolikë ose profane). Prandaj në këtë kontekst për ne zgjon interes edhe supozimi i studiuesit F. Xharra (Revista Drini, 30.08.2018), i cili i entuziazmuar që në Kroaci ndesh toponimet **Bel/aj** e **Letaj** si në Shqipëri shpreh mendimin se edhe emërtimi i toponimit atje **Uçka** duhet të ketë shpjegim origjine nga fjala shqipe **Ujk**, përkatësisht nga shprehja **ujq+ka** (vendi i ujqve), pyje këto, ku vërtet paska a paska pasur ujq!

Së teti, e përforcon bindjen tonë edhe fakti tjetër se U(l)k (VLK) Branku, motrën e tij të vetme Teodora e marton me princin shqiptar Gjergj Topia, familje kjo feudale e dëgjuar shqiptare durrsake, pinjojt e së cilës pas shuarjes së Mbretërisë Anzhuine Shqiptare, vazhdojnë të qeverisin ato vise, madje ndërkohë kjo familje ishte në aleancë me Skënderbeun dhe ishte njëra sikrahu i djathtë i shtetit të Gjergj Kastriotit. Pra, s’do mend se si familjet fisnike ashtu si ajo e Vukut dhe ajo e Gjergj Topisë, ashtu edhe popullsia do të jenë marrë vesh në në gjuhën e përbashkët, përkatësisht në të dyja gjuhët: serbishtja si me thënë ta quajmë si gjuhë zyrtare fetare këndeje, ndërsa shqipja gjithsesi si gjuhë popullore komunikuese ndoshta edhe fetare-zyrtare (Lutfi Alia) gjithandej e gjithkëndeje apo jo?!

Së nënti, sido që të ketë qenë, gjërat e tilla të diskutueshme rreth prejardhjes e përqindjes nga ai dokument, nuk është mirë të plasohen në mënyrë spektakurale si të vërteta, sepse propagandat e tilla po mjellin e

po shtojnë urrejtje kundër shqiptarëve të sotëm, kinse këta qenkan me faj pse pas vitit 1878 e deri sot në Kosovë nuk qenka një gjendje e tillë me shumicë serbe, andaj që masa e tillë me hir e pahir duhet ta pranojë serbizimin, ose të shpërngulet apo të zhduket së këtejmi(!!), sepse qenka në tokë të huaj, apo jo?! Për të argumentuar një dukuri të tillë kundërshqiptare alogjike patologjike, siç u cek, po i sjell këto gjashtë fakte si reagim-konstatime të ditës (nxjerrë nga interneti) që po e helmojnë masën serbe si të pazonjën pse nuk po reagon dhe po i përuhin dinjitetin rinisë serbe për çka duhet të luftojë, apo jo:

1) *Gjithsesi këtë (rezultat) duhet ta dijë gjithkush (serbë e të tjerë!), sepse po ai raport mund të përsëritet: **13000 shtëpi serbe / 46 shqiptare**...Sidoqoftë, me gjendjen e sotme Serbia kurrë nuk do të pajtohet... Ajo që me forcë me pa të drejtë është **uzurpuar**, herdokur do të vijë në rend - dite dhe pasardhësit do të paraqiten e do të trokasin në dyert e uzurpatorëve...!*

2) *...Për historinë serbe (rreth Kosovës, Stara Serbisë) më shumë mësojmë nga libërthi i M. Milojeviçit e vitit 1866 se nga çdo "udzbënik" - libër mësimor tjetër shkollor (!).*

3) Nga "Krstarica forum" (që është portali ose bashkësia më e madhe dhe e fiqishme e internetit në Serbi) veç pasaktësive të tjera lexuam këto fjalë nxitëse: *Nga regjistrimi mesjetar 1455 në atë territor vetëm 2% ishin shqiptarë, ndërkaq: **Milosh Milojeviç** më 1871-1873,.. ka lënë dëshmi që atje (në Kosovë Metohi), **serbët ishin popullsi shumicë, madje dominonin sidomos në qytete...**(!!!) ndërsa sot 97% janë shqiptarë që për këtë gjendje është vënë në shërbim: terrori fizik..., vrasja, frikësimi e krime të tjera...(!).*

4) Po kështu disi, madje edhe më **luftënxitëse** ishin edhe fjalët e të fortlumturit peshkop **Irinej**, i cili "milom ili silom" (me hatër ose me zor) gjithsesi Kosovën e do Serbi, ashtu si edhe mbarë aparati shtetëror serb, ngase sipas tyre, gjoja: **Kosova e Metohija është djepi, zemra e shpirtit serb...!**, përkatësisht, gjithsesi e duan që **Kosova të mbetet nën Serbi!**

5) Tash së voni bie viktimë e këtyre falsitet të dhënave sikurse edhe z. Vemic edhe intelektual i **Jovo Bajic**, i cili në Facebook më 08.11.2018, veç tjerash thekson:

*"Udhëpërshkrimet e Milojeviçit përfaqësojnë thesar të vërtetë (**prava riznica**) i të dhënave mbi praninë historike dhe aktuale në vitet e '70-a të shek XIX të serbëve në viset i Kosovës, Metohisë, Serbisë së Vjetër... të*

dhëna këto që, pikërisht ashtu siç i ka çliruar ai dhe vullnetarët e tij gjatë luftave serbo-turke 1877-1878 edhe sot mbrojnë me fakte këtë krahinë jugore serbe.”

6) Në një tekst “*ilirski srbi*” ndesha këtë shkrim për Milojeviqin, i cili duhet të kuptohet drejt, sepse vërtet ishte më i sinqerti në mes fryrës-gënjeshhtarëve të tjerë:

“Milojevic është mal ndaj breg-kodrinashëvetë frymëtarëve tanë, Ai është lis mes barnishtarëve të njerëzishmërisë sonë. Rrëfimi i tij nuk ka qenë madhështor vetëm pse hapi rrugë hulumtimesh për të kaluaren, por pse qe i gatshëm me marrë shpatën në dorë dhe të shkojë në vijën a parë të frontit si çetnik...”

Së këndejmi, nga mosnjohja ose nga mosdashja për me njoftë **të vërtetës** e shoqëruar nga propaganda e shfrenuar agresive kundër pavarësisë së Kosovës, si dhe ruajtja e emërimit shtues për Kosovën: **Metohi** që ka kuptimin “*pronë e kishës*”, që Milojeviçi *ish-Metohinë* e quan **Podrime**, Shteti e Kisha e Serbisë, lë hapur **gjendje lufte, agresivitet ndaj Kosovës**, andaj, jo vetëm reagimet e mësipërme duken si të natyrshme, por priten edhe të tjera, nëse nuk u thuhet e vërteta. Prandaj kërkohet që të vërtetën ta njohin dhe ta thonë shkencëtarët e politikanët konstruktivë, apo jo.

Sidoqoftë, pyesim, me çfarë të drejte Serbia lë hapur këtë *gjendje lufte*, kur u ditka se 97% të banorëve nuk qenkan serbë!? Vallë, me ç’arsyetim ndërgegjeje me zjarr e hekur e deshi dhe ende do rikthimin e Kosovën në **koloni serbe**!?

E nëntëmbëdhjeta, gjithsesi, ndërlidhur me pikën e sapocekur shkencëtarët, pushtetarët edhe kisha serbe e masmedia për hir të së drejtës, qetësisë shpirtërore e paqes kombëtare, meskombëtare e ndërkombëtare si dhe të respektit ndërfaqinjësor sipas obligimit hyjnor që kanë duhet “**me respektue të vërtetën, ngase vetëm e vërteta do t’i shpëtojë** (Gjoni 8.32) ose të heqin lakminë e fortë, ngase **Lakmia e tepërt është rrënja e të gjitha të këqijave... ajo të largon nga besimi dhe të depërton në shpirt shumë dhimbje** (Shën Pali, Timoteu 1-6.10), andaj së këtëjmi mekatarët e sotëm e kanë lehtë me shpëtue nga mekatet e mëtejme dhe të shërojnë sadopak shpirtin e vet e dhimbjet, sipas revelatës si dhe plagët mentale të qytetarëve vartës, besimtarëve të vet, nëse heqin dorë nga gënjeshtrat dhe njohin opinionin së paku me disa nga këto **të vërteta**, që të tjerët i kanë thënë e argumentuar më mirë se ne në këtë punim, të cilat besoj se i dijnë, por për mos me i harrue po ua rikujtojmë:

Së pari, duhet të kenë të njohur dhe të pranueshme të vërtetën dhe atë të vërtetë t'ua thonë brezave që shqiptarët në Kosovë kanë qenë shumicë në të gjitha epokat historike: si para e pas ndarjes shtetërore e fetare të Perandorisë Romake, përkatësisht para ardhjes së sllavëve këndej, pra edhe para e pas Shkizmës së Madhe kristiane, kur arbanas e sllavë në këto treva i përkisnin kryesisht të njëjtës fe kristiane, por varësisht nga sundimtarët më tepër në këto vise mbizotëronte respektimi i ritit lindor ortodoks bizantin.

Së dyti, pa u zgjatur në raportin iliroshqiptaro-sllavë është i njohur fakti se latinët dhe lashtogrekët sllavët i quanin *schlavus* (*skllavë - bujkrobë*), përkatësisht *servus* (*servos*) me kuptim përcmues: shërbëtorë **robë-sluga**, ndërsa në gjuhën shqipe nga fillimishtja fjalët *shklav, derivatet shkjav, shkav – **shkije**, përkatësisht **sherb/yes*, *shërbëtor* nuk kanë pasur kuptim pejorativ, ngase si duket sllavoserbët e protoarbanët i përkitnit të njëjtës shtresë sociale, jo vetëm sa ishin nën sundimin e Bizantit, por edhe kur ranë nën sundimin e bullgarëve. Vetë ekzistimi i trajtë-fjalëve të iliro-arbano-shqipe: *shkjavë-shkije*; *shërbyes*, deri më sot gjalluese në shqipe, pa përjashtuar fjalën e përbashkët me serbishten *rob* e *serb* (nga *sherb* *Sherbi*) dëshmon popullatën shqipfolëve të këtyre trevave, e cila nuk mund të mohohet nga pseudoshkenca serbe, apo jo. Madje ndërkohë, kur perandoritë e tilla u çmontuan dhe *serbët* (*servët* ose *shërbët edhe me arbanas*) fituan të drejta pronësie, e ndërkohë edhe liri e të drejtë (vetë)qeverisjeje trevat e tilla u quajtën Serbi (Servia) edhe ndërkohë formuan edhe autonomitë e veta shoqërore-politike deri edhe me mbretëri a principata të veta (serbo-arbanase), dhe së këtejmi edhe qytetarët vazhduan të quhen *serbë* (sherbë sot shëbyes) po me konotacion të ri, po gjithsesi, ai emërtim përfaqësonte të gjithë qytetarët sipas kuptimit të sotëm të etnive të ndryshme, por, siç merret me mend emërtimi i tillë përfaqësonte shqipfolësit shumicë e të tjerë dhe jo asesi vetëm besimtarët skizmatikë të një etnie, siç u përvetësua arbitrarisht në shekullin XIX nga *parapreporodi* serb (renesanca) fjala **serb**, si term njënacional.

Së treti, po këtë të vërtetë duhet ta kemi parasysh në ecejake historike të mëkëndejshe e mëtutejshe. Kështu ndodhi edhe më parë kur e njëjta shtresë shoqërore përjetoi sundimin e tribalëve nemanjidë, të cilët, historia sllave i quan gabim serbë njënacional, të cilët fillimisht dalin të organizuar në Duklea, në Zeta (Mal të Zi), në kohën e Kryqëzatave dhe së andejmi u fuqizuan në Rasa (Rashka) dhe duke shfrytëzuar Kryqëzatën IV, e cila e pati dërmuar Bizantin, nemanjidët ndërkohë duke gjetur edhe

miratimin e popullatës anase kryesisht arbanase të të njëjtit rit fetar shtrinë sundimin edhe në treva të Kosovës, më fort si aleatë bashkëqeverisës me arbanasit dhe së bashku me këtë shumicë arbanase nga Rasha kaluan në Kosovë e më gjerë dhe së bashku bënë lufta mbrojtëse e pushtuese. Kjo dëshmohet sidomos pas shuarjes së asaj dinastie, pas vdekjes së car Dushanit, ku shumica e fisnikëve me feudet e veta me kufij të qartësuar identifikohen si arbanas.

Së katërti, ndërkohë edhe në Betejën e Kosovës, dëshmohet që shumica e princërve shqiptarë ishin aleatë me knez Lazarin, madje Milosh Kopiliqi e Vuk Brankoviqi, si dhëndurë të Llazarit konsiderohen se ishin shqiptarë kosovarë ose gjithsesi u përkisnin familjeve kristiane mikste serbo-arbanase.

Së pesti, duhet të njihet opinioni me të vërtetën, siç e pohojnë studiuesit që “me ardhjen e turqve në trojet e Dardanisë jo vetëm në Kosovën e sotme, por edhe në në Nish, Toplicë, Vrajë e trevat e tjera të Serbisë së sotme (1375), popullsia e atjeshme paraqiten para turqve se nuk ishin sllavë, po arbër arbanas (Hakif Bajrami, Kosova sot, 6.09.2018 f. 9), prandaj kërkohet vërtetësimi i tillë i sforcuar nga burime të reja relevante më të sigurta, por sidoqoftë një gjë dihet me siguri se shqiptarët si pasardhës të iliro-thrakasve kanë pasur shtrirje gjithandej në Nish e përtej. Madje thuhet se Nishi para Shkupit një kohë ka qenë kryeqendra e Dardanisë.

Së gjashti, duhet pranuar e vërteta, se pas vdekjes së Skënderbeut, por edhe më parë një pjesë e konsiderueshme shqipfolësish ortodoksë si dhe katolikë nga mbarë Rumelia Verio-Lindore ndërruan fenë, u islamizuan, (më fort formalisht) po ruajtën gjuhën arbnore, ashtu si etniteti katolikë arbnorë legalisht pakicë, të cilët tani bashkë me të islamizuarit quheshin **shqiptarë**, ndërsa një pjesë tjetër po shqipfolësish ortodoksë ruajtën fenë duke hyrë nën mbrojtje të Autoqefalisë së Kishën Serbe, e cila me ferman sulltani kishte imunitet, por të tillët sadokudo humbën dinjitetin arbanas-arbnor duke iu dorëzuar me servilizëm kishës serbe u quajtën nga shqiptarët (muslimanë e katolikë): **shkje shkije**, kontaminim e fjalës **sllav** (skllav *shklav, shkja/v) dhe **shkizmë**, kështu shkallë shkallë një pjesë e tyre edhe gjuhësisht vërtet u shkizmuan (u serbizuan), ndërsa një pjesë tjetër edhe pse si shkije (serbjanë) mbeti shqipfolëse. Kjo dukuri **ndarje-përçarje** ndërsqipfolëse në këtë punim quhet **shkizma e madhe fatale ndërsqipfolëse**, sepse u bë vërtet ndarje fatale gjuhësore e fetare ndër shqipfolësit. Së këtejmi kjo ndarje fetare në njërën anë **islame (turke)**

e në tjetrën **pravosllave(serbe)**, u shfrytëzua nga sunduesit për interesa të tyre politike, qoftë nga Turqia me sforcimin e islamizimit, qoftë nga Serbia , si sforcim të pravosllavës, e cila me shumimin e serbo-shkieve nga arbanasit rriti konsiderueshëm numrin e etnitetit dhe si rrjedhojë nga një ndarje-përçarje e tillë si me thënë fqinjë u gjenden në dy tabore kundërshtarë, të cilët aq më keq përjetuan e përvujtësuan edhe lufta vëllavrasëse me frymesë fetare. Megjithatë, siç e vërteton akad. Radovan Samarxhiq, edhe historianë serbë siç ishte edhe Çubriloviq, e pranon që Serbia (me Kosovë) më 1739-1740 nuk ka mundur të ketë më shumë se 50-60 mijë serbë dhe se “kombi serb”del i imagjinuar në fillim të shek XIX (F. Xharra te “*rd*”, 07.06.’19). Pra kjo armiqësi (serbo-shqiptare) mori përmasa shumë plagërënda sidomos në shekullin XIX kur filloi dëbimi masiv i shqiptaro-muslimanëve nga trojet e veta shekullore nga Principata serbe e ndërkohë edhe nga e ashtu quajtura Serbi Jugore, ndërsa kjo hasmëri e shoqëruar me propagandë të paskrupull kundërshtare u përshkallëzua edhe më përbindësisht më 1912, 1918,e në vazhdimësi kur u ripushtua Kosova nga Jugosllavo-serbia, duke u shndërrua në koloni klasike.

Së shtati, është e vërtetë se pushtimet deri në vitin 1878 dhe sidomos këto të viteve 1912, 1918 përveç marrëveshjeve turko-serbe, arsyetohej edhe me një propagandë të paskrupullt shumë të fuqishme e mobilizim luftarak, veç tjerash edhe duke shfrytëzuar edhe *faktet* fallse të cekura më sipër, siç ishte edhe përqindja shumicë gjoja serbe në Kosovë duke u mbështetur, siç u cek më sipër, në Kartën e Deçanit, përqindja nga Regjistri i Vëlç-vilajetit, pastaj edhe nga Udhëpërshkrimi (Putopisi) i Milojeviçit – edhe pse që të gjitha ishin të pavërteta. Kështu nga propaganda e tillë e me mashtrime me të paskrupulla Serbias fitoi territore mbi kurrizin e shqiptarëve, por e keqja më e madhe ngjau që kjo propagandë e fuqishme kaloi në **rutinë patologjike** të pashërueshme gangrenëse jo vetëm për shqiptarët, por edhe për popullin serb, saqë b.f. as bombardimet e gjakosjet e fundit nuk mundën me ua heq nga mendja serbëve: **mashttrimin e madh patologic katastrofal** (*veliku katastrofalnu zabludu*) të plasuar gënjeshtërisht, veç tjerash edhe **rreth shumicës serbe kinse në Kosovë dikur, të argumentuar nga Milojeviçi (!!!), ndërsa tash nga faji i shqiptarëve ka mbetur pakicë**, dhe kështu ende qëndron në psikën e qarqeve serbe ky iluzion tejet i paqëndrueshëm, i ili duhet çedukuar me përgënjeshttrim nga vetëm serbët, ngase ende po

krijon armiqësi pa shkas kundër shqiptarëve, siç dëshmojnë edhe reagimet e cekura prej nesh pak më sipër.

Së teti, u cek pak më naltë që serbët emërtimin *serb* që kishte kuptim përgjithësues për etni të ndryshme, ku shqipfolësit gjithsesi zinin vend dominues e shfrytëzuen duke e lidhur me fe ortodokse rritit pravosllav, duke e fuqizuar si term vetëm njëncional, madje edhe të gjitha kultet fetare ia përshtaten nocionit serb njëncional, edhe pse dihet e vërteta e kulluar se tempujt fetarë kishat e manastiret që të gjitha këto objekte në Kosovë ishin prona të popullit shumicë arbanase ortodokse ose katolike autoktone në këto troje. Me një fjalë edhe pse mund të jenë quajtur serbe (sirbe) që nga periudha e Turqisë deri në ditët e sotme ato i takonin këtij populli, edhe pse një pjesë e të cilit nga halli ose interesi u islamizuan, ai popull megjithatë u kujdes i ruajti dhe i respektoi, siç i respekton e i ruan edhe sot si të vetat, si objektet ortodokse, ashtu edhe kishat katolike e xhamitë e teqet muslimane, tolerancë kjo që njihet si karakteristikë e shqiptarit. Prandaj kurrfarë brengje nuk duhet pasur patronalizëm nga Serbia as për serbë-shkiet as për objektet të quajtura ortodokse në Kosovë.

Së nënti, injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës si plagë katastrofale në marrëdhëniet shqiptaro-serbe ka ndodhur jo aq për mungesë koncepti, nga mosnjohja e një qëndrimi tolerant të shqiptarëve anas të këtij trualli ndaj objekteve: pagane, katolike, ortodokse dhe muslimane, por ka ndodhur si një qëndrim satan i nacional shovinizmit serb në bashkëpunim me kishën nacionaliste serbe më parë e sidomos në shekullin XIX të nxitur nga idetë romantike-iluministe, ku del e dalluar ideja pansllaviste e nxitur përveç oreksit kolonialist edhe nga ndihma e Ruisë cariste e Franca antiturko-islame, të cilat ishin në armiqësi me Perandorinë Osmane, andaj, pothuaj, u përkrah *Naçertanie*, plan-program ambicioz ky, i sajuar në frymën e pansllavizmit, mobilizim ky që i paraprinte formimit të shtetit të Serbisë së madhe të shtrirë edhe mbi territorin e imagjinuar të perandorisë Nemanjide gjoja serbe, troje këto qi ishin kryesisht pronë e trashëgimisë shqiptare.

Së dhjeti, Prof. Dr. Eshref Ymeri (Shih: portali *drini.us*, 11.09. 2021) bazuar në të dhënat më baskëkohore (nga Elena Kocaqi, F. Xharra etj.) paraqet të dhënë që del nga analiza *ADN* se në Serbi shqiptarët e besimit ortodoks dhe katolikë përbëjnë 35%, ndërsa ata të besimit muslimanë 5%. Kështu konsiderohet se gjithsej 40% janë shqiptarë me prejardhje ilire. Sidoqoftë, për mendimin tim tim, edhe ky fakt, sidomos

për klerikët serbë e shqiptarë, duhet të shërbejë për mirëkuptim e jo urrejtje mes kombesh.

Së njëmbëdhjeti, fundja sot për sot vetëm e vërteta, do ta esëllojë serbët e kishën serbe, ashtu dhe sundimtarët e sotëm serbë si dhe të gjithë intelektualët e mbarë popullin e Serbisë së sotme sesa i përket përqindjes etnike, sipas asaj që e shpjeguar më sipër *shumicë serbe Kosova kurrënkurrës nuk e ka përjetuar*. Madje me sa dimë, një përqindje të tillë Kosova, nuk e ka pasur as gjatë muajt të bombardimeve të NATO-s, 1999, kur së këndejmi u shpëngulën me dhunë afro 1 milion shqiptarë.

Fundi i fundit, nëse prejardhja shikohet historikisht e aktualisht, një përqindje e tillë e shumicës së pastër historike serbe (me kuptim njënacional) nuk është lehtë me u gjetë, qoftë në ndonjë lagje të cilitdo qyteti në Serbinë e sotme, qoftë te ndonjë fshati, në kuadër të vetë territorit të sotëm komunal të shtetit të Serbisë, ku do të jetë i banuar qindpërqind historikisht nga *serbë të pastër, të kulluar* (“*çisti istorijski serbi*”), apo jo?!

NËNKREU III

BASHKËPRANIA DHE KONTRIBUTI I SHQIPTARËVE NË BASHKËJETESË ME TURQ, SERBË, GREKË E TË TJERË DHE MOSPËRFILLJA GJITHANDEJ E TYRE NDAJ ASPIRATAVE TË RILINDJES SHQIPTARE

Sidoqoftë, është i vërtetë fakti që masa të konsiderueshme të caktuara shqiptarësh kudo që gjallonin kishin dhënë siç japin edhe sot kontribute, si për vete, për liri e prosperitet të atij vendi a shteti ose atij populli me të cilin bashkëjetonin ose dëshironin të bashkëpunonin. Si më parë edhe gjatë periudhës së romantizmit e iluminizmit evropian e botëror shqiptarët ishin të pakursyer. Kështu shqiptarët me qinda vjet kishin dhënë kontribut edhe për përforcimin e konsolidimin e drejtimin e Perandorisë Osmane, duke arritur në poste më të larta drejtuese, *pasha e vezirë*, mirëpo si hetoheshin se reflektonin ndjenja të veçanta shqiptarie, si thuhet, asgjësoheshin pabesisht. Në të vërtetë, jo vetëm për shtetin turk, por me shtrirjet e tyre hapërdare, duke shfrytëzuar intuitën e gjeniet luftarake e njerëzore të trashëguara ndihmuan e punuan si për vete edhe për lirinë e mëvetësinë e popujve të tjerë, pa përmendur Italinë, deri edhe Rusinë, ndihmuan egjiptianët, arabët, ndihmuan pa hile, rumunët, malazezët, grekët, bullgaro-maqedonët dhe në veçanti serbët e Serbinë në fillimshkullin XIX që ishte “*shekulli i formimit të kombeve ose të komb-*

shteteve”, por ata (shqiptarët) me sinqeritetin e tyre nuk mundën me gjetë askund aleatë e miq të sinqertë për bashkëpunim që të realizonin aspiratat e tyre për pavarësimin e vetvetes, të Arnautllëkut të tyre (*Shqipërisë së katër vilajeteve*). Fatkeqësisht, pothuaj të gjitha këto shtete, sidomos vendet ortodokse fqinje, bëmirësinë shqiptare e shfrytëzuan dinakërisht për interesa të veta e në dëm të shqiptarëve si komb. E shfrytëzuan atë kontribut të sinqertë **me pabesi**, për asimilimin e tyre brenda gjirit të vetë fetar, qoftë me masa **egërsie**, me shpërngulje me dhunë e deri me asgjësimin e tyre fizik me vrasje, mbytje. Turqia i përdorte trojet e pasurinë e tyre për qëllime kusuritjeje, ndërsa fqinjët me qëllim rrëmbimi e përvetësimi. Kështu pothuaj të gjithë i dolën të pabesë, të paburni, ngase secila sipas mënyrës së vet e nëpërkëmbën, përdhosën dhe e poshtëruan dinjitetin kombëtar shqiptar, duke shfrytëzuar edhe papjekurinë e naivitetin politik të pjesëtarëve të asaj popullate, si p.sh.:

Së pari, Turqia, e cila për dështimet e veta, sidomos në shekë XIX, kusuritej mbi kurrizin e shqiptarëve dhe të trojeve të tyre, të cilët nuk i ndihmoi në kohën e duhur, ngase shpresonte që shpëtimin ose zgjatjen e jetës së vet do ta jetësonte ndërlidhur me shqiptarët e islamizuar, duke llogaritur edhe në besnikinë dhe lidhshmërinë që kishin ata me vëllezërit e tyre ortodoksë ose katolikë të një gjaku, gjuhe e edukimi shoqëror, andaj hezitonte që shqiptarëve t’u jepte së paku autonomi qeverisjeje brenda katër vilajeteve, të cilat gjeografikisht që më parë atavikisht ishin të ravijëzuara natyrshëm mbi bazë gjuhe, madje jo edhe pa ndikimin edhe të ndonjërit nga pashallarët e vet që kishin pasur sadopak pushtet dhe guxonin të ndjenin në brendi ndonjë shibël shqiptarie. Po përmendim këtë rast se nën sundimin e Perandorisë Osmane, deri në shek. XVII-XVIII e pak më vonë në trojet shqiptare historia njihet forcimin e dy pashallëqeve të mëdha, siç ishin: **Pashallëku i Ali Pashë Tepelenës** (1740-1822), i shtrirë më tepër në Shqipërinë e Jugut dhe **Pashallëku i Bushatlijve** të Shkodrës në Shqipërinë Veriore e të Mesme (1754-1831), përfshirë edhe vise të Kosovës së sotme, të cilat si shtete nën hijen e Perandorisë Osmane, ishin forcuar aq shumë sa shprehnin edhe tendenca mëvetësie, andaj që të dyja këto pashallëqe, pasi krerët e tyre nuk kishin ndjenja të qarta iluministe shqiptarie dhe pasi nuk patën përkrahje të forta nga jashtë, u shuan me zjarr e hekur nga sulltanët e Turqisë. Pati edhe levizje të dalluara kundër reformave turke, siç ishte edhe ajo e Dërvish Carës (1843), por këto përpjekje edhe pse e dobësuan regjimin e Turqisë, të gjitha u shuan pa arritur ndonjë sukses të veçantë rreth autonomisë qeverisëse shqiptare,

ku duhej nënkuptuar administratën dhe shkollën shqipe që u mungonin vetë drejtuesve të pashallëqeve.

Siç dihet, ndërkohë në kapërcyell të shek. XVIII dhe në fillim të shekullit XIX, si te popujt e Europës edhe te shqiptarët edhe te serbët depërtuan rryma më cilësore me të cilat kërkohej më shumë liri e autonomi nga Porta e Lartë. Është koha kur u vetëdijësuan edhe kërkesat e rilindësve shqiptarë, të cilët kërkonin autonomi politike për trojet e veta shqipfolëve, kuptimësi kjo për administratë e shkollë shqipe që u mungonte krerëve të pashallëqeve që u cekën më sipër. Sidoqoftë pashallëqet u shuan, po vilajetet me shumicë shqiptare mbeten, andaj rilindësit shtruan kërkesë cilësore për autonomi politike shtetërore e kulturore për katër vilajetet shqiptare të Turqisë, ku edhe ishin popull shumicë (Vilajetin e Janinës, Vilajetin e Manastirit, Vilajetin e Kosovës me kryeqytet Shkupin dhe Vilajetin e Shkodrës, duke mos harruar edhe një pjesë të mire të Vilajetit të Selanikut), dhe po të ishte mirëpritur një ndërmarrje e tillë nga Turqia (cekur nga Mit-hat Pasha 1876), atëherë Shqipria do të ishte shtet i fortë, do ta shpëtonte vetveten, por edhe vetë Turqinë e sëmurë, ngase popullsia shumicë shqiptare e konfesionit islam e ndërliður organikisht në harmoni e mirëkuptim me vëllezërit ortodoksë e sidomos me ata katolikë me besë shqiptare të pandarë tradicionale, do të ishte aleati me besniku të fortë ndaj Turqisë, por njëherazi edhe aq më tepër do të lidhej dora-dorës paqesisht, pa luftë edhe me Evropën e krishterë, por elita e politikanëve egoistë turq me sulltanët miopë në krye, siç ishte edhe sulltan Hamiti II, nuk donin që shqiptarët të jenë të bashkuar e sovranë me elemente të forta shtetësie, sepse e dinin që ky shtet kombëtar shqiptar multifetar në kushte të reja do të ishte mbase më i fortë se vetë Turqia multietnike e paharmonizuar dhe e konsoliduar jomirë, andaj edhe i pamundësuan të ketë me kohë autonomi ose pavarësi të plotë, siç e meritonte populli shqiptar.

Së dyti, u tha disa here që Turqija me tërë aparaturën e vet me metoda më përfide edhe me spastrim truri, përpiquej që shqiptarët muslimanë t'i konvertonte në turq osmanli, Greqia e Serbia, në anën tjetër direkt e indirekt i ndihmonin turqit në këtë drejtim dhe njëherazi me tërë forcën propaganduese përpiqeshin që jo vetëm shqiptarët ortodoksë që i mbanin nën sqtull, duke i trullosur me liturgji fetare, të mos zgjoheshin kombëtarisht, por u përpoqën të përvetësonin edhe shqiptarë të tjerë (katolikë e muslimnë). Kështu grekë e serbë çdo aktivitet të ortodoksëve dhe të shqiptarëve patriotë e shuanin pa zgjedhur mjete, deri edhe me metoda banditeske barbare edhe për këtë patën edhe ndihmën e turqve,

besa edhe të ndonjë shteti europian. Në këtë kontekst të gjithë shqiptarët rezistonin, por më me sukses fillimisht u dalluan shqiptarët katolikë, të cilët i rezistuan presionit serbo-malazez dhe vërtet, ndoshta pse nuk kishin në fqinjësi tokësore asnjë shtet katolik dhelpnak, por kishin shtete mike katolike, jo dhe aq larg. Kishin Austohungarinë e Italinë me Vatikanin, që pa përjashtuar rivalitetin edhe qëllimet e tyre politike, u jepnin ndihmë e përkujdesje të konsiderushme katolikëve, por vërtet kjo ishte ndihmë me vlerë të jashtëzakonshme pa u përçmuar gjuha dhe si rrjedhojë, siç u cek më sipër, katolikët shqiptarë, sadopak arritën të arsimonin disa nga të rinjtë e vet, madje të gëzonin shkolla, kolegje në vend të vet, ku pati dritë dukshëm dhe fjala e shkruar shqipe edhe literatura shqipe, madje me guxim e diplomaci, arritën që edhe të shtrinin propagandë të bardhë me libra e fjalë tek vëllezërit e një gjaku e gjuhe kombëtare tek muslimanët e ordodoksët shqiptarë në vetë Shkodrën me rrethinë e në të gjitha trevat shqiptare, ku mund të rrezatonin, madje edhe në diaspora sipas motos “**FE e ATDHE**”, devizë kjo që do përpunohet ndërkohë nga rilindësit muslimnë në **Din e Vatan**, siç do të elaborohet më poshtë në nënkreun vijues, si pikë më vete.

Së treti, janë të njohura ngjarjet rreth luftës ruse turke Lufta e Krimesë, ku Rusia del fituese, pastaj Traktati i Shën Stefanit, dorëzimi me kushte shumë përçmuese nga Turqia, reagimet si reaksion që kushtëzuan thirjen e mbajtjes së Kongresit të Berlinit dhe si rrjedhojë në Stamboll u lejua formimi i Komitetit Shqiptar të Stambollit si dhe mbajtja e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, ku shqiptarët, edhe pse pak të vonuar dhe ende nën survejim, nuk patën derëzgjdhje tjetër vetëm të mbështeteshin në radhë të parë sa ishte e mundur në forcat e veta, duke u identifikuar si komb më vete jo me fe po **me gjuhën e vet shqipe** (shkipski, siç e quan Milojeviçi), e cila ende nuk kishte alfabet unik të vetin as shkolla legale në atë gjuhë, me fjalë të tjera ajo ishte gjuhë popullore me shtrirje të gjerë, por e papërpunuar.

Por sidoqoftë u bë përparim ndërgjegjësimiti në koncept: **mbështetja në gjuhën shqipe si promotor**, pa ndërprerë respektimin e tri feve tradicionale të shqiptarëve: **muslimane, ortodokse, katolike**, por duke i zhveshur në një farë mënyre këto fe nga fanatizmi ekstrem i tyre. Për mendimin tonë, kjo që u tha ishte tejet pozitive dhe jo e huaj për shqiptarët në këtë periudhë, ngase u zbulua e vërteta, e cila doli edhe sheshazi që populli shqiptar kishte kuadro të larta intelektuale nga të trija komunitetet fetare të orientuara drejt, nga të gjitha disiplinat shkencore e

shoqërore, të cilat, edhe pse jo pa shumë vështirësi, edhe pse me gjysmëmarrësveshje me Turqinë e lodhur (edhe nga kryengritjet shqiptare), arritën të bënin punë shumë të madhe me organizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), ku u demonstrua, përveç forcave diplomatike etj, sadokudo edhe *forca shqiptare intelektuale në formulimin e Platformës kombëtare mbi bazë të gjuhës shqipe dhe duke respektuar të tri fetë kombëtare: muslimane, ortodokse dhe katolike, duke toleruar sektet e variantet përkatëse*. E përmendëm së pari, **muslimane** sepse barra kryesore e organizimit politik dhe ushtarak mbi frymë kombëtare popullore, sipas Platformës, atë rast u vu mbi ta dhe vërtet ndërkohë do t'u takojë pikërisht atyre (muslimanëve shqiptarë) ta luanin rolin e vet atdhetar, sepse kishin shtrirje masive të pandërprerë terreni në tërë territorin shqipfolës të Rumelisë (të të katër vilajeteve shqiptare), duke filluar nga jugu deri në veri dhe nga lindja në perëndimi, zgjonte e ndërlihte e mirkuptonte edhe bashkëpunimin me sivëllezërit e dy feve të tjera që mos të shihen si konfrontim brenda masës shqipfolëse, apo jo. Kështu muslimanët shqiptarë të kohës, duke mbushur ndërmjetëzat ndërlihdën jugun ortodoks shqiptar, besa edhe engjëllor-protestant me veriun katolik yll-shqiptarie dhe të gjithë së bashku mundën me e shprehë dhe me mbajtë gjallë idenë ose në fakt të formëzonin **Platformën gjithëshqiptare si komb në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit** me Degët e saj, sepse në atë Kuvend, edhe pse gjithçka e për gjithçka nuk mund të flitej aq haptas Lidhja formoi qeverinë e vet thjesht kombëtare (prinin emrat muslimanë), e cila nuk mbeti vetëm në letër, por edhe veproi si shqiptare në kushte edhe pse të pamundshme nga rrethanat.

Është interesant se në Kosovë, siç mësojmë edhe nga vepra e Milojeviçit, 10 vjet para Lidhjes Shqiptare, edhe pse dihej mirëfilli propaganda e kishës dhe e shtetit serb, me shkolla, me literaturë, me banda-çetnike të organizuara dhe me çdo mjet tjetër dhe me para, ngulfatnin aktivitetin patriotik të shqiptarëve ortodoksë, nuk duhet mohuar faktin se **30 bujarë ortodoksë** shqiptarë, përfaqësues të asaj popullate, që historiografia serbe i quan serbë, sepse ndoshta edhe ishin në fazën e presionit të serbizimit, vunë *myhyrët* e tyre në shenjë miratimi të kërkesave zyrtare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për zbythjen e agresionit serbë nga tokat e okupuara, nga Sanxhaku i Nishit e gjithandej, prej nga sapo ishte dëbuar ajo pjesë aq e madhe e muhaxherisë shqiptare. Po në anën tjetër, katolikët, si përfaqësues jo vetëm të asaj popullate, po në emër të shqiptarisë në Shkodër, natyrisht në bashkëpunim me muslimanët vendës,

e në përputhje me platformën politike atdhetare si Degë e Lidhjes, hartuan një momerandum edhe më përmbajtsor se ai i Prizrenit dhe ua dorëzuan shteteve të mëdha, ku qartësohej edhe më mirë e më me guxim, kërkesa rreth pavarësimin të Shqipërisë nga Porta e Lartë (Osmane) dhe për këtë kërkonin mirënjohje e ndihmë nga jashtë. Në të vërtetë, demonstrimi i shqiptarëve në Kongresin e pas tij, edhe pse nuk u muar parasysh në Kongresin e Berlinit, për shqiptarët ishte një vepër shumë madhështore, sepse ravijëzoi nënkuptueshëm Platformën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që sipas Statutit të hartuar më 1 korrik 1878, sipas Jusuf Buxhovit, duke u spatruar teksteve nga ndonjë formulim me karaktere fetar e besnikërisë ndaj Portës, ishin përgatitur rrethanat që Lidhja shkallë shkallë me u ngrit si shtet autonom shqiptar brenda Perandorisë Osmane. Mjerisht as nga Porta e Lartë as në Kongresin e Berlinit nuk u dëgjua zëri i Lidhjes Shqiptare. Në Kongresin e Berlinit u miratua zgjerimi i Mali i Zi, më në fund edhe në bregdetin shqiptar Tivar e Ulqin, si dhe nga shteti Serb u miratuan okupimet e viseve me popullatë shqiptare (Nishi, Prokuplja, Vranja etj. etj. Madje, vlen të theksohet edhe kjo e vërtetë se nga ai Kongres kërkohej nga Serbia që popullsia shqiptare lojale mos të dëbohej, madje edhe të lejohej edhe kthimi i të shpërngulurve në trojet e veta, por siç dihet Serbia nuk e bëri të mundur kthimin e muhaxherëve, madje vazhdoi edhe më me egërsi spastrimin nga elementi shqiptar.

Së katërti, ndërlidhur me pikën e mësipërme, Serbia si gjithnjë edhe në këto rrethana u shërbye me gënjeshtër, *paburrni, pabesi e egërsi*, kundër shqiptarëve, duke u arsyetuar para botës se kinse po dëbonte turqit, ose nëpunësit e ata arnautë, të cilët i kishin kolonizuar këto troje jo fort moti, po para 100 vitesh, por disa edhe më herët, të cilët gjoja bashkë me ushtrinë turke atëbotë kishin ndjekur serbët, si hakmarrje, sepse serbët kishin ndihmuar forcat austrohungareze në luftë kundër turqve, me ç'rast kjo masë arnautë qenka vendosur këndeje si *kolonë*, andaj Serbia kishte të drejtë t'i dëbonte, siç ishte marrë vesh me tuqit që edhe këta të tërhiqeshin bashkë me ushtrinë e administratën turke, të cilët, gjoja si disa serbë turkoshakë, duke u islamizuar kishin humbur të drejtën e pronave të tyre të uzurpuara më përpara nga serbët vendës. Sigurisht, ky bllof makiavelist mund të ketë mashtruar vetëm naivët dhe të frustruarit vendës e të huaj. Mjerisht, edhe sot manipulohet po ashtu me arsyetime të tilla bajate, duke *faktuar (!)* këtë bindje kështu deri duke e futur edhe në libra shkollorë. Një arsyetim i tillë, del aq i palogjikshëm, sa që një gënjeshtër e të tillë të lakuriqavtë i del bishti më i madh se trupi, ngase vetë fakti flet se ata

kolonistë shqipfolës (!) kurrë nuk kishin qenë *uzurpatorë*, ngase pothuaj që të gjithë ishin autoktonë në trojet e veta, për ndryshe si kanë mundur të tillët:

E para, si ardhacakë, pa kurrfarë pasurie dhe pa kurrfarë përvojë pune në dhe të huaj, pa njohur terren, brenda afro 100 vitesh, të zinin 70% të terrenit, d.m.th. brenda periudhës 1739 – 1860, të stabilizoheshin familjarisht aq shumë në gjithë ato hapësira fshatrash e lagje qytetesh dhe të krijonin jetë komode normale me shtëpi e katandi, me pasuri të patundshme dhe objekte përcjellëse plotësuese për fryte bujqësore e strehime rezervë bagëtish etj., madje të rregullonin jetën fisnore si etnitet shqiptar, të kenë miq e miqësi, të bëjnë fejesa e martesë, të krijonin familje të mëdha, të kishin në shtëpi oda burrash, të kishin ahura, pleme, hambara, të krijonin edhe stil veshje me yrrneqe të veçanta po gjithsesi të ngjashme me viset e tjera shqiptare etj., të cilat (ato pasuri shpirtërore e sidomos materiale) gjatë dëbimit u detyruan me i lënë të paprekura, gjurmët e të cilave, thuhet se mund të shihen deri në ditët tona. Historiani ynë i shquar prof. Dr. Hakif Bajrami jep këtë statistikë, pa cekur dëbime të mëparshme. Ai konstaton se Serbia “*Vetëm gjatë dimrit 1877-1878 nga Sanxhaku i Nishit* (pa llogaritur të vrarët e robët e të asimiluarit) *largoj me dhunë 350.000 shqiptarë dhe përvetësoi pasuritë e patundshme e të tundshmer të tyre, si: 98.000 shtëpi, 98.000 maxhe, 58.000 hambarë drithrash, 82.000 stalla bagëtish, etj.* (Shih “*albaniapress*”, 13.01. 2019). Madje Serbia kur *spastroi 714 fshatra* as që pati popullsi me i mbushë të gjitha ato hapësira të boshatisura me njerëz të vet, andaj kërkonte *kolonistë* të vërtetë, nga Mali i Zi, Hercegovina, bile edhe nga Kosova, dhe pastaj të ankohej para botës se këta nga Kosova dëboheshin nga presioni i shqiptarëve, kur dihet fakti se asnjë familje muhaxhere (muslimane) nuk ka dëbuar nga shtëpitë e veta ndonjë familje të ashtuquajtur serbe (ortodokse.), apo jo?!

E dyta, fundi i fundit, kur ishte një shtet (turk) pa kufi të ndarë, përkatësisht i takonin një vilajeti, kishin mundësi të pakufizuar tregtimi e shtegtimi etj., si ishte e mundur që ata muhaxherë për disa dhjetëvjetësha, t’i kishin këputur të gjitha lidhjet kujtesore me të parët e tyre, të mos dinin fare prej nga ishin shpërngulur para 100 vitesh dhe të mos ktheheshin me lypë derman e strehë në trojet e mëparshme, në hise të veta, te vellezërit e kushërijtë e vet, apo jo?! Përkatësisht, si ishte e mundur, së paku të moshuarit 70-80 vjeçarë mos të dinin emrin e fshatit a të qytetit e të mos ktheheshin aty?! Për këtë që thamë, e vë dorën në zjarr se vërtet nuk më

ka ra rasa me ndëgjue as me lexue se ndonjë shtëpi muhaxhere e asokohshme të kishte uzurpuar shtëpitë e huaja (ortodokse) ose të ishte kthyer në vatrën e të parëve të vet, Madje asnjë familje e tillë, sipas traditës, nuk e kishte të ruajtur mbiemrin e familjes së vendlindjes së mëparshme gjyshore a prindore para se të bënte atë *kolonizim* (!!!), por të gjithë si muhaxherë, kur u dëbuan së andejmi morën me vete si patronime kryesisht emrat e fshatrave e të qyteteve prej nga u dëbuan, ku kishin jetuar babë e babëgjysh, dembabadem, që dëshmonin edhe varret e tyre të lëna atje, apo jo?! *Ata, të mjerë, tërësisht shqiptarë* (Reshat Avdiu), u detyruan me i lënë ato vendbanime dhe me marrë botën në sy prej zori dhe të vendoseshin kudo, vetëm sa me mbetë gjallë, me shpëtue shpirt dhe ç'është e vërteta, e jo pak prej tyre vdiqen, qoftë nga sëmundja, qoftë nga mospasja e mjeteve më elementare për shërim e jetesë. Pra a s' mjafton kjo sa thamë, të kuptohet e vërteta e gjenocidit dhe të përgenjeshtrohen arsyetimet *shkencore* (!) të plasura nga goja e penda e disa gjoja *shkencëtarëve* serbë që iminimizojn, këto barbarizma.

Së pesti, jo vetëm rrenat e mësipërme të paskrupullta që kuptohen si të tilla nga çdo mendje e shëndoshë, po ashtu edhe më transparente del edhe një gënjeshtër tjetër e kulluet që tani ende dikush po e zë në gojë. Është fjala për një gafë makiaveliste serbe, e cila po ashtu, *gjoja shkencore ka të bëjë* rreth shpërnguljes së mëparshme aq masive të serbëve nga *Serbija e Vërtetë!* (Kosova) nën presionin masiv të *arnautëve* të ardhur nga përtej *Alpeve Shqiptare*, ndërsa harrohet se edhe ata sipas studiuesve serbë, ashtu siç ngulmonte edhe Milojeviçi në veprën e tij, paraqiteshin se ishin “*çisti srbi*”, atëherë ku ka logjikë dëbimi i serbëve nga vetë *serbët e kulluet* (“*çisti srbi*”), apo jo?! Ajo gënjeshtër mbi gënjeshtër paradoksale, që nuk kishte të bënte fare me të vërtetën dëshmohet edhe nga statistika që jep vetë Milojeviçi më 1866/68. Sipas kësaj statistike, siç e pamë në kreun I të këtij punimi, kemi të bëjmë me lëvizje normale të qytetarëve brenda një shteti, madje, nuk kemi të bëjmë fare me aq shumë ardhacakë arnautë në Kosovë, por momentalisht kemi të bëjmë me shumicë vendase **poturë**, sipas tij *serbë të islamizuar!*, të cilët në të vërtetë ishin ose kishin qenë shqiptarë anas kryesisht ortodoksë banues të kësaj treve, madje jo aq të populluara sa ishin tokat e pushtuara të muhaxherëve 10 vjet më vonë nga serbët, siç ishin Nishi, Anamorava, Kurshumlia etj. Së këtëjmi logjikisht shtrohet pyetja, kur aq shumë serbë paskan qenë arratisur nga Prava Stara Srbija, përsëri i refererohemi statistikës së Milojeviçit, si mbeten në Kosovë mbi 80% shumicë serbe (*srpskih potura*), masë kjo, e cila qenka

islamizuar para 60 vitesh, po nga serbët ortodoksë të shqiptarizuar apo jo?! Dhe që paradoksi tjetër të jetë më i spikatur, kjo shumicë serbe qenka shqiptarizuar, nga një pakicë shumë e vogël të sapoardhur arnautësh nga Malësia, apo jo?! Pra, rrenat e tillë u plasuan, vetëm sa për ta arsyetuar gjenocidin para botës dhe opinionit naiv e injorantë vendës e të huaj, gjenocid ky, i cili po përgatitej nga “serbët e papoturëzuar” kundër “serbëve të poturëzuar” (!), apo jo?!

Së gjashti, fatkeqësisht Kongresi i Berlinit (1878), siç u tha, nuk miratoi kërkesën e shqiptarëve, dhe pikërisht nga ky Kongresi Serbisë iu dhurua pavarësi tokën iliro-shqiptare, duke u anashkaluar krimi rreth asgjatimit të 620 fshatrave e disa paralagjeve shqiptare vetëm në Sanxhakun e Nishit (H. Bajrami, R. Avdiu) dhe po aq e më tepër nga rrethinat e qytetet e tjera, madje, siç e pamë nga Regjistri i Milojeviçit nga Kadillëku i Kurshnumlisë, u uzurpua jo vetëm tërë qyteti pa asnjë serb, por u asgjësuan nja 130 fshatra shqiptare, prandaj pyesim çdo mendje të shëndoshë e ndëgjegje njerëzore të pafjetur, si mund të quhet kjo luftë si *çlirim i suksesshëm i tokave serbe*, ku në të vërtetë aty nuk banonte asnjë serb?! U cek më sipër se Kongresi kishte rekomanduar që popullsia që pranon lojalitetin mos të dëbohet, por ky rekomandim, me përjashtim të një komandati në rrethinë të Vranjës, *gjen. Jovan Belimarkoviq*, ushtarak njeri, *shumadinac*, i cili, nëse vërtet ka vepruar ashtu, meriton përmendore nga shqiptarët, nuk u respektua nga pothuaj të gjithë komandantët e tjerë të Ushtrisë serbe, të cilët, kundër popullsisë së pambrojtur shqiptare bënë masakra aq të rënda saqë nuk mund të shprehen dot me gojë, as me shkrim. U përmend më sipër pushkatimi i të gjithë nxënësve të shkollës (medresës) në Kurshumli, po përmendim edhe rastin e një familjeje të madhe kolektive shqiptare të dëgjuar, kur burra, gra e fëmijë i lidhin rreth stogut (mullarit) të sanës, të cilit ia shtinë flakën dhe i djegin për së gjalli!! Pastaj po përmendim rastin tjetër kur krenat e burrave dhe të rinjve shqiptar të therrur ose të prerë në besë, të ngulitur në hejt e rezhnikave i kanë endur nëpër fshatra shqiptare për t’u futur tmerrin atyre, të cilët për shkak të shtrirjen së gjerë terreni nuk ishin shpërngulur, po që tani panikisht edhe do të shpërnguleshin *vullnetarisht*, apo jo?!

Së shtati, edhe pse Lidhja e Prizrenit ushtarakisht u shua, megjithatë zëri i shqiptarëve dhe koncepti i Shqiprisë nuk mbeti pa jehonë. Fundja edhe pse territori saj me bekimin e atij Kongresi të Berlinit u tkurr shumë dhe pjesa tjetër vazhdoi të mbetet nën Turqi, shqiptarët vazhduan rezistencën e tyre kundër pushtetit osman. Në të vërtetë, në këtë kohë një

masë dominuese e shqipfolësve muslimanë të trevave shqiptare e më gjerë që ishin nën presion të ashpër të shtetit dhe fesë zyrtare turko-arabe u vetëdijësuan edhe më masivisht se ata nuk ishin *osmanli –turq*, por ishin *shqiptarë*, gjithashtu ndodhi edhe që një shumicë shqipfolësish ortodoksë të Jugut e të Mesmes që kishin presion nga kisha greke e shteti turk, të cilët ishin vetëdijësuar se nuk ishin *grekë* dhe kështu disa që patën guxim të distancoheshin nga greqizimi do të pësonin me jetë, siç ishte rasti i konstatuar nga gjeneral De Veer, holandez, i cili vëtëm nga një varr masiv kishte nxjerrë 230 trupa të vrarë e të gjymtuar shqiptarë civilë ortodoksë, vetëm pse flitnin shqip dhe nuk kishin pranuar me fjalë automatikisht asimilimin, duke u deklaruar si grekë. Përndryshe vetë Venezellos, shtetar i Greqisë së atëhershme pohon për 15000 viktima shqiptarë, po që në të vërtetë në anale të tjera pohohet për 50.000 viktima. Ndërkaq, sa u përket ortodoksëve shqipfolës të Veriut nga shteti e kisha pravosllave serbe që ishte edhe më e pamëshirshme dhe më finoke se armiqtë e tjerë, as që dihen viktimet e shqipfolësve ortodoksë, ngase askush prej tyre as që ka mundur me hapë gojë e me u identifikua si shqiptar, por dihen viktimat gjuhësore nën hijen fetare, qoftë muslimanë ose katolikë, që gjithashtu kapin shumë rreth 50.000 (sipas Malkolmit), përkatësisht edhe deri 500.000 shpirtë, sipas austriakut Leo Freundlich (Shih: *Bota sot*, 19.03.2018 f. 11). Lidhur me këtë mjafton të rikujtojmë masat për shkombëtarizimin me sukses të ortodoksëve shqipfolës në shtetin e ri serb dhe përndjekjen e të ashtuqaturve *arnautë e poturë (shqipfolës) si turq(!)*, jo më pak se 813.000 vetëve, vetëm nga ato vise prej nga u shpërngul muhaxheria, siç u cekën paksa edhe fakte. Për dëshmi të tilla shih punimet e studiuesve përkatës të kësaj teme (së paku edhe në internet): Sabit Uka, Hakif Bajrami, R. Avdiu, R. Doçi, Jusuf Osmani, J. Buxhovi e të tjerë, pa hyrë në kujtimet e pinjojve të mbetur gjallë nga familjet e asaj mase të madhe të muhaxherëve. Fundi i fundit, si mundet sot një serb normal me u krenue ose mos me i gjykue shpirtërisht për atë egësi serbo-ruse, të stërgjyshve të vet, pjesëmarrës në këto krime kaq monstruoze, të cilat ngjashëm edhe më skandaloze janë përsëritur më vonë gjatë pushtimit të Kosovës më 1912, 1918, gjatë ripushtimit më 1944/45, madje edhe këto të Luftës së fundit (1998-1999), apo jo?!

Së teti, së këtejmi, pra duke mos pasur mirëkuptim nga askush, tokat shqiptare të katër vilajeteve të sipërcekura pa pasur mbrojtje shtetërore turke, pikërisht atëherë kur shteti turk nuk mund të ndalte pa miratuar atë autonomi ose pavarësi të kërkuar me aq arsye e të drejte nga atdhetarët

shqiptarë, fatkeqësisht edhe trevat e tjera arbnore, u pushtuan me rrëmbim egërsie nga ushtritë e shteteve fqinje, të cilat në të vërtetë, ishin parapërgatitur nën rrogoz vite më parë dhe njëherazi ishin të ndihmuara nga jashtë.

Këto forca ushtarake zaptuese për të imponuar disiplinë ushtarake prej pushtuesi ndaj popullatës së pambrojtur shqiptare të të katër vilajeteve bënë masakra tejet monstruoze si më parë e aq më zi, ndërsa pas shumë përpëlitjeve mëzi shpëtuan disa vise e prej emrave të kryeqyteteve të vilajeteve edhe pse fort e dëmtuar shpëtoi mëzi vetëm Shkodra, por sidoqoftë, Shqipëria u shpall e pavarur më 1912 dhe ndërkohë u njoh si shtet më vete më 1913, edhe pse e cunguar, sepse mbeti pa Kosovë, Maqedoni, Sanxhak, Luginë e Preshevës, pa Çameri e një pjesë të Malësisë së Shkodrës, pa Ulqin e Tivar e disa vise të tjera shqifolëse.

NËNKREU IV

PËRKUNDËR PENGESAVE TURKO-SERBO-GREKE E GJITHANDEJ NË PRAG E GJATË I RILINDJES SHQIPTARE GJUHA SHQIPE SI PROMOTOR KARAKTERISTIK I SHQIPTARISË ÇAU PËRPARA

Edhe pse ushtarakisht autonomia politike e dy pashallëqeve shqiptare të sipërcekura (Pashallëku i Ali Pashë Tepelenës dhe Pashallëku i Bushatlinjve të Shkodrës) u shua, sa i përket bashkëjetesës ndërzonale shqiptare jug-veri dhe asaj ndërjetare *muslimane-ortodokse-katolike* e popullit, del gjithnjë e më e gërshetuar, më e përformëzuar, madje sa i përket përdorimit të gjuhës shqipe, koineve gege e toske, edhe pse jo si gjuhë zyrtare shkrimi po si mjet vazhdues ndërkomunikimi u bë përparim i madh ndërlidhës në atë kapërcyell kohe para, në prag e posarilindëse shqiptare. Pikërisht këtë dukuri të gjuhës shqipe si promotor karakteristik të shqiptarisë e të shqiptarësisë gjatë syrit të pranëverës së shkrimit të shqipes ose lindjes e rritës kombëtare gjatë shekullin XIX dhe nëfillimvitet e shek XX, pa hyrë në analiza të brendshme gjuhësore, do ta trajtojmë në vijim në disa pika:

Së pari, ia vlen të theksohet fakti që shqipja për fat si në periudhën antike e historike dhe gjatë periudhës së Rilindjes, përkundër rruhdjes kishte shtrirje mjaft të gjerë anembanë Ballkanit e më gjerë, që assesi nuk kufizohej as me qendrat fetare-politike serbe apo greke, as me qendrat zyrtare të ndarjeve administrative përkatëse të brendshme turke,

pashallëqe, sanxhaqe, nahi, kaza, bajraqe etj., madje jo vetëm në të gjitha këto, por kishte edhe punkte të caktuara përdorimi e kultivimi të njohura edhe më gjerë si në Azi, Afrikë, deri edhe në Amerikë, por sidomos në Itali (arbëreshët) si dhe në disa qendra në Europën Perëndimore. Sidoqoftë, pra, sipas studiuesve lidhur me këtë, del e argumentueshme që gjuha shqipe si gjuhë komunikimi e masës ishte e pranishme dhe në ato vise ku tashmë kishin arritur të ravijëzoheshin elemente të veçanta shtetësie vetjake joshqiptare, siç ishin: Greqia, Serbia, Bullgaria, Mali i Zi e sidomos Rumania, pa përmendur vise e punkte të njohura në Italinë e sotme dhe në viset bregdetare të Kroacisë, besa deri edhe në Istri të Sllovenisë... Me fjalë të tjera, aty ku shqiptarët jetonin kishte njëfarë harmonie ndëretnike pa dallim feje, *islame, ortodokse ose katolike* e aq më tepër në familjet e tyre shqiptarë të të tri konfesioneve gjindeshin mirë. Kështu ndodhi edhe në qytete e sidomos në kryeqytetin e Turqisë, në Stamboll, saqë këtë gjerësi e sidomos në kryeqytet si dhe kudo në trojet shqiptare e sidomos në Shqipëri e vërejnë edhe nacionalistët turq, ashtu si edhe nacionalistët grekë e serbë me orientim shqiptarofobie, saqë, sikush sipas mënyrës së vet, edhe e konsiderojnë si rrezik për ta. Në këtë situatë Sulltan Hamiti II, i cili ashtu si edhe Sulltan Mehmeti i kohës së Skënderbeut, edhe ky e shpalli shqipen, **si gjuhë të ndaluar**, në të shkruar, e deri edhe në të folur (Lutfi Alia, I. Kadare), si duket të vetmen ndër gjuhë të tjera të kombësive brenda perandorisë. Dihet se i pari (Sulltan Mehmeti, hakmerrej, ndaj gjuhës armike të Skënderbeut, dhe fesë së tij më fort me orientim unit e katolik, gjë që si rrjedhojë, jeniqerët shqiptarë nuk ishin të lejuar të vizitoheshin nga prindët e të komunikonin shqip, ndërkaq e kundërta ndodhte me jeniqerët sllavë. Ata mund të komunikonin sllavisht. Mbase për këtë ka ndikuar fakti se nëna e këtij sulltani ka qenë serbe. Ndërkaq, sulltani tjetër, këë e bëri nën sugjerimin ortodoks grek, sepse shihte rrezik nga ringjallja masive i shqipfolësve nën trysninë e rrymës romantiko-iluministe të sapodukshme europiane, e cila filloi të prekte jo vetëm të krishterët shqiptarë, por edhe muslimanët e shkolluar shqipfolës, andaj Sulltani e ndalon shqipen me ferman, sipas kërkesës së patrikanës, por politikisht gjoja shprehej si dashamirës i shkrimit të saj(!).

Së dyti, sidoqoftë, vërtet ajo ndalesë ndikoi, por acari i përkohshëm s'mund ta ndalte dot pranverën e shkrimit të shqipes, sepse kjo dukuri iluministe që mbi këtë bazë në Europën Perëndimore u tregua suksesshëm, ngase ndikoi edhe në formimin e shtet-kombeve, andaj idetë e tilla (romantiko-iluministe) kishin depërtuar, edhe brenda Perandorisë

Osmane, e cila ndërkohë në këtë periudhë, sidomos pas luftave të Krimesë kundër Ruisë dhe kryengritjeve të pandërprera të shqiptarëve, dukej sheshit se kishte simptome të mëdha të ploghshtësë së pashërueshme patologjike shtetërore edhe nga brenda dhe pa ndihmën e shqiptarëve të dëgjueshëm s'mundt'ia dilte dot mbanë. Ndërkaq shtetet e Europës pritnin që nga ajo bina, Perandoria Osmane, të përfitonin, gjithsesi shokkonin inresat e veta nga nga komb-shtete të reja që do të lindnin, qoftë nga ana e Azisë dhe e Afrikës, por edhe këndej sidomos në Ballkan, ku Rusia ortodokse potencialisht kishte shtrirë ndikim të dyfishtë edhe fetar ortodoks edhe ide pansllaviste. Është e vërtetë që ky ligshim force e Perandorisë Osmane, ishte vërejtur gjithandej e këndej edhe nga rilindësit shqiptarë, të cilët kërkonin mënyra se si të organizoheshin sa më mirë që të mund t'i shpëtonin të pandara tokat e Arnautllëkut (Shqipnisë) prej katër vilajeteve. Mirëpo atbotë kërkesa të ngjashme shpëtimi kishin edhe popujt e tjerë ballkanas, por për zgjimin e organizimin e tyre interesoheshin dhe përkujdeseshin përveç Ruisë edhe disa shtete të njohura të Europës, andaj të gjithë këta popuj përveç shqiptarëve, lidhur me formimin e shteteve të tyre kombëtare, kishin më shumë mundësi të ishin më të sukseshëm, ashtu edhe do të ndodhë.

Së treti, thamë më sipër që rilindësit tanë kishin vështirësi tejet të mëdha rreth përformimit dhe organizimit të çështjes kombëtare, ngase përlindja shqiptare kishte specifikat e veta të veçanta (sui generis), që ndryshonin shumë nga lëvizjet e popujve ose të kombeve të tjerë, disa prej këtyre specifikave rënduese po i përmendim në vijim:

1. Si vështirësi e parë rënduese ishte fakti se shqiptarët, duke qenë trashëgimtarë të të lashtëve: pellazgo-iliro-dardanë dhe kishin një gjurmë-shtrirjeje të gjerë vertikale e horizontale në kohë-hapësirë si jashtë, si brenda Siujdhesës Ballkanike, madje ishin përmendur apo njiheshin me disa emra, përkatësisht dilnin të përzier aq shumë me popuj të tjerë, diku pakicë e diku shumicë, diku ende ishin me ndërëgjigjegje kombëtare në zgjim e diku-diku jo ose vende-vende edhe ishin tjetërsuar fare, saqë rilindësit nuk e kishin lehtë të gjenin një vijë platforme të përbashkët uniteti, e cila do të ishte e përkapshme dhe përqafueshme atbotë, së paku nga elita kombëtare e së andejmi ta përkrahte edhe shumica e shtresave shoqërore të shqiptarëve po edhe nga ndonjëra nga fuqitë e mëdha botërore a europiane që do t'i kuptonte e t'u dilte krah aspiratave të tyre.

2. Si vështirësi e dytë madhore (sui generis) për shqiptarët në atë kohë ishte feja, ngase për dallim nga kombet e Ballkanit dhe më gjerë që

mbështeteshin zakonisht në një fe, shqiptarët fetarisht ishin të ndarë në tri besime kryesore të njohura: *islame, ortodokse dhe katolike*, madje edhe në më shumë sekte e tariqe si reaksion ndaj një feje ose ritit përkatës, andaj si mbështetje më të mirë gjetën jo ndonjë fe po **gjuhën shqipe**, e cila vërtet si edhe më parë edhe tashti i bashkonte pa dallim feje. Ndërkaq, edhe sa i përket zgjedhjes së gjuhës shqipe si promotor kishte vështirësi. Ajo ishte e palëruar, nuk kishte një alfabet kombëtar të njëzuar, nuk ishte as gjuhë shkolle, as administrate, as liturgjike, por ishte gjuhë me traditë përdorimi marrëveshjeje e masës vendëse, që me kodin e vet i lidhte të gjithë shqipfolësit, sidomos nëndarje të së drejtës, pleqnitë e mbarimet për zgjidhjen e ngatërresave ose ishte si gjuhë komunikuese në gazmende familjare e ndërfishnore me besë e ligje vendëse kanunore, sidomos në malësitë shqiptare dhe jo pa lidhje e përkrahje nga intelektualët përkatës edhe të disa familjeve qytetare, prandaj zgjedhja e gjuhës shqipe si promotor i shqiptarisë ishte zgjidhje më me mend dhe më e drejtë që premtonte.

3. Vështirësi tjetër paraqiste e vërteta, se shumica i shqiptarëve i përkisnin fesë islame që ishte identike me atë zyrtare të Turqisë, nga e cila duhej të ndaheshin, andaj nga kjo pikëpamje vetkuptohet se edhe ky fakt paraqiste vështirësi të paparashikueshme për dikë, por në këtë drejtim rilindësit gjetën njëfarë derëdalje në respektimin e disa sekteve muslimane tashmë që ishin të përquafuara nga një pjesë e tyre, siç ishte tarikati **begtashi** e të tjerë. Është e vërtetë se kjo mënyrë rrugëdaljeje bëri që të thyhej sadopak fanatizmi ekstrem ndaj sektit **sunit hanefi** në kuadër të vetë fesë islame, i cili gjithsesi mbajti primatin e shumicës. Si rrjedhojë mund të themi se edhe pse kjo dukuri e sekteve nuk ishte e mjaftueshme, një ndikim i tillë solli mbarësi në suazat e masës në të mire të atdhetarisë, andaj themi se në këtë drejtim pati sukses.

4. Në anën tjetër, edhe feja ortodokse ishte e ndarë në dy-tre nënrite sektesh që frekuentoheshin edhe nga shqiptarët ortodoksë, siç ishin nënritet sipas gjuhës përkatëse: greke, rumune, sllave (serbe, bullgare), me të cilat manipulonin, sidomos shtetet jomike për shqiptarët, si Greqia, Bullgaria dhe Serbia me Malin e Zi. Në këto shtete, shqiptarët pjesëtarë të asaj feje zyrtarisht quheshin në emër të fe-kombit përkatës të tyre, andaj edhe nga kjo pikëpamje ky fakt paraqiste shumë vështirësi që shqiptarët ortodoksë të shpëtonin nga kthetrat e asimilimit politik ose të shfrytëzimit nga popujt me të cilët bashkëjetonin fizikisht e fetarisht, por edhe këtu u përftua fatmirësisht një rit i ri edhe pse jo aq masiv, por edhe ky jo pa

sukses, siç ishte riti kristian **protestant** (engjëllor), në qytetet Manastir, Korçë, Elbasan etj.

5. Fati e desh që një pjesë e shqiptarëve t'i takonin trashëgimisht besimit katolik, të cilët që nga shekulli XV, XVI identifikohen kulturisht dhe ndërkohë ishin nën patronatin e Austrohungarisë, patronat ky që përforcohej në vazhdimësi edhe kur u vu në oponencë edhe Italia (vetë Vatikani i rinteresuar), ku për ogur të mirë në këto vise ndjenja fetare–kombëtare shqiptare për pavarësi ishte më e zgjuar, madje edhe më e rrënjosur trashëgimisht nga pikëpamja fetare e gjuhësore në krahasim me treva të tjera, gjë që e dëshmon edhe M. Milojeviçi. Mirëpo edhe kjo fe kishte vështirësi përfaqësimi, ngase katolikët shqiptarë, ishin pakicë dhe ishin të përqëndruar gjeografikisht, kryesisht në një pjesë të Shqipërisë Veriore (Shkodër, Lezhë, Malësi e Mirditë (me një shtrirje relative nga Kosova), kryesisht në vende malore, ku ekonomikisht shumica nuk qëndronin aq mirë dhe ishin të përzier edhe me fise të tjera jokatolike, mirëpo shqiptarisht e gjuhësisht ishin të orientuar mbarë të prirë nga disa nga prelatë të asaj feje, të ndihmuar e mbrojtur disi edhe sipas disa nga ligjet popullore (kanunore) të trashëguara që nga parahistoria që duke i ndërlidhur me fe e gjuhë shqipe, jo vetëm nuk u zhdukën aktivitetet e tilla, por edhe u fuqizuan të ndihmuara sadopak edhe nga rendi gjallues shoqëror kanunor ndërfishnor edhe nga kriptomuslimanët, ngase sipas traditës pjesëtarët e një fisi ishin kushëri, pa marrëparasysh fenë (katolike, muslimane a ortodokse apo ndonjë sekti a tarikati.

6. Sidoqë të ketë qenë, përveç pengesave nga Turqia e nga shtetet fqinje, sidomos bashkësitë fetare të tyre, në anën tjetër, ku u përzie edhe ndikimi rusët, madje edhe ai francez, të cilët ëndërrimin e shqiptarëve për mëvetësi apo autonomi shtetërore mbi bazë gjuhe e quanin **ide të vdekur**. Qëndrimi i tillë i shteteve të huaja, ishte vërtet fatkeqësi për popullin shqiptar të tri feve, që vështirësonin motivimin rreth zgjimit filltar kombëtar të masës shqiptare, sepse askush nga shtetet e mëdha nuk deshi të bashkëpunonte ideologjikisht e ushtarakisht për çlirimin e shqiptarëve. Madje pati shtete si Anglia e Gjermania që në raste të caktuara për t'i ndalë turrin Rusisë i jepnin krahun Turqisë, duke e lënë nën hije ose duke e viktimizuar edhe më çështjen shqiptare, kryengritjet e tyre. Mirëpo, përkundër vështirësive tejet të mëdha, shqiptarët nuk u gjunjëzuan po vazhduan aktivitete të parreshtura propagandistike, deri edhe me kryengritje të pandërprera, drejt realizimit të atij synimi të shenjtë rreth mëvetësisë kombëtare në trojet e veta autoktone, pa harruar ndihmat e

pjesërisht me fort arsimo-kulturore nga Austro-Hungaria e Italia me Vatikanin.

7. Pikërisht kjo dukuri rreth respektimit e kultivimit të gjuhës shqipe si promotor pothuaj i vetëm i fuqishëm në zgjimin kombëtar dhe mëvetësinë në trojet e veta u kuptua dhe u shfrytëzua drejt edhe nga disa shtresa feudo-borgjeze muslimane shqiptare, të cilat kishin interes dhe me shumë mend mbështetën **gjuhën shqipe**, si thesarin më të shtrenjtë ndërlidhës shpirtëror kombëtar, dhe si rezultat i kësaj u përqaftua slogan i prelatëve të fesë katolike: “**Fe e Atdhe**” slogan ky, të cilin të e modifikuan pa vështirësi në variantin “(**Din e Vatan**), (pa Vatan s’ka iman) madje metatezë **atdhe e fe**” edhe ta pëplotësonin parësorisht **ZotNjë** (për shqipfolësit e tri feve) dhe si rrjedhojë: **ZotNjë -gjuhë shqipe-atdhe e fe** --“**shqiptari**”, nënkuptohej **besimi në një Zot (ZOTYNË - ZOTNJË) dhe gjuha shqipe** që dilte si mjet veprimi a si promotorr i qëllimit të lartë idealist përbashkues që menjëherë duhej përplotësuar me **atdhe/mëmëdhe** pa përjashtuar të tri fetë: **islame/ortodokse/katolike** si fe kombëtare. Këtë moto nuk mund ta kuptonin të huajtë, por as të gjithë tanët (mjerisht, si disa sot!), andaj kërkohet paksa kohë për bindje e ndërgjegjësime, kërkohet kohë pikërisht atëherë kur koha nuk priste, apo jo?! Sidoqoftë, edhe në këtë rrugë të vetme veprimtarie, si rrugë e vetme drite kombëtare pati vështirësi edhe nga vetvetja shqiptare. Të huajtë joshqiptarofobë, nisur nga vetja e tyre, mbase kishin ndonjë arsye, sepse nuk njihnin historinë e kulturën e lashtë shqiptare, jetën fisnore multifetare të këtij populli etj., andaj e quanin utopi një zgjidhje të tillë, prandaj edhe nuk e mbështetnin ose e shikonin me dyshim, ndërkaq qëndrimi i disa tanëve, pa ndërgjegje të mjaftueshme atdhetarie, si atëherë, si tashti, nuk mund të arsyetohet dot, ngase shqiptarit normal, një mosrespektim i tillë rreth tolerancës konfesionale që prek në vijë kombëtare, nuk mund t’ia falë e arsyetojë dot as naiviteti, as fanatizmi, as injoranca e tij, apo jo?!

8. Po vijojmë edhe pak rreth problemit të sapocekur për **gjuhën shqipe si promotorr i shqiptarisë**. Ndoshta e pabesueshme për lexuesin e sotëm, vendës e të huaj, por ishte e vërtetë që në shek. XIX e më parë të gjitha etnitë në Rumelinë Turke kishin të drejtë të hapnin shkolla në gjuhët e tyre, vetëm shqiptarët jo, madje shqiptarëve u krijohet vështirësi, jo vetëm nga turqit, por edhe nga të tjerët, ndër të tjerl kuptohet, edhe nga vetvetja, nga fanatizmi e disa klerikëve të të tri feve dhe sundimtarëve kombëtarisht të paarrirë. Këtu nuk kam parasysh vetëm disa sundimtarë të llojit të alipashëve e maliqpashëve të cilët luftuan pa mëshirë shqipfolësit

e fesë tjetër (kristiane - kaurre) dhe kështu përsheptuan asimilimin e tyre në kombin tjetër (grek e serb), si dhe disa hoxhallarë e nëpunës në pozita, por edhe disa priftër ortodoksë të nënritit grek dhe atij paravosllav (serbo-bullgar), të cilët viktimizonin shqipen e shqiptarinë përhir të fesë. Në këtë kontzekst edhe ndonjë klerik katolik nuk ishte p damkë. Kështu, pothuaj, të gjithë pengonin pa kursyer, çdo veprim ilegal e legal atdhetar shqiptar në fushë të mësimit e shkrimit të shqipes, mirëpo shqiptarët e vërtetë të esëlluar nuk reshtën, edhe përkundër viktimave që patën, sidomos nga fanari ortodoks grek, më në fund aktivistët rilindës të tri besimeve kombëtare shqipe, arritën mjaft, që së paku të tregonin para botës se ideali i tillë i bashkimit kombëtar **mbi bazë gjuhe**, duke respektuar fetë përkatëse, nuk ishte utopi, por ishte **promotor platforme, ishte zgjidhje** me mundësi realizimi dhe që pa mëdyshje shqiptarët të spastruar nga fanatizmi fundamental të tri feve, si komb do të kenë ardhmeni, siç edhe u tregua ndërkohë si realitet, kur iu dha mundësia me e realizue, veprim ky që edhe sot po shërben si shembull harmonie ndërfetare për botën e qytetëruar, duke pasur shembëllyrë pikërisht shqiptarinë.

9, Kur kemi parasysh këto vështirësi, atëherë mund ta kuptojmë fillimisht rolin madhor të *Komitetit Shqiptar të Stambollit*, i cili sadopak theu miopinë turke rreth ndalimit të gjuhës shqipe nga Sulltani, i cili fillimisht nuk kishte penguar ndërmarrjet në të mirë të shqipes, ngase edhe vetë sadopak thonë se fliste shqip, lejoi themelimin e Komiteti Shqiptar të Stambollit, hapi rrugë në organizimin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, të formimit të shoqatës së shkronjave shqipe prej nga rezultoi alfabeti i parë kombëtar zyrtar i gjuhës shqipe, botimi i librave shqipe etj. por tregoi miopi rreth autonomisë së katër vilajeteve të Arnautistanit

Siidoqoftë, **gjuha si promotor i zgjimit kombëtar e gjeti vetveten**, nisi të mbaren te Shqiptarët e Stambollit, që atë aktivitet e shtrin në Rumani e gjetiu, kudo që jepej sadopak mundësi. Kështu aktiviteti kulturor e politik erdhi duke u shumëzuar, sidomos në fillim të shekullit XX.

Në këtë vazhdë, siç lexuam nga *La Naz. Albaneze* të vitit 1909 (marrë nga Interneti), duke shfrytëzuar ndërrimet në pushtetin osman, në shenjë parapërgatitjeje për autonomi ose pavarësi të Shqipërisë, u apelua botërisht sipas kësaj proklamate që të gjithë shqipfolësit të kërkojnë nga Qeveria Osmane që katër vilajetet me shumicë shqiptare të fuzionohen në një:

Vëllezër shqiptarë,

“Që në doni të mirën e vendit tuaj, në doni që mos t’u humbasë kombësija jonë ... gjithë anët që flasin shqip të kërkonin nga Qeveria që të bashkoheni në një Vilajet, i cili do të quhet Vilajeti i Shqipërisë (Arnautllëk Vilajeti) me kryeqytet Ohrin ja Elbasanin, i cili do t’i bashkojë në kufijtë e tij:

- 1) *Vilajetin e Janinës me këto qytete me rrethina: Janinë, Prevezë, Gjirokastrë, Berat.*
- 2) *Vilajetin e Shkodrës me qytetet me rrethina: Durrës e Shkodër me Malësi.*
- 3) *Vilajetin e Manastirit me qytetet me rrethina: Manastir, Dibër, Elbasan e Korçë.*
- 4) *Vilajetin e Kosovës me qytetet me rrethina: Shkup. Prizren, Pejë, Prishtinë e Sanxhak.*

Parashihej që vetëm valiu të caktohet nën autoritetin formal të Stambollit, kurse tërë aparati tjetër drejtues administrativ të jetë vendës. Siç po shihet, këtu si kriter i shtetësisë merret **gjuha shqipe**. shtrirja e saj geografike. Kryeqytet i Vilajetit të Shqipërisë parashihej të ishte **Ohri** ose **Elbasani**.

Në të vërtetë ideja për bashkim-fuzionimin e katër vilajeteve, përkatësisht bashkimin e trojeve shqiptare në një vilajet ishte dhënë më 1876 (nga Mit-hat Pasha me prejardhje shqiptare), madje botërisht në frymën e Lidhjes së Prizrenit i ishte drejtuar qeverisë së Stambollit nga një tubim i protestues në Janinë më 24.07. 1878, por ishte injoruar nga Sulltani (Shih edhe te “ZSH”, 12.06.2019). Në të vërtetë, si u cek prej nesh si udhëzim-kërkesa kjo u përsërit më 1909. Ishte edhe kërkesë e Hasan Prishtinës në Shkup më 1912. Vërtet ishte kërkesë me vend, por si duket ky “*zbulim veprimi*” i Komitetit Shqiptar të Stambollit, ende pa u rishqyrtuar nga Qeveria Osmane shtoi reaksionin kundër shqiptarëve, si nga osmanët, ashtu edhe aq më tepër nga shtetet fqinje kolonialiste, apo jo?!

10. Së këndejmi, përkundër vështirësive objektive, ky ogur i bardhë rreth gjuhës shqipe si promotor kishte edhe rritje pozitive në fushën e shkrimit dhe kështu, çdo arritje e mëparshme tash përforcohej, sepse ndërkohë të gjithë shqipfolësit e tri feve me emërtimin **shqiptar** e **shqiptari**, i cili u ripërfundua në marrëdhënie ndërshtetërore, fushorë e malësorë që vetëqeveriseshin me **njerëzishmëri: pleqni, besë e burrni**, jo veç me norma ndërfaqshme kanunore, por edhe me ndikim të kodeve

bashkëkohore përparimtare të kohës, të cilat respektoheshin në masë të gjerë nga e gjithë popullata, pa dallim feje e krahine dhe kështu u konceptua e dëshirueshmja e merituar: **Shqiptari –shqipe atdhe fe – njerëzishmëri**, si **platformë**, e forcave përparimtare shqiptare e cila nuk duhet të mungojë as sot, as nesër, as kurrënekurrës, apo jo?!

11. Nuk është pavend konstatimi i studiuesit Ahmet Asani shprehur në artikullin me titull *Besimi tradicional shqiptar dhe sistemet përjashtuese*, i botuar në portalin *revista drini*, më 03.06.2019, përmbajtjen e të cilit po e parafrazomë. Aty autori tolerancën fetare besimtarisht të formësuar, e sheh në “*sistemet e tri feve abrahamore të pranuar pa epitelin përjashtues të tyre*. Kështu aludohet në “shqiptarët e moderuar”, të cilët zgjidhjen e kanë gjetur si duhet: në besimin në një Zot, në gërshetim me dashurinë njerëzore e vëllazërore, gjithsesi me respekt ndaj gjuhës e kombit shqiptar dhe pikërisht mbi këtë bazë i kanë krijuar nënsistemet e tyre tradicionale brenda vetë sistemit të moderuar: besimi në Zot gërshetuar me vlerat më pozitive tradicionale kombëtare të të tri besimeve: *katolike, ortodokse e muslimane*, formulë e veçantë kjo sisteme që injoron e tejkalon interesat e ngushtë të sistemeve ekstreme klerikale, andaj toleranca ndërfitare ndër shqiptarë mund të merret si shembull unikat mes besimeve të ndryshme në botë, apo jo?.

12. Gjithsesi, pa marrë parasysh traditën, puna dhe veprimtaria e rilindësve dhe pasrilindësve tanë të asaj kohe e deri sot, duhet të vlerësohet lart, ashtu si edhe e disa prelatëve të fesë katolike, besa edhe protestante shqiptare pa mohuar edhe punën e vështirë deri në sakrifikim të jopak klerikëve ortodoksë shqiptarë, por edhe të veprimtarëve politikë shqiptarë të fesë islame, pa harruar shkollarët e hoxhët tanë të ndritur në vazhdimësi, të cilët shërbyen si ndërlidhës të Jugut, të Mesmes e të Veriut, të Perëndimit e të Lindjes dhe kështu me forca të përbashkuara u arrit që më 28 Nëntor 1912, në Vlorë të shpallet *Shqipnia e Lirë dhe e Mosvarme*, e cila pa forca ushtarake, po me forca të mëdha morale e tolerancë fetare, sadokudo si e drejtë e patjetërsueshme e një kombi arriti të fitojë njohje ndërkombëtare edhe pse mbeti rreth e qark saj me vise të veta të grabitura nga shtetet fqinje. Kështu fatkeqësisht një shumicë e popullit shqiptar mbeti në robëri, të cilët do të përpiqeshin të mbaheshin gjallë kryesisht vetëm me shpresa e me gjuhë shqipe që herdokur do t’u mundësohej çlirimi drejt përbashkimit kombëtar e gjuhësor.

Sidoqoftë, nuk duhet mohuar përpjekja e parreshtur shqiptare, të rilindësve, pasrilindësve dhe atdhetarëve të djeshëm e të sotëm, të cilët,

me rezistencë të lloj-llojshme të brendshme dhe me luftë të armatosur dhe diplomaci, pa humbur asnjë herë shpresën e gjuhën, korrën fitore, duke pasur përherë të gjallë moton: *shqiptari–shqipe-atdhe*, përkatësisht pa harruar vargjet moto të skalitura në ndërgjegje: “**Fe që ZOTYNË e bekon, SHQIPTARIA feja jonë!**”, ku nënkuptohet se fjala **shqiptari** si fe nënkupton brenda saj të *tri fetë kombëtare të shenjta fisnike: muslimane, ortodokse katolike* ose nënkupton botëkuptimin fetar shpirtëror, ideologjik e gjuhësor të çdo besimtari të devotshëm shqiptar, i cili mund ta zëvendësojë fjalën **shqiptari** me **emërtimin e fesë së vet**, por me një kusht që gjithsesi shqiptarinë ta ketë ndërgjegjesisht për zemër, apo jo?!

Së këtejmi na merr mendja se shqiptarët do të korrin edhe fitore të tjera të suksesshme që do të arrihen me forcat e përbashkuara **të fe-shqiptarisë**, me punë, me shkollë, me shkencë e me politikë paqësore, me demokraci dhe me ndihmën e miqve tanë të jashtëm dhe të vetë fqinjve, ngase sendërtimi i *të drejtës dhe të vërtetës shqiptare*, si një ogur i bardhë është edhe në të mirë të tyre.

Pëmbyllje

Në hyrje të këtij kreu shënuan hamendjen e stërgjyshit tim, pleqnar i dëgjuar i fundviteve të shek XIX dhe fillimviteve të shek XX, amator në politikë, si edhe unë, i cili për serbët si entitet shprehej se karakterizoheshin prej këtyre katër komponenteve, një pozitive dhe tri negative, së pari nga **njerëzishmëria vendëse** (*e trashëguar nga ortodoksia shqiptare*) dhe tri negative: nga **paburnia vetjake serbe**, dy të tjera të ndikuara, nga **pabesia turke** dhe tjetra nga **egërsia ruse**, që ne, pasi te çdo komb-shtet, më pak ose më shumë) mund të hasimtribute të tilla, nuk i dhamë aq të drejtë, por kërkuam nga lexuesi që në 4 nënkrerët e punimit tonë si dhe nga tërë analiza kritike kushtuar veprës së M, Milojeviçit (e formëzuar më 1866-1868) të vërejnë sa është e mundur të

dalë në shesh **e vërteta** nga këto katër atributet e cekura, andaj edhe të dallohen cila ishte më e tejdashme te palët përkatëse në marrëdhëniet e deritashme serbo-shqiptare dhe cila do të jetë në marrëdhëniet tashpërtashme dhe në të ardhshmen fqinjësore, cilin etnitet në marrëdhëniet e tyre më tepër e hijeshon **njerëzshmëria** dhe cilin e damkon **paburnia, pabesia dhe egërsia**.

Nuk di si mund të vlerësojnë lexuesit, por ne mendimin tonë në këtë fund kreu, do ta përmbylim në disa pika, duke e cekur ndonjë të veçantë që doli nga analiza jonë, sipas nënkrrerëve përkatës:

E para, nga etnogjeneza e të dy etniteteve shqiptare e serbe sipas burimeve serbe përmendet njëfarë pikëtakimi tek **ilirët**, që shqiptarët e quajtkan veten të sigurt si pasardhës të tyre, po edhe serbët e gjejnë veten në simbiozë me fise ilire (thrakase dake), edhe pse e quajnë veten parësisht fis sllav. Në të vërtetë në një vend tjetër thuhet se shqiptarët ishin ata që ruajtën *gjuhën e disa tipare ilire*, me të cilët janë shkriur ose janë *shqiptarizuar edhe fise serbe*, pohim ky mbase i shprehur me sherr, sepse mbi bazë të kësaj hipoteze garashaninët arsyetonin pushtimin e trojeve të shqiptarëve dhe asimilimin e tyre, duke u arsyetuar se nga *poturët* ose pinjojtë e tyre kanë të drejtë të kërkojnë rikthimin në fenë e të parëve, në ortodoksë serbë (!) ose për ndryshe do të dëbohen si turq, apo jo?! Por ka edhe hipoteza të tjera që dikush nga serbët pasi assesi nuk duan ta pranojnë lidhshmerinë prejardhësore me shqiptarët e sotëm, për shkak të njëfarë kompleksi armiqësor që nënkupton veç **paburni** e **pabesi**. që vërehet edhe nga Milojeviçi, përbuzje kjo që shpie deri në **urrejtje** ndaj shqiptarëve e gjuhës shqipe sa që, si reaksion kundër tyre, ka rezultuar deri edhe në **egërsi e luftë gjencidale**. Sidoqoftë, sipas studiuesve neutralë një qëndrim i tillë ndaj shqiptarëve është ekzagjeruar gjatë ose me lindjen e shtetit serb, sidomos gjatë shek XIX e këndej, andaj sot për sot sipas nesh duhet të esëllohen të dyja palët e sidomos serbët, të cilët duke respektuar të vërtetën historike rreth asaj që i ndan dhe i bashkon këta dy popuj sipas etnogjenezës dhe duke u shërbyer me **njerëzishmëri**, duke u çliruar nga gënjeshttrat, **paburnia**, **pabesia**, dhe **urrejtja** që shpie në **egërsi** duhet ta arrijnë *katarsisin* e plotë brenda vetes, madje patjetër edhe duke kërkuar falje, e nevojshme kjo për të gëzuar miqësinë e mirëkuptimin e sinqertë me shqiptarët si fqinjë të merituar që nga antika.

E dyta, për t'u çliruar nga iluzionet, falsifikimet, gënjeshttrat e së kaluarës duhet pranuar të vërtetën rreth mungesës së shumësisë serbe në Kosovë etj. dhe për këtë le t'u shërbejë edhe vepra e Milosh Milojeviçit (1866/68) edhe pse e hartuar në frymën e Naçertanies (1844) me tendencë antishqiptare, sepse nga analiza e të dhënave të plasuara me pahir aty del se përqindja e etnitetit shqiptar në Kosovën e atëhershme del shumë më e madhe ndaj asaj serbe. Mos me zgjatë, Milojeviçi në Kosovë (ashtu siç veproi edhe Vemiqi) të gjithë **poturët** i evidenton **serbë**, përkatësisht **serbë të shqiptarizuar**, vetëm pse i kishin takuar mbase më parë fesë

ortodokse, ne duke u mbështetur në të vërtetën historike dhe në gjuhën e tyre shqipe, **paturët** në Kosovë i evidentuam si joserbë dhe kështu arritëm në rezultatin real që përmbys përqindjen serbe në dobi të joserbëve (shqiptarëve), duke e ilustruar dhe me prova të tjera bindëse rreth ortodoksisë shqiptare tani të islamizuar si dhe **shkieve tanë** vendas ortodoksë shqipfolës faktikisht shqiptarë, andaj kërkojmë që studiuesit e në veçanti kisha serbe ta pranojnë të vërtetën që në trojet tona e më gjerë ortodoksë pravosllavë nuk ishin vetëm serbishtfolësit, por ishin madje me shumë shqipfolësit. Së këtejmi edhe sot ka shqipfolës ortodoksë me shqipe të trashëguar nga ajo etni, edhe pse tanipërtani zyrtarisht quhen serbë.

E dyta, gjithashtu për të qenë me i kapshëm çlirimi i palës serbe nga iluzionet e së kaluarës (zablude) që garashaninët *me gënjeshttra, paburrni, pabesi* e deri edhe me *egërsi* mbollën urrejtje dhe injorim ndaj shqiptarëve historisë e gjuhës shqipe të tyre dhe shkieve tanë, temë kjo që në këtë nënkrye trajtohen në 17 pika e tetë nënpika, ku paraqitëm argumenta të parrëzueshëm që dëshmojnë ekzistimin në kontinuitet të popullit shqiptar në këto troje që nga antika, në periudhën mesjetare para e pas kristianizmit, para e gjatë sundimit sllavobullgarët e tribalo-serbët, madje i mëshuam së vërtetës se vitaliteti shtetformues i shqiptarëve del veçan përveç me formimin e tri shteteve vetjake mesjetare shqiptare, por edhe në aleancë me Nemanët, sidomos me zhupan Dushanin, ku arbanasit njihen si pjesë konstitutive thelbësore e asaj perandorie dhe se me këtë forcë të përbashkët ata arritën të shtriheshin nga Jugu deri në Kreta etj., dhe se ky rol ose kjo forcë shihet edhe më qartë pas zhbërjes së atij shteti, kur feudalët shqiptarë dalin shumë më të fuqizuar dhe më në numër në krahasim me ata që edhe sot ende konsiderohen serbë. Kjo vërtetohet edhe me miqësinë me Knez Lllazarin dhe me pjesëmarrjen e tyre në Betejën e Kosovës 1389. Madje arbanasit, përkatësisht arnautët përmenden edhe si kundështar, por ndërkohë edhe si administratorë në pozita të larta brenda Perandorisë Osmane, gjendje kjo që vazhdoi deri në shek XIX, kur serbët e përformëzuan shtetin e tyre edhe me ndihmën e shqiptarëve, por këtë rast serbët vepruan kundër shqiptarëve me *paburrni, pabesi* dhe *egërsi*, ngase tradhëtisht mohuan ndihmesën e bashkëpunimin me ta, dhe aq më keq bënë dëbimin e tyre nga trojet veta autoktone, duke i konsideruar si *turq*, vetëm e vetëm për t'i pushtuar trojet e tyre dhe kështu prodhuan armiqësinë e paqenë ndëretnike në marrëdhëniet e deritashme shqiptaro-serbe.

E treta, shqiptarët duke qenë të shtrirë në një hapësirë mjaft të gjerë në bashkëjetesë me popuj të tjerë, siç dëshmohet në tetë pika e dy nënpika të këtij nënkreu, ata ndihmuan mirëqenien e të gjithë popujve me të cilët bashkëjetonin, Madje ata u dalluan edhe në administratën turke, ku arritën në poste më të larta, qoftë në aparatën qendror, si vezirë e nëpunës të lartë, qoftë në ushtri në udhëheqje provincash si pashallarë, pa përmendur nëpunësi të administratës së përgjithshme, megjithatë ata nuk patën kurrfarë mirëkuptimi nga turqit rreth përdorimit të gjuhës shqipe, madje as brenda vilajeteve shqiptare. Gjithashtu nuk patën mirëkuptim, përkundrazi u tradhëtuan keqas dhe nga shtetet e reja ortodokse fqinje malazeze, bullgare e sidomos greke e serbe, të cilat në vend të respektonin bëmirësinë ndihmën deri në sakrificim të shqiptarëve, ata aq më keq shfrytëzuan besimin fetar qoftë për asimilimin, ose për dëbimin me qëllim pushtimi të trojeve autoktone të tyre. Kështu edhe pse shekulli XIX, ishte periudha e identifikimit të komb-shteteve të tyre, ata nuk ndihmuan, përkundrazi penguan e luftuan shqiptarët që mos të arrijnë në pavarësinë e shtetit të tyre.

E katërta, dihet se shekulli XIX ishte shekulli i krijimeve të shteteve kombëtare në Europë dhe sidomos në Ballkan, zakonisht mbi baza fetare, siç përfituan edhe shtetet fqinje, ndërsa Shqiptarët, edhe pse ishin në tokat e tyre të vetmit që nuk mund të shfrytëzonin kriterin e një feje për formim kombëtar. Këtë dukuri e kishin të njohur edhe rilindësit shqiptar, sepse kombëtarisht u takonin tri feve muslimane, katolike, ortodokse, andaj rilindësit tanë si mjet përlindjeje e bashkimi kombëtar gjetën si mbështje „jo fetë po **gjuhën shqipe si promotore bashkimi**, por pa përjashtuar respektimin e secilës fe.

Përkundër vështirësive, megjithatë rilindësit tanë në fund arritën të shpallnin pavarësinë e shtetit shqiptar më 1912, edhe pse Shqipëria ishte pothuaj tërësisht e okupuar nga forcat ushtarake të fqinjve ortodoksë të pabesë. Sidoqoftë edhe kjo shpallje ishte sukses, ngase u arrit sipas një rruge mençurake duke përformëzuar rolin *e ri të gjuhës shqipe*. Kjo problematikë rreth formëzimit të **shqipe si promotor përlindjeje, zgjimi e bashkimi kombëtar** që u trajtua nënkreun e tretë të këtij kreu në tri pika e njëmbëdhjetë nënpika, ku u pa dhe u nënkuptua gjuha shqipe promotore: *si një aureollë hyjnëzimi e stolisur me njerëzishmëri, burri, besë e ideal të shenjtë kombëtar*, rrugë kjo, ku vërtet paraqiteshin shumë pengesa nga jashtë e nga brenda, por ishte rrugë e vetme dhe e vërtet, e cila edhe u solli suksese të pakrahësueshme, pa lënduar askënd nga fqinjët,

përkundrazi, veprimi i shqipçtarëvr, ishte ishte në të mirë të të gjithëve, sepse:

së pari ishte sukses të ruajturit e substancës kombëtare mbi bazë gjuhe, pa injoruar tri fetë: *muslimane, ortodkse katolike*, sipas devizës: **Fe që Zotynë e bekon/Shqiptaria feja jonë**, ku me fjalën **shqiptari** nënkuptohet respektimi i tri feve jetësore, ku secili besimtar ose bashkësi fetare, sipas dëshirës a nevojës shpirtërore, nga tekst-formula mund të këmbëjë lirisht fjalën **shqiptari**, me emrin e fesë së vet, por ndërgjegjesisht pa hequr nga adhurimi i shqiptarësisë si koncept-mesazh që vlen për jetë e mot, që qëndron si altar drejt mirësisë së Perëndisë;

së dyti arritën të imponohen si popull para Europës **demokratike e fuqive të mëdha si problem i pazgjidhur kombëtar dhe që patjetër kërkonte ndihmë ndërkombëtare për këtë kauzë;**

së treti, arritën që ndërkohë Shqipëria me fjalëmiret punëmbaretr Austri e Itali edhe pse e përgjysmuar të njëhej ndërkombëtarisht dhe sadokudo të shërbente si simbol shprese bashkimi për trevat e ndara pa të drejtë që rreth saj mbetet në robëri dhe

së katërti, u arrit që të mbahet problemi kombëtar hapur para botës, e cila, edhe pse pak vonë, duke njohur punë sidomos SHBA-ja me shtete të tjera demokratike ndihmoi ekzistencën e saj dhe njëherazi në fund të shekullit të kaluar bëri dekolonizimin ose krijimin e shtetit të ri shqiptar Republikën e Kosovës, shtet i ri ky, ende i pa përvojë shtetërore, por i pajisur me veçortë njerëzishmërie, pa probleme gjuhësore, *pa probleme fetare, po me probleme të pazgjidhura kufitare me kërkesë për të arritur zgjidhjen paqësisht, me ndihmën masave demokratike të shteteve europiane e amerikane të trevave mbarëshqiptare sipas devizës: pa vijë të zezë kufindarëse, ndaj Shqipërisë e viseve të tjera në Serbi, Mal të Zi, e Maqedoni.*

Së këtejmi, për hir të së vërtetës, kërkohet nga të gjithë, edhe nga grekët si dhe nga populli e kisha serbe, të flakin tej ose të lirohen tashmë nga paragjykimet e vjetra kolonialiste, rreth përçmimit të kombit shqiptar me metoda **inJORIMI, mohimi, pabesie e egërsie** nga e kaluara e deri në ditët e sotme, madje duke pranuar burrnisht atë për çka kanë u hyrë në hak deri tashti shqiptarëve, të ndalen e të gjykojnë ndërgjegjesisht për t'i ndrequr ato padrejtësi dhe tashemenjëherë të tregojnë **njerëzishmëri...**

Konkretisht, përfaqësuesit shtetëror e kishtar serb, duke i pasur parasysh gjithë ato vuajtje sjellë shqiptarëve me **pabesitë** dhe **egërsitë** pa kurrfarë arsyeje e faji të kërkojnë falje dhe për ta spastruar ndëgjegjen e

vet duhet të rrefehen para Zotit e njerëzisë dhe me rrëfim njerëzishmëriue të luten shkarkohen nga barra e mëkatit bërë kundër një populli të pafajshëm, nga i cili në të kaluarën nuk kanë pasur kurrënkurrës asnjë telash dhe kështu të krijojnë premisat e domosdoshme për të arritur paqetimin e vërtetë të sinqertë fqinjësor e ndërnjerëzor në marrëdhëniet serbo-shqiptare, dhe siç bën çdo fqinj i mirë. të ndihmojnë e mos të pengojnë mëkëmbjen e shtetit të Kosovës e popullit të saj.

Gjithsesi, kjo është rruga e burnisë e ruajtjes së mirëbesimit për një “hallalli” biblike të përbashkët, duke kërkuar ndjesë për të bëmat e deritashme kundër popullit shqiptar që njëherazi ishin dhe kundër popullit të vet, apo jo?! Këtë duhet ta bëjnë edhe grekët e kisha e tyre gjithandej për çamët e Çamerinë, të cilës duhet t’i mundësohet një frymëmarrje e lirë.

Një kërkesë a dëshirë e tillë nuk është naivitet i shprehur prej nesh, por është rruga si ogur bardhë, e cila kërkohet edhe nga shtetet e organizatat humanitare të botës së sotme të civilizuar, sepse është rrugë e civilizimit demoktrik të botës së lirë.

Kreu VII

KONTRIBUTI ME PAHIR I Z. MILOJEVIC PËR “SHKIPËT”, HISTORINË E GJUHËN SHQIPE

Hyrje

Është e vërtetë se Milos S Milojevic, siç e konstaton studiuesi *Srdjan Milosevic* në artikullin “**Kako se kalio shovinizam**” (*Si u kalit shovinizmi*), 18.10.2019, ishte njëri ndër militantët e parë të shek XIX që me rrena, falsifikime dhe sjellje destruktive ndaj popujve të tjerë ka arritur me botue libra në frymën nacionaliste serbomadhe dhe të gëzojë autoritet patrioti, cilësi kjo, të cilën aq më tepër e kurorëzoi me lavdi, duke marrë pjesë aktive në luftën e ashtuquajtur serboturke 1876-78 si komandant i vullnetarëve vendës dhe rus, ku Serbia korri fitore të paimagjinueshme në pushtimin e tokave me popullsi shqiptare, prej nga i shpërnguli si joortodoksët shqiptarë. Mirëpo ylberi i lavdisë në qiellin e krijimtarisë së tij iu shua shpejt fill pas kësaj fitoreje pikërisht për marrinat që kishte bërë më parë në shkrimet e tij në funksion parapropagandë lufte, duke idealizuar popullin serb dhe duke poshtruar popujt e tjerë kundër të cilëve kishte mjellë urrejtje deri në përmasa të shovinizmit ekstrem. Sipas shkrimeve të tij të mëparshme pothuaj të gjithë popujt e tjerë ishin fajtorë pse Serbia nuk ishte shtet i madh dhe pse kishte histori të këputur dhe pa lavdi, andaj sikurse që sipas fantazisë së tij se gjoja serbët dhe Serbia kishte ekzistuar dhe pandehej që kishte pasur jetë të lavdishme që nga parahistoria, antika, gjurmët fillimishte e së cilës i ruante të gjalla në Siujdhesën Ballkanike, sidomos nga Mesjeta nemanjide etj. Sa lehtëbindës ishte për të mjaftonte që të ndeshte një emërtimn Srbica në Maqedoni dhe Maqedoninë ta quante serbe ose ta ndeshte emërtiminn Arnautski Beligrad për Beratin dhe tërë Epirin ta quante serb etj. Ai edhe bullgarishten e quante gjuhë serbobullgare, kroatishten serbokroate, sllovenishtes serbosllvene , madje edhe shqipja e vjetër duhet të ketë qenë serbe apo duhet të jetë apo të klthehet në shkiposerbe etj.

Kështu ndërsa ishte në moshën tridhjetë vjeçare si pansllavist duke idealizuar serbishten e serbizmin shprehte alergji ndaj gjermanëve (shfabonemcëve), duke iu kundërvënë shkollës historike shkencore të tyre, shkollë kjo, e cila gjoja me tendencë në vend që serbëve t’ua njihte primatin e autoktonisë në Ballkan e në botë e jo atë t’ua njihte *shkipëve* e të tjerëve, dhe aq më keq ajo shkencë ardhjen e sllavëve këndeje e quanin

të vonshme, saqë edhe po me atë tendencë përçmuese e kishin bërë edhe latinët e grekët e lashtë, të cilët këtë popull hordhi e kishin emërtuar *skllavë*, jo me kuptim nga fjalat *slava* (*lavdi*) apo *slovo* (shkrim), njerëz të dijshtëm, por i quajktën me kuptim *robi* (*skllavi*): lat. **sclavus**, gr. **sclabos**, shq. **shklav**. Madje edhe serbët i kishin emërtuar lat. *servus* ose gr. *servos* me kuptim *slluga* (sherbëtor, shërbyes) si dhe vend i tyre ndërkohë quhej *Servia* ose *Serbia*, në shqip *Sherbia* (P. Bogdani). Ndërkaq Iliria ku vëshuan hordhitë barbare skllave në shqipe u quajt *Shklavonia* (Iliria, trajtë e shqipes nga F. Bardhi).

Lidhur me sa u tha, Milojeviçi nuk ishte i vetëm, por sidoqoftë nuk dimë mirë pse principata autonome sllavoruse apo autroperëndimore me qendër në Smederevë e pastaj në Beograd, mori epitetin *serbe me konotacion të një nacionaliteti sllav*, por dihet mirë se epiteti i tillë ishte emërtim me sherr të madh, sepse vet emri **Serbi** (**Sherbi**) kishte të bente me një terren më në jug që kishin pasur apo edhe kishin mërtime të tjera si: Albania me Kosovë (Dardani, Maqedoni, Traki, Epir) dhe sipas tij të gjitha të dhënat historike duhe të ishin në hije të histirsl së lashtë të Serbisë.

U tha se vetë emërtimi serb e sidomos Serbi ishte me sherr, sepse vetë emri joshte shtrirje të këtij shteti në viset jugore që më parë kishin pasur këtë emërtim, po edhe që ishin në sundimin e Perandorisë Osmane të dobësuar. Kështu fantazia kapi dhe përvetësoi nga Mesjeta shtetin e ashtuquajtur serb të Nemanajve, shtrirje të cilën duhet ta gëzonte shteti i ri i imagjinuar serb. Edhe pse, siç dihet më parë emërtimi serb e Serbi në të vërtetë nuk ka përfaqësuar kombësi njënacionale serbe.

Sido që të ketë ndodhur ky emërtim *serb* u përvetësua nga Lëvizja romantike iluministe e nacionaliste rilindëse serbe tek intelektualët e kësaj Knezhevine me kuptim nacionalist e përkrahur nga autoqefalia pravosllave (ortodokse) që ishte aktive edhe më parë, u dha shkas sajimeve fantastike, qoftë në këngë popullore, qoftë në krjimtari artistike e në veçanti sajime pseudohistoriko e propagandistike të natyrës agresive në sferën politike në të mirë të shtrirjes së shtetit dhe bërjes së nacionalitetit sllavoserb edhe në ato hapësira që nuk shin të banuara me serbë të kulluar po me shqiptarë ortodoksë e të tjerë, ku pos mungesës së gjuhës së ritit të njëjtë liturgjik kishte ndryshim feje e shprehish në aspekte sociale, gjithsesi mbizotëronin ndryshime edhe në trditën gjuhësore.

Këtu tashti ajo Lëvizje në vend bashkëpunimi me shqiptarët për të shpëtuar bashkë me ta nga zgjedha e sundimit turk, duke pasur synim

interesin e përbashkët çlirimin, pa marrë parasysh gjuhën fenë jounike tek shqiptarët, nacioanromantizmi serb, shfrytëzoi pjesën e ortodoksisë dhe të kaluarën ortodokse shqiptare, zgjodhi zgjidhjen më të keqe përvetësimit me dhunë të këtyre trojeve, duke nënshtruar e përvetësuar ne dhunë katolikë e muslimanë deri në asimilimin ose asgjatimin e tyre. Kështu për shkak të mosbashkëpunimit, si të thuash, serbo-shqiptar lindi urrejtja deri edhe shovinizmi tek kasta serbe ndaj fqinjve shqiptarëve joortodoksë si dhe të gjithë popujve të cilët paraqiteshin si pengesë ndaj hegjemonizmit serbomadh, të cilët gjoja edhe në të kaluarën që nga lashtësia kishin pasur armiqësi me serbët.

Pikërisht ky fenomen ndeshet i shprehur në veprën *Odlomci* të Milojeviçit, por ai u kalit edhe më keqas në veprat e të tjerëve edhe nga kritikuesit e adhuruesit e veprës së tij, sidomos kjo ndodhi në politikën shtetërore që u ndoq në raport me shqiptarët e pakrah, të pa ndihmuar nga ndonjë shtet i fuqishëm nga jashtë, andaj mbeten nënurvejim me e gjysmëshprese se ndoshta Turqia do t'u jepte autonomi duke i shkrirë katër vilajete shqiptare në një.

Sido që të ke qenë, sipas historisë së mirënjohur në atë fazë shqiptarët si pasardhës të pellazgo-ilirëve kishin pasur shtrirje të gjerë në Mesdhe e Ballkan, ndërsa Milojevic mendonte ndryshe se para rrënjë-fjalëve simbol **alb e arb -Albani**, ka akzistuar rrënjë-simboli **SRB**-disavariantesh: **sorb sirb sarb serb surb** etj., së këtejmi ai arsyetonte kombin **serb** dhe shtetin aktual **Serbi** që dikur ekzistonte dhe që tash duhet përtrirë, hipotezë kjo që e linte paksa nën hije tezën rreth lashtësisë pellazgo-ilire të *shqipëve*, Dhe kështu në saje të fantazisë së tij të bujshme krijuese *argumentonte* se populli serb nuk kishte kuptim sherbëtori, por kuptime të lavdishëm, ndër të tjera kishte edhe kuptimin *srodstvo, njerëz të një gjuhe e gjaku* dhe kështu që zanafillë e tij ishte *popull hyjnor* që nga zanafilla, gjuha e tyre këndeje përfaqësonte shtresën më të vjetër të popullatës, e cila si e tillë mbante primatin epran në Siujdhesën Ballkanike ndaj emërtimeve të ravijëzuara ndërkohë, si: Albania, Dardania, Makedonia, Trakia Epiro-Iliria e Grekia, prandaj disa emra që konsideroheshin shkipo-albanezë ose maqedono-helenë deri edhe etrusko-italianë duhen konstatuar si emra lashtë-serbo-sllav dhe se ky hyjnim, sipas fesë serbe iu riktfaktua këtij populli, pas humbjes së Luftës së Kosovës!

Kështu si Milojeviçi, pothuaj mbarë kasta ose elita intelektuale serbe nga Knezhevina u formëzua mbi kritere të nacionaizmit serbomadh

mbështetur edhe në idealizimet e tepruara në shkrimet e Milojeviçit, ku fyhen popujt fqinj, si hungarezët (*magjarët*) e bullgarët (bollgarë vullgarë) por edhe kundër *shkipëve* siç do të shohim, në më poshtë.

Së këndejmi, rreth asaj që u trajtua deri këtu, duke shfrytëzuar dy veprat e tij mjaft voluminoze *Odlomci ..* dhe *Putopis...* të shkruara në moshon 30 vjeçare, ku preket sadopal historia shkipëve dhe gjuha tyre, përkundër qëndrimeve edhe antishkipe, ne duke u nisur nga fakti se sipas metodës shkenore stilistike kur një vepër përçmohet nga dikush nga njëra anë, ajo në të vërtetë konsiderohet e vlerësuar, ngase nga ana tjetër (faqja tjetër) mund të vlerësohet pozitivisht, prandaj ne nga shkrimet përçmuese të Milojeviçit shohim njëfarë kontributi në të mirë për shqipët dhe për gjuhën e tyre, që do të trajtohet tash fillë në këta katër nënkrerët e këtij kreu:

Së pari, përkundër qëndrimeve subjektiviste të Milojeviçit, dromca realiteti ndaj shkipëve në shkrimet e tij nuk mungojnë.

Së dyti, rreth disa të dhënave hamendëse historike e etimologjike për shqipët e gjuhën e tyre në kontekst me serbishten.

Së treti, rreth shënimit e përkthimit të dy vjershëzave ngucakeqe dhe regjistrimit të një kënge folklorike të kënduar shqip nga shqipët e poturëzuar,, kushtuar Kumonës së kishës së Deçanit, dhe

Së katërti, rreth sajimit të një sifjalorthi shqip serbisht, i cili ndeshet në librin III të *Putopisit* . lëndë kjo ende të pastudiuar dhe vlerësuar nga askush nga autoritetet shkencore, as nga ana serbe as nga ajo shqiptare.

NËNKREU I

PËRKUNDËR QËNDRIMEVE SUBJEKTIVISTE NGA MILOJEVIÇI NË ATË KOHËHAPËSIRË NUK MUNGOJNË DROMCA REALITETI NDAJ SHKIPËVE

Përkundër qëndrimeve subjektiviste në veprat e Milojeviçit nuk mungojnë as raste ose dromca realiteti ndaj shkipëve dhe disa nga ato do të përpiqem me i paraqitë në disa pika:

1) Milojeviqi të gjithë ortodoksët i sheh serbë me kuptim të ri njënacional pa marrë parasysh gjuhën a prejradhjen e tyre, serb të vërtetë janë edhe shqipfolësit ortodoksë.

2) Autori serbët i paraqet edhe fizikisht si popull vital, ndërsa ata joserb i paraqet të shëmtuar edhe fizikisht, mirëpo në ballafaqim me realitetin tek fiset shqiptare atë vitalitet e arsyeton se edhe këta paskan qenë serbë.

3) Si rrjedhojë botëkuptimit si më sipër ky poturët shqipfolës i shënon serb dhe kështu me pahir pranon realitetin se shqiptarët si etni ishin dhe kishin qenë shumicë absolute në Kosovë e më gjerë si si pjesë e Serbisë së Vërtetë të Vjetër dhe se gjuha shqipe e para 150 vitesh, siç nënkuptohet, paska pasur aftësi reale momentale për të asimiluar serbishtfolësit.

4) Ndër shqiptarë dallon dhe vlerëson fiset të cilët si shqipfolës përbënin një popullatë unike, të cilët kishin ligjshmeri në marrëdhëniet si brenda ashtu edhe ndërfisnore, rregullsi këto të cilave u bindeshin si muslimanët e katolikët ashtu edhe ortodoksët (serbët) e vendit, të cilët iu nënshtroheshin ligjeve të kanunit shqiptar.

5. Çuditëj pse edhe ortodoksët gjithandëj u shtroheshin atyre ligjeve të fiseve shqiptare, madje pse tek familjet e njohura ortodokse (serbe sipas tij !) ishin në funksion normat shoqërore si te shqiptarët (muslimanë e katolikë): *besa*, *pleqnitë*, *besëpaqja*, *dorëzania*, madje *hakmarrja* e ***besa-besa shqiptare***. Po e veçojmë **besa-besën** si normë që bindet edhe ai se ajo ishte më e fortë se normat fetare, se betimi kishtar biblik (zakletva), si dhe më e fortë nga mbrojtja oficiele e pushtetit shtetëror turk, sepse me **besa-besë** të një shoqëruesi shqiptar, ai dhe tërë suita serbe me të, kishin shpëtuar nga prita që u kishin zënë disa cuba mes një pylli etj.- etj.

6) Milojeviçi, me disa nga të dhënat që i jep disa vjet para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, dëshmon faktin se shqiptarët "*poshkipjan-ët*": *Toska*, *Bardhi*, *Kastrati*, *Shala*, *Gashi*, *Berisha* dhe fiset e tjera flitnin dhe respektonin gjuhën e tyre "*shkipski*" si mbështetëse të parë, edhe pse ishin të pashkollë, ata e paskan zotëruar intelektualisht edhe serbishten e kishës ortodokse(!!!). Dhe siç na jep me nënkuptue sipas tij *poshkipët* ose *poshkipjan-ët*) që në atë kohë i kishin të përquafuara idetë ose platformën e rilindësve, **që si bazë e parë kombësie për shqiptarët që atëherë paska qenë formëzuar gjuha shqipe, jo feja, përkatësisht jo një fe, e cila nuk**

ndihmonte rilindjen e kombit, po respektoheshin të tri besimet shqipfolëse abrahamite.

7. Autori assesi nuk mundte ose nuk donte ta shpjegonte faktin e mungesës së serbëve ortodoksë serbishtfolës, andaj u detyrua me shënue fjalë shqipe, madje ndeshi këngë shqipe jo në serbishte kushtuar Kumonarës së Kishës së Deçanit po në gjuhën e *poshkipuar*, të cilën e njihte dhe e fliste dhe e respektonte Igumani i kishës (serbe).

8. Çuditej pse në Rogovë të Hasit të gjithë *poturët* ende nuk ishin *poshkipuar fetarisht* po e flisnin vetëm shqip, edhe pse e ndonjëri ende dinte të *belbëzonte sllavisht(!)*.

9. Për të mund të ishte e pabesueshme (mbase si edhe për disa europianë sot) kur ndeshi mbi 30 e sa shtëpi që bashkëjetonin familjarisht ortodoksë e katolikë, si dhe familje të tjera muslimanë e të krishterë brenda një fisi që si kushërij që të gjithë flisnin shqip. Kështu kurrfarë pengese bashkëjetese familjare nuk kishte për shkak të fesë. Atëbotë te shqipërt, fetë respektoheshin, por përparësi te shqiptarët ligj kanun shqiptar kishte ndërlidhja ose ruajtja e pastërtisë së gjakut si kushurinjtë fisi, andaj dhe nuk bënin krushqi brenda një fisi të ngushtë.

10. Milojeviçi nuk e kishte të qartë pse Bushatlia i Shkodrës kur e kishte të shtrirë pushtetin edhe në këto treva si musliman e kishte meremetuar Kishën (kristiane ortodokse) të Deçanit.

11. Çuditej edhe për të vërtetën tjetër, pse gra shqiptare (josllave tash joortodokse) por edhe burra të *islamizuar shqiptarë* ende gjenin prehje për nevoja shpirtërore në kishat ortodokse, si atë të Deçanit, që ende i konsideronin si faltore të veta, siç i kishin pasur më parë?

12. Milojeviçi përmend me admirim anëtarët e familjes të fisit Gashi, shqipë të islamizuar që kishin qenë *serb shqipfolës*, të cilët edhe pse të islamizuar si vovodë kishin vdekur në mbrojtje të kishës së vet (serbe!), ashtu si edhe Kelmendasit (katolikë!) për Patrikanën e Pejës, dhe s'e kuptonte shkakun pse ato fise edhe tani si muslimanë apo katolikë ata tempuj fetarë si objekte kulturi i konsideronin si të vetat etj.-etj.

13. Autori gjen rast që propagandisht me përmendë mitin për Betejën e Kosovës të dëgjuar gjoja nga goja e disa **crnagorëve**, të cilët pasi i lavdon për serbishten korrekte përmend gojëdhanën, e cila te ne ndërlidhet me vdekjen e Skënderbeut, të cilët gjoja në shenjë zie për *disfatën e perandorisë serbe në fushën e pafat Kosovë (zbog propasti srpskog carstva u nesreçnom polju Kosova) i paskan nxi dhe bartkan rrobe të zeza, mit ky që garashaninët e shfrytonin si propagandë për "Çlirimin"*

e Kosovës si pjesë të Serbisë së Vërtetë të okupuar nga arnautët e turqizuar shqipfolës (!), po që në të vërtetë ajo perandori ishte shpërbë para Betejës së Kosovës, pas vdekjes së Dushanit nga Uroshi i Dobët që në Betejën e Maricës, apo jo?!

14. U cek më sipër se autori *malësorët shqiptarë që i gjen në harmoni gjuhe e harmoni feje*, të të gjitha fiseve i jep gajret vetes duke i quajtur *serbë të kulluar “çisti srbi”(!!!!)*, pikërisht atë kohë kur në *Smederevën e Sovjetit* dhe në vetë *Beogradin* ende jo plotësisht ose të sapoçliruar me ndihmën e shqiptarëve të së njëjtit ideal antiosman, jetonin ose bashkëjetonin me serbë mbi 60% popullsi joserbe, të cilët ndërkohë u dëbuan pa mëshirë si turq. Kështu Milojeviçi këndej shqiptarët e paturëzuar i quan serbë, vetëm e vetëm që numri e serbëve në këto troje me dalë shumicë. Gënjesjtër kjo që u gëlltit epitetshem nga Vemiçi e të tjerë.

15. Sidoqoftë, për rëndësinë që kishte dhe ka ballafaqimi i Milojeviçit me të vërtetën, gjë që atë e bënte nervoz, pse toskët *muslimanë e ortodoksë*, dhe gegët *muslimanë, katolikë e ortodoksë*, që ishin “çisti srbi” (serbë të kulluar), ata të gjithë, që atëherë, përparësi i paskan pasë dhënë **gjuhës shqipe!**

16. Nuk dimë ishte shkencërisht vërtet i paarrirë autori kur shprehej për asfiksimin ose shuarjen e gjuhës shqipe, kur vitalitetin e saj në asimilimin e serbishtes e pranon si diçka të përfundar, madje kjo shihet edhe në barasvlerësit që me rastin e etimologjizimit dhe të barasvlerësisë ndaj gjuhës serbe, shprehjet e shqipes dalin më të fuqishme dhe më të konsoliduara se atë të serbishtes në atë kohë, konstatim ky që do të vërtetohet në nënkrerët vijues.

17. Me fjalë të tjera, ishin realitet festat e përbashkëta ose jo ortodokse muslimane edhe pse ai ishte vërtet i verbuar nga doktrina makiaveliste dhe e keqpëdorte të vërtetën ose ndoshta edhe i mungonte koncepti që përveç **poturëve shqipfolës**, të cilët qindpërqind kishin qenë **ortodoksë shqiptarë**, *jo vetëm në Kosovë* po edhe në viset e potenciale të Serbisë e gjithandej, të cilët bashkëjetonin me muslimanë së paku, në të gjitha fshatrat që ai i quan *poturë*, të kanë festuar edhe e festojnë bashkë **Uskrsin** (Pashkët) e **Bozhiqin** (Kërshëndellat) ortodokse. Madje ka fakte që si ilirë ose pasilirë të krishterëzuar sigurisht para serbëve i kishin pasur festat e tilla të veta, trashëgimi që ka rritur deri në ditët tona, ngase nuk besoj se dikush më i moshuar dhe ata të moshës sime nuk i mbajnë mend edhe *vezët e kuqe* para Shëngjegjit.

18. Në këtë pikë të fundit të këtij nënkreu, para se të kalojmë në nëkreun vijues, po shfrytëzojmë dy të dhëna me inters që mësuam ndërkohë nga portalet përkatëse në gjuhën serbe:

E para, nga portali *Meta* © 2021 po japim dy fakte me rëndësi rreth veprimtarisë propagandistike të Milojeviçit.

Së pari, aty lexuam se më 1866 Milojeviçi ishte i njohur me gjendjen në Turqi, kur atë vit në burimin *Svetovidu* boton artikullin me titull *Popaganda u Turskoj (Propaganda në Turqi)* që na jep me kuptue që ai ishte i përgaditur për misionin e sapo filluar në Stara Serbi e Maqedoni vizita, që do t'i bëjë disa herë ato vite ilegalisht duke u maskuar si “zograp mjesh të moler” dhe njëherazi mësojmë se me 1889, pasi kishte kryer atë mision në Prave Stare Srbije (Kosovë) paska themeluar organin *Odbor za propagandu srpske misli* (Këshill për propagandimin e mendimit serb). Edhe nga kjo kuptojmë se Milojeviçi kishte preokupim vetëm luftën propagandistike jo shkencën ose të vërtetën.

Së dyti, nga portali *Riznica srpska* (Thesari serb), ku me anë të këtij fragmenti të Milojeviçit “*Odlomci istorije srba*”, shkruar pothuaj para 150 vitesh:

Срби најлакше и најбрже од свију народа на свету ПРЕЛИВАЈУ у туђе народности, па и оне, на велику несрећу и жалост, које стоје на много нижем ступњу изображења од њега... Да неидемо далеко, него да наведемо пример из садањости. Свако зна: да ШКИПСИ дан: — АРНАУТИ— стоје на много нижем ступњу изображења у Ст. Србији па негледајући на то, што им језик... не може ни обичне домаће потребе да изрази, опет они, и ако неумеју ни копати ни орати па управо и ништа радити, СТРАШНО ПРЕЛИВАЈУ СРБЕ у се. ПРИМЕР је довољан да наведемо: да су пре 10—15. год. сва села око ДЕЧАНА говорила српски и врло мало ШКИПСКИ а данас, ван 8 кућа у ЛОЋАНИМА, НЕЗНАЈУ СКОРО НИ РЕЧИЦЕ СРБСКИ.

/Serbët më së shumti dhe më më së shpejti nga të gjithë popujt në botë përmythen apo shkrihen në kombësi të huaja, në ato, që mjerisht, fatkeqësi e madhe, qëndrojnë në shkallë më të ulët arsimi se ata... Nuk po shkojmë më larg, po marrim një shembull nga e tashmja: Gjithkush e di se shqipët e sotëm -arnautët, qëndrojnë në shkallë shumë më të ulët civilizimi në Serbinë e Vjetër, po pa marrë parasysh këtë, që gjuha e tyre nuk mund të

shprehë as nevojat e donmosdoshme të amvisnisë, përsëri ata, edhe pse nuk dinë as me mihë, asme lavrue, në të vërtetë nuk dinë asgjë me punue, kurse tmerrësisht po i përvetësojnë (përthithin) serbët. Mjafton ta shënoj një shembull që para 10-15 vjetësh të gjithë fshatrat rreth Deçanit flisnin serbisht fare pak shqip, ndërsa sot, pos 8 familjeve në Lloçan, të gjithë të tjerët nuk dinë pothuaj asnjë fjalëz serbisht.

Me këtë tekst (fragment) i tërhiqet vërejtje doktorandit Dejan Ristiq, i cili si historijan pa të drejtë i ishte bashkuar Apelit kundër pseudohistorizmave të Milojeviçit dhe njëherazii i tërhiqet vërejtje edhe luftëtarit e politikanit kosovar Ramush Haradinaj, nga Gillogjani (Loçani) i cili para gazetarëve paska deklaruar se serbët po e përmendin Betejën e Kosovës 1379, kurse ne shqiptarët me mija vite më përpara ishim këtu, prandaj Kosova është e shqiptarëve.

Edhe pse ka vend për më shumë vërejtje e konstatime, ne falenderojmë reaguesin, por edhe Milojeviçin, për të vërtetën e nënkuptueshme se fshatrat e Deçanit, jo para 10-15 vitesh që automatikisht e paskan harruar serbishtes(!), por ata kurrë nuk kanë folur serbisht, por vetëm shqip edhe nëse sipas Milojeviçit paskan qenë ortodoks (sipas tij serbë), por ata ishin shqipfolës, dhe vërtet vërtet para një mijë e sa vitesh si shqipfolës i kanë ndërtuar kishat e veta, apo jo?!

Prandaj, vërejtja e reaguesit si dhe fjalët e Milojeviçit, gjithsesi mbështesin doktorandin dhe Haradinajn, tregojnë reaguesin sepse ka intelektualë në Serbi që u besojnë gënjështër-mashkrimeve se kishat ortodokse në Kosovë i paskan ndërtuara atëherë vetëm serbët pa shqiptarë.

NËNKREU II DISA TË DHËNA HAMENDESE HISTORIKE ETIMOLOGJIKE TË MILOJEVIÇIT PËR SHKIPËT E GJUHËN E TYRE

U tha më sipër se Qeveria, shoqata e dijetarëve, shoqata e shkrimtarëve dhe sidomos kisha serbe të nxitur dhe të stimuluar nga gjendja politike në arenën e politikës ruse dhe europiane ishin të orientuar

për studimin e gjendjes reale në të ashtuquajturën Stara Serbi e në veçanti për gjendjen në Kosovë, në të cilën edhe ndodheshin monumente fetare që ortodoksia serbe, duke mënjanuar shqiptarët e gjuhën shqipe propagandisht i kishte përvetësuar, andaj rreth atyre kishave dhe manastireve duhej afruar sa më shumë ithtarë fetarë, mundësisht edhe me gjuhë letrare serbe, për të cilët edhe u hapen shkolla e punkte propagandistike, pa e përjashtuar edhe traditën e gjuhës kishtare sllave të qirilo-metodit, e cila figuronte më tepër vetëm në lutje, të cilat ishin veçori e kësaj Lëvizjeje socialromantike nacionaliste serbomadhe.

Andaj edhe Milojeviçi nuk e gjeti rrugën e pashtuar në këtë drejtim, prandaj filloi me mësimin e situatës dhe këtë e bëri duke i shënuar emërtimet në gjuhën serbe të vendbanimeve dhe me shënimin e numrit të shtëpive sipas etnive dhe pasi u bind se nuk kishte të bënte fare me toka turke, po të *shkipëve* që vetëm një pjesë të tyre e gjeti në fenë e dëshiruar pravosllave, ngase shumica ishte islamizuar, por që të gjithë, madje edhe ortodoksët flitnin shqip dhe domosdo mbaheshin me shqiptarë, atëherë gjeti zgjidhje që të gjithë poturët t'i quaj e regjistrojë në statistikë si serbë të *poshkipëzuar*.

Po sidoqoftë në këtë pjesë nënkreu do të përqëndrohemi në disa të dhëna shumica hamendëse po jo pa interes historik për **shkipët** dhe gjuhën e tyre, duke përfshirë edhe disa etimologji, ndonjë legjendë popullore, po më fort të sajuara prej tij mbi këtë bazë që i ndeshëm nga dy librat voluminozë të tij **Odlomci...** dhe **Putopis...** që tani po shtjellojmë në disa pika:

E para, zgjon interes fakti se përmend disa herë e disa gjëra mbase me pahir lidhur me emrat *arnaut*, *potur*, *latin* sipas kuptimit që u jepet në tekstin në shqyrtim për të njëjtën etni, sepse ai në të vërtetë e njihnte fjalë-emrin *arbanas*, po më tepër, *çka zgjon interes në veprat e tij* këtë etni shqipfolëse e shqipfolëse e quan në njëjës **shkip** si **emër**, si **emërprejfojlor**, por edhe si **folje** e **mbiemër**, ndësa në shumës që e përdor më shumës e shënon disa trajtash, sipas rasave dhe kontekstit: **shkipi**, **shkipe**, **shkipci**, **shkipimi**, **shkipuri**, **poshkiplijanci** (të shqiptarizuarit), përkatësisht si mbiemër **shkipski** jezik (gjuhë shqipe), i emërtim gjuhe dhe etnie,

E dyta, në një rast kur e cek veprën e Bues dhe si mbiemër ndeshim dhe trajtën **skipitarski**, dhe në një rast tjetër pikërisht kur e përmend faktin që në kuadër të Ilirisë përshfshihej edhe Epiri ose vendi mbi Avlona

(Vlorë), ku ishte formuar një shtet i vogël shqiptar, i cili karakterizohej edhe me veshjen e vet *shkipitarskom*.

E treta, edhe pse më tepër me ngjyrim politik e quajmë pozitiv faktin që **shkipët** i ndan si dy etni: **shkipë të lashtë** (stare shipe) të cilët pothuaj i admiron, ashtu si edhe gjuhën e tyre dhe të **shkipët e sotëm** (danasnji ose sadasnje shkiye), të cilët pothuaj i neglizhon, ngase i konsideron serb të islamizuar(!).

E katërta, në një vend tjetër thekson se në këto troje si popuj paralatinë ishin: *maqedonët, shkipët* dhe *elinët* ose *grekët*, por në një vend tjetër shprehet se **meqedonët ne i llogarisin në shkipë të vjetër (raçunamo u stare shkiye)**.

E pesta, përmend një rast që zgjon intetres fakti, ngase pasi nuk dihet qëllimi, pse konstaton se në shekullin II para Krishtit *shkipsi* (**shkipët** para se të binin nën sundimin romak(!)) **kishin themeluar mbretëri me fiset serbe (!)**.

E gjashta, ngulmon qëserbët e stërllashtë: *srbali, serblja* dhe *trivali* kanë jetuar në Maqedoni e në Albaninë e sotm. Fjalën fis e vlerëson dhe e përkthen me fjalën basvlerëse **pleme të serbishtes**.

E shtata, autori njih qytetin Albanopol dhese prej asaj fjale vendi ka marrë emrin Albania ose Labia, duke theksuar se Albania e sotme nuk është tjetër, por Labinja ose *Beli Ljudi* (Njerëzit e Bardhë), atribut me cilin është quajur njëherazi edhe *Srbska Zemlja* (Toka serbe!)

E teta, ndërlidhur me pikën e mësipërme në një rast emrin Krajina e lidh edhe me me krahinë (vend) bregdetare, por edhe me *Veneta, Vendi*, ku kanë jetuar serbët e lashtë (!!!), **por jo pa shkipë** e të tjerë...

E nënta, pikërisht kur përmend fisin *Bregiqi* (Bregu), të cilët siç thotë ai, mjerisht tani janë *poshkipuar (!)* (*na zhalost se poshkipishe*)), përmend shtrirjen e tyre kryesisht edhe në vise malore, por edhe në ato bregdetare, për të cilët përdor toponimin shqip dytrajtash: *Bregudetskim* (*Bregu+det*) edhe në trajtën *Brekudetskim* (nga *bregu i detit /dallimi k/g*).

E dhjeta, edhe në Mal të Zi, ndesh shqiptarë, të cilët edhe pse të islamizuar më shumë jetonin nën emrin etnik *crnogorac* e *Crna-Gora* që në *shkipski* quhet **Malezia** (kompozitë e tij) të cilën e shënon të pandarë *Malizi Malezia* dhe e shpjegon: *mal- plania dhe zi/ cerno*), që ndërkohë në shqipe kemi dy emërtime **Mali i Zi dhe Malësia (!)**.

E njëmbëdhjeta, fjalës **mal** e ka vërejtur edhe në vise të tjera malësore, konkretisht te fisi që ai e quan **krshogori**, ndërsa ata veten e

quatkëshin **krshmal (krshmalas!)**, si duket kjo ëshjtë sajësë e tij (*Krahaso krsh –shkrep shkrepstar!*).

E dymbëdhjeta, kur cek **Gurevc/ët** si banorë, rrënjën **gur-i** e shpjegon me fjalën e serbishtes **gora** dhe banorët i quan **goranë**). Në të vërtetë, konstatojmë se Milojeviçi nuk njih emërtimin **malësorë** (serbishtja e sotme **Malisori**), po përmend **gorani ose brdjani** me shtrirje mjaft të gjerë. **Goranë i quan** edhe **lumjanët** muhamedanë, të cilët e kanë humbur serbishten si dhe **goranët (!)** rugovas që jetonin në 80 fshatra në *Rugovën zemrake (u ljuetoj Rugovi)*, të cilët gjoja ende dinin serbisht.

E trembëdhjeta, fisin **gash** e shënon të prejardhur nga **gora/sh, -g'ash**. Edhe fisin **gallak: golak, gorak (l/r)** e shpjegon nga **gora**.

E katërbëdhjeta, autori ankohet pse *rozhasit, plavjanët e beranasit, me të përqafuar të islamit e kishin humbur tërësisht gjuhën e vet* (srpski!), edhe pse respektonin autoritetin e *knezit* të Malit të Zi, madje respektonin edhe **Shën Gjergjin** (sv. Gjurgja!). si festë të veten.

E pesëmbëdhjeta, autori si fis më të fortë ndër **shqipë** quan fisin **Leka** (Lekiq) Në këtë fis bënin pjesë edhe, **matjanët**, të cilët fatkeqësiht (na zhalost), sipas tij, pothuajse tërësisht ishin shqipëzuar (**sasvim poshkipili**), edhe pse e festonin si të veten Shën Nikollën e fesë ortodokse.

E gjashtëmbëdhjeta, është interesant se si në këtë vepër i shpjegon guximtarisht etimologjikisht disa fjalë nga shqipja në serbisht, si: fisin **Sop Solp (sop)** e zbërthen **slp : s(Dop (l/r, p/b): srb.**

E shtatëmbëdhjeta, **Suljotët** i shpjegon nga trajta **Sllavjot**, kurse fjala **Atika** i del nga **Ata** (otac), po nuk e cek edhe trajtat shqip të këtij emri: emrin at/ata dhe tatë/ tata(!).

E tetëmbëdhjeta, sipas lij fjala **Dukagjin** i del e ngjashme me **Dukle Mali i Zi**.

E nëntëmbëdhjeta, Metohinë në raste e quan **Podrimje**.

E njëzeta, ndërlidhur me pikën paraprake, në ndonjë rast fjalën Duka e përkthen me Duh Duha (frymim) **duha+gjin** ngjashëm me duh Dusha, Dushica (shpirt)!!!!

E njëzetënjëta, Lekë Dukagjinit autoritetin e tij popullor dhe e përvetëson, duke e ndërlidhur me folklorin serb. E quan *sin Lute Bogdana* (djalë i Lute Bogdanit), personazh i një kënge popullore serbe kushtuar Kosovës.

E njëzetedyta, emrin e qytetit Berati të sotëm e quan *Beogradski arnaut*, pa verifikim ndikimi bullgar e konstaton me prejardhje serbe,

E njëzetetreta, emërtimin Alba ose Laba e identifikon, ndërsa për **labët**, sqaron se janë arnautë ose **shkipë jोगेग़े**.

E njëzetekatërta emërvendi **Pelagonija**, sipas tij zberthehet me fjalë të serbishtes, po nga shqiptimi i *shkipëve*: Bela Gunja /**Pelagunë** (p/b pela/bela)+ *gunë - bardhëgunjët ose gunjëbardhët*). Me këtë fjalë, sot në të dyja gjuhët kuptohet: *veshja e sipërme dhe e trashë e barinjve e gjatë deri poshtë gjunjve e me kapuç*. Prejardhja e emrit *gunë-a* mund të diskutohet Serbët *gjunjve* u thonë *kolena*, gegnisht te ne u thonë “*guj*” e veshës “*gujë*”.

E njëzetepesta, malin **Gramoz** (me origjinë rumune) e shpjegon me kompozitën *grad + most* (qytet+urë)?!

E njëzetegjashta, emrin e qytetit **Nikopol** e shpjegon **Niqi + polje** (*fusha e askujt*). Dihet, në shqip shpjegohet *fusha apo qyteti i Nikës!*

E njëzeteshtata, emri i njohur **Rasha** (Rashka, Rassiena) që simbolizon themelimin e shtetit të Nemanjve në këtë libër merr shtrirje të popullatës serbe, jo vetëm në Kroaci, por gjoja u dëshmuaka edhe në Bullgari e Itali, ku serbët u quajtën **Selici**, të cilët jetonin, sipas tij në Dardani bashkë me *shkipët* (sa *shkipurima*), të cilët përmenden gjithandej me emërtimin **gogë (mbase gegë, jo torbeshë!)**.

E njëzeteteta, **Smederevën** e quan *Zllatogorska*.

E njëzetënenta, e përmend qytetin **Platinopol** mbi Ibër, të cilin latinët e paskan quajtur Trimonten, ndërsa autori! (mbase për të ikur nga interpretimi: **Ibar’ i bardhi!!!**) këtë e ndërlihd më shumë me emrin *Marica (!!!)*.

E tridhjeta, nga vizita në Mirditë pasi konstaton se këta të gjithë kanë qenë “pravosllavë” (ortodoksë), por janë detyruar me pranue “uniten”, andaj edhe edhe popat u vinë nga vendet katolike, shpjegon etimologjinë e emrit *Mirdita*, duke e lidhur me faktin se gjoja babai i Gjergj *Kastriotit* Jovani (Ivani) /Gjoni/, duke ikur nga Turqit paska ardhur një ditë këtu dhe i paska pasë pëlqyer vendi, andaj paska pagëzuar **mirë** serb, *miran dan (dobbar)* dhe **dita (dan)**: **Dobardan** (miran dan= ditë e qetë) - **Mirdita** dhe kështu të gjitha këta “**fandë**” mbahen se janë “**kastriotiqi**” *lkastriotas të vërtetë/*.

E tridhjetaenjeta, përmend disa herë ndërlihdjet fisnore etnike e fetare serbo-shkipe, natyrisht duke i dhënë përparësi gjuhës serbe dhe fesë pravosllave. Kështu pa të drejtë konstaton se **Toska, Bardi, Kastr, Shala e të tjerë** : “... **nuk janë askush tjetër por, serbë të pastërt, të kulluar (“çisti srbi”)** që tani duken të shqiptarizuar (“*poshkipljani*”), të cilët si

fiset e tjera (shkipe) edhe sot flasin serbisht (!) më tepër se “shkipski”(!!) dhe kjo që janë serbë, sipas tij, veç tjerash dëshmohej edhe me zakone e rite që nuk i paskan të tjerët vetëm serbët(!!!), ...

E tridhjetedyta, sipas tij, edhe *arnautët e fiseve: Kabash e Gash* e të tjerë, të cilët vetëm pse e kremtojnë (sikurse serbët) *Shën Premten (Sveti Petka)*, përkatësisht *Shën Gjonin (Sveti Jovana) etj*, dhe me këtë dëshmojnë se qenkan serbë (!!!).

E tridhjetedyta, sipas Milojeviçit, emërtimin *maxhar* për hungarezë serbëve gjoja ua kanë vulosur (dhuruar) shkipët ngase ata në saje të pamjes së jashtme fizike të tyre (hungarezëve) i paskan quajtur në gjuhën shqipe **maxharë** (si magarë!), ngase , sipas tij,

“Шкипси тврде: да су тако прозвали Маџаре и то на шкипском језику значи Магарац а ми волемо се држати њихове прве старине и имена... тврде да је тако, са њихових дугачких и уз главу прилепљених ушију, малог дежмекастог раста, широка лица, дебела врата, вечна робовања и т.д., /Shkipët pohojnë që ashtu i kanë quajtur maxharë (gomarë), kurse ne duam t'i përvetësojmë krijim-emërtimet lashtësore të tyre... pohojnë se kërshu është quajtur hungarezi, për shkak veshëve të gjatë ngjitur kokës, nga shtati shkurtakë e trashahalluq, fytyrëgjërë e qafëtrashë, robë të përhershëm etj./

por në një vend tjetër propozon që nocionet **maxhar (madzar** hungarez) ndaj **magjar (madjar** kafshë). Vërtet baltosjet e tilla nga Milojeviçi dalin shumë banale, apo jo?!!!!

E tridhjetetreta, emërtimin e Urës së Fshanjt, Milojeviç e shpjegon të formuar nga gjuha shqipe në shenjë falemderimi ndaj mbretit serb Stefan, i cili e paska ndërtuar urën. Etimologjikisht t e shpjegon kështu: **O shvan** ose **Shvanski most** nga fjala Shin –Sveti /O *shinji/ Stefan* ose Ivan / *Shin Stevan* **Sh/inste/van /sh+ van/ Shvanski Most** /Ura e Shin Stefanit? Most Sveti Stevana **Ura e Fshajt Shvanski Most**. Pra, Urën e Fshajt –serb. **Shvanski Most** e shpjegon me ndërhyrje të shqipes lokale: **Sh/in +I/Van** –madje edhe emri i fshatit **Shvan** ose **Oshvan**) — Sh+van – **SHVAN**, shpjegohet po sipas këtij zhvillimi.

E tridhjetekatërta, mes Manastirit, Dibres e Korçës e shënon një kishë me emrin **Ziaiscnska sv. ili Crna**, pra sqaron emërtim i përbërë nga e njëjta fjalë po në të dyja gjuhët Zia+ Crna ZIAIS. Pra i shton si dy fjalë barasvlerësve nga dy gjuhët, pjesa e parë shqip **Zia+Crna**, dytë përforcuese serbisht.

E tridhjetepesta, zgjojnë interes edhe kompozitat e vendbanimeve: Buzmakahala (Burrëmahalle!) ose Buzmagaza (buzëmagaze!), Kodralja/Kodralija (Kodra e Alisë).

E tridhjetegjashta, po i shënoj vetëm këta shembuj thjesht nga gjuha shqipe, si Lug Luga : Zoq Zoj... , Kotare/Kotore, por ka edhe të tjerë.

E tridhjeteshtata , Fjalën *shkipe* (shkabë) e përkthen me *orlovi* ; Emri **Drin**, sipas tij, *gjoja vjen nga dr'l brzi, bистри, Reka e keqe- Crna reka (e zezë), ndërsa Podujevo gjoja vlen nga Dub (lis) ose nga duh (duhi).*

E tridhjeteteta, po i shënojmë si pikë më vete disa kompozita si vendbanime që i ndeshim po ashtu të shënuara në variantin në gjuhën serbe si fjalë shqipe në njësinë gjeografike ku përfshihej Deçani, siç janë:

Lukasipra (Lluka e Sipërme)- Gornja Luka (sot Lluka e Epërme)

Lukaposhtra (Lluka e Poshtër) -Donja Luka (sot Lluka e Poshtme Lumbarli /Lumbardi që sqarohet me Beli Ljum (Lumbardi),madje edhe

Babaloç përkthehet në rubrikën Kd në Otac/blata etj.

E tridhjetenënta, kuptimi i fjalës SRBM SORB, SURB... do të thotë rodjak (kushurin), ndërsa në mënyrë tendencioze shpjegohet me prejardhje servus (rob) e deri edhe *Svrab* (zgjebarosh), ndërkaq serbët në robëri ata nuk janë serbë po RAJA.

Ka edhe të dhëna të tjera të kësaj natyre po ne po mjaftohemi me kaq.

NËNKREU III

RRETH PËRKTHIMIT TË DY VJERSHËZAVE NGUCAKEQE PREJ SHQIPES SERBISHT DHE SHËNIMIT TË NJË KËNGE POPULLORE SHQIPE

Milosh S. Milojeviçi që në vërejtjet e para pasi u sistemua në bazat e caktuara serbe, së pari në Graçanicë (Prishtinë) gjeti shoqëri e së andejmi u takua deri edhe me Patrikun e popat më përgjegjës në Pejë, Deçan, Prizren e gjithandej këndeje anembanë trojeve shkipfolëse deri në

Toskëri e Elbasan. Ndër të tjera sa ishte në Pejë del sa ishte në skortin e patrikut që kalonin rrugës së Pejës drejt Manastirit nën mbrojtjen e ushtarakëve turq, gjoja në rrugë i ka dëgjuar dhe i ka shënuar dy vjershëza ngucakeqe në shqip, të cilat i përkthen dhe i komenton dhe gjithashtu në një rrugë pa rrugë në një fshat të Prizrenit në shoqërim me *Igumanin e Këshës së Deçanit* po ashtu në rrugë e shënon një këngë kushtuar rrëmbimit të kumbnës së kishës së Deçanit dhe rikthimit nga Igumani, këngë të cilën e shënon shqip dhe e komenton, po nuk e përkthen.

Sidoqoftë, në këtë nënpjesë së pari analizojmë **Dy vjershëzas ngucakeqe** dhe së dyti, **Këngën e kumbonës**.

(1) Rreth dy vjershëzave ngucakeqe në shqipe dhe përkthimi

Milojeviçi, jo me qëllim studimor po me synim përcmimi të shqiptarëve dhe të gjuhës shqipe ka shënuar dhe përkthyer dy vjershëza ngucakeqe, të cilat po i analizojmë më poshtë, në katër pika:

E para, bëjmë prezantimin e dy vjershëzave në origjinal e të përkthyerat dhe të modifikuara prej nesh

E dyta, identifikojmë si sprovë të parë, nga ai fjalët e përkthyerat shqip serbisht para 150 vjetësh, kryesisht nga teksti i vjershëzave,

E treta, shprehim dyshim rreth vërtetësisë së vendndodhjes së dëgjimit të vjershëzave sipas autorit dhe

E katërta, duke mos mohuar *gjetjet e autorit* të vjershërimeve të tilla ngucakeqe në dëm të bashkëjetesës.

1) Prezantimi i dy vjershëzave ngucakeqe

Dy vjershëzat që janë objekt trajtimi në këtë nënkrye, autori M. Milojevic, thotë se i paska dëgjuar në një rrugë të qytetit të Pejës, ndërsa edhe ai ishte pjesë e një karvani kalorësish të serbëve (ortodoksëve) që ishte në levizje e sipër drejt Patrikanës së Pejës, të cilëve u printe vetë Patriku, i cili paska pasur autoritet edhe nga arnautët, si dhe nga pushteti turk. Në ato çaste, edhe pse karvani kishte skortë përcjellëse të armatosur zyrtare, sipas tij, disa fëmijë e të rinj adoleshentë, madje deri edhe gra *bullat*, karvanin e

paskan gjuajtur me baltë e gurë, duke shqiptuar si në kor vargje ngucakeqe ndaj Patrikut dhe shkive kalimtarë pravosllavë. Kështu, si në kor nga të dyja anët e rrugës paska dëgjuar dhe shënuar vargjet e dy vjershëzave, të cilat ne të fotokopjuara, po i prezantojmë tash fill, të trajtuara në katër rubrika:

Numri rendor i vargut,

1. Originali shqip (cirilicë), i fotokopjuar,
2. Përshtatja ose përkthimi i autorit (në cililicë) i fotokopjuar dhe
3. Përkthimi ose modifikimi a përshtatja në shqipen e sotme sipas nesh.

a) Vjershëza e parë: Поп, Поп...

		што ќе рећи: ---- -----	Që do të thotë: -----
1.	Поп, поп	Поп, поп	Pop, pop
2.	Трпокоп	Трнокоп	Tarrakop (<i>kazmë</i>)
3.	Ме синцир	на синђир	me zinxhir
4.	Ме коноп	на конопац	me konop
		(<i>Да га обесе</i>)	(<i>për ta varë</i>)
5.	Иња диња	иња диња	Inja, dinja (<i>pjepër</i>)
6.	Поп свиња	поп је свиња	pop svinja (<i>popi është derr!</i>)

Dhe autori sqaron:

Тек би се ова дивна песмица свршила, а наступила би опет ова:

Përthimi ynë:

Sapo përfundoj kjo vjershëz mrekullueshme, u shfaq po ashtu tjetra:

b) Vjershëza e dytë: Шкја, Шкја ...

А то све значи: Dhe (krejt kjo) do të thotë:

1	"Шкја,	Славенине,	Shka, shka
2	шкја	попра,	Pordha-shka
3	попра,	несрећна ти мајка	Mjer nana
4	Морен	што те има	që të ka ...
5	нанен	Обесите Шкјава	Merreni shkavin
6	Ћит ка ...		(sllavin, Serbin)

7	Мјерен шкја	(Словенина, Србина)	varee në birë... ..fija (bari) e
8	Вирен бир, Бар ух пут Шкја ора мут”	на сламку од траве Трава се прекиде Шкјав пропаде у проход	varëses u këput shkau ra në mut

Ndonëse ne nuk përjashtojmë provokime të tilla, në situata të caktuara të ndodhura edhe para 150 vitesh, por pikërisht lidhur me vërtetësinë e vendndodhjes së recitimit të këtyre vjershëzave shprehim rezervë, por së pari në trajtat e shqipes së sotme po i identifikojmë fjalët e përkthyer:

2) Fjalët e përkthyer shqip-serbisht në këtë kontekst:

- 1) Merreni – uzmite
- 2) Virnie (varnie) - obesite ga, vešajte ga
- 3) Barë – trava
- 4) Birë – rupa (rupa klozeta van hodnika u dvosptanim kucama) - birë nevojtojeje, në shtëpitë dykatëshe ngjitas ose jashtë divanhanës (korridorit) të odës.
- 5) Fije (kashte) – slamka
- 6) Bie- propadne
- 7) Këputet – prekida se
- 8) Mut – prohod, govno
- 9) Pordha -poprda
- 10) Konop, litar - konoplje
- 11) Zinxhir – lanac
- 12) shkja, shka – srbin, slavenin, slovenin
- 13) pop –prift (pop)
- 14) derr – svinja
- 15) mjer nana – nesrećna ti majka
- 16) që të ka - što te ima
- 17) krejt kjo – sve to (ovo)
- 18) pjepër!- dinja

Këtë barasvlerësi po e spikasim me qëllim se këta shembuj janë si paraprovë për autorin, i cili ndërkohë vazhdon ballafaqimin, përkatësisht përkthimin e në situata të caktuara të fjalëve të tjera shqip-serbisht, deri sa

në notesin e tij arrin ta shënojë një këngë folklorike shqipe dhe të përmbledhë një grumullim fjalësh në një sifjalorth shqip-serbisht, të cilat do t'i trajtojmë në nënkreun e katërt.

Sidoqoftë, ne tani po përmendim arsyen pse dyshojmë ose pse shprehim rezervë lidhur me vërtetësinë e vendndodhjes së vjershërimeve të tilla, edhe pse nuk e mohojmë ekzistimin e tyre me përmbajtje të ngjashme ngucakeqe.

/*

3) Rreth kontinuitetit të vjershëzave të tilla ngucakeqe në raporte përçarëse ndërfetare brendashqiptare

S'do mend që ne e admirojmë z. Milojević, i cili që në atë periudhë krizash politike të Perandorisë Osmane paska vënë re vjershëza të tilla ngucakeqe të këtij zhanri në raporte ndërfetare brendashqiptare, krijime këto të nxitura nga vegla të pushtetit osman dhe të klerikëve shqiptarofobë. Kështu autori na dha shkas të rikujtojmë nga fëmijnia jonë e hershme, pra, para 80 vjetësh, nga koha e Kralevinës Jugosllave, vargje të tilla kundër prirëse fetarë, sidomos kundër hoxhëve, priftërve shqiptarë, e mbase edhe kundër popave ortodoksë serbjanë që dinin sbqip, vargje këto, të cilat dëgjoheshin në versione të ndryshme, jo vetëm si lojëfjalështa adolshentësh, por përdroreshin në njëfarë mënyre edhe në “Lojë kapuçash” nga *të mëdhenjtë*, siç ishte edhe vjershëza e parë me “*Pop, Pop*”, po ne si fëmijë me tepër e kemi shqiptuar në variantin tjetër:

Hop, hop, tarrangop

Mjekrra e popit leshatok...

ku, në të vërtetë, *mjekrra e Popit* zëvendsohej në versione të ndryshme fjalësh, paksa *me marre!* dhe vazhdohej:

...Leshatok e kalavesh,

Kam një bari, që ia qes

As s'le kime as s'le lesh!...

Ndërsa, sa i përket pjesës ngucëse emërtimeve si: *thi, qen, bull* etj. që shqiptoheshin, pothuaj normalisht, siç u tha, edhe në këngë lojëkapuçash, ku hiperbolizohej shkryerja në baltë e thiut ose varja e kundërshtarit edhe *në birë të qenefit* etj. Kështu thumboheshin me fjalë ngucakeqe në situata e mjedise të caktuara pa kursyer edhe *kmetat, predsednikat, xhandarët, poreznikat*, po edhe udhëheqësit fetarë.

Fundja, kush nuk e di ose nuk e ka dëgjuar në moshë të adoleshencës vjershëzën ngucakeqe çunash:: “... *Hypi hoxha n’kerr*”...

*...Kerri u thy
Hoxha u shpërthy!*

ose

*...Sheh e dërvish
Pula në qervish!...*

ose

*...Hu hu, Baba Hu!
Merr magarin
shko për dru!...*

ose

*Prifti me faneca,
zhguna, panleca,
musteqesh kapreca!*

ose

*Shka, shka,
Byth pa la!
Mjer nana7/
Qi t’ka.*

Gjithashtu, kujtoj fjalëngucje çobaneshash, para 80 vitesh, kur guxonin e gjuheshin me fjalë shpat më shpat, pikërisht në raporte ndërftare, si:

*Oj turki, oj turki
t’ka hi mini
nër dimi...*

ose

*Oj faneshë, oj faneshë
me pshtellak,
pa tlina veshë...*

ose

*Oj shkinë, shkinulka
ku të hupi furka?...
Qysh t’u thye boshti,
mbas gardhi, te koshi!?*

etj, etj.

Siç po shihet ne, te këto fragmente vjershëzash ngucakeqe anashkaluam disa fjalë edhe më *me marre*, ngase druanim që me to

sadopak do të ligshohej serioziteti i lëndës që po trajtojmë, po sidoqoftë për zhanrin dhe rimimin artistik në to, i japim plotësisht të drejtë z. Milojeviç që i quan “*vjershbëza të bukura, të mrekuallueshme*”.

Edhe nga ky aspekt, flas për vargjet që sollëm ne, kuptohet qartë se edhe pushteti serb i Krlevinës, paska pasë kopjuar e vazhduar politikën *përçaj e sundo* nga Turqia, të veneruar nga Milojeviçi, ndaj popullatës shqiptare mjerisht deri edhe mbi bazë të ndasisë fetare. Të vihet re, që këso fjalësh ngucakeqe dëgjoheshin *legalisht* në situata e ambiente të caktuara edhe në lojë kapuçash *vetëm shqip*, po jo aq sert në shoqëri të përziera islamo-katoliko-ortodokse, ku sadokudo respekti ndërnyerëzor e shoqëror fetar ruhej.

Sidoqoftë, deklaroj guximtarisht se këto fjalë ngucakeqe në raporte ndërfitare shqiptare, pothuaj se *u shafiten* në Kohën e *Shqipnisë* të ne 1941-1944, kur filloi shkollimi në gjuhën mësimore shqipe, ku pa dallim feje, muslimanë e të krishterë (katolikë e ortodoksë), mësonim bashkë, ngase tani dolën vjershërime edhe më të bukura artistikisht mbi bazë të jetësës së përbashkët kombëtare, që nuk kishin në përmbajtje fjalë *me marre*, por vjershëzat e këtij zhanri të shënuara nga Milojeviçi e fragmentarisht prej nesh, nuk u shuan tërësisht, ngase ngucakeqet qitnin krye tek-tuk edhe në kohën e komunizmit, kur propagandisht u përtri edhe të ne fushata, kundër prijësve fetarë edhe vetë fesë - si *opium* i popullit, apo jo?!

(2) Rreth shënimit të një kënge popullore shqipe -Kënga e kumonës

Autori na njofton se këtë këngë në gjuhën shqipe e ka dëgjuar dhe shënuar rastësisht nga katër këngëtarë poturë ose arnautë në një rrugicë (rrugë parrugë) mes arash të fshatit Prilep të Prizrenit, e cila i ishte kushtuar Qirilit, arkimandritit të Kishës së Deçanit, i cili paska vajtur në Stamboll dhe e paska sjellë kabanën e grabitur ndoshta nga një **beg**, ekstremist muhamedan, i cili në shenjë besnikërie fetare ndaj sovranit ia paka dërguar sulltanit kumbonën e Kishës së Deçanit, mirëpo Sulltani sipas autorit, pas vërejtjes së *7 kralave*, me ferman ia paska kthyer kumbonën Kishës nëpërmjet Qirilit. Për çudi Qirili, protogonisti i këngës, që ishte shoqëruar i Milojeviçit, pasi e dëgjoji këngën për të (në shqipe) i nderoi këngëtarët me duhan e disa groshë. Mirëpo në ato çaste papandehur aty vijnë 8 shqiptarë të armatosur, por edhe me ta Qirili me bashkudhëtarët

ndahet mirë. Kështu suita e kalorësesh që e shoqëronte Qirilin pa hasur në vështirësi nga poturët ose arnautët, vazhdon rrugën mesarash për Prizren.

Edhe pse për ne çasti i takimit, dëgjimit dhe falenderimet si dhe të shënuarit e këngës nuk janë aq të pranueshme as për ndonjë tregim letrar (edhe pse studiuesi i V. Bovan disa shkrime të tij i vendos në mes të historisë e letërsisë, madje për disa poezi popullore i quan disi si të fryra), ngase logjikisht edhe syzheja e kësaj kënge nuk ka as harmoni kuptimore, sepse kënga shënohet zakonisht nga një informator, madje nuk është lehtë me besue që Qirili si protagonist, pop serb!, paska qenë aq i popullarizuar me kthimin e kumbonës sa që fshatarët shqiptarë qoftë paturë (muslimanë), qoftë arnautë (katolikë) të zinin vend buzë rrugice mesarash dhe të këndonin këngën, pa e njohur fare igumanin, megjithatë ne e vlerësojmë tekstin e këngës, fundi i fundit vetëm pse del e shënuar në gjuhën shqipe, por edhe për faktin se ai paraprakisht e përshkruan ngjarjen,

Sidoqoftë, ja teksti i këngës në tri rubrika:

1. teksti në origjinal, i kopjuar nga origjinali në cirilicë,
2. teksti me shkronja shqipe me ndonjë përmirësim prej nesh
- dhe
3. ndonjë vërejtje fonetiko-gjuhësore

Kënga e kumbonës

Origjinali në cirilicë	Teksti me shkronjat shqipe me ndonjë përmirësim	Vërejtje
Аман бегој, турит девлети! Мосна чуј мзинцир тумрети Н Станбол кур на шкове, Нанд мазбата екени чуве Оџа ларт пор мејкндуве, Фукараја то меун ди гуже Намсој Шкодра осикан фоне Мосиле па и трет њтоне, Пре и Станбол датна вјен, фермане,	Aman beg-o t'u rritë devleti Mos na ço m zinxhir tu mreti Në Stamboll kur na shkove Nand mazbata i keni çue Hoxha lart për me i këndue Fukaraja do me u ndigue Na mësoj Shkodra o si kanë thanë	-oj/o u/o n/në; ekeni /??? -uve/ue to/do; me u ndiguve! na mcoj / na mësoj o/a; t'tonë/te tanë pre i/ prej oda/atë haxha?! Mbase vjedhë? kunboni/kumbona?!!

Пртечу ода т киш Дечанит Хаџа Кирили Игумони Т киш Дечанит конвјер кунбони, Пре и Станбол ја мриви фермани, Дју бјуљук пр бајт низами. (III knjiga f. 78)	Mos i le pa i tretë te tanë Prej Stambolli do të na vjen fermani Për te çu atë te kishë t' Deçanit Haxha Kirili Igumoni Te Kish t' Deçanit kanë vjerr(?) kumbonë Prej Stambolli ia mbërrini fermani Dy bylyk për me bajt nizami.	ja mrvivi/ ia mbërrini ju/y
--	---	--------------------------------

Sqarime

Siç po shihet, vetë regjistrimi i një kënge shqipe atëbotë, përkundër gabimeve përmbajtësore e gjuhësore të shumta, siç është edhe mungesa e tabanit koheziv mund të cilësohet si një kontribut i autorit në *shqipe për shqipen*, ngase teksti i shënuar shqip me alfabetin cirilicë para 150 vitesh, së pari ka rëndësi dokumentare, si një provë që ekziston, që gjithkush mund ta konsultojë për ndonjë vlerë historike e gjuhësore. Për mendimin tim zgjon interes edhe për ndonjë shprehje, si: *t'u rrit Devleti, nandë mazbata, na mësoi Shkodra si kanë thanë, mos i le pa tretë te tanë* etj, edhe ana shkrimore si: *pastaj trajta lart, për ta çue, hoxha lart me i kënuve, me u ndiguve, mrrivi, do t'na vjen (vijë) etj.* Gjithsesi fjalët dhe ngjyrimi i shprehjeve sikrahonorizma meritojnë koment më të rrastë. Sidoqoftë, mesa dimë autori nga mosnjohja e sistemit themelor të ligjëritit shqip bën, qoftë përzierjen e fjalëzave me fjalë, qoftë fjalët e plota i ndan rrokjesisht qysh nuk duhet, por gjithsesi studiuesi i pasionuar mund të vërejë ndonjë lokalizëm gjuhësor, ndërsa neve na ranë në sy këto vëreja:

1. Tingullin **TH** e shënon me **f: thënë/fonë**,
2. Togun **te tanë** ose të tërë e shënon **тътоне**, ku *Joti* cirilik nuk është përdorur me vend,
3. Në vend të zanores **Y** përdor **JU Bylyk / bjuluk**,
4. Janë përdorur këto paskajore: **për me i këndue (me i kënduve), me i ndiguve (me i ndiguve)**, ku me të vërtetë këngëtarët tanë

për arritje tetërrokëshi e zgjatnin zanoren e parë të togut - UvvE.

5. Si me thënë bën pothuaj të njëjta gabime si tek përshkrimi, përkatësisht përkthimi i dy vjershave ngucakeqe që u trajtuan në pikën e mësipërme.

Ne, në të vërtetë, kërkojmë që ekspertët e folkloristikës dhe studuesit e gjuhës ta vlerësojnë gjithanshmërisht edhe këtë tekst të papërkthyer nga autori, duke cekur edhe rëndësinë historike, gjuhësore e politike në kohëhapësirën kur është shkruar teksti i kësaj kënge në krahasim me të vërtetën dhe rrjedhat e mëpastajme deri në ditët e sotme, ngase “ku ka zë s’është pa gjë”, prandaj lidhur me këtë shtrohen këto pyetje:

1) Si qëndronte çështja, kishte të bënte vetëm me kumbona të kishave ortodokse, hakmarrje ndaj kumonave si trofe si kërkesë nga Sulltan i që të mbrojë muslimanët e vet besnikë, nga pushtimet e shteteve ortodokse, apo jo?!

2) Pse shqiptarët muslimanë nga rrethi i Prizrenit përshëndetnin deri edhe me këngë kthimin e kumbonës në Kishën ortodokse të Deçanit?!

4) Pse Popi ortodoks (vetë protagonist) falenderon muslimanët për këngën shqipe, vallë, mos ishte edhe ai shqiptar ortodoks apo vetëm shqipenjuhës?!

5) Kjo ngjarje rreth kthimit të kumbonës së Kishës së Deçanit, ishte reflektuar atëbotë në këngë edhe nga besimtarët serbishtfolës ortodoksë (pravosllavë) apo vërtet kanë munguar familje ortodoksish serbishtfolës, si goranët e torbeshtë që vërtete nuk ishin të kapur nga islamizmi, apo jo?

6) Pse Qirili, si protagonist i këngës, nuk ndihmoi përkthimin e saj në serbishte që së paku t’ua ekspozonte besimtarëve ortodoksë vendës, apo nuk kishte motiv, pasi të gjithë ata besimtarë pravosllavë ishin shqipfolës, apo jo?!

Sidoqoftë mbesin shumë çështje edhe të tjera të paqartësuara me interes rreth gjenezës së kësaj kënge. ngase vërtet sa i përket topikës, aty s’ka topikë me tabana koherent “fol e mbushmamendjen”, sepse kudo në beseda e në shkrime letrare sado fantastike që të jenë insistohet nga krjuesi si dhe lexuesi që vendndodhja e ngjarjes të jetë sa më e kapshme mendjesisht, kështu që për vendndodhjen e dëgjimit dhe shënimit si të vjershëzave ose të këngës që thotë autori, kemi disa dyshime të ligjshme, ndër të cilat po theksojmë:

Së pari, nga ajo që shkroi autori ka qenë e pamundur t’i dëgjojë e kuptojë fjalët e vargjeve përkatëse, madje edhe t’i shënojë sa ishte hipur në kalë si pjesëmarrës i karvanit në ecje ose mes arash duhej mbajtur kali për dore. Fundja ku guxon të shahej popi i madh - Patriku, i cili, siç e pohon vetë autori, gëzonte autoritet zyrtar edhe nga pushteti turk, por edhe nga shqiptarët e paria e tyre deri në Shkodër (! etj.).

Së dyti, karvani kishte skortë përcjellëse zyrtare nga organet e pushtetit, andaj një demonstrim i tillë nga të dyja anët e sokakut, qoftë spontan, qoftë i organizuar, nuk mund të merret me mend, ngase, jo vetëm ligjshmëria shtetërore brendaqytetit, por edhe vetë edukata familjare e kohës (edukatë patriarkale e fetare shqiptare muslimane po edhe katolike, nuk do të lejonte që fëmijët e të rinjtë e aq më tepër “bullat” (gratë muslimane!) të shfaqeshin para karvanit të serbëve me provokime të tilla rrugaqërie, apo jo?!

Së treti, siç po shihet teksti në shqipe, që sigurisht është shënuar më vonë nga ndonjë informator shqipfolës po gjithsesi i pashkollë, i cili nuk ka ditur ta korrigjojë shënuesin, i cili, siç dëshmohet nga gabimet e shumta në të shkruar të këtij teksti, ai si shënues shihet që nuk kishte njohuri as fillestare për shqipen dhe nuk ka pasur qëllim hulumtimi filologjik për gjuhën shqipe, ndoshta as të bëjë ndonjë krahasim në raport me serbishten, apo jo?!

Së katërti, pikërisht, siç e shohim ne, edhe në këtë shkrim, nga përzgjedhja ose theksimi i vargjeve nga konteksti del qartë qëllimi i autorit, që kishte detyrë të paradhënë: me mjellë e me nxit urrejtje antishqiptare nga lexuesit serbë e të huaj. Kështu nga fantazia e tij e bujshme u sajua kjo temë (ngjarje) dhe në këtë mënyrë, kryente detyrën për të nxjerrë si *provë shkrimi rrugaqërinë e shqipëve dhe familjeve të tyre*, të cilët gjoja ishin pothuaj njerëz të egër, të padisiplinuar, arrogantë e të paedukuar familjarisht siç i paraqet ai dhe ishin aq të pafytyrë, por të lirë nga turqit (pushteti) që të provokonin, të shanin e të gjuanin me lloç e gurë **pop** e **shkje** (serbë) deri edhe Patrikun, apo jo?!

Së pesti, prej nga fjala *dinja* me koncept *pjepri (shalqini)*, në gjuhën e shqipe si fjalë pejorative? Si fjalë sharëse zakonisht në shqipe përdoret fjala *kungull (kryekungull)* në serbisht *tikva tikvan!*

Fundja, sido që të ketë qenë, ne duke u nisur nga fakti se “ku ka zë s’është pa gjë”, duke e admiruar e mos e gjykuar autorin për venerimet e tij për vjershëzat e këtij zhanri, nuk mohojmë ekzistimin e vjershëzave të tilla ngucakeqe që në ambiente të caktuara nxisnin përçarje

ndërkonfesionale brendashqiptare (muslimanë, ortodoksë e katolikë) gjithsesi në gjuhën shqipe.

Sipërfundim i këtij nënkreu

Në këtë pjesë nënkrye u konfirmua kontributi i Milojeviçit si përkthyes-përshtatës i disa vargjeve ose i fjalëve të dy vjershëzave, ku u manipulua jo pa sukses, para 150 vitesh, me përkthim barasvlerësie në të dyja gjuhët shqip-serbisht. Sidoqoftë, edhe nga ky veprim i vogël në dukje vërtetohet fakti që Milojeviçi, qenka ballafaquar që në fillim me gjuhën shqipe dhe atë ballafaqim e paqëllim e shndërroi kontribut si prijatar duke shënuar fjalësh e shprehjesh deri edhe këngë në gjuhën e shqipëve, të cilët donte t'i asimilonte. Mirëpo, meqë as azbuka serbe cirilicë, fyti i ngushtë e serbishtes nuk mund ta absorbonte gjuhën shqipe, e cila edhe pse e plandosur kishte histori e ngjallim aktuale, andaj nuk mundi ta gëlltiste jo serbishtja e Milojeviçit, por asnjë gjuhë tjetër, të ashtuquajtura të mëdha.

Sidoqoftë disa fjalë, por edhe ndonjë shprehje nga kjo pjesë nënkreu do ta trajtojmë fill, pasi të njihemi me **Sifjalorthin** dygjuhësh shqip-serbisht, të cilin për të parën herë po ia bëjmë të njohur opinionit lexues dhe studiuesve në nëkreun vijues.

NËNKREU IV RRETH SIFJALORTHIT DYGJUHËSH SHQIP-SERBISHT 1873)

Sqarime paraprake

Për ne ka qenë befasi e rrallë, kur rastësisht hasëm në botimin pothuaj të plotë nga origjinali i pjesës së tretë të Putopisit, ku ishte i botuar një grumbull fjalësh shqip të pëckthyera srbisht dhe për fat atë grumbull fjalësh që e quajta **Sifjalorth** për fat e fotokopjova, sepse në asnjë rast tjetër në internet nuk po del i botuara ky sifjalorth. Po në këtë pjesë (treca sveska) hasa edhe në të dhëna të tjera që nuk i fotokopjova dhe të do të dëshiroja t'i konsultoja, teksti integral në serbisht nuk po botohet, vetëm pjesë të seleksionuara, gjithsesi pa **Sifjalorthin shqip-serbisht**.

Sidoqoftë, para se ta japim tekstin e plotë të këtij Sifjalorthi, e shohim të nevojshme të bëj me dije lexuesin me Parathënien (Predgovor) dhe sqarimin që e jep autori lidhur me vështirësitë rreth botimit të këtij

vëllimi, të cilin siç e sqaron në parathënien e shkurtë (që ne po e japim në origjinal me përkthimin tonë) na njofton se atë e shkroi Ditën e Pashkëve (Uskrs) 1877, shqoqëruar me këto të dhëna, të cilat vërtet zgjojnë interes:

Predgovor

Ову свеску није ми хтело Срп. уч. друштво помоћи због својих материјалних незгода, те сам је о сопственом трошку напечатао, држећи да ће ме наша, српска публика својски подпомоћи. —Дело је ово дато у штампу још пре 4 год. па због многих послова, за прошле две године, и ове због мог бавлења на граници, сад је тек готово. У мом бавлењу на граници изгубили су се неки табаци рукописа, а прибележака немам да их надокнадим, те тако излази неподпуно нарочито о Призрену. Осим овог немам кад назначити печатње погрешке, те молим г. г. читаоце и читачице да их сами, изволе поправити где примете, а кад сав Путопис дела праве Србије, којег има 12 књига, изиђе, ми ћемо ставити. у последњој књизи и регистар и поправке погрешака.

На Ускрс 1877 год. у Београду. М.. С. Милојевић

Parathënie

Për këtë libër nuk ka dashur me më ndihmë Shoqata e dijetarëve serbë për mungesë mjetesh, andaj do ta botoj me harxhime vetjake, duke shpresuar që publiku ynë serb sinqerisht do të më shpërblejë. Kjo vepër është dorëzuar në shtyp para 4 vitesh, por për shkak të shumë punëve nga dy vitet e kaluara dhe për shkak të angazhimit në kufi, vetëm tash është gati. Gjatë angazhimit tim në kufi më kanë humbur dy tabakë të dorëshkrimit, ndërsa shënime nuk kam për t'i kompensuar, andaj (vepra) do të dalë jo e plotë, sidomos mbi Prizrenin. Përveç kësaj nuk kam kohë me i përmirësue gabimet e shtypit, andaj lus lexuesit e lexueset e nderuar që ku t'i vërejnë gabimet korrigjimet le t'i bëjnë vetë, ngase kur të botohet tërë Udhëpërshkrimi nga pjesa e Serbisë së Vërtetë, që përbëhet prej 12 vëllimesh, në librin e fundit do të vendoset si shtojcë: Regjistri i korrigjimeve.

Beograd, më Pashkë 1977. M. S. Mилоjevic

Ku siç po shihet veprën e kishte ofruar për shtyp para 4 vitesh (më 1873), mirëpo Shoqata e dijetarëve serb, nuk e kishte ndihmuar, gjoja për mungesë mjetesh, kështu ky vendos ta botojë me shpenzime vetjake, duke

shpresuar se do të shpërblehet nga opinioni serb. Por meqë 2 vjet ishte i angazhuar në kufi, ishte zvarritur botimi, madje, siç shpjegon ai, sa ishte në kufi (në frontin e luftës) i paskan humbur disa tabakë dorëshkrimi, sidomos lëndë që kishte të bënte me Prizrenin, por sidoqoftë tani (më 1877) ky po e dorëzonte veprën në shtypshkronjë, i cili pa vonesë edhe del nga shtypi.

Sido që të ketë qenë, nuk mund ta dimë ishte plotësisht i saktë për 9 vëllimet të mbetura dorëshkrim të *Udhëpërshkrimit*, por nga vëllimi i tretë, edhe pse i paplotë, kemi ndeshur material me vlerë për shqipen që do ta vëmë në dukje në këtë krye të vështrimit tonë, vëllim ky i botuar në vazhdë të ndërmarrjeve ushtarake gjatë Luftës serbo-turke, ku mori pjesë si epror ushtarak vetë Milojeviçi.

Në këtë paraqitje rreth veprimtarisë së Milojeviçit nuk dimë sa patëm të drejtë që këtë grumbull fjalësh shqip-serbisht që po e prezantojmë pak më poshtë ta quanim siç doli në titull: **Sifjalorth dy gjuhësh shqip-serbisht (1873)**, andaj kërkojmë që edhe ky guxim yni të vlerësohet, edhe pse këtë guxim tonin, fillim e mbarim, gjatë shtjellimit të këtij nënkreu do të përpiqemi ta arsyetojmë. Jo vetëm kaq. Po kërkojmë, gjithashtu, edhe pse kemi bindjen që qëllimi i autorit nuk ishte i tillë, sa është e drejtë edhe përpjekja jonë që këtë sajësë të tij ta prezantojmë me vlerësimin: ***kontribut me pa hir në e për të mirë të gjuhës shqipe***.

Në të vërtetë autori, Milojeviç, është shumë konrtavers, paradoks i njëmendtë në veprime ndaj gjuhës shqipe, në njerën anë, kur e injoron dhe e përçmon gjuhën shqipe, ai tregon veten se ishte argat i verbër deri në skajshmeri i Naçertanies (1844), kurse në anën tjetër, kur shqipen e lashtë nuk e sheh aq keq në kohëhapësirë nga ana diakronike, por as në disa raste konkrete edhe sinkronike mund të themi se ai bëhet agat i shqipes, ngase kontribuon sadopak mbase me pahir në të mirë të saj. Kështu themi, ngase sipas tasaj që prezanton autori del se në të kaluarën e afërme shqipja, kishte pasur aftësi të jashtëzakonshme, edhe pse nuk ishte gjuhë shtetërore as sakrale, po kishte aftësi të asimilonte në Kosovë e më gjerë një masë të madhe të etnisë serbe, siç i konsideronte ai *poturët shqipfolës (!)*, madje konkretisht edhe në raporte barsvlerësie sinkronikisht shqipja aspak nuk i del gjuhë amorfe, kur faktikisht në Sifjalorthin e tij, përzgjedhi nga baza shqipfolëse afro 350 fjalë e shprehje, të cilat, siç do të shohim ndaj baravlerësve të serbishtes aspak nuk dalin nën nivel shprehjesh sistemore ndaj serbishtes së përpunuar, përkundrazi,

siç do të shohim, në disa raste shprehjet e fjalët e shqipes edhe avancojnë kulturalisht për nga universaliteti i të shprehurit të nocioneve.

Sidoqoftë, meqë, punën e tij jo aq prej përkthyesi, sa për përzgjedhjen ose të shënuarit fjalëve dhe të shprehjeve, ne e quajtëm *kontribut me pahir në e për gjuhën shqipe*, patëm të drejtë apo jo, kërkuam që edhe ky guxim yni, të vlerësohet, ndërsa ne për t'u kuptuar më mirë qëllimi i shprehur i autorit në njërin anë dhe të cilësuarit e lëndës së përzgjedhur në gjuhën shqipe si kontribut me pahir në të mirë të gjuhës sonë, në anën tjetër, tani po e prezantojmë këtë punë të Milojeviçit, jo thjesht si lëndë Sifjalorthi, por të vështruar paksa me gjerë, të trajtuar sipas këtyre nëntitujve:

- 1) Paraprovë euforike të një mal serbizmash toponimastikë etj. nga trevat prej nga vijnë, sipas autorit, edhe fjalët e *Sifjalorthit dygjuhësh shqip-serbisht*;
- 2) Prezantimi i Sifjalorthit me disa sqarime e vërejtje;
- 3) Trajtimi lëndës, shikuar nga pikëvështrimi i të metave formale e subjektivo-objektive të Sifjalorthit,
- 4) Vlerësimi i këtij Sifjalorthi si *kontribut me pahir në e për gjuhën shqipe* dhe
- 5) Përmbyllje e shkurtër e rezultatit nga analiza e disa shembujve fjalë-shprehjesve me vlerë të veçantë nga ky Sifjalorth.

1. Paraprovë euforike të një mal serbizmash nga trevat që citohen nga autori ku gjoja janë vjelë edhe fjalët e Sifjalorthit shqip-serbisht

Meqë Sifjalorthi duket se del si një sajese shtojcë spontane në kuadër të vëllimit të tretë të veprës *Udhëpërshkrimi nga një pjesë e Serbisë së Vërtetë të Vjetër* (1873), sepse nuk lidhet drejtpërdrejt me temën Serbi e Vërtetë (Kosovën) sipas titullit të veprës dhese kemi të bëjmë me një paraqitje në një atmosferë të përgjithshme euforike, ku autori duke vazhduar me *trillim-argumentime* rreth mbizotërimit të një mal serbizmash toponimastike etj., që gjen gjithkund, cep më cep, trevave të Rumelisë (Turqisë europiane), nga Thesalia, Epiri, Maqedonia, Albania, ku jetonin ortodoksë: grekë, bullgaro-maqedonë, vllahë dhe një shumicë **shqipësh**, treva këto që sipas Naçertanies duhet t'i përkisnin Serbisë së ardhshme, ide që e kishte përqafuar edhe Milojeviçi, Serbi e Vërtetë e Vjetër jo vetëm sipas të drejtës historike të trashëguar nga dinastia

nemanjide (shek. XIII-XIV), por, sipas autorit, edhe për nga parahistoria, ngase, sipas mendimit të Milojeviçit (kjo është *shtojcë –shpikje* e tij) këta popuj duhet të jenë rezultat i njëfarë simbioze e serbëve të lashtë, ngase serbët kishin qenë banorë të padiskutueshëm më të hershëm të këtyre trevave, d.m.th. përpara grekëve e latinëve, makedonëve, shqipëve etj etj., prandaj, pasi bullgarishten e quante gjuhë serbe, pikërisht këtë kontinuitet ai përpiquej ta vërtetonte në misionin e tij edhe nëpërmjet fosil-fakteve si mbetje të gjuhës së lashtë serbe (sllave parakishtare), fakte këto të cilat edhe nëse nuk i gjente i fantazonte dhe çdo shenjë-sajesë që e kishte maje imagjinatë e hipërbolizonte.

Mos me zgjatë, meqë në këto troje jetonte si shumicë populli shqiptar me gjuhën e vet josllave, atëherë Milojeviçi, gjithsesi shqiptarët dhe gjuhën shqipe përpiquej me paraqitë nën hije të serbishtes së lashtë dhe të sotme.

Kështu për të *Arnautski Beligradi*, ishte një provë-argument që e kishte më për zemër, sepse ky emërtim sllav vinte me etimologji të pastër serbe nga “*beli grad*”, dmth, me prejardhje të hershme serbe, etimologji shkencërisht e pranuar si sllavo-bullgare, emër, të cilin *shkipët*, në gjuhën e tyre, e *përshatën* në **Berat**. Në të vërtetë fjala **berat** është term islam që quhet **Nata e madhe e Beratit**, dita 15 e muajit shaban, 15 ditë para fillimit të muajit të ramazanit, “*kërkim lutje pafajësie*”.

Përmenmd bashkë me Beratin (Beligradin) edhe *lumin* Dunavac si emërtim serb (edhe pse **dunav* (uji i madh) shpjegohet me prejardhje nga lashtogjermanishtja, të cilin shkipët e paskan *përkthyer* në *Lum*, por të cilin në Elbasan, po e quajkan *Dunaflit*!).

Sqarim preference: Po emërtimin **Lum** në shqipe *për Apsusin e lashtë* e paravërtetonte më 1850 edhe

udhëpërshkruesi Edmund Spenser, kur e kishte vizituar Beratin ose *Antripatrian e lashtë*. (Shih Durim Abdullahut, Koha ditore d. 20.07. 2018, f. 1.)

Sidoqoftë, po në këtë vazhdë euforike, për të përforcuar me një mal dëshmish trashëgiminë serbe(!), autori Milojeviç, shënon afro **150 emërtime toponimesh** (serbe!) nga ato treva, madje shton si provë edhe nja **30 fjalë**, sipas tij, gjithsesi “*të pastra serbe*”, si: *zakon, kosë, shatorr, gunjë* etj. të cilat në Epir e Thesali u përdorkan aktualisht *nga grekë, cincarë e shqipë...* Kështu pas kësaj euforia *serbizmash*, të cilat shkenca i nxjerrë të diskutueshme ose të pasakta, autori gjen rastin të shfaqet edhe si njohës edhe i gjuhës së *shqipëve (!!!)*, duke prezantuar një grumbull

fjalësh shqipe, të cilat i përkthen serbisht, duke i parashoqëruar përbuzshëm me këtë tekst-sqarim:

U Arnauta ili Škipitara, ond. i svoj dan. Albaniji i Epiru osim ovih korenih, njihovih galskih, stari skitskih, grčkih i rimskih reči, nemaju drugih svojih, no se služe samo čistim srp. A te su prave njihove reči ove:

Përkthimi ynë:

Arnautët ose shkipitarët e dikurshëm dhe këta të sotmit të mitë në Albani e Epir, veç këtyre

fjalëve me rrënjësi: gale, lashtoskite, greke dhe romake nuk kanë fjalë të tjera të veta, andaj,

shërbehën vetëm me fjalë të pastra (të kulluara) serbe. Sidoqoftë, këto janë fjalët e tyre të vërteta (!).

Sqarim 1

Këtë grumbullim fjalësh që ne e quajtmë **Sifjalorth shqip-serbisht i Milojeviçit (1873)**, po e japim të fotokopjuar në vijim si nëntitull të veçantë, duke e trajtuar në 5 rubrika:

1. Numri rendor, i praktikuar prej nesh.
2. Barasvlerësi i zbrëthyer sa që e mundur prej nesh në shqipen e sotme, duke u bazuar sidomos në barasvlerësit serbisht.
3. Originali shqip sipas versionit të autorit në cirilicë (i fotokopjuar).
4. Originali serbisht sipas versionit të autorit në cirilicë (i fotokopjuar).
5. Ndonjë vërejtja a sqarim rreth qëndrueshmërisë barasvlerëse dhe sinonimike e të tjera rreth trajtë-fjalës origjinale të shqipes.

Sqarim 2

1. Të gjitha fjalët ose trajtat në serbisht në latinicë, janë përdorur si sqarime prej nesh.

2. Siç u cek, ne, përveç numrit rendor, në rubrikën e dytë shënuam, sa që e mundur fjalët e zbrëthyer në shqipen e sotme (ndonjë edhe arbitrarisht), sepse, siç mund të shihet teksti gjoja shqip i autorit, me shkronja cililicë, shumicën e shembujve nuk i shkruan drejt. Ka edhe mungesa të tjera përveç asaj që nuk ka përdorur shenja të veçantë për tingujt e shqipes që i mungojnë *azbukës* serbe.

3. Paskajoren e serbishtes e kemi shënuar me paskajoren e mirëfilltë të shqipes.

4. Të gjitha shenjë-sqarimet me mbiemrin: **srp.** (*srpski, srpsko, srpska*) që e jep autori për të treguar se fjala përkatëse ndërlidhet ose ka preardhje serbe, i kemi vënë si vërejtje në rubrikën e katërt.

2) Lënda e Sifjalorthit shqip-serbisht (1873)

Nr. Rend. 1	Shqipja e sotme 2	Originali shq. qirilicë 3	Orgjinali serb qirilicë 4	Vërejtje 5
1.	Cjap	Чап (кап)	јапац	ç/k-c/s: cap, sjap (dial.)
2.	Dru	Дру	Дрво	M - trajtë e pashquar
3.	Flakë	Фљака	Пламен	F - trajtë e shquar
4.	Thëngjillt (i)	Франгди	Угљен	Th/ fr ?
5.	Kërcell, Kërc	Крч	Стабло	-c/ç
6.	Natë	Нокта или Нота	Ноћ	a/o
7.	Dreq	Треч или Дреч	Ђаво	t/d
8.	Dimër	Тимар	Зима	d/t dhe t/z?
9.	Me shtrakatë! (thurë, kërrabzue)	Штракат	Плести	Fjalë e re në shqipe: shtrakat
10.	Shenjtë (i)	Свјент	Свети (ова је српска)	she/svj... ??
11.	Rus? (i tmerrshëm)	Рус	Грозан	Me tendencë !!!
12.	Rrip, brez	Риуп	ремењ, кајиш	iu/y
13.	Purtekë	Пуртека	прут (српска)	pur/pr!?
14.	Frikësoj, përulem (N'besë tande!)	Пентан	Плашим, пудим У поверенју!	fjalë e pakuptueshme
15.	Njeri	Нери	Човек	Nj/n
16.	Burrë (djalë)	Бир	муж (sin)	i/u, i biri
17.	Grua	Груо	Жена	*uo - ua/ue

18.	Vajzë	Вајза	Девојка	F- trajtë e shq.
19.	Me pa (shih)	Шиф	гледати,	geg. shif, f/h
20.	Ari-u	Ари	међед, medved?	?
21.	Afër	Афер	Близу	
22.	Ballë	Бале	Чело	
23.	Baltë (dhe, vendi)	Балте	Земља, blato	
24.	Me pjekë	Бјек	Пећи	p/b
25.	But (kofshë) ose butë	Бут	Њога (but, noga?) Меко	2 koncepte
26.	Varfër (të)	Варфере	Сиромашни	Tosk. *varfërË
27.	Vapë	Вапе	Топли	
28.	Vjehërr, (vgis-heri?)	Вгисхери	Свекар	trajtë-fjalë e shkruar gabim
29.	Shok, mik	Шок, Шокац	друг пријатељ	neol. shokac (mik)
30.	Begatë (të)	Вехате	Богати	b/v??
31.	Vesh (veshë, me veshë)	Веш	ухо, (српски) и одевати	Shkrimisht homonim në në serbishte
32.	Viç (*vit, njëvitshe)	Виту	Теле	-ç/t-u
33.	Ju	Гју	Ви	G- e tepërt ?
34.	Gjashtë, g- jashtë	Гјаште	Шест	GJ / lokalizëm: G-j
35.	Gardh	Гарде	Ограда	-Dh /-d-ë
36.	Gati	лати!	готови (српски)	G/L? srps.???, gabim shtypi
37.	Gjarpër	Хјарпер	Змија	Gj/ Hј?
38.	Dhëmb	Деми	Зуб	DH /D; mb/m
39.	Emër	Емере	Име	*EmërË, tosk. vj.
40.	Asht (eshtër)	Еште	Кост	tosk.?
41.	Zonjë, grua	Зања	Жена (српска) Gospodja	o/a srp. ?

42.	Thëngjill (thingill), djegie pa flakë	/Тингил тињати) gacë e shuar – thingill	угаљ, (српска)	Th/t gj/g. serb. ?? Lok. Thingill
43.	Me hangër, me ngrënë (me ishte !)	Иште	Јести	Fj. e pakuptueshme
44.	Ка	Ка	Во	М – fjalë e pashq.
45.	Kalë (hipur në kalë)	Ипи Кале	Коњ	Hip (kalë) , l/l
46.	Kush	Куш	Ко	
47.	Kurm (trup)	Курм	телo, truplo	
48.	Krimb	Кримп	Црв	Mb/mp
49.	Krye	Крие	Глава	y/i
50.	Dru (Lis)	Лиш	Дрво (hrast)	l/l dhe s/sh
51.	Madh (më i)	Мад	Већи	Dh/d
52.	Mal (bjeshkë) /mall	Мал	Планина /ceznja i imovina/	l/l?
53.	Zi (i)	Зи	Црни	
54.	Marrë (i)	Маре	Глупи	Mungon nuja e përр.
55.	Martesë	Маргеса	Брак	?
56.	Mes	Мес	Средина	
57.	Gomar (magjar)	Мађар	Магарац	magjar /maxhar??
58.	Mish, muskul	Мише	месо (срп. мишић)	mish – misic???
59.	Mot (vit)	Мат	Година	o/a
60.	Nuse	Нусе	Снаха	
61.	Vjehërr (njeri)	Виери	Човек (svekar)	j/i dhe rr/r
62.	Merr vesh (di)	Вех	Зна	??? fj. jo e plotë
63.	Rrush	Руш	Грожђе	Rr/r
64.	Zotni (sifer), sefer/ arab. i nderuar!!!	Сифер (!)	господин (од Срб, Србин)	Tendencë vetjake!

65.	Posi, si	Си	ако, kako	barasvl. jo adekuate?
66.	Me mbytë, turp??/?/	Турп Вр а!!!,	Убијати (stid)	Barasvlerësi jo e saktë
67.	Ujë	Уге	Вода	g/j, ugë ?! gabim sht.
68.	Fashna (shami)	Фашне	Марама	shumësi –ne/-na?!
69.	Armë	Арме	Оружје	
70.	Armik (djall)	Армик	враг, непријатељ	Tosk.
71.	Verdhë (e)	Верде	Зелени	dh/d
72.	Fitore	Витора	Побједа	f/v
73.	Ngushtë	Нгуште	Узан	
74.	Gjel	Хјел	Петао	gj/hj
75.	Grigjë	Грик	Стадо	Gj/k ??
76.	Egër (të), egërsisht	Егре и Егресист	Дивљи, divljacki	??
77.	Argjend	Ержент	Сребро	Gj/zh
78.	Qen	Кен	Псето	q/k
79.	Korb	Кари?	Гавран	o/a; b/i... gabim shtypi
80.	Kudhët (i), farkim	Кудере?	наковањ	Kudh / kud(h)... ???
81.	Haraç (xhymryk?)	Кумерк	Данак	??? fj. e paqartë
82.	Gjerë(i), Larg	Љарге	Широки, (daleko)	ngatërresë barasvlerësie? ?
83.	Këndoj	Канух	Певам	-nd/n
84.	Mend	Менте	Ум	-nd/nt
85.	Lëpur	Љепур	Зец	
86.	Mik	Мик	Пријатељ	
87.	Mollë	Моле	Јабука	
88.	Mort	Март	смрт (старо српска)	o / a lat.
89.	Paqe	Паће	Мир	
90.	Pemë	Пеме	воће	
91.	Me grabitë, me u	Ропа	грабити (срп. робити)	

	ropë, me robërue			
92.	Sipër (mbi)	Сипер	Над	
93.	Shëndet	Шентет	Здравље	-d/t
94.	Shenjtë (i) Shenjti-, Shin-	Шент, Шелнхт и Шин	Свети	Sh/s sv ?
95.	Shërbëtor	Шерпетор	Слуга (српски)	/serb / serv!!, b/p
96.	Shigjeta	Шухета	Стрела	i/u?, gj/h
97.	Turp	Турп	Стид	
98.	Tra	Тра	Брвно	
99.	Faqe (fytyrë)	Факе	Лице (obraz)	q/k
100.	Hark	Харк	Лук	
101.	Të kam pa(rë)	Кампа	видео сам те	geg.
102.	Me mendue (ka menduor?!)	Камандуор	Мислити	* uom /uor?? R- Tosk,
103.	Rino! (lind)	Руно	Роди	E pakupt.; i/u
104.	Shkruaj e qëndis	Шкро	пиши и вези	Shkro??
105.	Me rrëmihë, vezirmo?!	Везирмо	Копати	Vezirmo - fj. e pazbërth.
106.	Parmend	Пен	Рало	jo e plotë
107.	Bir	Бир	Син	M - trajtë e pashq.
108.	Bijë	Бија	Ћерка	F – trajtë e shquar
109	Fëmijë (voc e djalë)	Вак и ђал	Дете	vak?, e paqartë
110,	Meshkull	Машкул	мушко, (српски)	Lat.
111.	Femën	Темен	Женско	f/t/ geg.
112.	Borë	Бор	Снег	
113.	Shi	Ши	Киша	
114.	Gur	Гур	камен, (срп: гора)	???
115.	Ujë	Уј	вода	

116.	Drithë /dritë	Дрита	Жито /svetlo	Barasvlerësi jo e saktë shkrimisht th/ta
117.	Dërrasë (pllakë)	Драса	плоча, даска	
118.	Lugë	Љуг	Лажца	
119.	Thikë	Тика	Нож (српски)	t/th
120.	Shtrat (tshtruemt), Tshtyemt	Тштуум	Постеља	Nyja e asnj.figuron Tshtuum!
121.	Shtëpi	Сштпија и Шпија	Кућа	Trajta e parë e gabuar!
122.	Diell	Дјел	Сунце	ie/ je
123.	Akull	Акул	Лед	
124.	Pokjo (qeknej!)	Чнеј	То	? e pa qartë
125.	Me vrapue, vrik	Врик	Трчати	? barasvl. jo e plotë
126.	Me kalërue, hipur në kalë)	Ипе кал	јахати коња	I/II
127.	Dhen, dele	Дије?	овца (dele)	Ngatërresë dele/dhi
128.	Dhija	Длен?	коза (dhi)	Ngatërron dhi/ (dhen)
129.	Dhëndërr	Дландр	Зет	Dh/dll
130.	Ëndërr	Андр	Сан	
131.	Dasmë, Me dhënë	Дасми	свадба (српска давати)	
132.	Kam porositë, me porositë	Кампросит	получио сам (српска) /I/r	Porosit, serb. Poruciti
133.	Kësulë	Ксул	Капа	I/II
134.	Një (nja)	На	један	Nja/na, gegizëm
135.	Dy	Ди	Два	y/i
136.	Perëndi	Перенди, Перун	Бог (старо српски)	Fryrje tendenc.
137.	Zot	Зот и Стапан	Бог	

138.	Erë	Ера	Ветар	F – trajtë e shq.
139.	Së shpejti, pak më herët ?	Махер	брзо скоро	??? barasvlerësi e Diskutueshme
140.	Më shpejt	Маштет	брже, скорије (обе српске)	Srps.??? p/t
141.	Me fejue /cucën??	Кемфрусуом	запросити девојку	E pakupt./??? /*-uom
142.	Dorë	Дара	Рука	o/a
143.	Këmbë	Камп	Нога	Mb/mp
144.	Gisht	Гиш	Прст	-t
145.	Pëllamb (shpresë???)	Пламб	надао (dlan?), pada	gabim barasvlerësie
146.	Hardhi (vresht)	Внеш	Лоза, vinograd	-th, geg. vn
147.	Flok	Флока	Коса	I/II
148.	Mjekërr	Мекр	Брада	-mj/-m???
149.	Zverk (qafë)	Зверк	Врата (zatiļjak)	fig.
150.	Shpatë (Çiad??)	Чиад	Сабља	Gabim,, pakuppt./ sh/ç, p/i, t/d
151.	Këmishë	Миш	Кошуља	Kë -?? Fj. jo e plotë
152.	Mërtëk (thupër)	Пртек	Пруће (српски)	Pr/pr ??
153.	Derr	Дер	Свиња	Rr/r
154.	Lum	Лум	Река	I/II
155.	Kodër	Кодр	Брдо	
156.	Bjeshkë	Бјешк	Шума	
157.	Det	Дет	Море	
158.	Dardhë	Дарда	Крушка	Dh/d
159.	Udhë	Уда	Пут	F – e shq./Dh/d
160.	Urë	Ура	Мост	Fem.- e shq.
161.	Bardh	Бар	Бело	-dh
162.	Kuq	Кућ	Цвено crveno	
163.	Gjak	Ѓак	Krv/ црвенорујно	

164.	Bojëgjake, bojna	Бојџак	Бојна (српска) или црвенорујна боја	Bojna shumësi geg.
165.	Verdhë (e)	Верд	Жуто	Dh/d
166.	Hasëm (armik)	Асм	Непријатељ	
167.	Orum (grek)	Орум	Грк	“rum” - ortodoks
168.	Brekë	Брека	Гаће	
169.	Rosë	Роса	патка (shotka)	ngatërresë barasvl.
170.	Patë	Пата	гуска (српски)	
171.	Pulë	Пуља	кокош (српска)	Kokoska??
172.	Djall	Џал	ђаво,	Dj/xh
173.	Vdekur (i) (njeri i dektë!)	Нерадек	мртвав (српска),	rast jo i qartë
174.	Venë	Вен	Вино	gegizëm
175.	Groshë	Граш	грах (српска)	o/a, sh/h?
176.	Kaza (nahi)	Каз	област нахија (срп.)	Kaza (turqizëm)
177.	Mera (kullotë)	Маера	Мера	
178.	Peshk	Пишћ	Риба	Pse *pishq ?
179.	Urreje (i lantë!)	Лан	мрзи га	fj. e paqartë
180.	Me u la, u lava	Уљава	измити се /	u- si pjesëz?
181.	Drekë	Дрек	Ручак	
182.	Darkë	Дарк	Вечера	
183.	Me v(n)u / ka nder?	Канери	Ставити / ima cast	Fjalë e paqartë
184.	Me lavrue (laroj!)	Ларо	орати (српска)	?
185.	Kam mbjellë /me pjellë	Кампијел?	посејао сам, roditi se	ngatërresë barasvl. ??
186.	Shumë (boll)	Бол	млого (турска) /l/n	

187.	Farë	Фара	Семе	
188.	Zjarr	Зјал	ватра (српска)	-rr / -ll ???
189.	Bini (qitni) dru	Бинидру	метни дрва	
190.	Ndiz zjarr	дисчин Зјар	наложи ватру	digj e ndiz
191.	Me pi, krua me u krue	Круар (grebenje)	Пити, izvor	Mungesë koncepti, keqkuptim ??
192.	Qengj (dhen)	Ден	Јање / -g-, /ovce	Dh/d
193.	Berr (dash)	Бер	Ован	
194.	Arushë, ari	Руша	Медвед, medvedica	A- apo Ha - ?
195.	Ujk	Ујку	Курјак, vuk!	Pse jo vuk? / uk ??
196.	Dhelpra	Велпа	Лисица	Dh/v ???
197.	Dren	Брен	Јелен	d/b ?
198.	Kaprolle, (drenushë)	Капрен	Срна	Kapren ???, e pa qartë
199.	Grykë (fyt)	Грик	Грло	y/i
200.	Me u pajtue, (e mpetuor ! - financ.)	Емпетуор	помирити се	*uo/r?, / fj. e paqartë ??
201.	Robtë (gjinja shpis	Робод	челја (српска)/-d	???
202..	Gardh	Гард	Плот	Dh/g
203.	Dosa	Доса	Крмача	
204	Lopë	Лопа	Крава	l/ll
205	Shkëmb	Шкамб	Стена	ë/a, geg.
206.	Këmbës/or	Кмбаш	Пешак	-ash /ës/or /ak, neol.
207.	Muaj	Муоје	Месец	/*O, --uo / - ua/ue
208.	Kjo javë ose e djelë	?	Ова недеља	? edhe serb., hom.
209.	E ve (grua pa burrë)	Груа па Бур	удовица,	Grua tosk.

210.	Plakë , plak	Пљак	Баба , starac	theksi?, barasvl. jo i qartë
211.	Kokë	Кок	Глава	
212.	Tërmet (Trem (b) et dheu!)	Тремет де	тресе се земља (српска)	Zemljotres?!, tog interesant!
213.	Dhe /vendi	Де	Земља /mesto	Dhe/de
214.	Ditë	Дита	Дан	F – e shq.
215.	Mirë (i) , (i qetë)	Мир	миран добар (српски)	ngatërresë koncepti??
216.	Mirëdita!	Мириодита	добар дан	-io-?
217.	Gjysma	Ђуема	Пола	s/e??
218.	Fytyrë (faqe)	Фаћа	Образ	
219.	Penë	Пен	Перо	
220.	Dru (каџубë, pajë)	Кчуп	Пањ	-a-, b/p
221.	Derë	Дера	врата (српска)	???
222.	Shkallë	Шкал	Лестнице	?? n/v
223.	Gabim, më fal të më falish	Фалиш	погрешка и опростити	falish kosovarizëm ??? shpr. jo e plotë
224.	Të më falësh	Ма Фалиш	опрости ми	Kosovar.-ësh/- ish
225.	Shtëpi e mbuluar , E m/buluar/a ?	Булуар	покривена кућа	Fj. pa kupt.??
226.	Majëmali (Qafë)	Чафа	врх планине! (vrat)	
227.	Jona? çat??	Чат	Наше	fj. pa kupt.???
228.	Me këndue , këndo	Кндо	Певати	
229.	Mos qani	Мосћане	не/плачи	
230.	T'shtëna! (shtëna!! (me pushkë??	Жчина	пуцајте из пушака	fj. pa kuptim???

231.	U gëzuan	Угзуом	веселимо се	*-uom (arkaizëm)
232.	Gëzoni	Гзони	веселити се	
233.	Rrofshi e qofshi	Рашни Кашни	да смо живи и весели	??k/q
234.	Trim	Трима	Јунак	-a (shumësi i pashq.)
235.	njeri i përunjët, i poshtëm (poshtër)	Јери Пош	Понизан	-i ?? , shprehje jo e plotë dhe e paqartë
236.	Mendtar	Ментар	паметан (од мен памет)	-dtar/- t/ar
237.	Ma fal zot (zotni) (unë kam gabuar)	Ма Фал Зот	опростими ми господин (ја сам погрешно).	zot /tosk,
238.	Faj	Фај	Кривица	
239.	E drejta (drejt)	Дрет	Правда	-j-?? Mung. e nyjës
240.	Tredhë (me), me shky herdhe?	Ђкур езд	Шкопити	?? togfj. i paqartë
241.	Ai	Аји	Он	-j-
242.	Tçava (kokën!), prish	Тчава	Разби	(Ty) të+çava?!
243.	me luftue, luftuar	Левтур	Бој, ratovati	Levtur – /fj. e pa qartë
244.	Ne	На	Ми	Geg.
245.	Yni	Неве	Наш (nama)	
246.	Ju	Ију	Ви	i-ju??
247.	Ata	Ата	Они	
248.	Im (imja)	Имеа	Мој	???
249.	Jotja	Јатија	Твој	o/a
250.	I atij	Ијати	Његов	i/j-
251.	Juaji	Ионж	Ваш	ionzh??? – gab, shtypi

252.	Lyej shtëpinë (kam lyej)	Камлуор	мажем кућу	-lluor /-yor?? Keq kuptim i sist. strukturor
253.	Fushë	Фуша	Поље	F- traj. e shq.
254.	Arë (ari!)	Ари	Њива (zlato)	Ar-/i/a
255.	Vreshta	Вњејшта	Виноград	V – nj (!)
256.	Diell , agim, e djelë	Дијел	зора сунце а и недеља	3 koncepte
157.	U ngrys? , u ndrit?	Унгриу	Свануло	???
258.	Prift	Прифт	Поп	Prift –kat./Pop –ort.
259.	Kishë	Киша	Црква	shq.
260.	Vijë	Вија	бразда (српска)	???
261.	Krua /çeshme	Круа	чесма (чизма),	UA tosk.
262.	Rrahje, breshër, shushlak (mbetje)	Шушљак	туча, град (српска) ostaci, <i>otraci</i>	Barsvlerësi e gabuar?!
253..	Letër (libër)	Летр	Књига, писмо	
264.	Kos (qumësht)	Косо	Млеко, kiselо <i>mleko</i>	-o
265.	Mirë	Мир	Добро	
266.	Keq	Кећ	хрђаво (српска)	Pse ???
267.	Me djegë (digje)	Диче	Запалити	ç/gj
268.	Baltë	Балт	Блато	I/II
269.	Qen, këlysh	Чен и Кен	пас, куче	q-/ç e k???
270.	Pus	Пуц	Кладенац	s/c
271.	Bukë	Бук	Леб /hleb	
272.	Hidhërim (pret/zi)	Предзи	Жалост	të pame ???, pret zi
273.	Brez (shokë)	Бреса	Појас	z/s
274.	Pamartuar (i) (beqar)	Памартуор	Neozenjen ???	-*-uor (arkaizëm)

275.	i lagët	???	Мокар	?
276.	Këpuçë	Кенуц	Ципеле	e/ë ke-/kë, n/p???
277.	Të ngrysurit (pa frymëzim)	Унгрисон	Изпевати	??? Fj. e paqartë
278.	Tubim (kuvend)	Кеми Кувенди	имамо скупштину, сабор	Sinonime
279.	U bë falja	Уфал	оправити се	Pjesëza u ngjitur!
280.	Me u pajtue (U fatua!)	Уфатуали	помирити се	Fj. e paqartë???
281.	Koha	Коа	Време	-h- ???
282.	Kec (një kec)	Никец	Јаре	Njëkec!
283.	Gjuhë	Дђу	језик,	-hë-, f j, jo e plotë???
284.	Shqa (shka)	Шћа	Славенин или слав (роб)	Historizëm, sinonme
285.	Shqijana (shkina)	Шчна	Славенка	neologizëm
286.	Tëmbëlit	Тамл	Сладко	Nyja e asnj.
287.	Djathë	Драфта	Сир	r/j dhe ft /th ???
288.	Gjizë	Ђуз и Урда	Урда (српска) изворок тварог	??? urda e fryrë me tendencë
289.	Gozhdë (peronë)	Перон	Клинац	??? nga gr.
290.	Me mbathë me patkua	Мембат	да поткујемо	t/th, Paskajore e mirëfilltë
291.	Për të mirë! (shëndet!)	Предмир	Уздравље (српска)	Gabimi nga mosnjohja e shqipes
292.	Të bëftë mirë! (shëndet)	Бов ти мир	на здравље (српска)	Gab. nga moskuptimi. i Shprehjes

293.	Kam çarë dru ose thërrmuar gurë	Камчаур дру или гру	цепати дрва, или лупати камен (кам. српска)	Keçkupt. kam çaur(!) (ça ose çarë) dru e thërrmuar gur
294.	Pëllumb	Пломб	голуб,	u/o, -mb tosk.
295.	Ndritu (u ndije!)	Ундије	светли се	Konstrukt i paqartë
296.	Veze /voja /veja	Веза или Вој	јајце, јаје	tosk.veza, /voja, geg.
297.	Tegërt	Тегр	Дивље	Nyja e asnj.
298.	Fëllanza	Фаланча	Јаребица	ë/a; z/ç
299.	Kam fituar	Камфитуар	Добио/сам	Tosk.
300.	Kam fluturuar	Камфритруор	излето сам	*fritruor ???, l/r, arkaiz.
301.	Klloçkë	Клочва	(српска) квочка	-va/-ka?
302.	Sëmunë (i)	Сьмун	Болестан	Ђ – në vend të Ё-së
304.	Shëndosh	Шьидош	здрав	Ђ – në vend të Ё-së
305.	Ethe	Ета	Грозница	th-t
306.	Dhallë??? (/mushtrellek ë ortodokse)/musht	Дал	маћеница, или мошћеница (mlacenica	trajtë dy kuptimshe
307.	Punambarë!	Пуна Бар	срећан вам рад	mb/b
308.	Mbarëpaç	Бар Пач	и ти срећан био	
309.	Qerre (kerr)	Кер	Кола	r/rr
310.	Natën e mirë	Натне мир	лаку ноћ	
311.	U trashëgofsh, me të mira (përfitim)	Утрашенгов ш	да је благословен о користо	f/v
312.	Gëzuar (i)	Гчзуор	Радостан	*uom /uor (arkaiz.)
313.	Na ka zbardhë	На Казбарт	урадио посао како ваља	dh/t

	(me punë)			
314.	Hënë	Хана	Месечина	geg. F- trajtë e shquar
315.	Hyll	Јул	Звезда	h/j
316.	Gomar	Мађар	Магарац	lokalizëm . Magjar
317.	Babai i gomarit gomar	- осел, Бобаин Мађар	отац мацаревим магарчев	Manip. me srb. <i>magjar</i> (hungarez), dallon gj/xh
318.	Kalë (i kuq) - dori	Ткућ и Дори	Дорат	Ткуќ
319.	Kali vranç	Кали	Вранац	I/II
320.	Kali i bardhë- gjok	Бал или Ђог	Ђогат	Rdh/II, k/g
321.	Plumb	Пљумб	Олово	M –trajtë e pashq.
322.	Copë	Цап	Комад	o/a
323.	Rëndë	Ранд	Тежак (српска)	Pse srps.???
324.	Kohë e rëndë /zaman/ose shekull	Ранд замани	тешко време, или век	Zaman orientalizëm.
325.	Na ruajtë zoti i vjetër Stapanj ose feja e vjetër	Наров Стапање вјетри	да сачува стари бог Стопан, или вера стара(српска)	Rast i sajuar me tendencë???
326.	Pe	Пен	конац, крај	Gegizëm
327.	Lule e lale (lale-lalje)	Луле и Лале	Цвеће	I/II shprehje shqipe
328.	Bilbil (zog)	Зук	Славуј	o/u, g/k
329.	Bilbili (zogu) na këndon	Зук на књндоп	славуј пева	u/o ъ – në vend të ë-së
330.	Tym	Думан (српска)	Дим	srp.???, duman turq.
331.	Shpend	Зок	Птица	k/g

332.	Arrë	Ара	Ораси	Rr/r, F- trajtë e shquar
333.	Fe	Фе	Вера	
334.	Lakra e laknor	Лакра и Лакуор	купус, lukuvaça	llakuor??? n/u
335.	Mulli	Мула (српски)	Воденицај	Mulla/i srp???, lat.
336.	Miell	Мијел	брашно (српско),	-ije/ -ie??
337.	Mbret, perandor	Емрет	Цар	E/mret???, mb/mp
338.	Princ, mbret	Дукадин,	краљевац, краљ	Gj/d
339.	Shtëpi /etj./	Шпиа	кућа /и т.д.	

Ja, lexues i nderuar, ky ishte ai grumbullim fjalësh, të cilin ne e quajtmë *Sifjalorth shqip-serbisht*. Patëm të drejtë apo jo, le të vlerësohet, por sidoqoftë autori e përfundon me etj. (*i t.d.*), përkatësisht i passhoqëron këtë grumbullim fjalësh me këtë tekst-sqarim, gjithashtu përcmues:

Мисмо из свог икипског језика пробрали ово 246 њихових правих речи, па и у њима има, осим погдеокоје грчке и латинске, још и српских 35 речи. Све остале речи икипског језика несу ништа друго: до готово све само чисте и праве српске речи нарочито кад се од њих одузму, грчке, турске, латинске и т.д.: Ами Бује у свом делу (La Turquie d'Europe у 2. свесци стр. 42—5.) набројава речи у икипитарском из лат: фр: нем: грч: тур: срп: санскр: влаш: и т.д: језика.

Përkthimi ynë:

/Ne nga gjuha ime shkipe kemi përzgjedhur këto 246 fjalë të tyre të vërteta (Në tekst janë 339 fjalë e shprehje n. v.), edhe pse ndër to, përveç ndonjë fjale greke e latine ka edhe nja 35 fjalë serbe. (Në tekst si serbe siglohen 44 shembuj n. v.) Të gjitha fjalët e tjera të gjuhës shkipe nuk janë tjetër, por, pothuaj të gjitha fjalët të pastra të vërteta serbe, natyrisht, kur prej tyre heqen ato: greke, turke, latine etj. Ami Bue në veprën e tij (La Turquie d' Europe vëllimi i dytë, f. 42-5) në shkipe llogarit fjalë nga: latinishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, turqishtja, serbishtja, sanskritishtja, vllahishtja e gjuhë të tjera..

Pra, pas këtij prezantimi ne, nga lexuesi e sidomos nga studiuesit na mbetet të kërkojmë me vlerësue, jo vetëm materialin nga ky Sifjalorth, por në këtë kontekst edhe ndihmesën tonë si prezantues, ngase nuk e themi për ndonjë retorikë, por është e vërtetë se më mungon përvoja filologjike për prezantime të tilla, madje, pos internetit, nuk kam pasur mundësi ta konsultoja as dosjen e autorit, as shënimet e ditarit, as letërlibërtimin e veprave etj. Nuk dimë ekziston ndonjë fakt, kur dhe më kë u konsultua autori për gjuhën shqipe. Cilat të dhëna i mbeten në dorëshkrim etj.?! Kështu pyesim sepse vetëm njëherë kam mundur në internet me ndeshë të botuar veprën III me këtë Sifjalorth, sepse në raste të tjera nuk po botohet ky tekst, madje po hniqet edhe emërtimi shqip shqipët e fjalë të tjera a shqipe edhe pse thuhet se po jepet (ribotohet e po shitete komplet vëllimi III (III sveska) kinse në origjinal!, prandaj më shkon mendja se punën e këtij punëtori të madh me fantazi të bujshme e kanë shfrytëzuar pasgarashaninët vetëm si mjet propagande. Kështu, duke “i ndihmuar” e mbase do ta kenë futur në teprime e falsifikime për interesa të projekteve të paracaktuara të politikës serbomadhe të tyre, apo jo?! Konkretisht edhe lidhur me shqipen e shqiptarët prej nga lindi edhe Sifjalorthi shqip-serbisht nuk pati kurrfarë ndihme as synim-qëllim të mbarë, prandaj Sifjalorthi i doli, i papërpunuar fare, sidomos teksti shqip, i cili, vështruar pa hile, pa marrë parasysh të metat, sot zgjon interes për vetë faktin se është sajuar me lëndë të para 150 vitesh dhe me përmbajtje të gjerë. pothuaj nga të gjitha fushat e nënfushat e jetës, fjalë e terma nga jeta baritore-blegtorale, malore-bujqësore, fetare e deri shtetërore, andaj nuk dimë arsyen pse deri më tash nuk është trajtuar nga askush, as nga serbë as nga shqiptarë as nga të huajt, madje pse jo në periudhën titiste të *vëllazërim-bashkimit*(!) e më vonë, apo jo?!

Sido që të ketë qenë, pasi e dhamë të fotokopjuar dhe të para- e të passhoqëruar me tekst-sqarimet përkatëse përçmuese të autorit, duke mos harruar atmosferën euforike që e parashoqëronte, tani na mbetet të vështrojmë këtë *Sifjalorth*, më në hollësi duke vënë në pah:

së pari, **të metat** formale e subjektivo-objektive të Sifjalorthit dhe

së dyti, **kontributin me pahir** që del nga ky Sifjalorth në e për gjuhën shqipe.

Kuptohet që lajthitjet por edhe kontributi që i mvishet këtij fjalorthi i referohen sajuesit të tij, z. Milojeviç.

3) Venerimi e vlerësimi ynë konkret rreth paragënjeshtave dhe të metave formale e subjektivo-objektive të Sifjalorthit shqip-serbisht (1873)

Nga prologu dhe epilogu, përkatësisht ngas tekst-sqarimet që para dhe pas e shoqëronin këtë grumbullim fjalësh të përkthyer shqip-serbisht që ne e quajtmë *Sifjalorth dygjuhësh shqip –serbisht*, kuptojmë qëndrimin tejet injorues e përbuzës të autorit ndaj gjuhës shqipe. Madje, e themi me keqardhje, ky Sifjalorth, përveç të metave të shumta dhe të rënda formale e subjektive materiale, siç e pamë edhe në sqarime, shërbehet me konstatime të pavërteta (gënjeshtra) të paskrupullta, kështu:

së pari, do të përmendim disa nga gënjeshtrat e paskrupullta me të cilat shërbehet autori në raport me shqipen e shqiptarët dhe

së dyti do t'i trajtojmë disa nga të metat formale e subjektivo-objektive që e përcjellin këtë Sifjalorth..

1. Gësnjeshtat e paskrupullta me të cilat parashërbehet argati më aktiv i nacionalshovinizmit serbomadh rreth injorimit të gjuhës shqipe

Pikërisht lidhur me Sifjalorthin, përkundër përcmimeve, ne shohim një punë jo të keqe të autorit, prandaj pyesim për gënjeshtra të tilla që e përcjellin para e mbas, kush ishte fajtori kryesor, nxitësi, urdhërdhënësi apo zbatuesi?! Përgjigjen për këtë pyetje rreth fajësisë po e lëmë të hapur. Ne do të përpiqemi me dhënë versionin tonë të përgjigjes pasi të njihemi me të pavërtetat më të paskrupullta me të cilat, pa pasur kurrfarë zori, u shërbye sajuesi i Sifjalorthit. Ja disa nga ato të rreme që identifikohen lehtë:

E para, nuk e kemi të qartë pse autori aq hapur gënjeu kur shqipët me gjuhën shqipe në shyrtime e quajti **svoj danasnji**, që në polisemantizëm nënkuptohet se gjoja shqipen e kishte aq për zemër e në fakt e injoronte shqipët e shqipen skajshmerisht dhe e përbuzte tmerrësisht?!?

E dyta, ku kishte ujë në sy të gënjejë aq padinjitetshëm saqë gjoja shqipen e njihite aq mirë aq sa të konstatonte me kompetencë se kësaj gjuhe të vjetër i paskan mbetur në pëqinje vetëm 276 fjalë, por që edhe këto qenkan me rrënjësi të huazuar nga gjuhë të tjera dhe aq më tepër nga serbishtja?!

E treta, pse gënjeu që gjoja vetëm këto 276 fjalë i paska *gjetur* në zonat e Epirit dhe të Albanias, kinse në ish Dardani, Kosovë në treva të tjera shqipfolëse ato fjalë nuk qenkan në përdorim(!).

E katërta, nuk dimë pse ishte aq i pambështetur kur konfirmonte që krejt populli shqiptar, edhe pse ishte nën administratën e Turqisë(!), pasi e paska e humbur gjuhën e vet të lashtë u shërbyeka vetëm me gjuhën serbe?

E pesta, me sa sy e faqe e përgenjeshtron vetveten, kur shqipen e quan gjuhë amorfe me grahma asfiksimi të fundit, kur vet konsfirmon, në anën tjetër që gjuha shqipe si gjuhë e gjallë momentalisht kishte aq pushtet funksional kulturor etj., saqë, sipas tij, e mbante të robëruar gjuhësisht një turmë të madhe ish- serbësh ortodoksë të islamizuar (poturët)?!

E gjashta, nuk dimë pse autori e gënjen veten dhe të tjerët se gjoja atje në Epir (Jug të Shqipërisë) ende gjallëronte gjuha serbe tek ortodoksët shqiptarë, madje - madje ia zgjat bishtin rrenës aq sa të thotë se paska ndeshur në familje muslimane shqiptare, tek të cilat ende nuk ishte shuar vetëdija e fesë serbe pravosllave(!), ku nderohej miku serb me fjalën *sifer* (*gospodin*) dhe ende respektonin fenë e vjetër, duke lutur Zotin **Stapan** që t'i ndihmonte të pravosllavizoheshin, apo jo?!

E shtata, pse nuk e thotë të vërtetën se në Epir e gjithandej ishte ballafaquar me ortodoksë që veten e quanin shqiptarë, ngase tek ata në atë kohë edhe te ortodoksët vendës kishte filluar sadopak të ndjehej ndjenja e shqiptarisë, të cilët nuk i ishin shtruar dhunës asimiluese fetaro gjuhësore sa viset e tjera veriore e jugore ritit ortodoks pravosllav e grek dhe, tani i rezistonin me sukses asimilimit fetar e gjuhësor jo vetëm ndaj ritit bullgar, rumun e sidomos atij grek, por edhe atij serb?!!

E teta, pse pa kurrfarë zori, rrejti vetveten dhe tërë opinionin kinse e zotëronte shqipen bashkë me 17 gjuhë të tjera, me të cilat gjoja manipulonte me kompetencë? Fundja, ne nuk mund të dimë për gjuhë të tjera, por sa i përket gjuhës shqipe mund të themi me plot gojë se njohja e tij del e gënjeshtërt, madje nëse kështu i paska zotëruar edhe gjuhët e tjera, atëherë e vërteta thotë se duhet ta rrudhë shumë atë numër dhe gojën, apo jo?!

E nënta, a nuk është gënjeshtërt e kulluar fakti, kur ankohet se paska qenë në rrezik misioni i tij për shkak mungesë së lëvizjes së lirë, qoftë nga *pushteti turk*, qoftë nga *shqipët e pushteti i tyre fisnor*, kur ai ç'është e vërteta, kudo ka qenë i mirëpritur nga rrjeti i njerëzve të tij aktivistë të dërguar më parë legalisht sidomos nga kisha qoftë nga mësues

ose klerikë ortodoksë dhe kështu me shoqërimin e njerëzëve të tillë, pa *asnjë therr në këmbë* ka vizituar cep më cep sa herë ka dashur dhe ku e kë ka dashur i shoqëruar edhe me shqiptarë qoftë muslimanë, qoftë katolikë (si në Mirditë), ku gjithkund ka gjetur mikpritje nga njerëzit e thjeshtë dhe tek krenët e fiseve përkatëse jo ortodokse, apo jo!

E dhjeta, pse gënjen për kisha e manastire inekzistence ortodokse, madje pse inskenon ngjarje kundër elementit shqiptar, nga të cilët gjoja rrezikoheshin ose ishin rrezikuar jo vetëm ortodoksët (serbjanë), por edhe objektet fetare ortodokse, kur vetë e pranon që në të kaluarën shqiptarët i paskan ruajtur e mbrojtur objektet e vjetra ekzistuese ortodokse, të cilat, në të vërtetë kishin genë të tyre dhe ende respektoheshin si të tilla.

E njëmbëdhjeta, fundja pse i ik të vërtetës, kur nuk pranon se atbotë disa fjalë të shqipes gjoja ende flitëshin vetëm në Epir e Albani, nga shqipët e islamizuar, e nuk pranon që të njëjtat fjalë e fraza flitëshin edhe në Kosovë (Stara Prava Serbi), po edhe në Kosovën Lindore e Veriore, duke përfshirë qytete të saxhaqeve e nahive atbotë, si: Nishi, të Pusta Reka, Prokupja, Rasha, Kushumlia, Pazarit i Ri etj., ku në të vërtetë shqipja nuk përdorej vetëm nga shqipët e islamizuar e katolikët, por edhe nga sivëllezërit e tyre ortodoksë, apo jo?!

E dymbëdhjeta, ç'është e vërteta, tash së voni lexuam, nga interneti: Pikërisht te portali "Krstarica" si dhe nga një artikull mjaft cilësor të z. Jovo Bajiq (më 8.11.2018), me titull "*Milosh S. Milojeviq, koji nam uzalud otvarao oči*" (*M.S. Milojeviç, i cili kot na i hapi sytë*), në të cilin, edhe pse e mbështet veprën e dr. M. Vemiçiqit, ndeshim të dhëna në të mirë të konstatimeve tona të mësipërme, sepse sipas z. Bajiq, që në atë kohë kur Milojeviçi i botoi Udhëpërshkrimet, disa studiues zyrtarë të Shoqatës së dijetarëve serbë (Stojan Novakoviç, Milan Kujunxhiq-Aberdar dhe Ilarion Rukovac, Radivoj Rakic, Jovan Cvijiq etj.) kishin vërejtur gënjeshttrat e paskrupullta nga shkrimet e Milojeviçit, ngase i gjitha realiteti: *gjeografik, etnografik dhe gjuhësor (dialektologjik)* ishte krejtësisht ndryshe, por as ata nuk demantuan gjërat lidhur me shqiptarët e gjuhën shqipe si kriter i së vërtetës. Këtë nuk e ndeshëm as në Apelin e 142 studiueve serbë të publikuar me 21.11.2019, të cilër nën titullin *Apel kundër valës së re pseudohistorike e mitonimike (Apel protiv novog talasa pseudoistorije e mitonimije)*, kushtuar dëmit që po i sjellin shkencës e vendit me ribotimin e veprave të Miklojeviçit të përcjellë me një fushatë euforike pa kurfarë mbështetje dhe shumë të dëmshme, andaj në apel veç tjerash konfirmohen si të drejta krtikat e atëhershme të bashkëkohësve të

tij ndaj veprave të Milojeviçit, ku, veç tjerash, përmendin edhe veprën e analizuar prej nesh *Putopis dela Prave (Stare) Srbije dhe Odlomci..*, duke theksuar se kjo vepër kushtuar Kosovës gëlon me trille të fabrikuara dhe të falsifikuara, gjoja ekzistonin mbishkrime në gjuhën serbe nga periudha e kohës së mesme, si dhe të përmendoreve serbe nga periudha antike, trillime këto e të tjera, të cilat ishin deskredituar shkencërisht qysh në kohën e tij, gjë që një pjesë të të cilave e kemi vërtetuar edhe ne në këtë punim. Në të vërtetë sipas “analizave” të tij shqipët, përkatësisht shqipja dy të dhjetat prejardhejsisht ka fjalë latine, dy të dhejtat anglo-keltishte, një të dhejtat greqishte, ndërsa pesë të dhjetat nga serbishtja (!!!).

Sidoqoftë, na duket se këto 12 raste të cekura prej nesh dhe nga studiuesit bashkëkohorë të autorit mjaftojnë sa për të marrë vesh të vërtetën se gënjeshtat e tilla lidhur me shqiptarët ishin shpifje të paskrupullta e shumë të rënda banale, të cilat mjerisht edhe mbeten si propagandë e zezë brenda masës sllavo-serbe të shfrytëzuara sidomos nga ana e klerit ortodoks, por patën jehonë në opinionin e jashtëm, edhe pse në atë kohë veç ishin botuar shkrimet e Buesë, sidomos ato të Hanit e të tjerëve që shqipen e paraqitnin në mënyre shumë më reale, madje sipas Ami Buesë më 1837-1840, në këto vise në përgjithësi dy herë më shumë kishte shqiptarë se serbë (Halim Hyseni, “rd”, 31.07. '19), prandaj reaksioni i Milojeviçit që nuk ishte aq kryenvete, po pjellë e nacionalshivinizmit serbomadhi, doli plotësisht i dështuar dhe paksa nuk pati aq sukses drejtpërdrejt në botën e jashtme shkencore. Por siç u tha, një e keqe e tillë nënçmuese brendaserbe, mjerisht ka vazhduar të selitet nën rogoz në shkrimet pasuesve të Milojeviçit dhe fatkeqësisht ende vazhdon në raport me shqiptarët, siç është edhe rasti i më i ri i z. Vojo Bajiç (viktimë e Vemiçit).

2. Rreth disa të metave formale e subjektivo-objektive që e përcjellin Sifjalorthin, qoftë nga pakujdesia, apo për mungesë të përvojës profesionale

Sido që të ketë qenë, meqë kurdisja e projektuar romantiko-nacional-shoviniste makiaveliste serbomadhe kundër shqiptarëve dhe gjuhës së tyre me gënjeshtra që atëherë konsiderohej e moralshme sipas Naçertanias (program i shtetit dhe kishës serbe), siç e përmendëm në nëntitullin më sipër, për çka ne nuk e shfajsuam personalisht vetëm Milojeviçin por projekt-programimin brenda strukturave ideo-politike

shtetërore e fetare serbe, tani do të përmendim disa nga lajthitjet ose të metat formale, objektive e subjektive që i takojnë **Sifjalorthit**, përkatësisht sajuesit të tij, të cilat pasi janë të shumta dhe të llojllojshme, ne po i përmendim vetëm disa, të cilat edhe mund të evitoheshin ose zbuteshim me fare pak ndihmë e përkujdesje që mjerisht kanë munguar. Sidoqoftë, neve më tepër na kanë rënë në sy këto të meta:

E para, në shikim të parë formohet bindja se kemi të bëjmë me lajthitje për mungesë përvoje të autorit, i cili paraqet një grumbullim fjalësh shqip-serbisht fare të pasistemuara as sipas nënfushave kuptimore as sipas alfabetit apo azbukës cirilice që e përdor.

E dyta, lajthitje e quajmë faktin që për t'i dhënë formë çdo fjale në fjalor, qoftë i vogël ose jo, do të duhej shënuar së paku inicialet e kategorisë përkatëse gramatikore, emër, mbiemër, folje etj., mirëpo, meqë shqipja, të cilës i dha vendin e parë, për të ishte gjuhë popullore, jo gjuhë shkrimi, atëherë pse në gjuhën serbe nuk e ka përdorur së paku respektueshëm trajtën përfaqësuese të kategorisë përkatëse gramatikore, nominativ, infinitiv etj., e parapunë kjo që kihet parasysh në hartimin e çdo fjalori çfarëdo përmase që të jetë ai.

E treta, si njohës i shqipes, siç deklarohej, pse nuk bën kurrfarë përpjekje që tingujt e shqipes që i mungojnë serbishtes, t'i dallonte me ndonjë shenjëzim specifik, gabim ky i pafalshëm profesional për një autor me dije gjuhësie, siç e paraqet veten ai.

E katërta, nuk bën keq që i vë vendin e parë në radhë barasvlerësit në gjuhës shqipe, gjoja atë e zotëronte, por lë keq faktin që nuk tregon së paku (në fusnotë) burimin ose emrin dhe vendbanimin ose prejardhjen krahinore të informatorit ku është mbështetur, ku e ka ndeshur e shënuar apo kupjuar ose ku e ka dëgjuar trajtën e caktuar në shqipe. Aq më me keqardhje nuk tregon kurrfarë interesi që fjalën e shqipes ta shënojë së paku ashtu siç flitej e plotë nga informatori ose nga burimi prej nga e ka kopjuar, prandaj lajthit pothuaj në shumicën e konstrukteve fjalësore, si: *neri për njeri, gish për gisht, timar për dimër, dret për drejt, çap për cap (cjav), vnesht për vnesht* etj.

E pesta, nuk është kujdesur fare t’i korrigjojë disa gabime të rënda shtypi, mbase janë edhe gabime shënimi e daktilografimi të fjalëve të shqipes për shkak të të cilave atëherë e sot është e pamundur të deshiftohen ose paraqiten vështirësi rreth zbëthimit kuptimor e shkrimor të fjalës apo shprehjes përkatëse në shqipe.

Kështu si raste të kësaj natyre ne veçuan këta shembuj, që po i paraqitin në pesë rubrika, si vijon:

- 1) Numri rendor
- 2) Fjala, kontrukt i paqartë
- 3) Numri rendor në Sifjalorth.
- 4) Barasvlerësi i vënë arbitrarisht prej nesh.
- 5) Origjinali i fjalës serbisht.

Nr. r.	Fjala e paqartë,	Nr. rendor në sifjalorth	Barasvlerësi i vënë arbitr. pre nesh	Origjinali serbisht
1)	pentan	nr 14,	përulem, n’ besë tënde	puđim
2)	vdis-heri	nr. 28	vjehërr	svekar
3)	ishte	nr. 43	me hangër apo?	jesti
4)	kudere	nr. 80	kudhërim	nakovanje
5)	vezirmo	nr. 105	me rrëmihë	kopati
6)	vak (e djalë)	nr. 109	voc (djalë), fëmijë	dete
7)	kam frysuom	nr. 141	me fejue cucën	zaprošiti devojkū
8)	çiall	nr. 150	shpatë	sablja
9)	lan	nr. 179	urrije (të lanët)	mrzi ga
10)	kaneri	nr. 183	me vu, ka nder!	staviti
11)	empetuor	nr. 200	me pajtue	pomiriti se
12)	buluar	nr. 225	(shtëpi) e mbuluar	pokrivena kuca
13)	qkur ezd	nr. 230	me tredhë (shkye herdh)	skopiti
14)	levtur	nr. 243	lëftuar, hyjnor?!	boj
15)	shushlak	nr. 262	shushlak: rrahje, breshër	tuca, grad
16)	ungruson	nr. 277	të ngrysurit (pa frymëzim)	izpevati.

Meqë ne sipas fjalës serbe ose sipas hamendjes jemi përpjekur me gjetë barasvlerësin e mundshëm për fjalën e pazbërthyeshme, kërkojmë ndjesë për ndonjë të paqëlluar, por njëharazi për të arritur zgjidhjen e duhur, kërkojmë ndihmë për ndreqje gabimesh nga lexues-studuesit e caktuar.

E gjashta autori bën përsëritje të panevojshme të disa fjalë-zërave, vetëm pse fillimisht nuk ishte shënuar drejt fjala përkatëse. Shembujt e tillë po i paraqitim në katër rubrika:

- 1) Numri rendor.
- 2) Fjala në serbishte.
- 3) Brasasvlerësi në gjuhën shqipe.
- 4) Përsëritje e numrit rendor në Sifjalorth, si p.sh: _

1	2	3	4

1) ugljen, ugalj	-	thingill e thëngjill,	nr.4 e 42
2) sveti	-	cvjent , shenjtë e shin,	nr. 19 e 94
3) blato, zemlja	-	baltë,	nr. 23 dhe 268
4) brak, svadba	-	martesë,	nr. 55 dhe 131
5) svekar	-	vjehërr (?),	nr, 28 dhe 61
6) stid	-	turp,	nr. 66 dhe 97
7) kuća	-	shpi,	nr. 121 dhe 339
8) voda	-	ujë,	nr. 67 dhe 115
9) neprijatelj	-	armik, hasmë	nr, 70 dhe 166.

Edhe ps ka edhe raste të tjera si përsëritje pa nevojë, këtu po mjaftohemi vetëm me këta 9 shembuj.

E shtata, disa barasvlerës nuk i ka të qëndrueshëm, jo vetëm sinonimisht, por as sa i përket nënfushës semantike, si shembuj të tillë po përmendim vetëm këto tri raste:

- a) *dhi (ovca!-dele) e dhen (koza – dhi).*
- b) *patë e rosë,*
- c) *ndafolet lartë e gjanë.*

Cekëm vetëm këto tri raste, ngase ngatërresat e tjera nuk duken aq me peshë.

E teta, janë disa raste të fryera ose me tendencë për të treguar se kinse ende shqiptarët muslimanë i kujtonin shenjtët e zotat pravoslavë serbë, siç janë rastet: *sifer, stopan, rus, Perun*, pastaj fryhet në qëllim lokalizma *magjarë (gomar për hungarezë)* etj.

E nënta, për mungesë përvoje disa pjesëza, nyje të përparme e ndonjë togfjalësh të shqipes i shkruan bashkë me temën e fjalës, kështu

vepron pothuaj edhe me foljet ndihmëse, si: *shent* në vend *i shenjtë*, *kamprosit* në vend *kam porositë*, *kamlyor* në vend *kam lyer*, *narov vjetri* në vend (*na roftë (ruajtë) i vjetri*) *etj*,

E dhjeta disa zanore ose bashkëtingëllore të shqipes i ngatërrojnë, ndër të cilat më së shumti dalin të ngatërruara:

a) zanoret: **A** me **O**, siç janë shembujt:

nota /nata, mat/mot, mart /mort, boftë mirë /të bafte mirë, capë / copë dhe një rast i kundërt

zanja për zonja dhe

b) bashkëtingëlloret **LL** me **L**, si p.sh.:

balltë/baltë, llis/lis, kallë/ kalë, ksull/ kësulë, flloka/flokë, llum,/lum, llopa/lopa, 'bulluar /mbuluar/, kam lluar / kam lyer, (e) diell /e diel, llulle-llalle/ lule-lale, llakra / lakra.

Shembuj ngatërresash në tekst ka edhe në jopak raste, qoftë zanore, qoftë bashkëtingëllore ose edhe bashklëtingëllore me zanore e anasjelltas, çka e bën të vështirë manipulimin me këtë Sifjalorth.

E njëmbëdhjeta, disa fjalë shqipe ose serbishte na u imponuan që për nevojë sqarimi ose barasvlerësie, sipas fjalë-zërit përkatës kryesisht në shqipe t'i shtonim fjalë-shtesë. Madje këto **fjalë-shtojca** i **nximë (bolduam)**, ndërsa barasvlerësit përkatës, në rubrikën tjetër, e shënuam me **shkronja të pjerrta (italike)**. Edhe këtë punë **shtojcash** po e sqarojmë në tri rubrika:

- 1) Numri rendor
- 2) Fjalë në gjuhën shqipe
- 3) Barasvlersi në serbishte.

Nr. r.	Shqip	Serbisht
1.	Princ , mbret	- <i>kralevic</i> kralj
2.	Lakër <i>laknor</i>	- kupus kukuvaca
3.	Zot , <i>Stapanj</i>	- bog, Stapan
4.	Me ça, me thërmue	- cepati, <i>lupati</i>
5.	kofshë (but këmbë), <i>butë</i>	- but noge, meko
6.	<i>Gjizë</i> , urda!	- urda, varog
7.	shqa e slav	- <i>slavenac</i> , slav (rob)
8.	qen, këlysh	- pas. <i>kuće</i>

9. Letër, libër	–	pismo, <i>knjiga</i>
10. frikohem, përulem	–	plasim <i>pudim</i>
11. rrahje, breshër	–	tuca, <i>grad</i>
12. diel e <i>djelë</i>	-	sunce, nedelja
13. Agim , diell	-	zora , sunce
14. gabim , më fal	-	<i>pogreska</i> , oprost
15. rrip, brez	–	<i>remej</i> , kais
16. Posi , <i>si</i>	-	<i>ako</i> , kako
17. Pllakë , dërrasë	–	<i>ploča</i> , daska
18. Shkruaj, qëndis	–	piši, <i>vezi</i>
19. <i>Me grabitë</i> , me robëru	-	grabiti , <i>robiti</i>
20. Egër, egërsisht	–	<i>divlji</i> , <i>divljački</i>
21. Njeri, vjehërr	-	čovek, <i>svekar</i>
22. Mish, muskul	-	meso, <i>mišić</i>
23. Dru, <i>lis</i>	-	drvo, hrast
24. Vesh, veshë (me u veshë)	-	uho, <i>odevati</i>
25. <i>Shok</i> , shokac (mik)	-	drug prijatelj
26. Burrë , bir (<i>djalë</i>)	–	<i>muž</i> , sin
27. <i>Baltë</i> , dhe	-	blato , zemlja
28. <i>Kurm</i> , trup	-	truplo , telo
29. Armik, djall	-	neprijatelj, vrug
30. Pëllamb	-	dlan
31. Vresht	-	vinograd
32. Me pi , <i>kruarje</i>	-	<i>piti</i> , grebenje
33. Kuvend, tubim	-	skupština, <i>sabor</i>
34. Bilbil , <i>zog</i>	-	<i>slavuj</i> , ptiće (pile)
35. Zaman (<i>kohë</i>), shekull	-	vreme, <i>vek</i>

Kështu vepruam me qëllim që sadopak konsultuesi i këtij Sifjalorthi të ketë njëfarë lehtësime gjatë konsultimit.

E dymbëdhjeta, autori në tekst-sqarimin në fund të Sifjalorthit, siç kemi rast ta lexojmë, na informon se ai paska përzgjedhur 246 fjalë shqipe, që në të vërtetë nuk është numër i saktë, sepse, siç e pamë, kishte 339 fjalë e shprehje, d.m.th. **93 shembuj** më shumë, madje, sipas tij, edhe këto që të gjitha shqipja i paska të huazuara e ndër to **35 sosh fjalë të pastra** (të qindpërqindta) me prejardhje **nga gjuha serbe**, numër edhe ky jo i saktë, sepse në Sifjalorth janë **44 shembuj**, d.m.th. **9 më shumë**, për të cilët autori pohon me shenjzimin: “*srpsko, -a, -i*”, d.m.th. **fjalë a shprehje me prejardhje serbe**. Meqë është e vërtetë se shqipja e serbishte

që gjinikisht nuk i takojnë një grupi gjuhësor, por me shekuj kanë qenë në kontakt, andaj mund të kenë edhe ndërhuazime, mirëpo pasi dyshuam në pohimin e Milojeviçit, i cili na duket se me tendencë pohon serbishten dhe mohon ndërndikimin e shqipes në rastet e tilla, gjoja me ndikim ose prejardhje serbe nga Sifjalorthi i morëm në trajtim, prandaj kërkujmë nga lexuesi e studiuesit që për secilin shembull nga 44 rastet të vlerësojnë argumentat, sa pati të drejtë autori apo ne që dyshuam në vërtetësinë e mbështetjeve të tij?

Po i trajtojmë shembujt radhazi:

1. **Purtekë (mërtëk)**, si duket quan fjalën me prejardhje serbe, vetëm pse morfema nistore **pur-e pr-** e fjalës shqipe mund të krahasohet pjesërisht me nistoren **pr** të fjalës **prut** të serbishtes?

2. Mbiemër-emrin **i shenjtë**, ndoshta veshi ia ka imponuar jo arsyeja ta shënojë **svjent**, andaj pa gjykuar fare e quan të huazuar nga serbishtja **sveti**, shembull ky që në tjetër vend përkthehet si duhet, deri edhe me trajtën sinonimike **shin** (*shën*). Ky latinizëm (sentum) mbase ka të bëjë me parashqipen, por assesi nuk mund të quhen ndikim i serbishtes në shqipes apo jo?!

3. Tek emri **vesh-i** (organi i të dëgjuarit) dhe emri *foljor* **veshë-a** (*me veshë - veshje*), që të dyja në shqipe me prejardhje i.e, autori emrin vesh, përkatësisht foljen me marrë vesh e ndërlihd ndoshta si ndikim nga fjalët e serbishtes: *vesht* (i zgjuet), *veshtak* ekspert etj. që nuk kanë të bëjnë me nocionet që ka fjala përkatëse në shqipe, ndërkaq *emrin prejpjesor* **veshë** (*veshje*) ose të *veshurit* e ndërlihd me ndikimin e trajtës *odevanje* përkatësisht *veshanje odela - varje rrobash* që në serbishte, siç e kemi vërejtur te *vešmašin* (lavatriqe) mund të jetë një ndikim i gjermanishtes, edhe pse ne më fort e shohim si ndërndikim në serbishte nga shqipja, ngase shqipja del gjuhë më e vjetër në Ballkan, apo jo? Sidoqoftë, le të vlerësohet.

4. Edhe fjala **gati** ose **gadi** nuk di si mund të shpjegohet nga ndikimi i serbishtes **gotov-**, vallë, vetëm pse përkuakan tingujt **g-t??!**. Fundja nëse insistohet në ndërndikim, mbase mund të ketë ngjarë e kundërta, apo jo?!

5. Nuk dimë ku gjen mbështetje autori, që emrin **zonjë**, që aty e shënon *zanja* dhe e përkthen s serbisht **žena** në vend **gospodja**, ta konsiderojë fjalë nën ndikimin ose me prejardhje serbe, kur dihet mirëfilli që kjo trajtë **Zonjë** është derivat që rrjedh nga fjala **Zot** e shqipes?!

6. Fjala **thingill** thëngjill, fjalë autoktone e shqipes, nuk di pse i del autorit e krijuar mbi bazë të fjalës serbe **tinjati**, vallë sugjeron kështu, vetëm pse i duket se tingulli nistar përkon, sipas tij, që në të vërtetë në shqipe del **th-** jo **-t**?! Po si duket autori bën mirë që dallon trajtën dialektore **thingill**, që te ne në Kosovë quhet kështu gaca e fikur e shndërruar në thëngjill. Krahaso letrarishten: *thëngjill* druri /*thëngjill* guri, në Kosovë *thingill* vetëm gaca e shuar prej druri. *Kemi shkruar me thingill -thingij.*

7. Emrin **mish**, fjalë i.e. të shqipes, e sheh të ndërlidhur nga fjala **mišići** (shq. *muskulat*). Për mendimin tonë ky supozim zgjon interes, që edhe ky rast mbase mund të ketë njëfarë ndërndikimi të kundërt. Të gjitha gjasat janë që parësorja në ndërndikim mund t'i takojë shqipes, apo jo? Sidoqoftë, le të vlerësohet?

8. Nuk e kam të njohur faktin që fjala **sifer** të jetë përdorur në shqipe në shenjë nderimi për mikun ose të fisnikun serb (!), që e përmend autori si rast me prejardhje nga serbishtja **sifer- serb**, *srbin* (*sirbin!*), me kuptimin zotni (gospodin?!). Në të vërtetë ne kemi hasur fjalë-trajtën **sefer** (jo sifer) sinonim për **arkondin**, përkatësisht në arabisht **Sefer** - emër i nderuar *njeri i shpatës(!)*, po nga këta shembuj assesi nuk mund të arsyetohet fjala *sifer* nga serbishtja, apo jo?! Si duket kjo fjalë është sajese e autorit me tendencë që gjoja kjo fjalë serbe (!), si fjalë nderimi ende qenka në përdorim e sipër në viset shqiptare (ish ortodokse serbe!) të Epirit, apo jo?!

9. Latinizma **mort**, si barasvlerës për fjalën **smrt** (vdekje) cilësohet nga autori si fjalë me prejardhje nga serbishtja e vjetër, paralatine?!

10. A pati të drejtë autori që fjalën **ropa** (*u ropa, me rjepë*) ta shënojë me konceptin *me grabitë*, serb. *grabiti*, dhe ta shpjegojë etimologjikisht me fjalën *robiti* (*me robnue*), le të vlerësohet.

11. Fjalën me origjinë latine **mashkull** e quan nën ndikimin e fjalës **mushko** të serbishtes?!

12. Fjala **gur**, fjalë shqipe me prejardhje i.e., në Sifjalorthin në shqyrtim autori e ndërlidh me fjalën **gora** të serbishtes, nëse kërkohet patjetër ndonjë ndërlidhje etimologjike e këtyre dy trajtave, atëherë fjala **gur** e shqipes duhet me pasë përparësi, jo vetëm pse fjalën **gur** disa studiues e konsiderojnë të trashëguar nga pellazgishja, por edhe për faktin se fjala **gur** del aq e shtrirë në shqipen e sotme sa që sot për sot kemi afro 100 derivate mbi këtë trajtë temëprodhuese, madje sistemi dhe strukturat

lelsikore e fjalëformuese lejojnë krijimin e fjalëve të reja mbi këtë bazë numerikisht edhe më shumë e shumë herë nga aq sa ka sot.

13. Kontrukti **thikë**, fjalë i.e. e shqipes me **nož** të serbishtes nuk duket se ka farë ndërlidhjeje as me ndonjë shkronjë, andaj nuk kuptojmë pse autori e shënon fjalën *thikë* me ndërndikim nga fjala **nož** e serbishtes!?

14. Edhe për fjalën **dasmë** ose **darsëm**, si fjalë autoktone e shqipes nga **darkë** (**darkvmë*), nuk di ku ka mundur të gjejë mbështetje autori me e ndërlidhë ndikimisht me fjalën **davati** (me dhënë) të serbishtes, ngase te shqiptarët zakonisht bën darsëm ose shtrohej dark(v)a jo nga ai që e jep vazhën, po ai që e merr nusen, apo jo?

15. Sa ka ndikim fjala **porucio** për foljen **porosit**, të cilën autori e shënon *kamprosit*, nuk mund ta dimë, por sa i përkët ndërndikimit **porosia** dhe **poruka** mund të kenë origjinë të përbashkët, por kjo u mbetet specialitstëve për ta sqaruar më mirë.

16. Fjalën **Perëndi** e quan të ndikuar nga emri **Perun** i gjuhës sllave. Me sa di ndërlidhjen **perun** me perëndi nuk e lidh askush nga studiuesit seriozë.

17. Për shprehje **ma shpejt** që ai këtë ndajfolje i shënon bashkë dhe, për çudi, thotë se që të dyja janë serbe, nuk mund ta kuptojmë!!!. Mbase kemi të bëjmë me një lapsus calami?!

18. Edhe fjalën **përtek** (mërtek) si barasvlerës i emrit **pruće**, nuk dimë pse e shënon me prejardhje serbe kur sikurse te shembulli nga nr. 1, këto fjalë nuk kanë as lidhshmëri formale me trajtën e serbishtes *prut*, *pruće*, apo jo?!

19. Fjalën **bojë bojna**, serb **boja**, fjalë e huazuar nga turqishtja, nuk dimë ku gjen arsye të pohojë që shqipja e paska marrë nga serbishtja?!

20. Nuk dimë gjithashtu, ku gjen mbështetje autori, kur emrin **patë**, me origjinë të diskutueshme në shqipe e quan serbe dhe i ngatërron konceptet **gusë** e **shotë**, të cilës nuk i shënon sinonimin **rosë**, që është fjalë i.e. e shqipes.

21. Po aq më tepër më duket se autori lajthit kur emrin **pulë** e lidh me serbishten **kokosh**!!!. Në të vërtetë në shqipe të Jugut ka përdorim lokal emri kokosh – sinonim për gjel e jo për pulë.

22. Është e çuditshme për ne pse konstruktin që ne e zbërthuem **njeridek** (i vdekuri) e konsideron të ndëndikuar prejardhjesisht nga fjala **mrtav** e serbishtes?!

23. Latinizmën **groshë** e shënon **grash** në shqipe dhe mendon se vjen nga serbishtja **grah**, mbase e ka fjalën për *grashak* – le të vlerësohet.

24. Fjalën **kaz(a)** të tuqishtes e përkthen me **oblast** po nuk di pse e quan fjalë me rrënjësi shqipe e ndikuar nga serbishtja, kur dihej se ajo ishte term i administratës turke??

25. Foljen **lëroi** (*larvroj*) me prejardhje ndërndikimi latin, autori e konsideron të ndikuar nga fjala sllavoserbe **orati**, mbase ka dashtë me thënë që arbanët (arë+bërësit) s’kanë ditë me punue tokën, andaj atë e mësuan nga serbët, apo jo (!).

26. Si barasvlerës të fjalës i. e. të shqipes **zjarr** e shënon në serbishte *vatra*, duke e cilësuar si **fjalë serbe**. Nuk mund ta dimë çfarë pati ndërmend autori, mbase fjalët **zhar zharavë**, si fjalë të përbashkëta shqipo-serbishte, apo ndoshta e ka pasur në dijeni se pikërisht fjala **vatra** (votra) nga studiuesit konsiderohej si fjalë shqipe e shtrirë në serbishte, apo jo?!

27. Nuk e fajësojmë autorin që për fjalën **sherbëtor** të shqipes në serbishte i jep barasvlerësin **sluga**, por nuk ka të drejtë kur këtë latinizëm **serv/us**, shq. shërb-ëtor e quan me prejardhje serbe.

28. Autori si fjalë shqipe shënon trajtën **robot**, të cilën e përkthen me me barasvlerësin **çelad** dhe së këndejmi ne e zbëthym me togun **robtë** (**e shpisë**) ose gjinja e shpisë) – anëtarët e familjes. Sidoqoftë fjala *rob*, ka përhapje në tërë shqipen e sotme.

29. Për ne zgjoi interes fakti që shprehjen **tremet de** (*trembet dheu!*) për konceptin *e termetit* e përkthen serbisht **trese se zemlja**, po nuk mund ta dimë ku e sheh prejardhjen nga serbishtja. Krahaso termat e sotëm **tërmet** (*trembet dheu!!*) ndaj serbishtes **zemljotres!**

30. Koncepti i mbiemrit **i mirë** i ngatërrohet autorit me konceptin në serbisht të fjalës **miran** që ka kuptimin *i qetë*, andaj e cilëson fjalë me prejardhje serbe, gjithsesi mbetet ndërndikim i diskutueshëm ky koncept i veçuar, sepse antonimia kuptimore e fjalës *mirë* me derivatet: *i mirë, e mira, mërësia, të mirat, të mirët* etj. si përparësi e shqipes nuk mund të mohohet dot.

31. Vërtet, na duket e pabesueshme kur fjalën shqipe e trashëguar shqipe **derë** e shënon të ndërndikuar nga fjala **vrata** e serbishtes?!

32. Fjala **vija** e shqipes me prejardhje latine përkthehet mirë me **brazda** në serbishte, po s’dimë sa ka të drejtë ta shënojë me prejardhje serbe?!

33. Fjala **shushlak** në shqipe përdoret më shumë për hedhurina që mbesin pas *rrahjes apo spastrimit të lëndës së caktuar si fasulja etj. që ai në serbishte i jep baravlerësin tuča* (rrahje), po i shton edhe sinonimin **grad** (breshër). Vërtet, nuk mund ta kuptojmë pse fjalën **shushlak** e quan me prejardhje serbe e nuk e shënon ndonjë barasvlerës në atë gjuhë.

34. Edhe ndajfolja **keq** që e përkthen **rdjavo**, sipas tij paska prejardhje serbe, mbase vetëm pse e ka ndeshur tek ortodoksët shqipfolës ose në të folmet nashke të kësaj ane? Gjithsesi kur kemi parasysh përdorimin enorm në shqipe dhe derivatet e krijuara nga kjo fjalë, gjithsesi del i pranueshëm fakti se kjo fjalë i takon thesarit të trashëguar të shqipes, apo jo?!

35. Është interesant se fjalën **shkja** (*shqa*), trajtë ekskluzive e shqipes, përveç për konceptin **sllav** në këtë Sifjalorth përforcohet edhe me konceptin **rob**, ngase në shqipe vjen nga trajta **skllav- *shklav shkllav, shkjav, shka** - sllav ashtu si edhe ajo **serb** (*shërbëtor*) vjen nga *serv-us - *sherb-tor* që të dyja këto *sklav sllav* dhe *serv serb* në gjuhët klasike mbulonin konceptin e fjalës **rob** e **sluga** të serbishtes. apo jo?!

36. Vërtet nuk mund ta kuptojmë, pse mbiemrin **randë**, serb. **težak** e cilëson si serbizëm, kur vërtet nuk shihet se ka mundur me pasë ndonjëfarë ndërndikimi sa i përket konstruktit të fjalëve, qoftë nga ana shkrimore, qoftë nga ajo shqiptimore.

37. Te shembulli **Stopan, Stapan**, shihet një tendencë për për theksimin e zotit me prejardhje ortodokse serbe, emër ky, të cilin gjoja e gjen të përdorur tek shqiptarët muslimanë, të cilët iu lutkan **Atij** që t'i ndihmojë me u kthye në fenë e vjetër pravosllave (serbe)??? Gjithsesi kjo çështje del e fryrë me tendencë, edhe pse nuk mohohet prania e kësaj fjale në të folmet jugore mbase edhe veriore të shqipes, apo jo?!

38. Gjithashtu del e pabesueshme kur fjalën turke, gjoja shqipe, **duman** e thekson të ndikuar nga fjala serbe **dim**. Ndoshta ka menduar për barasvlerësin e vërtetë të shqipes **tym**, barasvlerësi kjo që mbase mund të jetë e diskutueshme si ndërndikim, por antonima kuptimore e në shqipe sigurisht del parësore ndaj serbishtes, apo jo?!

39. Nuk dimë pse fjalën **mulli** serb. *vodenica* e cilëson si serbe? Mbase ka menduar për latinizmën *mlin* që e ka serbishtja!?

40. Edhe pse nuk e shënon mbase, duke menduar për trajtën *mlin* edhe emrin e fondit i.e. të shqipes **miell**, serbisht *brašno*, e cilëson vërtet pa të drejtë si serbizëm?!

41. Emri i bulmetit **gjizë-a** nuk duket që ka ndërlidhje formale shkrimore me barasvlerësin **urda** të serbishtes, andaj nuk mund ta kuptojmë shkakun pse këtë fjalë të fondit i.e të shqipes e quan të prejardhur nga serbishtja?!

42. Edhe te shprehja **kam ça dru** që i shënon në serbisht **cepati drva** nuk duket se ka farë ndërndimi, por si duket autori ndihmësen **kam** (është vërejtja e tij) **e** konsideron si *mjet coptimi -kama*, andaj këtë “fakt sugjestiv” e konsideron të mjsftueshëm si ndikim të serbishtes, apo jo?!

43. Ndoshta për emrin onomatoepik *kllukë* (të **pulës klluçe**) që ai e shënon në shqip **klluçka** e në serbishte **kvoçka**, ka pasur të drejtë që ka parë ngjashmëri, por sa i përket prejardhjes serbe do të ketë pasur arsyetim vetëm në prapashtesën e përbashkët klo -**çka**, apo jo?!

44. Nuk dimë pse shprehjen pashtrmore **Për të mirë**, serb. **U zdravlje**, si dhe shprehjen tjetër **Të bëftë mirë**, serb. **Na zdravlje** i cilëson si shprehje nën ndikimin e serbishtes, edhe pse fjala **zdravlje** te shprehjet: *u zdravlje* dhe *na zdravlje*, korrespondon me trajtën “*shëndet*” të shqipes. Ndërkaq shprehjet me “*mirë*” të shqipes assesi nuk mund cilësohen as si kalke, siç jep me kuptue autori, por janë shprehje autoktone të visarit të lashtë të trashëguar kulturor të shqipes.

Në përmbyllje kontatojmë se mesa pamë vetëm dy-tri raste mund të kenë pasur ndërndikim trajtash, kurse të gjitha rastet e tjera sa i përket prejardhjes serbe të fjalëve e shprehjeve përkatëse janë tejet të paqëndrueshme.

Sipërfundim

Pas gënjeshtreve të paskrupullta me të cilat shërbehej si argat-robot i programuar me porosi të Naçetanies, të cilat i shënuam në 11 pika dhe pas 14 pikave të tjera ku përmendëm disa nga të metat formale e konceptore subjektivo-objektive më të dalluara të autorit të shfaqura në Sifjalorthin në shqyrtim, ne në këtë sipërfundim do të tërheqim vëmendjen vetëm në pikën e fundit, ku në 44 shembujt si fjalë të shqipes, të cilat i konsideron me prejardhje nga serbishtja ose kryesisht nën ndikimin e saj.

Sipas trajtimit analitik që bëmë fare sipërfaqësisht ne konstatuam të vërtetën shkencore se vetëm dy-tri raste si folja **porosit me porosité** ndaj **poruciti** dhe emrin **groshë** me **grah e grashak** e ndonjë koncept me fjalën rob (serb. *sluga*) edhe pse në shqipe kanë konotacion të diferencuar semantik nga serbishtja, mund të kenë pasur ndërndikim me serbishtem,

ndërsa në mbi 40 rastet e tjera, pothuajse të gjitha pohimet e Milojeviçit mund të cilësohen si lajthitje ose trullavje (zabluda), veprime këto që nuk mund t'i arsyetohen ndryshe pos dy zgjidhjeve hipotetike me ndërlikime të ndërsjella që po i japim hamendjesisht edhe ne:

E para, ndoshta kishte si mostër ndonjë familje mikste ortodokse ish-shqipfolëse që ishte në serbizim e sipër atje, e cila ende kishte fjalë shqipe si këto, andaj në bazë të shembujve të tillë supozonte se kështu do të ndodhë me të gjitha familjet shqipfolëse ortodokse këndeje, bindje që kishte parë sadopak te formëzuar ose të realizuar në Principatën Serbe, kur me themelimin e saj me dëbimin e shqiptarëve muslimanë e katolikë ortodoksët shqipfolës të mbetur vërtet, pësuan edhe më keq e humbën gjuhën shqipe, dhe gjithë@ka shqiptare pos gjakut dhe historisë, apo jo! Së këtejmi, pasi të gjithë ortodoksët shqiptarë i shihte serbë, shihte tolerancë edhe në gjuhën e tyre. Shqipfolësit e tillë, fundi i fundit, nuk do të prishte punë që gjuhësisht t'i konvertonte në serb edhe me këto 40 e sa fjalë e shprehje apo jo?! Ndërkaq folësit aktual shqipfolës të islamizuar i konsideronte vërtet turq ose do të shpërnguleshin e turqizoheshin edhe me gjuhën turke, apo jo dhe kështu, mendja e tij, shqipja ashtu-kështu do të shuhej, andaj publikisht ky u ofron ortodoksëve shqipfolës serbishten. Së këtejmi, ngjashmëritë e vogla i zmadhonte, duke i arsyetuar edhe me konceptet që aktualisht mbuloheshin me fjalët e tilla. Kështu disi kjo logjikë jo aq me logjikë të shëndoshë, ndoshta mund t'ia lehtësojë sot dështimin aq të madh të tij në këtë pikë etimologjike, apo jo?!

E dyta, dështimi i tillë fatal i Milojeviçit mbase ka mundë të ndodhë edhe për shkak të faktit se duke qenë i dëshpëruar nga realiteti që serbë të vërtetë serbishtfolës në Prava (Stara) Srbi, siç propagandohej më parë ishin shumë pak në krahasim me shqipfolës, andaj rrëshqiti në gabime aq të rënde lidhur me prejardhjen e fjalëve të gjuhës shqipe, sa që nuk mund të arsyetohen dot, as me naivitetin e njeriut të zhgënjyer e të pa përvojë, as me mungesën e dijes profesionale në krahasim me studiuesit e huaj si G. Han, Bue etj., dhe as me një mal gënjeshtërash për hir të ndonjë ideali imagjinar, madje as me logjikë makiaveliste, por kjo mund të shpjegohet si pasojë e një *prekje patologjike*, e cila i bëri zhveshjen e vetive morale njerëzore të një studiuesi të vërtetë, duke shndërruar në një ushtar të thjeshtë me shpërlarje truri, i cili duke zbatuar urdhërin e eprorit symbyllazi zbatonte pa vetrëdije urdhëra të dhënë prej tij. Është e vërtetë se puna e tij në krahasim me punimet serioze nga studiues të vërtetë të huaj neutralë, mbeti vetëm si propagandë e zezë makiaveliste panserbe pa

njerëzishmëri dhe së këtejmi, u shndërrua në urrejtës ekstrem kundër popullit shqiptar e gjuhës së tij, që e dëshmon pak më vonë si udhëheqës-komandant i vullnetarëve serbë e rus, kur me dy hera sulmi *spastroi* mbi 400 fshatara shqiptarë, për çka, edhe pse nuk ishte luftë e shpallur kundër fshtrave shqiptare, po kundër ushtrisë turke, ai mori edhe shumë lavdata dhe u shpall qytetar nderi pothuaj i të gjitha qyteteve *të liruar nga shqiptarët*, por si duket pikërisht ky veprim jonjerëzor ndaj popullit të pafajshëm shqiptar e preku në ndërdije dhe ia topiti fantazinë e bujshme krjuese, saqë i humbi edhe aftësia mendore për sqarim e arsyetim të asaj që kishte krijuar që nuk ishte jashtë programit që vepronin edhe të tjerët.

Më duket se mjafton ky fakt rreth prejardhjes së fjalëve të caktuara që puna e Milojeviçit konceptualisht (formalisht e shkencërisht) edhe për këtë pikë si dhe për të gjitha pikat e tjera në raport me shqipen e shqiptarët njerëzishmërisht të konsiderohet e dështuar plotësisht.

S’do mend se dështimet dhe gabimet e tilla formale e kuptimore që nuk janë të pakta të Milojeviçit ishin pasojë ndaj obligimeve që verbërisht i vinin nga Projekt-Programi antishqiptar “Naçertanie”, të fryra e të frymëzuara edhe nga Kisha e atëhershme kombëtare serbe, të cilat nxiteshin edhe nga rrymat hegjemoniste dhe orekset kolonialiste europiane që ishin të orientuara në gllabërimin e tokave aziatike e afrikane, po edhe europiane të Perandorisë Osmane (tani të konvertuar *Perandori Turke*), e cila ishte në shembje e sipër.

Sidoqoftë, teksti i Sifjalorthit të Milojeviçit ka gabime dhe në versionin serbisht që kanë ndodhur para se të kryhej libërtimi edhe për mungesë lektorimi a redaktorimi, qoftë në dorëshkrim, qoftë edhe në shtypshkronjë. Së këtejmi kjo nuk do të thotë që studiuesit këtë drith ushqimor të këtij punëtori të palodhur Milojevic ta hedhin si si hedhurina në koshin e të pavlerave, por duhet ta pastrojnë, sepse brenda këtij byku me të spastruar dalin kokrra margaritari që pasqyrojnë atë periudhë edhe të serbishtes në përpunim edhe të gjuhës shqipe të pastudiuar, siç ishte edhe çështja e fjalës **gur** (që autori e ndërlidh me **gora**) për të cilën theksuam se kur kemi parasysh faktin se kjo fjalë cilësohet si fjalë e trashëguar e protoshqipes dhe në gjuhën e sotme ka mbi 100 derivate në përdorim e sipër ose si fjalëformime potenciale siç lejon sistemi fjalëformues i shqipes me strukturat e tij ka mundësi të pa kufizuar shumimi, atëherë s’do mend se kjo fjalë dallohet ndër margaritarët e parë të shqipes. Ndërkaq edhe sa i përket etimologjisë ndaj fjalës **orati (njivu)-lëroj** ose **lavroj (me lavrue arën)**, për të cilën thamë se është mirë të

rishikohet ndërndikimi jo vetëm me serbishten **orati**, por edhe me latinishten, përkatësisht raporti protoshqipe-latinishte, apo jo?! Ndërlidhur me këtë më ka rënë në sy ky fakt që studiuesi Milojeviç pikërisht fjalën **arë ara arati**, e potencon si fjalë serbe në një fjalorth pansllavist që ia dedikon pansllavishtes, ndërkaq ne po e përmendëm vetëm sa me marrë në dijeni edhe sudiusit tanë se si manipulonte ky edhe me fjalë të vjetra të përvetësuar të shqipes, të cilat me vetëdije i përvetësin si *starina (thesare me vlera të lashta të përbashkëta)*.

Mesa u tha, jo se duam t'i japim krah fantazisë edhe ne, siç bëri Milojeviçi, por lidhur me etimologjinë e fjalëve të shqipes pajtohem me disa studiues tanë e të huaj që thonë që tashmë ka ardhur koha për rivlerësimin e të gjitha të arriturave të degëve e nëndegëve të gjuhësisë shqiptare, sepse shqipja globale e historiku i vitalitetit të saj gjatë periudhës paraantike, antike e gjatë filleve të periudhës së mesjetës dhe deri në ditët e sotme nuk del e njohur dhe as e studiuar gjithanshmërisht. Kështu gjuha shqipe, dita - ditës, po vjen duke u pasuruar me të dhëna të reja që nuk njiheshin më parë ose njiheshin e interpretoheshin vetëm nga ndonjë grup i vogël studiuesish, të dhëna këto që patën fatin e popullit shqiptar, i cili neglizhohej ndoshta edhe nga studiuesit e vet servilë, nënshtrues të ideologjive ose autoritarëve të institucioneve të shteteve të caktuara, prej nga edhe indoktrinoheshin, gjë që po shihet edhe në stopimin lidhur me rishikimin e drejtshkrimit të shqipes nga grupe nga qendrat e caktuara ishnormëvënëse jo të arrirë, të cilët për fat të keq janë shndërruar në kapës të normëa së sotme dhe kështu po pengojnë lirizhvillimin e perfeksonimin e saj, apo jo?!

Prandaj, nëse duam të kërkojmë ndërndikim gjuhësor edhe në raportin shqip-serbisht, atëherë lypset praktikuar edhe kritere më serioze vlerësimi, me ç'rast duhet pasur parasysh edhe mundësinë e ndikimit të parashqipes që nga lashtësia në gjuhë të tjera, pra edhe në gjuhën serbishte apo jo?!

Rezultatet nga një rivlerësim i tillë do të ishin në të mirë të shkencës shqiptare e serbe në veçanti, por edhe të gjuhësisë universale, europiane e botërore në përgjithësi.

4) Rreth kontributit me pahir në e për gjuhën shqipe sipas këtij Sifjalorthi

Hyrje

Në fillim të paraqitjes sonë në këtë krye kërkua, lexues i nderuar, të vlerësohet guximi ynë pse këtë grumbullim fjalësh të pasistemuara e quajtëm **Sifjalorth**, tashti e zgjerojmë kërkesën: Lusim të vlerësohet një dilemë tjetër jona, nuk dimë sa patëm ose sa kemi të drejtë që lëndën e kësaj sajese (Sifjalorthi) ta quajmë **Kontribut me pahir në e për të mirë të gjuhës shqipe**, apo jo?

Ç'është e vërteta, ne kështu e cilësuam edhe pse jemi të vetëdijshëm se qëllimi i kësaj sajese nga autori nuk ishte për të mirën e shqipes, por për ta injoruar e përçmuar atë, e cila sipas programit të Naçertnies gjithsesi si e folme e **shkipëve** duhej zhdukur nga këto treva, të cilat konsideroheshin potencialisht treva serbe, të shtetit Serb, për arsye:

Së pari, sipas të drejtës historike, ngase Mbretnia Nemanjide (gjoja serbe) këtu kishte lindur dhe kishte mbretëruar në shek, XIV, me emrin Serbi, andaj fillon të quhej nga pansllavistët e Knezhevinës Serbe e më gjerë vendi Serbi e Vjetër (Stara Srbija), ndërsa Milojeviçi shkon edhe më tej e quan Pjesë e Serbisë së Vërtetë të vjetër (deo Prave Stare Srbije), i cili ndoshta për ta argumentuar atë “Serbi të Vërtetë” trilloi gënjeshtër të paimagjinueshme kundër gjuhës shqipe dhe shqiptarëve, vetëm pse ishin anas dhe si popull shumicë jetonin në këto troje.

Së dyti, një realizim të tillë e quanin të zbatueshëm, ngase me politikë djallëzore (me forcë e me dredhi) dhe me anim-përkrahje të Rusisë e Francës kishin fituar një *Ferman* (dekret) nga sulltani, qysh në vitin 1859, kur kreu i Perandorisë Osmane, me rastin e njohjes së autonomisë së Principatës Serbe i pranoi të drejtën Serbisë që me rastin e tërheqjes së administratës dhe të ushtrisë turke nga territori i asaj Principate të tërhiqej edhe popullata joserbe (turke), e cila në të vërtetë ishte pothuaj krejtësisht shqiptare dhe si shumicë muslimane të cilën Perandoria Osmane e konsideronte popullatë turke, madje kishin njëfarë pjesë e marrëveshjeje që për pasuritë e familjeve të shpërngulura Serbia t'i paguajë diçka Turqisë (H. Bajrami, F. Gjarra, Xh. Salihu).

Së treti, në këtë periudhë ishte intensifikuar edhe diplomacia me propagandat agresive kundër Turqisë nga të gjitha shtetet kryesore armike të Perandorisë Osmane, siç ishin Rusia, Austro-Hungaria e Franca dhe mbështetur në këto vjega përfitonte Serbia.

Së katërti, edhe paria serbe nuk hezitoi, duke pranuar e përqaftuar menjëhershëm idenë pansllaviste, përgatiti kuadro dhe me mençuri shfrytëzoi tri atutë si strategji më të fuqishme kombëtare, e para, forcimin

e unitetit politik shtetëror qeverisës, e dyta, gjuhën letrare serbishte mbi bazë popullore dhe e treta, kishën pravosllave me prirje historike nacionaliste dhe kështu, duke shfrytëzuar edhe ndihmën nga jashtë si dhe plogshinë e Perandorisë Osmane nga brenda bënë parapërgatitjet e duhura rreth hulumtimit të terrenit gjithnjë pa e ndërprerë duke shfrytëzuar edhe bashkëpunimin me Turqinë, dhe kështu gjithsesi duke spiunuar për individë me ide rilindëse shqiptare duke u bërë lajka faktorëve të Turqisë Kisha serbe me faktorë të saj vepronte e lirë gjithkëndej, andaj edhe bëheshin parapërgatitjet për ekspansion, por pritinin momentin e duhur për veprim.

Së pesti, në përgatitje terreni duke shfrytëzuar pra manipulimin e lirë të Kishës serbe, dhe ndikimit të fuqive të jashtme në përkrahje të reformave të dëshiruara në Perandorinë Osmane u shfrytëzua organizimi dhe përhapja e shkollave serbe si dhe meshat e festat fetare familjare pravosllave në të cilat e u krijuan apo ripërtrinë duke u përkthye nga shqipja sadokudo këngë e tregime kulturi me gojëdhana e legjenda të harruara ose edhe të imagjinuara për të kaluarën e hershme gjoja të lavdishme e përshtirëse ortodokse, të cilat moren konotacion të ri një nacional sllavo-serbe, dhe në këtë kontekst propagandimi doli edhe misioni i M.S. Milojeviqit, i këtij punëtori të palodhur serbomadh i këtij krijuesi me fantazi të bujshme, të cilit iu mundësua misioni lidhur me ballafaqimin me shqiptarët dhe në këtë kontekst u përfutua ndër të tjera edhe sajesa e Sifjalorthit në shqyrtim. Sidoqoftë, edhe ne e vlerësojmë Milojeviçin, si e njohin të tjerët, veprimtar i Naçertanies, serbomadh, siç e tregon veten me punë të palodhur, si udhëpërkrues, si një historian e shkrimtar me fantazi shumë të bujshme, dhe në mënyrë të veçantë si një propagandist i dalluar i pansllavizmit edhe si ushtarak, ku në qendër të vëmendjes kishte Serbinë dhe serbishten, kështu në kuadër të veprave të tilla në fushën propagandistiko-publicistiko-letrare mund radhitet edhe vëllimi i tretë i veprës **Putopis...** në kuadër të së cilës u përfshi edhe Sifjalorthi shqip-serbisht.

Lidhur me këtë shtrohet pyetja atëherë prej nga ideja ose arsyeja pse ne e quajtmë Sifjalorthin **“kontribut në e për gjuhën shqipe”**. Në mënyrë që përgjigjja të jetë më e kapshme më duhet të rrëfhem. Gjatë lexim-studimit të metodave dhe drejtimeve të disiplinave letrare-shkencore me ka pasë ra në sy *metoda stilistike e studimit të një vepre*, ngase atëherë nuk dinim se dallohej stilistika gjuhësore nga stilistika

letrare, dhe së andejmi ruajmë në kujtesë konstatimin e përvetësuar nga ai mësim, të cilin po e parafrazojmë:

Edhe nëse kritikohet ose i mohohen vlerat një vepre ose objekti, duhet konsideruar si punë pozitive për vetë faktin, ngase dihet se çdo objekt (punë, vepër) ka së paku dy faqe, prej nga mund të vështrohet deri në hollësi e thellësi, mirëpo çdo qasje qoftë nga e jashtmjja, qoftë nga e brendshmja paraqet kompleks më vete, madje edhe kriteret vlerësuese mund të ndryshojnë varësisht nga ndërrimi i raporteve shoqërore-politike në kohëhapësirën përkatëse etj.

Prandaj kërkujmë mirëkuptim nga lexuesi dhe të interesuarit lidhur me pikëvështrimin tonë rreth Sifjalorthit apo veprës së tij kundër gjuhës shqipe e shqiptarëve dhe në anë tjetër del **në e për të mirë të shqipes e shqiptarëve**, andaj po theksojmë konkretisht, siç gjykojmë ne, kontributin që del nga lënda e atij Sifjalorthit të Milojeviçit. Jemi të vetëdijshëm për këtë që thamë. Jo se duam të nxjerrim *dhjam prej pleshti*, por në qasjen tonë rreth këtij Sifjalorthi dygjuhësh, vërtet, shohim njëfartë kontributi që do ta sqarojmë më poshtë, andaj, pa marrë parasysh *argumentat* tanë mbështetës kërkujmë që të ndiqen me vemendje të zgjuar arsyetimet tona, pse po e konsiderojmë sot kontribut punën e para 150 vitësh të Milojeviçit, kohë kur edhe është sajuar ky Sifjalorth.

Në të vërtetë, ne aspak nuk na ka admiruar sajuesi i Sifjalorthit dhe veprimtaria e tij kundërshqiptare, qoftë si propagandist, qoftë si luftëtar e komandant, por na ka joshur vitaliteti i jashtëzakonshëm atavik i fjalëve të përzgjedhura nga gjuha shqipe nga ai në atë Sifjalorth ndaj serbishtes së përpunuar, të cilat edhe atbotë, edhe pse shqipja për autorin nuk ishte gjuhë as e shkruar as e përpunuar letrarisht, fjalët e asaj gjuhe iu imponuan sajuesit në funksion barasvlerësie si palë e barabartë. Dhe kjo, jo vetëm që dëshmon barasvlerësi të barabartë me serbishten e përpunuar, madje me disa shprehje, për ndonjë nocion, siç do ta shohim praktikisht, të formëzuara historikisht, del edhe në supremaci (eprani) ndaj barasvlerësve të serbishtes.

Sidoqoftë, meqë, ky tekst-dokument, mesa dimë, për herë të parë prezantohet para opinionit lexues e studiues, ne do të përipiqemi edhe paksa guximtarisht por me synim të qartë me i shprehë disa mendime e venerime, gjithsesi jo shterruese në të mirë të historikut të fjalëve ekzistuese të gjuhës shqipe të shekullit XIX të shënuara këtu me alfabet cirilikë. Dhe vërtet për disa vlera fjalësore që atë ditë e sot qëndrojnë si

veçori të veçanta të parrëzueshme të gjuhës shqipe do të japim arsytimin në këto dy pika:

së pari, do të përmendim Sifjalorthin si argument faktik që nuk mund të mohohet dot në të dyja gjuhët dhe

së dyti, do të vëmë në spikamë disa konstatime e venerime karakteristike që në radhë të parë vlejné si kontribut për gjuhën shqipe që gjithsesi i kalon caqet e ngushta të historikut të raportit barasvlerës thjesht ndërgjuhësor shqip-serbisht, shkruar në cirilicë në shek. XIX.

a) Konstatime për kontributin e Sifjalorthit dygjuhësh që si veçori argumentuese nuk mund të mohohet dot në të dyja gjuhët

Mesa na merr mendja ky Sifjalorth dygjuhësor shqip-serbisht patjetër duhet të zëre vendin që i takon në raportin ndërgjuhësor shqip serbish, ngase i plotëson këto kushte a veçori:

E para, me sa dimë qëndron si vepër-dokument i parë ku dalin të shënuar mbi 300 fjalë e shprehje të shqipes me azbukën serbe cirilicë, të cilat edhe janë përkthyer në serbisht.

E dyta, ka rëndësi historike, që nuk mund të mohohet dot, ngase në periudhën 10 vjet e tutje para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, barasvlerësit e shqipes së papërpunuar si gjuhë letrare bashkëkohore vihen në barasvlerësi të plotë me serbishten letrare si gjuhë e përpunuar moderne për kohën në krahasim me shqipen.

E treta, nuk mund të mohohet fakti se në këtë Sifjalorth është pëdorur i njëjti alfabet për të dyja gjuhët.

E katërta, për atëbotë ka rëndësi shoqërore-politike në raportin ndëretnik shqiptaro – serb, sepse të dyja etnitë nga trevat që u mbledhën fjalët shqipe ishin nën administrimin e Perandorisë Osmane.

E pesta, në mungesë të faktorit informativ shqiptar nuk mund të mohohet as qëndrimi subjektiv i autorit, sajues i Sifjalorthit, i cili ka raste që fjalët i fryn me tendencë, duke cilësuar e paragjykuar domosdo prejardhjen serbe të fjalëve shqipe.

b) Konstatime e venerime si kontribut që nuk mund të mohohen dot si veçori të gjuhës shqipe

Ndër veçoritë të cilat nuk mund të mohohen dot që vihen re në tekstin në gjuhën shqipe të Sifjalorthit, veçojmë:

E para, edhe pse në këtë Sifjalorth është përfshirë një fond fare i vogël i fjalësit të gjuhës shqipe, konstatojmë se aty mbizotërojnë trajtat e përbashkëta të shqipes globale, edhe pse në tekst janë disa trajta karakteristike që u takojnë kryesisht të folmeve lokale, si p.sh: *shif, nja, magjar* etj.

E dyta, përveç të përbashkëtave dallohen shlrë disa trajta karakteristike të dialekteve toske e gege, por edhe disa trajta arkaike, si me thënë, lashtoshqipe si:

- a) toskërisht: *lakra, zok, (m)buluar, më fal zot!, shqa, kokë* etj.
- b) gegnisht: *shpia, hana, vo-ja, pllamb, andërr, dhandërr, femën* etj.
- c) lashtoshqipe ose raste arkaike!, ngase në shkrimin shqip të tij del diftongu nga *-O/*UO*, të cilin *-UO/n* e përdor ai, edhe pse ndërkohë është zëbërthyer në: *UE/m, -U/ në gegërishte, përkatësisht në UE/n, U/n-* në kosovarishte, kurse në toskërishte *në UA/n* etj. Krahaso R/N: **UO/n* me **UE/n* gegnishtja e Kosovës etj.

Madje lidhur me këtë përveç arkaizmave : *muoj, gzuom, lakuor* etj. pati edhe lajthitje te rastet me *-YE* ose *-YER* që i shënon me *-YOR* (-uor), si lyOR, apo jo? Pastaj trajtat si pishq, nokta për natë, vitsh për viç e ndonjë tjetër, do t'i ketë kopjuar nga ndonjë burim apo studim i caktuar, sepse atëherë, me sa dimë 10 vjet para LSHP, sipas Fjalorit të Kristoforidhit, trajtat e tilla pothuaj ishin asimiluar në trajtat përkatëse letrare, apo jo?

E treta, edhe pse autori nyjet e përparme e pjesëzat, ashtu si edhe foljet ndihmëse etj. nuk i ndjen ndaras, andaj edhe i përziën me temën bazë, megjithatë është pozitiv fakti që autori paraqet ndonjë shembull me një karakteristike të asnjansit, si: *tshtruem, tegrít, tkuqtë, tambël* e ndonjë tjetër.

E katërta, edhe pse Milojeviçi në sqarime injoron ose mohen aftësinë e shqipes si gjuhë e gjallë e aktive ai në fakt demanton vetveten, sepse në barasvlerësi sjell një mori fjalësh e strukturash të fushave të ndryshme kuptimore të fjalëve shqipe sipas të gjitha kategorive gramatikore e stilistike, jo vetëm si emër e folje, por edhe si mbiemër, ndajfolje, përemër e numëror, por edhe si shprehje sinonimie, si p.sh.: *lakra e laknor, shtëpia e shpia, shenjt e shin, egër e egësisht, shok e shokac*

etj., të cilat tregojnë aftësitë aktive fjalëndërtuese e shprehëse të shqipes së asokohshme.

E pesta, siç dihet vitaliteti i një gjuhe shihet edhe në strukturën fjalëformuese e shprehëse, qoftë nga shembuj të trashëguar, qoftë në fjalë të rishtkrijuara, që i ndeshim si risime a përfitime rasti si: *vezët, shqijana, mentar, shokac, egërsisht, kambash* (kombësor), *sherbëtor* e ndonjë tjetër.

E gjashta, përveç këtyre risimeve fjalëformuese të shqipes në këtë Sifjalorth janë përfshirë edhe disa shprehje të veçanta të trashëguara të kulturës së mirësjelljes që siç do të shohim nuk kishin fare barasvlerësi kalkëzuese ndaj serbishtes etj. Të tilla janë afro 40 raste, shumica togfjalësha që ne po i ndajmë në katër grupe:

a. Folje jo të theshta, edhe pse autori nuk e ndan ndihmëtarin nga folja bazë, siç janë këta nëntë shembuj:

kam menduor, kam porositë, kam fejuom, ka nder, kam mbjellë, kam ça dru, kanë fituor, kam fluturuor, kemi kuvend.

b. Togfjalësha foljorë trajtash të ndryshme siç janë këto tetë raste:
bini dru, ndizni zjarr, mos qani, u gëzuom, pret zi, u pajtuam, hipi në kalë, zog na këndo.

c. Paskajore e mirëfilltë - 1 rast: *me mbathë.*

ç. Raste të tjera, me interes të veçantë, për të cilat po e jap edhe barsvlerësin e shënuar serbisht nga autori, sepse secili rast zgjon interes në vete, duke imponuar qasje vlerësimi nga njohësit ose studiuesit e të dyja gjuhëve, sidomos në krahasim me nënfushat semantike që mbulojnë, si:

Njeridek! (njeri i vdekur)- *mrtav*;

Tremet dhe! (tërmet) – *trese se zemlja*;

Pretzi (pranon të pamen, zinë!)– *zalost*;

Grua pa burrë (e ve) – *udovica*;

Bojgake - *crvenorujna boja etj.*

E shtata, bien në sy edhe disa prirje rreth shënimit të *trajtës përfaqësuese* në fjalor apo jo, si:

a) emrat e gjinisë mashkullore me bashkëtingëllore fundore shënohen në trajtën e njëjësit të pashquar si: *diell, akull, gisht, lis, rrush, zot, derr, faj* etj.

b) emrat e gjinisë femërore me bashkëtingëllore, përkatësisht me –Ë fundore shënohen në trajtën e njëjësit të shquar si: *bija, dardha, drita, dita, fara, era* etj. dhe

c) emrat e gjinisë femërore me –e fundore në trajtën e pashquar si trajtë përfaqësuese, shënohen po në trajtën e njëjësit të pashquar, si p.sh: *fe, faqe, paqe, nuse, lule, lajle*.

E teta, pa marrë parasysh qëllimin e tij që ta lidhë shqipen e lashtë me sllavishten e vjetër, për mendimin tim veprim pozitiv nga ai mund të cilësohet fakti kur heton shqiptimin e –**Ë-së** në shqipe dhe si zgjidhje për të parapëlqen grafën **Љ “jot”**, edhe pse vetëm në këta tre shembuj: *sËmunë, shËndosh dhe kËndo*, E quajmë pozitiv këtë veprim, edhe pse kjo **i** e shkurtër e sllavishtes nuk i përgjigjet shqiptimisht **Ë-së** së shqipes.

E nënta, edhe pse ka jo pak raste që tërheqin vemendjen e studiuesve sot, por që do të tërheqin nesër edhe më shumë, siç janë këto dy raste të veçanta:

Së pari, si barasvlerës të fjalës **shqa** (*shka, shkja*), aty shënohet katër trajtat: *slavenin, slav, rob e serbin*. Madje, edhe për barasvlerësin **shërbëtor** shënonn të tri trajtat: *serbin, slavenin, sluga*, sepse ai ishte në dijeni që në gjuhët klasike greke e latine dhe të tjera të dyja fjalët **schlav-* e **serv-* apo **serb-** përdorëshin me konceptin e një *sklavi* ose *shërbëtori*, siç është sqaruar kjo temë mjaft hollësisht edhe prej nesh po në këtë punim.

Së dyti, po e cek rastin **ujk**, barasvlerësin e të cilit në serbishte nuk e shënon **vuk**, por **kurjak**, që na jep me sugjerue se trajta *vuk*, sidomos **u-ja** e theksuar, mund të jetë e ndërndikuar shumë herët nga gjuha shqipe. Edhe ky rast është diskutuar prej nesh po në këtë punim.

E dhjeta, i ndamë veçan për fund, disa formula nga shprehjet përshëndetëse e të mirësjelljes, që po i shënojmë në barasvlerësi të plotë, siç janë të shënuara në Sifjalor, si:

- 1) **Mirdita!** – *dobrar dan,*
- 2) **Të më falish zot!** – *oprosti mi, gospodine,*
- 3) **Rrofshi e qofshi!**– *da smo živi i veseli,*
- 4) **Puna mbarë!** – *srećan vam rad,*
- 5) **Mbarëpaç!** – *i ti srećan bio,*
- 6) **U trashëgofsh!** – *da je blagosloveno korisno,*
- 7) **Natën e mirë!** – *laku noć,*
- 8) **Rand zamani!** – *teško vreme,*
- 9) **Lule e lajle!** – *cveće,*
- 10) **Për të mirë!** – *u zdravlje,*
- 11) **Të bafte mirë!** – *na zdravlje,*
- 12) **Na ka zbardhë!** – *uradio posao kako valja.*

Së këtejmi, mendojmë që secili rast për studiuesin mund të shërbejë si temë e veçantë krahasimi në raport shqip-serbisht, sipas aspektit *ndërgjuhësor, psikologjik, historik, shoqëror* etj.

Sipërfundim

Me sa pamë në këtë nëntitull të titulluar: *Rreth kontributit me pahir në e për gjuhën shqipe të Milojeviçit nga Sifjalorthi i tij*, të cilin e trajtuam në dy pjesë, në pjesën e parë përmendëm në pesë pika, 5 veçori, në të cilat theksuam që kontributi i Milojeviçit si sajues i këtij Sifjalorthi nuk mund të mohohet në të dyja gjuhët, shqip e serbisht, ndërsa në pjesën e dytë në dhjetë pika shënuam kontributin që vërehet qartë kryesisht në gjuhën shqipe, i cili nuk mund të mohohet dot, ngase edhe me atë barasvlerësi me fjalë të serbishtes, vitaliteti ekzistues i gjuhës shqipe përgenjshtron konstatimin e vet autorit gjoja shqipja atëbotë kishte mbetur si gjuhë amorfe dhe se gjoja ishte e asfiksuar dhe plotësisht gjoja qëndronte nën hijen e serbishtes, apo e gatshme të shkrihej në të, apo jo?! Dhe duke vazhduar me elaborimin e temës në vazhdim cekëm konstatimin tonë që edhe pse vëllimi i vogël i fjalëve të përzgjedhura të shqipes në këtë Sifjalorth, shumica e tyre i takonte, fondit të përbashkët të shqipes globale, madje edhe atëbotë para 150-200 viteve edhe këto fjalë e shprehje pasqyronnin në njëfarë dore realitetin e njëherazi edhe vitalitetin e gjuhës shqipe më fortë të bashkuar se të të ndarë në dy dialekte kryesore; toske e gege, mirëpo përveç kësaj ndarjeje dhe fondit kryesot të përbashkët aty ndeshim edhe trajta arkaike ose lashtoshqipe.

Si pikë më vete ndër te tjera, cekëm prirjen rreth mbizotërimit të kategorisë së shquarsisë të emrave, prirje kjo shihet edhe te Fjalori i F. Bardhit (1635). Kështu në fjalor si trajtë përfaqësuese për emrat femërorë del trajta e njëjës të shquar, tipi: *bija, drita* etj., ndërsa te emrat e gjinisë mashkullore mbi temë në bashkëtingëllore si trajtë përfaqësuese del njëjësi i pashquar, tipi: *lis, det, gjak, djall, zjarr, rrush* etj.

Në mënyrë të veçantë, zgjojnë interes disa shembuj formulash e shprehjesh të mirësjelljes të trashëguara mija e mija vjet më herët, por të regjistruara nga Milojeviçi para 150 vitesh, të cilat përdoren edhe sot në të gjitha trevat shqipfolëse që disa nga to do t'i trajtojmë në nëntitullin në vijim.

5) Komenti ynë i shkurtër rreth disa shembujve që dëshmon modelin e formëzimit shqip të shprehjeve të tilla që nga lashtësia

Për të treguar rëndësinë e lëndës së këtij Sifjalorthi, nga pika e dhjetë shkëputëm këto 8 raste të cilat insistojmë të krahasohen barasvlerësisht për të dalluar kështu nivelin dhe natyrën e dy gjuhëve siç qëndronin dhe qëndrojnë edhe sot në barasvlerësi, njëra pranë tjetrës, shqipja atëherë gjuhë e papërpunuar shkrimisht, në njërën anë, dhe serbishtja gjuhë e shkruar dhe e përpunuar, në anën tjetër.

Shembuj e përzgjedhur prej nesh po i paraqitim në formë table krahasuese, në 5 rubrika:

1. Numri rendor.
2. Nënfisha semantike përkatëse.
3. Teksti shqip nga Sifjalorthi.
4. Përkthimi ose baravlerësi serbisht nga autori.
5. Përkthimi i fjalëpërfjalshëm (bukval) prej nesh.

Tabela krahasuese e disa fjalë-shprehjeve

Numri	Nënfisha semantike	Teksti shqip nga Sifjalorthi	Teksti serbisht i përkthyr nga autori	Përkthimi bukval prej nesh
1.	Urim dollibashi:	Rrofshi e qofshi!	<i>Da smo zivi i veseli!</i>	Të jemi gjallë e të gëzuar!
2.	Urim pune (dialog):	Punambarë! Mbarëpaç!	<i>Srećan vam rad!</i>	Me fat puna! Edhe ti qofsh me fat!
3.	Urim martese:	U trashëgofsh!	<i>I ti srećan bio!</i>	Që (slavo)bekimi
4.	Zbukurime,	Lule e lajle!	<i>Da je blagosloveno</i>	të jetë i dobishëm.
5.	dekor	Për të mirë!	<i>korisno!</i>	Lule.
6.	Urim në qerasje:	Të baftë mirë!	<i>Cveće.</i>	Për shëndet!
7.	Urim pas ushqimi:	Na ka zbardhë!...	<i>U zdravlje! Na zdravlje! Uradio posao kako valja.</i>	Me shëndet! Ka bërë punë të lavdishme

Lavdërim, shprehje figurative:			
--------------------------------------	--	--	--

Sado që ne nuk kemi kurrfarë pretendim-përçmimi në krahasimin e vlerave të shprehjeve ose të fjalëthirrmeve të tilla në raport anasjelltas ndërgjuhësor, ngase respektojmë natyrën e secilës gjuhë, megjithatë duam të tërheqim vëmendjen në autonominë semantike të formëzimit si dhe lashtësinë e shprehjeve të gjuhës shqipe në krahasim me ato të serbishtes përmendim disa fakte apo veçori:

a) Siç po shihet barasvlerësit e shqipes nuk dalin aspak nën hijen kalkëzuese a korresponduese të barasvlerësve të serbishtes.

b) Veçori tjetër përmendim faktin, edhe pse trojet shqiptare ishin të coptuara ndërkohë deri në ditët e sotme, vërejmë se shprehjet e tilla të shqipes të para 150 vitesh, si atëherë edhe tashti, janë të shtrira me trashgim në të gjitha viset shqipfolëse me të njëjtin kuptim.

c) Së këtëjmi, jepet me u kuptue mirëfilli se këto shprehje ashtu si edhe të gjitha fjalët shqipe nga Sifjalorthi ishin formëzuar e përpunuar në mendjen e gojën e masës shqipfolëse të të gjitha viseve të Siujdhesës Ilirike e më gjerë me mija e mija vite më përpara, edhe pse folësit e tillë mund të jenë quajtur nga të huajt e mbase edhe nga vetvetja me emra të ndryshëm ndoshta edhe *serbë, bullgarë, rumunë, grek, madje edhe turq e latin* e ku ta dimë, varësisht nga zonat gjeografike apo fetare ku jetonin e vepronin.

ç) Sidoqoftë, edhe pse ne do të dëshironim të gjejmë fakte të shkruara edhe më të hershme edhe më serioze se këto që i la Milojeviçi, mund të themi me plot gojë që edhe këto fjalë e shprehje që i kemi në dispozicion nga Milojeviçi jo vetëm dëshmojnë të vërtetën rreth vazhdimësisë së gjuhës sonë pellazgo-ilire në këto troje, të përthyera ndërkohë në gjuhët atë folmet: dardano-epiroto-arbnore-shqipe apo arvanite, arbëreshe dëshmojnë njëherazi të vërtetën që gjuha jonë anase është e lashtë dhe njëherazi ishte dhe është në thelb gjuhë e pasur, po mjerisht jo aq e njohur dhe e studiuar në gjerësi e thellësi sa meriton, as nga të huajt as edhe nga studiuesit tanë të sotëm, të cilët më me vullnet po i studiojnë gjuhët e huaja se të veten, mjerisht?!

d) Gëzon fakti se të gjitha përshëndetje me *Rrnofsh e Qofsh*, me të *Mbara* e me të *Mira*, si dhe me *Zbardhje fytyre e pune* si dhe zbukurimet me *Lule-lajla*, ashtu si edhe pëshëndetjet e tjera të shumta si: *Tugjatjeta, Përshëndetje, Mirupafshim, Lamtumirë, Të lumtë puna, Lum qofsh e*

udhambarë, Si ke nje(h)!, Koftë mirë! –Mirësevjen, Qofsh shëndosh e me të mira!, Kjofsh faqebardhë! etj. etj., janë krijuar mbi bazë të fjalëve autoktone të shqipes dhe vijnë të trashëguara e të përpunuara nga goja, mendja e zemra e shoqërisë shqipfolëse me mija e vite gjallese në këto troje, të cilat me konceptet që mbulojnë mund të krahasohen me shprehjet kulturore civilizuese të gjuhëve më të zhvilluara të botës.

Kështu, pra, edhe për këto fjalë e shprehje të shënuara para 150 vitesh nga Milojeviçi dëshmohet argumentueshëm, jo vetëm autoktonia shqiptare (pellazgo-ilire, dardano-epiro-arbnore), por edhe shkalla kulturore e njerëzore e shoqërisë shqipfolëse, andaj për këtë kontribut me pahir ne e respektojmë dhe falenderojnë penën e personit Milojeviç, apo jo?

Së këtejmi, ne këtu pra e shohim kontributin e mirëfilltë të Milojeviçit kryesisht si sajues të Sifjalorthit, i cili edhe pse nuk e cek qartë, këto fjalë mund t'i ketë dëgjuar në të gjitha viset shqipfolëse, qoftë në Arnautllëkun Verior (Serbia Jugore e sotme), në Kosovë (Prava Serbi), në Malësitë Shqiptare Stara Serbi), Maqedoni, qoftë edhe, siç e pranon vet që i paska shënuar në Epir e Albani, të cilat bëri mirë që i quajti **fjalë shkipe** (jo epirote, albaneze apo arnaute), të cilat gjithashtu bëri mirë që u dha vendin e parë në sifjalorth dhe që i përktheu në serbishte, qoftë me përshtatje jo bukvalisht siç u dëshmuam ne në këtë Tabelë dhe në këtë mënyrë, ndonëse nuk i shënoj saktësisht, bëri eksplorim të denjë të shprehjeve e fjalëve të tilla sipas natyrës së gjuhës shqipe.

Për këtë kontribut, që po e përsërlis disa herë, të cilin mbase pa e vra mendjen e bëri me pahir, ai, duke i shënuar barasvlerësit e tillë i ofroi dhe i ngriti e i ndriti vlerat e jashtëzakonshme që shqipja i kishte të trashëguara nga thellësitë e kohëve, andaj për këtë punë, sipas nesh, edhe meriton të falenderohet.

Sidoqoftë, sa për ilustrim pse Milojeviçi meriton të falenderohet po i përmend vetëm këto raste, cikërrima në dukje:

Së pari, spikasim shprehjen figurative *E ka zbardhë...*sepse pikërisht shprehjet e tilla figurative me ngjyresë artistiket tregojnë se shprehje të tilla nuk i kanë gjuhët amorfe, por gjuhët e gjalla me taban të fortë, të formëzuar në kohëhapësirë, vlerë kjo që gjithsesi ka perspektivë të qartë premtuese.

Së dyti, shprehjen: *lule-lajle*, të cilës nuk i ka gjetur barasvlerësin adekuat në serbishte, ngase kuptimi i kësaj shprehjeje nuk ka vetëm konceptin e **lules- cvet cvece** që korrespondon sadokudo me të serbishtes,

sepse fjala e dytë anase e shprehjes **lajle** në shqipe si atëherë si edhe sot ka shumë kuptime, po si më kryesore në shprehjen e shënuar, bën një bashkëdyzim konceptesh të dy fjalëve: **lule + lajle**. E do puna që të zgjerojmë edhe pak sqarimin rreth fjalës së dytë: **lajle**, e cila si fjalë autonome e shqipes ndër të tjera, ka edhe konceptin që nënkupton edhe zbulimin i rrobave me qëndizma lulesh etj. E theksuam në mënyrë të veçantë këtë fjalë shqipe **lajle**, jo për faktin që bashkë me fjalën tjetër lule, duke i bashkuar konceptet e bëjnë shprehjen me kuptimësi të veçanta, sigurisht më të përplotë, por edhe për arsye se si duket këtë shprehje e kemi të gjetur e të shënuar në gjuhën shqipe të shkrimit së pari nga ky sifjalorth i Milojeviçit. Kështu themi sepse prof. Kolec Topalli në fjalorin e tij e përmend se **lajle** si fjalë popullore e karakterit i.e., është përdorur (së pari!) në gjuhën e shkrimit nga Gj. Fishta, ndërsa ne tani po e vërtetojmë se pëpara Gj. Fishtes, si gjymtyrë të shprehjes **lule-lajle** Milojeviçi, e paska futur në Sifjalorthin e tij shumë më heret, duke mos e ngatërruar konceptualisht me fjalën *lalë lala*, që është fjalë e përbashkët e disa gjuhëve ballkanike, pra edhe e shqipes edhe e serbishtes.

Së treti, krahaso gjerësinë universale në kohëhapësirë të shprehjes përgëzimore: **U trashëgofsh** me barasvlerësin serbisht **Da je blagosloveno korisno (Që sllavobekimi të jetë i dobishëm)**, ku krahasohet dëshira **për trashëgimi** pa kufizim ndaj **sllavobekimit fetar**, madje trashëgim në frymën e një nënriti fetar njënacional, apo jo?!

Së katërti, gjithashtu po e përmend (jashtë protokoll) përsëndetjen shqiptare me kuptim universal që praktikohej në takimet shqiptare **Ngjat jeta!- Tungjat me nder!** apo **Koftë mirë!** që praktikohej kur hyhej në odat tona, që merrte përgjigjen **Mirë se vjen!**, e cila shqiptarisht nuk mund të krahasohet me përsëndetjet e mëvonshme të përkufizuara me ngjyrë fetare: **Selam... ose Koftë lavdue...**, madje edhe me vetë shprehjen e re assesi jokritikuese: **Përsëndetje**, apo jo?!

Së pesti, krahaso edhe përsëndetjen dollibashe: **Për të mirë**, serb. **U zdravlje (Për shëndet)**, ngase *shëndeti*, është vetëm njeri për të mirave që urohet, apo jo?! Pikërisht këtë rast përsëndetjen dollibashe karakteristike veriore **Për të mirë!** që prejse e mbaj mend përdorej kështu te ne gegni e më gjerë, po e krahasoj me atë të tashmen urojmë jugore **Gëzuar!**, që tashmë e kemi të përvetësuar mrekullisht me kënaqësi shprehie pa dallim nga të gjithë shqiptarët në këtë trajtë, por shfrytëzoj rastin me rikujtue të gjithë kuqezinj të këto dyshprehje **për të mirë** e **gëzuar**, siç i kemi përdorur gjatë levizjes sonë sonë ilegale që tashmë

duhet afirmuar edhe legalisht si përshëndetje të përbashkëta mbarëkombëtare: **Për të mirë e Gëzuar në Shqiprinë e bashkuar! // Gëzuar e Për të mirë në Shqipninë tonë të lirë!**

Në fund, duke mos mohuar kontributin me pahir të Milojeviçit, nënkuptohet e vërteta, se merita i takon pikërisht vetë gjuhës shqipe, popullit që e foli në vazhdimësi në trollin e vet këtë thesar të jashtëzakonshëm, me të cilin shqipja kulturisht me këto shprehje mund të hyjë lirshëm, pa u skuqur fare si në odat tona të moçme, në të gjitha sallonet solemne moderne që karakterizohen me shprehje përshëndetëse kulturore botërore. Themi kështu sepse vlera e tyre, sidomos e shprehjeve origjinale të trashëguara të mirësjelljes, që doli në pah edhe nga krahasimi i tri versinoneve nga Tabela e mësipërme, mund të krahasohen me shprehjet e rralla nga gjuhët klasike dhe nga burimet parabiblike e biblike në njerën anë, por në anën tjetër, si gjuhë e gjallë që fatlumnisht ekziston, ngase përballoi shekuj të rëndë, por megjithatë arriti të mbijetojë, edhe pse pa pasur unitet shtetëror të qartë historik, me këto shprehje mirësjelljeje kulturore pa ndjenjë përulësi semantikiisht mund të krahasohet edhe me gjuhët e shteteve më të zhvilluara të Europës dhe të botës, apo jo?!

Gjithsesi ky Sifjalorth zë vend të parë si dokument në historikun e fjalorëpërpiluesve serbë dygjuhësh shqip-serbisht nga shekulli XIX.

Përmbyllje

Mesa pamë nga shtjellimi i lëndës, edhe pse vazhdonte injorimi i gjuhës shqipe nga Milojeviqi, e veçanta e këtij kreu është: *kontributi me pahir i autorit pikërisht në e për gjuhën shqipe*, ndihmesë kjo e cila shfaqet brenda shkrimeve të tij. Këtë kontribut me pahir u përpoqëm me vënë në pah në katër nënkrerët e këtij kreu:

Së pari, rreth disa dromcave realiteti, përkundër qëndrimit subjektivit të Milojeviçit në atë kohëhapësirë ndaj shqipëve.

Së dyti, disa nga të dhëna hamendëse historike etimologjike të autorit lidhur me shqipët e gjuhën e tyre.

Së treti, rreth shënim-përkthimit të dyvjershave ngucakqe dhe shënimt të një kënge në gjuhën shqipe.

Së katërt, rreth Sifjalorthit shqip-serbisht (1873).

Dhe tani në këtë përmbyllje, me pak fjalë, po rikujtojmë radhazi përmbajtjet e këtyre nënkrerëve:

1. Disa dromca realiteti, përkundër qëndrimit subjektivist të Milojeviçit në atë kohëhapësirë

Ne, përkundër qëndrimeve subjektiviste të Milojeviçit në shkrimet e tij kemi vënë re dromca realiteti ndaj shqipëve që i trajtuam në 17 pika ndër të cilat po spikasim si pikë të parë se ai pranon vitalitetin e fiseve shqipe dhe gjuhën e tyre, të cilët i pranon si racë e lashtë me gjuhë të lashtë, por gjithsesi në hijen e serbëve dhe të serbishtes së vjetër(!). Shqipen aktuale përpiqet ta nënçmojë por me atë që e thotë vetë përgenjshtron vetveten, sepse ajo ka aq autoritet e forcë sa nuk e rregullon sistemin shqoqëror brenda shqiptar, por e ka asimiluar dhe po e asimilon sebishten, e cila vetëm bëlbëzohet nga të folme shqipe dhe si rezultat i atij asimilimi sipas tij është shtresa shumicë poturët jo vetëm muslimanë, por përdoret gjithkëndej jo vetëm nga ortodoksët e pa poturëzuar, por edhe nga popat e kishave.

Milojeviçi përkundër botëkuptimeve të mëparshme të tij nga cilat nuk mund të lirohet në shkrimet e tij argumenton se fiset shqiptare gege e toskë që para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit fiset jo vetëm "*poshkipjan-ët*": *Toska, Bardhi, Kastrati, Shala, Gashi, Berisha* dhe fiset e tjera si Kabashi, Leka flitnin dhe respektonin vetëm gjuhën e tyre "*shkipski*" si mbështetëse të parë të kombësisë dhe kështu na që na jep me kuptue se *poshkipët* ose *poshkipljan-ët*) që në atë kohë i kishin të përqafulara platformën e rilindësve, **që si bazë e parë kombësie për shqiptarët që atëherë paska qenë e formëzuar si ideal gjuha shqipe jo feja, përkatësisht jo një fe**, e cila nuk ndihmonte rilindjen e kombit, po respektoheshin të tri besimet shqipfolëse abrahamike, sidomos kjo ishte e përforcuar me trashëgim në familje fisesh, ku më tepër respektohej pastërtia e gjakut e vllaznisë fisnore se përkatësia fetare.

Gjithashtu nga shkrimet e tij del se verteta se ortodoks serbishtfolës kishte pak ose edhe aspak dhe këtë e dëshmon fakti se këngë për kishën e nuk ndëgjon dhe e shënon nga këngëtarë serbë, siç e pranon ai, qoftë nga katolikë (arnautë), qoftë poshkipanët poturë (muslimanë).

Ka edhe realitete të tjera që secila e ka rëndësinë e vet, prandaj ia vlen të dihen.

2. Disa të dhëna hamendëse historiko-etimologjike të autorit lidhur me shqipët e gjuhën e tyre

Në këtë nënkrye në 37 pika sollëm të dhëna më konkrete ku historia e shqipëve del e pasqyruar sadopak, duke u ndërlidhur edhe me fjalë shqipe. Kështu, si fjalë të parë që e quajmë kontribut mbase me pahir e konsiderojmë fjalën *shqip* që ai e përdor sipas theksim-shqiptimit gegë edhe, ndërsa në shumës e përdor sipas kontekstit në variantet: **shkipi**, **shkipe**, **shkipci**, **shkipimi**, **shkipuri**, **poshkipljanci** (të shqiptarizuarit), përkatësisht shprehjes **shkipski** jezik (gjuhë shqipe)/ E përdor këtë fjalë edhe si emërtim gjuhe dhe si emërtim etnie, veprim ky që e quajmë pozitiv, ngase të tjerët para e pas tij shqiptarët si etnitet i kanë përdorur përveç si arbanas, albanez, madje edhe: arnaut, latin epirot, madje në shpjegime i përdor me rrënjësi: arb- e alb-, por edhe lab- por në ndonjë rast edhe shkipitar. Sidoqoftë, shkipët lashtë nuk i përçmon, madje e pranon shkipen që ka ndikuar ehe në formimin e gjuhës serbe, por edhe që ka huazuar nga ajo.

Në mënyrë të veçantë ka meritë se shkipët me shqipen e lashtë të tyre kanë jetuar krahas helenëve, madje edhe maqedonët e lashtë i quan shkipë, të cilët para se të pushtoheshin nga latinët kishin pasur edhe shtetin e tyre, kuptohet me serbë të pranishëm, të cilët (serbët) para tyre i kishin populluar (!) viset e Ballkanit. Aty dalin gjëra të diskutueshme, por për ne pa diskutim e shohim meritë të tij që në vitin 1866 ka shënuar toponime në gjuhën shqipe që i vendos Milojeviçi në veprat e tij në fillim viti 1870, si p.sh.: Begudetskimi si krahinëza bregdetare, pastaj *Lukasipra* (*Lluka e Sipërme*)- *Gornja Luka* (sot *Lluka e Epërme*, *Lukaposhtra* (*Lluka e Poshtë*))-*Donja Luka* (sot *Lluka e Poshtme*, *Lumbarli /Lumbardhi që sqarohet me Beli Ljum* (*Lumbardhi*),madje edhe *Babalçoçe*, e cila përkthehet në rubrikën Kd në *Otac/blata* etj. Përveç kësaj përkthen disa emra si gora –mal , crna gora - malezi . **krshogori -krshmal** (**krshmalas**, **gurevcët - goranë** (**gur gor**), ashtu si edhe **Gash** e përkthen gora **Goran**, **Suljotët -Sllavjot**, **Shin Gjergjin-** (sv. Gjurgja! Gjurgjevdan), përkatësisht prejardhjet etimologjike popullorqe: **Sopjant** nga **Slavjot**, **Atika** nga **Otac**, **Duka Gjini** nga **Duha Gjini**, **Duka** nga **Duklje**, pastaj **Alba** ose **Laba** i ndërlidh me **labët**, të cilët i sqaron se janë **shkipë jgegë**, **Pelagonija**, sipas tij, shpjegohet nga shqiptimi i *shqipëve*: /**Pelagonë** (Bela Gunja), **Gramoz** e shpjegon **grad + most** (qytet+urë), **Nikopol** nga **Niqi + polje** (*fusha e askujt*).- **Rasha** (Rashka, Rassiena)-i ndërlidh me banorë **Selici**, të cilët sipas tij **jetonin në Dardani bashkë me shkipët** (sa *shkipurima*), të cilët përmenden gjithandej me emërtimin **gogë** (**mbase gegë apo gogë- torbeshë!**). Emri **Mirëdita**, shpjegohet e

pagëzuar nga i ati i Skënderbeut **Miran-Dan (Dobardan), magjar apo maxhar**), siç quhet hungarezi në serbisht gjojj ashtu është paghëzuar nga shqipët me kuptim pezhorativ **magarac(!)**. Emrin e Urës së Drinit: **O shvan** ose **Shvanski most** e shpjegon të formëzuar nga shqiptimi në gjuhën i shqipe i fjalës *Shin Stevan* (Shtjefën!!!) –Sveti Stefan /Oshvan/ Stefan (Hrapavi) ose Ivan (most) *Shin Ivan* **Sh/in/van /sh+ van/** Shvanski Most /Ura e Shin Stevanit? Madje një emërtim që ndesh andej mes Korçes e Manastit në trajtën **Ziaiscnska** e shpjegën me dy fjalë me të njëtin kuptin shqip e serbisht - **Zia+Crna sv.** Binë në sy edhe këto emërtime thjesht në gjuhën shqipe: **Lug Luga, Zoq Zoq. Kotare/Kotore ; Buzmakahala** (Burrëmahalle!) ose Buzmagaza (buzëmagaze!), **Kodralja/Kodralija (Kodra e Alisë).**

Gjithsesi zgjojnë interes këta shembuj ashtu edhe të tjerë të kësaj natyre.

3. Rreth përkthimit të dy vjershëzave ngucakeqe prej shqipes në serbisht dhe shënimit të një kënge në shqipe

Milosh S. Milojeviçi që në vërejtjet e para pasi u sistemua në bazat e caktuara serbe së pari , në Graçanicë (Prishtinë) sipas programi u lidh me bazën dhe së andejmi kaloi në Pejë. Atje, siç shkruan në Putopis, bën pjesë në skortën Patrikut, me të cilin, që ishte nën mbrojtjen zyrtare, nisen drejt Manstirit. Në rrugë e sipër, gjatë kalimit me shtëpive shënoi dy vjershëza ngucakeqe në shqip, si sharje, të cilat i përkthen dhe i komenton dhe gjithashtu në një rrugë pa rrugë në një fshat duke udhëtuar për Prizren në shoqërim me shokë kalorës që e shoqëronin *Igumanin e Kishës së Deçanit*, rastësisht në rrugë buzëarash ndesh këngëtar që në shqipe këndonin një këngë kushtuar pikërisht këtij Igumani, këngë të cilën e shënon po nuk e përkthen. Këngës i vumë emrin Kënga e Kumonës të cilën sadopak e analizuar.

Në të vërtetë, nga vjershëzat ngucakeqe si të veçantë, po shënojmë, se jo vetëm i shënoi dy vjershëza, por edhe e përkthei tekstin e tyre, me ç’rast manipuloi me afro 20 fjalë shqipe. Pra përveç rëndësisë dokumentuese të shkrimit të shqipes para 150 vitesh, mbi dhjetë vjet para Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878), ky veprim ka edhe rëndësi a, ngase veç tjerash pasqyron në njëfarë dore jetën reale politiko-shoqërore shqiptaro-serbe, përkatësisht pasqyron sadokudo gjendjen ndërftare brendashqiptare nëpërmjet vjershëzave të tilla ngucakeqe të nxitura nga

politika e pushtetit të atëhershëm turk, sipas motos “përçaj e sundo”.. Siç e ilustruam në punim edhe pse fragmenntarisht me disa vargje konkrete ngucakeqe lojëfjalësha përfëmijë, por që në versione të ngjashme përsëriteshin në kohën e rinisë sonë edhe në lojëkapuçash.

Ndërkaq, gjithsesi kontributi i Miljeviçit në e për gjuhën shqipë nuk mund të mohohet nga përkthimi i vjershëzave ngucakeqe dhe aq më tepër nga regjistrimin e një këngë popullore shqipe të papërkthyer, siç ishte **Kënga e kumbonës**, rëndësia e së cilës më tepër u pa në aspektin jashtëgjuhësor politik se në atë artistik gjuhësor, po megjithatë e veçanta e kësaj kënge del se aty manipulohet me afro 60 fjale e shprehje, të cilat ishin në përdorim në gjuhën shqipe, para 150 vitesh.

4. Rreth Sifjalorthit shqip-serbisht (1873)

Këtij nënkreu i kushtuam më shumë vend, duke u ndaurm rreth vlerësimit të sajimit e përkthimit të një grumbulli fjalësh mbi 300 sosh që ne e quajtmë *Sifjalorth shqip-serbisht (1873)*, të cilin e trajtuan në këta pesë nëntituj:

a) Paraprovë euforike nga një mal serbizmash nga trevat që citohen nga autori se janë vjelë edhe fjalët e Sivjalorit shqip-serbisht

Në të vërtetë, autori Milojeviç, pas një mal serbizmash, sipas tij, në cilësi toponimesh të dyshimtë ose jo, të sajuar si ilustrim nga terreni solli edhe një grumbull fjalësh e shprehjesh shqipe nga Epiri e Albania, sipas tij, jo si pasuri, por, gjoja si mbetje amorfe nga shqipja e vjetër, gjuhë kjo, e cila sipas tij ishte në agoni, ishte në grahamat e fundit të asfiksimit, duke iu dorëzuar e tëra asimilimit në serbishte, edhe pse kjo hapësirë ishte nën sundimin e Turqisë dhe adminstrata ishte në atë gjuhë, ndërsa serbishtja pothuaj nuk kishte hapësirë përdorimi, pos në ndonjë kishë serbosllave. S’do mend se konstatimet e tilla ishin shumë të pambështetura, pa mëdyshje ishin *gënjeshtra të paskrupullta*, por që letra i bante, edhe sajime në frymën e Naçertanies, projekt-program ky që potencialisht parashihte gllabërimin e tokave shqiptare dhe me rrena të tilla do të arsyetohej ai pushtim, i cili edhe u miratua e nga disa shtete europiano e rusia që ishin të armiqësuar me Turqinë e dobësuar dhe dëshironin që gjithsesi atë ta shpormnin nga Ballkani, ndërsa për fatin e shqiptarëve dhe t[ë shqipërisë pak e vranin mendjen.

b) Rreth Sifjalorthit shqip-serbisht (1873)

Prezantimi i Sifjalorthit u bë në 5 rubrika, përveç numrit rendor, në rubrikën e dytë u shënua trajta shqipe e zbërthyer sa ishte e mundur në shqipen e sotme prej nesh, ndërsa në dy rubrikat e tjera u paraqit origjinaliteti i fotokopjuar i tekstit shqip e serbisht, kurse në rubrikën e pestë u bë ndonjë sqarim-plotësim, sidomos lidhur me trajtat e *shqipes së* përdëshiruar të autorit.

c) Venerimi e vlerësimi ynë konkret rreth paragënjeshtave dhe të metave formale e subjektivo-objektive të Sifjalorthit

Në analizë, së pari u shënuan në 11 pika disa nga gënjeshttrat e paskrupullta me të cilat parashërbehej verbërisht Milojeviçi si argati më besnik i nacional-shovinizmit serbomadh rreth injorimit të gjuhës shqipe dhe së dyti, gjithashtu në 12 pika u shënuan disa prej të metave të shumta dhe të llojllojshme formale e subjektivo-objektive që ka Sifjalorthi.

ç) Rreth kontributit me pahir në e për gjuhën shqipe sipas këtij Sifjalorthi

Gjatë trajtimit, së pari, në pesë pika u kontaktuan disa veçori si kontribut të Sifjalorthit që nuk mund të mohohen dot në të dyja gjuhët, ndërsa së dyti, gjithashtu u veneruan në 10 pika e 12 nënpika disa veçori të këtij Sifjalorthi si kontribut kryesish **në** e **për** gjuhën shqipe që nuk mund të mohohet dot.

d) Komenti ynë i shkurtër rreth disa shembujve konkretë si kontribut model në krahasim me serbishten

Në fund, u konstatua se disa shembujt konkretë dëshmojnë lashtësinë dhe përditshmërinë e formëzimit shqip të fjalë-shprehjeve të tilla dhe në mënyrë të veçantë në një tabelë krahasuese u dalluan disa fjalë e shprehje nga nëntitulli paraparak që për nga cilësia avancojnë kuptimisht në krahasim me barsvlerësit në serbishte.

Gjithsesi edhe veprimi ose kontributi me pahir i Milojeviçit rreth përkthim-përshtatjes dhe sajesa e Sifjalorthit shqip-serbisht, duhet të njihet dhe të vlerësohet nga studiuesit tanë e të huaj dhe në veçanti nga ata serbë e shqiptarë.

Së këtejme, nga të pesë këta nënkrerë të këtij kreu, dalin afro 400 fjalë e shprehje shqipe të cekura në ndonjë mënyrë, qoftë të sqaruara etimologjikisht ose të përkthyer shqip-serbisht nga Milojeviçi, prandaj edhe emri i tij gjithsesi duhet të zërë vendin përkatës në historikun e përkthyesve, përkatësisht të fjalorhartuesve shqip-serbisht të shekullit XIX, por zgjon interes edhe e për qëndrimin e tij kontravers, por paksa më objektiv se shumë të tjerë pas tij për shqiptarët (shqipët) e lashtë e gjuhën e tyre si dhe për shqiptarët (shqipët) e kohës së tij, gjuhën e të cilëve e dëshironte të shkrirë në serbishte, përkatësisht në serbishten e zgjeruar me fjalë shqipe(!), apo jo. Gjithsesi jo pak gjëra mbesin për t'u vlerësuar e sqaruar nga ekipet përkatëse të profilizuata të institucioneve kompetente.

**PËRFUNDIMI I VËSHTRIMIT KRITIK HISTORIKO-
GJUHËSOR I VEPRËS INJORIMI DHE DËSHMIMI
I GJUHËS SHQIPE SI KRITER I SË VËRTETËS
NGA M. MILOJEVIC (1873)**

**(me shkas vepra e M. Vemic *Etnicka karta dela Stare Srbije*, (2005),
hartuar sipas veprës “Putopis dela Prave –Stare Srbije” (1866-1873)
nga M. Milojevic)**

Sihyrje

Edhe pse përmbajtja e veprës në shqyrtima “*Harta etnike...*” sipas Putopis-it të M. Milojeviçit i takon shekullit të XIX, dhe se ishte hartuar në përputhje me projekt-idenë “Naçertanie”, program i nacional-shovinizmit serb, kur *garashaninët makiavelistë* bënë parapërgatitje intensive të shumanshme në proces e sipër rreth mënyrës së smadhimit sipërfaqësorj të Principatës serbe, ku do të përfshihej jo vetëm e ashtuquajtura Serbia Jugore si pjesë Serbisë së Vjetër), por edhe krejt Stara Serbia (Kosova me Sanxhak e Malësi , Maqedonia, Shqipnia etj që Milojeviçi e quan **deo Prave stare Srebije** (*pjesë Serbisë së Vërtetë (të vjetër)*), duke llogaritur asimilimin ose edhe shfarosjen e penguesve në këtë rrugë, siç llogariteshin shqiptaro-turqit. Ne, gjatë analizës konstatuam se të dhënat nga ai burim (*Etnicka, karta...*) për Kosovën, pothuajse në tërësi, siç e pamë në kërret e mëparshëm, mbase të evidentuara me pahir nga autorët, i parë dhe i dyti, dalin qartë me efekt të kundërt, sa i përke shumësisë, ngase shumësia del në dobi të shqiptarëve autoktonë, del në dobi të së vërtetës, e vërtetë kjo që aty është keqinterepretuar, andaj për dikë për mungesë koncepti mbase edhe ishte keqkuptuar, prandaj themi, me plot bindje se ajo e vërtetë historike shkencore që paraqitet prej nesh u kthehet dhe rrah bumerang (grushtakreje) sot ndaj të gjitha vatrave ose mbeturinave të nacional-shovinizmit makiavelist serbomadhi, i formuar e selitur sipas frymës së Kishës ortodokse serbe, të shprehur në afro 40 programe të tjera kundër shqiptarëve, sepse, nëse lexohen drejt shifrat në atë burim, përqindja e popullsisë dhe etnogjeneza për popullatën e Kosovën nuk del aspak në dobi të etnisë serbe, por sadopak del e nevojshme të qartësohet e kaluara e ortodoksisë shqiptare në trevat tona, ngase ishte gabim tejet i madh kur aludohej se vetëm katolikët ishin shqiptarë, ndërsa të gjithë ortodoksët i

takonin etnosit në të ashtuquajtur serbe, madje edhe më keq sipas kuptimit të sotëm njënacional. Serb.

Ç'është e vërteta, Milojeviçi e grupi i tij sipas detyrës që kishin për realizimin e planit të Naçertanies, më tepër shihnin pengesa nga shqiptarët as bga turqit, po nga bullgarët me gjuhën e tyre, andaj morën fushatë të organizuar që t'i neutralizonin bullgarët. Dhe këtë sadokudo e bënë ndërkohë në marrëveshje me Greqinë si dhe më së shumti me sforcimin e raporteve tinzare rreth përvetësimit të ndërlidhjes me Rusinë, me Turqinë dhe shtete perëndimore si Franca e Anglia. Kështu, duke shfrytëzuar armiqsinë e Ruisë ndaj Perandorisë Osmane serbët i mëshonin propagandës se *bullgarët* sipas tyre, edhe pse tani të sllavizuar, megjithatë origjina e elitës së saj ka qenë lashtoturke, andaj serbët si sllavë të kulluar në këtë anë, janë më të përshtatshëm për përkrahje kundërTurqisë,t, madje e kishin të gatshme propagandën se kjo sipërfaqe në mesjetë kinse kishte qenë tokë serbe, dhe pse aty kanë sunduar bullgarët (po me serbë) para Nemanjidve gjithashtu serbë (!), apo jo?! Ndërkaq, siç u paracek, nuk shihnin pengesa jo vetëm nga Turqia, e cila aso kohe jepte shenja patologjike si "*e Sëmura e Bosforit*", por as nga shqiptarët që si shumicë banonin në këto vise ngase ortodoksët shqipfolës i konsideronin serbë të mirëfilltë, për çka propagandisht edhe korrnin sukses me aktivizimin legalisht të klerit kishtar pravosllav, prandaj, në njërën anë, ishin për neutralizimin e masës shqiptare shumicë të islamizuar, duke bashkëpunuar me osmanlitë, për spastrim truri të tyre, përkatësisht duke e ndihmuar propagandisht politikën turke, e cila muslimanët kudo dhe sidomos shqiptaro-muslimanët i identifikonte si *etni turke* (turq osmanli) si bashkëqeverisës të dëgjueshëm në administratë në gjuhën gjithsesi shtetërore osmane dhe nga ana tjetër aktivistët garashanianë angazhoheshin me të gjitha mjetet e propagandës, deri edhe duke ua mbushur gushën me para familjarëve e krerëve përkatës, gjithherë jo pa sukses, për t'i bërë për vete përveç krerët muslimanë edhe ata katolikë. Kështu një propagandë të tillë nga Malësia, Has e Lumë e tutje deri në Mirditë e Shkodër do ta fuqizonin mësues e klerikë propagandistë vullnetarë të kualifikuar, siç ishte edhe M. Milojeviçi. Madje, si mbushamendje për europianët e gjithandej, përdornin opsionin rezervë si arsyetim plus, të cilin e plasuan që në Konferencën e Shën Stefanit (cituar sipas F. Xharrës) që kosovarët muslimanë e gjithandej edhe katolikët (!) në tërë hapësirën që shtrihej shumë thellë nga veriu, duke filluar që në Sanxhakun e Nishit, Pirotit etj. dhe më thellë në një pjesë të Stara Serbisë

(Kosovën e sotme), gjoja jo vetëm muslimanët shqiptarë, por deri edhe katolikët kishin qenë të gjithë serbë (garashanin-milojevic-gjorgjeviç), por ishin latinizuar, përkatësisht albanizuar në katolikë(!), e së andejmi ka edhe laramanë ortodoksë arnautashë që ishin islamizuar në masë me dhunë ose për interes nga osmanët e arnautët, andaj ata ose ajo masë *lypsej çliruar, duke i kthyer në fenë e të parëve*, (kuptohet) në *ortodoksë pravosllavë* dhe... me këso dokrra argumentash, politikë vërtet profesionalisht të rafinuar, jo pa sukses, ua mbyllnin gojën esytë e arsyes disa qarqeve vendëse e atyre europiane si nënrogoz edhe haptas. Dhe kështu jo pa taktikë, siç u tha, përgatiteshin intenzivisht për ndërmarrje pushtuese, por pritnin rastet më të volitshme që me ndihmën e politikës e të vullnetarëve rusë dhe me ndihmë eprorësh ushtrakë profesionistë nga disa shtete perëndimore, të nisnin ofensivën luftarake kinse kundër Turqisë me qëllim largimi të saj nga Ballkani, por qëllimi ishte të grabitnin (*çlironin*) gjoja tokat historike serbe, edhe pse në të vërtetë e dinin mirë qarqet e caktuara që ato toka kishin qenë dhe ishin iliro-arbërore shqiptare, po megjithatë përkrahnin ekspansionin.

Sido që ë ketë qenë, siç e kemi cekur në fillim të këtij punimi, deri sa ishim duke kërkuar në internet material rreth emërtimit të vendbanimeve të Kosovës, rastësisht m'u shfaq vepra e z. Mirceta Vemic, *Etnicka karta dela Stare Srbije*, botim i SANU-s (2005), hartuar sipas udhëpërshkrimit të z. M. Milojevic me titull "*Putopis dela Prave –Stare Srbije (1871, 1872 dhe 1873)*", material ky interesant i eksploruar në vitet 1866-1868 që kishte të bënte kryesisht me emërtime të vendbanimeve të këtij rajoni (Kosovës). Z. Vemic, kishte nxjerrë e seleksionuar nga tri vëllimet vetëm vendbanimet kryesisht me të dhëna statistikore me numër etnie, si serbë, arnautë, poturë etj. për tri Zona regjistruese pa tekstin tërësor të autorit.

Kështu në shikim të parë duke konsultuar këtë material, na ranë në sy jo aq ndryshime të emërtimeve të vendbanimeve, në krahasim me gjendjen e sotme zyrtare, serbisht e shqip, që i kisha në shqyrtim e sipër, por menjëherë m'u cyt kureshtja me shikue gjendjen sa i përket evidentimit të numrit të etnive të vendbanimeve para afro 150 vitesh, dhe menjëherë, duke nisur së lexuari shifrash nga fshati im i lindjes e fshatrat për-rreth e tutje në krejt Kosovën, pothuaj menjëherë na u shfaq dyshimi rreth vërtetësisë, sepse vumë re shumë pasaktësi. Shihej qartë se manipulohesh keqas sidomos me interpretimin e kuptimit të etnisë së ashtuaquajtur *poturë*, etni kjo që në tekst dilte shumicë në krahasim me

etnitë: *serbë* e *arnautë* e të tjera, por që të gjithë *poturët* në statistikën përfundimtare llogariteshin serbë, edhe pse, siç dihej aktualisht dhe në kontinuitet para 150 vitesh popullsia e tillë e pashpërngulur kishte qenë shqipfolëse. Kjo më dha shkas që pas konsultimit të krejt tekstit nga z. Vemic si dhe ndërkohë edhe të tre vëllimeve të veprës së cekur në origjinal (të z. Milojeviç nga interneti), u motivuan që tërë lëndën rreth kësaj teme ta trajojmë me seriozitetin e duhur shkencor. Si rezultat i kësaj pune u botuan 7 krerë në portalin www.zemrtashqiptare.net, nën titullin bosht: **Injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës...**(*vlerësim historiko-gjuhësor*), prandaj këtu në këtë përfundim-përmbyllje të analizës do të përqëndrohemi vetëm në këto tri pika:

Së pari, dy fjalë rreth personit kontraverz Milosh S. Milojeviç, i cili, edhe pse e injoron alergjikisht shqipen, me shikue pragmatikisht, nën profilin e një punëtori kulturo-gjuhësor, me këtë vepër më shumë i ka kontribuar të vërtetës për *Kosovën shqipfolëse*, sesa të vërtetonte kauzën: *Kosova Serbi e Vërtetë (Prava Srbija)* edhe gjuhësisht, siç e kishte mbase për zemër ose të kurdisur si porosi nga Qendra apo nga elita shtetërore e fetare e nacional-shovinizmit serbomadhi të asaj kohe, ta thoshte dhe ta konstatonte.

Së dyti, do t'i përsërisim me radhë titujt e krerëve të punimit, duke i shoqëruar secilin krye me pyetjen përkatëse motivuese dhe me një *abstrakt* (përmbajtje të shkurtë), ilustruar me ndonjë nga faktet që mendojmë se ndihmojnë dhe lehtësojnë mjaftueshëm frymëmarrjen e kujtesës, të mbamendjes dhe të gjykimit të drejtë që ndërlihet me të kuptuarit e realitetit të atëhershëm, nga të gjitha palët, serbët, shqiptarët e të huajt, se përqindja e etnisë joserbe (shqiptare) në Kosovë atëherë si sot ishte shumë here më e madhe se ajo e quajtur serbe (ortodokse).

Së treti, meqë sotpërsot *njohja me realitetin* e atëhershëm e në vijimsi pa mite të gënjeshtërtë e urrejtje, është mesazhi më i mirë drejt mirëkuptimit e paqetimit ndëretnik shqiptaro-serb, andaj në disa pika do të bëjmë fjalë pikërisht mbi periudhat kryesore zhvillimore historike të të qenët të popullit shqiptar në trojet e sotme, prova këto që demaskojnë katërcipërisht disa nga qëndrimet mohuese shqiptarofobe të Milojeviçit dhe të tjerëve para e pas tij të shprehura destruktivisht mbi bazë të nacional-shovinizmit serbomadhi pansllavist, njomur me mite e subjektivizma të sajuar mbi bazë të gënjeshtrove të paskrupullta që mohonin të qenët dhe autoktoninë shqiptare në periudhat e hershme e të mëvonshme historike në këto troje.

Sigurisht gjykimi që mund të nxirret pas analizës së temës në 7 krerë dhe përfundimit të këtij punimi do të lehtësojë të kuptuarit e *së vërtetës së mohuar*, e vërtetë kjo që troket në ndërgjegjen e arsyes së errësuar të disa qarqeve shtetërore e fetare serbe, e cila nëse kuptohet drejt sjell paqetim ndërnjerëzor e politik në raporte shqiptaro-serbe siç dëshirojmë ta realizojmë ne edhe me këtë punim, mirëpo sa ia kemi arritur objektivisht synimit tonë, gjithsesi le të vlerësohet.

D) PYETJET MOTIVUESE PËR TITUJT E KRERËVE DHE ABSTRAKTI (PËRMBAJTJA E SHKURTËR)

Gjatë shtjellimit të kësaj pike jemi përgjigjur disa pyetjeve, por edhe kemi hapur shumë çështje të diskutueshme shqiptaro-serbe me interes historik e gjuhësor që duhen pasur parasysh, prandaj ftojme lexuesin që me vëmendje të shtuar ta konsultojë tekstin në vijim.

Kreu I

Si qëndronte realisht gjendja e përqindjes së popullsisë në Kosovë?

Në titullin e parë të kësaj vepre me titull:

“Injorimi i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës rreth zbërthimit të përqindjes etnike serbe-joserbe nga vepra Etnicka karta dela stare Srbije (Kosovë) nga M. Vemic (2005) hartuar e ë përpunuar sipas veprës së M. S. Milojevic Putopis dela Prave (Stare) Srbije 1866-1873), u dha përgjigje në pyetjen:

Si qëndronte e vërteta rreth përqindjes së etnive në trevat e Kosovës (Prava Serbisë) që i regjistroi MiLojeviçi, 10 vjet e sa përpara shpërnguljes së dhunshme masive të muhaxherisë shqiptare nga Serbia e Jugut ose *Arnautllëku Lindor*, para e pas Kongresit të Berlinit (1878), nga të cilët (muhaxherët) gjoja vetëm atëherë Kosova u bë me shumicë shqiptare(!).

Kështu nga përmbajtja mjaft voluminoze e këtij kreu këtu lidhur me kontaktimin e z Vemic që nuk është i vetëm që jep shifra tejet të paqëndrueshme, ngase kështu veprohet edhe në burime të tjera zyrtare si, *Wikipedia*, portali “*Krstarica*” etj. ku theksohet

E para, në prag të luftës serbo-turke (1877) nga të dhënat e Milojeviçit, shihet seerbet në

s territorin e Krahinës së Kosovës e Metohisë ishin shumicë, ndërsa shqiptarët pakicë (!) dhe

E dyta, nga tabela për banorët e qyteteve, si: Kurshumlia, Prishtina, Vushtrria,

Peja, Gjakova, Prizreni, shihet se mbi 90% ishin me etni serbe... (!!!).

Ne pas verifikimit të saktësisë, për të treguar realitetin po mjaftohemi me (ri)paraqitjen e **tabelave** përmyllëse nga ky krye i punimit tonë që demantojnë katërcipërisht konstatimet e mësipërme të Vemiq-milojeviçit:

a) Statistika për numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse

ti	Fshatrat					Shëpitë		Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	K d
K	222	2	99 43	130 57	176	690 23	2230 77	71	-
Q	306	74	71 50	71 50	18	3585 33	7231 67	99	2
D	569	114	105 23	347 77	5	368 18	25242 82	48	52
Totali	1096	119	275 33	548 66	199	9643 22	34703 78	218	54

Pra numri i fshatrave të shënuar: **S 33%**, ndërsa **JOS 66%**. Kurse numri i shtëpive sipas këtij dokumenti, sipas interpretimit real del: **S 22%**, **JOS 78%**. Ndërkaq, gjendja statistikore e përqindjes së popullsisë (shtëpive) në tri Zonat, sipas burimit n[ë shqyrtim ishte:

S % JOS %

Kurshumlia	23%	77%
Kosova Qendrore	33%	67%
Rr. i Dukagjinit	18%	82%

Kështu numerikisht rezultati i përqindjes reale në *Serbinë e Vërtetë* të Milojeviçit (Kosovë) del 74 ndaj 226, d.m.th. JOS (joserbë) ishin mbi tri here më shumë se S (serbë ortodoksë, që në të vërtetë shumica prej tyre ishin shqipfolës ose ahqiptarë me fe ortodokse).

b) Statistika për numrin e shtëpive sipas etnive për qytetet mbi 500 shtëpi:

Nr r.	Qyteti	Nf	S %	JOS %	(P	A	L	C	O
1	Kurshumlia	2000	-	2000 100	1800	150	-	50	-

2	Prishtina	3270	350 11	2829 89	2600	70	-	-	250
3	Vushtrria	850	250 29	600 71	600	-	-	-	-
4	Peja	1850	550 30	1300 70	1200	-	100	-	-
5	Gjakova	2385	36 2	2330 98	2100	-	129	120	-
6	Prizreni	6620	1200	5220 81	4800	2004	100	-	120
	Gjithsej:		192386 14	14279 86	13100	20	329	170	370

Sqarim 1: Numri i *Paturëve* del mbizotërues. *Arnautë* nuk kishte të regjistruar vetëm në Vushtrri. *Ciganë* kishte të regjistruar vetëm në Kurshumli dhe Gjakovë. *Latinë* kishin të regjistruar në tri qytete: Peja, Gjakova e Prizreni, ndërsa *Osmanli* vetëm Prishtina e Prizreni.

Së këtëjmi, gjendja statistikore e popullsisë (shtëpive) në qytetet e mëdha sipas zonave regjistruese ishte:

S JOS

Kurshumlia	-	100%
Kosova Qendrore (Prishtina)	11%	89%
Rr. i Dukagj. (Peja, Gjakova, Prizreni)	18 %	82%,

Kështu rezultati del 29 ndaj 171% ose JOS ishin afro 6 herë më shumë se S.

Së këtëjmi, në të ashtuquajturën Prava (stara) Serbi (Kosovë) serbët, përkatësisht ortodoksët 10 vjet para vitit 1878 ishin pakicë, edhe sa i përket:

- numrit të fshatrave S 33% ndaj JOS 66%,
- numri i shtëpive S 22% ndaj JOS 78% dhe
- numrit i etnive në qytetete mbi 500 shtëpi: S14% ndaj JOS 86%.

Sqarim 2: Ndërkaq, nga z. Vemic, i cili nuk respekton kriterin e realitetit objektiv rreth paturëve, por ndjek kriteret e paqëndrueshme të Milojeviçit, statistikisht i dalin këto rezultate:

Serbë kishte në **130 vendbanime**, ndërsa *Shqiptarë* në **80** (A 69 + L 11).

Së këtëjmi:

Arnautë të përzier me serbë të islamizuar 152 vendbanime, ndërsa *latinë* të përzier me serbë **15** vendbanime, kurse serbët dalin të përzier me të tjerë në **109 vendbanime**. Përkatësisht 3 herë më shumë kishte

vendbanime serbe se arnautë (arbanase), dhe pothuaj 2 herë më shumë kishte vendbanime me serbët e islamizuar në krahasim me arnautët.

Sidoqoftë, ne nuk e përçmojmë mundin e Z. Vemic, mirëpo pa i polemizuar kriteret rreth përcaktimit të etnive, çështja përqindjes mbështetur në realitetin objektiv të riverifikuar prej nesh del e sakta siç e dhamë ne pak më sipër, ngase të gjitha faktet që demonstrohen në urim e Milojeviçit nuk pasqyrojnë të vërtetën, madje mbase me qëllim nga ai shumë fshatra shqiptare nuk janë regjistruar fare s në zpnën e Sharekës, Pejës etj, madje po marr shembull Podujevën qindpërqind shqiptare, ku nuk është shënuar numri i shtëpive.

Madje, ia vlen të konstatohet kjo e vërtetë shumë e domosdoshme se është një lajthitje e qëllimshme se është injoruar gjuha shqip e sëkëndejmi edhe etnia shqipaatre tek të ortodoksët shqipfolës (si etni më vete), kur atbotë shumica dërrmuese ortodokse ishin shqipfolës dhe normalisht respektonin kishën ortodokse (pravosllave) serbe, mbase pa dallim edhe atë greke.

Pyesim, ku mbështet dhe ende qëndron trullosja (mashtrimi i madh - *velika zabluda*) rreth përqindjes së atëhershme gjoja shumicë serbe në këto troje?!

Kreu II

Në të vërtetë, kush ishin poturë në Kosovë?

Në këtë krye, me titull: **Injorimi, por edhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe dhe të vërtetës jetësore shqiptaro-serbe në Kosovë para e në vitin 1866, dhe e trashëgon Vemiçi e të tjerë**, veç tjerash u dha përgjigje: Kush ishin **poturë të vërtetë** në Kosovë dhe gjithandej e këndej, me shifrën e të cilëve keq manipulon Milojeviçi, Vemiçi e të tjerë? Kishte poturë shqipfolës vetëm në Kosovë, apo gjithandej në viset e Principatës serbe, apo jo? Këtë të vërtetë para vitit 1878 e dëshmojnë edhe V. Karaxhiçi edhe M. Milojeviçi.

Kështu në të dy nënkrerët e këtij kreu u dëshmuar e vërteta se përveç **arnautëve** dhe **latinëve** vendës, vetëkuptohet se shqiptarë vendës ishin edhe **poturët shqipfolës** llogaritur **serbë** nga Milojeviçi e pasuesit e tij, mirëpo kishte gjithandej familje shqipfolësish ortodoksë, andaj konstatimi se pothuaj të gjithë ortodoksët ishin serbë është trullavje çmendurake (mashtrim – lapsus calami) mjerisht jo vetëm e asaj kohe, apo jo?

Kreu III

Siç dëshmojnë trajtat e shqipes së lashtë: *shkla/v, *s(h)erb- e shkizmë, pothuaj më të vjetra se ato latine e greke, apo jo, dhe si u përjetua fatalisht shkizma e madhe ndërkristiane te vetë arbnorët në trojet tyre?!

Kështu në kryeun vijues me titull: “**Injorimi i shqipes dhe reflektimi kontaminues i koncepteve të fjalë-termave ndërkombëtarë: s(k)llavë e s(h)erb (si etni) dhe s(h)kizmë (si dukuri) në gjuhën shqipe**”, veç tjerash u përpoqëm t’i përgjigjemi pyetjes: Si ndodhi dhe u përjetua **shkizma e madhe**, ndërkristiane, si dukuri në raportet fetare ndër shqiptarë dhe në krahasim me sllavët ortodoksë në këto troje dhe si u përftuan në shqipe e serbishte dhe në gjuhë të tjera termat: **shkizmë shizmë** (si dukuri) si edhe: **skllavë (sllavë)**, përkatësisht **serbë (servë e s(h)erb)** si etni? Po e rikojtopjmë përgjigjen nga ky krye pak fjalë:

Sigurisht në botën shkencore zgjon interes se si fjalët e tilla paraqiten në gjuhën shqipe me zhvillim të pavarur shkrimor e shqiptimor: **shkizmë, shkja** dhe ***sherb-** (refleks lat, *serv* -, greq *serv-* pastaj zhvillime në shbqipe: **shërbej, me shërbye: shërbyes, shërbëtor**. Gjithsesi nga kjo mënyrë dëshmohet prania e gjuhës shqipe që në këtë fillim-periudhë si fjalë aktive me ndërndikim ose zhvillim të pavarur, apo jo?! Krahaso dhe një herë lat. Schisma, shq. shkizma, përkatësisht lat *sclavus* shqip *shklavë* shkjav shkjav shka, ashtu si edhe *servus* servire), greq. *serbos*, ndërsa shqipja nga rrënja ***sherb-** shërbej: *shërbyes shërbëtor*, vendu Sherbi (P. Bogdani), sipas nocioneve: serb: **sluga, rob (bujkrob)**, por në shqipen fillimisht me kuptim **shërbyes**, pa u ngatërruar me nocionin modern të etnonimit serb e sllav apo jo?

Sidoqoftë, pra, në punim u dhanë shpjegime të gjithanshme, ku trajtat e shqipes dalin të shpjegueshme, madje u sqarua edhe nocioni e ri që morën ndërkohë trajtat **sllav** e **serb**, qoftë në gjuhën shqipe, qoftë në gjuhët moderne botërore, të cilat, sidomos e dyta kishte edhe kuptim toponimi ku jetonin besimtarë të konfesionit shkizmatik, gjë që ka ndikuar shumë negativisht në pasqyrimin e numrit të etnisë arbnore, për dallim nga ajo serbo-sllave e të tjera, ngase pala serbe për qëllime politike të gjithë ortodoksët ose banorët që jetonin në ato vise të quajtura Serbi (Sherb(n)i) i konsideronte dhe në shekullin XIX i plasonte **serbë** të gjithë ortodoksët me kuptim njëetnik (njënacional)(!).

Kreu IV

Si qëndronte raporti serbë-shqiptarë gjatë periudhës së Perandorisë Osmane dhe si u shfaq shkizma e re fatale brenda shqipfolësve?

Ajo që u cek në kreun e mëparshëm rreth problemit i shkizmës si dukuri rreth emrit **arbnor** si etni, sqarimi vazhon më tej edhe në këtë krye, me titull: **Arbënia gjatë periudhës së sundimit Osman, raporti turko-shqiptar/sllavo-shkja dhe pasojat fatale mbi shqipfolësit nga shkizma e re**, ku veç tjerash u përpoqëm të përgjigjemi: Si ndodhi shkizma e re fatale ndër shqipfolësv në periudhën e sundimit osman që nxori në shesh terma me konotacion të ri antonimik *shqiptarë /shkije*, me ç'rast kemi të bëjmë me joshje interesash turke e serbe në kurriz të shqipfolësve, sidomos pas vdekës së Skënderbeut, kur për rrugçzgjdhje mbijetes shqipfolësve u plasuan tri opsione jofavorizuese:

E para, katolikët e unitët të dalluar si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në ato lufta, domosdo veç e veç po edhe në turma u detyruan të shpërnguleshin jashtë ose të arratiseshin maleve të pakalueshme të Shqipërisë, duke iu shtruar jetës së vështirë malore. Aty ku kishin mundësi u përpoqën me e ruejtë fenë katolike, qoftë edhe duke u ndërlikur me familje mikste ndërfishnore pagane, muslimane e ortodokse malësore, deri sa edhe Milojeviçi në kohën e tij ka ndeshur në 30 e sa familje të tilla shqipfolësish të përziera fetarisht.

E dyta, të islamizoheshin, duke i shprehur lojalitet Perandorisë Osmane, mundësi kjo që u siguronte sadokudo mbijetesë e mbase edhe privilegje në trojet e veta, megjithatë ndoshta këtë e bënë edhe formalisht vetëm sa për t'iu shmangur përkohësisht tehut të dhunës, shembuj të tillë e të ngjashëm laramanë ndeshim në burime të caktuara, madje deri edhe në realitetin e sotëm të shoqërisë sonë.

E treta, ortodoksët shqiptarë duke u mbështetur në kompetencat e kishave autoqefale pranuan të futeshin nën tutelën e Patrikanës bizantine, përkatësisht në Kosovë gjithkëndeje të përuleshin nën mbrojtjen e autoqefalisë sllave (serbe e bullgare), por tjetër kah dhe kishave greke e rumune, natyrisht duke qenë të datyruar me krye me besniki obligimet ndaj shtetit osman dhe kishës së huaj.

Kështu shqiptarët në afat jo të shkurtë pësuan, duke përjetuar të trija këto të këqija për të ruajtur substancën e identitetit të vet, po më e keqja ndodhi me grupin e tretë, ngase një masë jo e vogël e tyre u sllavizua edhe gjuhësisht.

Kjo fazë si dukuri e përçarjes nga halli shqipfolësit që mbeten në troje të atdheut, megjithatë mbeten të ndarë fetarisht trizash muslimanë, ortodoksë e katolikë. Së këtejmi, kuptohet kjo është periudha kur shqipfolësit pësuan, siç e quajmë ne **shkizmë të vërtetë fatale**, jo vetëm nga shpërngulja, por edhe më keq nga përkulja e përlulja ndaj etnive të tjera fetare joshqipfolëse, sepse turku në një rën anë përforconte veten me besimtarë islamë dhe po ashtu në anën tjetër në viset tona këndeje nga veriu ortodoksizmi sipas meshës përforconte gjuhën përkatëse rituale sllave-serbe, ndërsa në jug e gjithandej ajo greke, pa përjashtuar edhe ndikimin n bullgar e rumun. Në të vërtetë, këto dy fe islame e ortodokse ndërkohë vinin gjithnjë e duke u politizuar deri sa u gjendën edhe në taborre konfrontimi. Në këtë kontekst, pothuaj të dyja palët tjetësuan emrin e mëparshëm arbër, duke i shpifur njëri tjetrit emërtime të tjera ndasie, kështu nga ana e besimtarëve islam veriakët ortodoksë u quajtën **shkije**, ngase vërtet duke u dhënë pas fesë shkallë shkallë, jepnin gjithnjë e më shumë shenja serbo-sllavizimi, ashtu si edhe arvanitasit nga jugu shenja greqizimi, ndërkaq te muslimanët në atdhe në vend të termave *turk* e *arnaut*, u (ri)përfutua termi **shqiptar**, dhe në këtë mënyrë u gjind një rrugë shpëtimi, fat në fatkeqësi, ngase tani si shqiptarë muslimanë patën mundësi me e rrujtë gjuhën e tyre arbnore tash **shqipe**, po edhe të joshnin vëllazërisht arbërit katolikë, të cilët, si duket me vetëdije përqaftuan emrin **shqiptar** si mundësi e qartë bashkimi, ashtu si edhe disa ortodoksë, të cilët që ende nuk ishin asimiluar gjuhësisht ruajtën fenë, por kishin presione, qoftë nga kisha greke ose ajo sllave (bullgaro-serbe).

Në punim, trajta **shkije** shpjegohet si kontaminim i dy termave të shqipes **shka** (shkja/ (njëjësi) nga *s(k)llav* -*schlavus) dhe shumësi **shki/je**, në kontaminim me fjalë-konceptin **shkizmë-a** (s(h)ki/zma/tikë-ortodoksë) që vjen si antonim me trajtën **shqipë shqiptarë (k/q)**, gjithsesi shqipfolës të ndarë nga i njëjti trung etnik. Kjo vërtetohet nga fakti se ky entitet sidomos në Kosovë (Shqipri, Maqedoni, Greqi) edhe pse u quajt serb apo grek për shkak të kishës serbe a greke, megjithatë jo pak prej tyre në treva të përziera me muslimanë e katolikë ruajtën gjuhën shqipe në familje deri në ditet e sotmes në Kosovë ashtu edhe në Serbi, Greqi, Maqedoni e gjithandej në Itali e gjetkë.

Sidoqoftë, duke qenë të nxitur nga kjo ndarje shkizmë) nga të dyja palët armike të shqiptarëve, në një rën anë nga *turku* dhe në anën tjetër nga *serbi*, greku sidomos në prag të rrymave iluministe-romantike (nacionaliste) të dyjat palët e shkizmuara shqipfolëse pësuan fatalisht nga

konfrontimet politike nga shtetet sunduese po me ngjyrë fetare: **shkije** (sllavë – serbë) në njërën anë, ndaj **shqiptarë** (muslimanë e katolikë) në anë tjetër. Kështu pasojat e **shkizmës së re** për shqipfolës verikorë ishin shumë shkatërruese, madje ishin më me pasoja, shumë më të dëmshme se **Shkizma e Madhe** ndërkristiane që i kishte pasë prekur shumë keq pikërisht këtë popullatë, ngase ajo fundja kishte të bënte në parim me ndarje ritesh jo me fe, por që edhe mund të kamufloheshin më lehtë sipas situatës, ndërsa kjo me ndarje feshë: **muslimane** (me bazë Kur'anin, profet Muhameddin) ndaj **kristiane** (me bazë Biblën, profet Jezu Krishtin), të cilat u shfrytëzuan politikisht ndërkohë në lufta antagoniste ortodokse shkije serbo-ruse ndaj shqiptarëve të tri feve (muslimane, katolike e unite), të cilat gjoja ishin nën mbrojtjen e shtetit turk. Kështu shqipëtarët (muslimanë, katolikë e ortodoksë) gjatë e pas kryengritjeve kundër osmane, megjithatë ishin qytetarë të shtetit turk, ata në këtë kontekst pësuan fatalisht, ngase vetë Turqia (muslimane), e cila si shteg ndodhej në gjendje asfiksioni, sidom os gjatë gjithë shek XIX e fillim shekullit XX dhe zgjaste jetën, duke luftuar aspiratat për pavarësi të shqiptarëve të tri feve dhe duke u kusuritur me trojet e tyre ndaj armiqve.

Në punim, meditohet rreth prejardhjes etimologjike të termit: **shqipo shqiptar Shqipri**, term ky i popullarizuar që zëvendësoi trajtat *arbër Arbëri, epirot Epir*, si dhe turko-arnaut e shqipo-arbanas etj. mirëpo për prejardhjen e fjalës: **shqip, gjuhë shqipe, Shqipni**, edhe pse deri tashti janë plasuar afro 20 hipoteza asnjëra nga ato nuk konsiderohet e vetmjaftueshme ose e pranuar shkencërisht. Kështu, sipas lëndës së trajtuar prej nesh u përpunuan me interpretim paksa të ri këto tri hipoteza kontaminuese si jo të lehtërrëzueshme:

E para, nuk hedhet poshtë hipoteza mbi bazëpsiko etnologjike rreth totemit *shqipe* (shqiponjë), ngase vërtet, edhe ky fakt ka shërbyer dhe shërben që kjo tezë të jetë e perceptueshme, siç ishte motivuese emocionalisht edhe nga rilindësit tanë dhe kështu ka ndikuar për përqafimin shpirtërisht me shumë dëshirë të termit **shqipe shqiptar, bijtë e bijat e shqipes** etj., hipotezë kjo, e cila ka histori të pamohueshme.

E dyta, mendohet se konfrontimi i trajtave *shqipo / shkja*, vërtet në periudhë të caktuar ka ndikuar në distancimin dhe përgjithësimin e termave përkatës, ngase, siç konstatohet, që të dyja këto fjalë kanë të bëjnë me konceptin e **shkizmës: të të shkyemes, të ndarje-përçarjes**, por ndërkohë për shqipfolësit e sotëm, koncepti i parë i fjalës **shqiptar** (*pjesë e ndarjes nga *trungvu* !) u përqafua kombëtarisht, si diçka ideale, si fjalë

bashkuese shumë pozitive joshkizmuese, ndërsa fjala e dytë *shka shkie shkini* (për ortodoksët shqiptarë që u shkrinë në shtetet fqinje) nga **shqiptarët** pra, u pranua emocionalisht me kuptim keqësues, ngase një pjesë e konsiderueshme nga *shkijet ortodoksë*, duke u kapur fort vetëm pas fesë serbo-pravosllave jo vetëm humbën gjuhën e të parëve, por si rrjedhojë një shumicë e tyre humbën edhe kujtesën historike, të cilët u shfrytëzuan nga Serbia e shtete e tjera, në luftë me ngjyresë fetare kundër **shqiptarëve** (të tri feve kombëtare). Ndërkaq **shqiptarët**, duke ruajtur gjuhën edhe pse shumica muslimanë, gjetën zgjidhje, duke respektuar edhe fenë kristiane (katolike e ortodokse) dhe kështu u krijua tolerancë me vetëdije të lartë, e cila çoj edhe në riformëzimin e kombit të veçantë shqiptar dhe rrojten e tij si komb i kohës moderne, shembull civilizimi bashkëkohor mbi bazë gjuhën e njëjtë kombëtare.

E treta, doli në dritë, një zgjidhje e mundshme që nuk bie ndesh me dy tezat e sipëcekura që i lë si anësore Është fjala për një **sitezë** të natyrshme, mbështetur në sistemin e brendshëm gjuhësor të shqipes, por që kërkon përpunim: Kështu për të parën herë del nga anonimiteti folja: *shqip me shqipë*, si barasvlerës i perifrazës: **me folë shqip (me shqipë: qartë, hapur, troç)** që njëherazi shërben mirëfilli edhe si temë e rregullt fjalëformuese për fjalë të tjera (folje e emra) natyrisht edhe për emrin **shqiptar e Shqipni**, përkatësisht për **shqipo-shqiptarin si folës e shqipes**. Kështu dalin të shpjegueshme morfologjikisht edhe përftimet e trajtëfoljeve: **shqip, shqipoj, shqipto** etj., të cilat edhe janë të njohura për konceptet e tyre që mbulojnë në kuadër të sistemit ligjërimitor të shqipes. Kështu b.f. folja **shqipoj me shqipue**, është e njohur me kuptimi semantik të specifikuar që ka të bëjë ekskluzivisht me nocionin: *shqiptari si veprues*, i cili për të mbrojtur ekzistencën e vet është shërbyer me mjete mbrojtëse, pune e sulmi, duke përfshirë nga ato më të thjeshtat deri tek ato më të ndërlikuarat, si p.sh.: *me ia thënë shqip : me folë shqip*, pastaj *Me ia shqipue armikut: me grusht (dorë), me gurë, shkop, shpatë, shigjetë e pushkë*, deri me mjetin më të ndërlikuar të sofistikuar sot me digjitalizim, përkatësisht me mjetin **më të shtrenjtë** dhe **më të shenjtë**, të shqiptarisë, siç është: **gjuha shqipe, si armë që mbron qeniesinë kombëtare, apo të qenët shqiptar**.

Së fundi, fjalë-folja **me shqipë** (për të shqipur) si **gjuhë** dhe fjala **me shqipue** (për të shqipuar) si **mjet veprimi i shqiptarit**, siç u konstatua në punim, me shumë gjasë paska pasë ekzistuar që nga antika në gjuhën tonë dhe që prej asaj kohe si **fjalë e vjetër** e mishnuar në **veçori veprimi**

të shqiptarit supozohet që si e tillë jo e huazuar, por si huazuese qenka përhapur (qenka huazuar) edhe nga gjuhët e huaja, klasike ntrajtën *skip/io*shkop*, si mjet shkop shkip! që mund të imagjinohet hipotetikisht me **Zeusin, si Zot që sundoi me shkop**, dhe për *njerëzit me shkop* që e trashguan mjetin për mbijetesë apo jo?! Në punim ka edhe hollësi të tjera, po gjithsesi fjala **shkip shkiptar** ka lashtësi pçë[rdorimi në protshqipe dhe me meritë bën pjesë si ndërkombëtarizëm në fjalorët e fjalëve ndërkombëtare.

Kreu V

Pse u prishën edhe më keqas marrëdhëniet muslimane shkiqe ose shqiptaro/serbe pas shekullit XIX e deri në ditët e sotme konkretisht në Kosovë?

Meqë në krerët e mëparshëm kishim të bënë me prova se si injorohej gjuha shqipe si kriter i së vërtetës, këtu konkretisht në këtë krye me titull: **”Rreth injorimit të gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës për shkak të fesë ortodokse në përcaktimin e kombësisë të shkiqe tanë (vendës) në përgjithësi dhe të atyre të fshatit Reçan të Therandës në veçanti”**, u përpoqëm me iu përgjegjë veç tjerash edhe pyetjes: Pse dhe nga kush u prish sadokudo harmonia e bashkëjetesës shoqërore ndërfitare **shqiptaromuslimane-serboshkiqe ortodokse** kresisht shqipfolëse përgjithësisht në Kosovë dhe konkretisht në fshatin Reçan të Therandës (Suharekë)?

Në të vërtetë, në këtë krye mjaft volumoniz që përbëhet nga 7 nënkrerësh, përveç historikut të fshatit dhe bashkëjetesës së trashëguar ndër shekuj ndërfitare muslimano-ortodokse ose *shkie vendi* shqipfolës, u bë fjalë edhe rreth paqartësisë së prejardhjes fetare rituale të familjes Veselaj. Madje rreth kësaj harmonie ndërfitnike, u shërbyem edhe me mbamendjen vetjake të përjetuar mbi 80 vjeçare, të cilën nuk mundi me prishë asnjë nga ish pushtuesit, as Turqia, as regjimet në kohë të luftave ballkanike (Serbi e Bullgari), madje as pushteti i Kralevinës Jugosllave (1912-1941), as Koha e Itali-Shqipnisë(!) 1941-1944), as Koha e Komunizmit (federatës jugosllave), por e prishi politika milosheviçiane, duke i përdorur fqinjët shkiqe (ortodoksë) si mashë zjarri si zhig kundër fqinjve të tyre dhe aq më keq krijoi aso situatash që gjatë kësaj lufte (1988-1999 t’i përdorë dyhovahash si gaca ndezëse, së pari, për djegie shpirtërore të mirëbesimit ekzistues fqinjësor dhe së dyti, për shpërnguljen me dhunë të tyre, duke ua djegur shtëpitë dhe duke ua grabitur mall e pasuri. Aq më keq në këto situata ndërfitqinjësore pati edhe njerëz të humbur (të vrrarë)

nga të dyja palët. Dhe më në fund ushtria serbe me rastin e tërheqjes, në atë rrugë pa kthim, mjerisht tërhoqi në Serbi edhe pjesëtarët e komunitetit ortodoks të fshatit.

Ndër të tjera në punim është faktuar konkretisht e vërteta e mohuar nga pala serbe (kisha e disa qarqe) që ka të bëjë me të vërtetën e pamohueshme rreth shtrirjes së etnisë anase shqipfolëse ortodokse në të gjitha trevat e Serbisë, Malit të Zi e të Maqedonisë së sotme që parakupton edhe ndërlidhjet shqiptaro-sllavo-serbe jo vetëm nga familjet princore të shtresës së naltë, por edhe të shtresës së thjeshtë e të mesme pagane e fetare katoliko-ortodokse dhe ndërkohë edhe muslimane, ku gjuha shqipe si gjuhë familjeje dhe e masës së gjerë pa dyshim dilte parësore. Kështu në fshatin tonë ashtu si edhe në shumë vise të Kosovës e më gjerë, pothuaj deri në ditë e fundit edhe te familjet ortodokse (shkije), përkundër shkollës e administratës serbe qindvjeçare, mbizotëruese ishte gjuha shqipe.

Themi kështu, ngase mjerisht etniteti që u quajt **shkitë tanë** ose **shkijet e vendit** në Kosovë e më gjerë, dilte dhe del i injoruar jo vetëm nga Shteti e Kisha pravosllave serbe, por edhe nga sivëllezërit e tyre të një gjaku e gjuhe muslimano-katolikë shqiptarë, madje edhe nga vetvetja për mungesë koncepti dhe për shkak të kushteve që pamundësonin dhe ende e pamundësojnë një ndërgjegjësim të tillë, temë kjo që mbetet e hapur.

Kreu VI

Si u konsolidua kombi modern shqiptar mbështetur në gjuhën shqipe si promotor?

Përmbajtja e këtij kreu me titull: **”Injorimi i gjuhës shqipe si promotor i zgjimit dhe rritës si shqiptarisë nga vatra e nacional-shivinizmit serbomadn e gjithandej sot shkencërisht mëshon bumerang ndaj tij dhe vatrave të tjera penguese”**, është shtjelluar në 4 nënkrerët, ku veç tjerash jepet përgjigje rreth shkakut pse në rutinë sidomos që nga gjysma e dytë e shekullit XIX e deri në ditët tona nga pala serbe, fillimisht e ndihmuar edhe nga pala turke, injorohet gjuha shqipe si promotore e shqiptarisë, duke përfshirë edhe Kosovën përherë me shumicë shqiptare.

Ndër të tjera për të pasur më shumë qartësi rreth të vërtetës historike u mbështetëm në atë të vërtetë që assesi nuk mund të mohohet ekzistenca shqiptare që nga Iliria, përkakatësisht që nga antika e më parë, ku ishte ngulitur e ku ende gjallnon populli ynë shqiptar me gjuhën e tij. Në të vërtetë hipoteza e Milojeviçit mbi hershmërinë e pranisë parahistorike serbe në këto troje del e përjashtuar, jo vetëm nga emrat e

mbretërve të Ilirisë dhe të Dardanisë, por edhe nga emrat e sundimtarëve nga periudha e hershme të sundimit latin. Kujtojmë nga kjo periudhë **Tetrakinë** e Dioklicionit me kufijtë pikërisht në hapësirat gjeografike të shqiptarëve të sotëm, si me thënë, me emër shtetkufizues(!) që atëherë me kryeqendra qytetesh: Provalis (Shkodër), Epiri i Ri (Durrës), Epiri i Vjetër (Prevezë) dhe Dardania (Shkupi), si dhe ajo para e pas kristianizmit, si dhe tërë periudha e mesjetës kristiane nën Bizantin para e gjatë kryqëzatave dhe pas tyre sundimit sllav, nga bullgarët (me qendër fetare Ohri) eshteti i du.kls em qendër hkodrën , por njëherazi më vonë serbët nemanjidë (Rasa (Rashka) - Prizreni – Shkupi), ku pikërisht në këtë periudhë të nemanjasve arbanasit (arbnorët) treguan vitalitetin e tyre shtetformues që dëshmohet edhe me krijimin e dy shteteve arbnore jashtë nemanjide: Prtincipata e Arbnit (Krujë), Mbretëria e Arbrit (Durrës), por prosperitetin e shtrirjes së tyre e arritën në aleancë me Nemanasit, sidomos me Car Dushanin, siç e pranojnë edhe historianët serbë, kur arbanasit pasi njiheshin si pjesë e barabartë konstitutive thelbësore e asaj perandorie me këtë forcë të përbashkët ata arritën të shtriheshin nga jugu deri në Kreta etj., dhe se kjo forcë aleance që ishte shqiptare shihet qartë pas zhbërjes të asaj perandorie, kur feudalët shqiptarë në shumicë dalin shumë më të fuqizuar dhe më në numër në krahasim me ata ose ndonjerin prej tyre që konsiderohej serb, siç ishte knez Llazari, me qendër në Krushevë. Kjo vërtetohet edhe me miqësinë me Knez Llazarin dhe me pjesëmarrjen e tyre në Betejën e Kosovës 1389. Madje shqiptarët jo serbët krijuan më vonë shtetin e vet në krye me Skënderebeun me qendër Krujën, apo jo?!

Sidoqoftë, arbanasit, përkatësisht arnautët përmenden edhe si kundështar, por ndërkohë edhe si administratorë në pozita të larta në kuadër të Perandorisë Osmane po në këto treva, pikërisht në Arnautllëkun e Rumelisë (Shqiprinë) shqiptarët dalin të identifikuar qartë në katër Vilajete (kryesisht mu në hapësirën e Tetrakisë) me kryeqendrat: Shkodër, Shkup, Manastir e Janinë. Është e vërtetë se gjeografia e përkufizimit të katër vilejet-shteteve me shumësi shqiptare në kuadër të Perandorisë Osmane ndodhi më përpara, po u dallua në shek XIX, kur grekët, serbët, malalazezët e sllavo-bullgarët ishin në përformëzim e sipër të autonomive të tyre shtetërore, autonomi këto që u formuan me ndihmën e pakursyer të shqiptarëve, gjë që dëshmon shtrirjen e gjerë historike të asokohshme të shqiptarëve si etni) në krejt Siujdhesën Ilirike e më gjerë, apo jo? Por i gjeti e keqja që pikërisht këto shtete (qeveritë e tyre) ndërkohë nuk i ndihmuan, fatkeqësisht i prenë në besë shqiptarët. Sidomos në anën tonë

serbët vepruan kundër shqiptarëve me *paburni*, *pabesi* dhe *egërsi*, ngase tradhëtisht mohuan bashkëpunimin e propozuar dhe aq më keq bënë luftë e politikë dyfytyshe për dëbimin dhe gllabërimin e trojeve të tyre. Megjithatë, në këtë mbështjellim e mashtrim të madh, shqiptarët edhe pse të pambrojtur faktikisht edhe nga shteti zyrtar Osman më në fund konceptualisht arritën të formëzonin autonominë 1878 me Lidhjen e Prizrenit dhe të shpallnin pavarësinë (1912) edhe pse ishin pothuaj tërësisht të okupuar nga forcat e fqinjve ortodoksë të pabesë.

Suksesin rreth autonomisë në shekullin XIX shqiptarët e arritën duke shfrytëzuar organizimin e brendshëm në njëfarë survejimi nga Turqia, por jashtë në saje të veprimtarisë së rilindësve tanë mendjendritur kryesisht pa pasur ndihmë nga jashtë, të cilët pasi e dinin se tri fetë që kishin shqiptarët muslimane, katolike, ortodokse, rilindësit shqiptarë si patriotë të vërtetë që ishin në rrugën e tyre mençurake si **promotore zgjodhën dhe përforcuan** jo fetë po **rolin e ri të gjuhës shqipe**, pragjuhën jo vetëm *për komunikim*, por edhe si *armë për zgjimin kombëtar*, **pa mohuar asnjërën fe**. Vërtet, edhe pse në këtë rrugë hasën në shumë vështirësi, të cilat në punim u trajtuan në tri pika e 11 nënpika, megjithatë, ia arritën që me **shqipen si promotor përlindjeje, zgjimi e bashkimi kombëtar të përbashkohen**, të *çanin përpara* me gjuhën si aureollë hyjnzuese të stolisur me *njerëzishmëri, burri, besë e ideal të shenjtë kombëtar* që e kishin të trashëguar si gjakim, brenda trupit që joshej me zemër e shpirt, rrugë kjo, e cila i solli këtij populli suksese të pakrahasueshme, pa lënduar askënd nga fqinjët, përkundrazi, kurorëzimi i shqiptarizmit ishte, siç është edhe sot në të mirë të të gjithëve, ngase të ruajturit e substancës kombëtare mbi bazë gjuhe në trojet e veta, pa injoruar tri fetë: *muslimane, ortodokse katolike*, ishte kontribut edhe në arenën ndërkombëtare, sepse deviza: **Fe që Zotynë e bekon/shqiptaria feja jonë**, është shembull e **një kombi modern të bekuar**, ngase me fjalën **shqiptari** nënkuptohet respektimi i tri feve jetësore kombëtare: *katolike, ortodokse, muslimane*.

Kreu VII

Cilat janë kontributet me pahir të Milojeviçit në e për shqipen e shqiptarët?!

Në kreun e fundit me titull: “**Injorimi i gjuhës shqipe dhe kontributi me pahir Milosh Milojeviçit në e për gjuhën shqipe**”, veç tjerash sqarohet kontributi me pahir M. Milojeviçi në e për shqipen, edhe pse me fjalë

faktikisht ishte injoruesi më i madh i gjuhës shqipe etj., i cili sqarohet në katër nënkrerë:

Së pari, përkundër qëndrimeve subjektive të Milojeviçit, dromca realiteti ndaj shqipëve në shkrimet e tij nuk mungojnë.

Së dyti, rreth disa të dhënave hamendëse historike e etimologjike për shqipët e gjuhën e tyre në kontekst me serbishten.

Së treti, rreth shënimit e përkthimit të dy vjershëzave ngucakeqe dhe regjistrimit të një kënge shqipe të kënduar nga arnautët ose shqipët e poturëzuar, kushtuar Kumonës së kishës së Deçanit, dhe

Së katërti, rreth sajimit të një sifjalorthi shqip serbisht, i cili ndeshet në librin III të Putopis-it, lëndë kjo ende e pastudiuar dhe vlerësuar nga askush nga autoritetet shkencore, as nga ana serbe as nga ajo shqiptare e as nga të tjerë.

Pra ne këtë punë të Milojeviçit e kemi parë fryt me lule gjelbërim mes gjembash thatukë injorues që e trajtuam me kënaqësi në këtë krye jo se gjoja deshëm me nxjerrë *dhjamë prej pleshti*, por vërtet, si u ekspozuan në katër nënkrerë e këtij kreu, besoj se patëm të drejtë që punën e tij mbase me pahir e cilësuaam kontribut që zë vend në historinë marrëdhëniesve dygjuhësore shqiptaro-serbe në shekullin XIX. Nisur nga ky fakt kontributin e Milojevit, me dashje a padashje, duhet cilësuar **në e për** të mirën e gjuhës shqipe, meritë kjo që edhe këtu po e parafrazojmë po në katër pika:

Së pari, meriton të përmendet Milojeviçi si konstataues, ndoshta me pahir, i shtrirjes së popullit shqiptar e gjuhës së tij si në lashtësis dhe aktualisht në të gjitha zonat shqipfolëse (Serbi Jugore, Kosovë, Malësi (Mal të Zi), Shqipëri (të Veriut, të Mesme e të Jugut) dhe në Maqedoni,

Së dyti, ka meritë se në raste i shënon toponimet në gjuhën shqipe, madje përpiqet me i shpjegue me etimologji hamendëse disa fjalë të serbishtes nën ndikimin e gjuhës shqipe. Këtu po i përmend vetëm tre shembuj:

a) Urën e Fshajt –serb. *Shvanski Most* e shpjegon me ndërhyrje të shqipes lokale: **Sh/in +I/Van** – Sveti Ivan (edhe fshati Shvan ose Oshvan) – Sh+van – **SHVAN**.

b) Toponimin *Pelagonia* e shpjegon nga serbishtja Bela+Gonia me ndërhyrje të shqipes vendëse (shqip: **pella** për **bela**, me ndryshim të konsonantit të parë p/b: pela/bela : Bela + Gunia, pra sipas shqiptimit shqip të vetë gunëbardhëve: *Pela+Gunia (Bela gunja)*(!), d.m.ths., sipas etimologjisë shqipe: Gunat e Bardha.

c) Edhe fjalën **maxhar** *Maxhar/ska* në gjuhën serbe për **hungarez Hungari**, e quan të përvetësuar në serbishte nën ndikimin e fjalë-trajtës (lokale!) të gjuhës shqipe **Magjar(!)** serb. **magarac**, pa e vra mendjen se më këtë konstatim, qoftë edhe përfitim rasti, për të hasmuar shqiptarë e hungarezë, ai edhe me këtë pohonte se shqiptarë paska qenë të shtrirë deri në kufi me Hungarinë, madje si shumicë paskan pasur mundësi me ndikuete serbët në përvetësimin e emrit pezhorativ ndaj hungarezve (!).

Sidoqoftë, ne nuk hyjmë në ndonjë vlerësim etimologjik të paqëlluar lidhur me shembuj të tillë, por, siç e cekëm, për ne është i rëndësishëm fakti se ai në njërin anë kur shqipen e shpall të paaftë, në anën tjetër e pranon se shqipja paska pasur aq shtrirje (Smederevë-Beograd -Pejë-Prizren - Ohër e gjithandej) dhe fuqi ndikimi gjuhësor kaq të madh në serbishten zyrtare, saqë ajo (serbishtja) t'i nënshtrohej deri shqiptimit të shqipfolësve, të cilët, siç nënkuptohet paskan pasë dominuar gjuhësisht ndaj serbishtes në të gjitha këto treva, apo jo?! Ç'është e vërteta një shtrirje e tillë e shqipes pohohet edhe nga shkenca e kohës sonë.

Së treti, sidoqoftë, emri i Milojeviçit gjithsesi duhet të zërë vendin përkatës në historikun e albanologjisë të shekullit XIX, qoftë paksa si përkthyes, si shënues i një kënge folklorike shqip, me afro 60 fjalë e shprehje, kushtuar Kishës ortodokse të Deçanit.

Së katërti, domosdo Milojevuiçi duhet përmendur për të mirë si sajues i një fjalorthi shqip-serbisht (1873) me afro 350 fjalë e shprehje shqipe me theks në të dy dialektet e shqipes, siç e kemi paraqitur e trajtuar mjaft në hollësi, por jo shterrueshëm në këtë nënkrye të këtij kreu.

Me fjalë të tjera, tërë ajo filozofi e elitës serbe e përqaftuar dhe e zbatuar nga Milojeviçi shikuar në përgjithësi, nuk ishte vetëm shqiptarofobe, por mbështetej në urrejtje edhe ndaj popujve të tjerë joserbë, si hungarezëve që u quajtkan magjar –kafshë), por edhe bullgarëve, të cilët herë i quan *vullgar* herë *bolllgar* (!) etj. Në të vërtetë ajo filozofi ishte e mbështetur në mite ekstreme, të cilat fatkeqësisht u krijuan mbi bazë albanofobie. Po cilat konkretisht ishin ato mite të gënjeshtërtë, ne do t'i përmendim në vijim, duke vënë në pah zhvillimin historik të popullit tonë në krahasim paksa me atë serbë.

II) NJOHJA ME TË VËRTETËN PA MITE TË GËNJESHTËRTA E URREJTJE NDËRETNIKE, SOTPËRSOT ËSHTË ZGJIDHJA E VETME REALE DREJT MIRËKUPTIMIT E PAQETIMIT SHQIPTARO-SERB

Duke marrë si shkas veprën e diskutueshme të z. M. S. Milojeviç, objektivi i këtij punimi ishte të pasqyruarit e realitetit objektiv ontologjik sa më qartë, nga i cili duhet me dalë në pah e **vërteta** demografike për Kosovën me shumicë shqiptare joserbe gjatë shekullit XIX dhe gjatë tërë historisë, e vërtetë kjo që për lexuesit e interesuar sidomos ata serbë do të shërbejë si medikament relaksues për të kuptuar dhe shëruar traumat patologjike shpirtërore ndëretnike serbe-shqiptare të shkaktuara më parë nga keqinformimi të sforcuar sidomos në shekullin XIX nga kastat politike shtetërore e fetare të elitës serbomadhe. Sido që të mund të kuptohet, ne kemi bindjen se po të njihet sot si duhet e **vërteta** rreth shkaqeve të konflikteve nga e kaluara që nga shekujt XVIII –XIX e më vonë deri në shekullin XX që sapo e lamë pas, tek të dyja palët do të mbizotërojë arsyeja për gjykimin e padrejtësive dhe që njëherazi do t'i lehtësojë tek çdo individ: egon, zemrën dhe shpirtine tij, por do të lehtësojë edhe vetë mendësinë e masës për të vepruar ndërgjegjesisht drejt përmirësimit të marrëdhënieve dhe të paqetimit të sinqertë ndërnjerëzor serbo-shqiptar tashemenjëherë dhe për jetë e mot.

Së këndejmi, meqë ne kemi bindjen që Milojeviçi nuk e kishte të qartë **të vërtetën** ashtu si edhe shumë të tjerë atëherë e sot në Serbi, Europë e botë, se *Kosova në asnjë periudhë historike* (pagane, kristiane ortodokse, katolike, muslimane, ateiste, serbokroatosllaviste, fashiste, jugosllavo – komuniste e paskomuniste deri edhe miloshevciane) edhe pse e robëruar ose në aleancë me sundues e sundimtarë të ndryshëm joshqiptarë edhe serbë, kurrë nuk ka qenë pa shumicë shqipfolëse (shqiptare), andaj po cekim disa fakte e prova logjike nga lashtësia e deri në ditët tona që njëherazi janë edhe të qarta objektive që e tregojnë këtë **të vërtetë** hapakrah:

Së pari, është konstatuar shkencërisht se që nga lashtësia e sidomos nga epoka historike protoshqiptarët jetonin në këto vise, asnjë mbret i Ilirisë, Dardanisë dhe nga periudhat e hershme të Perandorisë Romake në këto troje nuk ka pasur emër sllav. Krahaso: Agron, Bardhyl, Genti, Teuta, Dioklecian, Konstantin, Justinian, Glauk, Plator, Pleurat, Pirro etj. etj.

Së dyti, që nga ajo kohë po ritheksojmë **Tetrakinë** e Diklocionit identifikohet përqendrimi i iliro-dardano-shqipfolësve në trevat që edhe sot jeton si masë etniteti shumicë shqiptare. Po e theksojmë termin shqipfolës, ngase sllavishtja (serbishtja) dihet nga e ka burimin, ndërkaq shqipja ndryshe nuk mund të shpjegohet pos si gjuhë më e hershme në këto vise e trashëguar nga iliro-dardanët vendas.

Së treti, dihet e vërteta, se me ardhjen e sllavëve në viset e Ilirisë së Jugut gjithsesi pati takime iliroshqiptare-sllave, madje vende-vende nuk pati vetëm simbioza por edhe ndarje shtresash shoqërore, përndryshe nuk do të qëndronin si gjuhë të veçanta shqipja në njërën anë e në anën tjetër gjuha sllave. Pra duhet pranuar që gjuha shqipe që para këtyre kontakteve ishte e formëzuar si gjuhë e vetme me sistemin e vet stabil, andaj edhe nuk u latinizua. Edhe në raport me sllavo-serbishte del e ruajtur tek etniteti iliro-shqiptar, i cili del më i grumbulluar në perëndim, në brendi e jug të Siujdhesës Ilirike, ku edhe sot dominon jo si shtet, por si kombësi unike edhe pse diku-diku ende dihen të pashqyera vravrazhkat e sllavizimit (bullgaro-serb), rumunizimit ose greqizimit të shqipfolësve.

Së katërti, është e vërtetë, siç e pranon edhe vetë Milojeviçi se me depërtimin e sllavëve në këto vise të Ilirisë, natyrisht të përzier me autoktonët, aristokracia latine e greke popullsinë e tillë e quanin me emrat **skllav** e **serb** (*serv*) me kuptimin *sklav*, *rob* (*shërbë/torë*, d.m.th. kështu i quanin *sllavët*, përkatësisht *serbët e përzier me vendasit bujkrobë* si shërbëtorë, të cilët u shërbenin *si skllavë* apo *shërbëtorë* si të huajvea ashtu edhe elitave vendëse. Pra në këtë shtresë vartësish si bujkrobë nuk kanë qenë vetëm sllavët apo serbët sipas kuptimit të sotëm, por ishin popull i përzier sidomos me iliro-dardanët autoktonë shqipfolës të mposhtur, të asaj popullsie, e cila ndërkohë fitoi të drejta prone dhe administrimi, andaj vendi i tyre i kësaj amalgame popujsh, ku supozohet se mbizotëronin shqipfolësit arbnorë quheshin edhe servë në Servi (P/ Budi, apo shërbë e Sherbi (P. Bogdani) ashtu si edhe të gjithë ndjekësit të gjuhës sakrale lashtosllave metodoqirile. Pra për hir vendi doli ndërkohë edhe edhe emri i një etniteti **serb**, por që nuk e kishte kuptimin që ka sot vetën të nacionalitetit serb, ngase supozohet, siç u tha se që atëherë në ato treva nuk ishin shumicë sllavishtfolësit, ngase ishte në përdorim szyrtare si gjuhë latinishtja ose progreqishtja bizantine (variant i përzier i gjuhës sakrale e zyrtare pas pellazge), ndërsa shqipja ishte gjuhë popullore në oponentë me gjuhët liturgjike e zyrtare.

Së pesti, kuptohet se sllavët si ardhës këtu gjeten krishtërimin e përqaftuar nga masa iliroarbnore dhe gjithsesi prej tyre morën fenë kristiane. Nuk është i padrejtë konstatimi i historianëve që me rastin e **Shkizmës së Madhe** brendakristiane më së keqti e pësuan shqipfolësit (arbnorë), ngase edhe kishin shtrirje më të gjerë trashëguese si anas në Siujdhesën Ilirike e më gjerë. Kështu pjesa perëndimore ose zakonisht pjesa bregdetare veriore e Adriatikut ishin dhe mbetën nën ndikimin e fortë të Kishës së Romës dhe sa herë kishin mundësiu e shtrin këtë rit në brendi, ndërsa pjesa tjetër domosdo ishte e ndërlidhur me Kishën e Konstatinopojës, Perandorinë Bizantine dhe pikërisht nga kjo ndarje shqipfolësit iliro-dardanë-epirotë u dobësuan shumë. Sidoqoftë, kur është fjala para e pas ardhjes së tatarobullgarëve, të cilët u sllavizuan dhe njëherazi u krishterizuan dhe u forcuan si shtet, dobësia e shqipfolësve ishte edhe më e dalluar, sepse pjesa qendrore e jugore e tyre me dobësimin e Perandorisë Bizantine ra nën sundimin bullgar e pastaj edhe nën atë tribaloserb. Po gjithsesi fiset shqiptarofolëse mbijetuan si shumicë edhe nën sundimin bullgar ose tribaloserb, por jo me kuptim një nacion aliteti serbo-sllav. Tashti në periudhën e shkizmës së madhe pas disa luhatjeve sundimtarët bullgarosllavë e tribalo-serbë u përcaktuan për ritin ortodoks bizantin, ashtu ndodhi si diktum edhe me shumicën e iliro-dardano-arbnorëve shqipfolës të këtyre trevave, të cilët edhe emërtoheshin në bazë të trevës përkatëse *bullgar*, përkatësisht *serb*, *grek*, ndërsa ata të ritit latin më fort në viset bregdetare të adriatikut e të malësive veriore gjithandej emërtoheshin albanez (serb. latini arbanasi) edhe pse kishte raste që ende nuk e kishin braktisur emrin vetjak **arbnorë**.

Së gjashti, fati historik krijoi kushte që pas kryqëzatave, pas rënies së Perandorisë Bullgare dhe jo të mëkëmbjes së Perandorisë Bizantine në hapësirat gjeografike të Siujdhesës Ilirike fillimisht në Zeta (Mal tël Z)I e pastaj në Rashkë (Serbi) dhe së andejmi në Kosovë, Maqedoni e Shqipëri të shtrihet dinastia tribale nemanjide, dinasti që u përvetësua dhe u fry nga historiografia e mëvonshme serbe, edhe pse del mjaft e diskutueshme biografia e gjenealogjisë së asaj familjeje dhe sidomos të zhupanit të madh Stefan Dushanit, përkatësisht e Stevan Nemanit, të cilën, Feri Arifi (ashtu si edhe S. Riza, F. Xharra, J. Buxhovi etj.) e quan me prejradhje shqiptare (“R. drini”, 15.10.2018), ku pos tjerash përmend edhe protagonistin e punimit tonë me këto fjalë: “autori M.S. Milojeviq në librin e tij f . 352, thotë: ”*Stefan Nemanja është serb, por nuk i dihet as nëna as baba as fshati i lindjes*”... Andaj lidhur me këtë ne po shtojmë vetëm kaq, mos vallë

Milojeviqi, me këtë dëshiron ta mbrojë *carin e vet serb, Stefan Dushani*, pasi pothuaj është i vetmi i asaj familjeje që nuk është shenjtëruar për merita nga Kisha Serbe me arsyetimin se ai ishte *atvrasës*. Sidoqoftë, serbë me kuptimin e sotëm njënacional nuk kishte fare ose ishin pakicë në shtetin e Dushanit, fakt ky që e pranojnë edhe studiuesit sllavë Qoroviq, Kostiq e të tjerë.

Së shtati, edhe pse për shtetin e nemanjiqve ne thamë se ishte i përbashkët me arbanasit, pala serbe e ngre në mit gjoja vetëm si shtet serb (me kuptim njënacional). nocion ky që e kishte përvetësuar edhe Milojeviçi dhe pasuesit e tjerë që deri në ditët e sotme po e mbajnë arbitrarisht. Për këtë studiuesit konstatojnë se atributi *serb* ishte trillim, ngase si shtet ishte inekzistent, ngase edhe vetë Dushani, siç thuhet, e paska shpallur veten car i serbëve, arbanasve, grekëve e bullgarëve, mirëpo vetëm shqiptarët (arbanasit) pothuaj në tërësi ishin brenda kufijve të asaj perandorie dhe kjo dëshmohet, sidomos pas vdekjes së tij ose pas zhbërjes së asaj dinastie, kur fisnikët arbnorë dalin më shumë në numër dhe me zotërime pronash me kufij të caktuar, pikërisht në trojet që ishin shqiptare, ku edhe sot jetojnë shqiptarët, në toskëri e gegëri. Madje Rrafshi i Dukagjinit e vise të tjera të Kosovës në atë kohë identifikohen se ishin në sundimin e Principatës së Balshajve katolikë të Shkodrës e më vonë edhe nën pushtetin e Bushatlijve muslimanë të Shkodrës. Atëherë, pyesim, me çfarë logjike në shek. XIX e në vazhdimësi shpallej nga pala serbe që trevat që mendohej se ishin nën sundimit nemanjiq nga shek. XV sidomos Kosova ishin troje me tapi serbe, kur serbë nuk paska pasur as si pakicë simbolike, prandaj krejt arsyetimi i palës serbe deri në ditët e sotme mbetet realisht imagjinar (*izmishlotina!*), pa asnjë fije të drejte as morale as materiale. Po përsërisim, fundi i fundit, që në Kosovë e gjithkëndej në kohë të car Dushanit, përkatësisht të Vuk Brankoviçit ortodoksë nuk kanë qenë vetëm serbët, andaj Karta e kohës së Dushanit me pakicë fshattrash arbanase e shumicë serbe, si dhe Defteri i nahijes së Vlk Brankoviçit (1455), assesi nuk duhet kuptuar si shumicë serbe, sepse mbase si numër pakicë aty cekeshin arbanasët katolikët, sepse si shumicë serbe llogariteshin ortodoksët: shqiptarë, parabullgarë, vllahë e të tjerë.

Së teti, edhe në Betejën e Kosovës kundër ushtrisë Osmane, knjaz Lazarit, i cili pothuaj është i vetmi që konsiderohet fisnik serb, ngase ishte nga vendi i quajtur Serbia apo Sherbi (me qendër Krusheva ish Dardha dardane(!)) që nuk do të thotë se edhe ai ishte serb, sipas konceptit të sotëm të kombësisë serbe, por sidoqoftë atij i janë bashkuar fisnikë të njohur

shqipë (shqiptarë), madje ata ishin aleatët më kryesorë. më besnikë dhe më në numër. Kuptohet se Kosova si vendi i betejës gjithsesi ishte tokë me shumicë shqipfolëse që në disa anale quhej *Albani* madje ka historianë që dëshmojnë jo pa vend që edhe dy dhëndurët e Lazarit nga Kosova: vetë Ulk Branku (Brankoviçi) ashtu si drenicasi dëshmor i shenjtëruar Milosh Kopiliqi, familjarisht ishin shqipfolës. Së këtejmi, duhet të kuptohet e vërteta se miti që në atë betejë luftëtarë e martirë ishin vetëm serbë pa shqipfolës e të tjerë aspak nuk ka mbështetje logjike as reale. Ishte prodhim imagjinarë i murgjëve kishtarë e jo nga kujtesa e shëndoshë popullore, siç e mendonte edhe Milojeviçi, apo jo?

Së nënti, është i njohur fakti se që me rastin e dorëzimit të Konstatinopojës osmanëve, Patrikana bizantine siguroi privilegje për vetë **si organ** dhe për ortodoksinë **si fe**. Kështu në marrëveshje me sulltanin fitoi të drejtë autonomie, përkatësisht pavarësi në udhëheqje që të manipulonte e përkujdersej me grigjën fetare të ortodoksisë. Si rrjedhojë edhe kisha sllave-serbe autoqefale jo e njohur nga fanari, si edhe të tjerat nga pala turke gëzonin imunitet veprimtarie dhe qëndronin në aleancë me regjimin osman. Kështu murgjit në kisha ortodokse serbe legalisht idealizonin si mbrojtës martirë, ata që kishin rënë në luftë, por edhe ata që bashkëpunonin ose ishin në shërbim të Turqisë Osmane, të cilët i arsyetonte si martirë sepse ata në atë mënyrë duke qenë lojal ndaj shtetit osman, mbronin fenë e serbët. Po e përmendim faktin që veç martirizimit të Lazarit si Jezu, Milosh Kopiliqit si shenjtor, u idealizua edhe princesha Elena, e veja e Lazarit, e cila menjëherë pati lidhur miqësi me osmanët, duke i dhënë vajzën për grua sulltan Bajazitit, gjithashtu u idealizua në këngë po nga kisha edhe princi vasal Kraleviq Marko, i cili luftonte dhe u sakrifikua për Turqit gjoja si mbrojtës i popullit serb, i cili në të vërtetë vdiq në luftë për intera osmane. Megjithatë, ne, në këtë kontekst vlerësojmë si gjë positive luftën propagadistike se me mite e këngë të tilla ndërkohë u bë formimi, ruajtja apo ringjallja e identitetit dhe e gjuhës serbe ndër masa ortodokse. Pra, ne e çmojmë rolin serbo-nacionalist të murgjëve në sajimin e ruajtjen e kujtesës ndaj mitit të trilluar dhe të zmadhimit e substancës serbe, por e gjykojmë anën negative të atij miti, kur u orientua tehu i tij në kurriz të shqiptarëve, të cilëve u mohojë identiteti, duke i ngatërruar qëllimisht me turq zaptues, vetëm pse disa a bjë pjesë e tyre e kishite përqaftuar fenë muslimane. Ka mendime që në atë frymë shënoi vargje gjoja popullore, gjatë misionit të tij në Kosovë që i krijoi jo aq suksesshëm vet Milojeviçi.

Së dhjeti, historiografia serbe edhe Milojeviçi Kastriotët i quan serbë, madje gjatë një vizite të tij në Mirëditë, Milojeviçi përmend e përmend rastin që Gjoni (Ivani) i jati i Skënderbeut, gjatë ikjes nga Turqit, këtu gjen qetësi andaj e paska pagëzuara **Mirë Dita Dobar (Miran Dan)**. Ky vë re që mirëditasit katolikë me krenari e mbanin veten kastriotas (*kastriotiqi*).

Pyesim lidhur me këtë, pasi Skënderbeu paska qenë serb, gjatëluftës së tij heroike afro 30 vjeçare pse nuk iu kushtua një këngë nga murgjit serbë? Është e vërtetë se gjatë asaj kohe princat (vasalë) serbë i shërbenin verbërisht shtetit osman. Skënderbeu e organizoi atë luftëçlirimtare i cytur duke u mbështetur nga krenaria e liria natyrore e masës malësore e fushore dhe e përkrahur kryesisht nga krerë të fesë katolike, por edhe nga kisha unite kristiane ortodokse e kohës, e cila respektonte papatin latin. Në të vërtetë kur Skënderbeu si prijës popullor epirot arbnor afro 30 vjet suksesshëm luftoi kundër osmanëve, duke bashkuar shqiptarët e të dy riteve katolike e ortodokse dhe njëherazi pa e prishur ndërlidhjen e ndihmën miqësore me familjet e sapoislamizuara shqipfolëse, duke mos ndryshua emrin musliman **Skënder**, po edhe duke mos u dalluar aq me ndonjë shenjë të veçantë ekstreme fetaro-kristiane, për nga veshja me kryqa, me ndërtim e pagëzim manastiresh e kishash, qoftë ortodokse, qoftë katolike, ai, duke respektuadr të tri fetë, vërtet vulosi veten **me qenë për jetë e mot, hero kombëtar shqiptar**, apo jo?! Në këtë kohë, meqë Sulltan Mehmeti ishte nip i ordoksëve (serbë), kisha serbe thuhet më tepër qëndronte jo anash si soditëse, po ndihmonte palën turke, siç do të argumentohet në pikën vijuese.

Së njëmbëdhjeti, ç'është e vërteta, është i rëndësishëm fakti që edhe pas pushtimit Osman dyert fisnike t'i quajmë pasnemanjite (ortodokse, katolike shqiptare-serbe) vazhdonin me ndërlidhje krushqie martesore. Historia njih shembuj të tillë të shumtë. Ne këtu po e përmendim vetëm rastin rreth bijës së Gjergj Arianitit, të komnenëve shqiptarë, shenjtores se kishës serbe zonjës **Angelina**, e cila me fisnikun Stefan, djalin e Gjurgj Brankoviçit u kurorëzua në Shkodër, sepse vasalët serb proturq e kishin dëbuar nga Serbia. Kështu ajo me fisnikun Stefan përkohësisht u detyrua të strehohej tek e motra, Donika e Skënderbeut, deri sa u lindi djali, pastaj Skënderbeu e ndihmoi të emigrojë në Itali dhe së andejmi në Hungari. Në burimet serbe nuk kam hasur t'i ceket origjina shqiptare kësaj shenjtojeje dhe asnjë murg a shkrimtar serb nuk ia ka kushtuar një fjalë miradie Skënderbeut, ndërsa emrin e autoritativ të tij e

duan ta fusin në kornizën e serbizmit, ashtu si edhe preardhjen e tyre epiroto-ilire. Në asimilimin e kësaj mase.

Së dymbëdhjeti, është i njohur fakti që pas vdekjes së Skënderbeut shqiptarët si të mundur pësuan keqas, andaj për mbijetesë u detyruan, sipas rrethanave të ndiqnin nga halli njëjërën nga këto tri rrugë:

e para, katolikët e unitët të dalluar si pjesëmarrës të drejtpërdrejtë në ato lufta, domosdo veç e veç po edhe në turma u detyruan të shpërnguleshin jashtë ose të arratiseshin maleve të pakalueshme të Shqipërisë dhe të ndërlihdeshin me fise të papërkulura malësore deri në sakrifikim, ku vërtet gjetën solidaritet e ndihmë vëllazërore mbijetese,

e dyta, ortodoksët duke u mbështetur në kompetencat e kishave autoqefale kryesisht serbe e greke, kërkuan mbrojtje nën autoritetin e tyre, të cilët dhe i pritën mirë, natyrisht, pasi këta vartës në luftë për ekzistencë ishin të obliguar që ndaj kishës dhe shtetit osman me i krye me besnikë detyrimet, detyrime këto që kisha serbe i njihte dhe e përkrahte ashtu si edhe turqia që e njihte dhe e përkrahte etnitetin ortodoks si aleat të vetin. Në këtë periudhë joafatshkurtër u rrit konsiderueshëm numri i shqiptarëve shqipfolës të asimiluar në ortodoksë nën ombrellën e kishës ortodokse serbe.

e treta, të islamizoheshin, ose të deklaroheshin të islamizuar, rrugëzgjidhje kjo politike në krahasim me të parat më mençurakeose atavike që për fat e zgjodhën shumica shqipfolëse. E quajtmë mençurake vështruara nga logjikë-gjendja e sotme e interesit kombëtar, ngase mbase ishte e pamundur konfrontimi ushtarak, duke i shprehur lojalitet Perandorisë, çka në ato kushte ishte me shumë interes mbetja në trojet e veta, ruajtja e gjuhës dhe njëherazi ndërlihdja fisnore e veprimtare me sivëllezërit malësorë katolikë e ortodoksët shqipfolës të paasimiluar apo mbatja e pushtetit intelektualisht me orientim përëndimor vetëm kanunisht, mundësoi bashkëjetesë kombëtare deri në ditët e sotme. Kështu islamizimi formal ishte me interes mbijetese i privilegje, të popullit tonë që arriti të ruajë tradita shqiptarie duke arritur deri te Rilindja jonë kombëtare duke u islamizuar në atdhe i nënshtrohej pa dëshirë pushtetit fetar turk, por meqë rrethanat lejonin që ata të gëzonin privilegje dhe kishin mundësi ta ruanin gjuhën, ligjërimin vendës zakonet vendase. Kjo gjithsesi ishte një lehtësim i madh për ta, sepse gjuhësisht nuk largoheshin nga vetvetja si dhe nga pjesa tjetër katolike ose ish-katolike e unite ortodokse shqipfolëse.

Me fjalë të tjera që dy fakteve nga pika e mësipërme shpërngulja jo vetëm në perëndim por edhe në lindje në perëndim, nga halli pothuaj ishte e gjykuar me humbë lidhjen me ardheun, besa edhe identitetin e vet gjuhësor etj, dhe aq më keq serbizimi apo asimilimi gjuhësor nën ndikimin fetar ortodoks, ishte **shkizmë e re fatale**, pjesa tjetër, ndërsa pjesa e tretë shqipfolëse duke filluar nga periferia ose nga vatra më të organizuara sipas gjuhës fetare , shqiptarisht pësoi edhe më keq, sepse në rrethana të caktuara, duke iu nënshtruar ritit përkatës fetar të shoqëruar me një propagandë fort të organinuar nga kleri i përgatitur pravosllav, si me thënë, *u sivëllazërua* gjithnjë e më shumë deri në asimilim me popullin e gjuhën qirilometode sllavoortodokse kishtarë (serbe e bullgare). Për shtrirje të kësaj dukurie dëshmojnë edhe sot sa e sa mbiemra familjesh joserbe anëmbanë Serbisë. Nuk është fjala vetëm, për *gashiqët, arnautliqët, nikeziqët, gergurët saliqet*, hotët krashnikqët etj., por edhe për shumë të tjerë, apo jo?!

Së trembëdhjeti, kur patën plasur luftat turko-austrohunareze në shek. XVI-XVII, pikërisht në këtë periudhë del i ekzagjeruar nga pala serbe mitizimi rreth dy shpërnguljeve të një mase të krishterëve nga Kosova të implikuar në ndihmë palës austrohungareze. Kështu, burimet serbe i quajnë të gjithë të shpërngulurit nga Kosova serbë dhe i fryjnë shumë shifrat, që në të vërtetë ato ishin shpërngulje shqiptaro-serbe ose katoliko-orodokse. Kështu si duket të shpërngulurit e parë (1690) më fort ishin ordoksë (shqiptaro-shkije) të cilët gjetën strehë mikëpritje në Hungarinë *ortodokse*, ndërsa të shpërngulurit e dytë (1737) afro 50 vjet më vonë jo pak ishin shqiptaro-katolikë, të cilët gjetën strehë në Austrinë *katolike* të asokohshme, gjurmët e shqipes të kësaj mase i janë të njohur shkencës së albanologjisë.

Së katërbëdhjeti, shekulli XVIII karakterizohet me zgjime iluministe, rryma këto që depërtuan edhe në Turqinë e atëhershme shumetnike, ku vala e lëvizjeve autonomiste veç kishte nisur me marrë formë. Meqë kisha ortodokse serbe kishte liri veprimi tek ortodoksët me ndonjë fije emancimi edhe shtetëror, në anën tjetër xhamia muslimane propagandonte fenë tjetër lidhur me sforcimin drejt shtetit turk (osmanli). Kështu këto aktivitete ndikonin edhe më shumë në ndarje të masës, megjithatë populli shqipfolës ndërfishnor ishte tolerant, por interesat shtetërore kishin fuqi sa të futnin sherr e mostolerancë mes besimtarëve të këtyre dy palëve, përkatësisht edhe të dy apo tri feve ose sekte me ngjyrimë shqiptare, Edhe në këtë periudhë mitologjistët serbë vazhduan

edhe më me përpunimin e miteve të mëparshme, siç ishte miti për Kosovën, si djep i serbizimit pravosllav, ku duhet të rilindte, andaj ngritën shumë lart dhe futën në veprim manastiret e kishat ortodokse (Pejë, Deçan e Prizren, Prishtinë), duke u dhënë atributin vetëm si objekte *serboortodokse*, të cilat në të vërtetë nuk kanë qenë serbe, me kuptim të një nacionaliteti. Ato ishin ngritur në themelet e kishave kristiane parasllave dhe i takonin popullit kristian (katolik e ortodoks) shqipfolës që fillimisht ishte pa dyshim shumicë shqipfolëse në këto troje e më gjerë, mirëpo që tani në këto treva kristianët ortodoksë kishin mbetur pakicë, pasi një masë e konsiderueshme, siç u tha më sipër, kishte përqafuar fenë islame, atëherë pala serbe me dredhi propagandonte jo pa sukses emrin e vjetër toponimik Serbi dhe serb si etni, të cilin e shfrytëzonte vetëm për etnitetin njënacional dhe për kishën serbe, duke propaganduar se gjoja ato ishin vetëm ish-serbe, që në të vërtetë besimtarët shqipfolës muslimanë e katolikë, nuk kishin mundësi as fuqi të kundërshtonin ose të polemizonin së paku kur serbët i shpallën këto kishat e manastiret objekte në pronësi të tyre, problem ky ende i hapur, sidomos për Kosovën e sotme, por edhe për më gjerë.

Së pesëmbëdhjeti, po shtojmë edhe këtë se në shek. XVIII-XIX, pasi që serbët përvertësuan këto objekte, ata si: *kishat e manastiret*), ashtu si edhe *shkollat në gjuhën serbe*, i shfrytëzuan tani edhe si jatakë spiunimi e veprimi për kryerjen e disa misionëve komplekse proserbe:

së pari, të hetonin gjendjen politike brenda Turqisë, e cila jo vetëm në luftat me Rusinë cariste, por edhe me kryengritësit shqiptarë gjithnjë e më tepër jepte shenja patalogjike të një binaje që do të rrëzohej,

së dyti, gjoja jepnin me kuptue se e ndihmonin Turqinë, duke spiunuar kundër lëvizjes nacionaliste autonome kombëtare shqiptare që e denonconin tek Turqit,

së treti, serbizonin sa më shumë ortodoksë shqipfolës, duke blerë krenë e individë shqiptarë (edhe muslimanë e ndonjë katolik) që të punonin për interesa serbo-ruse dhe

së katërti, nxitnin hasmëri e konflikte jo vetëm shqiptaro-turke, por në raste edhe shqiptaro-shkije, duke inskenuar ekscese ndëretnike, që mbaronin me viktima të dhimbshme nga të dyja palët, ku pikërisht pësonin shqipfolësit si *arnautë* (shqiptarë malësie), në njërën anë, ashtu edhe *shqiptaro-shkijet* (argatë serbie), në anën tjetër.

Mjerisht kjo **shkizëmë** e re e fryrë nga të dyja palët **turq e serbë**, ishte fatale mes (ish)shqipfolësve të *shkizmuar* (*skizmatikë*), sepse jehona

propagandiste e ngjarjeve të tilla kishte ushqyer urrejtje që del e pashuar ndaj shqiptarëve edhe tek tërë brezi i Milojeviçit dhe pinjojve të tyre, mjerisht me veprimtari aktive deri në ditët e sotme.

Së gjashtëmbëdhjeti, rreth ngjarjeve, para e pas kryengritjes së parë serbe, nga fundi i shek XVIII dhe fillimi i shek. XIX (1804), edhe pse dalin të pranishëm shumë aktivistë shqiptarë ortodoksë si vetë Karagjorgji, Hondo Bimbashi e të tjerë, pala serbe pothuaj nuk i përmend fare. Për ato ngjarje në mënyrë makiaveliste zmadhohen me fjalë lavdie vetëm për elementin serb, i cili vërtet që nga ajo ngjarje do të jetë gjithnjë në ofensivë të pandalshme politike e ushtarake për zgjerimin e kufjve shtetëror drejt vendbanimeve të përziera serbo-shqiptare ose edhe thjesht shqiptare. Kështu pala serbe përveç ndikimit me propagandim mitesh kundër shqiptarëve tani plus si motiv e forcë ndikimi kishte pansllavizmin e organizuar me fuqinë, nxitjen dhe ndihmën e gjithanshme të Rusisë së forte cariste, pa e harruar besa edhe ndihmën europiane franceze, fillimishte austriake e të tjerëve të asaj periudhe, andaj Porta e Lartë si e pazonja për të kundërshtuar lëshonte pe ndaj kërkesave të palës serbe-ruse-franceze, duke shkalluar keqas kundrejt interesave të shqiptarëve, ngase, veç tjerash ishin pajtuar edhe me kushtin që me rastin e njohjes prej zori së autonimisë së principatës serbe turqit gjatë tërheqjes së ushtrisë dhe të administrates nga ato vise, do të zbatonin ose lejonin edhe tërheqjen a dëbimin e të gjithë joserbëve, qoftë me dashje, qoftë me dhunë, që ajo popullatë pothuaj qindpërqind ishin shqiptarë të islamizuar, por kishte edhe katolikë e ortodoksë shqipfolës në familjet mikste.

Së shtatëmbëdhjeti mjerisht në këtë periudhë plasën edhe konflikte serbo-shqiptare, jo për shkak të ndarjes fetare, edhe pse kjo ndarja fetare shfrytëzohej nga serbë e turq për interesa të tyre shtetërore dhe lidhur me këtë vëllavrasje më agresive u tregua pala serbe, e cila shfrytëzonte mitet për mobilizim të serbëve kundër popullit joshkie të Kosovës. Ky agresivitet u gjallërua politikish nga shteti e kisha pravosllave, duke i personifikuar shqiptarët si turq zaptues dhe njëherazi duke sajuar e përfocuar me gënjeshtër konflikte që do të arsyetonin ndërhyrje zaptuese kolonialiste ndaj Shqiprisë, pra kundër palës **shqiptare në përgjithësi dhe të Kosovës në veçanti**, pa marrë parasysh faktin se tash si shqiptarë (turq!) nuk bënin pjesë vetëm muslimanët, por edhe katolikët e unitët ortodoksë, madje edhe **shkitë tanë** ose **shkitë e vendit**, që ishte pjesa ortodokse që ende nuk ishte asimiluar gjuhësisht, por që tani kjo shtresë me makineri të ndryshme i shtrohej propagandës së zezë

serbëzuese të papenguar nga Turqia, por edhe me bekim ndërkombëtar, pasi ortodoksët e Turqisë (Shqipërisë) që më parë kishin hyrë nën patronatin e Ruisë, ishin të ndërlidhur fqinjërisht me Serbinë, ndërsa katolikët që ishin nën patronatin e Ausrohungariasë nuk kishin atë përparësi ffinjësie. Këtu në këtë pikë mund të cilësohet sadopak edhe propaganda konkrete shqiptarofobe e Milojeviçit, ngase ai vepronte në përputhje me direktivat e Qendrës, bazuar në Naçertanien pansllaviste serbe.

Së tetëmbëdhjeti, tani pushteti i Principatës serbe ishte edhe më i lire që me ndihmën e Kishës serbe të vepronte pothuaj legalisht në tërë Stara Serbinë (deri në bregdetin e Adriatikut. Organizimi i rrjetit të spiunazhit, për forcimin e serbizimit vazhdonte, siç po rivazhdon edhe sot, duke rezultuar me hapjen legale të shkollave të reja serbe, me të gjitha rrethanat e mundshme duke kërkuar edhe plotësimin e kushteve të domosdoshme, me sjellje literature, me kuadro, mësues etj., me një fjalë që në atë kohë kisha serbe ishte e lirë të vepronte në vazhdimin e përhapjes së nacionalizmit ekspansionist serb, sidomos ndër shkije vendës e shqiptarë të paguar (muslimanë e katolikë) dhe kështu bëheshin përgatitjet e duhura për agresion ushtarak me ndihmën e Ruisë për të zgjeruar sundimin në tërë hapësirën e Serbisë së Vjetër, ku parashihej, pra shtrirja e Serbisë së Madhe në Shqipëri e Maqedoni e në veçanti me sforcim Qendre në Kosovë, përkundër së vërtetës se ato vise ishin të banuara dembabadem nga shqiptarë autoktonë. Pra në këtë mision ta quajmë si pararojë agresioni u angazhua pra edhe Milojeviçi si udhëpëshkrues i parë civil serb në trojet tona.

Së nëntëmbëdhjeti, meqë për veprën e Milojeviçit kemi bërë fjalë në 7 kërret e këtij punimi këtu do të ricekim kalimthi vetëm edhe këtë pikëveprimi. Ai gjithsesi me shifra të falsifikuara *hartoi Hartën Etnike*, me të cilën do ta ndihmonte agresionin, duke e shpallur shumësinë e paqenë serbe në Kosovë në vitet '70 të shek. XIX dhe kështu me këtë armë, vërtetë të rrezikshme kulturore propagandistike e me libra të fryra me të dhëna të falsifikuara ndihmoi krijimin e atmosferës së tillë brenda popullatës serbe dhe ndër miq europian që Serbia të korrë sukses në luftën e vitit 1877-78, pra ta pushtojë të ashtuquajtën Serbi Jugore (Nish, Pirot, Kurshumli etj.) dhe pas 37 viteve më 1912 ta pushtojë edhe Kosovën, pjesën e Serbisë së Vërtetë të Vjetër, siç e pati pagëzuar Milosh S. Milojeviçi në Udhëpëshkrimin e tij. Së këtejmi, është e vërtetë se për një fitore të tillë ka ndikuar edhe edhe vepra e Milojeviçit, sidomos

konstatimi mbi gjoja shumësinë etnike të serbëve në Kosovë e Maqedoni, shifra këto edhe pse ishin të pasakta, atom si të tilla kanë vazhduar te po vazhdojnë të shfrytëzohet deri sot e kësaj dite, siç janë: tekstet mësimore shkollore, portalet nga interneti si “**Krstarica**”, “**Wikipedia**”, si dhe në të gjitha burimet enciklopedike, siç është edhe më karakteristike edhe vepra M. Vemiçit *Etniçka karta...* të cilën e shfrytëzuam ne, për të dermaskuar këtë mashtrim të madh, se gjoja para 150 vitesh ekzistonte shumësi etnike serbe në Kosovë.

Përmbyllje

Kur kemi parasysh përmbajtjen e lëndën së trajtuar në 7 krerët si dhe në këtë përfundim-përmbyllje dhe sidomos në 19 pikat e këtij nëntitulli na merr mendja se nga **e vërteta** për këtë çështje që del shumë e qartë do të kthjellohet çdo mendje, qoftë edhe fort naive serbe e shqiptare se armiqësia *shkije-shqiptare* tash mëse 150 vjeçare ka ndodhur në radhë të parë nga *shkizma fatale* e ndodhur *mes shqipfolësve* e shkaktuar fillimisht nga **dhuna turke** e ndërkohë e shfrytëzuar dhe e nxitur nga **nga pala serbe sidomos në shekullin XIX e XX** nxitur nga **pansllavizmi** përcjellë nga propaganda e zezë e shtetit dhe e kishës serbe e zhytur në ushqim mitologjik, nga e cila edhe lindi nacional-shovinizmi serbomadh me orekse kolonializmi ndaj trojeve shqiptare e ndihmuar nga **Rusia cariste kolonialiste** dhe në anën tjetër po kjo shkizmë është shfrytëzuar për interesa të veta, **nga turkoosmanët** që t’i përdornin shqiptarët *mish për top* dhe të shfrytëzonin rastin të zgjatnin asfiksimin pushtetor duke u kusuritur me trojet e tyre.

Sidoqoftë, shkurt me i ra, për vuajtjet e shqiptarëve pothuaj 200 vjeçare të dyja palët edhe Serbia edhe Turqia, duke pranuar fajësi e përgjegjësi për veprimet e tilla do ta çlironin sadopak vetveten nga mëkatet tejet të rënda shkaktuar popullit shqiptar e në veçanti këtij të Kosovës martire, por njëherazi edhe Europa e Rusia për pjesën e fajit të vet si kompensim duhet të ndihmojnë gjithanshmërisht pa hile shqiptarët kudo që janë e në veçanti Kosovën e Shqipërinë që të shërohen plotësisht nga traumat e ndarjës mëkateve të shekullit XIX e XX dhe të jetojnë, si Europa e Bashkuar, pa vizë të zezë kufindarëse.

Në fund, ne pa hy në komentime rreth iluzioneve të Milojeviçit, siç ishin: së pari, argatimi-iluzioni për shpalljen a konstatimin se serbët dhe gjuha tyre është sihyjnore, popull e gjuhë kjo që lindi e u bë këtu në Ballkan në Stara Srbi, por pati levizje, shtrirje e qarkullim pothuaj në tërë

botën e lashtë: europiane, afrikane e aziatike dhe përsëri u kthye këtu dhe po rilind në djepin e vet;

së dyti, për gjetjen e 4470 toponimeve serbe(!) gjithandej nëpër botë, si dhe të dhëna të tjera interesante *historike* të luftave të zhvilluara serbe gjithandej nëpër botë që gjoja dokumentohen deri edhe në këngë popullore serbe;

së treti, për gjetjen e shkrimeve e të mbishkrimeve në kisha e manastire *serbe* të periudhës së antikitetit e sidomos të ruajtura nga dinastia nemanjide serbe;

së katërti, rreth arsyes dhe fakteve që arsyetojnë *shkencërisht* aktoktoninë e serbeve në Ballkan kundrejt shkollës historike gjermane-perëndimore që sllavët dhe serbët i quajnë ardhës etj.- etj... por po nuk mund t'i lë pa përmend një çështje shumë të rëndësishme pse u shua aq shpejt autoriteti Milojeviçit si krijues pas botimit të veprës *Odlomci* dhe 2 librave të para të *Putopis-it* 1871, 1872, e kjo shihet, sepse kur e ofroi veprën e tretë 1873, nuk ia botoi Shoqata e dijetarëve serbë, pikërisht atëherë kur edhe filloi me u aktivizua drejtpërdrejt në Luftë kundër Turqisë. Një përgjigje të tillë pse nuk ia botuan nuk e kam ndeshur as nga adhuruesit as nga kundërshtarët e tij?

Me thënë të drejtën, këtë ftohje e bojkot, mos vallë e pësoi Milojeviçi për këto dy veprime:

Së pari jo vetëm pse nuk qe i *zoti që trillet e veta t'i thurte më me mjeshtri (Rugarac)*, ngase edhe të tjerët të asaj kaste përdornin trille he më të qoroditura, por si më qan zemra, Milojeviçi e pësoi pikërisht për qëndrimin e tij jo aq radikal ndaj shqipëve dhe gjuhës shqipe, edhe pse krejt kontribut në të mirë të shqipes e dha me pahir dhe

Së dyti, ai ishte trim dhe temperament prej natyre, andaj ato që e konsideronte mungesë programore e ecurie të regjimit e shprehte haptas. Po e përmend vetëm një rast, mbase jo aq i rëndësishëm, por ka peshë shumë të madhe. Milojeviçi shumë argumentueshëm sjell në dyshim mitin ose ekzagjerimin rreth numrit të *dy shpërnguljeve të serbëve* nga Kosova gjatë luftave turko - austro-hungareze, 1690 dhe 1770. Kështu sipas tij po të kishte qenë shpërngulja aq e madhe, atëherë si ishte e mundur që 85 vjet më vonë më 1775 përveç fshatrave të Llapit dhe shumë vendbanime të tjera, si: Glavnik, Podojevë, Krajmiroc, Marica etj. që ishin me banorë serbë "*одкуда би овде били Срби на 85 год доцније... Осим лапских села као Главник, Подујево, Крајмировце Марика и др. били су сви срби / ...* ndërsa tash vonë, që nga kufiri i Qarkut të Krushevës në Serbinë e Vërtetë

e deri këtu (në Kosovë) nuk ka as zë as gjurmë ortodokse pravosllave “... *a sad od naše granice kruševackog okruga u Prawoj Srbiji dovde (Kosovo) nema od pravoslavnih ni glasa ni traga!*” Kështu siç nënkuptohjet, ky pakësim i serbe nuk kishte ndodhur nga shpërngulja po nga konvertimi i ortodoksëve në fenë islame dhe kjo ka ngjarë sepse “Që në shek. XV Turqit e kishin turqizuar Shënmarinë hyjllindësen tonë” */Turci su dakle još u 15 veku poturčili našu sv. Bogorodicyu!/?*

Kështu pra, nuk kishte pasur pakësim serbësh (ortodiksish) nga shpërngulje, po nga konvertimi masiv i masës së *poshkipuar* në islam. Pastaj Milojeviçi tash flet për raste që në të njëjtën familje familje pleqt e të moshuarit ende janë kristianë, ndërsa zakonisht ata nën 20 vjet ishin muhamedanizuar, përkatësisht ishin *poshkipuar* (shqiptarizuar).

Ne e çuajmë me peshë edhe këtë konstatim, ngase siç nënkuptohet ajo popullatë shumicë ortodokse, përkatësisht **pravosllave**, gjë që nuk konstatohet aq, ajo në të vërtetë ishte shqipfolëse e mbase mund të kishte qenë me fe ortodoksë (**pravosllavne vere**), të cilët me rastin e konvertimit harruan lutjet e popave ortodoksë në gjuhën e sllavishtes së vjetër dhe tashti u harruan edhe ato fjalë lutjesh të pakuptueshme. Së këndejmi, kjo kuptohet këta paskanë qenë **shqiptarë me gjuhë dhe si të tillë kanë mbetur po me fe tjetër**, gjë që nuk kontestohet se shqiptarët gjithëkëndej në Sherbi ose Servi ishin shumica të ritit skizmatikë **ortodoksë**, me fe serbe (apo greke, bullgare a rumune) por që flitnin shqip dhe me të kuptuarit e kësaj **të vërtete** vetvetiu rrëzohen të gjitha *trill-mitet e rreme rreth Kosovës pa shqiptarë(!!!)*, siç ishin trill-mite të rreme, me të cilat është manipuluar me shekuj e po maniopulohet edhe sot në kurriz të shqiptarëve nga ana serbëve e më gjerë, si:

E para, përmenden dy dokumente gjoja të etapës para osmane, nga *srpsko carstvo*:

a) *Karta e Deçanit* (më 1330) ku qenkan shënuar 3 fshatrat arbanase, ndërsa 89 serbe (lexo ortodoksë kryesish shqiptarë shumicë), dhe

b) përmenden *shërbyes bujqësorë*, ku ndër 2666 familje vetëm 44 dalin të shënuara si arbanase, ndërsa 2622 serbe (dhe këtu lexo f44 familje katolike dhe të tjerat ortodokse shqiptaro-serbe).

E dyta, nga Etapa e sundimit Osman manipulohet me këta dokumenta:

a) te **VLK-Defteri** (1455), ku dalkan vetëm 480 vendbanime arbanase mbase të islamizuar apo katolikë, ndërsa 12.985 serbë (lexo e kupto ortodoks kryesisht shqiptarë)

b) edhe te **Regjistrimi vitit 1486** ku statistika nxirrka 99% ose 16.729 banorë ortodoksë lexo shqiptaro-serbë), dhe vetëm 1% arbanas (katolikë);

c) te statistikat e shekullit XIX ku si më i dalluari në burime të caktuara si në *Krstarica e Wikipedia* për Kosovë del **statistika e Milojeviçit**, veprën e të cilit e kemi trajtuar mjaft në hollësi, ku gjithsesi si shumicë etnike mbi 80% faktikisht dalin shqiptarët, jo serbët.

REZYME

Varianti i parë i këtij vështrimi kritik historiko-gjuhësor: **“Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës, shkas vepra e z. Milojević (1866 -1873) dhe epranët e pasuesit e tij”**, është botuar në portalin *zemrashqiptare*: 10.09.2017 – 20.11.2018, në nëntë vazhdimë. Tashti pas rileximit me përplotësime të nevojshme po letërlibërtohet në shtatë krerë që secili krye në vete paraqet një kompleks temash me përmbajtje të specifikuar, por të gjithë krerët rrumbullakësojnë mesazhin që ka të bëjë me pasqyrimin raporteve politiko-shoqërore serbo-shqiptare, sidomos nga fillimi i shekullit XIX, kur serbosllavët nën ndikimin e romantizmit nacional të rilindjes sllavoserbe *Preporod*, fjalëtermin **serb** që kishte nocion konglomerat etnish e përvetësuan si nocion një etnie dhe kjo u mbrumos konturisht gjatë dy kryengritjeve serbe, të Parë 1804–1815 dhe sidomos gjatë të Dytës (1815/1830) që rezultoi me njohjen autonomisë së shtetit të parë serb nga Turqia) Kështu shteti serb i nxitur nga përkrahja e shteteve armike të Perandorisë islame Osmane dhe i joshur nacionalisht nga vetë atributi **serb**, emërtim ky, i cili si toponim që nga mesjeta kishte shtrirje më të gjerë në Ballkan, pikërisht në territoret që ende ishin nën sundimin e Perandorisë Osmane, si Kosova e Maqedonia e më gjerë. Së këtejmi ky shtet i ri jo vetëm ëndërroi, por syhapur punoi, e bëri përgatitje intensive të shumanshme për ekspansionizëm, për zgjerim drejt këtyre tokave. Po kësaj kauze i sherbeu edhe intelektual i entuziast me fantazi të bujshme **Milosh S. Mlojević**, i cili i përgatitur si student nga Rusia dhe nga Kisha pravosllave serbe sidomos, u dërgua në të ashtuaquajturën Stara Serbi në mision udhëpërshkruesi, që të identifikonte çdo gjë serbe, sipas kuptimit njënational që kishte marrë ky emërtim në shtetin e Pashallëkut të Beogradit së Knezhevinë serbe.. Këtë mision si duket ky e filloi në vitin 1866 dhe përshtypjet e tij me ngjyrim romantik i përmbloodhi në tre vëllime (*sveske*) nën titullin *“Putopis, dela Prave stare Srbije”* (*Udhëpërshkrim nga një pjesë e Serbisë së Vërtetë të vjetër*, të botuara 1870-1873, e cila u vlerësua si vepër e përshtatshme propagandistike para fillimit të Luftës Serbo-Turke (1877-1878), ku autori mori pjesë aktive si komandant i vullnetarëve rus dhe i nxënësve të vet. Mirëpo ndërkohë, pas fitoreve në luftë, në Mbretinë Serbe, për shkak të kryeneqësisë dhe të pavërtetave ms të cilat shërbej, nuk pati jehonë e përkrahje as ai as vepra e tij, madje as në dy Jugosllavitë: as të Kralit dhe as të Titos (shek XIX-XX), por atë,

veprën e tij, për shkaqe propagandistike kundër Kosovës, në fillim të shekulli XXI, me leje–urdhër të SANU-s e të shtetit serb pasmilosheviçian, nga pluhuri raftave të arkivave kishtarë serbe, e nxori hartografi Mirčeta Vemić, në përpjekje për të mashtruar opinionin e gjerë ndërkombëtar e vendor se gjoja mëvetësia e Kosovës si shtet, pas Luftës UÇK, ishte e padrejtë, sepse vepra e Milojeviçit tregon që Kosova, para vitit 1878, ishte e banuar me shumicë serbe, por ndërkohë serbët i paskan dëbuar ose asimiluar shqiptarët me ndihmën e shtetit turk! Vërtet, konstantim absurd pasi Serbia atë shumnicë 90% nuk e ka gëzuar kurr, as pas pushtimit të Kosovës 1912, as ripushtimeve 1918, 1944, as me 1999, po Serbisë i duheshin qoftë edhe gënjeshtër e falsicitete për të penguar njohjen e Pavarësisë së Kosovës ndërkombëtarisht si shtet sovran dhe si fakt plus Vemić e kishte një hartë etnike që e kishte hartuar Milojević Së këltejmi z. Memiq, veprën e tij e titulloi **“Etnička karta dela Stare Srbije prema Putopisa, M. S. Milojevića 1871-1873 godine** (*Harta etnike e një pjese të Serbisë së Vjetër, sipas veprës Putopis të M. S. Milojevic 1871-1873*), e botuar serbisht e anlisht më 2005 si libër special i veçantë nga SANU. Edhe pse me këtë punë nuk mundi të pengojë Pavarësinë e Kosovës, e cila u njoh ndërkombëtarisht më 2008, megjithatë vepra Memiq-Milojeviq, e botuar serbisht e anglisht, vazhdon të ekzistojë dhe e tillë citohet në të gjitha burimet serbe e më gjerë si vepër në dobi të propagandës serbe se gjoja në fillim të shek. XIX Kosova kryesisht ishte e banuar me etni serbe, të cilët ndërkohë qenkan dëbuar me dhunë nga shqiptarët?!

Pikërisht vepra e z. Vemić që rastësisht na u shfaq në internet na dha motiv e shkas për të reaguar me këtë punim **“Injorimi dhe dëshmimi me pahir i gjuhës shqipe si kriter i së vërtetës, shkas vepra e z. M.S. Milojević 1866-1873 dhe epranët e pasuesit e tij”** për të demantuar atë që ishte shkruar e keqinterpretuar nga Milojević e Vemić e të tjerë, në kurriz të shqiptarëve, duke e qitur në dritë të vërtetën dhe vetëm të vërtetën që duhet ta dijë në radhë të parë vetë brezi i ri serb e shqiptar me akademikët në krye, por edhe opinionin i gjerë.

Në mënyrë që Rezymeja të jetë sa më funksionale dhe më e përkapshme për lexuesin po përpiqemi që sa me pak fjalë të rikujtojmë përmbajtjen e këtij libri, shtjelluar në 7 krerë, prandaj po në shtatë pika, pas titullit të kreut përkatës, do të spikasim vetëm ndonjëren nga të veçantat që sadopak do ta orientojnë lexuesin e nderuar drejt qëllimit kryesor të mesazhit njerëzor politik që pas njohjes me lajthitjet e bëra nga

autorët mbase rastësisht tashti me qëllim që e drejta dhe e vërteta si rezultat të sjellin **paqetim mes dy popujve të pafajshëm, shqiptar e serb**, ndërsa fajtorët e prishjes së mirëkuptimit dhe mosdurim mes popujve të demaskohen **nga të dyja palët**, e sidomos nga ajo anë që ka mjellë dhe vazhdon me mjellë ende urrejtje për faje të paqena ndaj shqiptarëve.

Po cilat ishin apo janë më të veçantat nga punimi ynë sipas shtatë krerëve, do të përgjigjemi tash fill me fakt-prova me radhë, sipas krerëve përkatës, duke spikatur më të veçantat:

I. Kreu I me titull “Injorimi i gjuhë shqipe si kriter i së vërtetëls rreth zbërthimit të përqindjes etnike serbe – joserbe në Serbinë e Vjetër (Kosovë) sipas veprës së z. Miorčeta Vemić (2005), hartuar sipas Udhëpërshkrimit të z. Miloš Milojević (1866-1873)” është shtjelluar në pesë nënkrerë, duke zënë kështu një hapësirë mjaft të gjerë në punim.

Vemić në të vërtetë pos një harte të ripunuar, ka bërë një punë të mirë, jo pa mund, që ka sistemuar 1400 emërtime vendbanimesh që z. Milojević i ka shënuar në tri vëllimet e veprës: **Putopis...**, ku shumica e emërtimeve të tilla shoqërohen me numrin e shtëpive sipas etnive që dalin të shënuara nga Milojević, i cili për emërtimet e etnive përdori këto initiale: **S** serbë, **O** osmanë, **Ç** çerkezë, **C** ciganë, ndërsa për etninë shumicë shqiptare, që i quan **shkip shkipi** manipulon me katër emërtime etnish: tri etni pakica që përdor inicialet : **L** latini, **A** arnauti dhe **ili-ili** (ose ose) të pavendosurit dhe një shumicë **P poturi**, ku ka përfshi **shkipët** (që i shpjegon si **serbë të islamizuar** ose **serbë të turqizuar**), të cilët Turqia këta **serbopoturë** i ka detyruar jo vetëm të konvertohen në islam, por edhe të shndërrohen në **shqipë** (shqipfolës) e ta harrojnë serbishten !!! Vërtet një asyetim absurd, apo jo?! Po në vepër ndeshim edhe në absurditete të tjera.

Po me këto initiale kalkulon edhe Vemić. Madje edhe ne respektojmë këto initiale, por kur patëm të bëjnë me etninë shqiptare (**shkipët**) për dallim nga Milojević e Vemić në total shifrën me **P (poturi)** e kemi bashkuar me ato nga inicialet e tjera (**O, Ç, C; L, A** dhe **ili-ili**) dhe për krejt atë shumë e kemi përdorur inicialin **JOS (joserbë)** dhe totalin e kemi krahasuar me totalin nën inicialin **S** (serbë) dhe kështu kemi *zbuluar* manipulimin me rezultatin: **shumicë-pakicë (S ndaj JOS)** nga z. Milojević e Vemić. Në të vërtetë, ne kemi konsultuar e ritrajtuar tërë materialin nga vepra e z. Vemić dhe nga tri vëllimet e z. Milojević, duke

ilustruar me tabela të reja dhe kështu kemi zbardhur të vërtetën ashtu si Milojević, e ka regjistruar numrin e banorëve (shtëpive sipas etnive), por të keqinterpretuar të Kosovës (Serbisë së Vërtetë) dhjetë vjet para Lidhjes së Prizrenit 1868-1878.

Këtu po i paraqit vetëm dy konstatime të z. Vemić, (bazuar tek Milojević) ku realiteti paraqitet shumë i pasaktë dhe kështu konstatimet e shifrat e paraqitura prej tij të pandryshuara mbesin damkë e zezë e turpfit shkencor:

e para, **“Pre Srpsko-turskih ratova 1877-1878 god. na Kosovo i Metohiji Srbi bili etnička većina a Arbanasi manjina. “Para luftës serbo-turke 1877-1878 në Kosovë e Metohi shumica etnike ishte serbe(!),ndërsa ajo shqiptare pakicë”(!) dhe**

e dyta, **“U gradskim naseljima Kosova: Prizren, Priština, Peć, Đakovica, Vučitern i Kuršumlija, Srbi su činili devedeset (90%) procenata stanovništva. “Gjendja në qytete të Kosovës: Prizren, Prishtinë, Gjakovë, Kurshumli tregon që në atë kohë 90% e banorëve ishin serbë”(!!!).**

Ndërkaq, pas verifikimit që bëmë ne, duke shfrytëzuar të dhënat nga z. Milojevic, përkatësisht z. Vemić, në total, në fakt e vërteta siç ishte e regjistruar nga z. Milojevic, mbështetur në interpretim të drejtë rezultati del krejt ndryshe:

1. Në Kosovë e Metohi (si pjesë e Stara Serbisë) numri i shtëpi-etnive sipas veprave të Milojevićit në vitet 1866-1868, d.m.th para luftës serbo-turke (1877-78) në përqindje ishte: S 22% (ortodoksë e serbë), ndërsa JOS 78%” (shqiptarë kryesisht).

Ndërsa si përgjigje për konstatimin tjetër, nga verifikimi doli ky rezultat:

2. Numri total i etnive në qytetet Prizren, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Kurshumli, Vushtri, ishte S 14% (ortodoksë e serbë), ndërsa JOS (shqiptarë kryesisht) 86%.

Këtë po e ilustruam më mirë edhe me këto dy tabela statistikore:

a) Statistka mbi numrin e fshatrave dhe të shtëpive sipas etnive në tri zonat përkatëse

Qyteti	Fshatrat					Shëpitë			Vërejtje	
	Nf	ST	S %	JOS %	PP	S %	JOS %	Ps	Kd	
Kurshumlia K.	222	2	99 43	130 57	176	690 23	2230 77	71	-	
Qendrore	306	74	71 50	71 50	18	3585 33	7231 67	99	2	
Rr i Dukagj.	569	114	105 23	347 77	5	368 18	25242 82	48	52	
Totali	1096	119	275 33	548 66	199	9643 22	34703 78	218	54	

Ndërsa

b) Statistika për numrin e shtëpive sipas etnive për qytetet mbi 500 shtëpi:

Nr r.	Qyteti	Nf	S %	JOS %	(P	A	L	C	O
1	Kurshumlia	2000	-	2000 100	1800	150	-	50	-
2	Prishtina	3270	350 11	2829 89	2600	70	-	-	250
3	Vushtrria	850	250 29	600 71	600	-	-	-	-
4	Peja	1850	550 30	1300 70	1200	-	100	-	-
5	Gjakova	2385	36 2	2330 98	2100	-	129	120	-
6	Prizreni	6620	1200 19	5220 81	4800	2004	100	-	120
	Gjithsej:		2386 14	14279 86	13100	20	329	170	370

Së këtejmi, sipas fshatrave (vendbanimeve) po nga penda e z. Milojević del ky rezultat: **S 33%** ndaj **JOS 66%**, kurse sipas shtëpive (banorëve) sipas etnive: **S 22%** ndaj **JOS 78%**.

Po përfundoj kreun e parë me këto tri konstatime:

E para, te iniciali **S** shënova atributet: *ortodoks e serbë*, sepse në të vërtetë shumica e tyre e të ashtuquajturve të shënuar **serbë** kanë qenë **ortodoksë shqipfolës**, jo serbë, me kuptim të ri njënacional që u përvetësua pas kryengritjeve serbe, ngase ortodoksët shqiptarë vllahë e të tjerë, mund të jenë qujatur **serbë** si të gjithë shkizmatikët, vetëm pse ishin apo kishin qenë autoqefalisht banorë të Serbisë mesjetare.

E dyta, siç po shihet sipas statistikës së Milojeviqit, qyteti i Kurshumlisë, që ishte pa asnjë serb, bashkë me 24 fshatra që e rrethonin, pas pushtimit të vitit 1878, aty e gjithandej nuk mbeti asnjë shqiptar, dihet fati i tyre, apo jo?!

E treta, kur është fjala për Kurshumlinë, madje edhe Rashkën, përkatësisht tash për problemin e fshatrave me shumicë serbe në veri të Mitrovics, mund të themi se në Perudhën para 1878-ës nuk ishte e banuar me serbë, sespe siç konstatohet shkencërisht (**Bajić**), kjo zonë rreth

Kopanikut paska qenë **Zonë ushtarake e Turqisë**, prandaj në atë zonë nuk kishte fshatra serbe (ortodokse) por vetëm fshatra të banuara vetëm me **shqipë** e **çerkezë**.

Ky konstatim gjithsesi nuk është i parëndësishëm për ata që duan ta njohin të vërtetën.

II. Kreu i dytë me titull: **“Injorimi, por edhe dëshmimi me pahir i shqiptarëve dhe i gjuhës shqipe në jetën e përbashkët shqiptaro-serbe në Kosovë dhe më gjerë”**, është shtjelluar në dy nënkrerë, në të parin imponon sqarimi më në hollësi i fjalë-termi **potur poturi** si nga pikëpamja etimologjike ashtu edhe nga ajo e fushës semantike. Sipas shpjegimit në internet të z. Ferid Shaliq, fjala **potur** ka origjinë turke. Turqit në të vërtetë **djemtë jeniqerë**, sipas preardhjes së prindërve, i klasifikonin në tri grupe:

a) nga kristianë: **axhami oqlan**;

b) nga muslimanë: **synetli oqlan** dhe

c) nga prindë të papërcaktuar etniko-fetarisht: **potur oqlan**.

Ndërkaq historiografia serbe e asaj kohe fjalën **potur** e futi në përdorim në kontaminim me fjalën serbe **poturçin po(l)turçin** (*siturk a gjysmëturk*) dhe e përdori si etni, duke konkretizua: **potur** quhet **ai (serb) që braktis fenë pravosllave**, duke u konvertuar në musliman e së këndejmi po ky nocion u reflektua në shqipe: **“ai që e braktis fenë e të parëve”** (Fjalori i Bashkimit). Për këtë koncept lindën e pëdoreshin dhe ende përdoren trajtat sinonimike në serbisht: **poturica, poturçin, poturçenjak**, në shqip edhe turkoshak.

Së këtejmi boshnjakët e shqiptarët e islamizuar quheshin pa të drejtë **poturi** me nocionin **serbë të turqizuar**. Sidoqoftë me këtë term të ndajmbathur **poturi**, nga Milojeviq u ndajmbath një etni e re serbe që në të vërtetë nuk ishte serbe po ishte **etni e qindpërqind shqiptare**.

Po në këtë krye, (nënkre II) jepen shembuj nga dukuria e familjeve shqiptare fetarisht të përziera ose jo që shtriheshin, madje-madje edhe si shumicë, edhe në Pashallëkun e Beogradit e në vise të tjera, dukuri kjo që dëshmohet pamëdyshje me fakte ku ndër të tjera jepen këto të dhëna statistikore: Atëkohë në Principatën Serbe, Beogradi kishte shtëpi S 842 ortodokse ndaj JOS 1480 (shumica shqiptarë), ndërsa Uzhica kishte S 600-700 ndërkaq JOS deri 3700. Në qytete të tjera si Valeva, Kraleva, banorët e ashtuquajtur serbë ishin në numër edhe më të vogël ndaj JOS, shqiptarëve poturë e të tjerë, të cilët ndërkohë u shpërngulën ose u asimiluan me dhunë (*Shih në internet 16.12.2018 «revista drini»*).

Po tani si dëshmi të veçantë rreth familjeve fetarisht mikste shqiptare po sjellim konstatimin e Vuk Karaxhiqit:

*Arnautët (shqiptarët) që janë të ritit perëndimor (katolikë), dhe mund të jenë edhe të atij lindor (ortodoks) dhe që të gjithë thirren **shqiptarë** mund të themi se mesveti fare pak vërehen, ndërkaq, para të huajve sillen si vëllezër si të ishin të një riti. Kështu një i ritit turk (musliman) për një të krishterë do të mbyste dhjetë turq dhe po ashtu një shqiptar i ritit të krishtenë do të vriste dhjetë italianë për një shqiptar të ritit turk (musliman)...*

Kjo karakteristikë e shqiptarëve rreth tolerancës fetare vjen si rezultat i edukatës së trashëguar lashtësore fisnore, njerëzore. Mua që në vegjëli më është thënë e ngulitur këshilla: që **anëtarin fisit e ke vëlla**, edhe pse fisi ishte i përbërë fetarisht nga muslimanë, katolikë e ortodoksë; fisin e nanës **e ke dajë**, ku gjithashti kishte muslimanë katolikë e ortodoksë, fisin e gruas **e ke mik**, fisin e shokut **e ke shok**, të vëllamit **e ke vëllamë**, përkatësisht: **Shqiptarin e ke mik e vëlla mos pyet çfare feje ka?!**

Sa më sipër pyesim universndërgjegjen:

A nuk ishte vërtet, absurditet e vërteta e përdhosur kundër shqiptarëve aso kohe, **kur te ne në Kosovë (Serbi e vërtetë!!!!) poturët (shqipfolës) me dhjeta mijë llogariteshin serbë, në të njëjtën periudhë nga Principata e Mretnia serbe, me qindra mijë të tillë, dhe pse shqipfolës, dëboheshin barbarisht, nga trojet e veta shekullore, si turq?!**

Edhe ky konstatim absurd nuk është i parëndëshëm për ata që duan me dijtë të vërtetën rreth fajtorësisë, apo jo?!

Si vërtetim që ata **poturë**, të llogaritur *serbë të islamizur!*, sidomos në Kosovë, e kudo, vërtet ishin rrënjësisht shqiptarë joserbë, dëshmohet edhe nga vetë fakti, sepse ndërkohë edhe pas 100 vjet sundimi të kishës e pushtetit serb (1912-1999), askush prej tyre në Kosovë, as nga muhaxherët që ishin dëbuar si turq(!) e as nga jerlitë të cilët Milojević i kishte llogaritur serbë(!!), përkundër privilegjeve e presioneve nuk u shkombëtrarizua, as në turq as në serbë as me zakone as me gjuhë.

Prandaj, prej kësaj që u përmend rrjedh e vërteta që shqiptari, nga burrnia, nga kultura e tij e ravijëzuar me shekuj e etapa, nuk urren asnjë popull, as popullin serb, edhe pse tash dy shekuj qeveritë fetaronacionaliste albanofobe serbe kanë hartuar e janë përpjekur me i zbatue me dhjetra projekte (40) për shfarosjen e shqiptarëve, për çka është në dijeni mbarë bota, apo jo?!

III. “Rreth reflektimit kontaminues të koncepteve të termave: *shklavë (sclav/us) e *sherb/ë (serv/us) si etni dhe shkizmë (scissm) si dukuri në gjuhën shqipe”, është titulli i kreut të tretë, i cili është shtjelluar në tre nënkrerë.

Para se të përsërisim ndonjë konstatim, për të hyrë menjëherë në të veçantat e analizuara në punim, këtu po japim paraprakisht Pasqyrzën e trajtave të tilla në përdorim në disa gjuhë:

Pasqyrza e fjalëtermave: sclavus e slave, servus +folja dhe scisma

I. a. shklav (rob) e **b. sllav** (etni) / **II. serb** +folja

III. shkizmë

	lat.	sclavus			servus		scisma
(sciss/us!)							
schism	angl.	sclave	/	slave,	/	serbe	(to) serve
schisme,	fr.	esclave	/	slav,	/	serbe	servir
scisma	it.	schievo	/	slavo,	/	serbo	servire
Schisma	sp.	esclavo	/	eslavo,	/	servio	servir cisma
schisma	gjer.	Sklave	/	Slawe,	/	Serbe	(zu) dienen
schisma	hol.	slaaf	/	slaaf	/	serbier	bedienen
šizma, raskol	sll.	rob (sklaven?)	/	slaven ose sloven	/	srbin	sluziti
shkizma	shq.	*shklav (skllav)	/	sllav	/	serb (*sherb)	me shërbye

shërbyes e shërbëtor

Pa hyrë në detaje, siç po shihet, trajta e fjalës e gjuhës shqipe del e implikuar në ndërndikim që në fillimishte me trajtën e latinishtes a lashtogrekes dhe të sllavishtes, andaj në shqipen iliro-dardano-arbnore të kohës (shek VII-XV) ndeshim barasvlerësit: ***shklav**, ***sherb**, ***shkizm**, ndaj trajtave strikt të latinishtes standarde: sclav/us, serv/us, scissm/o. Së këtejmi në shqipe si gjuhë e gjallë dalin zhvillim-ndryshimet përkatëse: *nj.* shklav- shkjav –shkav/ell, shkjav, shkja shka *sh.* shkje shqe, shkii, shkije; shkieini, shkinë e variante të tjera. Madje edhe folja nga Sherb- (lat servus, servir/er) **sherbej me shërbye**, është tjahtë e asaj kohe, siç

dalin të gjitha trajtë-emërtimet nga rubrika I.a. shkllav në gjuhët përkatëse që kanë të bëjnë me nocionin fillestar të **skllavit**, ashtu siç emërtoheshin sllavo-barbarët ardhacakë në Siujdhesën Ilirike (Ballkan) në Perandorinë Romake, konkretisht **sllavë-skllavët**. Së këndejmi në sllavisht shpjegohet ajo periudhë me emrin *rob robovlasnistvo*, e në shqip: *skllav (rob) epoka sklavopronare*, ndërsa emëtimet nga rubrika I.b **sllav** janë më të vona, kur u ndryshoi emërtimi në sllav, ashtu ndodhi edhe në shqipe, por në shqipe emërtimi i vjetër **shklav shkja shkije** etj, u ndërlidh me konceptin e **shkizmës**, sidomos trajta e shumësit, andaj me këtë emën quheshin të gjithë skizmatikët (ortodoksët) edhe shqiptarët (ortodoksë shqipfolës), por te ne ndodhi edhe një dukuri tjetër e re: individë e turma që ende nuk ishin serbizuar gjuhësisht, *mbase me pahir*, shpëtuan gjuhën dhe njëherazi shpëtuan etninë nga shkombëtarizimi, duke u islamizuar, më fort formalisht, çështje kjo e diskutueshme që do të trajtohet më në hollësi në kreun tjetër, por sidoqoftë në këtë krye u shihet shumë për të madhe hartuesve të parë të lesikografisë shqipe, të cilët, *mbase me pahir* lajthitën, nga mosdallimi i vëllezërve ortodoksë shqipfolës, jashtë sferës katolike e islame, ndaj atyre serbishtfolës në të ashtuquajturën Serbi (Servi, Shërbi) ngase për mungesë të atij koncepti, ndarje mbi bazë gjuhe, është ndikuar tejet negativisht në serbizimin e shqipfolësve të paislamizuar jo vetëm atëherë, por kjo ka lënë pasoja deri në ditët tona. Nga studimi ynë të trija këto trajta **shkllav** (sclav), **sherb** serb (serv) dhe **shkizmë** (scissm) në ndonjë mënyrë (Ke parasysh vetëm dallimin Sh/S nistore.), kanë pasur ndërndikim në latinishten (vulgare ose jo) e sidomos në serbishte në formëzimin e trajtave përkatëse, të cilat në mos nën ndikimin e shqipes gjithsesi janë formëzuar nën praninë e drejtpërdrejtë të gjuhës shqipe, andaj rreth kësaj dukurie në dy nënkrerët e fundit të këtij këtij kreu kemi dhënë mjaft prova që mund të diskutohen, por jo, assesi, nuk mund të mohohen.

IV. Në kreun IV, me titull “Injorimii gjuhës shqipe në Arbëri gjatë periudhës së sundimit osman, raporti turko-shqiptar/sllavo-shka dhe pasojat fatale, ndaj shqipfolësve nga shkizma e re ose me sa pasoja mbijetoi shqipja nga presionet e autoqefalive shqiptarofobe ortodokse dhe nga turko islamizimi fanatik osman”, lënda është shtjelluar në dy nënkrerë.

Në nënkreun e parë konstatohet se para pushtimit nga Perandoria e Osmanëve shqiptarët pikërisht në Siujdhesën Ilirike (Ballkan) u gjenden të ndarë në dy ritet kristiane, në njërën anë më shumë vise hapësinore në

ritin ortodoks bizantin, ndërsa në anën tjetër disa vise bregdetarë e veriorë në ritin romanokatolik, ndërsa serbët, kryesisht, jo me kuptim të sotëm njënacional po rajonal multinacional, me formimin e autoqefalisë së tyre (tribale) pas disa lëkundjeve gjatë dinastisë nemane ishin konsoliduar në ritin ortodoks (pravosllav), ku kishin përthithur ortodoksë shqipfolës e të tjerë. Kështu në rezistencat e para kundër Osmanëve serbë e shqiptarë u gjendën, si me thënë, të identifikuar në Kosovë e gjithëkëndej si të krishtenë ortodoksë, por edhe si shqiptarë të identifikuar veçan pas rënies së dinastisë nemane, ngase shumë fisnikë të identifikuar shqiptarë (albarez si muzakajt, pjesërisht dukleotët, ballshët, dukagjinët) u orientuan nga Perëndimi, u bashkuan me trevat malësorekatolike, duke pranuar katolikizmin, madje nga Jugu e gjithandej vepronin unitë ortodoksë, që vazhdonin ta respektonin Papatin. Sidoqoftë, në Besëlidhjen e Lezhës 1444, nën udhëheqjen e Skënderbeu disa principata shqiptare u bashkuan duke shkrirë veprimtarinë që deri atëherë vepronin si të pavarura ose si vasale, ndaj perandorive përkatëse, qoftë bizantne, bullgare, serbe, qoftë asaj osmane. Kështu nën komandën e Skënderbeut të gjithë shqiptarët (arbnorë, maqedonë, dukleotë, epirotë) si një trup i vetëm etnik shqipfolës (katolikë, ortodoksë, unitë e sektomuslimanë) të të gjitha krahinave deri edhe Mali i Zi ishin të bashkuar, andaj edhe patën sukses në identifikimin e njohjen e shtetit shqipfolës të Skënderbeut në botën Perëndimore, miqësi e ndikim ky që vazhdoi edhe pas vdekjes së Skënderbeut

Në të vërtetë pas vdekjes së Skënderbeut, sulltan Mehmet – Fatihu, nip e mik i shkje-serbëve, mori masa drastike kundër shqiptarëve, ndër të tjera me ferman e pati ndaluar gjuhën shqipe si gjuhë komunikimi, deri edhe jeniçerëve paturu-oglanë në takim me familjarë(!).

Së këltejmi, në ato kushte shqipfolësit për mbijetesë u detyruan që një pjesë katolikësh e unitësh të shpërngulen drejt Perëndimit, disa zgjodhën jetën e vështirë në malet e pashkelura shqiptare; një pjesë tjetër e konsiderueshme vazhdoi përqaftimin e islamit që kishte filluar më parë mbase edhe formalisht, po dikush prej tyre u detyrua të shpëngulej drejt Lindjes, brenda asaj perandorie. Ndërkaq, ajo që zgjon interes dhe që la pasojë të rënda brenda truallit arbnor si dukuri është që një pjesë gjithashtu e konsiderueshme ortodoksish, që nuk u pajtuan me islamizim u fut nën ombrellën e autoqefalive sllave (serbe, bullgare) po edhe të asaj vllahorumune e greke, sepse këto autoqefali kishin imunitet të garantuar me ferman sulltani në emër a nën hijen e Patrikanës aleate. Kjo dukuri

përçarëse e shqipfolësve nga halli në punim tonë, duke përfshirë të gjithë shqipfolësit që u daktisen kah sytë këmbët, quhet **shkizmë e fatale ndaj shqipfolësve**, sepse të shpërngulurit në Perëndim e në Lindje të shkëputur nga trunghi i atdheut, larg trevave shqipfolëse, ishin të dënuar ndërkohë me shkombëtarizim, kurse ata që iu bashkuan autoqefalive i priste dhe me e keqja: **shkiezimi**, në serb , bullgar, grek, rumun, ose për pjesë rebele sektoarabo-turko-islame të turkoosmanizohej në etni të caktuara, brenda asaj perandorie. Ehen E keqja më e madhe ndodhi që të shkyerit nga trunghi iliroshqiptar të urrehen e hasmohen shkieserbë e shkie grek me shqiptar, me bazën shqipfolëse me shqiptarët (muslimano-arbnorë). Kështu në situatë të tillë kur muslimanët zyrtarisht quheshin i **turko-osmanli**, katolikët **latinë** e ortodoksët sipas autoqefalive: **serbë, bullgarë e grekë**, emrat: **arbër, arban, epirot, maqedon, dukleot**, edhe pse shqipfolëse, nuk përfaqësonin etni unike. Pikërisht në këtë kohë, situatë e përmjegullt, ndër shqipfolës tash shumica muslimane, u shfaq, apo u rishfaq emërtimi **shqiptar**, si zëvendësim i emrit *arbër*-albanez e të tjerë.

Si duket fjalë-emri **shqip shqiptar** u përfaqua vullnetshëm, jo vetëm nga masa e shqiptarëve të islamizuar (mbase formalisht) për nevoja të brendshme e eklzistebciale, sepse me këtë emërtim shqipfolësit i eskivuan shpatës së turqizimit të plotë, sepse njëherazi ruanin gjuhën shqipe, tapitë e pasurive për mbijetesë, ruanin rendin e fiseve, mitet e zakonet, andaj këtij emërtimi etnik iu bashkuan po vullnetarisht arbërit katolikë si dhe ortodoksët epiroto-maqedonë unitë e të tjerë që ende nuk ishin infektuar masivisht nga gjuha e predikimit të kishës që i takonin.

E kësaj kohe është edhe rishfaqja, (trajta e fjalës **shki/je** nga shklavë (me kuptim të specifikuar, kështu quheshin skizmatikët që mbulonte kisha sllave. Fjala shka shkije vinte vinte si kontaminin i dy termave të shqipes së hershme, njëjësi: ***shklav** (shkja **shka**) për konceptin **sllav** (skllav) dhe fjalën **shki/z/më-a**, si dukuri sipas konceptit të ndarje-përçarjes, të *shkyerët* nga trunghi. Dhe së këndejmi edhe sot kemi njëjës–shumës, jo aq model edhe në dialekt **shka/shqa**) – shki/je shkau **shkiet e shkitë /shqetë**.

Ne, duke gjetur si shkas veprën e Milosh Milojeviqit që e kemi në vlerësim kritik, i cili shqiptarët si etni i quan **shkip** dhe gjuhën e tyre **shkipe, shkipski jezik**, morëm në trajtim etimologjinë e emrit **shqiptar** që gjithsesi vjen nga fjala bazë: **shqip (shkip)**, fjalë kjo e identifikuar si ndajfolje, në veprën *Meshari* të Buzukut (1555), por e zbuluar dhe e studiuar shumë më vonë, kur fjala **shqipe shqiptar Shqipni** ishte

përqafuar si etni nga mbarë bota shqiptare pararilindëse, por që mori hyjnizimin si fjalë-koncept nga intelektualë tanë rilindës.

Në punim shprehet rezervë ndaj supozimit se trajtë-folja **shqipoj** e së andejmi etnonimi **shqiptar** vinin nga folja latine **excipere** (ek/s +kip +ere, skip-shkip +ere – oj – shkipoj –shqipoj (k/q) shqip –tar, për këto dy arsye:

E para, ishte e pa mundur që një fjalë latinë të jetë përqafuar aq me zemër, kur islamizimi ishte në kulm e ajo nuk fjalë nuk ishte e natyrës arabo-turko-persiane, as bizantino-greke, po fjalë e kryqalive! latinë! dhe

E dyta, siç po shihet sipas sistemit eptimor për emrin **shqiptar**, vetvetiu imponohet jo trajtë-folja shqip/oj (ek[skip/ere), po trajta e fshehur temëprodhuese ekzistuese foljore: **shqip**, e cila mund të ishte shfaqur në përdorim më parë ashtu si edhe sot si fjalë njërrrokëshe (monosilabike), e cila fillimisht patjetër ishte polisemantike, përdorej si folje, ndajfolje dhe si emër, mbiemër etj. Shkenca e sotme dukurinë e till e argumenton. Pse fjala **shqip** e **shkip** ndeshet e ndeshet me shpërndërrim të tingujve **k/q**, është një fenomen i brendshëm i shqipes që kuptohet lehtë, andaj këtu nuk do të diskutohet.

Për mendimin tonë emërformimi dhe koncepti veprim-ekzistim i emrit **shqiptar** ndërtimisht shpjegohet nga trajtë-folja **shqip, me shqipë, me folë shqip**, ndërsa me foljen **shqipoj me shqipue** shprehet veprim, **shqiptari** si veprues.

Ndërkaq në nënekreun e dytë pasi konstatohet pështatshmëria e emrit **shqiptar** si term shpëtues homogjen për shqiptarët: muslimanë, katolikë e ortodoksë e të tjerë, u përqendruam rreth prejardhjes së fjalës shkip shqip **shqiptar**. Për këtë etimologji janë shprehur afro 20 hipoteza që nuk e rrahin keq çështjen, por asnjëra ende nuk kënaq logjiko-shkencërisht. Edhe ne përveç fjalëfoprmimit të fjalës **shqip shqiptar** e prekëm etimologjinë e saj. Studiuesit para nesh këtë fjalë e ndërlidhin nga fjalë-rrënja sanskrite ***Skel.P-** me kuptim *copë druri*, send a vegël së shkop, të cilën, fjalën **shkop**, me tingullpërmbajtjen e saj shqipfolësi e përdori si mjet pune, po edhe si mjet mbrojtjeje e sulmi.

Në këtë kontekst, na imponohet pikërisht nocioni i shkopit edhe në trajtën **shkip-i**. Studiuesi Aristidh Kola, kopnstaton se nga gjuha e pellazgoiliro-shqipe e Homerit koncepti i shkopit del i shprehur në trajtën **skipion, skipro** (lexo **shkip-ion shkip-tro**) që po përkon me bazën e emrit e të foljes **shkip / shqip** që e trajtuam më sipër me dallim **k/q**. Mirëpo në burime të tjera të dyja trajtat **shkopi** dhe **shkipi**, siç do të shohim, i

ndeshim për të njëjtin koncept, me dallmi **o/i** . Po i përmend disa burime, ku imponohen këto trajta, sidomos fjala në trajtën **shkip**, si emër sendi, mjeti, jo vetëm në gjuhën tonë, po edhe në gjuhë të huaj, por edhe me kuptim figurativ e me zgjerim kuptimi.

Së pari, për shenmbull në fjalorin latinisht shqip ndeshëm trajtë-fjalën *scipion* - *shkop*, *spektër* si dhe *scopa* – *thupër*, shkop i hollë, ashtu ndeshim të dyja trajtat edhe te Nikollë Keta e Nezir Myrta. Që këto trajta me **o shkop** dhe me **i shkip** janë përdorur përtë njëtin koncept ose të përafërt sinonimik masivisht kemi shembullin nga Fjalori i Kolec Topallit, i cili sjell shembullin **shqipij** për **shkopij**, madje edhe në fjalorin e Mehmet Elezit ndeshim tri raste të diskutueshme.

Së dyti, për më tepër pa ose me trajtën a konceptin shkop dy trajtat: **shkip** e **shqip** e ndeshim në dhjeta burime me kuptim figurativ a të zgjeruar. si

